



**UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I DREJTËSISË
DEPARTAMENTI I SË DREJTËS CIVILE**

**DISERTACION
PËR MBROJTJEN E GRADËS SHKENCORE
“DOKTOR”**

**SHOQËRITË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
NË SHQIPËRI**

Punoi : Fatri ISLAMAJ

**Udhëheqës Shkencor
Prof. Dr. Kudret ÇELA**

TIRANË, 2021

Abstrakti

Ky punim doktrature ka si qëllim të evidentojë zhvillimin në realitetin shqiptar të *shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar*, si lloji më i përhapur i shoqërive tregtare në vendin tonë. Punimi paraqet një analizë historike dhe të evoluimit të shoqërive me përgjegjësi të kufizuar në periudha të ndryshme. Për shkak të rëndësisë së madhe që ka kjo formë organizimi e sipërmarrjeve tregtare në vendin tonë, është synuar që të bëhet një analizë e plotë juridike e të gjitha elementeve të shoqërive me përgjegjësi të kufizuar. Një rëndësi e veçantë i kushtohet analizës së detajuar të legjislacionit në fuqi lidhur me: i) rolin dhe elementet thelbësore të shoqërive me përgjegjësi të kufizuar; ii) organizimit dhe mënyrës së funksionimit të tyre; iii) marrëdhënieve që krijohen mes vetë këtyre subjekteve dhe ortakëve që i themelojnë ato; iv) marrëdhëniet mes ortakëve dhe organeve drejtuese të shoqërive; si dhe v) të drejtat dhe detyrimet e ortakëve të këtyre shoqërive. Nëpërmjet një analize të imtësishme juridike, evidentohen problematikat e hasura në praktikën gjyqësore shqiptare në funksionimin e këtyre shoqërive tregtare, si dhe zhvillimet më të fundit të jurisprudencës në këtë fushë. Gjithashtu, punimi ofron një analizë krahasimore me subjektet e tjera të së drejtës tregtare duke evidentuar aspektet më favorizuese të kësaj forme organizimi të sipërmarrjeve tregtare në raport me format e tjera të parashikuara nga legjislacioni në fuqi. Në të njëjtën kohë, punimi përmban konkluzione dhe rekomandime të vlefshme, të cilat u adresohen komuniteteve dhe institucioneve të ndryshme si: i) studiuesit e së drejtës dhe ekspertët e kësaj fushe; ii) strukturat shtetërore të përfshira në procesin e hartimit të ligjeve dhe akteve nënligjore; iii) organet ligjzbatuese përgjegjëse për zgjidhjen e konflikteve në shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar; iv) institucionet përgjegjëse për mbajtjen e regjistrit tregtar; v) institucionet fiskale; dhe vi) strukturat përkatëse që kanë për përgjegjësi ndërtimin e strategjive të zhvillimit ekonomik në vendin tonë. Ky studim sjell analiza dhe njohuri të vlefshme e të dobishme, për qytetarët që duan të njihen me veçoritë e kësaj forme të organizimit të biznesit, ortakët e tyre, administratorët, të punësuarit dhe çdo subjekt tjetër që ka interes për organizimin e nje shoqërie me përgjegjësi të kufizuar.

Fjalë kyçe: shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, person juridik, asambleja e ortakëve, kapital, fitim, likuidim, falimentim.

Abstract

This thesis aims to highlight the development of the limited liability company in the Albanian reality, as the most widespread type of companies in Albania. The study contains a historical analysis regarding the development of legislation for limited liability companies. Due to the great importance of this form of organization of commercial enterprises in our country, it is intended to make a comprehensive legal analysis of all elements of limited liability companies. Particularly, the thesis provides a detailed analysis of the legislation in currently in force regarding: i) the role and essential elements of limited liability companies; ii) their organization and manner of functioning; iii) the relations established between these entities themselves and the partners who establish them; iv) relations between the partners and the governing bodies of the companies; and v) the rights and obligations of the partners of these companies. Through a detailed legal analysis, the problems encountered in the Albanian judicial practice concerning the functioning of these companies have been identified, as well as the latest developments in jurisprudence in this field. Also, this thesis provides a comparative analysis with other subjects of commercial law, highlighting the most favorable aspects of this form of organization of commercial enterprises compared to other forms stipulated by the Albanian legislation currently in force. The thesis contains valuable conclusions and recommendations which are addressed to various communities and institutions such as: i) legal scholars and experts in this field; ii) state structures involved in the law drafting procedure; iii) law enforcement bodies responsible for resolving conflicts in limited liability companies; iv) responsible institutions entrusted by law for maintaining the trade register; v) fiscal institutions; and vi) relevant structures that are responsible for building economic development strategies in Albania. This study brings valuable and useful analysis and knowledge for citizens who want to get acquainted with the features of this form of business organization, their partners, administrators, employees and any other entity that has an interest in organizing a society with limited liability company.

Keywords: Limited Liability Company, Legal Entity, General Meeting, Capital, Liquidation, Insolvency

Tabela e Përmbajtjes	
Abstrakti	ii
Abstract	iii
Falënderime	vi
Akronime	vii
Lista e Figurave	viii
1. Hyrje	1
1.1. Hyrje rreth temës së doktoraturës.....	1
1.2. Qëllimi i studimit	3
1.3. Pyetjet kërkimore bazë për këtë punim	5
1.3. Rëndësia e punimit	5
1.4. Kufizimet e punimit	7
1.5. Metodologjia e punimit	8
1.6. Struktura e Punimit.....	9
2. Zhvillimi Historik i Shoqërive me Përgjegjësi të Kufizuar në Shqipëri	11
2.1. Hyrje.....	11
2.2. Origjina Historike e Shoqërive me Përgjegjësi të Kufizuar në Lashtësi.....	11
2.3. E drejta islame dhe shoqëritë tregtare para Mesjetës	15
2.4. Periudha e Mesjetës dhe shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar.....	18
2.5. Realiteti shqiptar deri në vitin 1932	22
3. Evoluimi i legjislacionit shqiptar për Shoqëritë me Përgjegjësi të Kufizuar	24
3.1. Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar gjatë periudhës së monarkisë në Shqipëri ...	24
3.1.1 Kodi Civil i vitit 1929.....	25
3.1.2. Kodi Tregtar i vitit 1932.....	37
3.2. Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar në periudhën 1944 - 1991 dhe aktet normative të kësaj periudhe.....	59
3.3. Zhvillimi i shoqërive me përgjegjësi të kufizuar në Shqipëri pas vitit 1991 dhe aktet normative që shërbyen në këtë periudhë	63
3.4. Risetë që solli ligji nr.7638, datë 19.11.1992 “Për shoqëritë tregtare” dhe zhvillimi shoqërive me përgjegjësi të kufizuar në bazë të këtij ligji	71
4. Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar si Subjekt i Pavarur i së Drejtës dhe Karakteristikat e Veçanta të saj	86
4.1. Llojet e shoqërive tregtare.....	86
4.2. Personaliteti juridik i veçantë i shoqërive tregtare	88
4.3. Zotësia juridike e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar	91
4.4. Karakteristika të veçanta të shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar	93
4.4.1. Qëllimi i themelimit të një SHPK-je	93
4.4.2. Koncepti i përgjegjesisë së kufizuar të ortakëve të një SHPK-je	94
4.4.3. Kufizimet e përgjegjesisë së kufizuar.....	96
4.5. Veçoritë e shoqërisë së thjeshtë në dallim nga shoqëria me përgjegjësi të kufizuar	108
4.6. Veçoritë kryesore të SHPK-së në dallim nga shoqëritë e personit	113
4.7. Dallimi i SHPK-së në raport me Shoqërinë Kolektive	114
4.8. Dallimi i SHPK-së në raport me Shoqërinë Komandite	124
4.9. Dallimi i SHPK-së në raport me shoqërinë Aksionare	128
5. Themelimi i Shoqërive me Përgjegjësi të Kufizuar sipas Ligjit në Fuqi	136

5.1. Procedura e regjistrimit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar	136
5.2. Pasojat e regjistrimit.....	139
5.3. Statuti i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar.....	140
5.4. Elementet thelbësore të statutit dhe autonomia statutore	143
5.5. Kapitali në një SHPK.....	148
5.6. Pavlefshmëritë e themelimit të shoqërive me përgjegjësi të kufizuar.....	150
5.6.1. Pasojat e pavlefshmërisë.....	155
5.6.2. Efekti i vendimit gjyqësor	161
6. Administrimi i Shoqërive me Përgjegjësi të Kufizuar dhe Organet e saj sipas Ligjit në Fuqi.....	164
6.1. Hyrje.....	164
6.2. Kompetenca dhe përgjegjësitë e administratorëve	165
6.3. Marrëdhënia mes administratorit dhe shoqërisë.....	167
6.4. Kushtet për të qenë administrator.....	174
6.4. Mandati i administratorit.....	175
6.5. Asambleja e Ortakëve	176
6.5.1. Kompetencat Asamblese së Ortakëve (AO).....	176
6.5.2. Mbledhjet e Asamblesë së Ortakëve	180
6.5.3. Procedurat e thirrjes së Asamblesë së Ortakëve	185
6.5.4. Kuorumi dhe votimi në mbledhjen e Asamblesë së Ortakëve.....	187
7. Të Drejtat e Ortakëve në një SHPK dhe Aspekte të Veçanta të Marrëdhënieve mes tyre sipas Ligjit në Fuqi.....	190
7.1. Hyrje.....	190
7.2. E drejta e votës së ortakëve në asamble	190
7.3. Përjashtimi nga e drejta e votës.....	192
7.4. Pjesëmarrja në kapitalin e shoqërisë, kuota	195
7.5. Kuota	197
7.6. Transferimi i kapitalit, e drejta e parablerjes.....	201
7.7. E drejta e pjesëmarrjes në fitimet e shoqërisë (dividenti)	203
7.8. E drejta e pjesëmarrjes në shpërndarjen e tepicës së likuidimit.....	208
7.9. E drejta e informimit	209
7.9. Largimi dhe Përjashtimi i ortakëve	210
7.9.1. Largimi i ortakut nga shoqëria, koncepti, procedura.....	211
7.9.2. Përjashtimi i ortakut.....	219
8. Prishja e Shoqërisë, Likuidimi dhe Falimentimi i saj	234
8.1. Shkaqet e prishjes së SHPK-së.....	234
8.2. Likuidimi i SHPK-ve	238
8.3. Falimentimi i SHPK-ve.....	249
9. Konkluzione dhe Rekomandime.....	260
Bibliografia	282

Falënderime

Në përfundim të këtij punimi, në fushën e të drejtës së shoqërive tregtare dhe konkretisht në zhvillimin e shoqërive me përgjegjësi të kufizuar në Shqipëri, dua të shpreh mirënjohjen time për familjen, miqtë dhe kolegët që më kanë mbështetur në këtë rrugëtim plot sfida.

Një falënderim i veçantë dhe shumë mirënjohje i drejtohet udhëheqësit shkencor, Prof. Dr Kudret Çela, për sugjerimet, komentet, dhe vërejtjet e tij të çmuara në funksion të përmirësimit të kësaj pune kërkimore.

Gjithashtu një falënderim i veçantë u drejtohet profesorëve të Fakultetit të Drejtësisë së Universitetit të Tiranës, të cilët nëpërmjet sugjerimeve që më kanë dhënë, më kanë mbështetur në realizimin e kësaj teme doktorature.

Mirënjohja ime më e sinqertë, u drejtohet dhe stafit me të cilin kam punuar gjatë periudhës që kam ndjekur dhe studimet doktorale, për gatishmërinë e tyre në drejtim të komenteve dhe sugjerimeve rreth të dhënave empirike të vlefshme që kontribuan në realizimin e këtij kërkimi shkencor.

Akronime

AMF - Autoriteti i Mbikëqytjes Financiare

AO - Asambleja e Ortakëve.

AP – Asambleja e Përgjithshme

BSH - Banka e Shqipërisë

GJEDNJ – Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut (Strasbourg)

K.T. 1932 – Kodi Tregtar i vitit 1932

KC - Kodi Civil

KP - Kodi i Punës

KPrC - Kodi i Procedurës Civile

KT – Kodi Tregtar

Ligji 7638/1992 - Ligji Nr. 7638, datë 19.11.1992, “Për shoqëritë tregtare” i shfuqizuar.

Ligji 9723/2007 – Ligji Nr. 9723, datë 3.5.2007, “Për Qendrën Kombëtare të Biznesit” i ndryshuar

Ligji 9901/2008 - Ligji nr.9901 datë 14.04.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” i ndryshuar

QKB - Qendra Kombëtare e Biznesit

QKR - Qendra Kombëtare e Rregjistrimit

SHA – Shoqëri aksionare

SHPK – Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar

Lista e Figurave

Figura 1: Numri dhe vëllimi i shprehur në përqindje i shoqërive tregtare në Republikën e Shqipërisë nga viti 1992 e deri më Tetor 2020 3

Figura 2: Numri dhe vëllimi i shprehur në përqindje i shoqërive tregtare në Republikën e Shqipërisë nga viti 1992 e deri më Tetor 2020 116

Figura 3: Numri dhe vëllimi i shprehur në përqindje i SHPKve aktive dhe çregjistruara në Republikën e Shqipërisë deri më Tetor 2020 117

Figura 4: Numri dhe vëllimi i shprehur në përqindje i shoqërive tregtare në Republikën e Shqipërisë nga viti 1992 e deri më Tetor 2020 253

KREU I

1. Hyrje

1.1. Hyrje rreth temës së doktoraturës

Në Shqipëri, që pas Luftës së Dytë Botërore, u instalua një sistem politik diktatorial, në të cilin, për disa dekada me radhë, u zbatua një ekonomi e centralizuar dhe e kontrolluar totalisht nga shteti. Me ndryshimet demokratike të vitit 1991 e në vijim, ka filluar instalimi i një sistemi ekonomie të tregut të lirë, ku një rol të rëndësishëm e zënë marrëdhëniet ndërtregtare dhe iniciativa e lirë private e sipërmarrjeve tregtare. *Në sistemin demokratik të bazuar mbi ekonominë e tregut, është e garantuar edhe liria e sipërmarrjes tregtare si pjesë e të drejtave themelore të njeriut, të sanksionuara në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, dhe gjithë korpusin ligjor shqiptar. Në funksion të kësaj lirie për të kryer çfarëdo lloj aktiviteti tregtar të lejuar nga ligji, janë krijuar të gjitha mjetet për të vepruar në një treg pa kufij, të brendshëm dhe të jashtëm dhe për të kryer sipërmarrje të larmishme nga më të thjeshtat deri tek ato më komplekset.*

Në kryerjen e aktivitetit tregtar, si në çdo marrëdhënie tjetër juridiko–civile njëri nga elementet e domosdoshme janë subjektet e këtij aktiviteti. Në këtë kontekst është e qartë që sa më shumë sipërmarrje të operojnë në hapësirën shqiptare, aq më shumë mundësi ka për t’u zgjeruar, forcuar dhe konsoliduar ekonomia e vendit. Në gamën e subjekteve që regjistrohen në Qendrën Kombëtare të Biznesit vendin kryesor e zënë shoqëritë tregtare, të themeluara pas ndryshimeve demokratike të vitit 1991 me miratimin e Ligjit për Dispozitat Kryesore Kushtetuese.¹

Ligji në fuqi për tregtarët dhe shoqëritë tregtare (9901/2008), është një ligj bashkëkohor dhe i përgatitur në përputhje me parimet e legjislacionit evropian në fushën e shoqërive tregtare. Në mënyrë të veçantë ky ligj ka përvetësuar detyrimet e Direktivës së Parë të Këshillit të Evropës,² por edhe direktivave të tjera të BE për shoqëritë tregtare. Ky punim është thelluar veçanërisht në njohjen dhe analizimin e subjektit më të përhapur në marrëdhëniet tregtare në Shqipëri, që janë shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar, duke

¹ Ligji 7491/1991 “Për Dispozitave Kryesore Kushtetuese” [1991] FZ 4. Nenin 10 të tij përcaktohej: *“Ekonomia e vendit bazohet në shumëllojshmërinë e pronave, iniciativën e lirë të të gjitha subjekteve ekonomike në rolin rregullues të shtetit. Iniciativa ekonomike e personave juridikë dhe fizikë nuk mund të zhvillohet në kundërshtim me interesin shoqëror dhe nuk duhet të cenojë sigurinë, lirinë dhe dinjitetin e njeriut.”*

² First Council Directive 68/151/EEC of 9 March 1968 on co-ordination of safeguards which, for the protection of the interests of members and others, are required by Member States of companies within the meaning of the second paragraph of Article 58 of the Treaty, with a view to making such safeguards equivalent throughout the Community [1968] OJ Special edition.

shpjeguar mënyrën e themelimit, funksionimit dhe marrëdhëniet që lindin te këto shoqëri, si lloji më i aplikuar i organizimit të sipërmarrjeve tregtare në vendin tonë.

Rritja e numrit të shoqërive tregtare që ushtrojnë një larmishmëri të pafund sipërmarrjesh tregtare ndikon drejtpërdrejt në rritjen e Produktit të Përgjithshëm Kombëtar (GDP), si treguesi më i rëndësishëm i zhvillimit ekonomik të një vendi. Zhvillimi i shoqërive tregtare që operojnë në mënyrë të suksesshme, ndikon në rritjen e mirëqenies ekonomike dhe përmirësimin e nivelit ekonomik dhe kulturor të qytetarëve shqiptarë dhe në uljen e papunësisë në vend. Për pasojë, kjo është e lidhur drejtëpërsëdrejti me mirëqenien ekonomike të çdo qytetari, si dhe zhvillimin dhe prosperitetin e gjithë shoqërisë.

Shoqëritë tregtare padyshim zënë peshën më të madhe të sektorit privat në ekonomi. Koncepti i aktivitetit “tregtar” nënkupton çdo veprimtari me anë të së cilës ofrohen produkte (mallra) apo shërbime në treg, me qëllim fitimin.³ Sipas studimeve ekonomike rezultojnë se sektori privat luan rolin kryesor në zhvillimin ekonomik të vendit. Ky sektor, i cili është në rritje të vazhdueshme, prodhon 75% të PBB (Produkti i Përgjithshëm Bruto) dhe punëson 83% të fuqisë punëtore në shkallë vendi.⁴ Siç do të konstatohet në vazhdim të këtij punimi, një fakt është që pjesa dërmuese e shoqërive tregtare që ushtrojnë aktivitetin tregtar në Shqipëri, nga viti 1992 e në vijim, janë organizuar në formën e shoqërive me përgjegjësi të kufizuar (SHPK).

Nga statistikat e Qendrës Kombëtare të Biznesit të vëna në dispozicion nga ky institucion me komunikimin elektronik të datës 16 tetor 2020 rezultojnë se në vitin 2020 në Regjistrin Tregtar të këtij institucioni figurojnë të regjistruara 58084 shoqëri me përgjegjësi të kufizuara. Ndërkohë që numri total i të katër formave të shoqërive tregtare është 60434 shoqëri. Pra, e shprehur në përqindje rezultojnë se më shumë se 96 % e të gjitha shoqërive tregtare të regjistruara në Regjistrin Tregtar janë të formës “Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar”.⁵ Si forma më e përhapur e shoqërive tregtare në vendin tonë, kjo lloj shoqërie meriton një vëmendje të veçantë dhe një studim të detajuar të të gjitha aspekteve të funksionimit të saj.


Grafikët më poshtë ilustrojnë vëllimin që zënë SHPK-të në raport me tri llojet e tjera të shoqërive tregtare sipas regjistrit tregtar të Qendrës Kombëtare të Biznesit. Ky institucion mban dhe regjistrat e shoqërive tregtare të themeluar në bazë të ligjit 7638/1992 të cilat janë transferuar ne QKR nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë në vitin 2008.

³ Baki Berberi, *Komente të ligjit Nr. 7638 dt. 19.11.1992 “Për Shoqëritë tregtare”* (Shtëpia Botuese Morava 2004), fq. 4.

⁴ Filipos Ruxho, *“Sfidat e bizneseve shqiptare në tregun e ardhshëm europian”* (Tezë Doktorature, Shkolla Doktorale Universiteti Europian i Tiranës, 2018), fq. 48.

⁵ Kthim përgjigje në format elektronik nga Qendra Kombëtare e Biznesit dt. 16.10.2020 (Drejtoria e Analizës dhe Regjistrave) kërkesës së autorit të këtij punimi paraqitur pranë QKB me Nr. 8640 prot., datë 24.09.2020.

Figura 1: Numri dhe vëllimi i shprehur në përqindje i shoqërive tregtare në Republikën e Shqipërisë nga viti 1992 e deri më tetor 2020



Burimi: Drejtoria e Analizës dhe Regjistrave (të dhëna të përpunuara nga autori)⁶

Rrugëtimi i zhvillimit të shoqërive me përgjegjësi të kufizuar në vendin tonë, nuk ka qenë i lehtë dhe është përballur me sfida të vështira në faza të ndryshme historike. Në këtë studim është bërë dhe një hulumtim i plotë lidhur me evoluimin e zhvillimit të shoqërive me përgjegjësi të kufizuar në vendin tonë dhe zhvillimi i tyre që në fazat e para të aplikimit të tyre, e deri në ditët e sotme.

1.2. Qëllimi i studimit

Ky punim doktore ka si qëllim të evidentojë zhvillimin në realitetin shqiptar të njërit prej katër llojeve të shoqërive tregtare dhe pikërisht të shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar. Në këtë punim do të analizohet shoqëria me përgjegjësi të kufizuar si subjekt juridik i së drejtës, qëllimi, mënyra e themelimit dhe funksionimit, ecuria e zhvillimit të tyre, si dhe evoluimi i legjislacionit për këto shoqëri në kontekstin shqiptar.

Ky punim synon të analizojë në aspekte gjithpërfshirëse (megjithatë jo shteruese) të gjitha karakteristikat dhe elementet e shoqërive me përgjegjësi të kufizuara, si lloji më i përhapur

⁶ Qendra Kombëtare e Biznesit, Drejtoria e Analizës dhe Regjistrave, *Informacion i gjeneruar nga regjistri tregtar - të dhëna statistikore*, kthim përgjigje datë 16 tetor 2020 në bazë të kërkesës së Doktorantit Fatri Islamaj protokolluar nga QKB me Nr. 8640 prot., datë 24.09.2020.

i subjekteve të së drejtës tregtare në vendin tonë. Gjithashtu, me anë të këtij punimi synohet të bëhet dhe një analizë krahasimore me subjektet e tjera të së drejtës tregtare duke evidentuar aspektet më favorizuese të kësaj forme organizimi të sipërmarrjeve tregtare në raport me format e tjera të parashikuara nga ligji për tregtarët dhe shoqëritë tregtare apo ligje të tjera, si dhe të bëhen rekomandime se çfarë mund të përmirësohet në këtë fushë.

Nëpërmjet studimit dhe analizës së bërë në këtë material doktriture, kam synuar të shpjegoj: i) rëndësinë e njohjes së kësaj forme organizimi të sipërmarrjeve tregtare; ii) organet e saj, si dhe mënyra e funksionimit të tyre; iii) marrëdhëniet që krijohen mes vetë këtij subjekti dhe ortakëve që e themelojnë atë; iv) efektet dhe ndikimi që japin këto subjekte te njëri – tjetri; si dhe v) rolin që luajnë shoqëritë më përgjegjësi të kufizuar në një sistem ekonomik të bazuar në "Ekonominë e tregut" dhe iniciativën e lirë tregtare në qarkullimin civil. Në këtë studim do të gjejmë të trajtuar të gjithë faktorët, elementet bazë dhe të tërthorta, që përbëjnë dhe luajnë rol të rëndësishëm në këtë kategori të subjekteve tregtare.

Në këtë punim përfshihet dhe një hulumtim i plotë lidhur me rrugëtimin historik të shoqërive me përgjegjësi të kufizuar në vendin tonë dhe zhvillimin e tyre që në fazat e para të aplikimit të tyre. Në funksion të këtij qëllimi është analizuar evoluimi i legjislacionit shqiptar lidhur me këtë formë shoqërie, në periudha të ndryshme historike që ka kaluar vendi ynë, nga vitet e Monarkisë Shqiptare e në vijim, uljet dhe ngritjet e tyre në këto periudha, duke vënë theksin në mënyrë të veçantë në zhvillimin e instituteve të tilla, si:

- (i) koncepti i personalitetit juridik të veçantë të shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar si subjekt më vetë me personalitet juridik të pavarur nga ai i subjekteve themelues që janë ortakët;
- (ii) qëllimi i krijimit të shoqërive me përgjegjësi të kufizuar;
- (iii) koncepti i përgjegjësisë së kufizuar të ortakëve ;
- (iv) marrëdhëniet që lindin mes ortakut dhe shoqërisë;
- (v) procedurat dhe efektet e regjistrimit në regjistrat publik;
- (vi) administrimi i shoqërive me përgjegjësi të kufizuar;
- (vii) e drejta e transferimit të kapitalit, dhe kushtet për vlefshmerinë e veprimit juridik në momentin e transferimit të kuotave
- (viii) ndërlidhja e këtyre subjekteve me kategori të tjera të subjekteve të së drejtës;
- (ix) problematikat në zbatimin e procedurave të falimentit të këtyre shoqërive në vendin tonë;
- (x) rëndësia që ka zhvillimi i suksesshëm i këtyre shoqërive në zhvillimin e ekonomisë së tregut etj.

Ky studim synon të na njohë me aspektet më atraktive të shoqërive me përgjegjësi të kufizuara, veçori këto të cilat e kanë bërë dhe formën më të përhapur të organizimit të sipërmarrjeve tregtare në realitetin shqiptar.

1.3. Pyetjet kërkimore bazë për këtë punim

Ky punim doktoral synon të japë përgjigje në mënyrë profesionale, dhe me ilustrime nga praktika pyetjeve të mëposhtme:

- a) Çfarë është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar?
- b) Si është zhvilluar shoqëria me përgjegjësi të kufizuar në aspektin historik në realitetin shqiptar, prejardhja e këtyre shoqërive që nga kohët më të lashta ?
- c) Cilat janë karakteristikat e veçanta të kësaj shoqërie?
- d) Çfarë është përgjegjësia e kufizuar e ortakut?
- e) Çfarë është heqja e petkut të përgjegjesisë së kufizuar e njohur në doktrinë si “*Piercing Corporate Veil*”?
- f) Në cilat raste aplikohet zhveshja e ortakut nga privilegji i përgjegjesisë së kufizuar?
- g) Nga dallon shoqëria me përgjegjësi të kufizuar nga subjektet e tjera të së drejtës tregtare?
- h) Cili është qëllimi i krijimit të kësaj shoqërie?
- i) Përse duhet të zgjedh si formë organizimi një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar?
- j) Cilat janë avantazhet e kësaj forme të organizimit të biznesit në raport me format e tjera?
- k) Cili është roli i shoqërive me përgjegjësi të kufizuara në ekonominë shqiptare?
- l) Si ka evoluar kuadri ligjor për shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar që në hapat e parë të njohjes së tyre në realitetin shqiptar?
- m) Si bëhet regjistrimi i një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar?
- n) Cilat janë të drejtat e ortakëve në këto shoqëri dhe si rregullohen marrëdhëniet mes tyre?
- o) Kur dhe si mund të aplikohen institutet e largimit dhe përjashtimit të ortakut?
- p) Si bëhet administrimi i shoqërive me përgjegjësi të kufizuar?
- q) Si bëhet prishja, likuidimi dhe falimentimi i shoqërive me përgjegjësi të kufizuar?
- r) Cilat janë problematikat ligjore, me të cilat ndeshen këto shoqëri në vendin tonë?
- s) Si mund të përmirësohet kuadri ligjor dhe nënligjor me qëllim mirëfunksionimin e shoqërive me përgjegjësi të kufizuar?
- t) Cila është praktika gjyqësore mbi çështjet e përmendura më sipër?

1.3. Rëndësia e punimit

Kam zgjedhur të kryej studime të thelluara mbi këtë temë, me qëllim ofrimin e kontributit tim modest, në një kuptim më të qartë të instituteve të ndryshme juridike që aplikohen në

shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar. Nga përvoja ime e gjatë në sistemin gjyqësor dhe në rrethet akademike të vendit, kam hasur jo pak raste në të cilat konfondohen koncepte juridike të rëndësishme të funksionimit të shoqërive me përgjegjësi të kufizuar, si për shembull; koncepti i personalitetit juridik të veçantë të shoqërise me përgjegjësi të kufizuar, kompetencat dhe përgjegjësitë e administratorëve, apo asamblesë së ortakëve, marrëdhënien juridike midis vetë ortakëve dhe shoqërisë, kompetencat e administratorit, pronësia mbi kuotën në një shpk, transferimi i saj, përjashtimi dhe largimi i ortakut, likuidimi apo procedurat e falimentimit të këtyre shoqërive.

Si rrjedhim, një njohje më e mirë e ligjit, por dhe e mekanizmave të funksionimit të shoqërive me përgjegjësi të kufizuar, do t'u vinte në ndihmë të gjithë subjekteve, të cilat tërheqin interesa nga këto shoqëri, dhe sidomos atyre që janë të angazhuar me administrimin dhe funksionimin e tyre, ortakëve të këtyre shoqërive, si dhe të gjithë subjekteve që hyjnë në marrëdhënie tregtare me to.

Në tri dekadat e fundit sipërmarrjet tregtare të organizuara në formën e shoqërive me përgjegjësi të kufizuar, kanë njohur një rritje të vazhdueshme. Për shkak lidhjes reciproke me subjektet e tjera, në fokus të këtij studimi do të jetë dhe krahasimi i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar me këto subjekte tjera të së drejtës tregtare dhe të së drejtës civile në përgjithësi. Krahasuar me tre format e tjera të organizimit të shoqërive tregtare që njeh ligji për tregtarët dhe shoqëritë tregtare, shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar pa dyshim zënë vendin kryesor për nga përqindja e shoqërive të regjistruara me një vëllim prej 96 % të numrit të të gjitha shoqërive që njeh ligji për shoqëritë tregtare.⁷ Referuar numrit të regjistrimeve në QKB si formë e vecantë e organizimit të sipërmarrjeve tregtare, shoqëria me përgjegjësi të kufizuar mund të krahasohet vetëm me "Tregtarin" si person fizik, i cili nuk kërkon një formë të posacme organizimi dhe nuk është shoqëri tregtare. Në vijim do të shtjellohet dhe dallimi mes këtyre dy formave të ushtrimit të aktivitetit tregtar.

Literatura shqiptare e trajtuar deri më tani, në dijeninë time, nuk ofron një analizë krahasimore të detajuar të legjislacionit për shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar në raport me të gjitha fazat e zhvillimit historik të tij, si dhe të veçorive të kësaj forme shoqërie në raport me subjektet e tjera të së drejtës tregtare.

Me besimin se çdo kërkim shkencor mbi këto tema nga akademikë dhe praktikantë të së drejtës, përbën një kontribut të vyer në konsolidimin e koncepteve sa më të qarta tek studiuesit, juristët, dhe praktika gjyqësore. Ky kërkim bën një përpjekje për të pasqyruar dhe qëndrimet e ndryshme të doktrinës dhe praktikës për çështje me rëndësi në fushën e

⁷ Kthim përgjigje në format elektronik nga Qendra Kombëtare e Biznesit dt. 16.10.2020 (Drejtoria e Analizës dhe Regjistrave) kërkesës së autorit të këtij punimi të paraqitur pranë QKB me Nr. 8640 prot., datë 24.09.2020.

shoqërive me përgjegjësi të kufizuar.

Edhe sistemi gjyqësor në Shqipëri, ka një praktikë relativisht të pasur për shumë aspekte dhe marrëdhënie juridike që krijohen në fushën e shoqërive tregtare, të cilat do të trajtohen në këtë studim. Por, në disa raste, për çështje të ngjashme lidhur me marrëdhëniet juridike që lindin në shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar, ka dhe qëndrime të ndryshme nga praktika gjyqësore. Për ilustrim sjellim si shembull, përcaktimin e natyrës së marrëdhënies që krijohet midis administratorit të një shpk-je dhe vetë shoqërisë, (të cilin do ta shtjellojmë gjatë këtij punimi në vijim) në diskutimin nëse kjo është një marrëdhënie pune apo një marrëdhënie që rrjedh nga një kontratë shërbimi. Megjithatë ende nuk ka një qëndrim unifikues nga Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë për këtë çështje.

Risia e këtij punimi është që ky studim ofron konkluzione dhe rekomandime të vlefshme, të cilat u adresohen komuniteteve dhe institucioneve të ndryshme, si: i) studiuesit e së drejtës dhe ekspertët e kësaj fushe; ii) strukturat shtetërore të përfshira në procesin e hartimit të ligjeve dhe akteve nënligjore; iii) organeve ligjzbatuese përgjegjëse për zgjidhjen e konflikteve në shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar; iv) institucioneve përgjegjëse për mbajtjen e regjistrimit tregtar; v) institucioneve fiskale; dhe vi) strukturave përkatëse që kanë për përgjegjësi ndërtimin e strategjive të zhvillimit ekonomik në vendin tonë.

Gjithashtu, studimi ofron analiza dhe njohuri të vlefshme e të dobishme, për qytetarët që duan të njihen me veçoritë e kësaj forme të organizimit të biznesit, ortakët e tyre, administratorët, të punësuarit dhe çdo subjekt tjetër që ka interes për organizimin e një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar

1.4. Kufizimet e punimit

Ky punim fokusohet në trajtimin dhe sqarimin, e koncepteve dhe parimeve bazë, mbi të cilat funksionojnë shoqëritë me përgjegjësi të kufizuara në Shqipëri, si dhe procedurat e nevojshme që kërkon legjislacioni për regjistrimin dhe themelimin e tyre, duke mos u thelluar në format e tjera të organizimit të biznesit në Shqipëri.

Përfshirja në këtë punim e tri tipeve të tjera të shoqërive tregtare, kufizohet vetëm në aspekte krahasimore dhe nuk ezauron të gjitha çështjet që lidhen me tri tipet e tjera të shoqërive tregtare, për të cilat akademikë dhe studiues të tjerë të nderuar kanë botuar punime shkencore, tekste apo leksione, që secili prej tyre ka vlerat e veta shkencore dhe teorike.

Fokusi veçantë i këtij punimi te forma e shoqërive me përgjegjësi të kufizuar në Shqipëri, lidhet pikërisht me vendin që zë kjo formë shoqërie në raport me format e tjera. Nga statistikat e Qendrës Kombëtare të Biznesit, kjo lloj shoqërie rezulton si forma absolutisht më e aplikuar për organizimin e biznesit në kategorinë e personave juridikë.⁸

1.5. Metodologjia e punimit

Metodologjia e përdorur për këtë punim shkencor, mbështetet në analizën e thelluar dhe krahasimore të legjislacionit për shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar në vendin tonë. Analiza krahasimore evidenton edhe evoluimin e këtij legjislacioni ndër vite.

Gjithashtu është aplikuar edhe metoda e rishikimit të doktrinës vendase dhe të huaj lidhur me temën e këtij kërkimi dhe evoluimi i doktrinës në këtë fushë, e ndërthurur kjo me metodat e analizimit të praktikës gjyqësore dhe zhvillimit të kësaj praktike në realitetin shqiptar.

Po ashtu, në këtë studim është vënë në zbatim metoda e kërkimeve statistikore dhe analiza e të dhënave statistikore, me qëllim krijimin e një panorame të qartë për vëllimin që zënë shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar në krahasim me format e tjera të shoqërive tregtare, si dhe me qëllim për të identifikuar rolin e këtyre shoqërive dhe impaktin e tyre në zhvillimin ekonomik të vendit. Procesi këtij kërkimi shkencor, është mbështetur te metoda cilësore e analizës së çështjeve dhe temave të trajtuara në punim. Metoda cilësore në vetvete, përfshin brenda saj metodën përshkruese, hulumtuese, interpretuese dhe atë krahasimore.

Metoda hulumtuese kryesisht është përdorur përgjatë mbledhjes së burimeve dhe materialeve, qofshin këto nga burime doktrinale apo legjislative dhe administrative, si në formën të shkruar, ashtu edhe në formë digjitale. Metoda e hulumtimit është zbatuar gjatë seleksionimit të praktikave gjyqësore shqiptare dhe të huaja, në funksion të identifikimit të problematikave dhe trendeve në raport me aspekte të ndryshme të temës së punimit. Në harmoni me metodën hulumtuese është ndërthurur dhe metoda analizuese e informacionit dhe të dhënave, po ashtu dhe metoda përshkruese, si një mekanizëm i domosdoshëm për sqarimin e koncepteve dhe termave të ndryshëm juridikë.

Nëpërmjet këtyre metodave është bërë përpjekja për t'i prezantuar lexuesit të punimit, të gjitha aspektet e zhvillimit të shoqërive me përgjegjësi të kufizuar në Shqipëri, si dhe të evidentojë rolin e madh që ka zbatimi me korrektësi i dispozitave ligjore në organizimin dhe mirëfunksionimin e këtyre shoqërive. Në këtë punim janë evidentuar qëndrimet më të

⁸ Kthim përgjigje në format elektronik nga Qendra Kombëtare e Biznesit dt. 16.10.2020 (Drejtorja e Analizës dhe Regjistrave), kërkesës së autorit të këtij punimi të paraqitur pranë QKB me Nr. 8640 prot., datë 24.09.2020.

konsoliduara të kërimit, si dhe hapësirat për përmirësim të instituteve të ndryshme juridike që lidhen me shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar në vendin tonë, në formën e konkluzioneve dhe rekomandimeve.

Përvoja e punës si gjyqtar më ka dhënë mundësinë që ta pasuroj këtë punim edhe me raste ilustruese nga praktika gjyqësore e gjykatave, si dhe me të dhëna statistikore nga këto gjykata ku unë kam ushtruar funksionin.

1.6. Struktura e Punimit

Ky punim përbëhet nga kjo hyrje dhe VIII Krerë. HYRJA e këtij punimi përfshin jo vetëm një prezantim të përgjithshëm lidhur me arsyet e zgjedhjes së kësaj teme nga autori, si dhe vlerat që synon të reflektojë punimi shkencor, por edhe qëllimin, pyetjen kërkimore, rëndësinë, kufizimet dhe metodologjinë e punimit.

Kreu II *“Zhvillimi historik i shoqërive me përgjegjësi të kufizuar në Shqipëri”* synon të eksplorojë aplikimin e formës së organizimit të veprimtarisë tregtare në vendin tonë, që në fillimet më të hershme, në kontekstin historik. Në këtë kre përfshihen të dhëna për SHPK-të që nga periudha e lashtësisë, në të Drejtën Romake, roli i së drejtës islame dhe zhvillimet këtyre shoqërive në periudhën e Mesjetës, deri në konsolidimin e koncepteve të përgjegjësisë së kufizuar në shekujt XVIII dhe XIX.

Kreu III *“Evoluimi i legjislacionit shqiptar për shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar”* analizon në mënyrë të detajuar zhvillimin e legjislacionit shqiptar për SHPK-të, që nga momentet e para të implementimit të kuadrit ligjor për këto lloje shoqërishe në vendin tonë. Në këtë kre përfshihet një analizë e legjislacionit duke filluar nga periudha e Monarkisë në Shqipëri me Kodin Civil të vitit 1929 dhe me Kodin Tregtar të vitit 1932 e duke vijuar analizën e ndryshimeve të legjislacionit deri në ditët e sotme.

Kreu IV *“Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar si subjekt i pavarur i së drejtës dhe karakteristika të veçanta të shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar”* përmban një prezantim më të detajuar teoriko-juridik të objektit thelbësor të kërimit shkencor që janë SHPK-të. Në pjesën e parë të këtij kreu prezantohet rëndësia e SHPK-ve në ekonominë e vendit dhe në sferën e marrëdhënieve juridiko-civile në përgjithësi. Ndërsa, në pjesën e dytë ky kapitull synon të bëjë një dallim të qartë dhe të detajuar të SHPK-ve në raport me subjektet e tjera të së drejtës tregtare të parashikura në ligjin Nr. 9901/ 2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” si dhe me shoqërinë e thjeshtë. Në këtë kapitull bëhet dhe një prezantim i vetë qëllimit të themelimit të një SHPK-je dhe karakteristikave dalluese të kësaj shoqërie. Këtu prezantohen aspekte të veçanta dhe specifike të shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar, që e kanë bërë këtë lloj shoqërie formën më të aplikuar dhe më atraktive nga të gjitha llojet

e tjera të shoqërive tregtare për organizimin e një veprimtarie apo sipërmarrjeje tregtare në vendin tonë.

Kreu V “*Themelimi i shoqërive me përgjegjësi të kufizuar sipas ligjit në fuqi*”, bën një analizë të hollësishme të legjislacionit aktual në fuqi, përta i përket të gjithë procedurave të themelimit të SHPK-ve në vendin tonë. Në këtë kapitull analizohen pasojat juridike të regjistrimit dhe aktet e rëndësishme të themelimit, si statuti i shoqërisë dhe elementet thelbësore të tij. Gjithashtu në këtë kapitull bëhet një analizë juridike e rasteve të pavlefshmërisë së themelimit të SHPK-ve dhe pasojat e saj.

Kreu VI “*administrimi i shoqërive me përgjegjësi të kufizuar dhe organet e saj sipas ligjit në fuqi*”, përmban një analizë të thelluar juridike të mënyrës së organizimit të një SHPK-je, si dhe të strukturave administruese dhe vendimmarrëse në këto shoqëri. Në këtë kapitull shpjegohen kompetencat dhe përgjegjësitë e administratorit dhe të asamblesë së ortakëve në një SHPK dhe rëndësia e zbatimit me korrektësi të përgjegjësive të organeve drejtuese të shoqërisë si element thelbësor i realizimit me sukses të misionit të këtyre shoqërive.

Kreu VII “*Të drejtat e ortakëve në një shpk dhe aspekte te veçanta të marrëdhënieve mes tyre sipas ligjit në fuqi*”, bën një analizë të plotë të të drejtave dhe detyrimeve që kanë ortakët e një SHPK-je. Në këtë kapitull shpjegohen koncepte të rëndësishme si e drejta votës dhe kufizimet e saj, e drejta e pjesëmarrjes në kapitalin e shoqërisë, kuota, e drejta për të marrë pjesë në fitimet e shoqërisë dhe në tepicën e likuidimit dhe përgjegjësitë e ortakëve për zbatimin me korrektësi të parashikimeve ligjore në këto procedura. Gjithashtu, në këtë kapitull bëhet dhe një analizë e marrëdhënieve ndërmjet ortakëve, si dhe marrëdhënia mes ortakëve dhe shoqërisë. Në këtë kapitull analizohen dhe konceptet e largimit dhe përjashtimit të ortakut nga shoqëria dhe rastet e aplikimit të këtyre instituteve.

Kreu VIII “*Prishja e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar, likuidimi dhe falimentimi i saj*”, synon të bëjë një prezantim të përmbledhur të rasteve të prishjes së SHPK-ve dhe dhënies fund të aktivitetit tregtar të tyre. Në këtë kapitull analizohet mënyrat e likuidimit të SHPK-ve në kushtet e aftësisë paguese, si dhe rastet e falimentimit në kushtet e paftësisë paguese, procedurat e falimentimit të SHPK-ve dhe problematikat e lindura në këtë fushë në vendin tonë.

Kreu i IX “*Konkluzione dhe rekomandime*”, përmban disa konkluzione rreth temës së punimit, të cilat autori i prezanton në kuadër të analizës së përgjithshme të kësaj teme. Gjithashtu, në këtë kapitull prezantohen disa rekomandime, të cilat mund të shërbejnë për përmirësimin e kuadrit ligjor, apo akteve nënligjore, si dhe përmirësimin të performancës dhe efikasitetit të SHPK-ve, në rast se do të mbahen parasysh nga organet drejtuese dhe vendimmarrëse të këtyre shoqërive.

KREU II

2. Zhvillimi Historik i Shoqërive me Përgjegjësi të Kufizuar në Shqipëri

2.1. Hyrje

Shoqëritë tregtare si forma të organizimit tregtar kanë një histori që shkon më larg sesa vetë historia e shtetit të pavarur shqiptar. Për këtë arsye, duhet të hulumtojmë se si janë zhvilluar këto shoqëri tregtare edhe në periudhat historike kur vendi ynë ka qenë nën pushtimin apo ndikimin e perandorive të mëdha, të cilat i njeh historia e njerëzimit.

Duke pasur parasysh që Shqipëria është shpallur si shtet i pavarur në datë 28.11.1912, pas një periudhe prej më shumë se pesë shekujsh nën pushtimin otoman, një ndikim të rëndësishëm gjatë kësaj periudhe ka pasur e drejta osmane. Ndërkohë që edhe para pushtimit otoman, nuk kemi të evidentuar deri tani, legjislacion të posaçëm për shoqëritë tregtare, i cili të ketë qenë i miratuar nga autoritetet shqiptare të para shekullit XIV, përveç të drejtës zakonore shqiptare. Edhe në të drejtën zakonore shqiptare, megjithëse ka rregulla dhe zakone të mira për disiplinimin e tregtisë, deri tani nuk rezulton të jenë evidentuar format e shoqërive tregtare, megjithëse ky aspekt mbetet për t'u studiuar nga ekspertët dhe historianët e fushës.

Për rrjedhojë, në kuadër të studimit historik të shoqërive me përgjegjësi të kufizuar në kontekstin shqiptar, në përgatitjen e këtij punimi janë bërë hulumtime dhe analiza referuar legjislacionit të perandorive të mëdha të kohës, të cilat kanë pasur influencën e tyre në vendin tonë, që nga Perandoria Romake e në vazhdim.

2.2. Origjina Historike e Shoqërive me Përgjegjësi të Kufizuar në Lashtësi

Ortakëritë në ushtrimin e aktivitetit tregtar mund të gjurmohen që në kohët e lashta. Sipas studiuesve të ndryshëm, ka të dhëna, që edhe në civilizimet e lashta kanë ekzistuar forma të ndryshme të bashkëpunimit në tregti. Shembuj të këtyre normave ishin edhe “Partneriteti i Marinarëve” (*Maritime partnerships*), si dhe marrëveshjet e huave në tregtinë detare - *foenus nauticum* në Perandorinë Romake.⁹ Siç rezulton nga një fjalim i oratorit të famshëm Demosteni, në vitin 340 para Krishtit, edhe kjo marrëveshje për huanë në tregtinë detare e kishte prejardhjen nga qytetërimi grek.¹⁰

⁹ Maria Brouwer, “Managing Uncertainty through Profit Sharing Contracts From Medieval Italy to Silicon Valley” (2005) 9 *Journal of Management and Governance* 237, fq. 241.

¹⁰ Maria Brouwer, “Managing Uncertainty through Profit Sharing Contracts From Medieval Italy to Silicon Valley” (2005) 9 *Journal of Management and Governance* 237, fq. 241-242.

Ndërkohë që, sipas shumë historianëve vendas dhe të huaj, është provuar se njëkohësisht me qytetërimin grek është zhvilluar dhe qytetërimi ilir.¹¹ Ky qytetërim për shkak të origjinës historike, por edhe afrimitetit gjeografik kishte shumë ndërthurje dhe ngjashmëri me qytetërimin grek, ashtu siç kishte dhe veçoritë dhe specifikat e tij, të cilat janë akoma objekt i studimeve historike. Por, për shkak të shkëmbimeve tregtare, kuptohet, që zhvillimi i kontratave të huasë detare të jetë aplikuar edhe në trojet e banuara nga paraardhësit e shqiptarëve, që janë Ilirët. Kjo lloj huaje, apo kredie, ishte një marrëdhënie kontraktuale midis sipërmarrësve tregtarë që posedonin anije lundrimi dhe një apo më shumë investitorëve, të cilët mbështesnin financiarisht dhe/ose me kapitale sipërmarrësin lundërtar me qëllim minimizimin e riskut të sipërmarrjes.

Që në Romën e Lashtë, e drejta Romake njihete personalitetin juridik të entiteteve publike (persona publikë), si:¹² shteti (*Republica*), bashkitë apo komunat (*municipia, civitas*), shoqatat dhe këshillat publikë (*collegia*), organizatat e bamiresisë (*piae causae*), kolegjet kishtarë (*collegia templorum*), organizmat shtetërorë që mblidhnin taksat (*societates publicanorum*) etj.¹³ Pra, edhe në Romën e Lashtë njihet dhe zbatohet koncepti i personit juridik, i cili kishte personalitet të veçantë nga personat fizik apo qytetarët e angazhuar në veprimtarinë e këtij personi publik. Megjithatë, e drejta romake e njihete personalitetin juridik vetëm për strukturat publike shtetërore ose ato që ndiqnin një qëllim publik, si shoqatat humanitare, fondacionet apo këshillat fetarë.

Në Romën e Lashtë, në periudha të gjata paqeje, sistemi i sofistikuar juridik i mbrojtjes së të drejtave të pronësisë dhe taksimi i lehtë, krijuan kushtet për lulëzimin e aktiviteteve të shumëllojshme ekonomike.¹⁴ Sipas studuesve të ndryshëm ekonomia Romake arriti një nivel shumë të lartë zhvillimi të tregjeve të këmbimit të mallrave dhe shërbimeve (“*market exchange*”).¹⁵ Megjithatë në këtë kohë e drejta romake nuk e njihete shoqërinë tregtare si person juridik privat, ajo njihete kontratën e partneritetit (*societas consensu contracta*) që ishte një marrëveshje mes privatëve, të cilët si partnerë (ortakë) merreshin vesh për të ndarë fitimet dhe humbjet së bashku.¹⁶ Megjithatë, kjo kontratë partneriteti nuk kishte

¹¹ Për një trajtim më të hollësishëm historik shih: Neritan Ceka, “Pesëdhjetë vjet studime për qytetet ilire” (1998) 28 Iliria, fq 121-128; Aleksander Stipceviç, “Iliret, historia, jeta, kultura, simbolet e kultit” (Toena 2002); Charles A Frazee, *World History the Easy Way Volume One* (Barrons Educational Series 1997) fq. 88-90.

¹² Për një trajtim më të hollësishëm shih: Enkelejda Olldash, *E drejta Romake: Cikël leksionesh* (2011) kreu II; Arta Mandro, *E drejta romake* (Emal 2007) fq. 165-169.

¹³ Umberto Laffi, “*Coloniae et municipia nello stato romano, 2007*” (2008) 77 *L’Antique Clasique* 710.

¹⁴ Barbara Abatino, Giuseppe Dari-Mattiacci and Enrico C Perotti, “*Early Elements of the Corporate Form: Depersonalization of Business in Ancient Rome*” (2009) 32:1 *Oxford Journal of Legal Studies* 1, fq 3.

¹⁵ Walter Scheidel, Ian Morris dhe Richard P Saller (Editor), *The Cambridge Economic History of the Greco-Roman world* (Cambridge University Press 2007) publikuar në Revistën “*L’Antique Clasique*” 2010, fq 616-618.

¹⁶ Jean Andreau, *Banking and Business in the Roman World* (Cambridge University Press 1999).

karakteristikat e personit juridik, pasi nuk konsiderohej si entitet më vete dhe nuk siguronte përgjegjësi të kufizuar për ortakët.

Pavarësisht, disa autorë janë të qëndrimit se shoqëritë tregtare në format e tyre fillestare, e kanë origjinën që në kohën e Perandorisë Romake, në të cilën gjatë ushtrimit të veprimtarisë tregtare janë njohur disa forma të organizimit të ngjashme me ortakëritë e shoqërive tregtare,¹⁷ madje edhe duke u aplikuar *de-facto* konceptet e përgjegjesisë së kufizuar për ortakët.¹⁸ Sipas këtyre studiuesve, në periudhën e Perandorisë Romake, shoqëritë tregtare si mënyrë organizimi në tregti, kanë ekzistuar “de facto”, por personaliteti juridik i tyre nuk është njohur “de jure” për shkak të kulturës juridike të asaj kohe.¹⁹

Në të drejtën romake skllëverit nuk gëzonin personalitet juridik, përkundrazi ishin objekt i të drejtave të pronësisë njësoj si sendet (*res*).²⁰ Për pasojë skllëverit nuk mund të gëzonin të drejta pronësie apo të jenë palë në një kontratë. Gjithashtu edhe fëmijët e mitur nuk ishin subjekt i të drejtave të pronësisë.²¹ Për veprimet që kryheshin nga kjo këto kategori (skllëverit apo fëmijët e mitur) mbante përgjegjësi kreu i familjes *paterfamilias* personalisht. Në secilin rast, sipas së drejtës romake *paterfamilias* ishte i vetmi subjekt që posedonte privilegjin për të zgjedhur se çfarë lloj dënimi do t'i caktohet skllavit apo fëmijës së tij, për të shlyer dëmin që ka kryer.²² Kjo lloj përgjegjësie e prejardhur nga e drejta romake njihet në doktrinë si *noxal liability* – dhe sipas saj paterfamiljasi mund të dorëzojë anëtarin e familjes apo skllavin si kompensim për dëmin e kryer nga këta, dhe jo të mbajë përgjegjësi financiare.²³

Mundësia e ofrimit të skllavit si shpërblim për dëmin e shkaktuar prej tij, ishte teorikisht ekuivalent i përgjegjesisë së kufizuar.²⁴ Kjo pasi përgjegjësia e "*paterfamilias*" (kryetari i familjes) sipas vullnetit të tij, mund të mos shtrihej në pasuritë e tij personale, por vetëm në ofrimin e skllavit si mjet për shpërblimin e dëmit të shkaktuar nga ai, dhe njëkohësisht si dënim për këtë gabim. Sipas së drejtës romake thelbi i përgjegjesisë kontraktuale ishte përgjegjësia personale, që do të thotë se palët e treta (që nuk janë palë në kontratë) nuk

¹⁷ Jeffrey L Patterson, “The Development of the Concept of Corporation From Earliest Roman Times To A.D. 476” (1983) 10:1 The Accounting Historians Journal 87, fq. 87-98.

¹⁸ Robert W Hillman, “Limited Liability in Historical Perspective” (1997) 54:2 Washington & Lee Law Review 613, fq. 616.

¹⁹ Barbara Abatino, Giuseppe Dari-Mattiacci and Enrico C Perotti, “Early Elements of the Corporate Form: Depersonalization of Business in Ancient Rome” (2009) 32:1 Oxford Journal of Legal Studies 1, fq. 3.

²⁰ Arta Mandro, *E drejta romake* (Tiranë 1998).

²¹ Pë një trajtim më të hollësishëm shih: Bashkim Selmani dhe Bekim Rexhepi, *E drejta romake: ndikimi i saj në sistemet e së drejtës bashkëkohore* (Ferizaj 2014).

²² Robert W Hillman, “Limited Liability in Historical Perspective” (1997) 54:2 Washington & Lee Law Review 613, fq. 616.

²³ Alan Watson, *Roman Law & Comparative Law* (University of Georgia Press 1991) fq. 75.

²⁴ Alan Watson, *The Law of Obligations in The Later Roman Republic* (Clarendon P 1965) fq. 274-80.

mund të ishin përgjegjës për këto kontrata, edhe nëse njëra palë e kontratës ishte skllav dhe pala e tretë ishte pronari i skllavit.²⁵

Një rregull i tillë përbënte një pengesë në aktivitetet tregtare, pasi e bënte të vështirë që një person të kryente biznesin e tij nëpërmjet një agjenti, pra nëpërmjet dikujt tjetër. Megjithatë e drejta romake gjeti mekanizmat për të përmbushur nevojat e një mjedisi tregtar në lulëzim. Një nga mekanizmat juridikë që u zhvillua, ishte *actio institutoria*, sipas së cilës bëhej e mundur që një subjekt të ngrejë pretendime ndaj subjektit primar, për llogari të të cilit ishte kryer veprimi tregtar nga agjenti i tij.²⁶

Me zhvillimin e mjedisit tregtar në Perandorinë Romake, u zhvilluan dhe mënyra të tjera të përparuara të organizimit të biznesit, duke aplikuar përgjegjësinë e kufizuar të personave që investonin me kapitale në aktivitetin tregtar. Sipas Robert W Hillman, mënyra më e aplikuar diku nga mesi i periudhës Republikane në Romë ishte e njohur me emrin "*Peculium*".²⁷ *Peculium*-i konsistonte në dhënien nga *paterfamilias* të aseteve dhe kapitaleve skllavit të tij dhe ky t'i përdorte këto kapitale për të kryer aktivitet tregtar. Aktiviteti tregtar kryhej nga skllavi (ose femija) - *in potestas* – nën udhëzimet e pronarit (*Master*) të tij. Në këto raste kreditorët e mundshëm të aktivitetit tregtar nuk mund t'i kërkonin skllavit të shlyente detyrimin, por vetëm pronarit të tij. Por në një situatë të tillë ku kreditori e njihte statusin personal të skllavit *in potestas*, i cili me vullnetin e tij kishte hyrë në marrëdhënie tregtare me të, atëherë për shlyerjen e detyrimeve nuk mund të kërkonte nga *paterfamilias* (pronari i skllavit) më shumë sesa kapitalet që janë pjesë e *peculium*-it . Në këtë mënyrë, *paterfamilias* siguronte një përgjegjësi të kufizuar.²⁸

Këto organizime tregtare evoluan në struktura të cilat *de-facto* siguronin përgjegjësi të kufizuar për qytetarët romakë, që dispononin skllavë dhe i angazhonin ata si operatorë të aktivitetit tregtar, duke u dhënë një sasi kapitali si *peculium*. Rreth shekullit II para Krishtit këtë kohë u shfaq një strukturë e re e sipërmarrjes tregtare, e drejtuar nga një skllav, i cili ishte në bashkëpronësi mes dy ose më shumë personave (*negotatio per servos communes*) që kishin kapitale dhe asete të caktuara, të cilat ishin të vëna në dispozicion të skllavit për të ushtruar një aktivitet të caktuar (*peculium*).²⁹ Ndryshe nga kontratat e partneritetit, bizneset e drejtuara nga skllaverit ishin më shumë se sa thjesht një kontratë bashkëpunimi mes dy palëve. Baza e tyre ligjore derivonte nga dy koncepte të ndryshme ligjore, siç ishin statusi personal dhe pasuria. Statusi personal i skllavit, si joperson apo *send*, jepte dhe

²⁵ Robert W Hillman, "*Limited Liability in Historical Perspective*" (1997) 54:2 Washington & Lee Law Review 613, fq. 616.

²⁶ Po aty fq. 616.

²⁷ Po aty.

²⁸ Po aty fq. 617.

²⁹ Barbara Abatino, Giuseppe Dari-Mattiacci and Enrico C Perotti, "*Early Elements of the Corporate Form: Depersonalization of Business in Ancient Rome*" (2009) 32:1 Oxford Journal of Legal Studies 1, fq. 5.

mundësinë për të pasur bashkëpronësi mbi të dhe mbi të gjitha pasuritë dhe veprimtaritë me të cilat ky skllav është i angazhuar. Në këtë mënyrë mund të mblidheshin edhe disa qytetarë romakë, të cilët duke përdorur bashkëpronësinë mbi të njëjtin skllav, të ishin bashkëortakë edhe mbi kapitalin-*peculim* që skllavi e përdorte për të ushtruar aktivitetin tregtar.

Kështu, në veprimtaritë tregtare që drejtoheshin nga një skllav, ky në një farë mënyre ishte përfaqësues i vullnetit të bashkëpronarëve, të cilët e zotëronin, si skllavin, ashtu dhe *peculium*-in – kapitalin pasuror.³⁰ Në këtë mënyrë ata ruanin dhe të drejtën për të kontrolluar aktivitetin tregtar me urdhërimet ndaj skllavit dhe ndërkohë, siguronin dhe mundësinë për të pasur përgjegjësi të kufizuar për humbjet e mundshme nga sipërmarrja tregtare. Kjo pasi maksimumi i humbjeve për ta do të ishte kapitali i investuar si *peculium* dhe më tej akoma mund të dorëzonin dhe skllavin te kreditori, por jo të përgjigjeshin me pasuri personale të tyre.³¹

Pra, sipas këtyre kërkimeve ka të dhëna të organizimeve tregtare në Perandorinë Romake, në të cilat është aplikuar përgjegjësia e kufizuar, në forma të ngjashme me shoqëritë tregtare me përgjegjësi të kufizuara që njihen në ditët e sotme. Megjithatë ekzistonte një ndryshim i konsiderueshëm, pasi këto lloj organizimesh tregtare me *peculium* në Romën e lashtë, nuk gëzonin personalitet juridik si subjekt i mëvetshëm i së drejtës.³²

2.3. E drejta islame dhe shoqëritë tregtare para Mesjetës

Sipas Profesor Abraham L. Udovitch, organizime të ngjashme me shoqëritë tregtare, që kishin edhe ortak me përgjegjësi të kufizuar dhe ortak me përgjegjësi të pakufizuar, gjenden edhe në të drejtën islame, e cila është zbatuar nga shekulli VIII e në vazhdim.³³ Kjo e drejtë është zbatuar edhe në vendet që ishin nën pushtimin apo ndikimin e Perandorisë Osmane, siç ka qenë edhe vendi ynë, deri në shpalljen e pavarësisë, në vitin 1912. E drejta islame njih institutin e ortakërisë në kryerjen e aktiviteteve tregtare dhe ka gjetur një aplikim të gjerë.³⁴

Ndryshe nga e drejta romake, në të cilën përgjithësisht normat janë të kodifikuara, normat që rregullojnë ortakërinë në të drejtën islame bazohen në parimet e përgjithshme të parashkuara në librin e shenjtë Kuran, traditën profetike, si dhe jurisprudencën ndër

³⁰ Barbara Abatino, Giuseppe Dari-Mattiaci and Enrico C Perotti, “Early Elements of the Corporate Form: Depersonalization of Business in Ancient Rome” (2009) 32:1 Oxford Journal of Legal Studies 1, fq. 5.

³¹ Po aty fq. 5.

³² Po aty fq. 5

³³ Abraham L. Udovitch, *Partnership and Profit in Medieval Islam* (Princeton University Press 1970) fq. 170-200.

³⁴ Po aty, fq. 170-200.

shkuj.³⁵ Jurisprudenca islame i gruponte normat që rregullonin shoqëritë tregtare, në një korpus, të njohura si “*Fikh*”.³⁶ Sipas studiuesit Muhammad Yusuf Salem, disa ndër format më të njohura të ushtrimit të aktivitetit tregtar nga disa persona së bashku si ortakëri sipas së drejtës islame, janë: i) *Sharikat al-Amlak*; ii) *Sharikat al-amwal*; iii) *Sharikat al-Uuxhuh* dhe iv) *Mudarabah*.³⁷

Sharikat al-Amlak, dy ose më shumë persona bëhen bashkëpronar të pronës pa hyrë në marrëdhënie kontraktuale ortakërie. Karakteristika kryesore e *sharikat al-amlak*, është që asnjëri nga ortakët nuk ka autoritet/kompetencë mbi pjesën e ortakëve të tjerë dhe nuk mund të ndërhyjë pa lejen e ortakut. Prona ose fitimet ndahen bazuar në pjesët e secilit ortak të caktuar prej tyre në marrëveshje, deri në çastin kur vendosin që ta ndajnë ose shesin atë pronë.³⁸

Sharikat al-amwal. Ortakët mund të kontribuojnë në mënyrë të barabartë (*Sharikat al-Mufauada*) ose jo të barabartë (*Sharikat al-'Inan*). Në rastin e *Sharikat al-Mufauada*, secili nga ortakët kontribuojnë në mënyrë të barabartë në kapital dhe ndajnë fitimet dhe humbjet po në mënyrë të barabartë.³⁹ Ndërsa në rastin e *Sharikat al-'Inan* ortakët kontribuojnë në shuma të ndryshme dhe ndajnë fitimin dhe humbjen bazuar në kontributin e tyre.⁴⁰ Lidhur me menazhimin, rregulli i përgjithshëm është që secili ortak ka të drejtë të marrë pjesë në menazhimin e ortakërisë. Megjithatë, ortakët mund të bien dakort që menazhimin t’ia delegojnë njërit ose disa ortakëve, dhe quhet si i besuar (*amin*).⁴¹ Ky i fundit nuk është përgjegjës për humbjet, nëse ndodhin gjatë aktivitetit normal të biznesit, nëse e ushtron funksionin në mirëbesim. Në të kundërt, nëse është në keqbesim dhe abuzon duke tjetërsuar apo vjedhur pasurinë e ortakërisë, atëherë ai është përgjegjës.⁴² Ortakëri në shërbime (*Sharikat al-a'mal*), ku ortakët kontribuojnë vetëm nëpërmjet aftësive të tyre (punë apo shërbime) dhe jo me kapitale, qofshin këto sende, apo para.

Ortakëri bazuar në reputacionin (*Sharikat al-Uuxhuh*). Ortakët, bazuar në reputacionin e tyre, blejnë produkte me qëllim shitjen. Edhe te kjo lloj ortakërie njësoj si *Sharikat al-a'mal*, ortakët nuk kontribuojnë në kapital.⁴³

³⁵ Muhammad Yusuf Salem, *Islamic Commercial Law* (Wiley Finance 2006) fq. 111-121.

³⁶ Bello H, “Kodi Civil Osman - “*Mexheleja*” dhe trashëgimia juridike osmane në Shqipërinë e viteve 1912 – 1929” (2013) 2 Zani i Naltë <<https://zanalte.al/2013/09/mexheleja-kodi-civil-osman-dhe-trashegimia-juridike-osmane-ne-shqiperine-e-viteve-1912-1929/>> aksesuar më 14 shtator 2020.

³⁷ Muhammad Yusuf Salem, *Islamic Commercial Law* (Wiley Finance 2006) fq. 111-121.

³⁸ Po aty, fq. 111-121.

³⁹ Po aty, fq. 111-121.

⁴⁰ Po aty, fq. 111-121.

⁴¹ Po aty, fq. 111-121.

⁴² Po aty, fq. 111-121.

⁴³ Po aty, fq. 111-121.

Mudarabah njihet edhe si *Kirad*. *Mudarabah* i referohet kontratës ku njëra palë kontribuon nëpërmjet kapitalit (*sahib al-mal*) dhe palët e tjera kontribuojnë nëpërmjet ekspertizës, punës dhe aftësive të menazhimit (*mudarib*) për të operuar në nje aktivitet fitimprurës. Të dyja palët, ndajnë fitimin; ndërsa humbja, së pari kompensohet nga fitimi dhe nëse fitimi nuk është i mjaftueshëm, ajo merret nga kapitali i *mudarabah*-ut, pra ai shoqërisë.⁴⁴

Në të Drejtën Islame, shoqëria që ka ortak me përgjegjësi të kufizuar lidhet me termat *Mudaraba* ose *Kirad* (ose *Mudārabā*, dhe *Qirāḍ*, që kanë të njëjtin kuptim). *Mudaraba* rrjedh nga fjala *daraba*, që d.t.th. “të udhëtosh për tregti”.⁴⁵ Karakteristikat kryesore të Kiradit janë si më poshtë:

- a) Ka dy kategori ortakësh, ortaku që kontribuon në shoqëri nëpërmjet kapitalit në para (*sahib al-mal*) në rolin e investitorit, si dhe ortaku që kontribuon me shërbime në shoqëri (*mudarib*), i cili bën menazhimin e aktivitetit dhe merrte risqet e udhëtimit për transportin e mallrave.⁴⁶
- b) Përgjegjësia e ortakut që kontribuon në para (*sahib al-mal*) në kontratën e ortakërisë është e kufizuar në masën e kapitalit që ai ka ofruar në shoqëri. Pra këta ortakë kanë përgjegjësi të kufizuar dhe kanë rol pasiv në aktivitetin tregtar;⁴⁷
- c) Vlera e kontributit në para duhet të jetë e përcaktuar qartë, duhet të jetë ekzistues dhe jo abstrakt, dhe t’i dorëzohet shoqërisë *Kirad*.⁴⁸
- d) Ortaku tjetër që bën menazhimin e projektit tregtar ka rol aktiv dhe mund të mos investojë kapitale, por merr përsipër sipërmarrjen tregtare dhe risqet e udhëtimit;⁴⁹
- e) Ndarja e fitimit do të bëhet pasi të shlyhen humbjet dhe të kthehet kapitali i pronarit. Fitimi ndahet sipas marrëveshjes që ortakët kishin rënë dakord në kontratë.⁵⁰

Në këtë lloj shoqërie pronari i kapitalit (*sahib al-mal*) përfiton nga eksperiencia dhe aftësitë e agentit sipërmarrës (*mudarib*). Ndërsa sipërmarrësi përfiton nga kapitali që ai investon në treg. Në rast humbje, humbjet do t’i ngarkohen pronarit të kapitalit, por vetëm në masën e kapitaleve të investuara, ndërsa sipërmarrësi do të humbë kohën dhe mundin e tij.⁵¹ Pronari i kapitalit (*sahib al-mal*) nuk është një huadhënës, pasi ai përsëri ka nën pronësi kapitalin e investuar. Po ashtu, sipërmarrësi ose menazheri (*mudarib* ose *‘amil*) nuk është

⁴⁴ Po aty, fq. 111-121.

⁴⁵ Po aty, fq. 111-121.

⁴⁶ Po aty, fq. 111-121.

⁴⁷ Po aty, fq. 111-121.

⁴⁸ Po aty, fq. 111-121.

⁴⁹ Po aty, fq. 111-121.

⁵⁰ Po aty, fq. 111-121.

⁵¹ Noraina Mazuin Sapuan, “An Evolution of Mudarabah Contract: A Viewpoint from Classical and Contemporary Islamic Scholars” (2016) 35 *Procedia Economics and Finance*, fq. 349.

një huamarrës. Ai është një agjent i pronarit të kapitalit dhe një kujdestar i pasurisë *mudaraba*.⁵² Megjithëse sipërmarrësi duhet të bëjë të gjitha përpjekjet për të minimizuar rrezikun e humbjeve, ai nuk i garanton investitorit, as kthimin e kapitalit as fitimin. Për shkak të parimeve të fesë islame, që më parë duhet caktuar një normë fikse e fitimit, pasi në këtë rast kontrata *mudaraba* do të ishte një hua me kamatë.⁵³

Sipas studimeve të shumta, instrumenti i *Mudaraba*-së (Kirad), si rezultat i zhvillimit të tregtisë ndërkombëtare dhe operacioneve të shumta tregtare, është praktikuar nga arabët që para ardhjes së Islamit.⁵⁴ Me ardhjen e Islamit, kjo praktikë u aprovua dhe vazhdoi të praktikohet.⁵⁵ Pra ka shumë gjasë që kiradi (*mudarabah*) të ketë shërbyer si pararendës i konceptit modern të ortakërisë me përgjegjësi të kufizuar. Në Italinë e shekujve X dhe XI, zhvillimi i tregtisë solli lindjen e *kommendas*, një tregti e ushtruar nga disa ortakë, ndër të cilët disa prej tyre ishin me përgjegjësi të kufizuar dhe që shërbente kryesisht për financimin e tregtisë detare. Kiradi ka qenë burimi kryesor *kommendas* së aplikuar në Përendim, kryesisht në Itali.⁵⁶ Lidhja mes *kiradit* dhe *kommendas* duket shumë e spikatur, siç nënvizohet dhe nga autorë⁵⁷ dhe studiues të fushës.⁵⁸ Ky është modeli më i ngjashëm me shoqëritë komandite, të cilat ishin paraardhëse të shoqërive me përgjegjësi të kufizuara që njihen sot.

2.4. Periudha e Mesjetës dhe shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar

Shoqëritë me përgjegjësi të kufizuara me karakteristikat e sotme, ku dominojnë tiparet e shoqërisë së kapitalit, kanë marrë një zhvillim më të madh kryesisht pas shekullit XIX. Megjithatë, në rrugëtimin historik të zhvillimit të këtyre shoqërive, ato janë paraprirë nga disa forma më të thjeshta të shoqërive, të cilat kishin karakteristikat e shoqërisë me

⁵² Po aty.

⁵³ Po aty.

⁵⁴ Po aty.

⁵⁵ Po aty.

⁵⁶ Robert W Hillman, "Limited Liability in Historical Perspective" (1997) 54:2 Washington & Lee Law Review 613, fq. 622.

⁵⁷ Po aty, fq. 616.

⁵⁸ Abraham L Udovitch, *Partnership and Profit in Medieval Islam* (Princeton University Press 1970) fq. 170-190; Abraham L Udovitch, "At the Origins of the Western Commenda: Islam, Israel, Byzantium?" (1962) 37:2 *Speculum – A Journal of Medieval Studies* 198, fq. 198-207. Po ashtu i cituar dhe nga Robert W. Hillman, *Limited Liability In Historical Perspective* i cili shprehet se:

"Kiradi, mund të thuhet pa mëdyshje, është shembulli më i hershëm i një marrëveshje tregtare identike me *kommendan* e mëvonëshme, dhe që përmban të gjithë tiparet esenciale të saj. Nuk mund të thuhet me siguri nëse kiradi u mor nga tregtarët detarë Italian dhe u transformua në *kommenda* apo *kommenda* evoluoi në mënyrë të pavarur për të përmbushur nevojat tregtare. Megjithatë, edhe në kohët e Epokës së Errët në Mesjetë, nuk mungoi tregtia mes Perëndimit të Krishterë dhe Botës Islame. Kontaktet politike dhe ekonomike mes Islamit dhe Perëndimit përgjatë shekujve të tetë, nëntë dhe dhjetë u ofruan tregtarëve European mundësi të mëdha të përshatëshme për të mësuar dhe përvetësuar teknikat dhe praktikatat tregtare nga kolegët e avancuar Lindorë".

përgjegjësi të kufizuar për një pjesë ortakësh, por kishin dhe një apo më shumë ortakë që mbanin përgjegjësi të pakufizuar për detyrimet e shoqërisë. Pra në kontekstin historik mund të themi që pararendëset e shoqërive me përgjegjësi të kufizuar kanë qenë shoqëritë komandite të zhvilluara fillimisht në Provincat e Italisë fqinje.⁵⁹ Duke qenë se qytetet italiane ku janë zhvilluar këto forma organizimi tregtar kanë pasur vazhdimisht shkëmbime tregtare me Shqipërinë nëpërmjet detit, atëherë këto lloj organizimesh tregtare duhet të kenë qenë të njohura dhe në vendin tonë.

Sipas studiuesit Max Weber, gjatë Mesjetës u vendosën rregulla dhe norma juridike që ofronin më shumë pavarësi për subjektet e tregtisë detare, si dhe për partneritetet në këtë tregti. Sipas Weber-it, këto rregulla ishin më liberalë dhe më pak detyrues sesa rregullat antikë të partneriteteve të tregtisë detare. Në këtë periudhë u shfaqën rregullat ligjore mesjetarë për ortakëritë në tregtinë detare përmes vendimeve të dhëna nga Gjykatat e posaçme tregtare. Jurisprudenca e këtyre Gjykatave tregtare filloi të kodifikohet, si psh. në Piza (Itali) me “*Constitutum Uzus*”, apo në Genova (Itali), me “*Rota Genoa*”⁶⁰ Këto procedura lejuan që legjislacioni të përshtatet me ndryshimin dhe evoluimin e rrethanave dhe progresin e tregtisë.

Ortakëritë e tregtisë detare në Italinë e Mesjetës ishin të dy llojeve të ndryshme: huaja detare dhe komenda. E para, kredia detare apo huaja⁶¹ që i jepej sipërmarrësit lundërtar paraqet ngjashmëri me atë të kohërave antike të analizuar më lart. Sipas kësaj kontrate investitori i jepte sipërmarrësit një shumë të caktuar hua për të blerë mallra të caktuar dhe përfitonte një përqindje të caktuar interesi mbi këtë hua. Duke pasur një koficent të lartë të rrezikut në këto sipërmarrje, edhe interesat e huasë nga investitori ishin të larta. Për shembull, në Pisa dhe në Genova, norma e interesit ishte 35 përqind.⁶² Normat e interesit ndryshonin në varësi të gjatësisë së udhëtimit dhe riskut të pritshëm.⁶³ Norma e interesit në Siri ishte rreth 50 %; në Sicili norma e interesit ishte 25-30 %, në Afrikën Veriore norma e interesit ishte mes 20-30% .⁶⁴

Ndërsa forma tjetër e organizimit të tregtisë në Mesjetë ishte e njohur me emrin *komenda*.⁶⁵ Kjo formë siç u analizua më lartë paraqiste ngjashmëri me kontratën e ortakërisë *kirad* të

⁵⁹ Për më shumë lidhur me shoqëritë komandite shih Kreun IV pika 4.8, në këtë punim.

⁶⁰ Max Weber (përkthyes Lutz Kaelber), *The History of Commercial Partnerships in the Middle Ages* (Rowman & Littlefield Publishers 2002) fq. 63.

⁶¹ E njohur nga literatura e huaj si “*sea loan*”. Për më shumë shih: Calvin B Hoover, “*The Sea Loan in Genoa in the Twelfth Century*” (1926) 40:3 Quarterly Journal of Economics, fq. 495.

⁶² Max Weber (përkthyes Frank H Knight), *General Economic History* (Greenberg 1927), fq. 206.

⁶³ Maria Brouwer, “*Managing Uncertainty through Profit Sharing Contracts From Medieval Italy to Silicon Valley*” (2005) 9 Journal of Management and Governance 237, fq. 242-243.

⁶⁴ Calvin B Hoover, “*The Sea Loan in Genoa in the Twelfth Century*” (1926) 40:3 Quarterly Journal of Economics, fq. 495.

⁶⁵ Profesoresha e nderuar e Fakultetit të Drejtësisë të Universitetit të Tiranës, znj. Malltezi, shpjegon prejardhjen e fjalës “komandite” si term që vjen nga fjala latine *commendare*, e cila ka kuptimin (ia besoj) e

zhvilluar nga e drejta islame që në shekullin VIII. *Komenda* paraqitej si një formë më e avancuar e ortakërisë në tregti në krahasim me huanë/kredinë detare, pasi te *komenda* kemi edhe praninë e ortakëve me përgjegjësi të kufizuar në raport me humjet e shoqërisë.⁶⁶

Ky lloj bashkëpunimi mes disa personave për të ushtruar një aktivitet tregtar ishte veçanërisht i përhapur në qytetet e Pizas dhe Venecias në Itali që në shekullin XI. Ky organizim tregtar nuk kishte në themel të tij parimet e huasë, por mbështetej te barazia në të drejta për të gjithë ortakët e saj.⁶⁷ Kjo formë e organizimit të biznesit kishte filluar të zbatohet shumë kohë para se Kisha Katolike të sanksiononte ndalimin kanonik të fajdesë (huadhenja me interes), në vitin 1234.⁶⁸ Gjithsesi ky ndalim kanonik i kontratave të huasë, i nxiti akoma më shumë bashkëpunimet tregtare në formën e ortakërisë së njohur me emrin *komenda*, e cila më kalimin e kohës u quajt shoqëria komandite.

Edhe studiues të së drejtës tregtare në Shqipëri, në kuadër të analizës historike të shoqërive komandite, konsiderojnë se kjo shoqëri i ka fillimet e saj në Italinë e Mesjetës, kryesisht në tregtinë detare.⁶⁹ Sipas Profesoreshë Argita Malltezi, kjo formë shoqërie lindi si kontratë mes sipërmarrësve që ishin kryesisht pronarë anijesh lundrimi dhe tregtarë, të cilët në bashkëpunim me persona të tjerë, të cilët vetëm kontribuonin me mallra të ndryshme apo me para në këtë shoqëri, nuk ishin të ekspozuar nga risqet e sipërmarrjes tregtare.⁷⁰

Në këtë kategori personash, që ofrojnë vetëm kontributin në shoqëri dhe jo angazhimet e tyre, mund të futeshin edhe të gjithë ata persona që për arsye nga më të ndryshmet nuk u lejohej, apo nuk u interesonte, të ishin sipërmarrës tregtarë, (për shembull, klerikët kishtarë, fisnikët e kategorive të caktuara etj.), por ndërkohë mund të merrnin pjesën e tyre të fitimit, nëse sipërmarrja tregtare do të ishte e suksesshme.⁷¹ Pra sipërmarrësit tregtarë mbanin të gjitha risqet e sipërmarrjes dhe për këtë arsye ishin të ekspozuar pa kufizim ndaj kreditorëve. Ndërsa personat që nuk merrnin pjesë aktive në sipërmarrje, por vetëm ofronin kontributet në natyrë apo në para, nuk mund të mbanin përgjegjësi për risqet e sipërmarrjes më shumë sesa në vlerën e kontributit që kishin ofruar. Këta ishin ortakët me përgjegjësi të kufizuar në shoqëri.

cila është transformuar në *commandite*, i përdorur më vonë për shoqëritë komandite. Argita Malltezi, *E drejta shqiptare e shoqërive tregtare* (Shtëpia botuese "Mediaprint", 2011) fq. 37.

⁶⁶ Robert S Lopez dhe Irving W Raymond (përkthyes), *Medieval Trade in the Mediterranean World: Illustrative Documents* (Columbia University Press 1955) fq. 175-176.

⁶⁷ Maria Brouwer, "Managing Uncertainty through Profit Sharing Contracts From Medieval Italy to Silicon Valley" (2005) 9 Journal of Management and Governance 237, fq. 242.

⁶⁸ Max Weber (përkthyes Lutz Kaelber), *The History of Commercial Partnerships in the Middle Ages* (Rowman & Littlefield Publishers 2002) fq. 138.

⁶⁹ Argita Malltezi, *E drejta shqiptare e shoqërive tregtare* (Shtëpia botuese "Mediaprint" 2011) fq. 37.

⁷⁰ Po aty, fq. 37.

⁷¹ Po aty, fq. 37.

Në periudhën e Mesjetës forma e personit juridik (korporatës) ishte një privilegj i dhënë tradicionalisht nga shteti për entitetet që ndjekin qëllime publike, si shteti dhe organizma të tij, spitalet, manastiret etj. Shtrirja e konceptit të personit juridik si entitet më vete gradualisht ndodhi në shekullin XVII në vende të ndryshme, si Mbretëria e Bashkuar, Holanda, Italia dhe Franca, në kuadër të interesit të shteteve të asaj periudhe në nxitjen e fushatave të zgjerimeve koloniale, fushata këto që shoqëroheshin dhe me një element të marrjes përsipër të riskut dhe pasigurisë për ekipin e kolonizatorëve.⁷²

Në këto raste të veçanta këtyre sipërmarrjeve u jepej forma e entitetit të pavarur juridik si një privilegj i posaçëm me një autorizim të veçantë të shtetit (apo mbreti). Rastet më të njohura të shoqërive ku aplikohet përgjegjesia e kufizuar dhe fillimet e shoqërive aksionare sipas studuesve të kësaj fushe, janë: *British Ducht East India Company* (1600); *Ducht East India Company* (1600); *Verenigde OostIndische Compagnie (VOC) në 1602*, *West-Indische Compagnie* (1621); *Compagnies françaises des Indies* (1664); *the Compagnia di Negozio per il commercio con il Portogallo ed il Brasile* (1681).⁷³ Këto lloj autorizimesh apo të drejtash që iu njohën këtyre subjekteve kishin kryesisht për qëllim nxitjen e tregtisë së jashtme dhe lejimin e këtyre organizimeve për të transferuar dhe tregtuar mallra të kategorive të ndryshme.

Megjithatë mënyra e organizimit të këtyre shoqërive kishte disa ngjashmëri me shoqërinë me përgjegjësi të kufizuar. Për shkak se këto sipërmarrje kërkonin grumbullimin e shumë kapitaleve financiare për të siguruar mjetet e lundrimit, si dhe ngarkesat tregtare, organizatorët e këtyre sipërmarrjeve, u bashkuan, ftuan dhe persona të tjerë, në rolin e investitorit, pra të ortakut që ofron vetëm kontributin në para apo në natyrë, dhe nuk merr rol aktiv në këtë sipërmarrje. Këta ishin ortakët me përgjegjësi të kufizuar.

Autorë të tjerë, në analizën e tyre historike rreth shoqërive tregtare me përgjegjësi të kufizuar, vlerësojnë se këto shoqëri u shfaqën fillimisht rreth shekullit të shtatëmbëdhjetë (XVII) në Hollandën e sotme, me zhvillimin e tregtisë detare.⁷⁴ Megjithatë, transformimi i shoqërive tregtare (korporatat) nga një privilegj i veçantë i akorduar nga shteti (*ius singulare*) në një format biznesi të disponueshëm në përgjithësi nga çdo sipërmarrës ndodhi

⁷² Massimo Montanari, *Impresa e responsabilità. Sviluppo storico e disciplina positive* (Giuffrè 1990) fq. 146-63.

⁷³ Barbara Abatino, Giuseppe Dari-Mattiaci and Enrico C Perotti, "Early Elements of the Corporate Form: Depersonalization of Business in Ancient Rome" (2009) 32:1 Oxford Journal of Legal Studies 1, fq. 2; Armela Kromiçi, "Qeverisja e mirë e shoqërive tregtare në tregun financiar jobankar dhe kontrolli publik i tyre" (Tezë Doktorature, Fakultetit të Drejtësisë në Universitetin e Tiranës 2015) fq. 2.

⁷⁴ Jon Micklethwait dhe Adrian Wooldridge, *The Company: A Short History of a Revolutionary Idea* (Modern Library 2005); Stephen M Bainbridge and M Todd Henderson, *Limited Liability: A Legal and Economic Analysis* (Elgar 2016).

kryesisht në shekullin XIX për shkak të zhvillimeve të doktrinës dhe legjislacionit, të parapirira këto nga zhvillimet tregtare.⁷⁵

Forma moderne e shoqërisë tregtare mbështetet në konceptin e personalitetit juridik të pavarur, të përpunuar fillimisht nga juristët gjermanë në normat juridike të legjislacionit, të cilat i paraprinë jurisprudencës në këtë fushë.⁷⁶

Shoqëritë me përgjegjësi të kufizuara, të pranuar si subjekte të së drejtës, me personalitet juridik të ndarë nga ortakët, dhe me karakteristikat e sotme, ku dominojnë tiparet e shoqërisë së kapitalit kanë marrë zhvillim kryesisht pas shekullit XIX në Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe në Evropën Përfundimtare, si një realitet i zhvillimit ekonomik të kohës.

2.5. Realiteti shqiptar deri në vitin 1932

Pas shpalljes së pavarësisë, në vendin tone, në legjislacionin e shtetit shqiptar, shoqëritë me përgjegjësi të kufizuara janë rregulluar për herë të parë në Kodin Tregtar të vitit 1932. Për shkak të rrethanave historike, në vendin tonë, deri në periudhën e Mesjetës ka pasur një ndikim të theksuar e drejta zakonore dhe e drejta romake. Gjithashtu modelet e organizimeve tregtare në qytetet bregdetare të Italisë, duhet të kenë qenë të njohura edhe për tregtarët shqiptarë, për shkak të shkëmbimeve tregtare me këto vende si dhe marrëdhënieve politike dhe shoqërore me to.⁷⁷

Më pas, për shkak të ndikimit të ushtruar nga Perandoria Osmane, është zbatuar legjislacioni otoman⁷⁸ dhe e drejta islame, e cila është zhvilluar që nga shekulli VIII dhe IX, e në vazhdim. E drejta islame i njihte konceptet e shoqërive tregtare, madje edhe konceptin e përgjegjësisë së kufizuar të këtyre shoqërive⁷⁹ E drejta islame rregullonte shoqëritë tregtare në një korpus të veçantë normash juridike të njohura si “*Fikh*”⁸⁰.

⁷⁵ Barbara Abatino, Giuseppe Dari-Mattiacci and Enrico C Perotti, “*Early Elements of the Corporate Form: Depersonalization of Business in Ancient Rome*” (2009) 32:1 Oxford Journal of Legal Studies 1, fq. 2.

⁷⁶ Për një trajtim me të hollësishëm doktrinor shih: Otto Friedrich von Gierke, *Community in Historical Perspective, A Translation of selections from Das Deutsche Genossenschaftsrecht* (Cambridge University Press 2000); Ron Harris, “*The Transplantation of a Legal Discourse: Corporate Personality Theories from German Codification to British Political Pluralism and American Big Business*”, (2006) 63 Washington & Lee Law Review 1421, fq. 1421-78.

⁷⁷ Shih analizen e bërë më lart për organizimin e tregtisë në formën e “*komenda*”. (Kreu 2, pika 2.4, në këtë punim)

⁷⁸ Fatri Islamaj, “*Një analizë Juridike e Shoqërive Tregtare në Kodin Civil të Periudhës së Monarkisë në Shqipëri*” (2020) 11 Bedër Journal of Humanities (BHJ) 33.

⁷⁹ Shih analizen historike në këtë punim për SHPK-të në të drejtën islame (Kreu 2, pika 2.3).

⁸⁰ Bello (n. 36).

Në fund të shekullit XIX dhe gjatë dy dekadave të para të shekullit XX, kur shoqëritë tregtare me përgjegjësi të kufizuar filluan të bëhen një realitet në vendet e Evropës Përqendrore, Shqipëria zbatonte akoma legjislacionin osman, që ishte Kodi Civil Osman i njohur si “*Mexheleja*”. Ky i fundit ishte një legjislacion i reformuar në mes të shekullit të XIX, gjatë reformave të Tanzimatit.⁸¹ Gjithashtu në këtë periudhë, ishin të zbatueshme Kodi Tregtar Tokësor i datës 28 korrik 1850, bashkë me shtojcën e datës 30 prill 1860 dhe Kodi Tregtar Detar i 1 gushtit 1863, si dhe dispozitat e të drejtës zakonore. Këto kode pavarësisht se ishin trashëguar nga Perandoria Osmane, në fakt ishin përgatitur sipas modelit të Kodit Tregtar të Francës, (*Code de Commerce Français*), të vitit 1807.⁸²

Megjithatë, nuk evidentohet që shoqëritë tregtare në këtë periudhë të kenë pasur ndonjë zhvillim në vendin tonë, edhe për shkak të një ekonomie të prapambetur dhe të mbështetur kryesisht në prodhimet bujqësore dhe blegtorale ku nuk shquheshin akoma investime të rëndësishme industriale.

Gjatë periudhës së Monarkisë në Shqipëri pati një zhvillim të vazhdueshëm në kuadër të përmirësimit të legjislacionit në përgjithësi dhe atij civil në veçanti.⁸³ Pjesë e këtyre zhvillimeve ishte dhe nisma për miratimin e Kodit Tregtar të vitit 1932. Ky kod do të krijonte një infrastrukturë juridike më të plotë dhe bashkëkohore për subjektet e së drejtës tregtare në funksion të nxitjes së një ekonomie të tregut të lirë dhe rritjes së investimeve vendase dhe atyre të huaja, nëpërmjet sipërmarrjeve tregtare.⁸⁴

Duhet theksuar se, shoqërinë me përgjegjësi të kufizuara si një organizim i mirëfilltë tregtar në formën e një personi juridik, i cili kryen një sipërmarrje tregtare të pavaruar, në legjislacionin e Shtetit Shqiptar e hasim për herë të parë në Kodin Tregtar të vitit 1932⁸⁵.

⁸¹ Bello (n 36).

⁸² *Shqipëria më 1937: Veprimi shtetnor gjatë njëzet e pesë vjetëve të parë të vetqeverimit, vëllimi I* (Luarasi 1937) fq. 96-97.

⁸³ Për një trajtim doktrinor dhe më të hollësishëm të zhvillimit të së drejtës kushtetuese në Shqipëri shih: Aurela Anastasi, *Historia e të drejtës kushtetuese në Shqipëri 1912-1939* (Shtëpia botuese “Pegi”, 2007).

⁸⁴ Bashkim Boseta, “Veprimtaria Parlamentare në Shqipëri në vitet e Monarkisë Shqiptare, 1928 – 1939” (Tezë Doktorature, Departamenti i Historisë, Fakulteti i Historisë dhe i Filologjisë 2019) fq 85.

⁸⁵ Kodi Tregtar i vitit 1932, botuar në Fletoren Zyrtare të dt. 5 mars 1932.

KREU III

3. Evoluimi i legjislacionit shqiptar për Shoqëritë me Përgjegjësi të Kufizuar

3.1. Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar gjatë periudhës së monarkisë në Shqipëri

Shoqëritë tregtare në përgjithësi dhe SHPK-të në veçanti, kanë pasur hovin më të dukshëm të zhvillimit të tyre pas rënies së sistemit komunist, në vitin 1992, me zbatimin e legjislacionit të ri pas ndryshimeve demokratike.⁸⁶ Megjithatë, në kontekstin historik, Shqipëria ka implementuar në legjislacionin e saj civil edhe më përpara dispozita që rregullonin themelimin, organizimin dhe marrëdhëniet që lindin mes ortakëve në shoqëritë tregtare. Në periudhën e Mbretërisë Shqiptare, pra para Luftës së Dytë Botërore, në legjislacionin shqiptar të kohës u bënë ndryshime të mëdha për të zhvilluar fushën juridike në frymën e politikës së zhvilluar në vendet perëndimore.⁸⁷

Shoqëritë me përgjegjësi të kufizuara si një organizim i mirëfilltë tregtar në formën e një personi juridik, i cili kryen një sipërmarrje tregtare të pavaruar i hasim për herë të parë në legjislacionin e Shtetit Shqiptar në Kodin Tregtar të vitit 1932.⁸⁸ Kodi Tregtar i periudhës së Monarkisë në Shqipëri ishte një hap shumë i rëndësishëm në drejtim të modernizimit të legjislacionit tregtar, por dhe në drejtim të kodifikimit të këtij legjislacioni në një kod të vetëm. Një kodifikim i tillë në fushën e të drejtës tregtare nuk është arritur të realizohet as në ditët e sotme, pasi legjislacioni tregtar aktual, megjithëse është bashkëkohor, është i shpërndarë në një sërë ligjesh, për të cilat do të shpjegohet në vijim të këtij kërkimi.

Por, rreth 3 vite para se të miratohej Kodi Tregtar i vitit 1932, konkretisht në 1 prill të vitit 1929 është miratuar Kodi Civil, në të cilin përveç shumë instituteve të tjera civile, janë hedhur dhe bazat e koncepteve të shoqërive tregtare.⁸⁹

⁸⁶ Fatri Islamaj, “Një analizë Juridike e Shoqërive Tregtare në Kodin Civil të Periudhës së Monarkisë në Shqipëri” (2020) 11 *Bedër Journal of Humanities* (BHJ) 33.

⁸⁷ Për një trajtim më të hollësishëm historik, shih: Bernd Fisher, *Mbreti Zog dhe përpjekja për stabilitet në Shqipëri* (Shtëpia Botuese “Çabej” 2004)

⁸⁸ Kodi Tregtar i vitit 1932, botuar në Fletoren Zyrtare të dt. 5 mars 1932.

⁸⁹ Fatri Islamaj, “Një analizë Juridike e Shoqërive Tregtare në Kodin Civil të Periudhës së Monarkisë në Shqipëri” (2020) 11 *Bedër Journal of Humanities* (BHJ) 33.

3.1.1. Kodi Civil i vitit 1929⁹⁰

Përpara miratimit të Kodit Civil të vitit 1929, në Shqipëri zbatoheshin kryesisht legjislacioni otoman, Kodi Civil Osman, i njohur si Mexheleja, dhe e drejta zakonore me përjashtime të vogla.⁹¹ Në fushën e së drejtës tregtare në vendin tonë aplikoheshin gjithashtu dhe Kodi Tregtar Tokësor i datës 28 korrik 1850 bashkë me shtojcën e datës 30 Prill 1860 dhe Kodi Tregtar Detar i 1 gushtit 1863.⁹² Këto kode pavarësisht se ishin trashëguar nga Perandoria Osmane, në fakt ishin përgatitur sipas modelit të Kodit Tregtar të Francës, (*Code de Commerce Français*) të vitit 1807.⁹³

Kodi Civil shqiptar i vitit 1929, është Kodi i parë Civil, i miratuar nga shteti shqiptar pas shpalljes së pavarësisë dhe përbën, pa dyshim, hapin më të rëndësishëm në drejtim të modernizimit të legjislacionit civil shqiptar.⁹⁴ Përgatitja e kësaj veprë të rëndësishme të korpusit legjislativ të shtetit shqiptar iu besua një komisioni të përbërë nga ekspertët e shquar Dr. Baltasar Benusi, Mehdi Frashëri, Agjah Libohova dhe Thoma Orlllogaj dhe të kryesuar nga senatori Koço Kota.⁹⁵ Madje njëri nga kontributorët më të shquar në përgatitjen e këtij Kodi, Dr. Baltasar Benussi, ka publikuar dhe dy komentare mbi Kodin Civil të vitit 1932.⁹⁶

Ky kod ishte një vepër juridike me shumë interes, që bazohej në modelet më përparimtare të kohës, duke mos përjashtuar as disa institucione të së drejtës zakonore shqiptare.⁹⁷ Burimi kryesor i këtij kodi ishte Kodi Civil francez, i njohur si Kodi Civil i Napoleonit. Gjithashtu, si burime të rëndësishme kanë shërbyer edhe Kodi Civil në Gjermani, Kodi Civil zviceran, Kodi zvicerian i Obligimeve, si dhe Kodi Civil i Italisë.⁹⁸

⁹⁰ Në këtë pjesë të punimit janë referuar dhe të dhëna nga publikimi i vetë autorit Fatri Islamaj në artikullin shkencor me temë Fatri Islamaj, “Një analizë Juridike e Shoqërive Tregtare në Kodin Civil të Periudhës së Monarkisë në Shqipëri” (2020) 11 *Bedër Journal of Humanities* (BHJ) 33.

⁹¹ Bello (n 36).

⁹² “Shqipëria më 1937: Veprimi shtetnor gjatë njëzet e pesë vjetëve të parë të vetqeverrimit, vëllimi I (Luarasi 1937) fq. 96- 97.

⁹³ Po aty, fq. 97.

⁹⁴ Fatri Islamaj, “Një analizë Juridike e Shoqërive Tregtare në Kodin Civil të Periudhës së Monarkisë në Shqipëri” (2020) 11 *Bedër Journal of Humanities* (BHJ) 33.

⁹⁵ Boseta (n 84) fq. 83-84 .

⁹⁶ Dr. Baltasar Benussi, Antar i Gjyqit të Diktimit, dhe anëtar i Komisionit të eksperteve për hartimin e Kodit Civil të vitit 1929. Shih dy komentaret e tij: Baltazar Benussi, *Obligimet dhe kontratat përgjithësisht: Titulli II i librit IV të Kodit Civil* (Botim i Ministrisë së Drejtësisë 1932) dhe Baltazar Benussi, *Komentaret e Kodit Civil të vitit 1929: Sendet, zotënimi dhe modifikimet e tij* dhe *Obligimet dhe kontratat përgjithësisht* (Botime të Ministrisë së Drejtësisë 1932).

⁹⁷ Fikret Karic, *Studime për të drejtën e shariatit dhe institucionet* (Shtëpia Botuese Logos-A 2015) fq. 140.

⁹⁸ Feti Gjilani, “Shteti dhe e drejta gjatë regjimit të A. Zogut”, në *Historia e Shtetit dhe e së Drejtës në Shqipëri, Pjesa II* (Luarasi 1997).

Kodi Civil i vitit 1929 parashikonte disa dispozita për shoqëritë tregtare të formuara me kontratë, por këtu nuk përfshiheshin korporatat dhe të ashtuquajturat stabilimentet e të drejtës publike, të cilat rregulloheshin në Kodin Tregtar të vitit 1932.⁹⁹ Personaliteti juridik i korporatave fitohej me anë të dekretit mbretëror, pas dhënies së mendimit të favorshëm nga Këshilli Ministror¹⁰⁰ dhe shpalljes në fletoren zyrtare të qarkut apo të kryeqytetit të vendit.¹⁰¹

i) Kuptimi i kontratave të shoqërisë dhe llojet e tyre, personaliteti juridik i tyre

Kodi Civil i vitit 1929, apo siç quhej ndryshe "Kodi Civil i Zogut", përcaktonte kuptimin e kontratës së shoqërisë. Sipas këtij neni përcaktohej që dy ose më shumë persona me marrëveshje mes tyre mund të bien dakort që të realizojnë një qëllim ekonomik të përbashkët.¹⁰²

Kodi Civil i vitit 1929 i kualifikonte shoqëritë në dy lloje kryesore: i) shoqëritë e përgjithshme apo universale, dhe ii) shoqëritë e pjesshme, apo siç cilësoheshin ndryshe në Kodin Civil, shoqëritë partikolare.¹⁰³

Shoqëria universale mund të krijohet vetëm me marrëveshje të palëve që kishin zotësi të plotë për të vepruar dhe nuk u ishte ndaluar të përfitonin në dëm të të tjerëve.¹⁰⁴ Nga vetë emërtimi i tyre "shoqërite universale" kishin si karakteristikë që efektet financiare dhe pasurore të ortakëve të këtyre shoqërive shtriheshin në mënyrë të përgjithshme të të gjitha pasuritë e tyre ose të të gjitha fitimet e tyre në varësi të llojit të shoqërisë.¹⁰⁵ Në këto shoqëri secili ortak gëzonte të drejtën e ushtrimit të veprimtarisë tregtare, apo sipas konceptit bashkëkohor cilësinë e tregtarit. Në kuptim të legjislacionit aktual këto subjekte ngjasojnë me ortakët e një shoqërie kolektive, apo të një shoqërie të thjeshtë, të cilët mbajnë përgjegjësi solidare të pakufizuar për humbjet që shoqëria mund të ketë ndaj të tretëve.¹⁰⁶ Në këtë aspekt, këto shoqëri janë të ndryshme nga shoqëria me përgjegjësi të kufizuar ku ortakët nuk marrin risqe të tjera përveç shlyerjes së masës së kontributit të tyre.

⁹⁹ Fatri Islamaj, "Një analizë Juridike e Shoqërive Tregtare në Kodin Civil të Periudhës së Monarkisë në Shqipëri" (2020) 11 Bedër Journal of Humanities (BHJ) 33.

¹⁰⁰ Ministria e Drejtësisë, *Kodi Civil i vitit 1929* (Botimet Toena 1998) neni 410, fq. 127.

¹⁰¹ Ministria e Drejtësisë, *Kodi Civil i vitit 1929* (Botimet Toena 1998) neni 1689, fq. 422.

¹⁰² Ministria e Drejtësisë, *Kodi Civil i vitit 1929* (Botimet Toena 1998) fq. 413, sipas të cilit: "kontrata e shoqërisë ishte kontrata me anë të së cilës dy ose më shumë persona bënë marrëveshje midis tyre për të realizuar një qëllim ekonomik të përbashkët me anë të zotërimeve apo përdorimit të një apo më shumë sendeve (me natyrë pasurore ose kontribute në natyrë), apo industrisë që mund të disponojë secili prej tyre".

¹⁰³ Ministria e Drejtësisë, *Kodi Civil i vitit 1929* (Botimet Toena 1998) fq. 413.

¹⁰⁴ Ministria e Drejtësisë, *Kodi Civil i vitit 1929* (Botimet Toena 1998) neni 1661, fq. 415.

¹⁰⁵ Fatri Islamaj, "Një analizë Juridike e Shoqërive Tregtare në Kodin Civil të Periudhës së Monarkisë në Shqipëri" (2020) 11 Bedër Journal of Humanities (BHJ) 33.

¹⁰⁶ Po aty.

Shoqëria universale kategorizohet në dy lloje kryesore, që ishin: i) shoqëria universale e pasurive dhe ii) shoqëria universale e fitimeve.¹⁰⁷ Shoqëria universale e pasurive, ashtu siç kuptohet dhe nga emërtimi i saj, përbëhet nga të gjitha pasuritë e momentit të anëtarëve të saj, pasuritë e luajtshme dhe të paluajtshme në kohën e lidhjes së kontratës, si dhe nga dobitë që mund të nxirreshin prej tyre. Po ashtu, me marrëveshje të anëtarëve të saj, shoqëria universale e pasurive mund të kishte për objekt dhe të përfshinte edhe pasuritë që do të përfitonin (*vetësonin*) secili prej anëtarëve të saj mbas formimit të shoqërisë.¹⁰⁸ Megjithatë kishte një kategori pasurish të anëtarëve të kësaj shoqërie, të cilat, si rregull, nuk konsideroheshin pjesë e shoqërisë. Këto pasuri ishin ato sende ose të mira që i rridhnin anëtarëve të saj me anë të trashëgimit apo dhurimit dhe nuk përfshiheshin në objektin e shoqërisë universale. Ky ishte rregulli i përgjithshëm, por përjashtimisht edhe këto pasuri mund të viheshin në përdorim të shoqërisë nëse ekzistonte një marrëveshje mes ortakëve për këtë të drejtë përdorimi ose gëzimi¹⁰⁹.

Shoqëria universale e fitimeve kishte për objekt të saj vetëm fitimet e palëve për aq kohë sa ekzistonte shoqëria. Pra siç nënkupton dhe emërtesa e këtyre shoqërive universale të fitimeve, në ndryshim nga shoqëria universale e pasurive, ortakët e këtyre shoqërive vinin në dispozicion të shoqërisë të gjitha fitimet e realizuara prej tyre nga aktiviteti tregtar, gjatë kohës që ishin anëtarë (ortak) të këtyre shoqërive, por nuk vinin në dispozicion pasurinë që ata dispononin më përpara nga burime të ndryshme.¹¹⁰

Shoqëria universale e fitimeve, edhe pse nuk përvetësonte / përfshinte pasuritë e luajtshme apo të paluajtshme të anëtarëve të saj në kohën e kontratës, megjithatë kishte të drejtën e gëzimit të këtyre pasurive.¹¹¹ Nga karakteristikat e të dyja këtyre tipave të shoqërive, mund të themi që ato ngjasojnë më shumë me shoqëritë kolektive të parashikuara nga legjislacioni aktual.

Do të ndodheshim përpara shoqërisë universale të fitimeve kur ekzistonte një deklaram nga ana e palëve për pjesëmarrjen në një shoqëri të tillë.¹¹² Pra për të përcaktuar nëse një shoqëri universale do të ishte shoqëri universale e pasurive apo shoqëri universale e fitimeve kjo varej vetëm nga vullneti i ortakëve të shoqërisë, i cili duhej të ishte i shprehur qarte nga secili ortak. Në dallim nga shoqëria universale e fitimeve, shoqëria universale e pasurive kërkonte një angazhim dhe kontribut më të madh të ortakëve të saj të cilët

¹⁰⁷ Ministria e Drejtësisë, *Kodi Civil i vitit 1929* (Botimet “Toena”, 1998) fq. 414.

¹⁰⁸ Po aty, fq. 414.

¹⁰⁹ Po aty, fq. 414.

¹¹⁰ Fatri Islamaj, “Një analizë Juridike e Shoqërive Tregtare në Kodin Civil të Periudhës së Monarkisë në Shqipëri” (2020) 11 *Bedër Journal of Humanities* (BHJ) 33.

¹¹¹ Ministria e Drejtësisë, *Kodi Civil i vitit 1929* (Botimet Toena 1998) neni 1659, fq. 414.

¹¹² Po aty, neni 1660, fq. 415.

investonin në shoqëri dhe pasuritë e tyre të tashme, ose dhe të ardhme, sipas marrëveshjes së tyre.¹¹³

Ndërsa Shoqëria e pjesshme (partikolare) nënkuptonte shoqërinë që kishte për objekt të saj vetëm sende të përcaktuara, përdorimin e tyre apo fryteve që mund të rridhnin prej tyre si dhe ndarjen e punëve apo të sendeve nga ana e anëtarëve të saj për ushtrimin e përbashkët të një mjeshtërie, apo sipërmartjeje.¹¹⁴ Në këto shoqëri ortakët e tyre nuk ofrojnë të gjithë pasurinë e tyre, por vetëm një pjesë të saj.¹¹⁵ Pra, në shoqëritë partikolare, ortakët e këtyre shoqërive kanë një pavarësi më të madhe, përsa i përket gëzimit të pasurive të tyre të papërfshira në shoqëri dhe si rrjedhojë, një ekspozim më të vogël ndaj riskut që vjen prej borxheve të shoqërisë.¹¹⁶

Po ashtu, shoqëritë e krijuara me kontratë sipas nenit 1655 e vijues të K.C. të vitit 1929, kanë si element thelbësor mirëbesimin reciprok mes ortakëve të shoqërisë dhe mbështetjen te njëri-tjetri për shkak të cilësive personale (*intuitu personae*) në formimin e kësaj shoqërie.¹¹⁷

Shoqëritë tregtare të formuara sipas dispozitave të K.C. të vitit 1929, referuar nenit 1689 të tij, mund të fitonin personalitet juridik dhe të gëzonin të drejtën për të marrë mbi vete të drejta dhe detyrime përveç atyre të drejtave dhe detyrimeve për të cilat janë përjashtuar apo kufizuar me ligj, apo ato që lidhen me cilësitë e veçanta të personit fizik.¹¹⁸ Kushti formal që shoqëria të fitonte personalitetin juridik, ishte që të kryhej një procedurë e posaçme regjistrimi e parashikuar në nenet 1689 dhe 410 të K.C. të vitit 1929. Sipas kësaj procedure, shoqëritë duhet të regjistroheshin në një regjistër të posaçëm, i cili ishte pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të vendit ku kishte qendrën e administrimit shoqëria.¹¹⁹

Shoqëritë tregtare si persona juridikë përfaqësohen nga organet drejtuese të tyre që janë administratori ose administratorët. Veprimet e administratorit e ngarkojnë shoqërinë më përgjegjësi për çdo veprim të kryer në emër të saj. Referuar nenit 414 të Kodit parashikohet dhe përgjegjësia ndaj personit juridik për veprimet e kryera nga përfaqësuesit shoqërisë.¹²⁰ Shoqëria tregtare si person juridik mban përgjegjësi edhe për veprimet e paligjshme të organeve të saj drejtuese, pasi këto organe konsiderohen pjesë integrale e personit

¹¹³ Fatri Islamaj, “Një analizë Juridike e Shoqërive Tregtare në Kodin Civil të Periudhës së Monarkisë në Shqipëri” (2020) 11 *Bedër Journal of Humanities* (BHJ) 33.

¹¹⁴ Ministria e Drejtësisë, *Kodi Civil i vitit 1929* (Botimet Toena 1998) neni 1662, fq. 415.

¹¹⁵ Fatri Islamaj, “Një analizë Juridike e Shoqërive Tregtare në Kodin Civil të Periudhës së Monarkisë në Shqipëri” (2020) 11 *Bedër Journal of Humanities* (BHJ) 33.

¹¹⁶ Po aty.

¹¹⁷ Po aty.

¹¹⁸ Po aty.

¹¹⁹ Po aty.

¹²⁰ Po aty.

juridik.¹²¹ Megjithatë, në raste të tilla përfaqesuesi i shoqërisë duhet të kompensojë shoqërine për dëmin e shkaktuar.

Në K.C. të vitit 1929 nuk parashikoheshin dispozita¹²² për shoqëritë aksionare. Po ashtu në këtë kod nuk parashikohej shprehimisht shoqëria me përgjegjësi të kufizuar sipas konceptit të legjislacionit të sotëm. Pra, në K.C. të vitit 1929, parashikohen vetëm shoqëritë e personit të analizuara më lart dhe jo shoqëritë e kapitalit.¹²³

Shoqëritë partikolare janë një nga modelet fillestare në legjislacionin shqiptar ku shfaqen disa karakteristika të ngjashme me shoqërinë me përgjegjësi të kufizuar. SHPK-të do të parashikoheshin shprehimisht në Kodin Tregtar të vitit 1932, si "*shoqni me garanci të kufizuese*".¹²⁴

Sipas paragrafit të fundit të nenit 95¹²⁵ të Kodit Tregtar të vitit 1932, parashikohet edhe detyrimi që të gjitha shoqëritë tregtare të themeluara në bazë të ligjeve të tjera, siç ishin shoqëritë që themeloheshin në bazë të K.C. të vitit 1929, do t'u nënshtrohen dispozitave të ligjit të ri, që ishte Kodi Tregtar. Ky parashikim u vinte të gjitha shoqëritë tregtare detyrimin që të përshtateshin me rregullimet e Kodit Tregtar të vitit 1932, dhe të organizoheshin në njërin nga format e shoqërive të parashikuara në nenin 95 të tij.¹²⁶

ii) Detyrimet midis anëtarëve të shoqërisë

Kodi Civil i Monarkisë shqiptare parashikonte detyrimet midis ortakëve të shoqërisë, si dhe kundrejt të tretëve. Termi i përdorur për ortakët e shoqërisë apo anëtarët themelues të shoqërisë tregtare në dispozitat e K.C. të vitit 1929 është shprehja "shok".¹²⁷ Me këtë shprehje duhet të kuptojmë të drejtat dhe detyrimet e ortakëve në një shoqëri tregtare. Gjithashtu, siç edhe për kontratat e tjera, kërkohej që objekti veprimtarisë së shoqërisë të jetë i ligjshëm dhe të mos jetë kundërshtim me ligjin dhe parimet e së drejtës.¹²⁸

Kjo shprehje e përdorur për ortakët, si dhe vetë mënyra e krijimit të shoqërive me shfaqjen e përbashkët të vullnetit prej dy ose më shumë personave, për të realizuar një qëllim të

¹²¹ Balltazar Benussi, *Obligimet dhe kontratat përgjithësisht: Titulli II i librit IV të Kodit Civil* (Botim i Ministrisë së Drejtësisë 1932) fq. 135.

¹²² Ministria e Drejtësisë, *Kodi Civil i vitit 1929* (Botimet "Toena", 1998).

¹²³ Fatri Islamaj, "Një analizë Juridike e Shoqërive Tregtare në Kodin Civil të Periudhës së Monarkisë në Shqipëri" (2020) 11 *Bedër Journal of Humanities* (BHJ) 33.

¹²⁴ Shih nenin 143 e vijues të Kodit Tregtar të vitit 1932 botuar ne Fletoren Zyrtare të dt. 5 mars 1932.

¹²⁵ Shih nenin 95 të Kodit Tregtar të vitit 1932 botuar ne Fletoren Zyrtare të dt. 5 mars 1932.

¹²⁶ Fatri Islamaj, "Një analizë Juridike e Shoqërive Tregtare në Kodin Civil të Periudhës së Monarkisë në Shqipëri" (2020) 11 *Bedër Journal of Humanities* (BHJ) 33.

¹²⁷ Po aty.

¹²⁸ Balltazar Benussi, *Obligimet dhe kontratat përgjithësisht: Titulli II i librit IV të Kodit Civil* (Botim i Ministrisë së Drejtësisë, 1932), fq. 102.

përbashkët ekonomiko-tregtar, provon karakterin personal (dhe jo të kapitalit, si në rastin e korporatave) të këtyre shoqërive. Pra mund të themi që këto shoqëri themeloheshin nga ortakët e tyre, duke u mbështetur kryesisht në mirëbesimin reciprok dhe në cilësitë e veçanta të secilit ortak. Këto karakteristika janë tipike të shoqërive të personit, ndryshe nga veçoritë e shoqërive të kapitalit, të cilat do të përfshiheshin në Kodin Tregtar të vitit 1932, të miratuar tri vite pas miratimit të K.C.¹²⁹

Ndër të tjera, dispozitat e K.C. të Monarkisë sanksiononin detyrimin e pjesëtarit të shoqërisë për të paguar kamatëvonesën në rast të mosplotësimit të shumës (kapitalit) që rrjedh nga pjesëmarrja në shoqëri. Ky koncept i detyrimeve të ortakëve ndaj shoqërisë ekziston dhe sot në ligjin aktual 9901/2008, dhe është një nga detyrimet bazë edhe për ortakët e një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar.¹³⁰

Po ashtu, parashikohet që ortaku që kishte marrë prej buxhetit të shoqërisë një shumë të caktuar parash dhe e kishte përdorur për përmbushjen e qëllimeve personale, detyrohet për pagimin e kamatës që prej ditës që kishte marrë këtë shumë. Rezulton që edhe në këtë kod në mënyrë të ngjashme, si dhe në legjislacionin aktual për SHPK-të, ishin parashikuar parimet e shmangies së konfliktit të interesit.¹³¹

Ky kod i njihte të drejtën ortakëve të tjerë të shoqërisë për të kërkuar edhe dëmshpërblime më të mëdha se kamatëvonesa. Në kod nuk përcaktohet se sa do të ishte vlera financiare e dëmshpërblimit, por një vlerësim i tillë lihet në kompetencë të vetë ortakëve ose në rast mosmarrëveshjeje, në kompetencë të gjykatës.¹³²

Gjithashtu parashikohet edhe përgjegjësia civile për veprimet e ndërmarra nga ortakët në shoqëri. Kodi parashikon, që: asnjë prej ortakëve të shoqërisë nuk mund të ngarkojë shoqërinë me detyrime për shkak të interesave të tij personalë, apo për interes të një të treti.¹³³ Me këto dispozita konstatohet që K.C. i vitit 1929 ka siguruar një mbrojtje të veçantë për pasurinë e shoqërisë tregtare, duke disiplinuar ortakët që të mos trajtojnë pasurinë e shoqërisë si pasuri personale të tyre. Pra, që në këtë kohë ka pasur parashikime të qarta për shmangien e konfliktit të interesit në veprimtarinë e shoqërive tregtare. Shmangia e konfliktit të interesit është një sfidë aktuale e legjislacionit tregtar edhe në ditët

¹²⁹ Fatri Islamaj, “Një analizë Juridike e Shoqërive Tregtare në Kodin Civil të Periudhës së Monarkisë në Shqipëri” (2020) 11 *Bedër Journal of Humanities* (BJH) 33.

¹³⁰ Po aty.

¹³¹ Ligji 9901/2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” i ndryshuar, neni 13.

¹³² Ministria e Drejtësisë, *Kodi Civil i vitit 1929* (Botimet Toena 1998) neni 1663, fq. 415-416.

¹³³ Po aty, neni 1664, fq. 416. Në nenin 1664 thuhet se: “Asnjëri prej shokëve nuk mund të bëjë për llogari personale të veta ose të tjetrit ndonjë veprim që mund t’i shkaktojë dëm shoqërisë”.

e sotme, përse i përket respektimit korrekt të marrëdhënieve mes ortakut dhe shoqërisë, qoftë në shoqëritë me përgjegjësi të kufizuara, apo edhe në format e tjera të shoqërive.¹³⁴

Një parashikim i rëndësishëm që lidhet dhe me të drejtat e ortakëve në shoqërinë tregtare ishte përfshirë në nenin 1669, i cili rregullonte ndarjen e fitimit në këto shoqëri.¹³⁵ Kodi parashikonte se të drejtat dhe detyrimet janë në mënyrë proporcionale me kontributin e secilit ortak në kapitalin fillestar të shoqërisë. Ky proporcionalitet duhet të respektohej, qoftë në ndarjen e fitimit, qoftë në humbjet e shoqërisë. Ky përcaktim ishte i ngjashëm me mënyrën sesi ligji aktual 9901/2008, ka parashikuar për ndarjen e fitimit për SHPK-të.¹³⁶

Në K.C. të asaj kohe parashikohej se ortakët mund të kontribuonin edhe me shërbime.¹³⁷ Kjo është një karakteristikë për shoqëritë e personit dhe nuk haset te SHPK-të. Në lidhje me të drejtat e ortakut të shoqërisë, i cili ka kontribuar vetëm me shërbime, parashikohej që pjesa e fitimit dhe humbjes është e barasvlefshme me atë të anëtarit të shoqërisë që ka kontribuar më pak.¹³⁸ Por, kodi parashikonte që ortakët në kontratën e shoqërisë mund të bëjnë një rregullim të ndryshëm nga sa u citua më lart për parimin e proporcionalitetit.¹³⁹

Pra, ligji civil i kohës, i jepte prioritet autonomisë së vullnetit të palëve në përcaktimin e raportit të fitimit të secilit (pra, të drejtave të secilit ortak), me kusht që të jetë i shprehur ky vullnet në kontratën e shoqërisë. Fakti që ky vullnet duhet të ishte i shprehur në kontratë, do të thotë që për të pasur një mënyrë të ndarjes së fitimit të ndryshme nga parimi i proporcionalitetit me kontributet, duhet të shprehet vullneti (vendim) unanim i të gjithë ortakëve të shoqërisë, pasi kontrata e shoqërisë duhet të nënshkruhej nga të gjithë ortakët.¹⁴⁰

K.C. i vitit 1929 kishte parashikuar dhe një mënyrë tjetër të ndarjes së fitimit dhe të humbjes për secilin ortak. Mënyrë kjo që nuk gjen aplikim në legjislacionin e sotëm. Sipas kësaj mënyre parashikohej që edhe një person i tretë (pra, jashtë shoqërisë) mund të ngarkohej për të caktuar pjesën e fitimit dhe të humbjes për secilin ortak të shoqërisë.¹⁴¹ Në një rast të tillë, Kodi parashikonte mundësinë e ortakëve për të kundërshtuar këtë mënyrë të ndarjes së fitimit, nëse nuk ishin dakord. Një kundërshtim i tillë mund të bëhej në një

¹³⁴ Fatri Islamaj, "Një analizë Juridike e Shoqërive Tregtare në Kodin Civil të Periudhës së Monarkisë në Shqipëri" (2020) 11 Bedër Journal of Humanities (BHJ) 33.

¹³⁵ Ministria e Drejtësisë, *Kodi Civil i vitit 1929* (Botimet Toena 1998) neni 1664, fq. 416.

¹³⁶ Në nenin 76 pika 2 të Ligjit 9901/2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" i ndryshuar parashikohet si vijon: "Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në statut, fitimi u shpërndahet ortakëve në raport me kuotat e zotëruara."

¹³⁷ Ministria e Drejtësisë, *Kodi Civil i vitit 1929* (Botimet Toena 1998) neni 1664, fq. 416.

¹³⁸ Po aty neni 1669, fq. 417.

¹³⁹ Fatri Islamaj, "Një analizë Juridike e Shoqërive Tregtare në Kodin Civil të Periudhës së Monarkisë në Shqipëri" (2020) 11 Bedër Journal of Humanities (BHJ) 33.

¹⁴⁰ Po aty.

¹⁴¹ Po aty.

afat tremujor, në të kundërt kjo e drejtë parashkruhej. Kjo e drejtë lindte në rastin kur ortakun i shoqërisë, që pretendonte se ishte dëmtuar, ka marrë dajeni për dëmin.¹⁴²

Ashtu si në ligjin aktual 9901/2008, edhe në K.C. të vitit 1929 ka pasur parashikime që rregullonin pavlefshmërinë e kontratës së shoqërisë tregtare, pra të themelimit të shoqërisë. Sipas nenit 1671 të K.C.¹⁴³ të kohës përcaktohet se kontrata e shoqërisë tregtare është e pavlefshme në rast se ortakët e saj janë përjashtuar nga e drejta për të përfituar prej saj fitimet, si dhe për të marrë pjesë në humbjet e shoqërisë.¹⁴⁴ Megjithatë, ky rregull parashikon dhe përjashtimin e tij. Sipas paragrafit të dytë të këtij neni lejohej të përjashtohej nga humbjet ortakun i shoqërisë, i cili ka kontribuar vetëm me industrinë e tij (shërbimet e tij) në shoqëri. Subjektet e legjitimuara për të kërkuar pavlefshmërinë absolute të kontratës së shoqërisë tregtare ishin personat anëtarë të shoqërisë, të cilët ishin përjashtuar nga fitimet e shoqërisë apo ishin të detyruar për të kontribuar vetëm në humbjet e saj.¹⁴⁵ Parashikimi i këtij përjashtimi të përmenduar më lart, paraqet ngjashmëri me ortakun me përgjegjësi të kufizuar në një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar. Pasi, një parashikim i tillë në kontratën e shoqërisë sipas nenit 1671/2 të K.C. të vitit 1929, është bërë pikërisht për t'i krijuar një garanci një kategorie ortakësh, siç është përgjegjësia e kufizuar për humbjet e shoqërisë.¹⁴⁶

Gjithashtu në përcaktimin e të drejtave të ortakëve në shoqëri, një parashikim shumë i rëndësishëm ishte ai që lidhet me të drejtën e votës, i parashikuar në nenin 1677 të Kodit Civil të kohës. Sipas kësaj dispozite parashikohej se: “*Kur një vendim duhet të merret me shumicë, llogaritet në bazë të numrit të pjesëmarrësve*”,¹⁴⁷ pra duke i konsideruar të gjithë ortakët me të drejtë të barabartë vote. Sipas këtij parashikimi, pavarësisht nga fakti që ortakët mund të kenë kontribute të ndryshme, e drejta e votës është e barabartë.

Kjo mënyrë rregullimi paraqet një dallim me konceptin e sotëm të shoqërive me përgjegjësi të kufizuar ku sipas ligjit në fuqi, e drejta e votës në një SHPK është në proporcion të drejtë me pjesën që disponon ortakun në kapitalin e kësaj shoqërie. Ndërkohë që e drejta e votës sipas KC të vitit 1929, paraqet ngjashmëri me të drejtën e votës që kanë ortakët e shoqërisë kolektive në ligjin aktual.¹⁴⁸

¹⁴² Ministria e Drejtësisë, *Kodi Civil i vitit 1929* (Botimet “Toena” 1998) neni 1670, fq. 417.

¹⁴³ Ministria e Drejtësisë, *Kodi Civil i vitit 1929* (Botimet “Toena” 1998) neni 1671, fq. 417. Neni 1671 përcaktonte se: “*Asht nul kontrata e shoqërisë, në të cilën një apo më shumë shokë janë përjashtuar nga marrja pjesë në fitimet ose në humbjet. Megjithatë, shoku që ka vënë vetëm industrinë mund të përjashtohet nga çdo marrje pjesë në humbjet*”.

¹⁴⁴ Fatri Islamaj, “*Një analizë Juridike e Shoqërive Tregtare në Kodin Civil të Periudhës së Monarkisë në Shqipëri*” (2020) 11 *Bedër Journal of Humanities* (BJH) 33.

¹⁴⁵ Po aty.

¹⁴⁶ Fatri Islamaj, “*Një analizë Juridike e Shoqërive Tregtare në Kodin Civil të Periudhës së Monarkisë në Shqipëri*” (2020) 11 *Bedër Journal of Humanities* (BJH) 33.

¹⁴⁷ Ministria e Drejtësisë, *Kodi Civil i vitit 1929* (Botimet “Toena” 1998) neni 1677, fq. 419.

¹⁴⁸ Ligji 9901/2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” i ndryshuar, neni 25.

Ky ishte rregulli i përgjithshëm, por edhe në K.C. të vitit 1929, në nenin 1677 të tij, parashikohej dhe përjashtimi nga ky rregull, duke i dhënë epërsi marrëveshjes mes ortakëve në rregullimin e marrëdhënies mes tyre. Nëse në kontratën e shoqërisë parashikohej një marrëveshje e ndryshme nga rregulli i përgjithshëm, që nuk u jep të gjithë ortakëve të drejtë të barabartë vote, atëherë ky parashikim ishte i zbatueshëm.¹⁴⁹

iii) Detyrimet e ortakëve të shoqërisë ndaj të tretëve

Neni 1678 parashikon që ortakët e shoqërisë nuk kanë detyrime solidare për *detat* e shoqërisë (detyrimet) përveç përjashtimeve të parashikuara me ligjet tregtare dhe me kontratë.¹⁵⁰ Ndërsa për detyrimet ndaj kreditorëve, me të cilët kanë kontraktuar personalisht vetë ortakët në funksion të sipërmarrjes tregtare të shoqërisë, ata rezultojnë të kenë detyrime në pjesë të barabarta, pavarësisht pjesës së kontributit që zotëron secili ortak në shoqëri.¹⁵¹ Nga ky rregull i përgjegjësisë së barabartë mund të bëhet përjashtim në rast se në kontratën e lidhur me kreditorin kufizohet detyrimi i ortakut të shoqërisë deri në pjesën që ai ka në shoqëri.¹⁵²

Pra, siç rezultojnë nga nenet 1678 dhe 1679 të K.C. të vitit 1929, është parashikuar mundësia që ortakët e një shoqërie tregtare të parashikojnë klauzola të tilla në kontratat me kreditorët, të cilat u garantojnë këtyre ortakëve një përgjegjësi të kufizuar për borxhet, deri në pjesën që ortaku ka në shoqërinë tregtare. Ky është një koncept i ngjashëm me përgjegjësinë e kufizuar të ortakëve në shoqëritë me përgjegjësi të kufizuara, të cilat do të elaboroheshin më vonë në legjislacionin shqiptar. Më konkretisht nga Kodi Tregtar i vitit 1932 e në vijim.¹⁵³

iv) Administrimi i shoqërisë

Në K. C. të vitit 1929 parashikohej që administrimi i shoqërisë mund të bëhej nga një ose më shumë ortakë. Këtë aspekt të organizimit ortakët duhet ta zgjidhnin që në fillim në hartimin e kontratës së shoqërisë. Në rast të ndryshimit të mënyrës së administrimit, duhet të merreshin vesh mes tyre për të ndryshuar kontratën e shoqërisë. K.C. i vitit 1929 parashikonte një dallim për sa i përket qëndrueshmërisë në detyrë për administratorin, në varësi të faktit nëse administratori është caktuar në kontratën e shoqërisë, apo është caktuar

¹⁴⁹ Fatri Islamaj, “Një analizë Juridike e Shoqërive Tregtare në Kodin Civil të Periudhës së Monarkisë në Shqipëri” (2020) 11 Bedër Journal of Humanities (BHJ) 33.

¹⁵⁰ Po aty.

¹⁵¹ Po aty.

¹⁵² Ministria e Drejtësisë, *Kodi Civil i vitit 1929* (Botimet “Toena” 1998) neni 1678-1679, fq. 419-420.

¹⁵³ Fatri Islamaj, “Një analizë juridike e Shoqërive Tregtare në Kodin Civil të Periudhës së Monarkisë në Shqipëri” (2020) 11 Bedër Journal of Humanities (BHJ) 33.

si administrator me një akt të mëvonshëm.¹⁵⁴ Në rastin e parë kur administratori është caktuar në kontratën e shoqërisë, kohëzgjatja në detyrë sipas ligjit nuk lidhet me ndonjë afat të caktuar kohor, mjafton që administratori të veprojë në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi dhe në interes të shoqërisë. Ndërsa, në rastin e dytë, kur administratori është caktuar si administrator me një akt të mëvonshëm, atëherë vendimi i emërimit të këtij administratori është i revokueshëm në çdo kohë, si porosia (kontrata e porosisë). Konstatohet që kur administratori është caktuar në kontratën e shoqërisë, kemi të bëjmë me një administrator shumë më të qëndrueshëm, pasi ky administrator është pjesë e vetë vullnetit të themelimit të shoqërisë dhe qëndrueshmëria e tij lidhet me vetë fatin (suksesin) e shoqërisë së themeluar me kontratë.¹⁵⁵

Në rast se detyra e administrimit u është ngarkuar disa ortakëve, por pa u specifikuar tagrat e administrimit (pra pa iu përcaktuar funksione të caktuara secilit administrator) dhe pa përcaktuar që duhet të vepronë së bashku, atëherë secili prej tyre ka të drejtë të bëjë veçmas të gjitha veprimet e administrimit të shoqërisë.¹⁵⁶ Në një rast të tillë të gjithë administratorët konsiderohen të barabarte, njëjloj si dhe përfaqësuesit me prokurë solidare, ku secili prej tyre ka të drejtë të kryejë veçmas të gjitha veprimet e përfaqësimit.¹⁵⁷ Në rastet kur është rënë dakort në aktin e emërimit që administratorët duhet të vendosin me unanimitet apo me shumicë të caktuar, atëherë duhet të respektohet ky parashikim dhe administratorët nuk mund të kryejnë veçmas veprimet e administrimit të shoqërisë.¹⁵⁸ Bëjnë përjashtim vetëm veprime të ngutshme, shmangia e të cilave do t'i shkaktonte shoqërisë dëm të rëndë dhe të pariparueshëm.¹⁵⁹

Ligji i kohës, në nenin 1675, përcaktonte një sërë rregullash të detyrueshëm lidhur me mënyren e administrimit të shoqërisë në rastet kur mungonte marrëveshja specifike midis ortakëve të një shoqërie tregtare për administrimin e saj.¹⁶⁰

¹⁵⁴ Ministria e Drejtësisë, *Kodi Civil i vitit 1929* (Botimet "Toena", 1998) neni 1672, fq. 418.

¹⁵⁵ Fatri Islamaj, "Një analizë juridike e Shoqërive Tregtare në Kodin Civil të Periudhës së Monarkisë në Shqipëri" (2020) 11 *Bedër Journal of Humanities* (BHJ) 33.

¹⁵⁶ Po aty.

¹⁵⁷ Balltazar Benussi, *Obligimet dhe kontratat përgjithësisht: Titulli II i librit IV të Kodit Civil* (Botim i Ministrisë së Drejtësisë 1932) fq. 148.

¹⁵⁸ Ministria e Drejtësisë, *Kodi Civil i vitit 1929* (Botimet "Toena" 1998) neni 1672, fq. 418

¹⁵⁹ Fatri Islamaj, "Një analizë juridike e Shoqërive Tregtare në Kodin Civil të Periudhës së Monarkisë në Shqipëri" (2020) 11 *Bedër Journal of Humanities* (BHJ) 33.

¹⁶⁰ Ministria e Drejtësisë, *Kodi Civil i vitit 1929* (Botimet "Toena" 1998) neni 1675 parashikon se:

" a) *Prezumehet që çdo ortak i shoqërisë, mund të gëzojë të drejtën për të kryer veprime administrimi të shoqërisë edhe në rastin kur nuk ka marrë miratimin paraprak të anëtarëve të tjerë të shoqërisë. Në një rast të tillë çdo anëtar i shoqërisë ka të drejtën të kundërshtojë veprimin e ndërmarrë nga pjesëtari tjetër që ka vepruar në cilësinë e administratorit para se të përfundohet ky veprim. Këto kompetenca administrimi në lëgjislacionin e sotëm i hasim te shoqëria kolektive tek e cila të gjithë ortakët e saj mund të ushtrojnë kompetenca administruese.*

b) *Çdo ortak i shoqërisë gëzon të drejtën e administrimit të aseteve të shoqërisë sipas destinacionit që ato kanë, mjafton që të mos vijnë në kundërshtim me interesat e shoqërisë dhe as të mos ndalohen ortakët e tjerë t'i përdorin.*

Në çdo rast ky kod parashikonte detyrimin e çdo ortaku të shoqërisë për të mos ndryshuar destinacionin e sendeve të shoqërisë pa miratimin e ortakëve të tjerë edhe nëse i konsideronte të dobishme për shoqërinë.¹⁶¹ Në rastet kur shoqëria me një akt të posaçëm ka caktuar një apo disa ortakë si administratorë, vetëm këta ortakë mund të kryejnë veprime administrimi, ndërsa ortakëve të tjerë nuk u lejohej.¹⁶² Megjithatë ortakët e shoqërisë, të cilët nuk kishin detyra administruese, gëzonin të drejtën e informimit mbi librat dhe aktet e shoqërisë.¹⁶³ Madje, për të garantuar të drejtën e informimit në shoqëri, parashikohej shprehimisht në ligj, që çdo klauzolë e kontratës apo marrëveshjes që ndalon të drejtën e informimit të ortakëve të tjerë është e pavlefshme.¹⁶⁴

Ky kod, në nenin 414 parashikonte dhe përgjegjësinë e administratorëve për dëmet që mund t'i shkaktojnë ata shoqërisë. Në bazë të kësaj dispozite administratorët e shoqërisë ishin personalisht përgjegjës për dëmet që i shkaktonin shoqërisë me veprimet e tyre të kryera me faj. Kjo do të thotë që përgjegjësia personale e administratorit lidhet vetëm me kryerjen e një veprimi në dëm të shoqërisë me dashje ose pakujdesi të rëndë.¹⁶⁵ Gjithsesi në raport me kreditorët dhe dëmet që mund t'u shkaktohen atyre nga administratori i shoqërisë ishte përgjegjësia e shoqërisë¹⁶⁶ për të shlyer dëmin kreditorit.¹⁶⁷

v) Mbarimi i shoqërisë dhe likuidimi i saj

K.C. i vitit 1929 kishte parashikuar dhe mënyrat me anë të të cilave shoqëria mbaronte.¹⁶⁸ Sipas nenit 1680 këto mënyra ishin:

1. *Me kalimin e kohëzgjatjes për të cilën është lidhur kontrata;*
2. *Më humbjen e sendit objekt kontrate apo me përfundimin e punës;*
3. *Me vdekjen e njërit prej ortakëve të shoqërisë;*
4. *Me paaftësinë dhe falimentin e njërit prej ortakëve të shoqërisë;*
5. *Me vullnetin e lirë të secilit ortak të shoqërisë.*¹⁶⁹

c) Çdo ortak i shoqërisë gëzon të drejtën për t'u kërkuar ortakëve të tjerë të shoqërisë për të kontribuar në shpenzimet e nevojshme lidhur me ruajtjen e aseteve (pasurive) të shoqërisë."

¹⁶¹ Ministria e Drejtësisë, *Kodi Civil i vitit 1929* (Botimet "Toena" 1998) neni 1675, fq. 418-419.

¹⁶² Fatri Islamaj, "Një analizë Juridike e Shoqërive Tregtare në Kodin Civil të Periudhës së Monarkisë në Shqipëri" (2020) 11 *Bedër Journal of Humanities* (BHJ) 33.

¹⁶³ Ministria e Drejtësisë, *Kodi Civil i vitit 1929* (Botimet "Toena" 1998) neni 1676, fq. 419.

¹⁶⁴ Fatri Islamaj, "Një analizë juridike e Shoqërive Tregtare në Kodin Civil të Periudhës së Monarkisë në Shqipëri" (2020) 11 *Bedër Journal of Humanities* (BHJ) 33.

¹⁶⁵ Po aty.

¹⁶⁶ Po aty.

¹⁶⁷ Balltazar Benussi, *Obligimet dhe kontratat përgjithësisht: Titulli II i librit IV të Kodit Civil* (Botim i Ministrisë së Drejtësisë, 1932) fq. 135.

¹⁶⁸ Fatri Islamaj, "Një analizë juridike e Shoqërive Tregtare në Kodin Civil të Periudhës së Monarkisë në Shqipëri" (2020) 11 *Bedër Journal of Humanities* (BHJ) 33.

¹⁶⁹ Ministria e Drejtësisë, *Kodi Civil i vitit 1929* (Botimet "Toena", 1998) neni 1680, fq. 420.

Sipas pikës së pestë të këtij neni parashikohet që secili nga ortakët e shoqërisë kishte të drejtë që të kërkonte zgjidhjen e kontratës së shoqërisë për shkaqe të arsyeshme. Në rast se kjo kërkesë nuk pranohej nga ortakët e tjerë, atëherë ortakët mund t'i drejtohej gjykatës për të vendosur zgjidhjen e shoqërisë me vendim gjyqësor.¹⁷⁰ Po ashtu, parashikohet mundësia që ortakët të mund t'i drejtohen gjykatës edhe me një kërkesë për përjashtimin e ortakut, i cili me sjelljet e tij e çon shoqërinë drejt zgjidhjes pa shkaqe të arsyeshme, duke i kërkuar kështu gjykatës që shoqëria të vazhdojnë mes ortakëve të tjerë.¹⁷¹

Ky kod, që në atë kohë parashikonte konceptin e përjashtimit të ortakut si mënyrë për "shërimin" e krizave apo konflikteve në shoqëri. Ky koncept nuk ekzistonte në legjislacionin për shoqëritë tregtare gjatë viteve 1992 - 2008 në Shqipëri. Dispozitat për largimin e ortakut me vullnetin e tij dhe për përjashtimin e ortakut nga ortakët e tjerë u parashikuan vetëm në vitin 2008 në ligjin e ri Nr. 9901/ 2008.

vi) Likuidimi

Sipas K.C. të vitit 1929 parashikohet që pas vendimit për zgjidhjen e kontratës së shoqërisë apo mbarimit të saj për çfarëdolloj arsyeje, vijojej me procesin e likuidimit dhe ndarjes së pasurive.¹⁷² Ky kod kishte parashikuar se në lidhje me likuidimin e shoqërive duhet të zbatoheshin dispozitat që rregullonin pjesëtimin e trashëgimit, për sa është e mundur midis pjesëtarëve të një shoqërie tregtare.¹⁷³ Si rregull, në funksionin e likuidatorit të shoqërisë mund të caktohej një person që përfaqesonte në unanimitet vullnetin e të gjithë ortakëve të shoqërisë. Vetëm në rast të një mosmarrëveshjeje likuidatori emërohej nga gjykata, e cila vihej në lëvizje mbi bazën e kërkesës së një apo më shumë ortakëve.¹⁷⁴

Kodi i kohës kishte parashikuar dhe mundësinë e revokimit të likuidatorit për shkaqe të arsyeshme ose kur ai nuk përmbushte në mënyrë të rregullt detyrën.¹⁷⁵ Sipas nenit 417 e vijues të Kodit, likuidatorët kishin të njëjtin pushtet drejtues si administratorët dhe zëvendësonin administratorin në detyrën e tij. Kur kishte më shumë se një likuidator vendimet merreshin me unanimitet, përveç kur ishte urdhëruar ndryshe në aktin e emërimit.¹⁷⁶

¹⁷⁰ Po aty neni 1685, fq. 421.

¹⁷¹ Fatri Islamaj, "Një analizë Juridike e Shoqërive Tregtare në Kodin Civil të Periudhës së Monarkisë në Shqipëri" (2020) 11 *Bedër Journal of Humanities* (BHJ) 33.

¹⁷² Po aty.

¹⁷³ Ministria e Drejtësisë, *Kodi Civil i vitit 1929* (Botimet "Toena", 1998) neni 1686, fq. 422.

¹⁷⁴ Ministria e Drejtësisë, *Kodi Civil i vitit 1929* (Botimet "Toena", 1998) neni 1687, fq. 422.

¹⁷⁵ Ministria e Drejtësisë, *Kodi Civil i vitit 1929* (Botimet "Toena", 1998) neni 1687, fq. 422.

¹⁷⁶ Fatri Islamaj, "Një analizë juridike e Shoqërive Tregtare në Kodin Civil të Periudhës së Monarkisë në Shqipëri" (2020) 11 *Bedër Journal of Humanities* (BHJ) 33.

Likuidatorët kishin për detyrë të mbarojnë punët që ishin nisur dhe duheshin përfunduar, të mbledhin (arkëtojnë) kreditë, të shesin aktivet dhe t'i konvertojnë në para, të bënin shlyerjen e kreditorëve dhe të ndanin tepricën e aktiveve që mbetej, mes ortakëve sipas kontributeve ose sipas kontratës.¹⁷⁷

Personaliteti juridik i shoqërisë zgjaste deri me marrjen fund të procesit të likuidimit të shoqërisë.¹⁷⁸ Pas komunikimit të këtij procesi shoqëria çregjistrohej nga regjistri i posaçëm dhe merrte fund personaliteti juridik i saj, duke pushuar së ekzistuari si një subjekt i së drejtës.¹⁷⁹

Si konkluzion mund të thuhet se në Kodin Civil të vitit 1929 ishte parashikuar mundësia e themelimit të shoqërive tregtare nëpërmjet marrëveshjes së ortakëve themelues në kontratën e shoqërisë, duke u mbështetur kryesisht në mirëbesimin reciprok dhe cilësitë e veçanta të secilit ortak (*intuitu personae*).¹⁸⁰ Në këtë kod nuk përfshiheshin në mënyrë eksplicite shoqëritë me përgjegjësi të kufizuara, të cilat për herë të parë në legjislacionin shqiptar do të përfshiheshin në Kodin Tregtar të vitit 1932, të miratuar gjatë Monarkisë, të njohura me emrin “*Shoqni me garanci të kufizueme*”.¹⁸¹

3.1.2. Kodi Tregtar i vitit 1932¹⁸²

i) Konsiderata të përgjithshme

Shoqëritë me përgjegjësi të kufizuara aktualisht janë forma më e suksesshme e organizimit të sipërmartjeve tregtare në Shqipëri. Ndërsa në periudhën nga viti 1955 e deri në miratimin e ligjit Nr.7638, datë 19.11.1992 “Për shoqëritë tregtare”, nuk mund të flitet për ekzistencën e shoqërive me përgjegjësi të kufizuar, pasi gjatë kësaj periudhe ishte e ndaluar me ligj themelimi i këtyre shoqërive, dhe gjithashtu nuk ekzistonin as parimet e ekonomisë së tregut dhe sipërmarrjes private tregtare.¹⁸³ Por në Shqipëri, para Luftës së Dytë Botërore, ka pasur një traditë të pasur juridike përsa i përket legjislacionit tregtar në përgjithësi dhe rregullimit të shoqërive me përgjegjësi të kufizuara si pjesë e llojeve të shoqërive tregtare.

¹⁷⁷ Po aty.

¹⁷⁸ Ministria e Drejtësisë, *Kodi Civil i vitit 1929* (Botimet “Toena” 1998) neni 1689, fq. 422.

¹⁷⁹ Fatri Islamaj, “Një analizë Juridike e Shoqërive Tregtare në Kodin Civil të Periudhës së Monarkisë në Shqipëri” (2020) 11 *Bedër Journal of Humanities* (BHJ) 33.

¹⁸⁰ Po aty.

¹⁸¹ Po aty.

¹⁸² Kjo pjesë permban dhe referime nga artikulli shkencor i vetë autorit Fatri Islamaj, “*Vështrim krahasues i disa instituteve të shoqërive tregtare sipas kodit tregtar të vitit 1932 dhe ligjit aktual Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare në Shqipëri*” (2020) 1 *Revista Juridike Shkencore “Jeta Juridike”* fq. 27-52.

¹⁸³ Ligji 2022/1955 “Për Pjesën e Përgjithshme të Kodit Civil” *Gazeta Zyrtare* 4 hoqi në mënyrë përfundimtare mundësinë e themelimit të shoqërive tregtare në përgjithësi, pra edhe shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar. Sipas këtij ligji nuk parashikohet fare mundësia e themelimit të personave juridikë privatë.

Në periudhën e monarkisë në Shqipëri pati një evoluim domethënës në drejtim të përmirësimit të legjislacionit në përgjithësi, por dhe atij civil në veçanti.¹⁸⁴ Statuti Themeltar i Mbretërisë i vitit 1928 në titullin IV i parashikonte krijimin e një organi legjislativ si *Këshillit të Shtetit*. Vepra e parë legjislative ishte hartimi i Kodit Tregtar në vitin 1932. Ky Kod u përgatit nga një grup ekspertësh të shquar¹⁸⁵ nën drejtimin e Kryetarit të Këshillit të Shtetit, Mehdi Frashëri.¹⁸⁶ Një nga burimet kryesore të këtij kodi veçohet, të ketë qenë Kodi Tregtar Italian që njihej edhe si "*Projekti i Vivantes*" në shenjë respekti ndaj Prof. C. Vivante, i cili ishte udhëheqësi i komisionit të ekspertëve që kishin punuar në redaktimin e tij.¹⁸⁷

Miratimi i Kodit Tregtar të vitit 1932 krijoi një infrastrukturë juridike të plotë dhe bashkëkohore përsa i përket subjekteve të së drejtës tregtare në funksion të nxitjes së një ekonomie të tregut të lirë dhe rritjes së investimeve të vendit dhe të huaja në Shqipëri.¹⁸⁸

Edhe studiues të huaj kanë shprehur vlerësimet e tyre për këtë kod;¹⁸⁹ Sipas Roberto Morozzo della Rocca, "*Në vazhdimësinë e kodeve të tjera, Zogu kishte synuar të adoptonte një kod tregtar ultramodern, shumë të hollësishëm e kompleks*".¹⁹⁰

ii) Struktura e Kodit Tregtar të vitit 1932

Në pjesën e hyrjes në këtë kod janë parashikuar dispozitat paraprake, duke filluar me përcaktimin e fushës së zbatimit të tij.¹⁹¹ Neni 2 i Kodit Tregtar të vitit 1932 (K.T. 1932) parashikonte se cilat janë veprimet juridike që duhet të konsiderohen si veprime tregtare.¹⁹²

¹⁸⁴ Për një trajtim doktrinor dhe më të hollësishëm të zhvillimit të së drejtës kushtetuese në Shqipëri shih: Aurela Anastasi, *Historia e të drejtës kushtetuese në Shqipëri 1912-1939* (Shtëpia botuese "Pegi", 2007).

¹⁸⁵ Balltazar Benussi, *Obligimet dhe kontratat përgjithësisht: Titulli II i librit IV të Kodit Civil* (Botim i Ministrisë së Drejtësisë 1932); Balltazar Benussi, *Komentaret e Kodit Civil të vitit 1929: Sendet, zotërimi dhe modifikimet e tij* dhe *Obligimet dhe kontratat përgjithësisht* (Botime të Ministrisë së Drejtësisë 1932).

¹⁸⁶ Boseta (n 84) fq. 83-84.

¹⁸⁷ Po aty fq. 83-84.

¹⁸⁸ Po aty fq. 85.

¹⁸⁹ Fatri Islamaj, "*Vështrim krahasues i disa instituteve të shoqërive tregtare sipas kodit tregtar të vitit 1932 dhe ligjit aktual Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare në Shqipëri*" (2020) 1 Revista Juridike Shkencore "Jeta Juridike" fq. 27-52.

¹⁹⁰ Roberto Morozzo Della Rocca, *Kombësia dhe feja në Shqipëri* (Shtëpia botuese "Eleni Gjika" 1994) fq. 126.

¹⁹¹ Fletore Zyrtare datë 5 Mars 1932, *Kodit Tregtar*, neni 1.

¹⁹² Fletore Zyrtare datë 5 Mars 1932, *Kodit Tregtar*, neni 2, sipas të cilit: "*Janë veprime tregtare:*

1. *blerja për shitje, shitja që rrjedh nga një blerje e mëparshme që është bërë me qëllim shitjeje dhe përgjithësisht çdo vepër në të cilën shkëmbimi është i lidhur me një tjetër vepër shkëmbimi;*
2. *çdo veprim bankar;*
3. *çdo veprim shkëmbimi;*
4. *çdo veprim me afat mbi titujt e kredisë;*
5. *krijimi i shoqërive tregtare dhe çdo veprim mbi pjesët ose mbi aksionet;*
6. *çdo veprim që i përket lundrimit;*

Ndërsa në nenin 3 të Kodit është përcaktuar prezumimi i natyrës tregtare të çdo veprimi të subjekteve tregtare me përjashtim të rasteve kur veprimet nuk kanë të bëjnë fare me tregtinë.¹⁹³ Kurse nën 4 përcakton përjashtimet nga fusha e zbatimit të kodit për veprimet që ushtrohen në sektorin e bujqësisë, përveç rasteve kur këto veprime ushtrohen si sipërmarrje transformimi ose shitje prodhimesh.¹⁹⁴

Në nenin 6 të K.T. 1932, përcaktohen se cilët janë subjektet që konsiderohen tregtarë duke përfshirë këtu personat fizikë që ushtrojnë si profesion, vepra tregtie në emër personal, si dhe shoqëritë tregtare. Ky përcaktim i termit “tregtar” është ngjashëm edhe me kuptimin që përdoret aktualisht për subjektet tregtare, duke përfshirë qoftë tregtarin si person fizik, qoftë shoqëritë tregtare.¹⁹⁵

Llojet e shoqërive tregtare prezantoheshin në pjesën e dytë të librit të parë të këtij kodi, e cila fillon me dispozita të përgjithëshme për të gjitha shoqëritë tregtare.

iii) Themelimi i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar sipas Kodit Tregtar të vitit 1932

Në nenin 95 të K.T. të vitit 1932 përcakohen llojet e shoqërive tregtare, të cilat janë: *shoqnia kolektive, shoqnia komandite, shoqnia me garanci të kufizueme, shoqnia anonime*.¹⁹⁶ Siç vërehet në K. T. të vitit 1932 parashikoheshin katër forma të shoqërive

7. *sipërmarrjet mbi të luajtëshmet ose të paluajtëshmet, si dhe ato të furniturës, të manifakturës, të sigurimeve, të depozitave, të shfaqjeve publike dhe të botimeve;*

8. *çdo veprim ndihmues ose që ka të bëjë me veprimet e mësipërme, si porosija, ndërmjetësimi, spedicioni, shoqërimi në pjesëmarrje pengu dhe dorëzania.”*

¹⁹³ Po aty, neni 3.

¹⁹⁴ Patri Islamaj, “Vështrim krahasues i disa instituteve të shoqërive tregtare sipas kodit tregtar të vitit 1932 dhe ligjit aktual “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare në Shqipëri” (2020) 1 Revista Juridike Shkencore “Jeta Juridike”, fq. 27-52.

¹⁹⁵ Fletore Zyrtare datë 5 mars 1932, *Kodit Tregtar*, në nenin 6/1 përcaktohej: “Janë tregtarë ata që ushtrojnë, si profesion, vepra tregtie në emër të vet, ashtu dhe shoqnit tregtare”.

¹⁹⁶ Fletore Zyrtare datë 5 mars 1932, *Kodit Tregtar*, neni 95, sipas të cilit:

“Shoqnit tregtare kanë për objekt ushtrimin e një ma shumë veprave tregtije, dhe dallohen në llojet vijuese:

1) *shoqnia kolektive, në të cilën obligimet shoqnore janë të garantueme, në radhën e dytë prej përgjegjësis së pakufizueme dhe solidare të të gjith shokëve;*

2) *shoqnia komandite, në të cilën obligimet shoqnore janë të garantueme, në radhën e dytë prej përgjegjësis së pakufizueme dhe solidare të njanit ose ma shume shokëve komanditarë, kurse shoku ose shokët komandues janë të detyruem vetëm me derdhjen e pjesës së tyre. Kapitali i shoqnis me emër komandite mund të pjestohet edhe në aksione;*

3) *shoqnia me garanci të kufizueme, në të cilën të gjith shokët janë të obliguem vetëm me derdhjen e një pjese të caktueme të kapitalit shoqnuer dhe ky mik pjestohet kurrë në aksione;*

4) *Shoqnia anonime në të cilën te çdo shok asht janë i obliguem vetëm me derdhjen e një pjese të caktueme të kapitalit shoqnuer dhe ky gjithmonë asht i pjestuem në aksione;*

Shoqnit e sipërtregume, kur janë konstituue ligjërisht, janë subjekte juridike të dallume nga personat e shokëvet.

Shoqnit civile, kur konstituohen ligjërisht në format e shoqnive tregtare, u shtrohen dispozitave të këtij kodi”

tregtare të cilat janë të parashikuara edhe në Ligjin aktual 9901/2008,¹⁹⁷ por gjithsesi këto rregullime kishin disa ndryshme të vogla për secilën formë. Ndryshimet më substanciale konstatohen në formën e shoqërive komandite, të cilat nuk janë objekt i këtij studimi. Ky ishte akti i parë legjislativ në vendin tonë, në të cilin u parashikua shoqëria me përgjegjësi të kufizuar dhe u rregullua në imtësi mënyra e organizimit dhe funksionimit të saj.

Në këtë kod termi “*shok*” në një shoqëri tregtare i korrespondon termit ortak sipas legjislacionit aktual. Ndërkohë emërtimi “*shoqni me garanci të kufizueme*” i korrespondon termit shoqëri me përgjegjësi të kufizuar sipas legjislacionit aktual.¹⁹⁸ Ndërkohë sipas paragrafit të fundit të nenit 95 të Kodit Tregtar të vitit 1932 parashikohet edhe detyrimi që të gjitha shoqëritë tregtare të themeluara në bazë të ligjeve të tjera, siç ishin shoqëritë që themeloheshin në bazë të Kodit Civil të vitit 1929, do t’u nënshtrohen dispozitave të ligjit të ri që është Kodi Tregtar. Ky ishte një parashikim që i detyronte të gjitha shoqëritë tregtare të përshtaten me rregullimet e Kodit Tregtar të vitit 1932 dhe të organizoheshin në njërën nga format e shoqërive të parashikuara në nenin 95 të tij.¹⁹⁹

Kontrata e shoqërisë sipas K. T. të vitit 1932 kishte karakter konstitutiv dhe rregullonte marrëdhëniet ndërmjet ortakëve të shoqërisë. Ekzistenca e një kontrate themelimi si akt i domosdoshëm në formimin e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar sipas doktrines italiane përbënte një karakteristikë të ngjashme me mënyrën e themelimit të shoqërive të personit.²⁰⁰ Në doktrinën italiane të së drejtës tregtare shoqëritë me përgjegjësi të kufizuara

¹⁹⁷ Fletore Zyrtare datë 5 mars 1932, *Kodit Tregtar*. Ligji 9901/2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” i ndryshuar.

¹⁹⁸ Patri Islamaj, “*Vështrim krahasues i disa instituteve të shoqërive tregtare sipas kodit tregtar të vitit 1932 dhe ligjit aktual “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare në Shqipëri”* (2020) 1 Revista Juridike Shkencore “Jeta Juridike”, fq. 27-52.

¹⁹⁹ Fletore Zyrtare, datë 5 mars 1932, *Kodit Tregtar*, neni 95, sipas të cilit:

“Shoqnit tregtare kanë për objekt ushtrimin e një ma shumë veprave tregtije, dhe dallohen në llojet vijuese:

- 1) *shoqnia kolektive, në të cilën obligimet shoqnore janë të garantueme, në radhën e dytë prej përgjegjesis së pakufizueme dhe solidare të të gjith shokëve;*
- 2) *shoqnia komandite, në të cilën obligimet shoqnore janë të garantueme, në radhën e dytë prej përgjegjesis së pakufizueme dhe solidare të njanit ose ma shume shokëve komanditarë, kurse shoku ose shokët komandues janë të detyruem vetëm me derdhjen e pjesës së tyne. Kapitali i shoqnis me emër komandite mund të pjestohet edhe në aksione;*
- 3) *shoqnia me garanci te kufizueme, në të cilën të gjith shokët janë të obliguem vetëm me derdhjen e një pjese të caktueme të kapitalit shoqmuier dhe ky nuk pjestohet kurrë në aksione;*
- 4) *Shoqnia anonime në të cilën te çdo shok asht janë i obliguem vetëm me derdhjen e një pjese të caktueme të kapitalit shoqmuier dhe ky gjithmonë asht i pjestuem në aksione;*

Shoqnit e sipërtregume, kur janë konstituue ligjërish, janë subjekte juridike të dallume nga personat e shokëvet.

Shoqnit civile, kur konstituohen ligjërish në format e shoqnive tregtare, u shtrohen dispozitave të këtij kodit”.

²⁰⁰ Francesco Galgano (përktheu Alban Dauti dhe Artan Fida), *E Drejta Tregtare* (Botim Kompakt i “Luarasi University Press” 2009) fq. 951. Sipas profesor Galganos, në shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar marrëdhëniet e brendshme mes ortakëve mund të modelohen sipas skemës së shoqërive të personave.

konsiderohen si shoqëri që lindin mbi bazën e një akti të përputhjes së vullnetit të ortakëve themelues, që është kontratë e themelimit të shoqërisë.²⁰¹

Përsa i përket dokumentave të themelimit, mund të themi që Kodi Tregtar paraqet një veçori në raport me mënyrën e themelimit të SHPK-ve në raport me legjislacionin aktual, sipas të cilit nuk kërkohet një kontratë themelimi, por vetëm statuti i shoqërisë.²⁰² Por edhe sipas variantit aktual, statuti përfshin dhe konceptin e aktit konstitutiv të mishëruar në vetë aktin e statutit.²⁰³ Pra, thjesht kemi të bëjmë me thjeshtim të procedurave të themelimit duke u bashkuar dy akte në një të vetëm që është statuti. Edhe sipas legjislacionit modern, SHPK-të kanë si karakteristikë faktin që për ortakët themelues paraqet një rëndësi të madhe njohja e cilësive personale të secilit prej ortakëve (*intuitu personae*), si element thelbësor për të vendosur themelimin e shoqërisë.²⁰⁴

Forma e kontratës së themelimit të shoqërisë (përfshirë dhe rastin e SHPK-ve), sipas nenit 107 të K.T. të vitit 1932 duhej të bëhet me akt publik.²⁰⁵ Ky kod përcaktonte si element të detyrueshëm të kontratës një formë me shkrim dhe solemne të saj. Ndërsa legjislacioni aktual nuk i obligon ortakët e një SHPK-je që statuti i shoqërisë të nënshkruhet domosdoshmërisht para noterit publik.²⁰⁶ Në ndryshim nga K. T. i vitit 1932, ligji për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit, aktualisht lejon që të bëhet edhe regjistrimi i shoqërisë pa u respektuar domosdoshmërisht kjo formë. Pra i jep mundësinë ortakëve që edhe pa pasur një statut apo akt themelimi, të paraqiten personalisht pranë QKB dhe të nënshkruajnë formularët përkatës të aplikimit dhe deklaratën e posaçme për njohjen, pranimin dhe zbatimin e dispozitave ligjore në fuqi.²⁰⁷

Kodi Tregtar i vitit 1932, parashikonte që për shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar të hartohen dy akte bazë gjatë themelimit (kontrata e themelimit dhe statuti), pra paraqiste me shumë ngjashmëri me parashikimet e ligjit 7638/1992 “Për shoqëritë tregtare”, tashmë i shfuqizuar, sipas të cilit për themelimin e SHPK-së duhej të hartoheshin dy akte bazë që

²⁰¹ Për një trajtim doktrinor në jurisprudencën italiane shih: Giuseppe Giacomo Auletta, *Il contratto di società commerciale* (Giuffrè 1937); Francesco Jr Ferrara dhe Francesco Corsi, *Gli imprenditori e le società* (Giuffrè 2011).

²⁰² Fatri Islamaj, “Vështrim krahasues i disa instituteve të shoqërive tregtare sipas kodit tregtar të vitit 1932 dhe ligjit aktual “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare në Shqipëri” (2020) 1 Revista Juridike Shkencore “Jeta Juridike”, fq. 27-52.

²⁰³ Thomas Bachner, Edmund-Philipp Schuster dhe Martin Winner, *Ligji i ri shqiptar për shoqëritë tregtare: interpretuar sipas burimeve të tij në të drejtën evropiane* (Dudaj 2009) fq. 98.

²⁰⁴ Argita Malltezi, *E drejta shqiptare e shoqërive tregtare* (Shtëpia botuese “Mediaprint” 2011) fq. 45.

²⁰⁵ Fletore Zyrtare, datë 5 mars 1932, *Kodit Tregtar*, neni, 107.

²⁰⁶ Ligji 9723/2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit” [2007] FZ 60 i ndryshuar për herë të fundit me Ligjin 30/2019 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9723, datë 3.5.2007, “Për regjistrimin e biznesit” [2019] FZ 99, neni 26.

²⁰⁷ Po aty, neni 28.

ishin, akti i themelimit dhe statuti.²⁰⁸ Ndërsa ligji aktual 9901/2008,²⁰⁹ për shoqëritë tregtare nuk e parashikon ekzistencën e aktit të themelimit, por vetëm të statudit.²¹⁰

Në nenin 108 të K.T. të 1932 parashikohen elementet thelbësore që duhet të përmbajë akti konstitues i shoqërisë me garanci të kufizueme, që sipas ligjit aktual i korrespondon statudit të SHPK-së. Sipas këtij neni akti konstitues duhet të përmbajë:²¹¹

- a. emrin, mbiemrin, dhe/ose nënshkrim dhe adresen e banimit të shokëve (ortakëve);
- b. emërtimin e shoqërisë, vendin e ushtrimit të aktiviteteve, selinë e shoqërisë, si dhe përfaqësive të saj;
- c. ortakët që kanë të drejtën e përfaqësimit të shoqërisë;
- d. objektin e shoqërisë, pjesën që ka secili ortak në kapitalin e saj, si dhe llojin dhe vlerën e kontributeve të ofruara nga secili ortak (si dhe mënyrën e vlerësimit) në kapitalin e shoqërisë;
- e. pjesën që do të ketë secili ortak në fitimet dhe në humbjet e shoqërisë;
- f. kohën kur shoqëria do të fillojë aktivitetin e saj, si dhe kohën kur do të përfundojë atë.²¹²

Ashtu si për kontratat e tjera, kërkohej që objekti i veprimtarisë së shoqërisë të jetë i ligjshëm dhe të mos jetë në kundërshtim me ligjin dhe parimet e së drejtës.²¹³

Sipas nenit 110 të K.T. të 1932²¹⁴ ishte përcaktuar dhe mënyra e regjistrimit të shoqërive kolektive, komandite dhe shoqërive me përgjegjësi të kufizuara. Sipas këtij kodi parashikohej që administratori i shoqërisë ose vetë noteri që ka përpiluar aktin konstituitiv, (kontratë e shoqërisë), paraqet aktin konstitues të shoqërisë me garanci të kufizuar ose një

²⁰⁸ Fatri Islamaj, “Vështrim krahasues i disa instituteve të shoqërive tregtare sipas kodit tregtar të vitit 1932 dhe ligjit aktual “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare në Shqipëri” (2020) 1 Revista Juridike Shkencore “Jeta Juridike” fq. 27-52.

²⁰⁹ Ligji 9901/2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” i ndryshuar, neni 6.

²¹⁰ Artan Hajdari shprehet se:

“Përsa i përket debatit nëse është e nevojshme ekzistenca e dy akteve apo mjafton një statut për të përmbyllur kërkesat e regjistrimit të shoqërisë, mund të themi se atë e ka zgjidhur ligji, i cili aktualisht nuk kërkon domosdoshmërisht ekzistencën e të dyja akteve. Por nëse themeluesit e një shoqërie do të zgjidhin hartimin e dy akteve, pra dhe të kontratës së themelimit dhe të statudit, duhet të marrin në konsideratë ndryshimet mes tyre”.

Artan Hajdari, “Natyra juridike e administrimit të shoqërive tregtare” (Tezë Doktorature, Fakulteti i Drejtësisë Universiteti i Tiranës 2019) fq. 37.

²¹¹ Fletore Zyrtare datë 5 mars 1932, *Kodit Tregtar*, neni 108.

²¹² Fatri Islamaj, “Vështrim krahasues i disa instituteve të shoqërive tregtare sipas kodit tregtar të vitit 1932 dhe ligjit aktual “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare në Shqipëri” (2020) 1 Revista Juridike Shkencore “Jeta Juridike” fq. 27-52.

²¹³ Balltazar Benussi, *Obligimet dhe kontratat përgjithësisht: Titulli II i librit IV të Kodit Civil* (Botim i Ministrisë së Drejtësisë 1932) fq. 102.

²¹⁴ Fletore Zyrtare datë 5 mars 1932, *Kodit Tregtar*; Ligji 9901/2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” i ndryshuar, neni 110.

shkurtim të tij të lëshuar nga noteri publik në gjykatën e qarkut ku ndodhet selia e shoqërisë, për ta regjistruar në regjistrin tregtar.²¹⁵

Procedura e regjistrimit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar sipas Kodit Tregtar të vitit 1932, fillonte te noteri publik ku hartohej akti konstitues i shoqërisë. Dhe brenda 15 ditëve ky akt duhej t'i paraqitej gjykatës së qarkut ku ndodhej selia e shoqërisë nga administratori i shoqërisë ose nga noteri. Më pas, gjyqtari që ka verifikuar (vistuar) nëse janë respektuar kushtet ligjore për llojin përkatës të shoqërisë, urdhëron regjistrimin e shoqërisë në Regjistrin e Tregtisë, i cili mbahej në Odën e Tregtisë (Dhomën e Tregtisë),²¹⁶ duke ia transmetuar kësaj Ode të Tregtisë aktin konstitues ose shkurtimin e tij, si dhe urdhrin përkatës të gjykatës. Po ashtu duhej bërë një inskriptim i njëjtë edhe në regjistrin e shoqërive që mbahej në Gjykatën e Shkallës së Parë.²¹⁷ Procedura e themelimit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar është shumë e ngjashme me procedurën e parashikuar nga Ligji Nr.7638, datë 19.11.1992 “Për shoqëritë tregtare”, i cili hyri në fuqi menjëherë pas ndryshimeve demokratike në Shqipëri.²¹⁸ I vetmi ndryshim ishte në faktin që regjistri tregtar në legjislacionin pas vitit 1992 mbahej pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, ndërsa në Kodin Tregtar të Monarkisë mbaheshin dy regjistra, njëri ishte “Regjistri i Tregtisë” në Odën (Dhomën) e Tregtisë së Qarkut dhe tjetri “Regjistri i shoqërive” që mbahej nga Gjykata e Shkallës së Parë.²¹⁹

Ndryshe nga parashikimet e K.T. të 1932, si dhe ligjit 7638/1992, në legjislacionin aktual të shoqërive tregtare, me ligjin 9723/2007, “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit” i ndryshuar dhe ligjin 9901/2008, procedura e regjistrimit të një SHPK-je është thjeshtuar akoma më shumë pasi është shmangur procedura gjyqësore dhe regjistrimi bëhet në QKB sipas parimit “one stop shop”.²²⁰ QKB është institucion që e ka qendrën në Tiranë, por ka sportelet e shërbimit edhe në bashkitë e tjera të vendit. Në këtë mënyrë ortakët themelues kursejnë kostot kohore dhe financiare (përfshirë distancën gjeografike, pasi sipas ligjit 7638/1992, regjistrimi bëhej vetëm në Gjykatën e Tiranës), të cilat lidhen me burokracitë dhe formalitetet juridike që duheshin respektuar për t’iu drejtuar Gjykatës, konsulencën juridike dhe kohëzgjatjen në fazën e regjistrimit në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë.²²¹

²¹⁵ Fatri Islamaj, “Vështrim krahasues i disa instituteve të shoqërive tregtare sipas kodit tregtar të vitit 1932 dhe ligjit aktual “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare në Shqipëri” (2020) 1 Revista Juridike Shkencore “Jeta Juridike” fq. 27-52.

²¹⁶ Po aty, fq. 27-52

²¹⁷ Po aty, fq. 27-52.

²¹⁸ Po aty, fq. 27-52.

²¹⁹ Po aty, fq. 27-52.

²²⁰ Po aty, fq. 27-52.

²²¹ Po aty, fq. 27-52.

K.T. i vitit 1932 përmbante dhe norma për publikimin e shoqërive tregtare dhe të akteve të tyre të themelimit dhe të gjitha elementet thelbësore të këtyre akteve.²²² Në nenin 123 të këtij kodi parashikohet botimi në buletin e Odës së Ekonomisë në juridiksionin e së cilës ishte shoqëria, i një shkurtimi të aktit konstitues, me të gjitha elementet e parashikuara në nenin 108 dhe 109 të kodit.²²³ Në rast se shoqëritë kishin degë në qarqe të tjera ky detyrim për botim i përcillej dhe Odave të Ekonomisë së qarqeve ku ndodhej dega e shoqërisë.²²⁴

Ky botim bëhej me iniciativën e vetë Odës së Ekonomisë dhe shërbente si një informacion për të tretët dhe kreditorët potencialë të këtyre shoqërive, në funksion të parimit të transparencës dhe garantimit të të drejtave të kreditorëve. Gjithashtu, në nenin 115 të Kodit të kohës parashikohet detyrimi që çdo ndryshim i aktit konstitues ose statutit duhet të regjistrohet në regjistrin e tregtisë për efekt të publikimit. Këto ndryshime nuk kanë efekt ndaj të tretëve deri sa të mos jenë pasqyruar me transkriptim në Regjistrin e Tregtisë.²²⁵

Nga neni 143 deri 157 të K.T. të 1932 ishin parashikuar dispozita që rregullonin posaçërisht shoqërinë me përgjegjësi të kufizuar, e titulluar si “*shoqëria me garanci të kufizueme*”.²²⁶

iv) Marrëdhëniet mes ortakëve

Sipas kodit të kohës parashikohet që kjo shoqëri nuk mund të kishte më shumë se 25 ortakë.²²⁷ Ky lloj kufizimi i numrit të ortakëve paraqiste një veçori që nuk konstatohet në legjislacionin e sotëm në fuqi 9901/2008²²⁸ dhe as në ligjin 7638/1992²²⁹.

Në këtë aspekt legjislacioni bashkëkohor për SHPK-të (teorikisht) ka kontribuar në forcimin e karakteristikave të shoqërive të kapitalit, duke mos e kufizuar numrin e ortakëve

²²² Po aty.

²²³ Po aty.

²²⁴ Fletore Zyrtare datë 5 mars 1932, *Kodit Tregtar* neni 123.

²²⁵ Fletore Zyrtare datë 5 mars 1932, *Kodit Tregtar*, neni 115.

²²⁶ Fletore Zyrtare datë 5 mars 1932, *Kodit Tregtar*, neni 143 – 157.

²²⁷ Po aty, neni 143, sipas të cilit thuhet se:

“Në shoqnit me garanci të kufizueme numri i shokëve nuk mund të jetë më shumë se 25. Kapitali shoqmuër ndahet në shumë pjesë, të cilat mund edhe të mos jenë të barabarta. Kapitali nuk duhet të jetë më pak se 10.000 fr. ari. Dhe duhet të derdhet tanësisht në kohën e konstituimit të shoqnisë. Çdo dispozitë e kundërt asht nul.”

²²⁸ Neni 68 i ligjit 9901/2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” i ndryshuar parashikon:

“1. Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar është një shoqëri tregtare, e themeluar nga persona fizikë ose juridikë, të cilët nuk përgjigjen për detyrimet e shoqërisë tregtare dhe mbulojnë personalisht humbjet e shoqërisë deri në pjesën e pashlyer të kontributeve të nënshkruara. Kontributet e ortakëve përbëjnë kapitalin e regjistruar të shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar”.

²²⁹ Ligji 7638/1992 “Për shoqëritë tregtare” [1992] FZ 8 (shfuqëzuar). Sipas neni 37 të tij përcaktohet se: “Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar themelohet nga një ose disa ortakë që përballojnë humbjet vetëm deri në kufirin e vlerës së kontributit të tyre në kapitalin themelues”. Të njëjtin parashikim e gjejmë të sanksionuar edhe në Ligjin 9901/2008 i ndryshuar, neni 68.

në shoqëri.²³⁰ Gjithsesi, nga praktika e SHPK-ve në vendin tonë, pavarësisht se ligji nuk përmban kufizime, nuk rezulton që të jetë zbatuar kjo formë shoqërie nga grupe me numër shumë të madh ortakësh. Madje këto shoqëri mund të themelohen edhe nga një person i vetëm. Si rrjedhim, mund të thuhet se është ruajtur tradita e themelimit të këtyre shoqërive nga grupe të vogla ortakësh, të cilët vlerësojnë dhe elementin e mirëbesimit reciprok të njëri-tjetri. Kjo veçori lidhet edhe me faktin se këto shoqëri ruajnë si karakteristikë të shoqërive të personit faktin se kapitali i tyre nuk i ofrohet për nënshkrim publikut të gjerë, siç ndodh me shoqëritë aksionare me ofertë publike.

Sipas nenit 148 të K.T. të 1932 parashikohet që shoqëria me përgjegjësi të kufizuar përveç librave të tregtisë, duhet të mbajë një libër të ortakëve të saj ku të shënohen gjeneralitetet e ortakëve dhe adresat e tyre, si dhe pjesa që i takon secilit ortak në kapitalin e shoqërisë. Edhe ky parashikim ekspozon qartë parimin e transparencës në aktivitetin e shoqërive tregtare, si një element i rëndësishëm në funksion të interesave të kreditorëve dhe mirëqeverisjes së shoqërive tregtare.

Marrja e vendimeve në Asamblenë e Ortakëve dhe kuorumi, rregullohen sipas nenit 153 të ligjit të Kodit Tregtar të kohës.²³¹ Në këtë dispozitë përcaktohet që vendimmarrja në Asamblenë e Ortakëve konsiderohet e vlefshme nëse një vendim është votuar nga ortakët që disponojnë shumicën e kapitalit të përfaqësuar në mbledhje dhe të paktën gjysmën e kapitalit të shoqërisë. Megjithatë ligji i ka deleguar të drejtën statutit, i cili mund të parashikojë një shumicë më të lartë (shumicë të cilësuar).

Përsa i përket pjesëmarrjes në fitim të ortakëve të shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar, Kodi Tregtar i kohës parashikonte që dividendët (ndarja e fitimit neto për ortakët²³²) duhet të jenë në proporcion me pjesën që ka secili ortak në shoqëri. Pra edhe në këtë çështje, ligji i kohës i jep autonomi statutit të shoqërisë në rregullimin e marrëdhënieve mes ortakëve dhe në caktimin e të drejtave të tyre, në mënyrë të ngjashme me legjislacionin aktual për SHPK-të.

v) Përrjashtimi i ortakut dhe tërheqja e ortakut

Në nenet 250 deri 252 të K. T të 1932 rregullohej edhe koncepti i përrjashtimit të ortakut dhe tërheqja e tij nga shoqëria. Në nenin 250 të kodit të kohës parashikohet që një ortak mund të përrjashtohet nga shoqëria në rastet e mëposhtme.²³³

²³⁰ Argita Malltezi, *E drejta shqiptare e shoqërive tregtare* (Shtëpia botuese “Mediaprint” 2011) fq. 49.

²³¹ Fletore Zyrtare datë 5 mars 1932, *Kodit Tregtar*, neni 153.

²³² Po aty, neni 156.

²³³ Po aty, neni 250.

- a) Nëse ortakut megjithëse është vënë në morë (vonesë) nuk ka paguar pjesën e plotë e tij në kapitalin e shoqërisë, ose nuk ka paguar pjesën plotësuese (në rastin e zmadhimit të kapitalit);
- b) Nëse ortakut në cilësinë e administratorit ka përdorur firmën apo kapitalin e shoqërisë në dobi të tij personale ose që bën “dredhi” në dëm të shoqërisë. Me fjalën “dredhi” duhet të kuptojmë ato veprime të kryera me keqbesim nga ana e ortakut që është adminitror nëpërmjet të cilave ai ka pasur si qëllim arritjen e interesave të tij personale në dëm të shoqërisë.
- c) Ortaku, i cili ndërhyr në mënyrë arbitrare në veprimet e administrimit të shoqërisë, pa qenë administrator i saj.
- d) Ortaku që është deklaruar si i falimentuar, i ndaluar ose i paqftë. Të tria këto cilësi mund të deklaroheshin vetëm me vendim të organit kompetent shtetëror.²³⁴

Sipas K.T të kohës, përjashtimi i ortakut nga një SHPK nuk shkakton përfundimin e shoqërisë apo likuidimin e saj. Ortaku që përjashtohet kishte të drejtën e fitimeve dhe merrte pjesë në humbjet e shoqërisë deri në ditën e përjashtimit të tij nga shoqëria. Po ashtu ortakut i përjashtuar kishte të drejtën e një shume të hollash ekuivalente me pjesën e kapitalit të tij në shoqëri, por jo të tërhiqte kapitalet e veta nëse këto janë sende, pra kapitale në natyrë.²³⁵

Në paragrafin e fundit të nenit 252 parashikohet edhe mundësia e tërheqjes së ortakut (largimit) nga shoqëria. Por, një e drejtë e tillë mund të aplikohet vetëm nëse ishte e parashikuar dhe në statutin e shoqërisë. Pra kjo ishte një e drejtë e kushtëzuar nga statuti i shoqërisë. Për tërheqjen e ortakëve nga shoqëria, Kodi parashikonte se zbatohen të njëjtat parashikime të përcaktuara në nenet 251 dhe 252, të cilat rregullojnë përjashtimin e ortakut.²³⁶

Konstatohet se në Kodin Tregtar të vitit 1932 kanë qenë të parashikuara edhe institute të tilla, si “Përjashtimi i ortakut” dhe “Tërheqja e ortakut”, të cilat në legjislacionin modern për shoqëritë tregtare janë ripërfshirë shumë vonë në Shqipëri. Ligji Nr.7638/1992 “Për shoqëritë tregtare” i cili ka qenë në fuqi deri në vitin 2008, nuk i njëjti këto koncepte për SHPK-të. Këtë fakt e konfirmon edhe jurisprudenca e Gjykatës së Lartë, e cila në vendimin Nr. 39 datë 30.05.2002²³⁷ do të arrinte në konkluzionin që një ortak nuk mund të

²³⁴ Cituar dhe në artikullin me temë Fatri Islamaj, “Vështrim krahasues i disa instituteve të shoqërive tregtare sipas kodit tregtar të vitit 1932 dhe ligjit aktual Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare në Shqipëri” (2020) 1 Revista Juridike Shkencore “Jeta Juridike” fq. 27-52.

²³⁵ Po aty, fq. 27-52.

²³⁶ Po aty, fq. 27-52.

²³⁷ Gjykata e Lartë, Vendim Unifikues i Kolegjeve të Bashkuara Nr. 39 datë 30.05.2002. Në këtë vendim Gjykata shprehet se:

përrjashtohet nga shoqëria, pavarësisht çdo lloj veprimi të tij dhe pasojave që mund t'i kenë ardhur shoqërisë.

Konceptet e përrjashtimit dhe të largimit (tërheqjes) të ortakut u përrfshinë në legjislacionin për shoqërit tregtare vetem në ligjin 9901/2008 që është në fuqi aktualisht²³⁸ Edhe në praktikën gjyqësore shqiptare, rastet e përrjashtimit dhe largimit të ortakut janë evidentuar pas hyrjes në fuqi të ligjit aktual, dhe jurisprudenca akoma nuk është e harmonizuar në zbatimin e këtyre koncepteve.²³⁹

Fakti që dispozitat për përrjashtimin dhe tërheqjen e ortakëve të SHPK-së janë parashikuar në këtë kod që në vitin 1932, provon cilësinë e lartë të Kodit Tregtar të vitit 1932 dhe largpamësinë e ekspertëve që kanë punuar në hartimin e dispozitave të tij.²⁴⁰

vi) Kapitali themeltar sipas Kodit Tregtar të vitit 1932

Sipas nenit 143/2 të K.T. të 1932 parashikohej një kapital minimal i domosdoshëm për themelimin e shoqërisë me *garanci të kufizueme* (sot e njohur si SHPK). Ky kapital nuk mund të ishte me i vogël se 10.000 (dhjetë mijë) Franga Ari, e cila ishte monedha me kurs ligjor e kësaj periudhe në shtetin shqiptar.²⁴¹ Kjo shumë përfaqësonte një vlerë të konsiderueshme për kohën dhe përbënte një nxitje dhe shtysë domethënëse në aspektin e kapitalit fillestar për nisjen e një aktiviteti tregtar. Neni 144 i Kodit parashikonte që kontributet në para depozitoheshin në një bankë dhe Gjykata verifikon transkriptimin përkatës që provon se kapitali në para është depozituar pranë bankës dhe do të përdoret vetëm nga shoqëria.²⁴² Këto depozitime në të holla të ortakëve të shoqërisë nuk mund të tërhiqeshin më prej tyre, por vetëm nga administratori i shoqërisë së sapothemeluar.²⁴³

Pra, ndryshe nga sa parashikon ligji aktual 9901/2008, sipas të cilit SHPK-të mund të themelohen më një kapital krejtësisht simbolik prej 100 lekësh, Kodi Tregtar i vitit 1932, i kushtonte një rëndësi më të madhe të pasurit së një kapitali të konsiderueshëm qysh në nisje të aktivitetit tregtar të SHPK-ve.

“Në këtë përrfundim u arrit pasi, nga përmbajtja e dispozitave të kreut IV të Ligjit nr.7698, datë 19.11.1992 “Për shoqëritë tregtare”, të cilat rregullojnë mënyren e krijimit, formimin e kapitalit themeltar, pozicionin e ortakëve, marrëdhëniet midis tyre, organet drejtuese dhe modalitetet e tjera të funksionimit të shoqërive me pergjegjësi të kufizuar, rezulton që ortaku (kur janë më shumë se një) i një shoqërie të kësaj forme (sh.p.k.) nuk mund të përrjashtohet nga të qenët ortak, pra, nga ortakëria, për asnjë veprimtari të ushtruar prej tij në këtë shoqëri, pavarësisht nga natyra dhe pasojat që mund t'i vijnë shoqërisë nga kjo veprimtari”.

²³⁸ Ligji 9901/2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” i ndryshuar, neni 101 dhe 102.

²³⁹ Fatri Islamaj, “Vështrim krahasues i disa instituteve të shoqërive tregtare sipas kodit tregtar të vitit 1932 dhe ligjit aktual “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare në Shqipëri” (2020) 1 Revista Juridike Shkencore “Jeta Juridike” fq. 27-52.

²⁴⁰ Po aty.

²⁴¹ Po aty.

²⁴² Po aty.

²⁴³ Fletore Zyrtare datë 5 mars 1932, Kodit Tregtar, neni 144.

Kodi Tregtar i kohës së monarkisë në Shqipëri, me këtë parashikim lidhur me kapitalin minimal të domosdoshem, nënvizonte më shumë karakteristikat e shoqërisë së kapitalit për SHPK-të. Kjo vinte për shkak se një kapital themeltar me vlerë substanciale (jo më i vogël se 10.000 Fr. Ari) i kërkuar si kusht për themelimin e *shoqnisë me garanci të kufizueme*, i jepte më shumë garanci kreditorëve të këtyre shoqërive, që në marrëdhëniet tregtare që do të krijonë me këtë shoqëri, të kishin një siguri më të lartë dhe risk më të vogël për rikuperimin e kredive të tyre te kjo formë shoqërie.²⁴⁴ Pra, në këtë kod pasqyrohej më qartë pikëpamja tradicionale që mbizotërontë në Evropën Kontinentale (*quid – pro – quo*) sipas së cilës, për të gëzuar “privilegjin” e përgjegjësive të kufizuara, ortakët duhet të kontribuojnë me sasi të konsiderueshme kapitali duke ia kaluar shoqërisë në themelimin e saj.²⁴⁵

Gjithashtu, një karakteristikë tjetër e ndryshme në Kodin Tregtar të kohës në raport me ligjin në fuqi 9901/2008 është fakti që sipas nenit 143 të Kodit Tregtar, kërkohet që i gjithë kapitali fillestar i themelimit të shoqërisë duhet të shlyhet në momentin e regjistrimit të shoqërisë. Kurse në ligjin aktual nuk ka një dispozitë të qartë që të përcaktojë mënyrën e shlyerjes së kontributeve të ortakëve për SHPK-të.²⁴⁶ Ligji në fuqi 9901/2008 në nenin 68 pika 5²⁴⁷ i jep liri statutore ortakëve për të disiplinuar mënyrën e shlyerjes së kapitalit. Ndërsa për shoqëritë aksionare kjo rregullohet me nenin 113 të ligjit ku është parashikuar detyrimi për kapitalin e ofruar në vlerë monetare. Ky kontribut mund të shlyhet edhe me këste brenda një afati të përcaktuar në statutin e shoqërisë.²⁴⁸

Ndërkohë që për sa i përket mundësisë që ortakët të kenë kontribute të ndryshme nga njëri-tjetri, Kodi Tregtar i vitit 1932, ashtu si edhe legjislacioni i sotëm, u japin mundësi ortakëve që të kontribuojnë në kapitalin e shoqërisë sipas vullnetit dhe mundësive të tyre, pa pasur

²⁴⁴ Fatri Islamaj, “Vështrim krahasues i disa instituteve të shoqërive tregtare sipas kodit tregtar të vitit 1932 dhe ligjit aktual “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare në Shqipëri” (2020) 1 Revista Juridike Shkencore “Jeta Juridike”.

²⁴⁵ Thomas Bachner, Edmund-Philipp Schuster dhe Martin Winner (n 203) fq. 59; Fatri Islamaj, “Vështrim krahasues i disa instituteve të shoqërive tregtare sipas kodit tregtar të vitit 1932 dhe ligjit aktual “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare në Shqipëri” (2020) 1 Revista Juridike Shkencore “Jeta Juridike” fq 27-52.

²⁴⁶ Po aty, fq. 27-52.

²⁴⁷ Sipas nenit 69 pika 5 e ligjit Nr.9901, datë 14.4.2008 "Për Tregtarët Dhe Shoqëritë Tregtare" "5. Kontributi i ortakëve mund të jetë në para ose në natyrë (pasuri të luajtshme/të paluajtshme apo të drejta). Statuti përcakton mënyrat e shlyerjes së kontributeve."

²⁴⁸ Sipas nenit 113 të ligjit Nr.9901, datë 14.4.2008 "Për Tregtarët Dhe Shoqëritë Tregtare:

“1. Aksionet e nënshkruara me kontribut në para duhet të shlyhen përpara regjistrimit të shoqërisë, të paktën në një të katërtën e vlerës së tyre nominale. Shumat që mbeten shlyhen në një ose më shumë këste, sipas vendimit të organeve të administrimit të shoqërisë. Vlerat më të larta, sipas pikës 2 të nenit 110 të këtij ligji, duhet të shlyhen plotësisht. 2. Aksionet e nënshkruara me kontribut në natyrë duhet të kalohen tërësisht përpara regjistrimit. 3. Themeluesit, të cilët nuk shlyejnë apo kalojnë kontributet e tyre brenda afateve të përcaktuara më sipër, përgjigjen ndaj shoqërisë, në përputhje me përcaktimet e neneve 10 pikat 2 e 3 dhe 124 të këtij ligji”

Në doktrinën italiane të shoqërive tregtare është pranuar edhe për shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar kjo lehtësi, pra për ortakët që kontribuojnë në vlerë monetare të mund shlyejnë kontributin me këste. Galgano (n 200) fq. 954.

ndonjë detyrim që pjesëmarrja në kapital duhet të jetë e barabartë. Ky është një aspekt i rëndësishëm i lirisë së vullnetit të ortakëve themelues të një SHPK-je, duke krijuar mundësinë ortakëve të kontribuojnë vetëm aq sa ata e vlerësojnë në kapitalin e një SHPK-je, duke pasur parasysh që kontributi në një shoqëri ka dhe elementin e vet të riskut, pasi sukcesi i shoqërisë nuk është asnjëherë plotësisht i garantuar. Gjithashtu, ky është një tipar tjetër i shoqërive të kapitalit, pasi, nga momenti i themelimit e në vazhdim, edhe të drejtat e ortakëve në shoqëri do të jenë në përpjestim me masën e kontributit të secilit në kapitalin e shoqërisë.

vii) Transferimi i kapitalit

Përsa i përket transferimit të kapitalit të shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar sipas rregullimit të K. T. të vitit 1932, vërehet një ngjashmëri me ligjin 7638/1992 “Për shoqëritë tregtare”²⁴⁹, i cili tashmë është shfuqizuar nga ligji aktual 9901/2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”.²⁵⁰

Në nenin 145 të K.T. të 1932, parashikohet që transferimi i kuotës (pra pjesa që ka secili ortak në kapitalin e shoqërisë) mund të bëhet te personat e tretë vetëm pasi të jetë respektuar e drejta e parablerjes.²⁵¹ Kjo do të thotë, që kur një ortak do ta disponojë pjesën e tij të kapitalit në shoqëri duke e shitur, ai në fillim duhet t’i vërë në dijeni ortakët e tjerë, të cilët kanë të drejtën e preferimit për ta blerë këtë pjesë të kapitalit, me të njëjtat kushte që u është ofruar të tretëve.²⁵² Neni 145 parashikonte që ky komunikim i ortakëve bëhet me ndërmjetësimin e administratorit të shoqërisë. Ligji parashikonte se ortakët e tjerë të shoqërisë kanë afat një muaj për të kryer këtë blerje dhe kanë të drejta të barabarta ndërmjet tyre për të marrë pjesë në këtë transaksion.²⁵³

Gjithashtu parashikohet që në rast se ortakët nuk e shfrytëzojnë këtë të drejtë parablerjeje brenda afatit njëmuajor, atëherë ortaku që do të disponojë pjesën e tij në kapitalin e shoqërisë është i lirë t’ia kalojë çdo personi të tretë.²⁵⁴ Kodi i kohës sipas këtij neni parashikonte që transferimet e kapitalit duhet të kryhen me akt publik, çka nënkupton aktin e kryer para noterit. Përfundimi i vetëm nga ky detyrim ishte rasti kur transferimi i kapitalit kryhej për

²⁴⁹ Ligji 7638/1992 “Për shoqëritë tregtare” [1992] FZ 8 (shfuqëzuar), neni 47.

²⁵⁰ Fatri Islamaj, “Vështrim krahasues i disa instituteve të shoqërive tregtare sipas kodit tregtar të vitit 1932 dhe ligjit aktual “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare në Shqipëri” (2020) 1 Revista Juridike Shkencore “Jeta Juridike” fq. 27-52.

²⁵¹ Fletore Zyrtare datë 5 Mars 1932, *Kodit Tregtar*, neni 145.

²⁵² Fatri Islamaj, “Vështrim krahasues i disa instituteve të shoqërive tregtare sipas kodit tregtar të vitit 1932 dhe ligjit aktual “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare në Shqipëri” (2020) 1 Revista Juridike Shkencore “Jeta Juridike” fq. 27-52.

²⁵³ Po aty.

²⁵⁴ Po aty.

shkak të dispozitave mbi trashëgiminë.²⁵⁵ Kodit Tregtar i kohës, në nenin 146 parashikonte mundësinë që një kuotë e shoqërisë me garanci të kufizuar të pjesëtohet edhe në disa ortakë, por duke respektuar kufizimin e vendosur në nenin 143 (në të cilin parashikohej që shoqëria nuk mundet të ketë më tepër se 25 ortakë).²⁵⁶

Kurse në ligjin në fuqi 9901/2008 ka një parashikim ndryshe përsa i përket transferimit të kapitalit, pasi nuk parashikon si prezumim ligjor të drejtën e parablerjes.²⁵⁷ Në nenin 73 të ligjit 9901/2008 parashikohet e drejta e ortakëve që të transferojnë lirisht pjesët e tyre të kapitalit te të tretët. E drejta e parablerjes sipas pikës 3 të këtij neni, duhet të respektohet vetëm nëse është parashikuar në statutin e shoqërisë.²⁵⁸ Sipas ligjit aktual, nëse në statutin e një SHPK-je nuk është rregulluar e drejta e parablerjes, atëherë ortakët mund të disponojnë lirisht pjesën e tyre të kapitalit.²⁵⁹

Në këtë mënyrë ligji aktual 9901/2008, duke implementuar prezumimin e lirisë së plotë të transferimit të kapitalit te SHPK-të, ka përforcuar një karakteristikë tipike të shoqërive të kapitalit.²⁶⁰

viii) Zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit themeltar

K.T. i vitit 1932, në nenin 147 të tij parashikonte rregulla për zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit themeltar të SHPK-së. Në këtë aspekt Kodi paraqiste ngjashmëri me ligjin Nr. 7638/1992, i cili u kushtonte disa dispozita të posaçme zmadhimit dhe zvogëlimit të kapitalit të SHPK-së.²⁶¹ Kurse ligji aktual 9901/2008, nuk parashikon dispozita të posaçme përsa i përket zmadhimit dhe zvogëlimit të kapitalit të shoqërisë. Megjithatë, në nenin 81 në pikën “ë”, ka një parashikim të përgjithshëm që i njuh asamblesë së ortakëve të drejtën për të bërë ndryshimin e kapitalit (zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit).

²⁵⁵ Fletore Zyrtare datë 5 mars 1932, *Kodit Tregtar* paragrafi 5 i nenit 145, sipas të cilit: “*Transferimi i pjesëve, pos rastit të trashigimit, duhet me u-ba me akt publik*”.

²⁵⁶ Fletore Zyrtare 50 5 mars 1932, *Kodit Tregtar*, neni 146.

²⁵⁷ Sipas nenit 73 të ligjit Ligji 9901/2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” i ndryshuar percaktohet që: “1. Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet: a) kontributit në kapitalin e shoqërisë; b) shitblerjes; c) trashëgimisë; ç) dhurimit; d) çdo mënyre tjetër të parashikuar me ligj. 2. Në rastin e kalimit të kuotave me kontratë, kontrata duhet të bëhet me shkrim. 3. Statuti mund të kushtëzojë kalimin e kuotave, veçanërisht duke përcaktuar miratimin e shoqërisë ose të drejtën e parablerjes në favor të shoqërisë apo të ortakëve të tjerë”.

²⁵⁸ Fatri Islamaj, “Vështrim krahasues i disa instituteve të shoqërive tregtare sipas kodit tregtar të vitit 1932 dhe ligjit aktual “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare në Shqipëri” (2020) 1 Revista Juridike Shkencore “Jeta Juridike” fq. 27-52.

²⁵⁹ Po aty, fq. 27-52.

²⁶⁰ Hajdari (n 210) fq. 48.

²⁶¹ Ligji 7638/1992 “Për shoqëritë tregtare” [1992] FZ 8 (shfuqëzuar), neni 62-64.

K. T. i vitit 1932 në nenin 147 të tij përcaktonte që zmadhimi i kapitalit themeltar të shoqërisë mund të parashikohej që në hartimin e statutit të shoqërisë.²⁶² Kjo procedurë e parashikuar në K.T. të vitit 1932 për zmadhimin e kapitalit të SHPK-së, paraqet një ngjashmëri me njërën nga format e zmadhimit të kapitalit të shoqërisë aksionare në ligjin aktual 9901/2008 dhe konkretisht, me atë të parashikuar në nenin 176 të ligjit në fuqi.²⁶³

Në këtë nen përcaktohet “*Zmadhimi i autorizuar i kapitalit*”²⁶⁴, sipas të cilit është pikërisht statuti i shoqërisë që duhet të parashikojë të drejtën dhe kushtet për të kryer një zmadhim të kapitalit të shoqërisë.²⁶⁵ Pra, ky zmadhim kapitali autorizohet paraprakisht nga statuti dhe administratori i shoqërisë zbaton kushtet e këtij autorizimi duke bërë zmadhimin e kapitalit.

Në mënyrë të ngjashme parashikohej të bëhej dhe zvogëlimi i kapitalit të shoqërisë në paragrafin e tretë të nenit 147 të K.T. të vitit 1932, por pa u cënuar e drejta e kundërshtimit që kanë kreditorët e shoqërisë.²⁶⁶ Për zvogëlimin të kapitalit, Kodi Tregtar i kohës i referohet me shprehjen “*rimbursimi i tanëshëm ose i pjesëshëm i pjesëve plotësuese*”.²⁶⁷ Nga ky parashikim rezulton se zvogëlimi i kapitalit të shoqërisë lejohej të kryhej vetëm nëse më parë ka pasur një procedurë të zmadhimit të kapitalit në këtë shoqëri.²⁶⁸ Pra zvogëlimi i kapitalit mund të efektonte vetëm pjesët plotësuese, në mënyrë të plotë ose pjesërisht sipas vendimit të asamblesë.²⁶⁹

²⁶² Fletore Zyrtare datë 5 mars 1932, *Kodit Tregtar* Sipas paragrafit të parë e të dytë të nenit 147 përcaktohej: “*Në statut mund të përcaktohet qi shokët të jenë të detyruëm me derdhë pjesa plotësuese në një proporsion të caktuem me pjesat fondatore të sejcilit*
Vendimi i asamblesë në bazë të së cilit kërkohen pjesët plotësuese, duhet të depozitohet në dy kopje në sekretarinë e Gjykatës së Shk. I., mbrenda një afati 15 ditësh, për përmbushjen e formaliteteve për të cilat ban fjalë pjesa e parë e nenit 113”.

²⁶³ Fatri Islamaj, “*Vështrim krahasues i disa instituteve të shoqërive tregtare sipas kodit tregtar të vitit 1932 dhe ligjit aktual “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare në Shqipëri”* (2020) 1 Revista Juridike Shkencore “Jeta Juridike” fq 27-52.

²⁶⁴ Sipas kësaj dispozite të ligjit aktual ligjit 9901/2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare, parashikohet që: “*Kushtet për zmadhimin e autorizuar të kapitalit 1. Statuti ose një vendim i asamblesë së përgjithshme për ndryshime në statut mund t'u japë administratorëve të drejtën për të kryer, brenda një afati 5-vjeçar nga regjistrimi i shoqërisë, zmadhim të kapitalit me emetim të aksioneve të reja, për një vlerë maksimale të përcaktuar (kapital i autorizuar). Vlera e zmadhimeve të autorizuara nuk mund të jetë më e madhe se gjysma e kapitalit të regjistruar të shoqërisë në datën në të cilën merret vendimi për zmadhimin e autorizuar ..*”

²⁶⁵ Fatri Islamaj, “*Vështrim krahasues i disa instituteve të shoqërive tregtare sipas kodit tregtar të vitit 1932 dhe ligjit aktual “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare në Shqipëri”* (2020) 1 Revista Juridike Shkencore “Jeta Juridike” fq. 27-52.

²⁶⁶ Fletore Zyrtare datë 5 mars 1932, *Kodit Tregtar*, neni 157.

²⁶⁷ Po aty.

²⁶⁸ Fatri Islamaj, “*Vështrim krahasues i disa instituteve të shoqërive tregtare sipas kodit tregtar të vitit 1932 dhe ligjit aktual “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare në Shqipëri”* (2020) 1 Revista Juridike Shkencore “Jeta Juridike”, fq. 27-52.

²⁶⁹ Po aty, fq. 27-52.

Sipas këtij rregullimi, nënkuptohet që kapitali themeltar i fillimit të aktivitetit të shoqërisë nuk mund t'i nënshtrohet procedurës së zvogëlimit të kapitalit. Ndërkohë që ligji aktual 9901/2008, nuk përmban rregulla për zvogëlimin e kapitalit të shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar.²⁷⁰

ix) Administrimi i shoqërive me përgjegjësi të kufizuar sipas Kodit Tregtar të vitit 1932

1. Asambleja e Ortakëve

Edhe sipas K.T. të vitit 1932 Asambleja e Ortakëve (AO) ishte organi më i lartë vendimmarrës në shoqëritë me garanci të kufizuar. AO i zhvillonte mbledhjet e saj në selinë e shoqërisë dhe sipas ligjit duhet të thirrej të paktën një herë në vit nga administratori i shoqërisë²⁷¹. Po ashtu parashikohej që për shkaqe të arsyeshme ortakët që disponojnë 1/5 e kapitalit të shoqërisë, kanë të drejtën për të thirrur mbledhjen e asamblesë së ortakëve.²⁷²

Kodi parashikonte dhe një procedurë të thirrjes së mbledhjes së AO dhe njoftimit të saj. Njoftimi për mbledhjen e AO duhet të bëhej me shkresë dhe t'i shkonte të gjithë ortakëve të paktën 8 ditë para mbledhjes. Njoftimi duhej të përmbante rendin e ditës dhe çështjet që do të diskutohen në mbledhje. Këto parashikime të ligjit ishin urdhëruese dhe nuk mund të ndryshohen as me statutin e shoqërisë. Nëse nuk respektohej kjo procedurë parashikohej që vendimi do të jetë i pavlefshëm.²⁷³

Kodi parashikonte që në mbledhjet e AO, ortakët mund të paraqiten personalisht ose të caktojnë një përfaqësues të tyre në rast se statuti nuk ka parashikime që ndalojnë pjesëmarrjen me përfaqësim.²⁷⁴ Në ndryshim nga K.T. i vitit 1932, në legjislacionin aktual për shoqëritë tregtare, ligji e parashikon si dispozitë urdhëruese të drejtën e ortakëve për të marrë pjesë edhe me përfaqësim në mbledhjen e AO dhe nuk i delegon një të drejtë të tillë statutit.²⁷⁵

AO sipas kodit kishte në kompetencë të saj miratimin e bilancit të shoqërisë, emërimin dhe shkarkimin e administratorëve, zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit të shoqërisë dhe çdo

²⁷⁰ Thomas Bachner, Edmund-Philipp Schuster dhe Martin Winner (n 203) fq. 81.

²⁷¹ Fletore Zyrtare datë 5 Mars 1932, *Kodit Tregtar*, neni 154.

²⁷² Fletore Zyrtare datë 5 Mars 1932, *Kodit Tregtar*, neni 154.

²⁷³ Po aty.

²⁷⁴ Fatri Islamaj, "Vështrim krahasues i disa instituteve të shoqërive tregtare sipas kodit tregtar të vitit 1932 dhe ligjit aktual "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare në Shqipëri" (2020) 1 Revista Juridike Shkencore "Jeta Juridike" fq. 27-52.

²⁷⁵ Po aty, fq. 27-52.

vendim që ndryshonte dispozitat apo parashikimet e statutit dhe kompetenca të tjera²⁷⁶ të shprehura në ligj apo në statut.²⁷⁷

K.T i vitit 1932, në nenin 149 parashikonte që AO ishte kompetente për të caktuar administratorët me një afat të përcaktuar ose pa afat. Neni 153 i Kodit parashikonte që vendimmarrja në AO konsiderohet e vlefshme kur një vendim është votuar nga ortakët që disponojnë shumicën e kapitalit të përfaqësuar në mbledhje, por jo më pak se gjysma e kapitalit të shoqërisë, nëse në statut nuk është parashikuar një shumicë më e lartë.²⁷⁸

Në nenin 153/2 parashikoheshin disa vendimmarrje, për të cilat në AO kërkohet shumicë e cilësuar, pra votimi në favor nga ortakët që disponojnë tri të katërtat e kapitalit të shoqërisë. Kodi, në mënyrë të ngjashme me ligjin aktual, përcaktonte që një shumicë e tillë është e detyrueshme, kur në AO do të merren vendime për zmadhimin e kapitalit të shoqërisë, si dhe për vendimet që ndryshojnë statutin e shoqërisë.²⁷⁹

Po ashtu, K.T. u jepte ortakëve themelues të drejtën që të parashikojnë në statutit edhe vendimmarrje të tjera për të cilat duhet të vendoset me shumicë të cilësuar. Në rast se statuti kishte parashikuar një shumicë të tillë, atëherë ajo duhet të respektohej.²⁸⁰

Madje K.T. i vitit 1932, në paragrafin e dytë dhe të tretë të nenit 153, parashikonte një veçori në raport me legjislacionin e mëvonshëm për shoqëritë tregtare. Sipas këtij parashikimi, në rast se shoqëria nuk ka më shumë se pesë ortakë, atëherë kërkohet unanimitet për marrjen e vendimeve, kur diskutohet ndryshimi i statutit të shoqërisë dhe zmadhimi i kapitalit themeltar.²⁸¹ Gjithashtu, në paragrafin e tretë të këtij neni parashikohet që pavarësisht numrit të ortakëve (pra edhe nëse shoqëria ka më shumë se pesë ortakë) kërkohet unanimitet për marrjen e vendimeve në të cilat vendoset ndryshimi i objektit të veprimtarisë së shoqërisë dhe modifikimet e statutit të shoqërisë, në rast se këto ndryshime dhe modifikime shkaktojnë një rritje të përgjegjësisë të ortakëve të shoqërisë.²⁸²

K.T. i vitit 1932 parashikonte që AO e shoqërisë, mund të caktonte një ose disa administratorë për të përfaqësuar dhe administruar veprimtarinë e shoqërisë tregtare. AO

²⁷⁶ Po aty.

²⁷⁷ Shih dispozitat për shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar të Kodit Tregtar të vitit 1932 botuar në Fletoren Zyrtare të dt. 5 mars 1932.

²⁷⁸ Fletore Zyrtare datë 5 mars 1932, *Kodit Tregtar*, neni 153. Gjithashtu shiko trajtimin doktrinor në: Fatri Islamaj, “Vështrim krahasues i disa instituteve të shoqërive tregtare sipas kodit tregtar të vitit 1932 dhe ligjit aktual “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare në Shqipëri” (2020) 1 Revista Juridike Shkencore “Jeta Juridike” fq. 27-52.

²⁷⁹ Po aty, fq. 27-52.

²⁸⁰ Po aty, fq. 27-52.

²⁸¹ Po aty, fq. 27-52.

²⁸² Fletore Zyrtare datë 5 mars 1932, *Kodit Tregtar*, neni 153, paragrafi 2 dhe 3.

kishte të drejtën e revokimit të administratorit nga detyra.²⁸³ (pra ruante të drejtën për t'i shkarkuar).

2. Administratorët

Edhe në K.T. të vitit 1932, administratorët në shoqëri kishin të drejtën dhe përgjegjësinë që të bëjnë përfaqësimin e shoqërisë, në raport me të tretët, si dhe administrimin e punëve dhe aktivitetit tregtar të përditshëm të shoqërisë. Ata kishin për detyrë që të përgatisin bilancin ekonomik të shoqërisë për çdo vit financiar dhe t'ia paraqesin për ta miratuar organi vendimmarrës AO.²⁸⁴ Në këtë kod parashikoheshin dhe rregulla të detajuar për mënyrën e miratimit të bilancit në shoqërinë tregtare, duke i garantuar të drejtën e për informim dhe transparencë të plotë për të gjithë ortakët e shoqërisë.²⁸⁵

Sipas nenit 150 të K.T. të vitit 1932, parashikohej se në rast se shoqëria ka dy ose më shumë administratorë, për marrjen e vendimit të administrimit midis administratorëve kërkohet shumicë absolute. (Pra, votimi në favor nga më shumë se gjysma e administratorëve të shoqërisë). Ndërkohë që, në rast se statuti parashikonte që administratorët duhet të veprojnë bashkërisht, atëherë për marrjen e vendimeve nga administratorët kërkohet unanimitet. Sipas ligjit të kohës, parashikohej vetëm një përjashtim nga vendimmarrja me unanimitet, dhe ky është rasti kur shumica e administratorëve vlerëson se shoqërisë mund t'i shkaktohet një dëm i rëndë. Në një rast të tillë parashikohej që vendimi të merret nga shumica e administratorëve. Megjithatë, në paragrafin 3 të nenit 150 të ligjit të kohës, parashikohej edhe mënyra se si merren vendimet në rastin kur statuti ka parashikuar unanimitet dhe ky unanimitet nuk realizohet midis administratorëve.²⁸⁶ Sipas nenit 153 të K.T. të vitit 1932, në rast se paraqitet një situatë e tillë, vendimi do të merret në AO nga ortakët që disponojnë shumicën mbi 50% të kapitalit.²⁸⁷

Ky kod, në nenin 149 të tij parashikonte që administratorët mund të kenë një mandat të caktuar ose mund të emërohen nga AO pa afat. Sipas kodit të kohës, nuk është parashikuar ndonjë shumicë e cilësuar për emërimin dhe shkarkimin e administratorit, për pasojë mund të themi që shumica absolute (51% e kapitalit), është e mjaftueshme për të emëruar një

²⁸³ Po aty, neni 149.

²⁸⁴ Po aty, neni 157.

²⁸⁵ Fatri Islamaj, "Vështrim krahasues i disa instituteve të shoqërive tregtare sipas kodit tregtar të vitit 1932 dhe ligjit aktual "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare në Shqipëri" (2020) 1 Revista Juridike Shkencore "Jeta Juridike" fq. 27-52.

²⁸⁶ Fletore Zyrtare datë 5 mars 1932, *Kodit Tregtar*, neni 150.

²⁸⁷ Fletore Zyrtare datë 5 mars 1932, *Kodit Tregtar*.

administrator sipas nenit 153 të ligjit të kohës.²⁸⁸ Megjithatë, sipas këtij neni konstatohet se statuti mund të parashikojë edhe një shumicë më të lartë.²⁸⁹

Sipas ligjit të kohës, administratori mund të shkarkohej nga detyra pavarësisht faktit nëse ky administrator është emëruar me një afat të caktuar apo pa afat të caktuar. Por, gjithsesi, administratori kishte të drejtën që të kërkojë dëmshpërblim në rastet e largimit të tij nga kjo detyrë pa shkaqe të arsyeshme.²⁹⁰

K. T. i vitit 1932 paraqiste një karakteristikë që nuk haset në legjislacionin e pas vitit 1990 në Shqipëri, lidhur me të drejtën e administratorit për dëmshpërblim në rast shkarkimi.²⁹¹ Sipas paragrafit 3 të nenit 149 të këtij kodi, rezulton se ky ligj i jepte një besueshmëri shumë më të lartë një vendimi për shkarkimin e administratorit, kur ai është marrë me shumicë të cilësuar të ortakëve që disponojnë $\frac{3}{4}$ e kapitalit të shoqërisë. Kjo, pasi në një rast të tillë, ligji nuk i jepte të drejtë fare administratorit për të kërkuar dëmshpërblim për revokimin nga detyra.²⁹²

Kodi në nenin 151 kishte parashikuar disa parime të mirëadministrimit dhe të shmangies së konfliktit të interesit që duhet të respektohen nga administratorët. Sipas këtyre parashikimeve administratorët nuk mund të bënin veprime për llogari të tyre personale ose të personave të tjerë me shoqërinë tregtare që administrojnë pa u dhënë pëlqimi nga AO për një veprim të tillë.²⁹³ Gjithashtu, në këtë dispozitë është parashikuar ndalimi i administratorëve për të ushtruar veprimtari konkurruese, duke i ndaluar administratorit të drejtën për të pasur pozicione drejtuese në shoqëri të tjera, që kryejnë të njëjtën veprimtari tregtare, si dhe duke i ndaluar të drejtën vetë administratorëve, që të ushtrojnë të njëjtin lloj veprimtarie tregtare si shoqëria ku ata shërbejnë si administrator.²⁹⁴

²⁸⁸ Fletore Zyrtare datë 5 mars 1932, *Kodit Tregtar*, neni 153.

²⁸⁹ Fatri Islamaj, “Vështrim krahasues i disa instituteve të shoqërive tregtare sipas kodit tregtar të vitit 1932 dhe ligjit aktual “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare në Shqipëri” (2020) 1 Revista Juridike Shkencore “Jeta Juridike” fq. 27-52.

²⁹⁰ Fletore Zyrtare datë 5 mars 1932, *Kodit Tregtar*, neni, neni 149.

²⁹¹ Fatri Islamaj, “Vështrim krahasues i disa instituteve të shoqërive tregtare sipas kodit tregtar të vitit 1932 dhe ligjit aktual “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare në Shqipëri” (2020) 1 Revista Juridike Shkencore “Jeta Juridike” fq. 27-52.

²⁹² Po aty, fq. 27-52.

²⁹³ Fatri Islamaj, “Vështrim krahasues i disa instituteve të shoqërive tregtare sipas kodit tregtar të vitit 1932 dhe ligjit aktual Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare në Shqipëri” (2020) 1 Revista Juridike Shkencore “Jeta Juridike” fq. 27-52.

²⁹⁴ Fletore Zyrtare datë 5 mars 1932, *Kodit Tregtar*, neni 151.

Këto parime të pasqyruara në K.T. të vitit 1932, janë edhe aktualisht në ligjin në fuqi për shoqëritë tregtare,²⁹⁵ si parime të besnikërisë dhe mirëadministrimit, por të cilat janë të vendosura te dispozitat e përgjithëshme në pjesën e parë të ligjit aktual.²⁹⁶

Kodi i kohës parashikonte që në rast se ka më shumë se një administrator, atëherë ata janë solidarisht përgjegjës para shoqërisë tregtare.²⁹⁷ Në këtë kod parashikohej e drejta për të ngritur padi për shpërblim dëmi ndaj administratorit, si nga organi i AO, qoftë edhe nga secili prej ortakëve. Gjithashtu, të drejtën për të ngritur padi për shpërblim dëmi ndaj administratorit e gëzonin edhe kreditorët e shoqërisë.²⁹⁸

Sipas këtij kodi parashikohej edhe mundësia e organit të AO që me një shumicë të cilësuar të ortakëve që disponojnë $\frac{3}{4}$ e kapitalit të shoqërisë të shkarkojë administratorin ose administratorët nga përgjegjësia civile për shpërblimin e dëmit. Në një rast të tillë ortakët nuk mund të ngrenë padi ndaj administratorit për shpërblim dëmi.²⁹⁹ Gjithashtu edhe një kompetencë e tillë e AO është një veçori e K.T. të vitit 1932, e cila nuk aplikohet në legjislacionin e sotëm për shoqëritë tregtare.³⁰⁰

x) Prishja e Shoqërisë dhe Falimentimi

Ky kod parashikonte dhe rastet e prishjes së shoqërisë më përgjegjësi të kufizuar, por sipas Kodit Tregtar të vitit 1932, procesi i përfundimit të aktivitetit tregtar të shoqërisë njihet me emërtimin “zgjdhje e shoqërisë” dhe jo prishje e shoqërisë, siç konsiderohet sot në legjislacionin modern.³⁰¹

K.T. i vitit 1932 në nenin 253 të tij parashikonte që shoqëritë me përgjegjësi të kufizuara zgjidhen në rastet si vijon:³⁰²

- a) *me kalimin e kohës së parashikuar në statut për vazhdimin e tyre;*
- b) *nëse objekti i veprimtarisë së tyre bëhet i pamundur;*
- c) *me përfundimin e sipërmarrjes, (në rast se objekti i tyre ka qenë vetëm një sipërmarrje e caktuar);*
- d) *me falimentimin e shoqërisë;*

²⁹⁵ Ligji 9901/2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” i ndryshuar, nenet 12-15.

²⁹⁶ Fatri Islamaj, “Vështrim krahasues i disa instituteve të shoqërive tregtare sipas kodit tregtar të vitit 1932 dhe ligjit aktual “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare në Shqipëri” (2020) 1 Revista Juridike Shkencore “Jeta Juridike” fq. 27-52.

²⁹⁷ Fletore Zyrtare datë 5 mars 1932, *Kodit Tregtar*, neni 152.

²⁹⁸ Fletore Zyrtare datë 5 mars 1932, *Kodit Tregtar*, neni 152.

²⁹⁹ Fatri Islamaj, “Vështrim krahasues i disa instituteve të shoqërive tregtare sipas kodit tregtar të vitit 1932 dhe ligjit aktual “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare në Shqipëri” (2020) 1 Revista Juridike Shkencore “Jeta Juridike” fq. 27-52.

³⁰⁰ Fletore Zyrtare datë 5 mars 1932, *Kodit Tregtar*, neni 152.

³⁰¹ Ligji 9901/2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” i ndryshuar, neni 99.

³⁰² Fletore Zyrtare datë 5 mars 1932, *Kodit Tregtar*, neni 253.

e) *me humbjen e të paktën dy të tretave të kapitalit të shoqërisë.*

Ndërsa në nenin 254 të këtij Kodi parashikohej dhe një përkufizim shumë konciz dhe i thjeshtë lidhur me situatën e falimentimit të shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar. Sipas këtij parashikimi,³⁰³ Shoqëria është në falimentim kur shuma e pasiveve (pra e detyrimeve ndaj të tretëve) kalon shumën efektive të kapitalit të shoqërisë.

xi) Fuzionimi (Bashkimi)

Në Kodin tregtar të vitit 1932 parashikohej edhe mundësia e bashkimit të shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar me shoqëri të tjera tregtare. Ky proces, në ligjin e kohës, njihej me emrin “Fuzionimi” dhe për një proces të tillë duhet të vendosnin Asambletë përkatëse të secilës shoqëri. Gjithashtu duhet të respektoheshin rregullat e transparencës dhe të publikimit të këtyre vendimeve sipas neneve 258-260 të Kodit Tregtar të vitit 1932.³⁰⁴

xii) Likuidimi i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar sipas Kodit Tregtar të vitit 1932

Në nenin 261 e vijues të Kodit Tregtar 1932 përcaktoheshin rregullat për likuidimin e shoqërive me përgjegjësi të kufizuar. Sipas këtij Kodi i jepej përparësi statutit dhe aktit konstitues për të parashikuar rregullat e likuidimit të shoqërisë. Por, nëse ortakët themelues të shoqërisë nuk kanë përcaktuar rregulla të tilla në statut, atëherë do të zbatohen normat e kodit lidhur me likuidimin e shoqërisë.³⁰⁵

Vendimi i caktimit të likuidatorëve merret nga AO me shumicë të cilësuar nga ortakët që disponojnë $\frac{3}{4}$ e kapitalit. Në rast se kjo shumicë nuk arrihet në Asamble, atëherë likuiduesi caktohet me vendim të Gjykatës së Shkallës së Parë, e cila vihet në lëvizje nga administratori.³⁰⁶ Ky vendim duhet të depozitohet në sekretarinë e Gjykatës së Shkallës së Parë nga vetë personi që është caktuar si likuidues. Ky është një detyrim që buron nga një dispozitë urdhëruese e ligjit dhe nuk mund të shmanget as nga parashikimet e statutit. Çdo parashikim në statut, i ndryshëm nga ky detyrim do të ishte i pavlefshëm.³⁰⁷

Nga momenti i transkriptimit të aktit të emërimit të likuidatorëve në Regjistrin e Tregtisë, likuidatori merr kompetencat e administratorit dhe është përfaqësues ligjor i shoqërisë. Gjithashtu shoqëria duhet të shtojë në emërtimin e vet dhe fjalët “Shoqëri në likuidim e

³⁰³ Po aty, neni 254.

³⁰⁴ Fletore Zyrtare datë 5 mars 1932, *Kodit Tregtar*, nenet 258-260.

³⁰⁵ Po aty, neni 261.

³⁰⁶ Po aty, neni 271.

³⁰⁷ Po aty, neni 261/2.

sipër”, me qëllim që të gjithë kreditorët dhe të tretët të kenë të qartë statusin ligjor të shoqërisë dhe faktin që kjo shoqëri është në procedurat e likuidimit.³⁰⁸

Likuidatori në bashkëpunim me administratorin e shoqërisë duhet të përgatisin bilancin dhe inventarin e të gjitha aktiveve dhe pasiveve të shoqërisë. Këto dokumenta duhet të nënshkruhen edhe nga likuiduesi edhe nga administratori që ka qenë përgjegjës për administrimin e shoqërisë deri sa është çelur procedura e likuidimit.³⁰⁹ Likuiduesit kanë detyrimin të informojnë ortakët e shoqërisë që kërkojnë informacion për çdo dokument apo hap të procedurës së likuidimit.³¹⁰

Likuiduesit edhe pse janë përfaqësues të shoqërisë tregtare, nuk kanë të drejtë të nisin veprime tregtie nga fillimi, të cilat nuk janë në funksion të procedurës së likuidimit. Në të kundërt, ata do të përgjigjen personalisht për dëmin e shkaktuar.³¹¹ Sipas këtij parashikimi, likuidatori duhet t’i përmbahet misionit për të cilin është caktuar, pra procesit të likuidimit të shoqërisë, dhe nuk mund të kthehet në një administrator të shoqërisë. Megjithatë, në kuadër të kompetencave të veta likuidatori mund të përmbyllë kontrata të caktuara apo veprime të tjera tregtare, të cilat janë pjesë e procesit të likuidimit dhe përgatitjes sa më të qartë të bilancit dhe inventareve të pasiveve dhe aktiveve.³¹²

Në nenin 265 paragrafi i dytë i Kodit Tregtar kishte parashikuar një përjashtim nga rregulli i parashikuar më lart. Sipas këtij paragrafi, likuiduesi mund të autorizohet me vendim të AO të shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar, që të vazhdojë përkohësisht aktivitetin tregtar të shoqërisë.³¹³

Likuidatorët nuk mund t’u shpërndajnë ortakëve asnjë shumë para se të shlyhen detyrimet për kreditorët dhe pasivet e shoqërisë. Pasi janë shlyer pasivet e shoqërisë, likuiduesi përgatit një bilanc, sipas të cilit bëhet dhe pjestimi i kapitaleve të mbetura midis ortakëve të shoqërisë në proporcion me pjesën e secilit. Me përfundimin e likuidimit, likuiduesit i drejtohen gjykatës për të bërë shuarjen (çregjistrimin) e shoqërisë tregtare nga regjistri tregtar.³¹⁴

³⁰⁸ Po aty, neni 262.

³⁰⁹ Po aty.

³¹⁰ Po aty, neni 264.

³¹¹ Po aty, neni 265/1.

³¹² Po aty, neni 265 e vazhdim.

³¹³ Po aty.

³¹⁴ Po aty, neni 270.

Konkluzioni

Pra siç u analizua më lart, Kodi Tregtar i miratuar në vitin 1932 në Shqipëri, përbënte një korpus të plotë juridik dhe shumë modern për zhvillimin e tregtisë në vendin tonë duke parashikuar rregulla të detajuara për themelimin dhe organizimin e katër formave të shoqërive tregtare që njihen dhe sot në legjislacionin aktual.³¹⁵

Megjithëse ka kaluar pothuajse një shekull nga koha e miratimit të këtij kodi, vihet re që dispozitat mbi rregullimin e shoqërive me përgjegjësi të kufizuar në pjesën më të madhe të tyre janë të njëjta me legjislacionin aktual, përveç disa ndryshimeve, të cilat u prezantuan më lart në analizën e këtij Kodi.³¹⁶

Ky Kod, së bashku me Kodin Civil të vitit 1929, mund të konsiderohen si kontributet e para dhe më të rëndësishme në formimin e infrastrukturës legislative shqiptare në funksion të nxitjes së një sistemi ekonomik të bazuar në iniciativën e lirë të sipërmarrjes tregtare dhe në nxitjen e investimeve të huaja në Shqipëri.³¹⁷ Kjo infrastrukturë ligjore krijonte kushtet për themelimin dhe organizimin e sipërmarrjeve të ndryshme tregtare në Shqipëri sipas modeleve më të zhvilluara të vendeve përfundimtare. Ky kuadër ligjor përbënte një incentivë pozitive edhe për investitorët nga vende të ndryshme me zhvillim më të madh ekonomik për të investuar në Shqipëri, duke pasur një legjislacion modern të organizimit të shoqërive tregtare.³¹⁸

Kodi Tregtar i vitit 1932 paraqiste një kuadër kompleks dhe të pasur ligjor me insitute juridike shumë bashkëkohore të kodifikuara në një korpus të vetëm legjislativ.³¹⁹ Me shfuqizimin e këtij Kodi, këto institute juridike do t'i mungonin legjislacionit tregtar për një periudhë shumë të gjatë, deri në miratimin e ligjit aktual në fuqi Nr. 9901/2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”.³²⁰

3.2. Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar në periudhën 1944 - 1991 dhe aktet normative të kësaj periudhe

Gjatë kësaj periudhe, në të cilën vendit tonë iu imponua sistemi politik komunist, ka pasur një regres të vazhdueshëm në të gjitha konceptet e ekonomisë së tregut të lirë, deri në

³¹⁵ Fatri Islamaj, “Vështrim krahasues i disa instituteve të shoqërive tregtare sipas kodit tregtar të vitit 1932 dhe ligjit aktual “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare në Shqipëri” (2020) 1 Revista Juridike Shkencore “Jeta Juridike” fq. 27-52.

³¹⁶ Po aty, fq. 27-52.

³¹⁷ Po aty, fq. 27-52.

³¹⁸ Po aty, fq. 27-52.

³¹⁹ Po aty, fq. 27-52.

³²⁰ Po aty, fq. 27-52.

mbylljen totale dhe zhdukjen e konceptit të shoqërive me përgjegjësi të kufizuar dhe të gjitha shoqërive tregtare, si formë e sipërmarrjes së lirë ekonomike.

Akti i parë kushtetues pas Luftës së Dytë Botërore, ishte Statuti i Republikës Popullore të Shqipërisë i vitit 1946, në nenin 5 të tij përcaktohej se veprimtaritë prodhuese si minierat, pasuritë e nëtokës, kullotat dhe pyjet, ujrata, burimet natyrore, mjetet e komunikacionit, transportit dhe bankat, janë pasuri e përbashkët e popullit, pra administrohen nga shteti. Gjithashtu ky nen përcaktonte se tregtia e jashtme është nën kontrollin e shtetit.³²¹

Me kolektivizimin e mjeteve të prodhimit dhe burimeve natyrore shteti paralizoi dhe detyroi të mbyllin aktivitetin tregtar të gjitha ato shoqëri tregtare, të cilat aktivitetin e tyre kishin të lidhur me fushën prodhuese, burimet natyrore apo tregtinë e jashtme. Sipas këtij akti themeltar kushtetues dhe ligjeve e akteve nënligjore të dala në zbatim të tij, shoqërive tregtare u ndalohej me ligj kryerja e çdo aktiviteti tregtar me vendet jashtë shqipërisë, që do të thotë se SHPK-të nuk mund të bënin aktivitet tregtar në fushën e importeve dhe eksporteve.³²²

Rezulton se menjëherë pas çlirimit të vendit u instalua një sistem diktatorial, i cili në aspektin ekonomik realizoi një ekonomi të centralizuar dhe të kontrolluar nga shteti, ku prona private dhe sipërmarrja e lirë tregtare do të kufizohej deri në cenimin e plotë të këtyre të drejtave themelore të individit.

Ndërsa në nenin 8 të Statutit të Republikës Popullore të Shqipërisë përcaktohej se shteti kujdeset për krijimin e kooperativave bujqësore dhe favorizon ato.³²³ Kjo tregon se politika ekonomike e shtetit ishte përqëndruar te kolektivizimi, ekonomia e kontrolluar nga shteti, dhe kufizimi i hapur i lirive ekonomike, qoftë për personat fizikë, qoftë për shoqëritë tregtare. Megjithatë në këtë periudhë, formalisht njiheshin akoma personat juridikë të rregulluar nga legjislacioni i Monarkisë pra K. C. i vitit 1929 dhe dhe K. T. i vitit 1932. Kështu formalisht ekzistonte akoma infrastruktura ligjore e shoqërive tregtare, por në të

³²¹ Neni 5 i Statutit i Republikës Popullore të Shqipërisë përcaktonte se:

“Në Republikën Popullore të Shqipërisë mjetet e prodhimit përbëhen prej pasurisë së përbashkët të popullit që gjëndet në duart e shtetit, prej pasurisë së organizatave kooperative popullore dhe prej pasurisë së personave private, fizike ose morale.

Janë pasuri e përbashkët e popullit të gjitha minierat dhe pasuritë e tjera të nënëtokës, ujrata, burimet natyrore, pyjet dhe kullotat, mjetet e komunikacionit ajror, postat, telegrafet, telefonet, radio-stacionet dhe bankat. Tregëtia e jashtme është nën kontrollin e shtetit”.

Asambleja Kushtetuese, Statuti i Republikës Popullore të Shqipërisë (Bashkimi 1946) <<http://shtetiveb.org/wp-content/uploads/2012/10/STATUTI-I-ASAMBLESE-KUSHTETONJE%C2%A6%C3%AASE-1946.pdf>> aksesuar me 14 mars 2020.

³²² Po aty.

³²³ Statutin e Republikës Popullore të Shqipërisë (Shtypëshkronja “BASHKIMI” 1946) në neni 8 shprehej që: *“Shteti kujdeset veçanërisht për lëvizjen e kooperativave të popullit; e përkrah këtë dhe e favorizon”.*

vërtetë ato u detyruan të mbyllen për shkak të pamundësisë për të ushtruar aktivitetin ekonomik të lirë.

Sipas nenit 9 të këtij Statuti të RPSH, në menyrë formale mbrohej prona private dhe iniciativa në ekonomi.³²⁴ Por këto formulime për mbrojtjen e pronës private dhe iniciativës private në ekonomi, mbeteshin thjeshtë deklarative dhe jo si garanci reale.

Gjithashtu në nenin 10 të këtij Statuti të RPSH të vitit 1946 dhe në legjislacionin në zbatim të tij për “Reformën Agrare”, në Shqipëri u mohua e drejta e pronësisë private mbi tokën dhe për pasojë kjo reformë agrare preku drejtpërdrejt të gjitha shoqëritë tregtare, të cilat në aktivitetin e tyre tregtar kishin si asete ekonomike sipërfaqe të tokave.³²⁵

Në këte periudhë SHPK-të ishin të bazuara në një ekonomi të lidhur me bujqësinë dhe blegtorinë, reforma agrare e vitit 1946 e në vijim çoi drejt mbylljes së këtyre shoqërive, për shkak të pamundësisë për të vazhduar sipërmarrjen e lirë private mbi tokat bujqësore, si dhe mjetet e prodhimit.

Në të njëjtën linjë të kufizimit të lirive ekonomike për shoqëritë me përgjegjësi të kufizuara ishin dhe parashikimet e Kushtetutës së vitit 1950. Në nenin 7 të saj përcaktohej që mjetet e prodhimit dhe burimet natyrore të të gjitha llojeve janë pasuri që administrohet nga shteti.³²⁶

³²⁴ Shih nenin 9 të Statutit të Republikës Popullore të Shqipërisë 1946, sipas së cilit:

“Garantohen pronësia private dhe iniciativa private në ekonomi.

Garantohet e drejta e trashëgimit të pasurisë private.

Asnjëri nuk munt të përdorë të drejtën e pronësisë private në dëm të kolektivitetit.”

³²⁵ Sipas nenit 10 të Statutit të Republikës Popullore të Shqipërisë 1946 parashikohej që:

“Toka u takon atyre që e punojnë. Caktohet me ligjë kur një institut ose një person që nuk e punon tokën munt të mbetet zot i kësaj toke dhe në ç’masë. Tokat e mbëdha për asnjë arsëye nuk munt të jenë në duart e privatëve. Me ligjë caktohet maksimumi i sipërfaqes së tokës që munt të jetë pronë private. Shteti mpron dhe përkrah veçanërisht fshatarët e vegjël dhe fshatarët e mesmë me politikën e tij ekonomike, me kredi dhe me sistemin e taksave. Me masa ekonomike dhe të tjera, shteti përkrah masat punonjëse të popullit që të bashkohen dhe të organizohen kundër shfrytëzimit ekonomik. Shteti mpron personat që pajtohen për punë duke i u siguruar të drejtat e organizimit, duke kufizuar orët e punës dhe duke caktuar minimumin e mëditjeve. Ay i përkrah me anë të sigurimeve shoqërore dhe me mprojtjen e së drejtës së tyre për një pushim të përvitshëm që u paguhet nga ana e punëdhënësve. Shteti mpron veçanërisht të rinjtë që nuk janë në moshë madhore për sa i takon marrjes së tyre në punë.”

³²⁶ Kushtetuta e Republikës Popullore të Shqipërisë e vitit 1950; Neni 7 përcakton:

“Në Republikën Popullore të Shqipërisë mjetet e prodhimit përbëhen prej pasurisë së përbashkët të popullit që gjëndet në duart e shtetit, prej pasurisë së organizatave kooperativiste popullore dhe prej pasurisë së personave privatë, fizikë ose moralë.”

Janë pasuri e përbashkët e popullit të gjitha minierat dhe pasuritë e tjera të nëntokës, ujrat, burimet natyrore, pyjet dhe kullotat, mjetet e komunikacionit ajror, hekurudhor edetar, postat, telegrafet, telefonat, radiostacionet dhe bankat.

Tregëtia e jashtme është nën kontrollin e shtetit. Shteti gjithashtu rregullon dhe kontrollon gjithë tregëtinë e brëndëshme të vëndit.”

Ne këtë Kushtetutë të vitit 1950 konsolidohen të gjitha parimet e një rendi ekonomik krejtësisht të centralizuar ku mjetet e prodhimit dhe burimet ekonomike, tregtia e jashtme dhe tregtia e brendshme, janë të gjitha në kontroll të shtetit, dhe nuk mbetet më hapësirë për veprimtarinë tregtare të shoqërive tregtare në përgjithësi, apo të SHPK-ve në veçanti. Në paragrafin e tretë të nenit 7 të kësaj Kushtetute parashikohej që edhe tregtinë e brendshme e kontrollon shteti. Ne këto kushte megjithëse formalisht mbetej mundësia për të pasur të regjistruar akoma shoqëri tregtare si persona juridike, do të ishte i pakuptimtë vazhdimi i tyre, për sa kohë nuk mund të ushtronin veprimtari tregtare dhe nuk mund të realizonin qëllimin.³²⁷

Ligji 2022 dt. 02.05.1955 “Për Pjesën e Përgjithshme të Kodit Civil hoqi në mënyrë përfundimtare mundësinë e themelimit të shoqërive tregtare në përgjithësi, pra edhe SHPK-së. Sipas këtij ligji nuk parashikohej fare mundësia e themelimit të personave juridikë privatë. Neni 25 i tij, parashikonte si persona juridikë vetëm institucionet organizatat dhe ndërmarrjet shtetërore dhe jo personat juridikë privatë me karakter fitimprurës.³²⁸

Me miratimin e pjesës së parë të Kodit Civil në Prill të vitit 1955 u hoq edhe formalisht e drejta e themelimit të shoqërive tregtare në Shqipëri. Nga ky moment e në vazhdim, përgjatë gjithë periudhës së sistemit komunist, në vendin tonë nuk kanë ekzistuar shoqëritë tregtare. Madje, në këtë periudhë, edhe e drejta themelore e pronës private, u mohua me ligj.

Kushtetuta e vitit 1976 në nenin 16 të saj përcaktonte se ekonomia e vendit mbështetej mbi pronën socialiste, mbi mjetet e prodhimit dhe prona private nuk do të ekzistojë.³²⁹ Gjithashtu fakti që prona private nuk gëzonte mbrojtje ligjore nga shteti përfshihej edhe në dispozita të tjera të Kushtetutës së vitit 1976. Neni 17 parashikonte që “*Prona socialiste është baza e paprekshme e rendit socialist, burimi i mirëqenies së popullit dhe i fuqisë së atdheut; ajo ka mbrojtje të veçantë nga shteti. Prona socialiste përbëhet nga prona*

Kushtetuta e Republikës Popullore të Shqipërisë-1950 <<http://shtetiweb.org/2013/10/08/kushtetuta-e-republikes-popullore-te-shqiperise-1950/>> aksesuar më 15 mars 2020.

³²⁷ Po aty.

³²⁸ Ligji 2022/1955 “Për Pjesën e Përgjithshme të Kodit Civil” Gazeta Zyrtare 4. Neni 25 përcaktonte se: “*Personat juridikë janë institucionet, ndërmarrjet dhe organizatat të cilat në emër të tyre mund të fitojnë të drejta pasurore të marrin përsipër detyrime dhe të jenë paditës dhe të paditur në gjyq.*”

³²⁹ Kushtetuta së Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë së vitit 1976, neni 16 përcaktonte se:

“Ekonomia e Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë është ekonomi socialiste, që mbështetet në pronën socialiste mbi mjetet e prodhimit.

Në Republikën Popullore Socialiste të Shqipërisë nuk ka klasa shfrytëzuese, janë zhdukur dhe ndalohen prona private e shfrytëzimi i njeriut prej njeriut.”

Kushtetuta së Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë së vitit 1976 <<http://shtetiweb.org/2013/10/08/kushtetuta-e-republikes-socialiste-te-shqiperise-1976/>> aksesuar më 15 mars 2020.

shtetërore dhe nga prona kooperativiste në bujqësi". Ndërsa neni 23 kufizonte të drejtën e pronës vetëm në konceptin e pronës vetjake për sende të përdorimit personal.³³⁰

Si përfundim rezultoi se në periudhën nga viti 1955 e deri në miratimin e ligjit Nr.7638, datë 19.11.1992 "Për shoqëritë tregtare", nuk mund të flitet për ekzistencën e shoqërive me përgjegjësi të kufizuar, pasi gjatë kësaj periudhe ishte e ndaluar me ligj themelimi i këtyre shoqërive dhe, gjithashtu, nuk ekzistonin as parimet e ekonomisë së tregut dhe sipërmarrjes private tregtare.

3.3. Zhvillimi i shoqërive me përgjegjësi të kufizuar në Shqipëri pas vitit 1991 dhe aktet normative që shërbyen në këtë periudhë

Me rënien e sistemit komunist në Shqipëri, në vitin 1991, u hodhën dhe hapat e parë drejt një sistemi të ekonomisë së tregut të lirë dhe instalimit të një demokracie funksionale në vendin tonë. Këto ndryshime demokratike sollën një tërësi reformash ligjore dhe institucionale që përfshinë edhe të drejtën e iniciativës së lirë ekonomike. Këto reforma u ndërморën me qëllim ndërtimin e shtetit të së drejtës dhe respektimit të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, të njohura.

Parimet që udhëhoqën këto ndryshime demokratike u përcaktuan fillimisht në ligjin nr.7491 dt.29.04.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese", më pas me ligjin nr.7561 dt.29.04.1992 "Për disa ndryshime e plotësime në ligjin nr.7491 dt.29.04.1991 Për dispozitat kryesore kushtetuese", të cilat kishin vlerën e Kushtetutës së vendit.³³¹ Në këto dispozita kushtetuese sanksionohet parimi i ndarjes dhe balancimit të tri pushteteve, legjislativ, ekzekutiv dhe gjyqësor.³³²

³³⁰ Po aty neni 23 parashikonte që:

"Prona vetjake e shtetasve njihet e mbrohet nga shteti. Janë pronë vetjake: të ardhurat nga puna dhe nga burime të tjera të ligjshme, shtëpia e banimit dhe sende të tjera që shërbejnë për plotësimin e nevojave materiale e kulturore vetjake e familjare. Pronë vetjake janë edhe objektet që i përkasin familjes kooperativiste në bazë të statutit të kooperativës bujqësore. Prona vetjake nuk mund të përdoren në dëm të interesit shoqëror."

³³¹ Neni 3 i Ligjit 7491/1991 "Për Dispozitave Kryesore Kushtetuese" i ndryshuar përcaktonte që:

"Parimi themelor i organizimit shtetëror është ndarja e pushtetit legjislativ, ekzekutiv dhe gjyqësor. Populli e ushtron pushtetin nëpërmjet organeve përfaqësuese të tij si dhe me referendum. Organet përfaqësuese zgjidhen me votim të lirë, të përgjithshëm të barabartë, të drejtpërdrejtë dhe të fshehtë. Veprimtaria shtetërore ushtrohet vetëm nga organet e shtetit të njohura me ligj."

³³² Për më shumë rreth teorisë së ndarjes së pushteteve shih doktrinën shqiptare: Zejnullah Balanca dhe Aurela Anastasi, *Historia e institucioneve: Periudha moderne dhe bashkëkohore. Pjesa 2* (Luarasi 1995); Aurela Anastasi, *Historia e Institucioneve* (Ribotim i punuar, SHBLU 2011); Luan Omari dhe Aurela Anastasi, *E drejta Kushtetuese* (Shtëpia Botuese ABC 2008).

Ligji për Dispozitat Kryesore Kushtetuese i vitit 1991 në nenin 10 të tij riktheu në Shqipëri konceptin e pronës private duke garantuar mbrojtje kushtetuese. Gjithashtu, në këtë nen konfirmohet e drejta për iniciativën e lirë ekonomike të të gjitha subjekteve.³³³ Në ndryshim nga Kushtetutat e sistemit komunist (si Kushtetuta e vitit 1976 apo Kushtetuta e vitit 1950) në këto dispozita kryesore kushtetuese kishte një kthesë rrënjësore përse i përket sistemit ekonomik të vendit, i cili tashmë do të bazohej mbi iniciativën e lirë ekonomike dhe në respektimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, përfshirë edhe të drejtën e pronës private.

Orientimi i vendit drejt ekonomisë së tregut të lirë krijoi premisat për të patur një rregullim specifik në fushën e krijimit, administrimit dhe funksionimit të shoqërive tregtare, në harmoni me sistemet e tjera juridike europiane. Në ndryshim nga periudha e sundimit komunist ku ekonomia ishte e planifikuar dhe e kontrolluar totalisht nga shteti dhe iniciativa e lirë tregtare ishte e ndaluar, pas vitit 1992 u hartuan dhe filluan të zbatoheshin reforma ligjore që u jepnin individëve mundësinë e ushtrimit të aktivitetit tregtar, duke u organizuar kështu në aktivitete tregtare të vogla apo më të mesme. Parë në këtë prizëm edhe legjislacioni i dalë në bazë dhe për zbatim të këtij kuadri kushtetues duhet të garantonte të drejtat dhe liritë themelore të njeriut në të gjithë spektrin e tyre, përfshirë dhe liritë ekonomike dhe të drejtën e pronës private.

Ndryshimet politiko-ekonomike të vendit, si dhe ndryshimet kushtetuese ekspozuan nevojën e rregullimit më të hollësishëm të aktivitetit tregtar në Shqipërinë e pas vitit 1991. Në këtë kohë, një nga hapat e parë legjislativë në të drejtën tregtare ishte hyrja në fuqi e Ligjit 7512, datë 10.08.1991 *“Për sanksionimin dhe mbrojtjen e pronës private, të nismës së lirë, të veprimtarive private të pavarura dhe privatizimit”*.³³⁴ Me anë të këtij ligji, për

³³³ Neni 10 i Ligjit 7491/1991 *“Për Dispozitave Kryesore Kushtetuese”* I ndryshuar përcaktonte që:

“Ekonomia e vendit bazohet në shumëllojshmërinë e pronave, iniciativën e lirë të të gjitha subjekteve ekonomike në rolin rregullues të shtetit.

Iniciativa ekonomike e personave juridikë dhe fizikë nuk mund të zhvillohet në kundërshtim me interesin shoqëror dhe nuk duhet të cenojë sigurinë, lirinë dhe dinjitetin e njeriut.”

Ndërsa në neni 11 përcaktohej që:

“Subjekte të së drejtës së pronësisë janë shteti, personat juridikë dhe fizikë. Të gjitha llojet e pronësisë gëzojnë mbrojtje të barabartë me ligj. Pasuritë që përbëjnë objekte të pronës shtetërore përcaktohen me ligj.”

³³⁴ Ligji Nr.7512/1991 *“Për sanksionimin dhe mbrojtjen e pronës private, të nismës së lirë, të veprimtarive private të pavarura dhe privatizimit”* [1991] FZ 6. Në preambulën hyrëse të tij përcaktohej qëllimi i këtij ligji si vijon:

“Me qëllim që të vendoset një rend i ri ekonomik dhe të zbatohet kalimi nga një sistem me ekonomi të centralizuar e të kontrolluar nga shteti, në një sistem ekonomik të bazuar në parimet e tregut të lirë, në mbështetje të neneve 10, 11, 12 dhe 16 të ligjit nr. 7491, datë, 29.4.1991 “Për dispozitat kryesore kushtetuese”, me propozimin e Këshillit të Ministrave .”

Ndërsa neni 1 të tij përcaktohej:

“Në Republikën e Shqipërisë sanksionohen dhe mbrohen prona private, nisma e lirë, veprimtaritë private të pavarura, afarizmi, investimet e huaja, e drejta për të marrë e për të dhënë kredi, e drejta për të punësuar e për t'u punësuar, privatizimi i pronës shtetërore dhe gjithë procesi i

herë të parë pas shumë dekadash u pranua edhe në Shqipëri mundësia për të krijuar sipërmarrje tregtare të organizuar, qoftë si individit, apo edhe si shoqëri tregtare.

Kështu, pas rreth katër dekadash, ky ligj hodhi bazat juridike për rilindjen e shoqërive tregtare në Shqipëri dhe të sipërmarrjes së lirë tregtare. Në nenin 2 pika “ç” të këtij ligji përmenden në mënyrë eksplicite shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar, si një nga format e mundshme të organizimit të sipërmarrjes tregtare.³³⁵

Përcaktimet e bëra në ligjin nr 7512/1991 kishin më shumë si qëllim proklamimin dhe nxitjen e sipërmarrjes se lirë tregtare dhe konfirmimin e lirisë së të gjitha subjekteve të cituara në këtë ligj për t’u angazhuar në sipërmarrjet e ndryshme ekonomike, qofshin këto me karakter prodhues, shërbimi, import-eksporti etj. Por ky kuadër ligjor nuk ishte i mjaftueshëm për të dhënë një përshkrim të qartë dhe të plotë të shoqërive tregtare, themelimit, organizimit, marrëdhënieve mes ortakëve apo veçorive juridike të këtyre subjekteve, që për shkak të situatës politike dhe social-ekonomike ishin lënë në “harresë” për disa dekada.

Pavarësisht faktit historik që shoqëritë tregtare përbënin një realitet të konsoliduar shumë mirë juridikisht me Kodin Tregtar të vitit 1932, e deri në periudhën pas Luftës II Botërore, tashmë këto ligje nuk ishin në fuqi, dhe nuk qëndronin më as në kujtesën kolektive të qytetarëve shqiptarë në këtë moment (viti 1991), që sapo ishte ndryshuar sistemi politiko – ekonomik.

Në këto kushte, në vitet 1991-1992, paraqitej një vakum ligjor dhe një nevojë për përmirësim dhe plotësim të legjislacionit tregtar. Kjo me qëllim që sipërmarrësit të kishin një informacion të qartë dhe të mjaftueshëm për të kuptuar themelimin, organizimin, administrimin dhe funksionimin e shoqërive tregtare, pra funksionet e tyre të brendshme dhe ato të jashtme.

kalimit të ekonomisë së Republikës së Shqipërisë nga një ekonomi e planifikuar dhe e kontrolluar nga shteti, në një ekonomi të tregut të lirë.”

³³⁵ Ligji Nr.7512/1991 “Për sanksionimin dhe mbrojtjen e pronës private, të nismës së lirë, të veprimtarive private të pavarura dhe privatizimit” [1991] FZ 6. Në nenin 2 të këtij ligji përcaktohej se:

“Subjektet shqiptare ose të huaja ushtrojnë veprimtaritë private të mëposhtëme (pa u kufizuar vetëm me to);

a) si individë;

b) me ortakëri;

c) me kolektiva ose kooperativa;

ç) me formim ndërmarrjesh, shoqërish të ndryshme aksionere ose me përgjegjësi të kufizuar, anonime dhe forma të tjera të mundshme ;

d) me formim bankash, fondacionesh e institucionesh bamirësie ,si dhe me forma të tjera të mundshme.

Të gjitha veprimtaritë e mësipërme rregullohen me ligj.”

Në frymën e këtyre reformave dhe me qëllim plotësimin nevojave për kuadrin ligjor që rregullon funksionimin e subjekteve tregtare, u miratua dhe *Ligji nr. 7632, datë 04.11.1992 “Për Dispozitat që Rregullojnë Pjesën e Parë të Kodit Tregtar”*

Ky ligj përbënte një kontribut të rëndësishëm në drejtim të kodifikimit të legjislacionit tregtar dhe bën një përpjekje për të përkufizuar natyrën juridike të së drejtës tregtare, duke e dalluar atë nga e drejta e përgjithshme civile.³³⁶ Megjithatë, në ndryshim nga periudha e Monarkisë Shqiptare (Kodi Tregtar i vitit 1932), ky Ligj nuk arriti të unifikojë të gjithë legjislacionin për sipërmarrjet tregtare dhe rregullimin normativ të ushtrimit të të gjitha llojeve të tregtisë në Shqipëri.³³⁷ Kjo pasi rregullimet dhe plotësimet ligjore që dolën më pas, nuk u përfshinë si pjesë të këtij Kodi Tregtar të vitit 1992, por legjislacioni tregtar u pasurua me ligje të tjera, të cilat gjithsesi përmirësuan në mënyrë domethënëse infrastrukturën juridike për sipërmarrjet tregtare në përgjithësi, përfshirë dhe shoqëritë me përgjegjësi të kufizuara, që janë objekt i këtij kërkimi shkencor.

Në nenet 2 dhe 3 të ligjit 7632/1992 ishin bërë përkufizimet e para të subjekteve tregtare dhe të veprimtarisë tregtare. Sipas nenit 2 të këtij ligji ishte përcaktuar se të gjithë personat fizikë dhe juridikë që kryejnë veprime tregtare konsiderohen tregtar.³³⁸ Në këtë kategori nuk futeshin ortakët e shoqërive tregtare.

Ndërkohë sipas nenit 3 të këtij ligji bëhej një përkufizim i veprimeve tregtare.³³⁹ Ky përkufizim përfshinte në një listë joshteruese fushat kryesore të veprimtarisë tregtare, por gjithsesi nuk kufizonte mundësinë që edhe veprimtari apo aktivitete të tjera të kategorizohen si veprime tregtare.

³³⁶ Në nënin 1 të ligjit nr. 7632, datë 04.11.1992 “Për Dispozitat që Rregullojnë Pjesën e Parë të Kodit Tregtar” përcaktohet:

“Ligjet që zbatohen në fushën e tregtisë. Në fushën e tregtisë zbatohet legjislacioni tregtar. Për çështjet që nuk trajtohen nga ky legjislacion, zbatohen praktikat tregtare; praktikat lokale ose te veçanta marrin përparësi ndaj praktikave të përgjithshme. Në mungesë të tyre zbatohen dispozitat e Kodit Civil”:

³³⁷ Hajdari (n 210) fq. 8, 25.

³³⁸ Ligji 7632, datë 04.11.1992 “Për Dispozitat që Rregullojnë Pjesën e Parë të Kodit Tregtar” neni 2 përcaktohet “Përkufizimi i tregtarit”. *Konsiderohen tregtare personat fizikë dhe shoqëritë tregtare, që gjatë ushtrimit të profesionit kryejnë veprime tregtare në emër të tyre. Ortakët e shoqërive tregtare nuk konsiderohen tregtarë.*

³³⁹ Shih nenin 3 të ligjit nr. 7632, datë 04.11.1992 sipas të cilit:

“Përkufizimi i veprimeve tregtare: Konsiderohen veprime tregtare veçanërisht:

- 1. Blerja me qëllim rishitjeje, shitja që rrjedh nga një blerje e mëparshme e bërë me qëllim rishitjeje, si dhe përgjithësisht çdo veprim shkëmbimi i lidhur me një veprim tjetër shkëmbimi.*
- 2. Çdo akt i sipërmarrjeve industriale të ndërtimit, të shfrytëzimit të minierave, të transportit, të transportit, të sigurimeve, të magazinimit, të shfaqjeve publike, të reklamës, të botimit të shtypshkrimit joartizanal;*
- 3. Çdo operacion bankar dhe këmbimi*
- 4. Të gjitha operacionet ndërmjetëse tregtare, si operacionet e ndërmjetësisë ose të speditonit dhe ato të përfaqësuesve tregtarë.”*

Gjithashtu, në ligjin për pjesën e parë të Kodit Tregtar të vitit 1992, u përcaktua dhe mënyra e mbajtjes së Regjistrimit Tregtar, si regjistër i posaçëm i tregtarëve pranë Gjykatës.³⁴⁰

Hapi më i rëndësishëm pas vitit 1992 në zbatim të reformave demokratike të filluara në ligjin për Dispozitat Kryesore Kushtetuese, me qëllim konsolidimin e legjislacionit që mbështet sipërmarrjet tregtare, ishte pa dyshim *ligji Nr.7638, datë 19.11.1992 "Për shoqëritë tregtare"*, në të cilin u përcaktuan katër format e shoqërive tregtare, të cilat mund të themeloheshin në Shqipëri, kuptimi i tyre, organizimi dhe funksionimi i këtyre shoqërive. Njëra nga format e shoqërive tregtare që parashikoheshin në këtë ligj³⁴¹ ishte dhe shoqëria me përgjegjësi të kufizuar, e cila, siç do të analizohet në vijim, pati dhe zhvillimin më të madh në raport me të gjitha format e shoqërive tregtare. Në këtë ligj u përcaktuan rregulla të imtësishëm për mënyrën se si themelohen shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar, si funksionojnë ato dhe cilat janë organet drejtuese dhe përfaqësuese të SHPK-ve, rastet e prishjes së tyre, si dhe mënyra e likuidimit të këtyre shoqërive.

Në mbështetje të ligjit për shoqëritë tregtare, u miratua *dhe ligji nr. 7667, datë 28/01/1993 "Për Regjistrin Tregtar dhe formalitetet që duhet respektuar nga Shoqëritë Tregtare"*.³⁴² Në këtë ligj u përcaktuan rregullat për regjistrimin e shoqërive tregtare dhe për regjistrin tregtar, i cili duhet të mbahej pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, për të gjitha shoqëritë në shkallë vendi.³⁴³ Poende, në këtë ligj përcaktohen procedurat dhe modalitetet e regjistrimit të të gjitha të dhënave të nevojshme për publikim nga shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar dhe format e tjera të shoqërive. Normat që rregullonin mbajtjen e regjistrimit tregtar përcaktuan Gjykatën e Tiranës si organin kompetent, që do të mbante Regjistrin Tregtar për të gjithë Shqipërinë.³⁴⁴

Në kuadër të decentralizimit ekonomik dhe implementimit të ekonomisë së tregut të lirë, legjislatori shqiptar, në vitin 1995, miratoi ligjin Nr. 7926 dt. 20.4.1995 "Për transformimin e ndërmarrjeve shtetërore në Shoqëri Tregtare, duke përfshirë kështu edhe shoqëritë shtetërore nën ombrellën e shoqërive tregtare të rregulluara nga ligji Nr. 7638/1992."³⁴⁵

³⁴⁰ Sipas nenit 13 të ligjit nr. 7632, datë 04.11.1992 përcaktohej se: "Regjistri tregtar mbahet nga gjykatat. Modalitetet për këtë caktohen me vendim të Këshillit të Ministrave."

³⁴¹ Ligji 7638/1992 "Për shoqëritë tregtare" [1992] FZ 8 (shfuqizuar), neni 37.

³⁴² Ligji 7667/1993 "Për regjistrin tregtar dhe formalitetet që duhen respektuar nga shoqëritë tregtare" [1993] FZ 1.

³⁴³ Ligji 7667/1993 në nenin 1 të ligjit përcaktohet se: "Mbajtja e regjistrimit nga gjykata: Regjistri Tregtar mbahet nga Gjykata e Rrethit të Tiranës për gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë."

³⁴⁴ Po aty.

³⁴⁵ Ligji 7926/1995 "Për transformimin e ndërmarrjeve shtetërore në shoqëri tregtare" [1995] FZ 11. Neni 3 parashikonte që:

"Të gjitha ndërmarrjet shtetërore do të transformohen në shoqëri anonime ose shoqëri me përgjegjësi të kufizuar dhe do të funksionojnë në përputhje me dispozitat e ligjit 7638, datë 19.11.1992 "Për shoqëritë tregtare", përveç rasteve kur në këtë ligj parashikohen ndryshe. Çdo

Sipas këtij ligji parashikohej që shoqëritë shtetërore mund të transformohen në shoqëri anonime ose shoqëri me përgjegjësi të kufizuar. Në realitet shumica e shoqërive shtetërore u transformuan në shoqëri anonime për shkak të vëllimit të madh të kapitalit dhe aktivitetit që ushtronin, por ka pasur edhe raste kur janë transformuar në shoqëri me përgjegjësi të kufizuar. Në këto shoqëri shtetërore, të cilat u transferuan në shoqëri me përgjegjësi të kufizuara shteti si zotërues i vetëm i kapitalit të tyre, përfaqësohej nga Ministria e Financave, e cila nëpërmjet përfaqësuesit të saj ushtronte të gjitha tagrat e ortakut të shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar.

Në këtë ligj³⁴⁶ përcaktohej dhe ngritja e një strukture të posaçme pranë Ministrisë së Financave për të ndjekur dhe drejtuar këtë proces. Ky organ quhej "Drejtoria e shoqërive publike" dhe në përbërjen e saj perfshiheshin të gjitha drejtoritë e sotme të privatizimit pranë ministrive dhe institucioneve përkatëse, si dhe nënkomisionet e privatizimit pranë organeve të pushtetit lokal. Sipas nenit 7 këtij ligji parashikohej dhe një afat, brenda të cilit duhet të përfundonte procesi i transformimit të ndërmarrjeve shtetërore në shoqëri tregtare. Ky afat ishte data 31.08.1995.³⁴⁷

Ky proces u shoqërua edhe me procesin e privatizimit të një sërë ndërmarrjesh shtetërore në Shqipëri. Një pjesë e këtyre ndërmarrjeve pas privatizimit u përshatatën si shoqëri me përgjegjësi të kufizuar. Në mbështetje të procesit të privatizimit të shoqërive tregtare me kapital shtetëror u miratuan disa ligje të tjera, si: Ligj Nr. 8334, datë 23.4.1998 "Për privatizimin e shoqërive tregtare që veprojnë në sektorët jostrategjikë", i ndryshuar; Ligji Nr. 8306 datë 14.3.1998 "Për Strategjinë e Privatizimit të Sektorëve me Rëndësi të Veçantë", i ndryshuar; Ligj Nr. 9967, datë 24.7.2008 "Për miratimin e aktit normativ, me fuqinë e ligjit, nr.4, datë 9.7.2008, të Këshillit të Ministrave, "Për privatizimin dhe dhënien në përdorim shoqërive tregtare dhe institucioneve shtetërore të ndërmarrjeve apo objekteve të veçanta, mjeteve kryesore dhe mjeteve të xhiros së këtyre ndërmarrjeve" dhe një sërë aktesh nënligjore, si vendime të Këshillit të Ministrave, urdhra të ministrave dhe akte të tjera në këtë fushë.

ndërmarrje mund të transformohet në një ose disa shoqëri anonime ose me përgjegjësi të kufizuar. Shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar do të krijojnë këshill mbikëqyrës".

³⁴⁶ Ligji 7926/1995 "Për transformimin e ndërmarrjeve shtetërore në shoqëri tregtare" [1995] FZ 11, neni 5.

³⁴⁷ Sipas nenit 7 të ligjit 7926/1995 "Për transformimin e ndërmarrjeve shtetërore në shoqëri tregtare" parashikohet që:

"Regjistrimi i shoqërive që krijohen nga transformimi i ndërmarrjeve, duhet të kryhet brenda datës 31.8.1995. Çdo ndërmarrje shtetërore që pas kësaj date nuk është transformuar e regjistruar si shoqëri, vendoset nën kujdestarinë e Drejtorisë së shoqërive publike. Ministri i Financave ka të drejtë të marrë masa disiplinore deri në largimin nga detyra për çdo drejtues të ndërmarrjes shtetërore, i cili ka penguar transformimin dhe regjistrimin e ndërmarrjes shtetërore si shoqëri tregtare, brenda afatit të parashikuar në paragrafin e parë të këtij neni."

Gjithashtu edhe në *Kodin Civil të vitit 1994* parashikohen shprehimisht personat juridikë privatë si subjekte të së drejtës.³⁴⁸ Ky kod ka disa norma, të cilat rregullojnë aspekte të veprimtarisë së shoqërive tregtare si një kategori e personave juridikë privatë.

Në nenin 26 të këtij kodi përfshihen dhe shoqëritë tregtare në kategorinë e personave juridikë privatë.³⁴⁹ Në K.C. të vitit 1994 i cili është në fuqi edhe aktualisht, në kapitullin që parashikon “Subjektet e së drejtës” dhe personat juridikë, rregullohen elemente, si; emri, qendra e veprimtarisë, zotësia juridike e tyre dhe elemente të tjera, të cilat lidhen me zotësinë juridike të shoqërive tregtare.

Përsa i përket analizës rreth evoluimit të legjislacionint për SHPK-të, duhet pasur parasysh që edhe ligji 7638/1992 “Për shoqëritë tregtare”, i cili ka qenë në fuqi deri në vitin 2008, ka pasur përmirësime të vazhdueshme për shkak të ndryshimeve dhe zhvillimeve të kuadrit ligjor shqiptar gjatë këtyre viteve. Ligji i vitit 7638/1992 është përshtatur ndër vite me kërkesat dhe nevojat në zhvillim të shoqërisë shqiptare në drejtim të përafrimit të legjislacionit të vendit tonë me legjislacionin e vendeve të Bashkimit Europian. Gjithashtu, gjatë kësaj periudhe të operimit të këtij ligji është miratuar dhe Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë me ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, e cila është në fuqi edhe sot me ndryshimet e saj.³⁵⁰

Me Kushtetutën e vitit 1998, Shqipëria bëri akoma më shumë përparime në synimin e saj për të implementuar një shtet të së drejtës dhe garantimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, sipas standardeve më të mira ndërkombëtare, të mishëruara edhe në Konventën Evropiane të të Drejtave të Njeriut,³⁵¹ të cilën e bëri pjesë të vetë Kushtetutës. Në nenin 11 të Kushtetutës parashikohet se sistemi ekonomik i vendit bazohet mbi parimet e mbrojtjes se pronës private dhe ekonomisë së tregut të lirë.³⁵²

³⁴⁸ Ligji 7850/1994 “Për Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë” [1994] FZ 11 ndryshuar për herë të fundit me Ligjin 113/2016 “për disa shtesa në ligjin nr. 7850, datë 29.7.1994, “kodi civil i republikës së shqipërisë” [2016] FZ 219 (Kodi Civil) neni 24.

³⁴⁹ Neni 26 i Kodit Civil përcakton se: “*Persona juridikë privatë janë shoqëritë, shoqatat, fondacionet dhe entet e tjera me karakter privat, të cilat e fitojnë personalitetin juridik në mënyrën e caktuar nga ligji.*”

³⁵⁰ Ligji 8417/1998 “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë” [1998] FZ 28 i ndryshuar për herë të fundit me ligjin 115/2020 “Për disa ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë” [2020] FZ 153.

³⁵¹ Shih Konventa për mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore dhe Protokollet e saj. botuar në Fletoren Zyrtare Nr. Ekstra 28 viti 2008.

³⁵² Kushtuta e Republikës së Shqipërisë në nenin 11 parashikohet që:

- “1. Sistemi ekonomik i Republikës së Shqipërisë bazohet në pronën private epublike, si dhe në ekonominë e tregut dhe në lirinë e veprimtarisë ekonomike.
2. Prona private dhe publike mbrohen njëjloj me ligj.
3. Kufizime të lirisë së veprimtarisë ekonomike mund të vendosen vetëm me ligj dhe vetëm për arsye të rëndësishme publike.”

Gjykata Kushtetuese³⁵³ ka bërë interpretimin e kësaj dispozite duke e zbërthyer këtë liri edhe në të drejta dhe liri të tjera, si liria e ushtrimit të biznesit, e drejta për të krijuar dhe ushtuar një sipërmarrje tregtare, liria e tregtisë pa kufizime përsa i përket importimit apo eksportimit të mallrave dhe shërbimeve. Gjithashtu, Gjykata Kushtetuese ka interpretuar këtë liri edhe në kontekstin e detyrimeve që i ngarkon shtetit, i cili nëpërmjet organit ligjvënës të ndërhyjë për rregullimin e kësaj lirie, duke nxjerrë ligjet dhe aktet nënligjore të nevojshme tregtare që bëjnë të mundur aplikimin e të drejtave dhe lirive të cituara më sipër³⁵⁴. Sipas Vendimit Nr 14 dt. 21.03.2014 të Gjykatës Kushtetuese, në fushën e së drejtës tregtare duhet mbajtur parasysh edhe legjislacioni dhe jurisprudenca evropiane.³⁵⁵ Madje në nenin 49 të Kushtetutës në fuqi janë parashikuar dhe të drejtat dhe liritë ekonomike duke garantuar një mbrojtje në nivel kushtetues.³⁵⁶ Në këtë mënyrë, edhe për shoqëritë tregtare si persona juridikë të themeluar me qëllim fitimin, u garantohen të gjitha të drejtat dhe liritë ekonomike dhe gëzojnë të drejtën për t'u drejtuar gjykatës në mbrojtje të çdo të drejte të cenuar.

Në këtë kontekst Kushtetuta ka garantuar një sistem efikas të balancimit të pushteteve ku një rol thelbësor në këtë drejtim ka sistemi gjyqësor dhe Gjykata Kushtetuese. A. Hamilton thekson se “*E drejta e kontrollit nuk e vë Gjyqësorin mbi Legjislativin, përkundrazi, të dyve u vë për detyrë që t'i nënshtrohen autoritetit suprem të Kushtetutës*”.³⁵⁷ Një qëndrim të tillë ka mbajtur edhe Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë në praktikën e saj.³⁵⁸ Koncepti i shtetit të së drejtës në kuptimin formal mishërohet në përcaktimet kushtetuese lidhur me procedurat dhe formën, të caktuara për ndërtimin dhe veprimtarinë e organeve shtetërore, dhe respektimin e këtyre procedurave.³⁵⁹ Ndërsa me shtetet të së drejtes në kuptimin material, janë konsideruar kërkesat e nevojshme për të garantuar përmbajtjen e ligjeve të caktuara që dalin në bazë dhe për zbatimin e kushtetutës,³⁶⁰ mes të cilave vend

³⁵³ Shih Vendimin Nr. 10 dt 19.03.2008 të Gjykatës Kushtetuese.

³⁵⁴ Shih Vendimin Nr. 24 dt 24.07.2009 të Gjykatës Kushtetuese.

³⁵⁵ Shih Vendimin Nr. 14 dt 21.03.2014 të Gjykatës Kushtetuese.

³⁵⁶ Sipas nenit 49 të Kushtetutës; “*1. Secili ka të drejtë të fitojë mjetet e jetesës së tij me punë të ligjshme, që e ka zgjedhur ose pramuar vetë. Ai është i lirë të zgjedhë profesionin, vendin e punës, si dhe sistemin e kualifikimit të vetë profesional.*”

³⁵⁷ Alexander Hamilton dhe James Medison (përkthyer nga Kristaq Traja), *Letrat e Federalistit, Pjesa e parë* (Drejtësia Kushtetuese, Luarasi 2000) fq. 3.

³⁵⁸ *Vendime të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë 2010* (Shtypshkronja “ILAR”, 2010) fl. 138. Në Vendimin nr. 9/2010, ka theksuar:

“*Në nenin 4 paragrafi i dytë i Kushtetutës deklarohet se “Kushtetuta është ligji më i lartë në Republikën e Shqipërisë”. Deklarimi i epërsisë së Kushtetutës, duke e vendosur në majë të piramidës së normave juridike, përbën një aspekt thelbësor të parimit të shtetit të së drejtës. Ky parim detyron të gjitha organet e pushtetit publik që t'i ushtrojnë kompetencat e tyre vetëm në kuadër dhe në bazë të normave kushtetuese. Aktet juridike që nxirren nga këto organe duhet të jenë në pajtim me aktet juridike më të larta, si në kuptimin formal, ashtu edhe atë material*”

³⁵⁹ Peter Badura, *Staatsrecht*, (Mynih 1996) fq. 266;

³⁶⁰ Denar Biba dhe Xhezair Zaganjori, “*Rule of Law and Albanian Institutional Reality*” (2010) 32 *Political Thought*.

të veçantë zënë aktet mbi të drejtat dhe liritë themelore.³⁶¹ Autorët e punimit shkencor “Shteti i së Drejtës në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë”, në analizën e tyre rreth konceptit të “Shtetit të së Drejtës”, sqarojnë se ky koncept duhet parë i lidhur ngushtë edhe me parimet e tjera themelore kushtetuese, si parimi i ndarjes së pushteteve, parimi i kushtetushmërisë, parimi i pluralizmit, parimi i sovranitetit shtetëror, parimet e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, si dhe me të gjitha parimet e tjera kushtetuese.³⁶²

Gjykata Kushtetuese e R.Sh. me praktikën e saj ka kontribuar duke pasuruar jurisprudencën shqiptare në fushën zhvillimit legjislacionit tregtar dhe konsolidimit të disa koncepteve të rëndësishme në fushën e shoqërive me përgjegjësi të kufizuara. Në Vendimin nr. 22 datë 08.02.2013 Gjykata Kushtetuese ka trajtuar koncepte të rëndësishme kushtetuese, të cilat gjejnë aplikim në veprimtarinë e shoqërive me përgjegjësi të kufizuar dhe në zgjidhjen e konflikteve që lindin në këto shoqëri.³⁶³ Disa nga këto parime, janë: parimi i shtetit të së drejtës, parimi i ndarjes së pushteteve, parimi i mbrojtjes së pronës dhe veprimtarisë ekonomike private, mbrojtja e të drejtave dhe lirive themelore për personat juridikë, si dhe zhvillimi i një procesi të rregullt ligjor në respekt të të drejtave dhe lirive themelore vetjake.³⁶⁴

3.4. Risitë që solli ligji nr.7638, datë 19.11.1992 “Për shoqëritë tregtare” dhe zhvillimi shoqërive me përgjegjësi të kufizuar në bazë të këtij ligji

Në këtë pjesë të kërkimit shkencor që ka për objekt analizën krahasimore të infrastrukturës ligjore mbi të cilën kanë vepruar SHPK-të, dhe evoluimin e saj, do të nënvizojmë kryesisht

³⁶¹ Po aty.

³⁶² Për një trajtim më të hollësishëm doktrinor shih: Xhezair Zaganjori, Aurela Anastasi dhe Eralda (Methasani) Çani, *Shteti i së Drejtës në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë* (Shtëpia Botuese “Adelprint” 2011)

³⁶³ Shih Vendim nr. 22 datë 08.02.2013 të Gjykatës Kushtetuese të R.SH. është shprehur se:

“11. Në lidhje me pretendimin se gjykimi i pjesëtimit ka çënuar lirinë e ushtrimit të veprimtarisë ekonomike, duke ndërhyrë në ndarjen e kuotave që tashmë ishin të ndara, Kolegji vlerëson se është kontradiktor dhe i pabazuar. Nga njëra anë pranohet nga vetë kërkuksi dhe pohohet se kuotat kanë qenë të ndara, nga ana tjetër kundërshtohet ndarja e kuotave për efekt të pjesëtimit gjyqësor. Lejimi i pjesëtimit të një pasurie, që përfshin si sende të paluajtshme ashtu dhe të luajtshme (tituj pronësie-kuotat e shoqërisë), nuk presupozon se personi juridik në vetvete do të prishet dhe nuk do të ekzistojë më. Në rastin konkret kemi dy shoqëri me përgjegjësi të kufizuara, të cilat janë në pronësi të barabartë të të dy palëve ndërgjyqëse dhe është propozuar, nga njëra palë, që secili prej tyre të mbajë njëren shoqëri. Pjesëtimi gjyqësor nuk presupozon prishje të shoqërive, si persona juridikë, pasi këta të fundit do të kenë po ato të drejta dhe detyrime siç kanë pasur më parë, me ndryshimin se do të jenë me një ortak të vetëm. Pra, nuk ka cenim të ushtrimit të veprimtarisë ekonomike.

12. Lidhur me pretendimin se me gjykimin e pjesëtimit është shkelur neni 11/3 i Kushtetutës, Kolegji vlerëson se nuk qëndron. Kërkuksi, jo vetëm që nuk e argumenton pretendimin, por dhe bën një referim që nuk ka lidhje me pretendimin dhe me gjendjen faktike, për më tepër që nuk provohet se ka ndonjë kufizim të lirisë së veprimtarisë ekonomike.”

³⁶⁴ Argita Malltezi, Jonida Rystemaj dhe Armela Kromiçi, *Gjykatat Shqiptare mbi shoqëritë dhe veprimtarinë Tregtare* (Shtëpia botuese “Mediaprint” 2015) fq. 51.

ato risi ose veçori dalluese të ligjit Ligjit 7638/1992 “Për shoqëritë tregtare”, të cilat rezultojnë si specifika të këtij ligji në raport me ligjin aktual. 9901/2008.

Në ndryshim nga ligji aktual 9901/2008, i cili ka përfshirë dhe tregtarin si person fizik në kategorinë e subjekteve tregtare, ligji 7638, /1992 përcaktonte rregulla të detajuar vetëm për katër format e shoqërive tregtare (shoqëritë kolektive, shoqëritë komandite, shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar dhe shoqëritë anonime).

Ashtu si në ligjin aktual, edhe në ligjin 7638/1992, parashikohej mundësia për të themeluar një SHPK, nga një ose më shumë persona fizikë ose juridikë, të cilët përballojnë humbjet e shoqërisë vetëm deri në kufirin e vlerës së kontributit të tyre në kapitalin themeltar. Në ndryshim nga ligji aktual, i cili sipas nenit 71 të tij parashikon disa detyrime për shoqërinë që mbetet me një ortak, në ligjin e vitit 1992 nuk konstatohen këto detyrime publikimi dhe pasojat në rast moszbatimi, me heqje të privilegjit të përgjegjësive së kufizuar.³⁶⁵

i) Procedura e themelimit

Mënyra e themelimit të shoqërive me përgjegjësi të kufizuar e parashikuar në ligjin 7638/1992, në harmoni me ligjin 7667/1993 “Për regjistrin tregtar dhe formalitetet që duhen respektuar nga shoqëritë tregtare” ishte krejtësisht e ndryshme me procedurën që u parashikua pas reformimit të legjislacionit për shoqëritë tregtare me ligjin 9723/2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit” dhe Ligjin 9901/2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”

Ky legjislacion që ishte në fuqi nga viti 1992 deri në vitin 2007, parashikonte regjistrimin e shoqërive tregtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, gjykatë kjo që mbante dhe Regjistrin Tregtar për të gjithë Republikën e Shqipërisë.

Kështu, sipas reformës në legjislacionin tregtar të periudhës pas vitit 1992, veprimtaria e shoqërive tregtare me përgjegjësi të kufizuara, ashtu si dhe e shoqërive të tjera, do të fillonte pas kontrollit gjyqësor të kërkesës për regjistrim, si dhe akteve të domosdoshme të kërkuara, siç ishin akti i themelimit dhe statuti. Në këtë mënyrë të gjitha shoqëritë tregtare kudo që të kishin selinë apo veprimtarinë tregtare në Republikën e Shqipërisë do të duhet t'i drejtoheshin Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë për të kryer regjistrimin e shoqërisë në momentin e themelimit, si dhe të çdo vendimi tjetër, për të cilin ligji kërkonte domosdoshmërisht publikimin në Regjistrin Tregtar.³⁶⁶

³⁶⁵ Ligji 7638/1992 “Për shoqëritë tregtare” [1992] FZ 8 (shfuqëzuar), neni 71.

³⁶⁶ Sipas nenit 13 të ligjit nr. 7632, datë 04.11.1992 përcaktohej se: “Regjistri tregtar mbahet nga gjykatat. Modalitetet për këtë caktohen me vendim të Këshillit të Ministrave”.

Këto detyrime formale u reduktuan me reformën e bërë në legjislacionin për shoqëritë tregtare pas vitit 2007 me miratimin e ligjit 9723/2007 për QKR, sipas të cilit Regjistri Tregtar nuk do të mbahej më nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, por nga një institucion si Qendra Kombëtare e Regjistrimit, e cila kishte selinë qendrore në Tiranë, por kishte dhe sportelet e saj në të gjitha bashkitë e vendit. Në këtë mënyrë ortakët themelues kursenin kostot kohore dhe financiare, të cilat lidheshin me burokracitë dhe formalitetet juridike që duheshin respektuar për t'iu drejtuar Gjykatës dhe për të pritur deri sa të bëhet regjistrimi në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Një karakteristikë tjetër e ligjit 7638/1992 ishte dhe fakti që ky ligj kërkonte domosdoshmërisht hartimin e dy dokumenteve bazë të themelimit të shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar. Në nenin 39 përcaktohet detyrimi i ortakëve për të hartuar Aktin e themelimit, ndërsa në nenin 3, te dispozitat e përgjithshme, përcaktohej detyrimi për hartimin e statutit të shoqërisë.³⁶⁷

Në Ligjin aktual 9901/2008, përmendet vetëm statuti i shoqërisë tregtare si dokument thelbësor me karakter konstitues të shoqërisë tregtare. Në nenin 6 të ligjit bëhet referimi te ligji për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit, përse i përket përmbajtjes së statutit për të katër format e shoqërive tregtare³⁶⁸.

Ndërkohë që, sipas paragrafit katër të nenit 28 të ligjit Nr.9723/2007³⁶⁹ për QKR, konstatojmë se për shoqërinë me përgjegjësi të kufizuar është parashikuar edhe mundësia që ortakët themelues të regjistrojnë një shoqëri të tillë, pa paraqitur një akt themelimi apo statut të shkruar, por vetëm duke nënshkruar formularin e aplikimit për regjistrim fillestar me të dhënat e nevojshme dhe një deklaratë të *posaçme për njohjen, pranimin dhe zbatimin e dispozitave ligjore në fuqi për shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar*.³⁷⁰ Në një situatë të tillë, formulari i aplikimit merr vlerën e statutit.

³⁶⁷ Ligji 7638/1992 “Për shoqëritë tregtare” [1992] FZ 8 (shfuqëzuar), nenin 39.

³⁶⁸ Sipas nenit 6 të ligjit 9723/2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit” i ndryshuar përcaktohet se: “Statuti i shoqërisë tregtare përmban të dhënat e përcaktuara në nenet 32 deri në 36 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”. Paragrafi i katërt i nenit 28 të ligjit të sipërpërmendur mbetet i zbatueshëm”.

³⁶⁹ Sipas nenit 28/4 ligjit 9723/2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit” [2007] FZ 60 përcaktohet se: “Shoqëritë kolektive, komandite dhe ato me përgjegjësi të kufizuar mund të regjistrohen, gjithashtu, duke depozituar vetëm aplikimin për regjistrim fillestar, të plotësuar me të gjitha të dhënat e detyrueshme sipas këtij ligji, dokumentet e identifikimit të anëtarëve apo ortakëve dhe duke nënshkruar deklaratën e *posaçme për njohjen, pranimin dhe zbatimin e dispozitave ligjore në fuqi, për organizimin dhe funksionimin e llojit të shoqërisë që regjistrohet. Në këtë rast, aplikimi për regjistrim fillestar dhe deklarata e mësipërme, e nënshkruar sipas rastit nga ortakët, anëtarët ose nga personat e autorizuar të veprojnë në emër e për llogari të tyre, zëvendëson aktin e themelimit dhe statutin e shoqërisë.*”

³⁷⁰ Po aty.

Ky ndryshim u bë me qëllim thjeshtëzimin dhe lehtësimin e procedurave për regjistrimin e një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar, por, në të vërtetë, nuk rezultoi se shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar e kanë aplikuar një lehtësi të tillë. Kjo vjen edhe për shkak të faktit që juridikisht është e këshillueshme në çdo rast, që shoqëria me përgjegjësi të kufizuar të ketë të miratuar një statut sa më të plotë me qëllim paracaktimin e rregullave të ortakërisë dhe funksionimit të SHPK-së në elementet thelbësore të saj. Duke kontribuar kështu në zvogëlimin e mundësisë së konflikteve eventuale në shoqëri.

ii) Kapitali Themeltar

Përsa i përket kapitalit themeltar për formimin e një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar ligji Nr.7638, datë 19.11.1992 “Për shoqëritë tregtare” përcaktonte një minimum prej 100.000 lekësh si kapital minimal i domosdoshëm për themelimin e një SHPK-je.³⁷¹ Ky kapital minimal për periudhën e hartimit të ligjit, (pra referuar vitit 1992) përfaqësonte një vlerë relativisht të konsiderueshme duke pasur parasysh që paga mesatare në shkallë vendi ka qenë shumë e ulët në atë kohë. Në këtë ligj pasqyrohej pikëpamja tradicionale që ka mbizotëruar në Evropën Kontinentale e parimit “*quid-pro-quo*”³⁷² sipas së cilit, për të gëzuar “privilegjin” e përgjegjësive të kufizuar, ortakët duhet të kontribuojnë me sasi të konsiderueshme kapitali duke ia kaluar shoqërisë në themelimin e saj. Pra, një kërkesë e tillë e ligjit, e vendosur si kusht për themelimin e një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar përforconte te këto shoqëri, karakteristikat e shoqërisë së kapitalit.

Ky aspekt karakterizues për shoqëritë e kapitalit përforcohej akoma më shumë në nenin 72 të ligjit Nr. 7638/1992 “Për shoqëritë tregtare”.³⁷³ Sipas kësaj dispozite parashikohej që,

³⁷¹ Sipas nenit 38/1 të Ligji 7638/1992 “Për shoqëritë tregtare” [1992] FZ 8 (shfuqëzuar) : “*Vlera minimale e kapitalit themeltar të kësaj forme shoqërie është 100 000 lekë. Këshilli i Ministrave ngarkohet që, në përputhje me nivelin e inflacionit, të ricaktojë vlerën minimale të kapitalit themeltar*”.

³⁷² Thomas Bachner, Edmund-Philipp Schuster dhe Martin Winner (n 203) fq. 59.

³⁷³ Sipas nenit 72 të këtij ligji parashikohej se:

“Në rast se kapitalet e veta të shoqërisë, për shkak të humbjeve të konstatuara në dokumentet financiare, rezultojnë më të vogla se gjysma e kapitalit themeltar, ortakët vendosin, brenda 4 muajve nga miratimi i llogarive që pasqyrojnë këtë humbje, mbi mundësinë e prishjes së parakohshme të shoqërisë. Në rast se prishja nuk shpallet nga shumica e nevojshme për ndryshimet e statutit, shoqëria detyrohet të zvogëlojë kapitalin e saj me një vlerë jo më të vogël se ajo e humbjeve që kanë mbetur të pambuluara nga rezervat, duke pasur parasysh edhe rregullat e nenit 38 të këtij ligji. Ky operacion duhet të kryhet jo më vonë se data e mbylljes së vitit të parë financiar, para të cilit është konstatuar humbja, në qoftë se brenda këtij afati kapitalet e veta të shoqërisë nuk janë plotësuar deri në një vlerë jo më të vogël se gjysma e kapitalit themeltar. Në të dy rastet rezoluta e ortakëve botohet në një gazetë të autorizuar për publikimin e njoftimeve ligjore. Ajo gjithashtu regjistrohet në regjistrin tregtar. Në mungesë të iniciativës për marrjen e një vendimi nga ana e administratorit ose ekspertit kontabël të autorizuar apo në rast se ortakët nuk kanë mundur të marrin një vendim të vlefshëm, çdo person i interesuar mund të kërkojë në rrugë gjyqësore prishjen e shoqërisë. Prishja e shoqërisë mund të kërkohej edhe në rast se dispozitat e paragrafit të dytë të këtij neni nuk janë përmbushur. Gjykata mund t’i akordojë shoqërisë një afat maksimal prej 6 muajsh për të rregulluar gjendjen. Ajo nuk mund të shpallë prishjen, në rast se ky rregullim është bërë ditën në të cilën ajo mblidhet për të marrë vendim”.

në rast se shoqëria gjatë aktivitetit tregtar të saj pëson humbje të konsiderueshme, të cilat i ulin kapitalet e shoqërisë (pra të gjitha kapitalet, përfshirë dhe rezervat) në një vlerë më të vogël se gjysma e kapitalit themeltar të shoqërisë, atëherë shoqëria detyrohet të vendosë për zvogëlimin e kapitalit të saj themeltar deri në vlerën e kapitaleve që disponon realisht (por gjithsesi jo më pak se kapitali minimal ligjor prej 100.000 lekësh) ose shoqëria duhet të prishet.³⁷⁴

Kjo karakteristikë e shoqërive me përgjegjësi të kuafizuara ndryshoi me reformën e vitit 2008, kur u miratua ligji aktual 9901/2008. Sipas ligjit aktual, kapitali minimal i domosdoshëm për të themeluar një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar u ul në një vlerë kejtësisht simbolike dhe jo domethënëse në aspektin financiar që është vlera prej 100 lekësh. Ligji i ri reflektoi traditën evropiane të evoluimit të shoqërive me përgjegjësi të kufizuara, sipas së cilës nuk përcaktohet ndonjë limit apo kufizim për kapitalin themeltar.³⁷⁵ Në këtë aspekt ky ligj kishte më shumë ngjashmëri me përcaktimet e Kodit Tregtar të vitit 1932, i cili parashikonte si kusht të domosdoshëm për themelimin e në SHPK-je, ekzistencën e një kapitali jo më të vogël se 10.000 (dhjetë mijë) Franga Ari.³⁷⁶

Përsa i përket mënyrës se si ortakët mund të kontribuojnë në kapitalin themeltar të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar, neni 40 paragrafi i parë i ligjit kishte përcaktuar shprehimisht që kontributet në kapital mund të ofrohen në para dhe me kontribute në natyrë, të cilat duhet të shlyhen plotësisht para se të regjistrohej shoqëria në gjykatë.³⁷⁷

Në nenin 38 paragrafi i dytë i ligjit për shoqëritë tregtare të vitit 1992, kishte dhe një parashikim, i cili krijonte një konfuzion në mënyrën e ndarjes së kapitalit të SHPK-së, duke i dhënë karakteristikat e ndarjes së kapitalit në aksione njësoj si të shoqëritë aksionare.³⁷⁸

iii) Transferimi i pjesëve të kapitalit

Në ligjin për shoqëritë tregtare të vitit 1992 parashikohej si kusht vlefshmërie që transferimi i pjesëve të kapitalit në një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar duhet të bëhet me akt noterial.³⁷⁹ Si rrjedhim, në çdo rast të transferimit të kapitalit nga një ortak te një

³⁷⁴ Po aty.

³⁷⁵ Thomas Bachner, Edmund-Philipp Schuster dhe Martin Winner (n 203) fq. 59 - 60.

³⁷⁶ Për më shumë shih Kreun 3.1.2. Kodi Tregtar i vitit 1932 në këtë punim.

³⁷⁷ Sipas nenit 40/1 të Ligji 7638/1992 "Për shoqëritë tregtare" [1992] FZ 8 (shfuqizuar):

"Të gjitha pjesët e kapitalit themeltar duhet të nënshkruhen në tërësinë e tyre nga ortakët dhe të shlyhen krejtësisht, si për rastet kur përfaqësojnë kontribute në natyrë, ashtu edhe për kontributet në para. Ato nuk përfaqësojnë kontribute në shërbime"

³⁷⁸ Sipas Ligji 7638/1992 "Për shoqëritë tregtare" [1992] FZ 8 (shfuqëzuar), neni 38/2 përcaktohej që: "Ky kapital ndahet në pjesë të barabarta, vlera nominale e të cilave nuk mund të jetë më e vogël se 1000 lekë."

³⁷⁹ Shih nenin 45 të Ligji 7638/1992 "Për shoqëritë tregtare" [1992] FZ 8 (shfuqizuar) sipas të cilit:

ortak tjetër duhej që ky veprim të shoqërohej dhe me burokracitë e paraqitjes para noterit dhe kishte kostot e veta financiare. Ky detyrim u ndryshua me ligjin aktual 9901/2008, i cili nuk e kërkon si kusht të domosdoshëm formën solemne, pra mjafton që kontrata të jetë me shkrim dhe jo domosdoshmërisht para noterit.

Në nenin 49 të këtij ligji parashikohej se transferimi i pjesëve të kapitalit mes ortakëve mund të bëhej lirisht pa pasur asnjë kufizim apo kërkesë për miratimin e këtij transferimi nga organet e shoqërisë.³⁸⁰ Krejt ndryshe rregullohej transferimi i kapitalit te të tretët, për të cilët parashikohej si kusht respektimi i të drejtës së parablerjes.

iv) E drejta e parablerjes

Një nga karakteristikat dalluese të ligjit 7638/1992, përsa i përket dispozitave që rregullonin funksionimin e shoqërive me përgjegjësi të kufizuar ishte e drejta e parablerjes në rastin e transferimit të kuotave. Në nenin 47 të ligjit përcaktohej si kusht i detyrueshëm që ortakët të respektonin të drejtën e parablerjes në rast se ata do të disponojnë me shitjen e pjesës së tyre në kapitalin e shoqërisë.³⁸¹ Sipas kësaj dispozite ortakët nuk kishin lirinë e transferimit të kapitalit pa marrë më parë pëlqimin e ortakëve të tjerë. Pra nevojitej një vendim i AO (asamblesë së ortakëve), me shumicë të cilësuar për dhënien e pëlqimit. Sipas këtij ligji parashikohej që pëlqimi për transferimin e kapitalit nga një ortak te një person i tretë duhet të jepet nga ortakët që disponojnë të paktën tri të katërtat e pjesëve të kapitalit themeltar.³⁸²

E drejta e parablerjes në këtë ligj kishte karakter absolut dhe parashikohej në një dispozitë urdhëruese të ligjit, duke i dhënë ligjit epërsi mbi statutin. Çdo parashikim i ndryshëm i statutit që binte në kundërshtim me këtë dispozitë, do të konsiderohej i pavlefshëm. Gjithashtu çdo transaksion për transferimin e pjesës së kapitalit te të tretët, në rast se nuk është respektuar e drejta e parablerjes do të konsiderohej i pavlefshëm.

“Pjesët e kapitalit themeltar nuk mund të përfaqësohen nga letra me vlerë të tregtueshme. Transferimet e pjesëve të kapitalit themeltar duhet të vërtetohen me një akt noterial. Shoqëria ose të tretët duhet të respektojnë këto transferime sapo t’i bëhen të ditura asaj”

³⁸⁰ Në nenin 49 të Ligji 7638/1992 “Për shoqëritë tregtare” [1992] FZ 8 (shfuqizuar) përcaktohej se: “Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme ndërmjet ortakëve. Në rast se statuti përmban një klauzolë që kufizon transferimin, janë të zbatueshme dispozitat e nenit 47 të këtij ligji.”

³⁸¹ Në nenin 47 të Ligji 7638/1992 “Për shoqëritë tregtare” [1992] FZ 8 (shfuqizuar) përcaktohej se: “Pjesët e kapitalit themeltar mund t’u transferohen personave të tretë që nuk bëjnë pjesë në shoqëri, vetëm me miratimin e shumicës së ortakëve që përfaqësojnë të paktën tre të katërtat e pjesëve të kapitalit themeltar. Projekti i transferimit i njoftohet shoqërisë dhe secilit prej ortakëve. Në rast se shoqëria nuk ka bërë të ditur vendimin e saj brenda tre muajve nga data e njoftimit të fundit sipas paragrafit të mësipërm, miratimi i transferimit konsiderohet i dhënë. Në rast se shoqëria refuzon të japë miratimin e transferimit, ortakët, brenda tre muajve nga data e këtij refuzimi, duhet të blejnë apo të lejojnë blerjen e pjesëve të kapitalit themeltar me vlerën e përcaktuar sipas rregullave të nenit 11 të këtij ligji”.

³⁸² Po aty.

Megjithatë e drejta e parablerjes në mënyrën e parashikuar në këtë ligj kishte edhe kufizimet e saj. Ne paragrafin e tretë të nenin 47 parashikohej edhe një afat tre mujor brenda të cilit AO duhet të shprehet nëse e ka dhënë pëlqimin ose jo. Nëse Asambleja nuk shprehej brenda tre muajve, atëherë konsiderohej se ky pëlqim është dhënë dhe ortaku ishte i lirë të operojë me transferimin e kapitalit të një personi të tretë jashtë shoqërisë. Pra, në këtë dispozitë është parashikuar dhe parimi i miratimit në heshtje.

Nëse AO, me anë të vendimit, refuzonte të jepte pëlqimin për transferimin e pjesës së kapitalit, atëherë sipas këtij ligji ajo kishte një afat tremujor për të realizuar blerjen nga ortakët ekzistues, ose për të lejuar blerjen e pjesëve të kapitalit themeltar me vlerën e përcaktuar sipas rregullave të nenit 11 të këtij ligji.³⁸³

Në ligjin nr.7638/1992 për shoqëritë tregtare u bënë dhe ndryshime të tjera në dispozitat që rregullonin transferimin e kapitalit të SHPK-ve në funksion të zbatimit të legjislacionit për kthimin dhe kompensimin e pronave ish-pronarëve. Konkretisht me ligjin Nr.9787, datë 19.7.2007 “Për një shtesë në ligjin nr.7638, datë 19.11.1992 “Për shoqëritë tregtare “i ndryshuar parashikohej një përjashtim nga e drejta e parablerjes vetëm për rastet e shoqërive me përgjegjësi të kufizuar me kapital shtetëror ose me kapital të përbashkët me shtetin, në të cilat lejohej të bëhej transferimi i pjesës së kapitalit nga ortaku shtet te ortaku ish-pronar që përfiton këtë pjesë të kapitalit në përputhje me procedurat ligjore të kthimit dhe kompensimit të ish-pronarëve.³⁸⁴

v) Lënia peng e pjesës së kapitalit

Në ligjin Nr. 7638 të vitit 1992 parashikohej dhe një koncept deri diku i çuditshëm dhe jo shumë i qartë për rastin e shoqërive me përgjegjësi të kufizuar, që ishte ai i “lënies peng të pjesëve të kapitalit të saj” .

Sipas nenit 48 të këtij ligji parashikohej që shoqëria mund të lërë peng pjesë të kapitalit të saj.³⁸⁵ Kjo dispozitë ishte e paqartë në kushtet kur nuk përcaktonte se për çfarë dakordësie

³⁸³ Po aty.

³⁸⁴ Në Ligjin 9787/2007 “Për një shtesë në ligjin nr.7638, datë 19.11.1992 “Për shoqëritë tregtare” të ndryshuar [2007] FZ 103, neni 1 parashikohej ky ndryshim:

“Në fund të nenit 47 të ligjit nr.7638, datë 19.11.1992 “Për shoqëritë tregtare”, të ndryshuar, shtohet një paragraf me këtë përmbajtje:

“Përjashtimisht këtij rregulli, në shoqëritë me kapital të përbashkët, për kapitalin shtetëror, që i përgjigjet pasurive të paluajtshme të shoqërisë, që i janë njohur ose kthyer ish-pronarëve, sipas legjislacionit në fuqi, ortaku shtetëror zëvendësohet nga ish-pronari në të drejtat e tij mbi pjesën takuese të këtij kapitali. Transferimi i pjesëve të kapitalit në favor të ish-pronarit, i cili zëvendëson shtetin në të drejtat e tij mbi këtë pjesë kapitali, bëhet me akt noterial, sipas procedurave të parashikuara në ligj.”

³⁸⁵ Neni 48 I Ligji 7638/1992 “Për shoqëritë tregtare” [1992] FZ 8 (shfuqizuar) përcaktonte që:

të mëparshme i referohej me mundësinë për të disponuar me lënien peng. Pavarësisht parashikimit në paragrafin e parë të këtij neni “... *kur bie dakord*” sipas të cilit kërkohet një dakordësi për një vendim të tillë, kjo dispozitë mbetet e pazbatueshme pasi pjesët e kapitalit janë të drejta pasurore që gëzohen nga ortakët e shoqërisë dhe një veprim i tillë vjen në kundërshtim me tagrat e pronësisë dhe me parashikimet e dispozitave të Kodit Civil për pengun si mjet sigurimi të detyrimeve.³⁸⁶ Edhe nëse do të kishte një dakordësi të ortakëve për të lënë si peng pjesët që disponojnë në kapitalin të shoqërisë tregtare, atëherë do të kishim ortakët në cilësinë e penglënësit dhe jo shoqërinë. Ndërkohë sipas nenit 64 paragrafi i fundit të këtij ligji parashikohej që shoqëria nuk mund të blejë kapitalet e veta.³⁸⁷ Si rrjedhim të gjitha pjesët e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar disponohen nga ortakët e saj dhe jo nga shoqëria.

vi) Praktikë Gjyqësore

Në praktikën Gjyqësore Shqiptare është konsoliduar qëndrimi që kuota apo pjesa e kapitalit në shoqërinë me përgjegjësi të kufizuar duhet të futet në kategorinë e sendeve sipas përkufizimit të bërë në nenin 141 të K.Civil.³⁸⁸

Për shembull, Gjykata e Lartë e R. Sh. në Vendimin e saj Nr. 11112-02188-00-2011 Regj Themeltar Nr. 00-2012-2043 i Vendimit (340) dt. 26.06.2012 të Kolegjit Civil të saj, në çështjen juridike të ngritur nëse mund t’i nënshtrohen pjesëtimit gjyqësor pjesët e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar apo jo, ka arritur në përfundimin se kontributi i ortakëve në shoqërinë tregtare futet në kategorinë e sendeve dhe si rrjedhim dhe pjesët në kapitalin themeltar të shoqërisë mund t’i nënshtrohen pjesëtimit mes bashkëpronarëve. Në të njëjtin qëndrim kishin arritur dhe dy gjykatat e tjera me vendimet përkatëse për të cilat

“Shoqëria ka të drejtë, kur bie dakord të lërë peng pjesë të kapitalit të saj themeltar.

Në rast shitjeje të detyruar të pjesëve të lëna peng, pengmarrësi do të pranohet si person që i transferohen pjesët e kapitalit, me përjashtim të rastit kur shoqëria preferon t’i riblejë pjesët pa vonesë, me qëllim që eventualisht të zvogëlojë kapitalin e saj themeltar.”

³⁸⁶ Sipas nenit 547 të Kodit Civil përcaktohet se:

“Kontrata e pengut duhet të bëhet me shkresë ose te noteri, ndryshe është e pavlefshme. Ajo duhet të përfshijë gjithashtu një përshkrim të pronës së lënë peng. Në rastin e pengut të pjesëve, pengu duhet të regjistrohet në librin e anëtarëve të shoqërisë. Në rastin e pengut të aksioneve, pengu duhet të regjistrohet në librin e aksionarëve, në aksionet e lëna peng. Mund të lihet peng e gjitha ose një pjesë e pronave të përdorura në një ndërmarrje që vepron si një koncern veprues. Në një rast të tillë pengu është efektiv kur pronat i besohen një pale të tretë ose një kreditori, i cili nga ana e tij, do t’i menazhojë ato si një koncern veprues i pandashëm.”

³⁸⁷ Neni 64 paragrafi 4 i Ligji 7638/1992 “Për shoqëritë tregtare” [1992] FZ 8 (shfuqizuar) parashikonte që: *“Ndalohet blerja e pjesëve të kapitalit themeltar nga vetë shoqëria. Megjithatë, asambleja që vendos zvogëlimin e kapitalit që nuk motivohet nga humbjet, ka të drejtë të autorizojë administratorin për të blerë një numër të caktuar pjesësh, për t’i anuluar si pjesë të kapitalit themeltar.”*

³⁸⁸ Sipas nenit 141 të K.Civil përcaktohet se: *“Send është çdo gjë që mund të përbëjë objekt pronësie ose i të drejtës tjetër reale”.*

është ushtruar rekursi; Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë me vendimin 15025/4897 dt. 04.04.2011, dhe Gjykata e Apelit me vendimin e dt. 12.07.2011.

Gjithashtu, kjo çështje është gjykuar edhe nga Gjykata Kushtetuese, e cila me Vendimin nr. 22 datë 08.02.2013, është shprehur se:

“11. Në lidhje me pretendimin se gjykimi i pjesëtimit ka cenuar lirinë e ushtrimit të veprimtarisë ekonomike, duke ndërlyrë në ndarjen e kuotave që tashmë ishin të ndara, Kolegji vlerëson se është kontradiktor dhe i pabazuar. Nga njëra anë pranohet nga vetë kërkuesi dhe pohohet se kuotat kanë qenë të ndara, nga ana tjetër kundërshtohet ndarja e kuotave për efekt të pjesëtimit gjyqësor. Lejimi i pjesëtimit të një pasurie, që përfshin, si sende të paluajtshme, ashtu dhe të luajtshme (tituj pronësie-kuotat e shoqërisë), nuk presupozon se personi juridik në vetvete do të prishet dhe nuk do të ekzistojë më. Në rastin konkret kemi dy shoqëri me përgjegjësi të kufizuara, të cilat janë në pronësi të barabartë të të dy palëve ndërgjyqëse dhe është propozuar, nga njëra palë, që secili prej tyre të mbajë njërin shoqëri. Pjesëtimi gjyqësor nuk presupozon prishje të shoqërive, si persona juridikë, pasi këta të fundit do të kenë po ato të drejta dhe detyrime siç kanë pasur më parë, me ndryshimin se do të jenë me një ortak të vetëm. Pra, nuk ka cenim të ushtrimit të veprimtarisë ekonomike.”³⁸⁹

Gjykata Kushtetuese në këtë vendim të saj i konsideron kuotat e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar si tituj pronësie mbi sende të luajtshme.

Gjithashtu, edhe studiues të tjerë dhe profesorë të së drejtës tregtare,³⁹⁰ kanë arritur në konkluzionin se kuota e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar duhet të trajtohet si një titull pronësie mbi pjesën e kapitalit të ortakut, në mënyrë të ngjashme me aksionin në këtë aspekt, pavarësisht se nuk janë letra me vlerë. Edhe sipas studiuesit Andrea Nathanili, edhe letrat me vlerë janë sende të një natyre të veçantë.³⁹¹

Gëzimi i nje pjese kapitali në një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar është një e drejtë pasurore e njëjtë si e drejta e pronësisë. Në doktrinën e të drejtës tregtare dhe civile pjesët e kapitalit konsiderohen sende të luajtshme të patrupëzuara. Kështu ortakut që disponon një pjesë të kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar gëzon dhe të drejtat e pronarit mbi këtë pjesë, në kuptimin e tagrave të pronësisë, përfshirë dhe disponimin e pjesës së kapitalit në shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar.³⁹² Gjithashtu dhe të drejtat që të jep kuota në shoqëri, (e thënë ndryshe, pjesëmarrja në kapitalin e saj), që janë të drejtat e votës në asamble, të dividendit, apo e drejta për disponimin kësaj kuote janë të drejta ekskluzive të ortakut, njësoj si tagrat e pronësisë së pronarit mbi sendin që ka në pronësi.

³⁸⁹ Vendimi nr. 22 datë 08.02.2013 të Gjykatës Kushtetuese të R.SH, para 11.

³⁹⁰ Argita Malltezi, Jonida Rystemaj dhe Armela Kromiçi, *Gjykatat Shqiptare mbi shoqëritë dhe veprimtarinë Tregtare* (nr. 364) fq. 46.

³⁹¹ Andrea Nathanili, *E drejta Civile në Republikën Popullore të Shqipërisë - Pjesa e përgjithshme* (Kurs leksionesh 1974) fq. 18.

³⁹² Argita Malltezi, Jonida Rystemaj dhe Armela Kromiçi, *Gjykatat Shqiptare mbi shoqëritë dhe veprimtarinë Tregtare* (nr. 364) fq. 47.

Sipas këtij parashikimi, të nenit 48, ligji i vitit 1992 “Për shoqëritë tregtare” i jepte mundësi shoqërisë, të dispononte pjesët e kapitalit që zotërohen nga ortakët e shoqërisë, duke krijuar kështu një konfuzion mes drejtave të ortakut në shoqëri dhe përgjegjësive apo kompetencave të organeve administruese të saj³⁹³ Dhe marrëveshja midis palëve sipas kësaj dispozite, nënkupton që palë në këtë marrëveshje duhet të jetë edhe pronari i sendit apo i së drejtës.

Referuar përkufizimit të pengut, e drejta për të lënë peng një send, një titull apo një të drejtë i takon vetëm pronarit të sendit, titullit apo të drejtës.³⁹⁴ Por, sipas nenit 48 të ligjit Nr. 7638 të vitit 1992 “Për shoqëritë tregtare”, ky parim do të përmysej dhe organet administruese të shoqërisë mund të dispononin pjesët e kapitalit që u takonin ortakëve të shoqërisë. Ky është një koncept, i cili u hoq në reformën e vitit 2008 me miratimin e ligjit aktual 9901/2008.

Në ligjin.7638/1992 “Për shoqëritë tregtare”, ndryshe nga ligji aktual nuk përfshiheshin konceptet e përjashtimit të ortakut apo largimit (tërheqjes) së ortakut, koncepte këto që parashikoheshin edhe në legjislacionin tregtar të Monarkisë Shqiptare, konkretisht në Kodin Tregtar të vitit 1932.

Gjykata e Lartë e mbledhur në Kolegje të bashkuara me Vendimin Unifikues Nr. 39 dt. 30.05.2002,³⁹⁵ ka njësuar praktikën gjyqësore përsa i përket interpretimit të ndryshëm të neneve 46 dhe 47 të Ligjit Nr.7638, datë 19.11.1992 “Për shoqëritë tregtare”. Ky vendim konfirmon qëndrimin që një ortak i SHPK-së nuk mund të përjashtohet në bazë të ligjit 7638/1992.

Sipas kësaj praktike gjyqësore rrethanat e faktit rezultojnë si më poshtë:

Rrethanat e faktit. Në bazë të akteve të themelimit të shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar, me emrin “*****” sh.p.k., me seli në qytetin e Korçës, paditësi “*****”³⁹⁶ është një nga të njëmbëdhjetë ortakët themelues të kësaj shoqërie, me kontribut të barabartë me dhjetë ortakët e tjerë në kapitalin shoqërisë, konkretisht në masën e saj 1/11 pjesë të tij.

³⁹³ Ligji 7638/1992 “Për shoqëritë tregtare” [1992] FZ 8 (shfuqizuar), neni 48.

³⁹⁴ Kodit Civil në nenin 546/1 të bëhet përkufizimi i pengut, sipas kësaj dispozite;

“Peng u vihet mbi një pasuri të luajtshme, mbi një të drejtë ndaj prurësit, ose me urdhër, ose mbi uzufuktin e kësaj pasurie ose të drejte. Pengu krijohet duke vendosur pasurinë ose titullin në posedim të kreditorit ose të një të treti të caktuar me marrëveshje midis palëve”.

³⁹⁵ Shih Vendimin Unifikues të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë nr. 39 dt. 30.05.2002. http://www.gjykataelarte.gov.al/web/nr_39_dt_30_05_2002_c_77.doc.

³⁹⁶ Të dhënat personale janë anonimizuar në respekt të ligjit 9887/2008 “Për Mbrojtjen e të dhënave personale” [2008] FZ 44 i ndryshuar për herë të fundit me ligjin 120/2014 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9887, datë 10.3.2008, “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” [2014] FZ 160.

Sipas vendimit nr.1, datë 03.11.1994, mbledhja e asamblesë së ortakëve të Shoqërisë “*****” sh.p.k., duke e konsideruar ortakun “XY” fajtor për shkelje të rënda dhe të përsëritura të procesit teknologjik për prodhimin e birrës, gjatë administrimit si administrator, me detyrën e kimistit teknolog, mori vendim që ai të zhdëmtonte dëmin e shkaktuar nga prodhimi i birrës jashtë standardit, duke e shlyer atë nëpërmjet mbajtjes së një milion lekëve, që ishte masa e kontributit fillestar të tij në krijimin e kapitalit themeltar të shoqërisë. Sipas këtij vendimi të Asamblesë, ajo shprehet dhe se “duke mbetur pa kontribut, paditësi përjashtohet nga shoqëria.” Pra, Asambleja e ortakëve, me këtë vendim ka përjashtuar ortakun “****” nga shoqëria duke i hequr atij cilësinë e ortakut duke e bazuar në nenet 14, 17, dhe 22 të Statutit të shoqërisë dhe nenet 53, 55 e 59, të Ligjit nr.7638, datë 19.11.1992 “Për shoqëritë tregtare”.

Vendimin e mësipërm të Mbledhjes së Asamblesë së Ortakëve, paditësi e kundërshtoi, duke kërkuar, gjyqësisht, konstatimin e pavlefshmërisë së tij, me pretendimin se ai nuk ishte emëruar administrator i shoqërisë tregtare “*****” sh.p.k., si dhe duke pretenduar se, shuma prej 1 milion lekë që ishte kontribut i tij në kapital, i është mbajtur në kundërshtim me dispozitat e ligjit “Për shoqëritë tregtare”, kështu që nuk mund të përjashtohet si ortak i kësaj shoqërie, pa dhënë pëlqimin e tij.

Gjykata e Rrethit Korçë, me vendimin nr.3268, datë 26.12.1995,³⁹⁷ ka vendosur rrëzimin e padisë si të pabazuar në ligj e në prova duke e konsideruar të vlefshëm vendimin e Asamblesë së Ortakëve që kishte vendosur përjashtimin e tij si ortak. Ky vendim u la në fuqi edhe nga Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin e saj nr.1637, datë 18.06.1997.³⁹⁸

Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, arritën në përfundimin se të dyja këto vendime janë marrë në kundërshtim me ligjin dhe provat e administruara gjatë gjykimit të çështjes dhe për rrjedhojë, duhet të ndryshohen. Me qëllim njohjen sa më qartë me interpretimet jurisprudenciale të Gjykatës së Lartë të kohës, më poshtë pasqyrohen citime nga Vendimi Unifikues Nr 39 dt. 30. 05. 2002, ku gjykata shprehet se:³⁹⁹

³⁹⁷ Vendimi Nr. 3268, datë 26.12.1995 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë

³⁹⁸ Vendimi Nr. 1637, datë 18.06.1997 i Gjykatës së Apelit Tiranë.

³⁹⁹ Vendimi Unifikues Nr. 39 dt. 30.05.2002 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, në arsyetimin e të cilit shprehet se:

“Në këtë përfundim u arrit pasi, nga përmbajtja e dispozitave të kreut IV të Ligjit nr. 7968, datë 19.11.1992 “Për shoqëritë tregtare”, të cilat rregullojnë mënyrën e krijimit, formimin e kapitalit themeltar, pozicionin e ortakëve, marrëdhëniet midis tyre, organet drejtuese dhe modalitetet e tjera të funksionimit të shoqërive me përgjegjësi të kufizuar, rezulton që ortaku (kur janë më shumë se një) i një shoqërie të kësaj forme (sh.p.k.) nuk mund të përjashtohet nga të qenët ortak, pra, nga ortakëria, për asnjë veprimtari të ushtruar prej tij në këtë shoqëri, pavarësisht nga natyra dhe pasojat që mund t’i vijnë shoqërisë nga kjo veprimtari.

Pas plotësimit me korrektësi të detyrimeve që rrjedhin nga Akti i Themelimit (kontrata) dhe statuti i shoqërisë që është pjesë e pandarë përbërëse e tij, sikurse janë nënshkrimi dhe shlyerja e pjesëve

*“Mbarimi i mandatit nominal i një ortaku të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar, përveç vdekjes së tij, vërtetohet në praktikë në njërin prej rasteve që parashikohen në dispozitat e neneve 46 (Transferimi i pjesëve të kapitalit themeltar me trashëgim ose brenda familjes), 47 (transferimi te të tretët) dhe 49 (Transferimi ndërmjet ortakëve) të Ligjit nr.7638, datë 19.11.1992 “Për shoqëritë tregtare, rrethana keto që, sikurse rezulton nga aktet që janë administruar gjatë gjykimit të çështjes, nuk kanë ekzistuar në rastin e marrjes së vendimit nr.1, datë 03.11.1994, të mbledhjes së Asamblesë së Ortakëve të shoqërisë tregtare “*****”-sh.p.k.”.⁴⁰⁰*

Siç konstatohet edhe nga ky vendim Unifikues i Gjykatës së Lartë, zbatimi i parimeve të përgjegjësisë së kufizuar të ortakut ka pasur paqartësi dhe keqkuptime në praktikën gjyqësore të gjykatave shqiptare.

Po ashtu, ligji i kohës Nr.7638/1992 nuk ka parashikuar konceptin e përjashtimit të ortakut. Për pasojë nuk kishte asnjë hapësirë ligjore për përjashtimin e ortakut, edhe në rast se AO kishte pretendime për dëme të ndryshme të shkaktuara shoqërisë nga ortaku. Ky koncept do të përfshihej në ligjin e vitit 2008.

të kapitalit themeltar (neni 40 i Ligjit nr.7638, date 19.1.1992), ofrimi efektiv i kontributeve (kur ndodhemi para rastit të krijimit të kapitalit themeltar me kontribute në natyrë, neni 42 i Ligjit të përmendur) dhe respektimi i formaliteteve të regjistrimit që kërkohen nga Ligji 7667, datë 28.01.1993 “Për regjistrin tregtar dhe formalitetet që duhen respektuar nga shoqëritë tregtare”, secili prej ortakëve të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar, gëzon të gjitha të drejtat që burojnë nga fakti i të qenit ortak i saj, natyrisht, në masën e përcaktuar nga ligji, masë, e cila kushtëzohet nga vlera konkrete e pjesëmarrjes së tij në kapitalin e shoqërisë, e cila, aritmetikisht, llogaritet në përqindje.

Të vetmet detyrime ligjore të ortakut të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar janë, së pari ato që rrjedhin në rast se, në fund të vitit ekonomiko-financiar, shoqëria rezulton me humbje, humbje, që edhe këto sipas përmbajtjes së paragrafit të parë të nenit 37 të Ligjit 7638, datë 19.11.1992, përballohen vetëm në kufirin e vlerës së kontributit të tij në kapitalin themeltar dhe së dyti, detyrimi për të pranuar çdo vendim të asamblesë së ortakëve me rastin e zëvendësimit të kapitalit, me kusht që, ashtu sikurse përcaktohet në paragrafin e parë të nenit 64 të Ligjit të përmendur, zvogëlimi i kapitalit t’i prekë të gjithë ortakët e një shoqërie në të njëjtën masë që ata përfaqësojnë në pjesët (kuotat) takuese të kapitalit të kësaj shoqërie.

*Mbarimi i mandatit nominal i një ortaku të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar, përveç vdekjes së tij, vërtetohet në praktikë në njërin prej rasteve që parashikohen në dispozitat e neneve 46 (transferimi te të tretët) dhe 49 (transferimi ndërmjet ortakëve) të Ligjit nr. 7638, datë 19.11.1992 « Për shoqëritë tregtare », rrethana këto që, sikurse rezulton nga aktet që janë administruar gjatë gjykimit të çështjes, nuk kanë ekzistuar në rastin e marrjes së vendimit nr. 1, datë 03.11.1994, të mbledhjes së Asamblesë së Ortakëve të shoqërisë tregtare “*****”-sh.p.k.*

*Përveç kësaj, gjatë shqyrtimit të akteve që ndodhen në dosje, ndryshe nga ç’thuhet në vendimin e përmendur të asamblesë së ortakëve, paditësi nuk figuron të ketë qenë emëruar as administrator i saj, as i punësuar si teknolog në këtë shoqëri. Përkundrazi, sipas nenit 22 të Statusit të Shoqërisë Tregtare “*****”-sh.p.k., i punësuar ishte caktuar i ati i paditësit, i quajtur «**», veprimet e të cilit mund të kenë qenë shkaku i prodhimit të birrës jashtë standardit që mund të ketë sjellë dëmin ekonomik të pretenduar nga ortakët pjesëmarrës në mbledhjen e datës 03.11.1994.*

Por, edhe sikur të qëndronte pretendimi i ortakëve pjesëmarrës në këtë mbledhje sipas përmbajtjes së dispozitës së nenit 53 të Ligjit nr. 7638, datë 19.11.1992 « Për shoqëritë tregtare », ata legjitimoheshin të kërkonin zhdëmtim për dëmin e shkaktuar me padi për shlyerjen e dëmit. »

⁴⁰⁰ Vendimi Unifikues Nr. 39 dt. 30.05.2002 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

vii) Administrimi

Përsa i përket administrimit të SHPK-ve, në pjesën më të madhe të parashikimeve, ligji 7638/1992 “Për shoqëritë tregtare” paraqet ngjashmëri me ligjin aktual. Këto shoqëri, mund të administroheshin nga një ose më shumë persona fizikë. Këta mund të ishin dhe ortakët e shoqërisë ose persona jashtë rrethit të ortakëve.

Gjithashtu, edhe ky ligj kishte parashikimet për përgjegjësinë e administratorëve në rast se administratori i shkakton dëm me faj shoqërisë⁴⁰¹. Në nenin 51 dhe 52 të Ligjit kishte parashikime që synonin të shmangnin konfliktin e interesit të administratorëve dhe ortakëve me shoqërinë me përgjegjësi të kufizuar.

Në nenin 52 parashikoheshin si “marrëveshje të ndaluara” veprime të cilat konsideroheshin absolutisht të pavlefshme.⁴⁰² Të tilla konsideroheshin ato kontrata të lidhura mes administratorit, apo ortakëve të shoqërisë, dhe vetë shoqërisë. Këto parashikime u ndryshuan me ligjin aktual 9901/2008, duke bërë një rregullim të ndryshëm. Ligji i ri, në nenin 16 të tij, ka parashikuar konceptin e zhveshjes së ortakut apo administratorit nga përgjegjësia e kufizuar, në rast se provohet që ka kryer veprime abuzive.

Në nenin 50 të këtij ligji parashikohej një rregullim i ndryshëm përsa i përket afatit të qëndrimit në detyrë të administratorit.⁴⁰³ Sipas kësaj dispozite, parashikohej që statuti mund të vendosë një afat për qëndrimin në detyrë të administratorit. Por, në rast se në statutin e shoqërisë nuk janë parashikuar afate për kohëzgjatjen e qëndrimit në detyrë të administratorit, atëherë ai konsiderohet si i emëruar në këtë detyrë pa afat, për të gjithë periudhën e kohëzgjatjes së shoqërisë. Në ligjin 9901/2008 u ndryshua ky rregull, duke caktuar administratorit një afat pesëvjeçar të kohëzgjatjes në detyrë, me të drejtë riemërimi.⁴⁰⁴

⁴⁰¹ Ligji 7638/1992 “Për shoqëritë tregtare” [1992] FZ 8 (shfuqëzuar), nenin 53.

⁴⁰² Sipas nenit 52 të Ligjit 7638/1992 “Për shoqëritë tregtare” [1992] FZ 8 (shfuqëzuar):

“Administratorëve ose ortakëve që nuk janë persona juridikë nuk u lejohet të kontraktojnë në çfarëdoq formë qoftë, të marrin hua të shoqëria, të japin pëlqimin në emër të saj, për paradhënien si dhe të bëhen dorëzënës apo të garantojnë në emër të saj angazhimet ndaj të tretëve. Në rast të kundërt kontrata është e pavlefshme. Kjo masë ndaluese zbatohet edhe ndaj përfaqësuesve ligjorë të ortakëve që janë persona juridikë. Kjo masë zbatohet gjithashtu ndaj bashkëshortëve, pasardhësve dhe pasardhësve të personave të cituar në paragrafin e parë të këtij neni, si dhe ndaj çdo personi ndërmjetës”.

⁴⁰³ Sipas nenit 50 të Ligjit 7638/1992 “Për shoqëritë tregtare” [1992] FZ 8 (shfuqëzuar):

“Shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar administrohen nga një ose disa persona fizikë. Administratorët mund të zgjidhen jashtë bashkësisë së ortakëve. Ata emërohen me vendim të ortakëve që përfaqësojnë më tepër se gjysmën e pjesëve të kapitalit themeltar. Në mungesë të dispozitave përkatëse në statut, ata janë të emëruar për tërë periudhën e ekzistencës së shoqërisë.”

⁴⁰⁴ Në nenin 95/1 të Ligjit Ligji 9901/2008 përcaktohet se:

“Asambleja e përgjithshme emëron një ose më shumë persona fizikë si administratorë të shoqërisë. Afati i emërimit, i cili caktohet në statut, nuk mund të jetë më i gjatë se 5 vjet, me të drejtë

Në nenin 55 Ligjit Nr.7638/1992, parashikohej dhe e drejta e administratorit për dëmshpërblim financiar, në rast se shkarkimi i tij nga detyra bëhet i padrejtë.⁴⁰⁵ Në praktikën gjyqësore ka pasur qëndrime të ndryshme përse i përket marrëdhënies së krijuar mes administratorit dhe shoqërisë tregtare. Ndryshimi qëndron në faktin se në një pjesë të praktikës gjyqësore, kjo marrëdhënie është konsideruar si një marrëdhënie pune. Për pasojë, për këtë kategori juristësh, (gjyqtarë, avokatë etj.) edhe konfliktet e lindura mes administratorit dhe shoqërisë në rast shkarkimi të tij nga detyra, janë trajtuar si konflikte pune duke iu referuar dispozitave të Kodit të Punës. Pra, sipas kësaj pjese të praktikës gjyqësore administratori është konsideruar si i punësuar në shoqëri, dhe vetë shoqëria si punëdhënëse. Si ilustrim mund të përmendim; Vendimi Nr. 415 dt 17.02.2015 i Gjykatës së Apelit Tiranë,⁴⁰⁶ Vendimi Nr. 4271, datë 25.05.2015 Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.⁴⁰⁷

Ndërsa, në një pjesë tjetër të praktikës gjyqësore, marrëdhënia mes administratorit dhe shoqërisë është konsideruar si një kontratë e posaçme shërbimi, për të cilën nuk duhet të zbatohen dispozitat e Kodit të Punës, por dispozitat e Kodit Civil për kontratat. Si ilustrim mund të përmendim; Vendimi Nr. 5904, datë 16.05.2014 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë,⁴⁰⁸ Vendimi Nr.229 dt 03.02.2017 i Gjykatës së Apelit Tiranë⁴⁰⁹. Një analizë më të detajuar të këtij raporti mes shoqërisë dhe administratorit kemi bërë në kapitullin V pika 2.⁴¹⁰

viii) Emërimi i ekspertit kontabël të autorizuar

Në kuadër të disiplinimit financiar të shoqërive me përgjegjësi të kufizuar ligji Nr.7638/1992 bënte një rregullim të qartë dhe me karakter detyrues, përse i përket faktit

ripërtëritjeje. Emërimi i administratorëve prodhon efekte pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit. Statuti mund të vendosë rregulla të posaçëm për emërimin e administratorëve.”

⁴⁰⁵ Ligji 7638/1992 “Për shoqëritë tregtare” [1992] FZ 8 (shfuqizuar), nenin 55.

⁴⁰⁶ Shih Vendimin Nr. 415 dt 17.02.2015 i Gjykatës së Apelit Tiranë.

⁴⁰⁷ Shih Vendimin Nr. 4271, datë 25.05.2015 Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

⁴⁰⁸ Shih vendimin Vendimin Nr. 5904, datë 16.05.2014 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, Në këtë vendim gjykata argumenton ndër të tjera se:

“Gjykata, vlerëson se, ushtrimi i funksionit të administratorit në shoqërinë aksionare, nuk kryhet në kuadër të urdhrave të shoqërisë, kështu mungon elementi i vartësisë. Gjykata, vlerëson se, nga njëra anë administratori e ushtron detyrën e tij në kuadër të organizimit të shoqërisë aksionare duke qenë se është organ i shoqërisë dhe kryen atë që njihet si përfaqësimi organik i personit juridik. Nga ana tjetër, administratori nuk e ushtron veprimtarinë në kuadër të urdhrave të shoqërisë, në këto kushte mungon elementi i vartësisë, e i cili karakterizon marrëdhënien e punës dhe e dallon nga marrëdhëniet e tjera të cila disiplinohen nga ligje të ndryshme nga Kodi i Punës.”

⁴⁰⁹ Shih vendimin Vendimin Nr.229 dt 03.02.2017 të Gjykatës së Apelit Tiranë

⁴¹⁰ Shih Kreun “6.3. Marrëdhënia mes administratorit dhe ” në këtë punim.

nëse një shoqëri e tillë duhet të ketë ekspertizën e një eksperti kontabël.⁴¹¹ Në nenin 65 të ligjit rregullohej mënyra e thirrjes së ekspertit.⁴¹²

Ligji përcakton si sugjerim përfshirjen e një eksperti kontabël në ato shoqëri me xhiro relativisht të vogël vjetore, që nuk plotësojnë kriteret e përcaktuara në nenin 65 të tij. Ndërkohë, për ato shoqëri që kalonin pragun e caktuar në këtë nen, apo që kishin një numër të konsiderueshëm të punësuarish (mbi 50), si dhe kur ortakët minorancës e kërkonin, ligji përcaktonte si të detyrueshme përfshirjen e ekspertit kontabël të autorizuar, i cili si ekspert i kontabilitetit dhe financës, asistonte administratorin në aktivitetin financiar të shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar.⁴¹³

Duke pasur parasysh kohën e miratimit të ligjit Nr.7638/1992 në fillim të përpjekjeve për të instaluar një ekonomi të tregut të lirë, si dhe sfidat e jashtëzakonshme për formalizimin e ekonomisë shqipëtare, kulturën e pakët të sipërmarrësve përse i përket legjislacionit tregtar në përgjithësi por edhe atij fiskal, këto dispozita që bënin të detyrueshme përfshirjen e ekspertëve kontabël të autorizuar në veprimtarinë tregtare të shoqërive me përgjegjësi të kufizuara ishin një domosdoshmëri e kohës dhe tranzicionit shumëplanësh që e shoqëroi këtë ligj.

⁴¹¹ Ligji 7638/1992 “Për shoqëritë tregtare” [1992] FZ 8 (shfuqizuar), nenet 56-57 dhe nenet 64 – 69.

⁴¹² Shih nenin 65 të Ligji 7638/1992 “Për shoqëritë tregtare” [1992] FZ 8 (shfuqizuar), sipas të cilit:

Ortakët mund të emërojnë një apo disa ekspertë kontabël të autorizuar sipas kushteve të përcaktuara në nenin 59 të këtij ligji. Janë të detyruara të caktojnë një ekspert të tillë të paktën ato shoqëri që në mbyllje të vitit financiar tejkalojnë dy prej tri shifrave të mëposhtme:

- Bilanci në mbyllje të vitit përkatës 12 milionë lekë.

- Vlera e të ardhurave nga qarkullimi, pasi është zbritur tatimi mbi qarkullimin në mbyllje të vitit përkatës, 24 milionë lekë.

- Mesatarisht 50 të punësuar gjatë vitit financiar.

Edhe në rast se këto kushte nuk përmbushen, emërimi i një eksperti kontabël të autorizuar mund të kërkohet në rrugë gjyqësore nga një apo disa ortakë që përfaqësojnë të paktën 1/10 e kapitalit.”

⁴¹³ Po aty.

KREU IV

4. Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar si Subjekt i Pavarur i së Drejtës dhe Karakteristikat e Veçanta të saj

4.1. Llojet e shoqërive tregtare

Në kuptimin etimologjik fjala “shoqëri” në gjuhën shqipe ka një kuptim dhe spektër të gjerë përdorimi.⁴¹⁴ Aplikimi i këtij termi në legjislacionin tonë duket se është i prejardhur nga terminologjia e legjislacioneve përendimore, në të cilat mbizotëron termi “shoqëri” tregtare. Megjithatë fjala “shoqëri” i përshtatet dhe në gjuhën shqipe organizimeve tregtare të quajtura “shoqëri tregtare”, për shkak të faktit se, në shumicën e rasteve, kemi të bëjmë me një grup njerëzish, apo ortakëri të dy ose më shumë personave që njihen me njëri-tjetrin dhe vendosin me marrëveshje që të organizohen së bashku për të kryer një aktivitet tregtar.

Studiues të së drejtës tregtare kanë sqaruar se fjala “shoqëri” në gjuhën shqipe i përgjigjet fjalës “*società*” në Itali, fjalës “*société*” në Francë dhe fjalës “*Gesellschaft*”, në Gjermani. Ndërsa në gjuhën ligjore angleze, fjala “company” kryesisht përdoret në një kuptim më të ngushtë vetëm për shoqëritë e kapitalit. Pra, vetëm për shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar dhe shoqëritë aksionare, duke mos i përfshirë shoqëritë kolektive dhe ato komandite në konceptin e shoqërisë.⁴¹⁵ Në kuadër të këtij diferencimi në trajtim, sipas ligjit anglez, vetëm SHPK-të dhe SHA-të, gëzojnë statusin e personit juridik, ndërsa shoqëritë kolektive apo komandite nuk e gëzojnë këtë status.⁴¹⁶

Ligji shqiptar në fuqi për shoqëritë tregtare, u jep statusin e personit juridik të katër llojeve të shoqërive tregtare të cituara më lart dhe të përfshira në këtë ligj.⁴¹⁷ Edhe ligji i mëparshëm për shoqëritë tregtare 7638/1992, i ka dhënë të njëjtin status të personit juridik të katër llojeve të shoqërive tregtare. Në këtë aspekt, ligji aktual 9901/2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, paraqet një ngjashmëri me legjislacionin francez për shoqëritë tregtare.⁴¹⁸

Ligji Nr. 9901, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, përcakton 4 lloje të organizimit të sipërmarrjeve tregtare, të cilave u referohet me termin e përgjithshëm “shoqëri tregtare”, të cilat janë: i) Shoqëritë Kolektive; ii) Shoqëritë Komandite; iii) Shoqëritë me Përgjegjësi të Kufizuar (SHPK) dhe iv) Shoqëritë aksionare (SHA).⁴¹⁹ Sipas ligjit Nr. 9901 /2008 “Për

⁴¹⁴ Fjalor Shqip, “Shoqëri” <<http://www.fjalorshqip.com/>> aksesuar më 20 korrik 2020.

⁴¹⁵ Thomas Bachner, Edmund-Philipp Schuster dhe Martin Winner (n 203) fq 15-16

⁴¹⁶ Po aty, fq. 15-16.

⁴¹⁷ Ligji 9901/2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” i ndryshuar.

⁴¹⁸ Thomas Bachner, Edmund-Philipp Schuster dhe Martin Winner (n 203) fq. 16.

⁴¹⁹ Ligji 9901/2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” i ndryshuar, neni 1/1.

tregtarët dhe shoqëritë tregtare” i ndryshuar, këto 4 lloje organizimi janë tregtare për shkak të formës së tyre. Regjistrimi i shoqërive tregtare në Qendrën Kombëtare të Biznesit, në Regjistrin Tregtar, është kusht pa të cilin nuk do të fitonin personalitetin juridik (*condicio iuris*).⁴²⁰

Në varësi të formës së shoqërisë së zgjedhur prej vullnetit të ortakëve, të një shoqërie që është në themelim e sipër, përgjegjësia e ortakëve të shoqërisë ndaj të tretëve (në të ardhmen-gjatë aktivitetit të shoqërisë në rast mospërbushjeje të detyrimeve nga ana e shoqërisë), mund të kufizohet në kapitalin e shoqërisë, apo të përfshijë në mënyrë të pakufizuar dhe pasuritë e ortakëve.

Doktrina e së drejtës tregtare ka bërë një ndarje të këtyre shoqërive në dy kategori të mëdha.⁴²¹ Sipas këtij kategorizimi, shoqëritë kolektive dhe shoqëritë komanditë janë konsideruar si shoqëri të personit, ndërsa shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar dhe shoqëritë aksionare janë konsideruar si shoqëri kapitali.

Sipas kësaj ndarjeje doktrinare, të shoqërive tregtare, karakteristika kryesore e shoqërive të personit është fakti që te këto shoqëri paraqesin një rëndësi thelbësore cilësitë personale të ortakëve (*intuitu personae*)⁴²² në bashkëpunimin mes tyre në ushtrimin e sipërmarrjes tregtare, por dhe në përmbushjen e detyrimeve në raport me të tretët. Pra, janë pikërisht cilësitë personale të ortakut, të cilat bëjnë që të ndërtohet një raport besimi reciprok mes ortakëve, dhe të themelojnë një shoqëri kolektive ose komandite, sepse ortakët themelues besojnë që bashkëpunimi i këtyre personave në një ortakëri do të garantojë më shumë sukses në sipërmarrjen tregtare të ardhshme.

Nga ana tjetër për kreditorët e këtyre shoqërive paraqet një rëndësi shumë të madhe njohja e personave që janë ortakë të këtyre shoqërive dhe cilësitë personale të tyre në marrëdhëniet tregtare që do të krijojnë. Kreditorët e shoqërisë së personit, kanë parasysh që kredinë e tyre mund ta shlyejnë edhe duke iu drejtuar secilit prej ortakëve, pasi ata kanë përgjegjësi të pakufizuar për detyrimet e shoqërisë.

Ndërsa në shoqëritë e kapitalit, cilësitë personale të ortakëve apo aksionerëve nuk paraqesin ndonjë rëndësi të madhe.⁴²³ Kjo, pasi garancia për suksesin e këtyre shoqërive, bazohet në akumulimin e një kapitali të konsiderueshëm në nisje të aktivitetit të tyre dhe mirëadministrimin e këtyre shoqërive, në përputhje me parimet e mirëqeverisjes së

⁴²⁰ Sipas Iset Morina (editor), *Fjalori Juridik* (Akademia e Drejtësisë së Kosovës 2019) *Condicio iuris* – nënkupton një kusht të imponuar nga ligji për vlefshmërinë e një transaksioni juridik. Fq. 26.

⁴²¹ Galgano (n 200) fq. 231 e në vijim.

⁴²² Nënkupton rastin kur për shkak të cilësive personale të personit që është palë në një kontratë, kjo palë nuk mund të zëvendësohet me një person tjetër.

⁴²³ Galgano (n 200) fq. 391 e në vijim.

korporatave.⁴²⁴ Në kushtet kur ortakët (apo aksionerët) e këtyre shoqërive tregtare kanë përgjegjësi të kufizuar financiare, vetëm për të shlyer kontributin në kapitalin e shoqërisë dhe jo më tepër, edhe kreditorët e këtyre shoqërive tregtare kanë si garanci për rikuperimin e kredive të tyre kapitalet dhe asetet financiare të shoqërisë dhe jo të personave që janë ortakë të shoqërisë. Për këtë arsye këto shoqëri janë konsideruar si shoqëri kapitali dhe jo shoqëri personi.

Në kuadër të këtij punimi shkencor do të analizojmë në mënyrë të veçantë vetëm njërin prej katër llojeve të shoqërive tregtare të parashikuara në ligjin shqiptar dhe konkretisht "Shoqërinë me përgjegjësi të kufizuar". Megjithatë në vazhdim do të ndalojmë edhe në analizimin veçorive kryesore të kësaj shoqërie në raport me tri llojet e tjera të shoqërive tregtare.

4.2. Personaliteti juridik i veçantë i shoqërive tregtare

Karakteristika më thelbësore e të gjitha shoqërive tregtare në përgjithësi, përfshirë dhe SHPK-të, është personaliteti juridik i veçantë i tyre. Ky personalitet juridik i shoqërisë është i pavarur nga personaliteti juridik i ortakëve, apo i administratorit si individ. Ky është një tipar karakteristik, veçanërisht për shoqëritë e kapitalit, siç janë shoqëria me përgjegjësi të kufizuar dhe shoqëria aksionare.

Shoqëritë tregtare janë konsideruar si entitete artificiale të infrastrukturës ligjore, të cilat themelohen me qëllim realizimin e fitimeve pasurore të ortakëve apo aksionerëve të tyre. Por, nga momenti kur një shoqëri themelohet, ajo gëzon zotësi të pavarur për të vepruar dhe nuk duhet të konfundohet me identitetin e ortakëve të saj. Kjo bën të mundur që shoqëria tregtare të njihet si person juridik i veçantë, pra si entitet juridik më vete, e dallueshme nga ortakët ose aksionerët e saj. Një nga përfitimet e këtij fakti është dhe përgjegjësia e kufizuar e ortakëve për detyrimet e shoqërisë, si dhe fakti që vetë shoqëria nuk mban përgjegjësi për detyrimet personale të ortakëve.⁴²⁵

Në Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë,⁴²⁶ në kreun e dytë përcaktohen personat juridikë si një kategori e subjekteve të së drejtës civile. Ndërsa kategoria tjetër e subjekteve të së drejtës civile janë personat fizikë, siç përcaktohet nga neni 1 e vijues i Kodit Civil.⁴²⁷

⁴²⁴ OECD, "Kodin Etik të Qeverisjes së Korporatave dhe Parimet e mirëqeverisjes së korporatave të OECD" <<http://www.oecd.org/corporate/principles-corporate-governance/> marrë online datë 17.12.2020> aksesuar më 19 shtator 2020; Drejtoria e Politikave të Konkurrueshmërisë së Ekonomisë, "Kodi i Drejtimit të Brendshëm të Shoqërive Tregtare në Shqipëri" <https://www.bkt.com.al/assets/uploads/documents/kodi_i_qeverisjes_se_korporatave_al.pdf> aksesuar më 19 shtator 2020.

⁴²⁵ Thoma A Humphreys, *Limited Liability Companies* (Law Journal Press 2003) fq. 2-13.

⁴²⁶ Kodi Civil, neni 24.

⁴²⁷ Kodi Civil, neni 1 e vijues.

Në kategorinë e subjekteve të së drejtës që janë persona juridikë, përfshihen dy nënkatëgori të mëdha, që janë "*personat juridikë publikë*" dhe "*personat juridikë privatë*"⁴²⁸

Persona juridikë publikë janë institucionet që financohen vetë ose nga buxheti i shtetit, si dhe entet e tjera publike të njohura nga ligji si person juridik⁴²⁹. Ndërsa me persona juridikë privatë sipas Kodit Civil, kuptojmë shoqëritë, shoqatat, fondacionet dhe entet e tjera me karakter privat, të cilat e fitojnë personalitetin juridik në mënyrën e caktuar nga ligji.⁴³⁰

Me fjalën "shoqëritë" duhet të kuptojmë shoqëritë tregtare që rregullohen me ligj të veçantë që është Ligji Nr.9901 dt. 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" i ndryshuar. Një nga katër llojet e shoqërive tregtare është dhe Shoqëria me Përgjegjesi të Kufizuar (SHPK), e cila është dhe lloji absolutisht më i përhapur i tyre.

Në e doktrinën e të drejtës civile ekzistojnë disa teori, të cilat, mbi bazën e kriterëve të ndryshme, përpiqen të bëjnë kategorizimin dhe ndarjen e personave juridikë publikë nga personat juridikë privatë.⁴³¹ Teoria mbizotëruese në fushën e doktrinës civile për dallimin mes personit juridik publik dhe personit juridik privat mbështetet te kriteri që personi juridik publik është mbajtës i të drejtave të sovranitetit të shtetit, pra i pushtetit publik urdhërdhënës (*podesta d'imperium*).⁴³² Ndërsa personat juridikë privatë - ku futen dhe shoqëritë tregtare - personi juridik karakterizohet nga tri elemente si: uniteti organizativ, pavaresia pasurore dhe përgjegjësia e pavarur pasurore e tij.⁴³³

Në legjislacionin shqiptar është i konsoliduar qëndrimi juridik se shoqëritë tregtare janë subjekte të pavarura të së drejtës. Një përcaktim të tillë e gjejmë në një spektër të gjerë të legjislacionit civil në përgjithësi, por dhe të atij tregtar në veçanti. Mjafton të kujtojmë dispozitat të Kodit Civil,⁴³⁴ dispozitat e ligjit të posaçëm Nr.9901 dt. 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" i ndryshuar, legjislacionit për regjistrimin në Qendrën Kombëtare të Biznesit, apo legjislacionit fiskal, etj. Në paragrafin tre të nenit 3 të ligjit 9901/2008 përcaktohet se:

"Shoqëritë tregtare fitojnë personalitetin juridik në datën kur kryhet regjistrimi i tyre në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit. Shoqëritë përgjigjen me të gjitha aktivet e tyre për detyrimet, që rrjedhin nga veprimtaritë e ushtruara".⁴³⁵

⁴²⁸ Kodi Civil, neni 1 e vijues dhe neni 24 e vijues.

⁴²⁹ Kodi Civil, neni 25.

⁴³⁰ Kodi Civil, neni 26.

⁴³¹ Ardian Nuni, *E drejta Civile, Pjesa e përgjithëshme* (Tiranë 2012) fq.138-146 .

⁴³² Për një trajtim më të hollësishëm doktrinor shih: Francesco Ferrara, *Le Persone giuridiche* (UTET Torino 1938) dhe Francesco Jr Ferrara, *La-teoria-giuridica-dell-azienda* (Giuffrè 1982).

⁴³³ Nuni (n 431) fq. 138.

⁴³⁴ Kodi Civil, neni 26 e vijues.

⁴³⁵ Ligji 9901/2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" i ndryshuar, neni 3.

Veshja e shoqërisë tregtare me personalitet juridik të veçantë i jep asaj mundësinë të ketë të drejta dhe detyrime kundrejt të tretëve dhe kundrejt ortakëve apo aksionerëve të saj. Gjithashtu, shoqëria tregtare mund të jetë palë ndërgjyqëse në procese gjyqësore, si palë paditëse, apo si palë e paditur. Disa studiues i konsiderojnë kompetencat e gjera të shoqërisë si një koncesion që i vjen asaj që nga themelimi, jo vetëm nga themeluesit e saj, por nga një grup më i gjerë shoqëror i interesuar për rolin e shoqërive tregtare në ekonomi dhe në mjedisin ekonomiko-social.⁴³⁶

Personaliteti i veçantë juridik bën të mundur që shoqëria të zotërojë prona dhe të figurojë në regjistrat e pasurive të paluajtshme apo regjistrat e pasurive të tjera që regjistrohen (si psh. automjetet apo aksionet) si pronare e pasurive të saj. Madje një SHPK, mund të disponojë dhe kuota apo aksione në një shoqëri tjetër tregtare, duke marrë kështu dhe rolin e ortakut apo aksionerit.

Pasuritë që janë në emër të shoqërisë, i administron vetë shoqëria dhe jo ortakët e saj. Ky administrim bëhet në interesin e shoqërisë, në kuadër të aktivitetit tregtar të përcaktuar në statut dhe politikave tregtare të miratuara nga asambleja e ortakëve. Kjo vlen edhe në rastet kur shoqëria tregtare është shoqëri me një ortak te vetëm.⁴³⁷ Megjithatë, ortakët e shoqërisë kanë padyshim interes nga administrimi i suksesshëm dhe fitimprurës i asetëve pasurore të shoqërisë, pasi në bazë të vendimit të Asamblesë (AO), në përfundim të vitit financiar ortakët e shoqërisë marrin fitimet në formën e dividendit si pjesë e fitimit neto të realizuar nga shoqëria.

Në praktikën shqiptare ka pasur edhe raste konfuzioni, ku ortakët e SHPK-ve gabimisht kanë konsideruar pasurinë dhe aktivitetin e shoqërisë si pasuri apo aktivitet të tyre personal. Raste të tilla kanë shkaktuar konflikte gjyqësore dhe pasoja me dëmtim ekonomik të shoqërisë.⁴³⁸

Subjektet që synojnë të nisin një ativitet tregtar, apo një sipërmarrje tregtare, duhet të vlerësojnë shumë situata dhe të bejnë analiza të gjithëanshme edhe përsa i përket formës ligjore të organizimit të këtij biznesi. Në varësi të kësaj analize, ortakët mund të zgjedhin formën që rezulton më e përshtatshme për ta. Asnjë formë e shoqërive tregtare nuk mund

⁴³⁶ Janet Dine, *The Governance of Corporate Groups* (Cambridge University Press 2000) fq. 27.

⁴³⁷ Ligji 9901/2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” i ndryshuar, neni 3/1.

⁴³⁸ Shih Vendimin nr.10-2011-1471(706), datë 01.12.2011 të Gjykatës e Apelit Durrës, në të cilin gjykata ka konstatuar se ortaku *** me cilësinë e administratorit ka trajtuar pasuritë e shoqërisë si të ishin pasuri personale. Gjithashtu në Vendimin Nr.2546 datë 09.12.2016 Gjykata e Apelit Tiranë ka konstatuar se ortaku i shoqërisë ka trajtuar pasuritë e shoqërisë si të ishin pasuri personale dhe ka aplikuar parimin e zhveshjes së privilegjit të përgjegjësisë së kufizuar (*piercing corporate veil*) sipas nenit 16 te ligjit 9901/2008.

të konsiderohet *a priori* si forma ideale për të gjitha llojet e aktivitetetve apo sipërmarrjeve tregtare.⁴³⁹

Megjithatë dy janë kriteret kryesore që themeluesit e aktivitetit tregtar duhet të kenë në vëmendje para se të vendosin se cilën formë të shoqërive tregtare do të zgjedhin. Së pari, duhet të synojnë një formë shoqërie, e cila kufizon sa më shumë përgjegjësitë e ortakëve për detyrimet financiare të shoqërisë ndaj kreditorëve, pasi çdo sipërmarrje tregtare ka edhe elementin e riskut dhe humbjeve. Së dyti, ortakët themelues duhet të vlerësojnë se cila formë shoqërie është më e përshtatshme në raport me sistemin fiskal dhe shpenzimet e detyrueshme të organizimit dhe drejtimit të sipërmarrjes tregtare.⁴⁴⁰

4.3. Zotësia juridike e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar

Sipas nenit 7 të Ligjit 9901/2008, përcaktohet se shoqëria tregtare mund të ushtrojë çdo veprimtari, e cila nuk ndalohet me ligj. Ky parashikim vlen edhe për shoqërinë me përgjegjësi të kufizuar. Në një interpretim të zgjeruar të nenit 7 mund të konsiderojmë që zotësia juridike e SHPK-së, si person juridik, në parim është e ngjashme me atë të personit fizik.

Potencialisht, personi juridik mund të marrë pjesë dhe në veprimtari të tilla si ushtrimi i një aktiviteti në fushën e mjekësisë apo arsimit etj., të cilat në aspektin tekniko-praktik ushtrohen nga personat fizikë që janë “profesionistët” e fushës përkatëse. Për shembull, një shoqëri tregtare me përgjegjësi të kufizuar mund të ketë për objekt veprimtarie ofrimin e shërbimeve të ndryshme mjekësore, duke përfshirë dhe trajtime kirurgjikale, ndonëse është e qartë se personi juridik si i tillë nuk është i aftë të kryejë asnjë ndërhyrje kirurgjikale të sëmurët.⁴⁴¹

Gjithashtu administrimi i shërbimeve të caktuara brenda organizimit të klinikës, apo dhe vetë përfaqësimi i të gjithë SHPK-së duhet të bëhet nga persona fizikë. Pra, dhe veprimtaria e administratorit të një personi juridik, është një kufizim tjetër për shoqëritë tregtare dhe personat juridikë, pasi nuk mund të marrin cilësinë e administratorit. Një cilësi të tillë mund ta ketë vetëm një person fizik që gëzon aftësinë e plotë për të vepruar.

Veprimet e përfaqësimit të administratorit të shoqërisë, në ushtrimin e kësaj detyre, kryhen si “përfaqësues” në bazë të ligjit, por i atribuohen personit juridik të cilin përfaqësojnë. Në këtë mënyrë, shoqëria është përgjegjëse për veprimet e kryera nga përfaqësuesit e saj.

⁴³⁹ Tom Cody, Dem A Hopkins and Lawrence A Perlman, *Guide to Limited Liability Companies* (9th edition, Wolters Kluwer business 2007) fq. 7.

⁴⁴⁰ Po aty, fq. 7.

⁴⁴¹ Thomas Bachner, Edmund-Philipp Schuster dhe Martin Winner (n 203) fq. 25-26.

Zotësia juridike e SHPK-së ka dhe disa kufizime natyrore. Si shembull, personi juridik nuk mund të hyjë në marrëdhënie juridike të së drejtës familjare. Po ashtu, personi juridik nuk mund të aplikojë disponimin e pasurisë së tij me testament, dhe dispozitat e kodit Civil të trashëgimisë nuk aplikohen për personin juridik, i cili nuk mund të ketë një vdekje natyrale si personi fizik. Ndërsa, personat fizikë, në cilësinë e ortakut të shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar, u nënshtrohen dispozitave ligjore të trashëgimisë njësoj si për të gjitha të drejtat e tjera pasurore të personit fizik.

Neni 30 i Kodit Civil Shqiptar,⁴⁴² parashikon që “*personi juridik mund të kryejë çdo veprim juridik të lejuar në ligj, në aktin e krijimit ose në statut*”. Kjo teori e zotësisë juridike të kufizuar brenda parashikimit të statutit, në doktrinë është e njohur si “*ultra vires*”. Sipas kësaj teorie do të konsideroheshin të pavlefshme veprimet e kryera nga përfaqësuesi i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar, në rast se ato janë jashtë objektit të veprimtarisë së shoqërisë të parashikuar në statut.⁴⁴³ Një parashikim i tillë duket sikur e kufizon zotësinë juridike të personit juridik, vetëm në ato veprime të parashikuara në statutin e shoqërisë.⁴⁴⁴

Por kjo teori e konceptit “*ultra vires*” të zotësisë juridike të kufizuar të SHPK-së e parashikuar në nenin 30 të K.Civil, është e kapërcyer tashmë me evoluimin e legjislacionit shqiptar dhe praktikës gjyqësore. Ligji Nr.9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”⁴⁴⁵ ka shfuqizuar detyrueshmërinë për të regjistruar objektin e aktivitetit tregtar të shoqërisë, sepse ky objekt regjistrohet vetëm “në rast se është përcaktuar”. Neni 32 i Ligjit për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit përcakton se cilët janë elementët e detyrueshëm për regjistrim nga shoqëritë tregtare. Dhe në listën e këtyre elementëve të detyrueshëm nuk përfshihet domosdoshmërisht dhe “objekti i aktivitetit të shoqërisë tregtare”. Ai duhet të përfshihet vetëm nëse është përcaktuar nga ortakët themelues.⁴⁴⁶ Pra.

⁴⁴² Kodi Civil, neni 30.

⁴⁴³ Thomas Bachner, Edmund-Philipp Schuster dhe Martin Winner (n 203) fq 25

⁴⁴⁴ Po aty fq 25.

⁴⁴⁵ Me ligjin 8/2015 “Për disa ndryshime dhe shtesa Në Ligjin Nr. 9723, Datë 3.5.2007, “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”, të Ndryshuar ” përcaktohet se ky ligj është përafuar pjesërisht me direktivën 2009/101/KE të Parlamentit Europian dhe të Këshillit, datë 16 shtator 2009, “Për koordinimin e masave, të cilat, për qëllime të mbrojtjes së interesave të anëtarëve dhe të palëve të treta, duhet të zbatohen nga shoqëritë e shteteve anëtare, në kuptimin e paragrafit të dytë të nenit 48 të Traktatit, dhe me qëllim për t’i bërë këto masa ekuivalente”, të ndryshuar”. Numri CELEX: 32009L0101, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Europian, seria L, nr. 258, datë 1.10.2009, fq. 11-1.

⁴⁴⁶ Në nenin 32 të Ligjit 9723/2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit” [2007] FZ 60 përcaktohet se:

“Për regjistrimin fillestar të shoqërive tregtare janë të detyrueshme këto të dhëna:

- a) emri;
- b) forma;
- c) data e themelimit;
- ç) të dhënat e identifikimit të themeluesve;
- d) selia;
- dh) objekti, në qoftë se është i përcaktuar;
- e) kohëzgjatja, në qoftë se është e përcaktuar;
- ë) të dhënat e identifikimit të personave përgjegjës për administrimin dhe përfaqësimin e

sipas këtij formulimi rezulton se ortakët mund të regjistrojnë një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar edhe pa përcaktuar objektin e aktivitetit të saj. Në një rast të tillë, edhe sipas studiuesve të tjerë,⁴⁴⁷ shoqëria prezumohet se ka zotësi të pakufizuar juridike, për të kryer çdo veprim që nuk vjen në kundërshtim me ligjin.

Ndërsa ligji Nr.9901/2008, në nenin 12 të tij, përcakton se veprimet e kryera nga përfaqësuesi juridik i shoqërisë, janë të detyrueshme për këtë shoqëri edhe kur ato e kapërcejnë objektin e veprimtarisë së saj.⁴⁴⁸

Pra, ligjet e posaçme që rregullojnë organizimin e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar dhe regjistrimin e saj në QKB kanë tejkaluar doktrinën “*ultra vires*” duke e nxjerrë çështjen e mosrespektimit të statutit nga përfaqësuesi i shoqërisë, jashtë sferës së zotësisë juridike për të vepruar të personit juridik dhe duke e trajtuar atë në sferën e përfaqësimit të personit juridik dhe rregullave të përfaqësimit.⁴⁴⁹

4.4. Karakteristika të veçanta të shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar

4.4.1. Qëllimi i themelimit të një SHPK-je

I gjithë kuadri ligjor që parashikon mundësinë e themelimit të SHPK-ve, është ngritur me qëllim për t’u ardhur në ndihmë subjekteve të së drejtës civile, (qofshin këto persona fizikë (qytetarët) apo persona juridikë), që të ngrenë një infrastrukturë juridike të përshtatëshme për të kryer aktivitet tregtar me qëllim fitimi, por me një ekspozim minimal ndaj risqeve financiare.

Qëllimi primar i themeluesve të një SHPK-je është që të realizojnë fitime për veten e tyre, duke bërë të mundur që një apo disa sipërmarrje tregtare të kryhen në emër dhe për llogari të një subjekti tjetër, siç është shoqëria tregtare që po krijojnë, e cila mban të gjithë përgjegjësinë e veprimeve dhe marrëdhënieve me të tretët dhe kreditorët. Ortakët

shoqërisë në marrëdhënie me të tretët, kompetencat e përfaqësimit, si dhe afatet e emërimit të tyre.

f) specimet e nënshkrimit (firmave) të personave, që përfaqësojnë shoqërinë përpara të tretëve.”

⁴⁴⁷ Thomas Bachner, Edmund-Philipp Schuster dhe Martin Winner (n 203) fq. 25-26

⁴⁴⁸ Neni 12 i ligjit 9901/2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” i ndryshuar parashikon se:

“Veprimet e kryera nga përfaqësuesit ligjorë të shoqërisë janë të detyrueshme për shoqërinë edhe nëse këto tejkalojnë objektin e saj, me përjashtim të rastit kur këto veprime shkojnë përtej tagrave të përfaqësimit që u jep ligji apo lejon t’u jepen përfaqësuesve. Këto veprime nuk janë detyruese për shoqërinë, nëse shoqëria provon se i treti ka pasur dijeni se akti tejkalon objektin e saj, apo në bazë të rrethanave të qarta nuk mund të mos kishte pasur dijeni për të. Publikimi nëpërmjet ndryshimit të statutit nuk përbën provë të mjaftueshme për dijeninë e të tretëve, nëse ky ndryshim është bërë publik në mënyrë të ndryshme nga ato të parashikuara nga ligji për Qendren Kombëtare të Regjistrimit”.

⁴⁴⁹ Thomas Bachner, Edmund-Philipp Schuster dhe Martin Winner (n 203) fq. 25.

themelues, zgjedhin këtë formë të shoqërisë tregtare pikërisht në rastin kur ata nuk kanë dëshirë apo interes, që aktivitetin e sipërmarrjes tregtare ta ushtrojnë në emrin dhe për llogarinë e tyre.

Ndërkohë që SHPK-ja si formë e shoqërisë tregtare u jep ortakëve mundësi që nga aktiviteti tregtar që kryhet, në përfundim të çdo viti financiar, ata të përfitojnë ekonomikisht nga ndarja e fitimit neto që realizon shoqëria. Ky fitim neto i realizuar nga shoqëria, ndahet në interes të ortakëve, pasi janë mbajtur rezervat ligjore dhe statutore, të cilat do të analizohen në mënyrë të detajuar në vijim të këtij kërkimi.⁴⁵⁰

Pra, forma e SHPK-së si shoqëri tregtare i jep mundësi çdo qytetari apo subjekti të së drejtës, duke përfshirë këtu të gjitha kategoritë e subjekteve, (persona juridikë publikë dhe persona juridikë privatë) që të investojnë një kapital të caktuar dhe të bëhen pjesë e një sipërmarrjeje tregtare si ortakë.

Madje edhe në rastet kur ligje të posaçme parashikojnë kufizime apo ndalesa për subjektet e së drejtës (persona fizikë apo juridikë) që të ushtrojnë veprimtari tregtare si tregtarë, ky lloj kufizimi nuk i ndalon ata që të jenë ortakë në një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar. Me përjashtim të rasteve kur kufizimi e shpreh në mënyrë eksplicite edhe ndalimin e të drejtës për të qenë ortak në një SHPK.

4.4.2. Koncepti i përgjegjësisë së kufizuar të ortakëve të një SHPK-je

Koncepti i përgjegjësisë së kufizuar është një nga bazat e ekzistencës dhe zhvillimit të shoqërive tregtare dhe konsiston në garancinë që kanë ortakët e një SHPK-je, që të mos mbajnë përgjegjësi financiare për borxhet që shoqëria ka ndaj kreditorëve të ndryshëm, apo të tretëve. Pasuria personale e ortakëve të shoqërisë është e ekspozuar ndaj kërkimeve të kreditorëve vetëm deri në vlerën e pashlyer të kontributit të nënshkruar në shoqëri. Në kushte normale, pjesa tjetër e pasurisë personale të ortakut është e “imunizuar” nga pretendimet e kreditorëve të shoqërisë. Kjo do të thotë se kreditorët e shoqërisë nuk kanë të drejtë t’u drejtohen ortakëve të SHPK-së për shlyerjen e borxheve që u janë krijuar atyre nga mospërbushja e detyrimeve nga ana e shoqërisë.

Sipas nenit 68/1 të ligjit Nr.9901 Dt. 14.04.2008, për SHPK-të është bërë përkufizimi si vijon:

⁴⁵⁰ Sipas nenit 76 të Ligjit 9901/2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” i ndryshuar:

“1. Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në statut, ortakët kanë të drejtë të ndajnë pjesën e fitimit të deklaruar në pasqyrat financiare të shoqërisë. 2. Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në statut, fitimi u shpërndahet ortakëve në raport me kuotat e zotëruara.”

“Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar është një shoqëri tregtare, e themeluar nga persona fizikë ose juridikë, të cilët nuk përgjigjen për detyrimet e shoqërisë tregtare dhe mbulojnë personalisht humbjet e shoqërisë deri në pjesën e pashlyer të kontributeve të nënshkruara. Kontributet e ortakëve përbëjnë kapitalin e regjistruar të shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar”.

Koncepti i përgjegjësisë së kufizuar mund të ilustruhet në mënyrë figurative si një “*petk mbrojtës*” apo “*vello mbrojtëse*”, e cila i ndalon kreditorët e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar që të kërkojnë nga ortakët e kësaj shoqërie që të shlyejnë detyrimet, të cilat shoqëria nuk i shlyen dot. Pra, ky *imunitet* i ortakëve merr rëndësi në rasin kur shoqëria ka detyrime dhe borxhe ndaj kreditorëve, të cilat nuk i shlyen dot për shkak të paafësisë paguese, dhe në një situatë të tillë, kreditorët nuk kanë të drejtë të kërkojnë shlyerjen e borxheve të shoqërisë me pasurinë personale të ortakëve. Në këtë punim, kjo e drejtë e ortakëve të SHPK-ve do të emërtohet dhe si “*privilegji i përgjegjësisë së kufizuar*”.

Koncepti i përgjegjësisë së kufizuar, i kombinuar me efektet e personalitetit të pavarur juridik të shoqërisë, sigurojnë një mbrojtje të dyanshme, përsa i përket ekspozimit ndaj borxheve dhe detyrimeve të ndryshme. Këta janë mekanizma juridikë që i sigurojnë ortakut “*imunitet*” për borxhet e shoqërisë, por edhe shoqërisë, ata i sigurojnë mbrojtje dhe “*imunitet*” për paprekshmërinë e aseteve të saj nga kreditorët personalë të ortakëve të shoqërisë.⁴⁵¹

Duke qenë se shoqëria ka personalitet të veçantë juridik të ndarë nga ai i ortakëve të saj, të gjitha asetet financiare dhe kapitalet e shoqërisë janë në pronësi të shoqërisë, si entitet i veçantë juridik. Ortakët e një SHPK-je e kanë humbur pronësinë e çdo kapitali me të cilin kanë kontribuar në shoqëri që në momentin e shlyerjes se kontributeve në fazën e themelimit. Nga ky moment e në vazhdim, këto kapitale si dhe të gjitha rezervat e akumuluar nga shoqëria janë pronë e shoqërisë si person juridik dhe jo e ortakëve të saj. Prandaj, asnjë kreditor personal i ortakëve nuk mund të kërkojë shlyerjen e detyrimit me asete të shoqërisë.

Por nuk mund të themi të njëjtën gjë për kuotën që përfaqëson të drejtat e ortakut në shoqëri. Kuota e ortakut të SHPK-së, e njohur ndryshe dhe si pjesëmarrje e ortakut në kapitalin e shoqërisë,⁴⁵² është objekt i pretendimeve të kreditorëve personalë të ortakëve në kuadër të shlyerjes se detyrimeve personale të ortakut. Megjithatë, kjo nuk cenon kapitalet e shoqërisë, por mund të shkaktojë transferimin kuotës nga ortaku te një person tjetër që futet si ortak i ri në shoqëri.

⁴⁵¹ Bainbridge and Henderson (n 74) fq 9.

⁴⁵² Këtu duhet bërë kujdes, kur themi “pjesën e ortakut në kapitalin e shoqërisë”, pasi kjo shprehje duhet të kuptohet si sinonim i fjalës *kuotë* dhe nuk duhet të keqkuptohet sikur disa kapitale, sende te caktuara, janë të këtij ortakut. Pasi, të gjitha sendet, pra asetet që ka shoqëria, janë të shoqërisë dhe jo të ortakëve.

Në ndryshim nga ortakët e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar, te shoqëritë kolektive dhe pjesërisht, te shoqëritë komandite, ortakët kanë përgjegjësi të pakufizuar për humbjet dhe detyrimet e shoqërisë ndaj të tretëve. Kjo do të thotë që ortakët me përgjegjësi të pakufizuar përgjigjen për përmbushjen e detyrimeve ekonomike të shoqërisë me të gjithë pasurinë e tyre të tashme dhe të ardhme. Prandaj, këta ortakë janë të ekspozuar ndaj një risku të pakufizuar në kuadër të sipërmarrjes tregtare, kjo, sepse ortaku nuk riskon vetëm paratë apo pasurinë me të cilën ka kontribuar në shoqëri, por të tërë pasurinë e tij personale, të tashme dhe të ardhme.⁴⁵³ Për shkak të këtij risku të pakufizuar rrjedh dhe kuptimi i shprehjes përgjegjësi e pakufizuar e ortakut.

Në ndryshim nga ortakët me përgjegjësi të pakufizuar, ortakët e një SHPK-je kanë vetëm përgjegjësinë financiare që të shlyejnë pjesën e kontributit të tyre sipas parashikimit të bërë në statut, në momentin e themelimit të shoqërisë (apo në formularët përkatës të regjistrimit në QKR). Megjithatë, në vijim të këtij punimi do të shohim se ka dhe përjashtime nga rregulli i përgjithshëm i imunitetit të ortakëve të SHPK-së për detyrimet e shoqërisë (si, për shembull, aplikimi i “*Piercing Corporate Veil*”).

Siç do të analizohet hollësisht në vijim të këtij kërkimi ku do të shpjegohet që ortakët e shoqërisë mund të kontribuojnë në kapitalin fillestar të SHPK-së me para (monedhë vendase ose valutë të huaj) dhe/ose, me pasuri në natyrë, e cila ka një vlerë ekonomike të caktuar. Statuti mund të parashikojë që ortakët që kontribuojnë në kapitalin e shoqërisë me para, mund ta shlyejnë kontributin e tyre edhe me këste brenda një afati të përcaktuar në statutin e shoqërisë.⁴⁵⁴

4.4.3. Kufizimet e përgjegjesisë së kufizuar

Pavarësisht se koncepti i përgjegjesisë së kufizuar të ortakëve në një SHPK është karakteristika thelbësore e saj, ligji parashikon edhe disa përjashtime, apo kufizime, të zbatimit të këtij privilegji.

Rasti i parë i kufizimit të privilegjit të përgjegjesisë së kufizuar të ortakëve ndaj kreditorëve të shoqërisë, është i njohur si koncepti i “*Piercing Corporate Veil*”.⁴⁵⁵ Ortakët e një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar, si rregull, nuk mbajnë përgjegjësi për detyrimet e shoqërisë, por ata nuk kanë një imunitet absolut që i mbron në rastet kur ata me keqbesim

⁴⁵³ Galgano (n 200) fq 232.

⁴⁵⁴ Ligji 9901/2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” i ndryshuar, neni 68 pika 5.

⁴⁵⁵ Termi “*Piercing Corporate Veil*” është zhvilluar fillimisht në SHBA dhe më pas dhe në Europë, dhe nënkupton rastet kur ortakët apo aksionerët e një shoqërie të cilët kanë privilegjin e përgjegjesisë së kufizuar të cilët kanë një imunitet përsa i përket kërkimeve të kreditorëve të shoqërisë, në raste përjashtimore kur veprojnë në mënyrë abuzive me këtë privilegj të përgjegjesisë së kufizuar, mund zhvishen nga ky imunitet i tyre ndaj kreditorëve të shoqërisë dhe të ngarkohen me përgjegjësi personale të pakufizuar për të shlyer detyrimet e ardhura si pasojë e veprimeve të tyre abuzive.

kryejnë veprime abuzive duke pretenduar të përfitojnë nga “petku mbrojtës” i përgjegjësisë së kufizuar që ofron forma e SHPK-ve. Ligji 9901/2008 në nenin 16 të tij, ka parashikuar rastet kur ortakët mund të zhvishen nga “privilegji” i përgjegjësisë së kufizuar, të cilat janë si më poshtë:⁴⁵⁶

- abuzojnë me formën e shoqërisë tregtare për arritjen e qëllimeve të paligjshme;
- trajtojnë pasuritë e shoqërisë tregtare ku janë ortak si të ishin pasuritë e tyre apo;
- në çastin kur ortaku ka marrë dijëni apo duhet të kishte marrë dijëni se shoqëria nuk ka asete të mjaftueshme për të përmbushur detyrimet ndaj kreditorëve, nuk ka marrë masat e nevojshme që ligji i ka lënë në kompetencë të tij, për të mos lejuar që, shoqëria të vazhdonte veprimtarinë tregtare, duke marrë përsipër kështu dhe detyrime të reja ndaj kreditorëve.

Këto situata doktrina e së drejtës së shoqërive tregtare i njeh si “*Piercing Corporate Veil*”.⁴⁵⁷ Koncepti i “*Piercing Corporate Veil*”⁴⁵⁸ është tashmë një mjet i zakonshëm i pretendimeve të kreditorëve ndaj shoqërive më përgjegjësi të kufizuar apo shoqërive aksionare në Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Ndërsa, në Evropë,⁴⁵⁹ ky koncept i zhveshjes së petkut të përgjegjësive së kufizuar të ortakut është vënë në zbatim më vonë, por, gjithsesi, tashmë konsiderohet si një mjet i rëndësishëm për kreditorët e shoqërive.⁴⁶⁰

Në ditët e sotme, ky koncept është trajtuar gjerësisht nga jurisprudenca e gjykatave të SHBA dhe vendeve Europës Përfundimtare. Ndërsa në gjykatat Shqiptare megjithëse ne faza fillestare, konstatojmë se ka filluar të aplikohet ky institut disiplinues i aktivitetit të shoqërive tregtare.⁴⁶¹

Ligji 9901/2008 i ndryshuar, në nenin 16 të tij, i ka parashikuar këto koncepte të “*Piercing Corporate Veil*”.⁴⁶² Këto parashikime synojnë që të pengojnë subjekte të ndryshme, të cilat

⁴⁵⁶ Ligji 9901/2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” i ndryshuar, neni 16.

⁴⁵⁷ Humphreys (n 425) fq. 7-19.

⁴⁵⁸ Martin M Shenkman, Samuel Weiner dhe Ivan Taback, *Starting a Limited Liability Company* (2nd edition, Wiley 2003) fq. 145-146.

⁴⁵⁹ Beate Sjøfjell “Environmental Piercing of the Corporate Veil The Norwegian Supreme Court Decision in the *Hampel Case*” (2010) 7:4 *European Company Law* 154-160.

⁴⁶⁰ Karen Vandekerckhove, *Piercing the Corporate Veil* (Kluwer Law International 2007) fq. 8-14.

⁴⁶¹ Shih Gjykata e Apelit Tiranë Vendimi Nr. 2546 datë 09.12.2016.

⁴⁶² Ligji 9901/2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” i ndryshuar, në nenin 16/1 përcaktohet se:

- “1. Individit, i cili gëzon cilësinë e ortakut, aksionarit apo përfaqësuesit të ortakut ose aksionarit, të administratorit apo të anëtarit të këshillit të administrimit të shoqërisë tregtare, i cili, me veprimet apo mosveprimet e tij, u siguron vetes apo të tretëve një përfitim ekonomik të padrejtë, apo i shkakton një të treti pakësimin e pasurisë me dashje, është përgjegjës personalisht ndaj të tretëve, përfshi autoritetet publike, me pasurinë e tij, për shlyerjen e detyrimeve të shoqërisë, kur:
- a) ka abuzuar me formën dhe/ose përgjegjësinë e kufizuar që ofron shoqëria tregtare; ose
 - b) ka trajtuar pasuritë e shoqërisë tregtare si të ishin pasuritë e tij/të saj personale; ose
 - c) në çastin kur ka marrë dijëni apo duhet të kishte marrë dijëni që shoqëria nuk ka kapital të mjaftueshëm për të përmbushur detyrimet ndaj palëve të treta, nuk mori masat e nevojshme, të përfshira në kompetencat e tij/të saj, sipas këtij ligji, për të mos lejuar që, në

me keqdashje tentojnë të abuzojnë me infrastrukturën juridike të shoqërive me përgjegjësi të kufizuar dhe shoqërive aksionare dhe synojnë të fshihen pas petkut mbrojtës të përgjegjesisë së kufizuar në dëm të subjekteve të tjera.

Në rast se vërtetohet pika “a” e nenit 16/1, pra që ortakët e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar kanë abuzuar me formën e shoqërisë dhe petkun e përgjegjesisë së kufizuar, atëherë, sipas nenit 16 të ligjit, ata nuk kanë më imunitet për detyrimet e papaguara nga shoqëria.⁴⁶³ Pra, në një situatë të tillë, ortakët do të duhet të përgjigjen për detyrimet e papaguara të shoqërisë duke mos përfituar më nga privilegji i përgjegjesisë së kufizuar.

Në rast se vërtetohet pika “b” e nenit 16/1, pra që ortakët e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar kanë trajtuar pasuritë e shoqërisë sikur të ishin pasuritë e tyre personale, atëherë sipas nenit 16 të ligjit, ata do të duhet të përgjigjen për detyrimet e papaguara të shoqërisë ndaj kreditorëve deri në vlerën e tregut të pasurisë apo pasurive të shoqërisë tregtare, të cilat i ka trajtuar si të ishin pasuritë tyre personale. Në këtë rast, zhveshja nga privilegji i përgjegjesisë së kufizuar bëhet në mënyrë të pjesshme, vetëm për diferencën e vlerës së pasurive të shoqërisë të cilat ortaku, në mënyrë të kundërligjshme i ka trajtuar sikur të ishin pasuri e tij personale. Pra, nëse vërtetohet një situatë e tillë, konsiderohet si një dëm i shkaktuar kapitalit të shoqërisë nga ortaku i saj dhe për vlerën e këtij dëmi, ortaku do të jetë përgjegjës para kreditorëve të shoqërisë në rast se shoqëria ndodhet në paaftësi paguese për të shlyer detyrimet ndaj kreditorëve. Por, përgjegjësia e ortakut, në këtë rast është

-
- varësi të rrethanave, shoqëria të vazhdonte ushtrimin e veprimtarisë tregtare, dhe/ose marrjen përsipër të detyrimeve të reja ndaj palëve të treta, përfshirë autoritetet publike.*
2. Në rastet e parashikuara në pikën 1 të këtij neni, përgjegjësia personale për detyrimet e shoqërisë kufizohet deri në vlerat e përcaktuara në vijim:
- a) në rastin e parashikuar në shkronjën "a", të pikës 1, të këtij neni, deri në vlerën e përgjithshme të detyrimeve të papaguara të shoqërisë; ose
 - b) në rastin e parashikuar në shkronjën "b", të pikës 1, të këtij neni, për detyrimet e papaguara të shoqërisë, deri në vlerën e tregut të pasurisë apo pasurive të shoqërisë tregtare, të cilat i ka trajtuar si të ishin pasuritë e tij/të saj personale; ose
 - c) në rastin e parashikuar në shkronjën "c", të pikës 1, të këtij neni, deri në vlerën e përgjithshme të detyrimeve të papaguara të shoqërisë, të cilat kanë lindur pas marrjes dijene për gjendjen e parashikuar sipas shkronjës "c", të pikës 1, të këtij neni.
3. Nëse një apo më shumë nga shkeljet e sipërpërmendura kryhen së bashku nga më shumë se një prej personave të përmendur në pikën 1, të këtij neni, atëherë këta persona përgjigjen në mënyrë solidare ndaj të tretëve, përfshi autoritetet publike.
4. Personi i përcaktuar sipas pikës 1 të këtij neni, mban përgjegjësi personale ndaj palëve të treta, përfshi autoritetet publike, vetëm nëse kryerja e shkeljeve të përcaktuara në këtë nen vërtetohet me vendim gjyqësor të formës së prerë.
5. Personi i përcaktuar sipas pikës 1, të këtij neni, nuk mban përgjegjësi personale ndaj palëve të treta, të cilat, në momentin e marrjes përsipër të detyrimit nga shoqëria, kishin dijeni për shkeljet e përcaktuara në këtë nen apo, në bazë të rrethanave të qarta, nuk mund të mos kishin dijeni për to.
6. Padia ndaj personave të përcaktuar sipas pikës 1, të këtij neni, duhet të ngrihet brenda 3 vjetëve nga data e kryerjes së shkeljes.”

⁴⁶³ Po aty.

gjithsesi e pjesshme, deri në vlerën e pasurive, të cilat ishin të shoqërisë, por ai i ka trajtuar si të vetat personale, duke u ekspozuar kështu në mënyrë të kufizuar para parimit të “*Piercing Corporate Veil*”.⁴⁶⁴

Në rast se vërtetohet pika “c” e nenit 16/1, pra, që ortakët/administratorët e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar, kur ortakët/administratorët megjithese kishin dijeni për paaftësinë paguese, nuk kanë marrë masat e duhura për të shlyer detyrimet ose të ndalojnë veprimtarinë tregtare, atëherë ata do të duhet të përgjigjen deri në vlerën e përgjithshme të detyrimeve të papaguara të shoqërisë, të cilat kanë lindur pas marrjes dijeni për gjendjen e parashikuar. Edhe në këtë rast, zhveshja nga privilegji i përgjegjësive së kufizuar bëhet në mënyrë të pjesshme, vetëm për detyrimet e papaguara të shoqërisë, të cilat kanë lindur pas marrjes dijeni për gjendjen e parashikuar sipas shkronjës “c” dhe jo për të gjitha llojet e detyrimeve të papaguar të shoqërisë. Pra përgjegjësia e ortakut dhe ose administratorit në këtë rast është gjithsesi e pjesëshme, duke u ekspozuar kështu në mënyrë të kufizuar para parimit të “*Piercing Corporate Veil*”.⁴⁶⁵ Vlerësojmë administratorët e SHPK-ve janë më të ekspozuar të ndodhen para një situatë të tillë, pasi ata kanë përgjegjësinë e administrimit dhe janë në dijeni të gjendjes financiare të shoqërisë.

Sipas ligjit parashikohet se zhveshja e petkut të përgjegjësive së kufizuar mund të bëhet për të gjithë ata ortakë, të cilët kanë kryer një apo më shumë nga pikat e parashikuara në nenin 16 pika 1 e ligjit të sipërcituar. Në një situatë të tillë, kur ka më shumë se një ortak për të cilin është aplikuar “*Piercing Corporate Veil*”, atëherë këta ortakë përgjigjen në mënyrë solidare për detyrimet e shoqërisë ndaj kreditorëve, qofshin këto dhe autoritet publike, si përshembull institucionet fiskale.⁴⁶⁶

Por aplikimi i heqjes së privilegjit të përgjegjësive së kufizuar për ortakët e një SHPK-je, duhet të konsiderohet si një procedurë, e cila mund të aplikohet me kujdes të veçantë, vetëm në raste përjashtimore të abuzimit të ortakut, të cituara më lart. Për këtë arsye ligji ka parashikuar vetëm institucionin e gjykatës si organ kompetent për të marrë një vendim të tillë. Në çdo rast, kur nga kreditorët pretendohet të aplikohet “*Piercing Corporate Veil*”⁴⁶⁷, pra heqja e privilegjit të përgjegjësive së kufizuar, në mënyrë të plotë apo të pjesshme, ata duhet t’i drejtohen gjykatës dhe të paraqesin provat që provojnë abuzimin e ortakut. Kështu që garancia karakteristike e ortakëve të SHPK-ve mund të kufizohet, apo hiqet, vetëm nëpërmjet një vendimi gjyqëror të formës së prerë.

Këto parashikime janë një mjet i rëndësishëm në dispozicion të kreditorëve të shoqërisë për të rikuperuar kreditë e tyre, duke iu drejtuar ortakëve të shoqërisë që të përgjigjen

⁴⁶⁴ Ligji 9901/2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” i ndryshuar, neni 16 pika 2.

⁴⁶⁵ Po aty.

⁴⁶⁶ Ligji 9901/2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” i ndryshuar, neni 16 pika 3.

⁴⁶⁷ Ligji 9901/2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” i ndryshuar, neni 16 pika 4.

personalisht për detyrimet e shoqërisë, (si rast përjashtimor) nëse këta ortakë kanë kryer një nga rastet e mësipërme të abuzimit me petkun e përgjegjësisë së kufizuar. Në këto raste kreditorët kanë një afat 3-vjeçar, brenda të cilit duhet të ngrenë padinë ndaj ortakëve ose ortakut që ndodhet në kushtet e aplikimit të “*Piercing Corporate Veil*”.⁴⁶⁸ Afati për ngritjen e padisë fillon nga kryerja e shkeljes prej ortakut.

Neni 16 i ligjit 9901/2008, ka parashikuar dhe një kufizim të aplikimit të tij për të tretët (kreditorët). Të tretët, që janë kreditorë të shoqërisë, duhet të provojnë që nuk kanë qenë në dijeni dhe nuk kishin mundësinë të ishin në dijeni të abuzimit të ortakut me formën e shoqërisë apo njërin nga abuzimet e tjera të cituara në pikën 1 të këtij neni.⁴⁶⁹ Nëse shoqëria apo ortakut provon se i treti kishte pasur dijeni për abuzimin, apo në bazë të rrethanave të qarta nuk mund të mos kishte pasur dijeni për të, atëherë kreditori nuk mund të përfitojë nga ky parim i zhveshjes së ortakut nga përgjegjësia e kufizuar.

Edhe në praktikën gjyqësore shqiptare, megjithëse në raste të rralla, por ka pasur aplikime të heqjes së petkut të përgjegjësisë së kufizuar të ortakëve të cilët janë konstatuar në kushte të abuzimit të parashikuara në pikën e parë të nenit 116 të ligjit Nr.9901/2008. Gjykata e Apelit Tiranë në vendimin Nr.2546 Vendimi datë 09.12.2016 ka aplikuar nenin 16 të ligjit duke vlerësuar se ortakut i shoqërisë H***G***, duhet të zhvishet nga petku i përgjegjësisë së kufizuar “*Piercing Corporate Veil*”, duke vendosur ndryshimin e vendimit dhe pranimin e padisë së kreditorit për detyrimin e ortakut të vetëm, i cili vepronte dhe si administrator me përgjegjësi personale për dëmin e shkaktuar kreditorit.⁴⁷⁰:

Në arsyetimin e vendimit gjykata shprehet se kanë qenë pikërisht veprimet e kundërligjshme të ortakut të vetëm H. G., i cili ka vepruar dhe në cilësinë e administratorit të shoqërisë, që kanë sjellë paafësinë pagueuse për shoqërinë dhe për pasojë, i kanë shkaktuar dëm kreditorit paditës. Si veprim i kundërligjshëm është konsideruar fakti se ky ortak, (njëkohësisht dhe administrator) ka trajtuar pasurinë e shoqërisë sikur të ishte pasuri e tij personale dhe i ka kaluar në përdorim, personit të lidhur, (djalit të tij) asetin e vetëm që ia kishte mbetur shoqërisë (që ishte një mjet transporti tip autobus).

⁴⁶⁸ Ligji 9901/2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” i ndryshuar, neni 16 pika 6.

⁴⁶⁹ Ligji 9901/2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” i ndryshuar, neni 16 pika 5.

⁴⁷⁰ Gjykata e Apelit Tiranë Vendimi Nr.2546 datë 09.12.2016. ku autori i këtij punimi ka qenë në cilësinë e anëtarit të trupit gjykues. Në dispozitivin e këtij vendimi është vendosur:

“1. *Ndryshimin e vendimit nr. 3258, datë: 11.04.2015 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, si më poshtë vijon:*

a) *Pranimin e padisë.*

b) *Detyrimin e të paditurit H*** G*** që të paguajë solidarisht me të paditurin tjetër shoqëria “A****” sh.p.k, detyrimin monetar që rrjedh nga vendimi nr.4545, datë: 07.05.2012 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, lënë në fuqi me vendimin nr.1641, datë: 18.07.2013 të Gjykatës së Apelit Tiranë (titull ekzekutiv).”*

Gjykata ka vlerësuar se këto veprime përfshihen në kategorinë e veprimeve abuzive të parashikuara nga neni 16 i ligjit për tregtarët dhe shoqëritë tregtare të sipercituar.⁴⁷¹

⁴⁷¹ “Gjykata e Apelit Tiranë Vendimi Nr.2546 datë 09.12.2016 në arsyetimin e këtij vendimi shprehet se: 17.1. Gjykata e Apelit çmon se ortaku i vetëm (i cili ishte njëkohësisht edhe administrator i shoqërisë, dhe tani është likuidues) duhet të zhvishet nga përgjegjësia e kufizuar që i ofron shoqëria tregtare dhe të përgjigjet solidarisht me shoqërinë për detyrimin ndaj kreditorit, pasi kanë qenë veprimet e ortakut të vetëm (dhe administrator), ato që kanë sjellë si pasojë pamjaftueshmërinë e pasurisë së shoqërisë për të shlyer detyrimin ndaj paditësit Y*** B****. Ortaku i vetëm (dhe administratori) i shoqërisë H*** G***, ka shfrytëzuar formën e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar për të shmangur shlyerjen e detyrimit ndaj kreditorit, duke shkaktuar kështu pakësim me dashje të pasurisë së kreditorit, i cili e ka përfituar këtë vlerë nëpërmjet një vendimi gjyqësor që ka zgjidhur mosmarrëveshjen lidhur me zgjidhjen e kontratës së punës që ai ka patur me shoqërinë. Përmes formës së shoqërisë që ortaku ka zgjedhur për të ushtruar veprimtarinë tregtare të ideuar prej tij, përgjegjësia e tij, si rregull, është e kufizuar deri në vlerën e pashlyer të kontributeve të nënshkruara. Siç u theksua më lart, kjo e vendos ortakun në një pozitë më të favorizuar, pasi ai është i imunizuar nga humbjet e mëtejshme të shoqërisë dhe rreziku me të cilin përballet, si rregull, nuk tejkalon kontributin e dhënë prej tij në shoqëri. Gjykata vëren se, ky avantazh nuk duhet të keqpërdoret duke abuzuar pikërisht me privilegjin me të cilin është veshur ortaku, për të përkeqësuar e rënduar pozitën e kreditorëve të shoqërisë.

17.2. Gjykata arrin në përfundimin se nga ana e ortakut të vetëm (njëherazi dhe administrator) ka patur abuzime me qëllim shmangien e shlyerjes së detyrimit, pasi sikurse rezultoi edhe nga provat e administruara në dosje, shoqëria “A****” sh.p.k. nuk ka aktive të tjera përmas të cilave të përmbushë detyrimin ndaj kreditorit Y*** B****. “Tharja” e aktiveve të shoqërisë është përgjegjësi e administratorit dhe ortakut të vetëm njëherazi, i cili ka qenë personi përgjegjës për administrimin e shoqërisë dhe në momentin që ka konstatuar pamjaftueshmëri të kapitalit duhet të kishte marrë masat e nevojshme për të mos lejuar vazhdimin e aktivitetit të shoqërisë ose marrjen përsipër të detyrimeve të reja ndaj palëve të treta. Mungesa e kapitalit të mjaftueshëm për shlyerjen e detyrimit ndaj kreditorit Y***B****, është rezultat i veprimeve abuzuese të ortakut të vetëm (njëkohësisht administrator) në shoqëri.

17.3. Nga ana tjetër, veprimet vijuese të të paditurit H***G*** tregojnë për shmangie të qëllim të detyrimi për të shlyer kreditorin, pasi aktivi i vetëm përmes të cilit shoqëria mund të përmbushë detyrimin ndaj kreditorit (autobusi, siç konfirmohet nga shkresa e komisarit të policisë cituar më sipër), i është dhënë djalit të ortakut të vetëm/ish administrator dhe tashmë likuidues i shoqërisë H***G***. Abuzimi me pasurinë e shoqërisë është një tjetër shkak për të cilin ortaku zhvishet nga përgjegjësia e kufizuar që ofron shoqëria tregtare, pasi sikurse gjykata vlerësoi edhe më sipër, personaliteti juridik i shoqërisë prezumon ndarjen e pasurisë së ortakut nga pasuria e shoqërisë e rrjedhimisht nuk mund të shkrihen me njëra-tjetrën. Mbi pasurinë e shoqërisë, së pari kanë pretendime kreditorët e saj, e vetëm pas shlyerjes së detyrimeve të tyre, pasuria e mbetur i kalon ortakut/ortakëve të shoqërisë. Në këtë drejtim, gjykata vlerëson se ortaku i vetëm-administrator ka përdorur pasurinë e shoqërisë si pasuri personale, duke ua dhënë në përdorim familjarëve të tij.

17.4. Në kushte normale, dhënia në përdorim (kundrejt pagesës përkatëse) dhe rikthimi i pasurisë së shoqërisë të tretëve përbën një veprim të lejueshëm e si rregull pa asnjë pasojë. Madje, edhe përdorimi i pasurisë së shoqërisë nga ana e ortakut, e cila nuk sjell asnjë pasojë (si psh.: pamjaftueshmëri të aktiveve të shoqërisë) nuk mund të përbëjë shkak për heqjen e mburojës së përgjegjësive të kufizuar të ortakut. Por, nga ana tjetër, trajtimi i pasurisë së shoqërisë si pasuri personale duhet të sjellë si pasojë pamundësinë për përmbushjen e detyrimeve të shoqërisë, përfitimin ekonomik në dëm të shoqërisë, apo pamundësinë e të tretëve për të realizuar të drejtat e tyre në raport me shoqërinë, në mënyrë që të hiqet velloja e përgjegjësive të kufizuar.

17.5. Pra, në kushtet kur autobusi në pronësi të shoqërisë i është dhënë në përdorim djalit të ortakut të vetëm-ish-administrator dhe likuidues, H***G*** (duke iu shmangur kështu ekzekutimit të detyrueshëm), në momentin që shoqëria nuk kishte aktive të tjera dhe ishte në dijeni të detyrimit që kishte ndaj ish-punëmarrësit të saj (tani kreditor), kjo përbën përpjekje për të mashtruar dhe për t’iu shmangur detyrimin ndaj kreditorit të saj. Ky veprim, me dashje çon në

Më tej në arsyetimin e këtij vendimi gjykata e Apelit ka analizuar edhe veprimet e ortakut të vetëm të shoqërisë në cilësinë e tij si administrator i shoqërisë, për të vlerësuar nëse këto veprime përshihen në sferën e atyre situatave të parashikuara nga neni 16 i ligjit, situata këto, që nëse vërtetohen, gjykata mund të vendosë të ngarkojë me përgjegjësi personale personin që ka vepruar si administrator. Por në rastin konkret ka rezultuar se është i njëjti person që ka vepruar dhe si ortak i vetëm i shoqërisë dhe si administrator i saj.⁴⁷²

Nga ky vendim i Gjykatës së Apelit konstatohet se është bërë një analizë e detajuar juridike për institutin e “*Piercing Corporate Veil*”, apo “*heqjes së “velit” të përgjegjësisë së kufizuar të ortakut në një SHPK*” - siç e quan vetë gjykata, duke e ilustruar këtë edhe me praktikën e gjykatave të Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe standardeve amerikane të zbatimit të këtij instituti.⁴⁷³ Në këtë vendim, përveç se është shpjeguar në mënyrë shumë të kuptueshme ky koncept i zhveshjes së ortakut nga përgjegjësia e kufizuar, është bërë dhe analiza se në çfarë rrethanash të veçanta dhe përjashtimore mund të zbatohet “*Piercing Corporate Veil*”. Rrethana këto që lidhen më abuzimin e ortakut të shoqërisë, në

pakësimin e pasurisë së ish-punëmarrësit (tani kreditor i shoqërisë). Gjykata çmon se qëllimi i përdorimit të pasurisë së shoqërisë (njetit motorrik në këtë rast) është bërë me keqbesim nga ana e ortakut të shoqërisë, pasi kjo ka passjellë pamundësinë e shoqërisë për të shlyer detyrimin ndaj kreditorit, duke i pamundësuar përmbaruesit gjyqësor të shesë sendin në ankand. Qëllimi i ligjit nuk është që të dëmtohen kreditorët e shoqërisë, apo të disavantazhohen për shkak të pamundësisë së tyre për t’u informuar e për të patur ndikim në drejtimin e shoqërisë. Për këtë arsye, këto rregulla ligjore të parashikuara në ligjin nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar (të sipërcituara) synojnë mbrojtjen e kreditorëve.”

⁴⁷² Gjykata e Apelit Tiranë Vendimi Nr.2546 datë 09.12.2016 në arsyetimin e këtij vendimi shprehet se: “Dhënia e pasurisë së shoqërisë të familjarë të afërm të administratorit (i padituri) është qartazi një veprim i kryer në kushtet e konfliktit të interesit, duke synuar dëmtimin e interesave të kreditorit Y*** B***. Për këtë arsye, administratori (njëherazi edhe ortaku i vetëm i shoqërisë) do të duhet të përgjigjet me pasurinë e tij personale për detyrimin ndaj paditësit. Nga ana tjetër gjykata vëren se ndonëse edhe veprimet e administratorit kanë qenë shkak i paaftësisë për të shlyer detyrimet, nga rrethanat konkrete, duke qenë se ortaku është njëherësh edhe administrator i shoqërisë, është e padobishme caktimi i përgjegjësisë për shkak të shkeljes së standardit profesional dhe gjykata çmon se zhveshja e ortakut nga përgjegjësia e kufizuar është e mjaftueshme, për të realizuar të drejtën e kreditorit.

21. Për këtë arsye, gjykata ngarkon solidarisht shoqërinë A**** sh.p.k dhe ortakun e saj H***G*** për të shlyer detyrimin sipas kërimit të paditësit. Madje, nga veprimet e të paditurit, ai edhe në pozitën e likuiduesit përgjigjet për veprimet që i kanë sjell dëm kreditorit, megjithatë sikurse u tha edhe më sipër, gjykata vlerëson të mjaftueshëm heqjen e velit të shoqërisë për ortakun e vetëm (ish administrator dhe tashmë likuidues). ”

⁴⁷³ Gjykata e Apelit Tiranë Nr.2546 datë 09.12.2016 në arsyetimin e saj shprehet se: “Në çështjet *Van Dorn Co. v. Future Chemical and Oil Corp.*, 753 F.2d 565 (7th Cir. 1985)⁴⁷³ dhe *Sea-Land Services, Inc. v. Pepper Source*, 993 F.2d 1309 (1993) gjykatat amerikane kanë hartuar një test për të vlerësuar nëse duhet hequr veli i shoqërisë ose jo, sipas të cilit: “entiteti i korporatës (personaliteti juridik i shoqërisë) do të injorohet dhe veli i përgjegjësisë së kufizuar do të hiqet, nëse plotësohen dy kërkesa: Së pari, duhet të ketë një unitet (bashkësi) interesash dhe pasurie, në mënyrë që personalitetet e ndara të shoqërisë (tregtare) dhe të individit nuk ekzistojnë; dhe së dyti, rrethanat duhet të jenë të tilla që ruajtja e fiksionit të ekzistencës së pavarur të shoqërisë tregtare do të ligjëronte mashtrimin dhe do të promovonte padrejtësinë”.

kundërshtim me ligjin, dhe gjykata me të drejtë arsyeton se aplikimi pa kufizim i imunitetit të përgjegjësisë së kufizuar do të ligjëronte mashtrimin dhe do të promovonte padrejtësinë. Gjithashtu, ky vendim ka dhe vlerat e veta në jurisprudencën e gjykatave shqiptare, pasi është një nga vendimet e para në të cilat është aplikuar ky koncept i ri i heqjes së petkut të përgjegjësisë së kufizuar i “*Piercing Corporate Veil*”. Aplikimi i këtij koncepti të zhveshjes së ortakut nga privilegji i përgjegjësisë së kufizuar, sa delikat, aq edhe të rëndësishëm, kërkon shumë përgjegjshmëri, maturi dhe analizë të balancuar juridike në praktikë.

Rasti i dytë i kufizimit të përgjegjësisë së kufizuar lidhet me detyrimet e ngarkuara nga neni 71/2⁴⁷⁴ i ligjit në fuqi, për ato shoqëri, që pasi janë themeluar mbetën me një ortak të vetëm, në rast se ky ortak nuk respekton formalitetet e regjistrimit të këtij fakti në QKB. Sipas këtij sanksioni, ortaku që nuk përmbush detyrimin për regjistrimin e këtij fakti, do të konsiderohet si ortak me përgjegjësi të pakufizuar për detyrimet që shoqëria ka marrë përsipër gjatë kësaj periudhe. Ky është një rast përjashtimor, sipas të cilit një ortak i SHPK-së mund të kthehet nga ortak me përgjegjësi të kufizuar në ortak me përgjegjësi të pakufizuar. Por, ky ekspozim është vetëm për periudhën e kohës që ortaku nuk ka publikuar në QKB (regjistrin tregtar) faktin që ka mbetur ortak i vetëm në shoqëri. Nga momenti i publikimit të këtij fakti në QKB, e në vazhdim, ortaku rifiton statusin e ortakut me përgjegjësi të kufizuar.⁴⁷⁵ Ligji ka parashikuar këtë sanksion me qëllim që të shërbejë si një shtysë dhe motivim efektiv që të detyrojë ortakët, të cilët mbeten të vetëm gjatë ushtrimit të aktivitetit të një SHPK-je, që ta publikojnë këtë fakt në QKB (regjistrin tregtar) si garanci për kreditorët.

Nga hulumtimi i praktikës së deritanishme gjyqësore, nuk janë evidentuar raste në të cilat kreditorët të kenë përfituar nga ky parashikim ligjor. Ndërsa për SHPK-të e regjistruara që në fillim me një ortak të vetëm, nuk ekziston asnjë risk i cenimit të përgjegjësisë së kufizuar të ortakut, pasi detyrimi për publikim është ezauruar që në momentin e regjistrimit të shoqërisë në QKB.

Rasti i tretë që mund të konsiderohet si një situatë e cila ekspozon ortakun e një SHPK-je ndaj detyrimeve të kreditorëve, lidhet me sasinë e pashlyer të kontributit të ortakut në kapitalin e shoqërisë. Kjo mund të ndodhë vetëm në momentet e para të formimit të shoqërisë, për ata ortakë që kontributin e tyre e shlyejnë me këste. Në një rast të tillë hipotetik, kur ortakët nuk kanë shlyer akoma këstin e fundit të kontributit të tyre, dhe

⁴⁷⁴ Ligji 9901/2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” i ndryshuar. Neni 71 përcakton se:

“1. Nëse shoqëria mbetet me një ortak, atëherë ortaku i vetëm detyrohet ta regjistrojë këtë fakt, sipas nenit 43 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007. Nëse ortaku i mbetur nuk përmbush këtë detyrim, atëherë ai përgjigjet personalisht për detyrimet që shoqëria ka marrë përsipër. 2. Nga çasti i regjistrimit të ndryshimit, sipas pikës 1 të këtij neni, shoqëria tregtare vijon si shoqëri me përgjegjësi të kufizuar me ortak të vetëm.”

⁴⁷⁵ Ligji 9901/2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” i ndryshuar, neni 71 pika 2.

shoqëria ka detyrimin të shlyejë një borxh apo detyrim të çfarëdo natyre, në ditët apo muajt e parë pas themelimit, atëherë kreditori i shoqërisë ka të drejtë, që në rast të pamundësisë financiare të shoqërisë për të shlyer këtë detyrim, t'u drejtohet dhe ortakëve që nuk kanë paguar/ shlyer të plotë vlerën e kontributit të tyre në shoqëri, me kërkesën që ata të paguajnë atë pjesë apo ato këste të pashlyera. Këto këste të pashlyera konsiderohen si pjesë të kapitalit të shoqërisë që nga momenti i regjistrimit të SHPK-së në QKB, dhe ortaku ka detyrimin që t'i shlyejë për të plotësuar kapitalin e nënshkruar, i cili përbën garancinë e kreditorëve.

Megjithëse edhe në një rast të tillë përjashtimor, kur ortaku është i ekspozuar ndaj kërkesës së kreditorëve të shoqërisë për borxhet e saj, kjo është një përgjegjësi e kufizuar deri në masën e pashlyer të kontributit të ortakut. Në rast se detyrimet ndaj kreditorëve janë më të mëdha se kaq, pra e tejkalojnë vlerën e kontributeve të pashlyera të ortakëve, atëherë ortakët nuk kanë asnjë përgjegjësi financiare për këto detyrime, dhe ndaj tyre nuk mund të kërkohet asnjë detyrim tjetër financiar.

Burimi i kësaj përgjegjësie rrjedh prej detyrimeve që ortaku ka ndaj shoqërisë, dhe jo drejtëpërdrejt ndaj kreditorëve të shoqërisë. Megjithatë, kreditorët, duke u nisur nga statuti dhe masa e kapitalit të shprehur në statut, legjitimohen në kërkimet ndaj ortakut për të shlyer vlerën e plotë të kontributit, i cili do t'i shërbejë si burim për shlyerjen e kredisë.

4.4.4. Veçoritë e tregtarit si person fizik, në dallim nga shoqëria me përgjegjësi të kufizuar

Ligji.9901/2008, shtrin konceptin e subjektit tregtar të shoqëritë, të cilat për shkak të formës konsiderohen shoqëri tregtare. Ky ligj, kryesisht është konsideruar si ligji organik që rregullon shoqëritë tregtare, pra personat juridikë tregtarë. Por, në këtë ligj, që në nenin 1 të tij përcaktohet se: “subjektet e së drejtës tregtare janë tregtarët dhe shoqëritë tregtare”.⁴⁷⁶ Në kushtet kur ligji i posaçëm përcakton si subjekt të së drejtës tregtare edhe tregtarin si person fizik, në vijim do të shtjellohen dallimet mes tregtarit si person fizik në raport me shoqëritë tregtare në përgjithësi dhe shoqërinë me përgjegjësi të kufizuar në veçanti.

Ligji.9901/2008, megjithëse përmban gjithsej 233 dispozita, në lidhje me tregtarin si person fizik, nuk ka bërë një rregullim të detajuar, por referon te Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë. Në këtë ligj është vetëm një dispozitë, në të cilën është përcaktuar koncepti i tregtarit si person fizik.⁴⁷⁷ Konkretisht është neni 2 i ligjit që bën përkufizimin e tregtarit si person fizik, dhe e përfshin atë të subjektet e të drejtës tregtare.

⁴⁷⁶ Ligji 9901/2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” i ndryshuar, neni 1.

⁴⁷⁷ Ligji 9901/2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” i ndryshuar, neni 2.

Përfshirja e tregtarit si person fizik në këtë ligj ishte domosdoshmëri, për shkak se ky ligj sipas nenit 232⁴⁷⁸ të tij ka shfuqizuar ligjin Nr.7632 dt. 04.11.1992 “Për dispozitat që rregullojnë pjesën e parë të Kodit Tregtar” ku, në nenin 2 të tij, ishte parashikuar ndër të tjera dhe tregtari si person fizik.⁴⁷⁹ Sipas nenit 2 të ligjit 9901/2008, për tregtarin si person fizik, duke u parashikuar si subjekt i të drejtës tregtare, lindin një sërë të drejtash dhe detyrimesh duke filluar nga detyrimi për regjistrim pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit deri te detyrimet që lindin si pasojë e legjislacionit fiskal.⁴⁸⁰

Ligji i posaçëm ka parashikuar katër lloje të ndryshme personash juridikë, të cilët e përfitojnë cilësinë e tregtarit për shkak të formës. Këto janë shoqëritë kolektive, shoqëritë komandite, shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar dhe shoqëritë aksionare.

Në gjuhën e përditëshme të rretheve juridike dhe financiare, të gjitha subjektet e te drejtes tregtare, quhen tregtare. Megjithatë ekzistojnë shumë dallime mes personit fizik të regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit si "tregtar" dhe subjekteve të tjera që janë "shoqëritë tregtare" (ku shoqëria me përgjegjësi të kufizuar është lloji më i përhapur i tyre).

Regjistrimi i këtyre shoqërive në Qendrën Kombëtare të Biznesit është kusht pa të cilin nuk do të fitonin personalitetin juridik (*condicio juris*). Ndërsa tregtari si person fizik konsiderohet i tillë për shkak të aktivitetit tregtar që ai zhvillon, duke ofruar mallra dhe/apo

⁴⁷⁸ Ligji 9901/2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” i ndryshuar, neni 232.

⁴⁷⁹ Ligji 7632/1992 “Për Dispozitat që Rregullojnë Pjesën e Parë të Kodit Tregtar” [1992] FZ 8 (shfuqizuar).

⁴⁸⁰ Ligji 9901/2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” i ndryshuar, neni 2, sipas të cilit përcaktohet si vijon:

1. Tregtari është personi fizik, sipas kuptimit të Kodit Civil, i cili ushtron veprimtari ekonomike të pavarur, që kërkon një organizim tregtar të zakonshëm.
2. Personi fizik, i cili ushtron një profesion të pavarur (si avokat, noter, kontabilist, mjek, inxhinier, arkitekt, artist etj.), vlerësohet tregtar, nëse një ligj i posaçëm i ngarkon këtë status.
3. Personi fizik, i cili ushtron veprimtari bujqësore, blegtorale, pyjore e të ngjashme, vlerësohet tregtar, nëse veprimtaria e tij përqendrohet kryesisht në përpunimin dhe shitjen e produkteve bujqësore, blegtorale, pyjore (agrobiznes).
4. Personi fizik, veprimtaria ekonomike e të cilit, për shkak të vëllimit të tij, nuk kërkon një organizim të zakonshëm tregtar (tregtar i vogël), nuk vlerësohet tregtar e nuk i nënshtrohet këtij ligji. Ministri i Financave dhe ministri përgjegjës për ekonominë, me urdhër të përbashkët, miratojnë pragjet e vëllimit të veprimtarisë, në bazë të të cilave lind detyrimi i regjistrimit si tregtar.
5. Tregtari regjistrohet sipas neneve 28 pika 1 dhe 30 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”. Nëse tregtari ka krijuar një faqe në internet, të gjitha të dhënat e njoftuara pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit publikohen në këtë faqe.
6. Tregtari është i detyruar të ndjekë parimet e ndershmërisë profesionale, të zbatueshme në mjedisin tregtar, ku ai vepron. Tregtari, për detyrimet që rrjedhin nga veprimtari të ushtruara, përgjigjet personalisht me të gjithë pasurinë e të drejtat e tij të tashme dhe të ardhshme, përfshirë pasuritë e luajtshme e të paluajtshme, pronësitë industriale e intelektuale, kreditë ndaj të tretëve e çdo të drejtë apo pasuri tjetër, vlera e të cilave mund të shprehet në para.
7. Tregtari e humbet statusin e tij kur pushon ushtrimin e veprimtarisë ose kur është i detyruar ta pushojë atë. Në një rast të tillë ai çregjistrohet nga regjistri, në përputhje me nenet 48 deri në 53 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”.

shërbimeve në treg, por personat fizikë tregtarë, ndryshe nga shoqëritë, e gëzojnë personalitetin juridik edhe para regjistrimit në QKB.

Te tillë, konsiderohen personat fizik që zhvillojnë aktivitet tregtar dhe nxjerrin përfitime, për llogari dhe në emrin e tyre personal. Ndërsa te shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar aktiviteti tregtar nuk ushtrohet nga ortakët themelues, por nga vetë shoqëria tregtare, në emër dhe për llogari të shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar. Përfitimi i ortakëve të shoqërisë vjen për shkak të ndarjes së dividendit, si një pjesë e fitimit neto të realizuar gjatë vitit financiar të shoqërisë. Ortakët e SHPK-së nuk marrin cilësinë e tregtarit dhe nuk kanë detyrimisht rol aktiv në kryerjen e veprimtarisë tregtare.

Në Ligjin 7632/1992 “Për dispozitat që rregullojnë pjesën e parë të Kodit Tregtar”⁴⁸¹ tashmë të shfuqizuar ishte bërë dhe një përkufizim i veprimeve tregtare në nenin 3 të tij. Me qëllim për ta bërë sa më të lehtë dallimin e SHPK-së nga tregtari si person fizik mund të sjellim në vëmendje per ilustrim dhe këtë dispozitë të Kodit Tregtar të vitit 1992 tashmë të shfuqizuar. Sipas këtij përkufizimi, konsiderohen veprime tregtare blerja me qëllim rishitjeje, veprimet e sipërmarrjes në fusha të ndryshme, veprimet bankare dhe të këmbimit, si dhe veprimet e ndërmjetësimit, spedicionit dhe përfaqësimit tregtar.⁴⁸²

Cilësia e tregtarit (si person fizik), përveç sferës së veprimeve tregtare të përfshira në përkufizimin tradicional të mësipërm, në shumë raste të parashikuar nga ligje të posaçme lidhet ngushtë me kryerjen e veprimeve tregtare nëpërmjet ushtrimit të profesionit të personit fizik (profesionet e lira).⁴⁸³

Ushtrimi i një aktiviteti profesional në mënyrë të pavarur, të vazhdueshme dhe nën përgjegjësinë personale, me qëllim nxjerrjen e përfitimeve perkatese financiare, sipas ligjit i obligon qytetarët që të regjistrohen pranë QKB si tregtar (person fizik).⁴⁸⁴

⁴⁸¹ Ligji 7632/1992 “Për Dispozitat që Rregullojnë Pjesën e Parë të Kodit Tregtar” [1992] FZ 8 (shfuqizuar).

⁴⁸² Sipas nenin 2 të ligjit 7632/1992 “Për Dispozitat që Rregullojnë Pjesën e Parë të Kodit Tregtar” përcaktohet se:

“Konsiderohen veprime tregtare veçanërisht:

- 1. Blerja me qëllim rishitjeje, shitja që rrjedh nga një blerje e mëparshme e bërë me qëllim rishitjeje, si dhe përgjithësisht çdo veprim shkëmbimi i lidhur me një veprim tjetër shkëmbimi.*
- 2. Çdo akt, sipërmarrjeve industriale, të ndërtimit, të shfrytëzimit të minierave, të transportit, të sigurimeve, të magazinimit, të shfaqjeve publike, të reklamës, të botimit e të shtypshkrimit joartizanal.*
- 3. Çdo operacion bankar ose këmbimi.*
- 4. Të gjitha operacionet e ndërmjetësisë ose të spedicionit dhe ato të përfaqësusve tregtarë.”*

⁴⁸³ Ligji 9901/2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” i ndryshuar, në nenin 2 pika 2 përcaktohet se: “Personi fizik, i cili ushtron një profesion të pavarur (si avokat, noter, kontabilist, mjek, inxhinier, arkitekt, artist etj.), vlerësohet tregtar, nëse një ligj i posaçëm i ngarkon këtë status”

⁴⁸⁴ Sipas nenit 22 të ligjit 9723/2007 “Per Qendrën Kombëtare të Biznesit” i ndryshuar parashikohet që:

- “1. Subjektet që detyrohen të regjistrohen janë:*
 - a) subjektet tregtare;*

Në nenin 5 të ligjit Nr.10 171, datë 22.10.2009 “Për profesionet e rregulluara në Republikën e Shqipërisë”⁴⁸⁵ përcaktohen disa nga profesionet e lira të rregullura, ndërsa në pikën 2 të këtij neni, referohet edhe në ligje të tjera të posaçme, si psh. Ligji Nr. 55/2018 “Për Profesionin e Avokatit në R.SH.”,⁴⁸⁶ ligji Nr. 110/2018 “Për Noterinë”⁴⁸⁷ etj.

Tregtarët, ashtu si shoqëritë tregtare, e ushtrojnë veprimtarinë e tyre nën emrin e regjistruar prej tyre në QKB. Emri i tregtarit është emri i tij, sipas nenit 5 të Kodit Civil, i regjistruar në përputhje me nenin 30 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”. Tregtari dhe shoqëritë tregtare mund të përdorin dhe emërtime tregtare, si dhe shenja të tjera dalluese të veprimtarisë dhe i regjistrojnë këto në përputhje me nenin 44 pika 1 shkronja “a” të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”.⁴⁸⁸

Në kuadër të ushtrimit të aktivitetit tregtar, personat fizikë përgjigjen për detyrimet ndaj të tretëve me të gjithë pasurinë e tyre dhe të drejtat e tyre të tashme dhe të ardhshme, përfshirë pasuritë e luajtshme e të paluajtshme, dhe çdo pasuri tjetër, vlera e të cilave mund të shprehet në para.⁴⁸⁹

b) shoqëritë e thjeshta, sipas dispozitave të Kodit Civil;

c) personat fizikë, sipas kuptimit të Kodit Civil, që nuk kanë cilësinë e tregtarit, që ushtrojnë veprimtari ekonomike apo një profesion të pavarur;

ç) zyrat e përfaqësimit të shoqërive shqiptare dhe të shoqërive të huaja;

d) shoqëritë dhe unionet e kursim-kreditit;

dh) shoqëritë e bashkëpunimit të ndërsjellë;

e) çdo subjekt tjetër, i cili me ligj detyrohet të regjistrohet pranë QKR.

2. Përveçse kur një ligj i posaçëm parashikon ndryshe, nuk detyrohen të regjistrohen në regjistër personat fizikë, në kuptimin e Kodit Civil, të përcaktuar me urdhër të përbashkët të ministrit dhe të Ministrit të Financave, që veprojnë si punëdhënës apo të vetëpunësuar në fusha të posaçme apo që ushtrojnë një veprimtari me vëllim të vogël qarkullimi.

3. Subjektet, përveç kur parashikohet ndryshe nga ligje të posaçme, aplikojnë për regjistrim fillestar si më poshtë:

a) personat fizikë, shoqëritë e thjeshta dhe degët apo zyrat e përfaqësimit, përpara datës së nisjes efektive të veprimtarisë;

b) personat juridikë, brenda 30 ditëve kalendarike nga data e themelimit, por, në çdo rast, përpara datës së nisjes efektive të veprimtarisë.”

⁴⁸⁵ Ligji 10171/2009 i ndryshuar në nenin 5 të tij përcaktohet se:

“1. Profesionet e rregulluara në Republikën e Shqipërisë janë profesioni i: a) mjekut; b) stomatologut; c) farmacistit; ç) infermierit; d) mamisë; dh) fizioterapistit; e) veterinerit; ë) arkitektit; f) inxhinierit; g) mësuesi; gj) punonjësi social; h) psikologu.

2. Profesionet e rregulluara janë edhe profesionet e përcaktuara si të tilla me ligje të tjera, të veçanta.”

Ligji 10171/2009 “Për profesionet e rregulluara në Republikën e Shqipërisë” [2009] FZ 154 ndryshuar për here të fundit me Ligjin 90/2016 “për një shtesë në ligjin nr. 10 171, datë 22.10.2009, “Për Profesionet e Rregulluara në Republikën e Shqipërisë” [2016] FZ 126.

⁴⁸⁶ Ligji 55/2018 “Për Profesionin e Avokatit në Republikën e Shqipërisë” [2018] FZ 123, neni 14 pika 1 germa “b”.

⁴⁸⁷ Ligji 110/2018 “Për Noterinë” [2018] FZ 16, neni 20.

⁴⁸⁸ ligjit 9723/2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit” i ndryshuar, neni 44.

⁴⁸⁹ Ligji 9901/2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” i ndryshuar, neni 2 pika 6.

Ndërsa ortakët e SHPK-së mbajnë përgjegjësi të kufizuar për humbjet, dhe detyrimet ekonomiko-financiare të shoqërisë ndaj të tretëve. Kufiri i përgjegjësisë së ortakut është, të shlyejë vlerën për të cilën ai ortak ka nënshkruar në statut, se do ta ofrojë si kontribut në kapitalin fillestar në themelimin e shoqërisë. Nga momenti që ortakët e SHPK-së kanë shlyer këtë kontribut ata nuk kanë asnjë përgjegjësi për humbjet dhe detyrimet që shoqëria ka ndaj të tretëve, dhe normalisht janë të “imunizuar” ndaj risqeve të cenimit të pasurive të tyre personale për shkak të detyrimeve të shoqërisë. Megjithatë ky rregull ka përjashtimet e veta, që lidhen me rastet e zhveshjes së ortakut nga petku i përgjegjësisë së kufizuar të parashikuar në nenin 16 të ligjit (siç u analizua më lart).⁴⁹⁰

4.5. Veçoritë e shoqërisë së thjeshtë në dallim nga shoqëria me përgjegjësi të kufizuar

Kodi Civil rregullon organizimin e dy ose më shumë personave në një bashkëpunim tregtar, të quajtur "*Shoqëria e thjeshtë*".⁴⁹¹ Shoqëria e thjeshtë formohet mbi bazën e vullnetit të dy ose më shumë personave, të cilët hartojnë një kontratë me objekt ushtrimin e përbashkët të aktivitetit tregtar, dhe ndarjen e fitimeve mes tyre sipas marrëveshjes. Në këtë marrëveshje ata bien dakord dhe për mënyrën e kontributit që do të ofrojë secila palë në kontratë, me para, sende ose shërbime.⁴⁹² Kontrata e shoqërisë së thjeshtë, sipas Kodit Civil nuk kërkon një formë solemne të veçantë, përveç se kur kjo formë vjen për shkak të disponimit të pasurive të paluajtshme, për të cilat kontrata duhet të bëhet me akt noterial.⁴⁹³

Por, në dallim nga Shpk-të, dhe në tërësi nga shoqëritë tregtare, të cilat gëzojnë personalitet të pavarur juridik, shoqëritë e thjeshta nuk kanë personalitet të pavarur juridik. Pra këto shoqëri nuk mund të konsiderohen entitete të pavaruara juridike. Për rredhje, nuk mund të hyjnë në një marrëdhënie juridike si subjekt i pavarur nga anëtarët e shoqërisë dhe as të thirren si palë në një proces gjyqësor. Në këto kushte shoqëria e thjeshtë nuk mund të identifikohet si subjekt i së drejtës, por janë anëtarët që kanë nënshkruar kontratën e shoqërisë, të cilët marrin përsipër të drejtat dhe detyrimet në emrin e tyre personal.⁴⁹⁴

⁴⁹⁰ Ligji 9901/2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” i ndryshuar, neni 16.

⁴⁹¹ Kodi Civil, neni 1074 e vijues.

⁴⁹² Kodi Civil, në nenin 1074 parashikon që:

"Shoqëria është një kontratë, me të cilën dy apo më shumë persona merren vesh për të ushtruar një aktivitet ekonomik, me qëllim që të ndajnë fitimet që rrjedhin prej tij. Personi anëtar i shoqërisë duhet të vërë në dispozicion të këtij aktiviteti para, sende apo shërbime".

⁴⁹³ Në nenin 1075 të Kodit Civil parashikohet që:

"Në shoqërinë e thjeshtë kontrata nuk është objekt i ndonjë forme të veçantë, përveç kur kërkohet nga natyra e sendeve të bashkuara. Shoqëria është e thjeshtë, kur nuk paraqet cilësitë dalluese të shoqërisë tregtare të rregulluara në Kodin Tregtar."

⁴⁹⁴ Në nenin 1088 të Kodit Civil përcaktohet se:

"Shoqëria fiton të drejta dhe merr përsipër detyrime me anë të anëtarëve që kanë të drejtën për ta përfaqësuar. Në mungesë të dispozitave të tjera në kontratë, përfaqësimi i takon çdo anëtar administrator dhe shtrihet për të gjitha aktet që përfshihen në objektin e shoqërisë. Ndryshimet dhe shuarja e tagrave të përfaqësimit rregullohen me dispozitat për përfaqësimin."

Gjithashtu administrimi i veprimtarisë tregtare në një shoqëri të thjeshtë iu lejonet të gjithë anëtarëve të saj, si rrjedhim të gjithë anëtarët mund të kenë rol aktiv në këtë aktivitet, ndryshe nga ortakët e një shpk-je.

Në këtë konkluzion ka arritur edhe jurisprudenca shqiptare, e cila nuk e konsideron shoqërinë e thjeshtë si subjekt me personalitet juridik. Në vendimin Nr. 1416 dt. 26.05.2017 Gjykata e Apelit Tiranë⁴⁹⁵ ka vendosur prishjen e vendimit Nr. 9397 dt. 21.11.2016 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë,⁴⁹⁶ për arsye të shkeljeve procedurale për sa i përket ndërgjyqësisë. Sipas gjykatës së Apelit pala e paditur **** si shoqëri e thjeshtë nuk gëzon personalitet juridik, si e tillë nuk mund të thirrej shoqëria e thjeshtë si palë e paditur, por subjektet që janë palë në kontratën e shoqërisë së thjeshtë.

Megjithatë, në doktrinën shqiptare ka edhe mendime të ndryshme, të cilat konsiderojnë se edhe shoqëria e thjeshtë duhet të trajtohet si subjekt me personalitet juridik, e aftë për të marrë përsipër të drejta dhe detyrime, apo për të qenë palë ndërgjyqëse.⁴⁹⁷ Por, opinione të tilla nuk rezultojnë të kenë një mbështetje bindëse në kuadrin ligjor shqiptar.

Në nenin 22 pika 1 germa "b" të ligjit 9723/2007 për QKB-në i cituar me lart parashikohet detyrimi për të regjistruar shoqërinë e thjeshtë në Regjistrin tregtar të QKB-së.⁴⁹⁸ Fakti që shoqëria e thjeshtë ka detyrimin për t'u regjistruar në QKB, nuk do të thotë që kjo ortakëri e shoqërisë së thjeshtë u nënshtrohet rregullave të shoqërive tregtare të parashikuara në ligjin 9901/2008. Kjo pasi shoqëria e thjeshtë nuk ka personalitet juridik dhe nuk gëzon cilësinë e subjektit të së drejtës. Në Ligjin Nr.9723/2007 "Për QKB", parashikohen se cilat janë subjektet që kanë detyrimin për regjistrim në QKB. (e cila nga viti 2015 ka marrë emrin Qendra Kombëtare e Biznesit). Megjithëse është përdorur terminologjia "subjekte që detyrohen për regjistrim", kjo nuk u jep shoqërive të thjeshta personalitet juridik.

E njëjta gjë mund të thuhet dhe për kategorinë e "Degëve" dhe "Zyrave të përfaqësimit" të shoqërive të huaja, të parashikuara në pikën "ç" të këtij neni.⁴⁹⁹ Por, ky parashikim është bërë për t'i shërbyer legjislacionit fiskal dhe institucioneve të ndryshme, si Inspektorati i Punës e të tjerë, për të identifikuar të gjitha sipërmarrjet dhe angazhimet në fushën e aktiviteteve tregtare.

Ky konkluzion konfirmohet edhe nga neni 53 i ligjit 9723/2007 për QKB, në të cilin përcaktohet shprehimisht që shoqëritë e thjeshta, të themeluara sipas Kodit Civil, nuk

⁴⁹⁵ Shih Vendimin Nr. 1416 dt. 26.05.2017 Gjykata e Apelit Tiranë.

⁴⁹⁶ Vendimi Nr. 9397 dt. 21.11.2016 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë

⁴⁹⁷ Për më shumë shih Arbër Gjeta, "Shoqëria e thjeshtë midis Kodit Civil dhe legjislacionit tregtar" (2019) 31 Revista Avokatia.

⁴⁹⁸ Ligji 9723/2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit" i ndryshuar, neni 22/1 germa "b".

⁴⁹⁹ Ligji 9723/2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit" i ndryshuar, neni 22/1 germa "ç".

përfitojnë personalitet juridik nëpërmjet regjistrimit në QKB, për pasojë edhe çregjistrimi ka vetëm efekt deklarativ. Ndërsa, për një shoqëri tregtare si SHPK-ja, çregjistrimi ka dhe efektin e shuarjes së personalitetit juridik të kësaj shoqërie.⁵⁰⁰

Ndryshe nga SHPK-ja, shoqëria e thjeshtë, duke mos pasur personalitet juridik, nuk mund të konsiderohet si subjekt më vete i së drejtës as në aspektin fiskal. Siç përcaktohet në dispozitat përkatëse të Kodit Civil, janë anëtarët e saj që mbartin të gjitha të drejtat dhe detyrimet, duke caktuar njërin prej tyre si përfaqësues, ose duke qenë secili përfaqësues i saj.⁵⁰¹ Ortakët e shoqërisë së thjeshtë mund të barazohen për nga cilësia me kategorinë e "tregtarit si person fizik", i parashikuar në ligjin për tregtarët dhe shoqëritë tregtare të analizuar më lart.

Ndryshe nga ortakët e një shoqërie të thjeshtë, ortakët e një shpk-je nuk mbajnë përgjegjësi financiare për humbjet e shoqërisë. Më saktë, ata kanë përgjegjësi financiare dhe pasurore të kufizuar, vetëm për të shlyer masën e kontributit të tyre në shoqëri dhe nga momenti që kanë shlyer këtë kontribut, nuk kanë asnjë përgjegjësi për humbjet apo detyrimet financiare të shoqërisë ndaj të tretëve (përveç rasteve përjashtimore të nenit 16 të ligjit për tregtarët dhe shoqëritë tregtare të analizuar më lart).⁵⁰² Ky dallim është i rëndësishëm në praktikë pasi shpesh krijohet një konfuzion në trajtimin e këtyre instituteve të ndryshme, pra mes shoqërive të thjeshta, të cilat nuk janë shoqëri tregtare dhe shoqërive tregtare.⁵⁰³

Një dallim të qartë mes shoqërive të thjeshta dhe shoqërive tregtare ka bërë edhe ligji nr. 48/2014 "Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare" në nenin 3 pika 3 të tij, kur bën përkufizimin e "sipërmarrjes tregtare" e përjashton shoqërinë e thjeshtë, duke e limituar vetëm në rrethin e subjekteve tregtare që janë persona juridikë.⁵⁰⁴ Ky parashikim i përjashtimit të shoqërisë së thjeshtë nga rrethi i subjekteve tregtare prej këtij ligji është bërë objekt i një iniciative për gjykim incidental në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë në çështjen me Nr 951 Akti dt. 12.02.2015 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor

⁵⁰⁰ Ligji 9723/2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit" i ndryshuar, neni 53 përcakton se:
*"Çregjistrimi i personave juridikë nga regjistri tregtar ka si pasojë humbjen e personalitetit juridik të subjekteve, përveç rasteve kur parashikohet ndryshe nga ligje të posaçme.
Çregjistrimi nga regjistri tregtar i personave fizikë, degëve dhe zyrave të përfaqësimit të shoqërive të huaja, shoqërive të thjeshta, sipas Kodit Civil, si dhe të subjekteve të tjera që, sipas legjislacionit në fuqi, nuk fitojnë personalitetin juridik nëpërmjet regjistrimit, ka vetëm efekt deklarativ.
Subjektet e çregjistruara përgjigjen për detyrimet e mbetura ndaj të tretëve dhe ndaj autoriteteve publike, në përputhje me legjislacionin në fuqi".*

⁵⁰¹ Kodi Civil, neni 1088.

⁵⁰² Ligji 9901/2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" i ndryshuar, neni 16.

⁵⁰³ Ligji 9901/2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" i ndryshuar, neni 16 dhe neni 1/1.

⁵⁰⁴ Ligji 48/2014 "Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare" ndryshuar nga ligji "Për një shtesë në ligjin nr. 48/2014, "Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare" [2015] FZ 64, në nenin 3 pika 3 përcakton se: "3. *Sipërmarrje tregtare*" është çdo person juridik, i krijuar sipas ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008, "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", të ndryshuar, me përjashtim të një autoriteti publik, i cili vepron në kuadër të veprimtarisë së tij të pavarur ekonomike a profesionale".

Tiranë. Sipas vendimit të gjykatës:

ky përkufizim i bërë në pikën 3 të nenit 3 të ligjit 48/2014 kufizon sipërmarrjen tregtare vetëm te personat juridikë duke lënë jashtë këtij përkufizimi shoqëritë e thjeshta dhe subjektet tregtare si persona fizikë. Sipas këtij vendimi kjo cenon parimin e barazisë juridike dhe veprimtarisë tregtare dhe kështu, cenon nenet 18, 11 dhe 70 të Kushtetutës së R. Sh.⁵⁰⁵

Gjykata Kushtetuese e R.SH me vendimin Nr. 85 dt. 29.05.2015 ka vendosur të mos e kalojë për shqyrtim çështjen në seancë plenare, pasi nuk plotëson kushtet për gjykim incidental. Sipas këtij vendimi Gjykata Kushtetuese ka vlerësuar:

se neni 3/3 i ligjit 48/2014 me mosparashikimin e shoqërive të thjeshta në kategorinë e sipërmarrjeve tregtare, nuk passjell cenim të barazisë dhe lirisë ekonomike, pasi shoqëria e thjeshtë nuk është subjekt i të drejtës tregtare.⁵⁰⁶

Dallimin mes këtyre shoqërive e ka bërë edhe legjislacioni fiskal. Për efekt të zbatimit të ligjit 8438/1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, duhet bërë kujdes që të mos konfondohej koncepti i shoqërisë së thjeshtë me atë të një shoqërie tregtare si psh.: një SHPK-je apo SHA-je, pasi do të konfondohej dhe procesi i ndarjes së dividendit nga fitimi i realizuar tek shoqëritë tregtare, me ndarjen e fitimit të realizuar nga ortakët që kanë lidhur kontratën e shoqërisë së thjeshtë. Në zbatimin e legjislacionit fiskal,⁵⁰⁷ ortakët e shoqërisë së thjeshtë (ndryshe nga ortakët e shoqërive tregtare në përgjithësi dhe të SHPK-së në veçanti,) përfitojnë lehtësirat fiskale që ligji i njuh personit fizik tregtar, pasi shoqëria e thjeshtë nuk është subjekt i së drejtës më vete, por bashkim i disa personave fizikë tregtarë, të cilët ushtrojnë aktivitetin të tyre në menyrë të përbashkët. Udhëzimi nr.5 dt.30.01.2006 i ndryshuar i Ministrisë të Financave, parashikon se tatimi mbi të ardhurat personale, përfshin të gjitha llojet e të ardhurave të individëve, të parashikuara nga ligji.⁵⁰⁸

Në kuptim të nenit 8 të ligjit nr.8438/1998, të ardhura të tatueshme për qëllim të tatimit mbi të ardhurat personale përfshihen edhe të ardhurat që përfitojnë individët, në formën e ndarjes së fitimit nga ortakëritë, apo të dividendit nga shoqëritë tregtare. Në të ardhurat e tatueshme sipas kësaj pike nuk përfshihet fitimi neto (pas pagimit të tatimit mbi fitimin, apo tatimit të thjeshtuar mbi fitimin mbi biznesin e vogël) i personave fizikë tregtarë,

⁵⁰⁵ Vendimi Nr 951 Akti dt. 12.02.2015 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

⁵⁰⁶ Vendimi Nr. 85 dt. 29.05.2015 i Gjykatës Kushtetuese të R.SH.

⁵⁰⁷ Ligji 8438/1998 “Për tatimin mbi të ardhurat” [1998] FZ 32 i ndryshuar për herë të fundit me ligjin 94/2018 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat” [2018] FZ 183; Vendim i Këshillit të Ministrave 285/2007 “Për përcaktimin e pagës referuese mujore, për efekt të llogaritjes së kontributeve të sigurimeve shoqërorë dhe shëndetësore, dhe të tatimit mbi të ardhurat personale, sipas nomenklaturës së veprimtarisë ekonomike, për të punësuarit në sektorin jopublik që kryejnë punë, të pakualifikuara e të kualifikuara, si dhe për personelin drejtues tekniko-ekonomik të tyre” [2007] FZ 59.

⁵⁰⁸ Udhëzimi i Ministrisë të Financave 5/2006 “Për Tatimin mbi të Ardhurat i ndryshuar” [2006] ndryshuar me Udhëzim 14/2014 [2014] FZ 80.

pavarësisht nëse këta të fundit janë subjekt i tatimit mbi fitimin apo tatimit të thjeshtuar mbi fitimin mbi biznesin e vogël. Të ardhurat e personit fizik tregtar nga ushtrimi i aktivitetit tregtar taten vetëm sipas kreut III "Tatimi mbi fitimin" (nenet 16-32 të ligjit) në rastin e subjekteve me xhiro mbi 8 milionë lekë në vit dhe sipas ligjit nr. 9632/2006, për subjektet me xhiro deri në 8 milionë lekë në vit.

Personi fizik tregtar nuk ka personalitet juridik të ndryshëm nga individi (i regjistruar si tregtar), ndryshe nga rasti i shoqërive tregtare, dhe rrjedhimisht fitimi neto i personit fizik tregtar nuk konsiderohet si e ardhur personale e individit, subjekt i pikës "g" të nenit 8 të ligjit. Togfjalëshi "*ndarja e fitimit nga ortakëritë*" nuk duhet të përfshijë ortakët e shoqërisë së thjeshtë. Ky togfjalësh "*ndarja e fitimit nga ortakëritë*" i referohet fjalisë së parë dhe është shpjegim se çfarë duhet të kuptojme me "*Të ardhurat që rrjedhin nga fitimi i ortakut apo i aksionerit në shoqërinë tregtare (pika b) e paragrafit*". Pra i referohet ortakërisë së një shoqërie tregtare, e cila mund të ketë më shumë se një ortak, ose aksionerë, por jo personave fizike që kanë lidhur kontratën e shoqërisë së thjeshtë, e cila nuk konsiderohet si shoqëri tregtare në asnjë rast. Si rrjedhim, edhe ortakët apo anëtarët e një shoqërie të thjeshtë të formuar me kontratë sipas Kodit Civil, përfshihen në përjashtimin e parashikuar në nenin 2.3.3 të udhëzimit nr.5 dt.30.05.2006⁵⁰⁹ dhe kanë një trajtim të ndryshëm fiskal nga ortakët e shoqërive tregtare.

Megjithatë duhet të evidentojmë dhe faktin se mes shoqërive tregtare dhe shoqërive të thjeshta ka dhe disa pika ndërthurjeje. Në praktikën e sipërmarrjeve tregtare ka dhe raste kur disa shoqëri tregtare të organizuara si persona juridikë (për shembull, SHPK ose SHA) kanë themeluar një shoqëri të thjeshtë në përputhje me dispozitat e Kodit Civil.⁵¹⁰ Në këto raste subjektet e organizuara si shoqëri tregtare me personalitet juridik të pavarur, shprehin vullnetin nëpërmjet kontratës së shoqërisë së thjeshtë, që të bashkëpunojnë me njëri-tjetrin, për një projekt të veçantë dhe të përcaktojnë rregullat e këtij bashkëpunimi. Ky bashkëpunim është njohur dhe si bashkim operatorësh ekonomikë dhe nganjëherë, përdoret termi anglez "Joint Venture"(JV).⁵¹¹ Megjithatë ky bashkim operatorësh (personash juridikë) nuk fiton personalitet juridik të veçantë sipas ligjit shqiptar.

⁵⁰⁹ Neni 2.3.3 të udhëzimit nr.5 dt.30.05.2006:

"2.3.3 Të ardhurat që rrjedhin nga fitimi i ortakut apo i aksionerit në shoqërinë tregtare (pika b) e paragrafit 1. Në kuptim të kësaj pike, bëhet fjalë për të ardhurat që përfitojnë individët, në formën e ndarjes së fitimit nga ortakëritë, apo të dividendit nga shoqëritë tregtare. Në të ardhurat e tatueshme sipas kësaj pike nuk përfshihet fitimi neto (pas pagimit të tatimit mbi fitimin apo tatimit të thjeshtuar mbi fitimin mbi biznesin e vogël) i personave fizikë tregtarë, pavarësisht nëse këta të fundit janë subjekt i tatimit mbi fitimin apo tatimit të thjeshtuar mbi fitimin mbi biznesin e vogël. (Ndryshuar me Udhëzim Nr.14, dt. 23.05.2014. Botuar në Fletore Zyrtare Nr. 80, dt. 4 qershor 2014)."

⁵¹⁰ Arbër Gjeta, "Shoqëria e thjeshtë midis Kodit Civil dhe legjislacionit tregtar" (2019) 31 Revista Avokatia.

⁵¹¹ Kathryn Rudie Harrigan, *Strategies for Joint Ventures* (Lexington Books 1985) fq. 148-150.

4.6. Veçoritë kryesore të SHPK-së në dallim nga shoqëritë e personit

Në doktrinën e së drejtës tregtare ka ekzistuar një ndarje mes shoqërive tregtare, në dy kategori si; “shoqëri të personit” dhe “shoqëri të kapitalit”.⁵¹² Megjithatë, kjo ndarje nuk është plotësisht e qartë dhe kategorike, pasi edhe shoqëritë tregtare kanë evoluar dhe janë përshtatur me nevojat, kërkesat dhe ekzizjencat e sipërmarrësve dhe kapacitetet e tregut në vende dhe realitete të ndryshme.

Në doktrinën e të drejtës tregtare⁵¹³ është bërë një kategorizim i shoqërive tregtare në dy grupe, shoqëri personi dhe shoqëri kapitali. Shoqëritë kolektive dhe shoqëritë komandite janë konsideruar si shoqëri të personit. Ndërsa shoqëritë me përgjegjësi të kufizuara dhe shoqëritë aksionare (të njohura dhe me termin shoqëri anonime) janë konsideruar si shoqëri kapitali.

Sipas kësaj ndarjeje doktrinare të shoqërive tregtare, karakteristika kryesore e shoqërive të personit, është fakti që te këto shoqëri paraqesin një rëndësi thelbësore cilësitë personale të ortakut, (*intuitu personae*) në lindjen e bashkëpunimit mes ortakëve për ushtrimin e sipërmarrjes tregtare, por edhe përsa i përket përgjegjësisë personale të ortakut të shoqërisë, në aspekt të përbushjes së detyrimeve në raport me të tretët.

Janë pikërisht cilësitë personale të ortakut, të cilat bëjnë që të ndërtohet një raport besimi reciprok mes ortakëve dhe të themelojnë një shoqëri kolektive ose komandite, sepse besojnë që bashkimi i këtyre personave si ortakëri do të garantojë më shumë sukses në sipërmarrjen tregtare të ardhshme.

Nga ana tjetër, për kreditorët e këtyre shoqërive paraqet një rëndësi shumë të madhe njohja e personave që janë ortakë të këtyre shoqërive, dhe cilësitë personale të tyre, në marrëdhënjet tregtare që do të krijojnë. Kreditorët e shoqërisë së personit, kanë parasysh që kredinë e tyre mund ta shlyejnë edhe duke iu drejtuar secilit prej ortakëve, pasi ata kanë përgjegjësi të pakufizuar për detyrimet e shoqërisë.

Ndërsa në shoqëritë e kapitalit, sipas doktrinës së të drejtës tregtare,⁵¹⁴ cilësitë personale të ortakëve apo aksionerëve nuk paraqesin ndonjë rëndësi të madhe. Kjo, pasi garancia për suksesin e këtyre shoqërive bazohet në akumulimin e një kapitali të konsiderueshëm në nisje të aktivitetit të tyre dhe mirëadministrimi i këtyre shoqërive në përputhje me parimet

⁵¹² Argita Malltezi, *E drejta shqiptare e shoqërive tregtare* (Shtëpia botuese Mediaprint 2011) fq. 45.

⁵¹³ Galgano (n 200) fq. 231 e vijim.

⁵¹⁴ Galgano (n 200) fq. 391 e vijim.

e mirëqeverisjes së korporatave.⁵¹⁵ Në kushtet kur ortakët (apo aksioneret) e këtyre shoqërive tregtare kanë përgjegjësi të kufizuar financiare vetëm për të shlyer kontributin në kapitalin e shoqërisë dhe jo më tepër, kreditorët e këtyre shoqërive tregtare kanë si garanci për rikuperimin e kredive të tyre kapitalet dhe asetet financiare të shoqërisë dhe jo ato të personave që janë ortakë të shoqërisë. Për këtë arsye, këto shoqëri janë konsideruar si shoqëri kapitali dhe jo shoqëri personi.

Në realitetin shqiptar, shoqëria me përgjegjësi të kufizuar ka disa karakteristika të shoqërisë së kapitalit, por ajo ka dhe disa karakteristika të shoqërisë së personit dhe për këtë arsye konsiderohet se kjo formë shoqërie qëndron në kufirin ndarës mes shoqërive të kapitalit dhe shoqërive të personit. Këto karakteristika të dyfishta të SHPK-ve, të cilat i bëjnë ato shoqëri me natyrë mikse, do të trajtohen në mënyrë të zgjeruar në vijim të këtij punimi.

4.7. Dallimi i SHPK-së në raport me Shoqërinë Kolektive

Së pari, në shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar të gjithë ortakët e shoqërisë kanë përgjegjësi të kufizuar për humbjet e shoqërisë. Ky është një avantazh i madh për ortakët e shoqërisë dhe për të gjithë personat, të cilët janë duke vlerësuar se cilën formë të shoqërisë të zgjedhin për të ushtruar aktivitetin e tyre tregtar.

Ndërsa ortakët e një shoqërie kolektive mbajnë përgjegjësi të pakufizuar për humbjet e shoqërisë ndaj të tretëve, me të gjithë pasurinë e tyre, të tashme dhe të ardhme, pa kufizim.⁵¹⁶ Kjo do të thotë që, në rast se kreditorët e një shoqërie kolektive, pasi kanë bërë të gjitha përpjekjet për të rikuperuar kredinë e tyre te shoqëria kolektive, por kapitalet e shoqërisë janë të pamjaftueshme, atëherë ata legjitimohen që këto kredi dhe shuma financiare t'i rikuperojnë duke i detyruar ortakët e shoqërisë kolektive që me pasurinë e tyre personale, të tashme dhe të ardhme, të shlyejnë detyrimet e shoqërisë ku ata janë ortakë. Neni 40 i ligjit përcakton se kjo përgjegjësi e pakufizuar e ortakëve të një shoqërie kolektive është një përgjegjësi solidarë.⁵¹⁷ Pra, kreditorët e shoqërisë kolektive mund të kërkojnë shlyerjen e detyrimit, edhe duke iu drejtuar vetëm njërit prej ortakëve, i cili ka më shumë kapacitet financiar dhe pasuror, pavarësisht se këto pasuri të ortakut nuk kanë asnjë lidhje me shoqërinë dhe as me ortakët e tjerë.

⁵¹⁵ OECD, "Kodin Etik të Qeverisjes së Korporatave dhe Parimet e Mirëqeverisjes së korporatave të OECD" (n 424); Drejtoria e Politikave të Konkurrueshmërisë së Ekonomisë, "Kodi i Drejtimit të Brendshëm të Shoqërive Tregtare në Shqipëri" (n 424).

⁵¹⁶ Ligji 9901/2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" i ndryshuar, neni 22 dhe neni 40.

⁵¹⁷ Neni 40/1 i Ligjit 9901/2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" i ndryshuar përcakton se: "*Ortakët përgjigjen personalisht e në mënyrë solidarë për detyrimet e shoqërisë me të gjitha pasuritë e tyre. Çdo marrëveshje, në kundërshtim me këtë dispozitë, nuk prodhon efekte ndaj palëve të treta*".

Për shembull, në rast se njëri prej ortakëve ka një gjendje pasurore më të mirë për shkak të trashëgimisë familjare apo burime të tjera të tij personale, kreditori mund t'i kërkojë këtij ortakut që të shlyejë të gjithë shumën e kredisë së tij, pikërisht sepse mundësia për rikuperimin e borxhit është më e madhe dhe e sigurtë. Në një rast të tillë, sipas rregullave të përgjegjesisë solidarë, të përcaktuara në Kodin Civil,⁵¹⁸ ky ortak, i cili shlyen një detyrim të shoqërisë, ka të drejtën e kompensimit nga ortakët e tjerë për pjesën e detyrimit që secili prej tyre duhet të paguante. Në rast se ky ortak nuk kompensohet, ai ka të drejtë të ngrejë padinë e regresit dhe të kërkojë rikuperimin e këtij kompensimi nga ortakët e tjerë. Megjithatë, ai gjithmonë do të jetë i ekspozuar ndaj riskut të pamundësisë financiare të ndonjërit prej ortakëve të tjerë për të shlyer këtë detyrim, të ortakut që ka paguar borxhet e shoqërisë. Pra është lehtësisht e kuptueshme, që koncepti i përgjegjesisë së kufizuar të shoqëria me përgjegjësi të kufizuar është një avantazh shumë i madh në raport me shoqërinë kolektive, ku ortakët kanë përgjegjësi të pakufizuar për humbjet e shoqërisë ndaj të tretëve.

Praktika e deritanishme në nivel global ka treguar që sipërmarrjet tregtare të çdo lloji, përfshirë dhe ato që organizohen në një nga katër format e shoqërive tregtare, shoqërohen edhe nga faktori i pasigurisë në raport me suksesin apo dështimin e tyre, në aspektin ekonomik. Si rrjedhim, edhe risku i ekspozimit për të shlyer borxhet e shoqërisë, në një të ardhme të papërcaktuar, është relativisht i lartë për ortakët që kanë përgjegjësi të pakufizuar. Sipas statistikave të publikuara për vitin 2017, në nivel evropian rezulton se një në pesë biznese të hapura në Evropë, ka falimentuar që në vitin e parë, ndërsa në tri vitet e para, vetëm dy të tretat e bizneseve mbijetojnë, ndërsa në pesë vitet e para, vetëm gjysma (50%) e bizneseve mbijetojnë.⁵¹⁹ Kjo është dhe një nga arsyt kryesore që ka bërë formën e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar si formën më tërheqëse dhe më të aplikuar nga të gjitha subjektet që themelojnë një shoqëri tregtare, në vendin tonë.

Nga statistikat e vëna në dispozicion nga Qendra Kombëtare e Biznesit⁵²⁰ rezulton se në vitin 2020 në Regjistrin Tregtar të këtij institucioni figurojnë të regjistruara 58.084 shoqëri me përgjegjësi të kufizuara. Ndërsa numri i shoqërive kolektive të regjistruara deri në fund të vitit 2020, është 449 ose vetëm 0.7% e numrit të shoqërive me përgjegjësi të kufizuar.⁵²¹

⁵¹⁸ Sipas nenit 430/2 të Kodit Civil përcaktohet se; “Debitori që ka ekzekutuar një detyrim solidar, ka të drejtë të kërkojë nga debitorët e tjerë pagimin në pjesë të barabarta të detyrimit të ekzekutuar prej tij, përveç kur në ligj ose në kontratë është parashikuar ndryshe.”


⁵¹⁹ D Clark, “Business survival rates in selected European countries in 2017, by length of survival” (9 Shtator 2020) <<https://www.statista.com/statistics/1114070/eu-business-survival-rates-by-country-2017/>> aksesuar më 17 tetor 2020.

⁵²⁰ Kthim përgjigje në format elektronik nga Qendra Kombëtare e Biznesit dt. 16.10.2020 (Drejtoria e Analizës dhe Regjistrave) kërkesës së autorit të këtij punimi të paraqitur pranë QKB-së me Nr. 8640 prot., datë 24.09.2020.

⁵²¹ Kthim përgjigjeje në format elektronik nga Qendra Kombëtare e Biznesit dt. 16.10.2020 (Drejtoria e Analizës dhe Regjistrave) kërkesës së autorit të këtij punimi paraqitur pranë QKB me Nr. 8640 prot., datë 24.09.2020.

Ndërkohë që numri total i të katër formave të shoqërive tregtare që njeh ligji Nr.9901/2008 është 60434. Pra, e shprehur në përqindje rezulton se më shumë se 96% e të gjitha shoqërive tregtare të regjistruara në Regjistrin Tregtar, janë shoqëri me përgjegjësi të kufizuar.⁵²² Figurat dhe grafikët më poshtë ilustronjë këto të dhëna zyrtare të Qendrës Kombëtare të Biznesit, të gjeneruara në tetor të vitit 2020, sipas kërkesës së autorit të këtij punimi.

Figura 2: Numri dhe vëllimi i shprehur në përqindje i shoqërive tregtare në Republikën e Shqipërisë nga viti 1992 e deri më tetor 2020




Burimi: Drejtoria e Analizës dhe Regjistrave (të dhëna të përpunuara nga autori)⁵²³

⁵²² Kthim përgjigjeje në format elektronik nga Qendra Kombëtare e Biznesit dt. 16.10.2020 (Drejtoria e Analizës dhe Regjistrave) kërkesës së autorit të këtij punimi paraqitur pranë QKB me Nr. 8640 prot., datë 24.09.2020.

⁵²³ Qendra Kombëtare e Biznesit, Drejtoria e Analizës dhe Regjistrave, *Informacion i gjeneruar nga regjistri tregtar - të dhëna statistikore*, kthim përgjigjeje datë 16 tetor 2020 në bazë të kërkesës së Doktorantit Fatri Islamaj protokolluar nga QKB me Nr. 8640 prot., datë 24.09.2020.

Figura 3: Numri dhe vëllimi i shprehur në përqindje i SHPK-ve aktive dhe të çregjistruara në Republikën e Shqipërisë, deri në tetor 2020



Burimi: Drejtoria e Analizës dhe Regjistrave (të dhëna të përpunuara nga autori)⁵²⁴

Së dyti, ligji ka lejuar që një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar të mund të themelohet edhe me një ortak të vetëm, ndërsa një shoqëri kolektive duhet të këtë detyrimisht të paktën dy ortakë.⁵²⁵ Ligji 9901/2008 në nenin 3 të tij, ka bërë një përkufizim për të gjitha shoqëritë tregtare⁵²⁶ ku parashikon se shoqëritë kolektive dhe komandite duhet të kenë dy ose më shumë ortakë, ndërsa SHPK-të dhe SHA-të mund të themelohen edhe nga një orak, apo aksioner i vetëm. Ky parashikim ligjor tregon një aspekt tjetër favorizues për shoqëritë me përgjegjësi të kufizuara në funksion të fleksibilitetit, përshtatshmërisë dhe jetëgjatësisë së tyre në treg.

Për shëmbull, në rast se një shoqëri kolektive, gjatë aktivitetit të saj, mbetet me një ortak atëherë kjo shoqëri duhet të priset dhe të çregjistrohet.⁵²⁷ Pra, nuk mund të vazhdojë

⁵²⁴ Qendra Kombëtare e Biznesit, Drejtoria e Analizës dhe Regjistrave, *Informacion i gjeneruar nga regjistri tregtar - të dhëna statistikore*, kthim përgjigjeje datë 16 tetor 2020 në bazë të kërkesës së Doktorantit Fatri Islamaj protokolluar nga QKB me Nr. 8640 prot., datë 24.09.2020.

⁵²⁵ Argita Malltezi, *E drejta shqiptare e shoqërive tregtare* (Shtëpia botuese “Mediaprint” 2011) fq. 47.

⁵²⁶ Ligji 9901/2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” i ndryshuar, neni 3. Sipas pikës 1:

“1. Shoqëritë tregtare themelohen nga dy ose më shumë persona fizikë dhe/ose juridikë, që bien dakord për arritjen e objektivave ekonomikë të përbashkët, duke dhënë kontribute në shoqëri, sipas përcaktimeve në statutin e saj. Shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar dhe shoqëritë aksionere mund të themelohen edhe vetëm nga një person fizik dhe/ose juridik (shoqëritë me ortak apo aksioner të vetëm).”

⁵²⁷ Ligji 9901/2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” i ndryshuar. Neni 50 i tij parashikon:

“1. Kur, për çfarëdo arsye, shoqëria kolektive mbetet me një ortak të vetëm, atëherë ai është i detyruar që, brenda 6 muajve nga ngjarja e këtij fakti, të marrë masat e nevojshme për ta përshtatur shoqërinë me kërkesat e këtij ligji, apo në mënyrë alternative, t'i kalojë veprimtarinë e

aktivitetin tregtar. Ndërsa në rastin e një SHPK-je, dhe në rast se gjatë ushtrimit të aktivitetit tregtar për cdo lloj arsye mbetet me një ortak të vetëm, kjo nuk shkakton detyrimisht prishjen e shoqërisë pasi ajo mund të vazhdojë aktivitetin tregtar edhe me një ortak të vetëm, por me detyrimin që ta publikojë këtë fakt pranë QKR-së.

Në nenin 71 të ligjit, parashikohet edhe situata kur një SHPK mbetet me një ortak të vetëm⁵²⁸. Sipas fjalisë së dytë të pikës së parë të kësaj dispozite parashikohet një sanksion në rast të moszbatimit të detyrimit të ortakut që mbetet i vetëm gjatë ushtrimit të aktivitetit tregtar të shoqërisë. Sipas këtij sanksioni, ortakut që nuk përmbush detyrimin për regjistrimin e këtij fakti do të konsiderohet si ortak me përgjegjësi të pakufizuar për detyrimet që shoqëria ka marrë përsipër gjatë kësaj periudhe.

Pra, ky është rasti kur një ortak i SHPK-së mund të kthehet nga ortak me përgjegjësi të kufizuar dhe ekspozohet ndaj përgjegjësisë së pakufizuar. Edhe ky ekspozim është vetëm për periudhën e kohës që ortakut nuk ka publikuar në QKB (regjistrin tregtar) faktin që ka mbetur ortak i vetëm në shoqëri. Nga momenti i publikimit të këtij fakti në QKB e në vazhdim, ortakut rifiton statusin e ortakut me përgjegjësi të kufizuar.⁵²⁹

Sigurisht që ky është një rast përjashtimor për shoqëritë me përgjegjësi të kufizuara dhe lidhet me garantimin e të drejtave të kreditorëve, të cilët kanë të drejtë të kenë informacionin që një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar me të cilën kanë hyrë në marrëdhënie, ka mbetur me ortak të vetëm. Ligji ka parashikuar këtë sanksion, me qëllim që të shërbejë si një shtysë dhe motivim efektiv, që të detyrojë ortakët, të cilët mbeten të vetëm gjatë ushtrimit të aktivitetit të një SHPK-je, që ta publikojnë këtë fakt në QKB (regjistrin tregtar) si garanci për kreditorët.

Nga praktika e deritanishme gjyqësore dhe hulumtimi i saj, nuk janë evidentuar raste në të cilat kreditorët të kenë përfituar nga ky parashikim ligjor për vonesat e publikimit të faktit që shoqëria ka mbetur me ortak të vetëm. Ndërsa për SHPK-të e regjistruara që në fillim me një ortak të vetëm, nuk ekziston asnjë risk i cenimit të përgjegjësisë së kufizuar të

saj një shoqërie të themeluar rishtazi, që pranon ekzistencën e një ortakut të vetëm ose të vazhdojë ushtrimin e veprimtarisë duke u regjistruar si tregtar.

2. Nëse brenda afatit të parashikuar në pikën 1 të këtij neni, ortakut i mbetur nuk regjistron një prej veprimeve si më sipër në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit, shoqëria kolektive vlerësohet e prishur dhe likuidohet sipas dispozitave të këtij ligji. Çdo person i interesuar mund t'i drejtohet gjykatës për të konstatuar prishjen e shoqërisë.”

⁵²⁸ Ligji 9901/2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” i ndryshuar. Neni 71 përcakton se:

“1. Nëse shoqëria mbetet me një ortak, atëherë ortakut i vetëm detyrohet ta regjistrojë këtë fakt, sipas nenit 43 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007. Nëse ortakut i mbetur nuk përmbush këtë detyrim, atëherë ai përgjigjet personalisht për detyrimet që shoqëria ka marrë përsipër. 2. Nga çasti i regjistrimit të ndryshimit, sipas pikës 1 të këtij neni, shoqëria tregtare vijon si shoqëri me përgjegjësi të kufizuar me ortak të vetëm.”

⁵²⁹ Ligji 9901/2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” i ndryshuar, neni 71 pika 2.

ortakut pasi detyrimi për publikim është ezauruar që në momentin e regjistrimit të shoqërisë në QKB.

Së treti, në shoqëritë më përgjegjësi të kufizuar ortakët mund të jenë persona fizikë dhe persona juridikë pa asnjë lloj kufizimi.⁵³⁰ Ndërsa te shoqëritë kolektive, si shoqëri tipike të personit, ortakët e tyre normalisht duhet të jenë personat fizikë që mbajnë përgjegjësi *personale* të pakufizuar ndaj kreditorëve. Në të vërtetë, lidhur me këtë konkluzion ligji nuk bën një përcaktim të shprehur qartë, por nga interpretimi në tërësi i dispozitave të ligjit dhe karakteristikat e këtyre shoqërive, vlerësojmë se nuk është e natyrshme që personat juridikë të jenë ortakë të këtyre shoqërive. Argumenti kryesor në këtë drejtim është fakti që shoqëritë kolektive janë shoqëri tipike personi, të cilat krijohen me kontratë në bazë të përputhjes së vullnetit të personave fizikë të angazhuar në mënyrë aktive me një aktivitet tregtar dhe që mbështeten në cilësitë personale (*intuitu personae*) të njëri-tjetrit, të cilat janë përcaktuese në këtë ortakëri.⁵³¹

Gjithashtu një karakteristikë tjetër e shoqërive të personit është fakti që të gjithë ortakët mund të marrin pjesë në administrimin e shoqërisë dhe mbajnë përgjegjësi të pakufizuar për detyrimet e shoqërisë.⁵³² Sipas nenit 38/1 të ligjit përcaktohet që çdo ortak ka të drejtë ta përfaqësojë shoqërinë në raport me të tretët.⁵³³ Është e qartë, që një person juridik nuk mund të jetë përfaqësues i kësaj shoqërie. Po ashtu, në nenin 44 të ligjit rregullohet pasoja e largimit të ortakut duke iu referuar “*a) vdekja e ortakut*”⁵³⁴ dhe është e qartë që vetëm personat fizikë mund të vdesin. Ndërsa në pikën b të kësaj dispozite, parashikohet “*b) hapja e procedurave të falimentimit ndaj një ortaku.*”⁵³⁵ Kjo pikë mund të ketë krijuar një konfuzion, duke i dhënë shkas diskutimeve nëse mund të jetë ortak në një shoqëri kolektive edhe një person juridik. Shumë studiues të së drejtës tregtare vlerësojnë se edhe personat juridikë mund të jenë ortakë në një shoqëri kolektive. Por duhet të kemi parasysh që procedurat e falimentit nuk janë ekskluzivisht të rezervuara për shoqëritë tregtare. Ligji për falimentin parashikon edhe falimentimin e një personi fizik.⁵³⁶ Gjithashtu, ligji i falimentit që ka qenë në fuqi në vitin 2008 kur ka hyrë në fuqi ligji 9901/2008, ka parashikuar edhe falimentimin e një personi fizik.⁵³⁷ Për këto arsye, konkludojmë se në një shoqëri kolektive

⁵³⁰ Ligji 9901/2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” i ndryshuar, neni 68 pika 1.

⁵³¹ Galgano (n 200) fq. 233-234.

⁵³² Po aty, fq. 232.

⁵³³ Ligji 9901/2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” i ndryshuar, neni 38/1.percakton se; “*Secili ortak ka të drejtë të përfaqësojë shoqërinë në marrëdhënie me të tretët, me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në statut.*”

⁵³⁴ Ligji 9901/2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” i ndryshuar, neni 44.

⁵³⁵ Ligji 9901/2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” i ndryshuar, neni 44.

⁵³⁶ Ligji 110/2016 “Për Falimentimin” [2016] FZ 226, neni 7. Sipas kësaj dispozite ligjore është përcaktuar se: “Procedura e falimentimit mund të fillojë ndaj çdo debitori si person fizik ose juridik”.

⁵³⁷ Ligji 8901/2002 “Për Falimentimin” [2002] FZ 31 (i shfuqizuar). Sipas nenit 11 të këtij ligji përcaktohej se: “*Procedura e falimentimit mund të hapet për pasuritë e çdo personi, fizik ose juridik, si dhe për pasuritë e shoqërive të thjeshta.*”

nuk është e natyrshme që personat juridikë të përfshihen si ortakë. Pra, mundësia që u jep neni 68 i ligjit Nr.9901 Dt. 14.04.2008, “Për Tregëtarët dhe Shoqëritë Tregëtare” edhe personave juridikë për të qenë ortakë të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar, është një fleksibilitet dhe mundësi shumë më të madhe për të organizuar sipërmarrjet e ndryshme ekonomike.⁵³⁸

Edhe kjo mundësi, përbën një avantazh të konsiderueshëm për këtë formë të sipërmarrjeve tregtare, pasi u jep mundësi një numri të pakufizuar subjektësh, që janë persona juridikë, të cilat përfaqësojnë një potencial më të madh ekonomik të përfshihen në sipërmarrjet tregtare të formës së SHPK-ve. Kështu, në praktikën e zhvillimit të SHPK-ve në Shqipëri, në mënyrë progresive janë shtuar SHPK-të e themeluara nga persona të tjerë juridike në rolin e ortakut.

Nga hulumtimet në Qendrën Kombëtare të Biznesit rezulton se në shumicën e rasteve që SHPK-të kanë ortakë persona juridikë, ata janë persona juridike privatë dhe konkretisht shoqëri tregtare. Ka një larmishmëri rastesh kur si ortakë të një SHPK-je janë shoqëri të tjera tregtare, kryesisht të formës së SHPK-së apo SHA-së.⁵³⁹ Kjo sepse këto dy forma shoqërishe, janë dhe format më të përhapura në Shqipëri. Ndërsa shoqëritë kolektive dhe shoqëritë komandite nuk janë konsideruar si forma tërheqëse të organizimit të biznesit dhe sipërmarrjes në vendin tonë. Si rrjedhim, edhe numri i tyre është plotësisht i papërfillshëm në raport me numrin total të shoqërive tregtare të regjistruara në Shqipëri.

Ligji 9901/2008 u jep mundësi dhe personave juridikë privatë jofitimprurës (që janë organizatat jofitimprurëse) që të jenë ortakë në një SHPK.⁵⁴⁰ Pra, teorikisht edhe OJF-të mund të jenë ortakë të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar, përse i përket parashikimeve të ligjit 9901/2008. Një angazhim i tillë në veprimtari ekonomike të një organizate jofitimprurëse lejohet dhe nga neni 36 i ligjit Nr. 8788 dt. 07.05.2001 «Për Organizatat jofitimprurëse» i ndryshuar. Por, një angazhim i tillë është i kufizuar nga parashikime të ligjit të posaçëm dhe akteve të themelimit të organizatës jofitimprurëse, duke i kushtëzuar që fitimet e realizuara nga dividendi i këtij ortaku të përdoren në përputhje me objektivat dhe qëllimet e organizatës jofitimprurëse dhe jo thjesht si fitim.⁵⁴¹

Megjithatë ka edhe raste kur ortakë të një SHPK-je janë persona juridikë publikë, si psh. institucione të ndryshme të administratës publike të qeverisjes qendrore apo vendore. Në shumicën e rasteve institucionet shtetërore kanë preferuar formën e shoqërisë aksionere. Sipas nenit 213 të ligjit, kur personi juridik publik si aksioner ka shumicën ose të gjithë

⁵³⁸ Ligji 9901/2008 “Për Tregëtarët dhe Shoqëritë Tregëtare” i ndryshuar, neni 68.

⁵³⁹ Qendra Kombëtare Biznesit, <<https://qkb.gov.al/>>

⁵⁴⁰ Ligji 8788/2001 “Për Organizatat Jofitimprurëse” i ndryshuar, neni 36.

⁵⁴¹ Ligji 8788/2001 “Për Organizatat Jofitimprurëse” i ndryshuar, neni 36/1.

aksionet, këto shoqëri quhen shoqëri shtetërore. Të tilla janë OSHEE sh.a., KESH sh.a. OST sh.a., Posta Shqiptare sh.a., UKT sh.a. dhe shumë shoqëri të tjera.⁵⁴²

Megjithatë ka dhe raste të shoqërive me përgjegjësi të kufizuar ku institucione publike janë ortakë. Për shembull, nga një kërkim në faqen e QKB, identifikohet shoqëria PRESS POINT ELBASAN (PPE) SH.P.K. e themeluar me dt. 11.12.2009⁵⁴³, e cila ka si ortak Bashkinë Elbasan me një pjesëmarrje prej 15 % të kapitalit të shoqërisë dhe ortakut tjetër në shoqëri është një tjetër shoqëri tregtare ***, pra një person juridik privat.⁵⁴⁴ Gjithashtu, një shembull tjetër i partneritetit publik privat është ai i shoqërisë Gatic sh.p.k., ku ortak mazhoritar është një qytetar privat V. K., ndërsa ortakut në minorancë është Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjitikës.⁵⁴⁵

Së katërti, ligji ka parashikuar që për shoqëritë me përgjegjësi të kufizuara është i domosdoshëm një kapital minimal themeltar si kontribut i ortakëve themelues. Kjo është një karakteristikë tipike e shoqërive të kapitalit, te të cilat kreditorët mbështeten pikërisht te kapitalet e shoqërisë, si garanci për shlyerjen e kredive të tyre dhe jo cilësitë personale të ortakëve të shoqërisë.

Në ligjin 7638/19.11.1992 “Për shoqëritë tregtare”, parashikohet që kapitali i domosdoshëm për themelimin e një SHPK-je, duhet të jetë jo më i vogël se 100.000 lekë.⁵⁴⁶ Ndërsa ligji Nr.9901/2008 në fuqi, ka ulur vlerën e kapitalit minimal themeltar në një masë të papërfillshme prej 100 lekësh.⁵⁴⁷ Ky kapital minimal i parashikuar është vetëm simbolik, sa për të ruajtur qoftë edhe në aspektin formal një karakteristikë të shoqërive të kapitalit.

Por, themeluesit e SHPK-ve në çdo rast janë të lirë që të përcaktojnë një kapitalin minimal në vlera më të mëdha, pa asnjë kufizim. Një shembull të këtyre shoqërive të shkarkuar nga faqja publike e Qendres Kombëtare të Regjistrimit për arsye ilustrative po e paraqes më

⁵⁴² Sipas nenit 213 të Ligjit 9901/2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” i ndryshuar:

“1. Shoqëria shtetërore është një shoqëri tregtare, e cila zhvillon veprimtari tregtare, me interes të përgjithshëm ekonomik, aksionet e së cilës zotërohen drejtpërdrejt ose në mënyrë të tërthortë nga pushteti qendror, pushteti vendor apo nga shoqëri, ku këto pushtete veprojnë si mëmë, sipas përkufizimit të nenit 207 të këtij ligji.

2. Themelimi, organizimi e funksionimi i shoqërisë shtetërore u nënshtrohen dispozitave të këtij ligji.”

⁵⁴³ QKB, “Kërko” <<http://qkr.gov.al/kerko/kerko-ne-regjistrin-tregtar/kerko-per-subjekt/>> aksesuar më 14 tetor 2020.

⁵⁴⁴ QKB, “Kërko” <<http://qkr.gov.al/kerko/kerko-ne-regjistrin-tregtar/kerko-per-subjekt/>> aksesuar më 14 tetor 2020.

⁵⁴⁵ QKB, “Kërko” <<http://qkr.gov.al/kerko/kerko-ne-regjistrin-tregtar/kerko-per-subjekt/>> aksesuar më 14 tetor 2020.

⁵⁴⁶ Sipas nenit 38/1 të ligjit 7638/1992 “Për shoqëritë tregtare” [1992] FZ 8 (shfuqëzuar) përcaktohet se: *“Vlera minimale e kapitalit themeltar të kësaj forme shoqërie është 100 000 lekë. Këshilli i Ministrave ngarkohet që, në përputhje me nivelin e inflacionit, të ricaktojë vlerën minimale të kapitalit themeltar.”*

⁵⁴⁷ Ligji 7638/1992 “Për shoqëritë tregtare” [1992] FZ 8 (shfuqëzuar), neni 70.

poshtë; “B*** G***”shpk e themeluar në dt. 17.03.2017.⁵⁴⁸ Në këtë shoqëri megjithëse kapitali minimal i lejuar nga ligji është 100 lekë, shoqëria rezulton se ka pasur si kapital të nënshkruar në momentin e themelimit (kapitali themeltar) vlerën prej 13.500.000 lekë, që është shumë herë më i lartë se kapitali minimal i lejuar nga ligji.⁵⁴⁹

Ndërsa në rastin e shoqërive kolektive, ndryshe nga SHPK-të, ligji nuk parashikon detyrimin për të pasur një kapital minimal të detyrueshëm. Kjo për shkak se ato kanë si karakteristikë kryesore përgjegjësinë personale të ortakëve të shoqërisë, përgjegjësi kjo e pakufizuar.

Gjithashtu një arsye tjetër së përse nuk parashikohet një kapital minimal i domosdoshëm të shoqëritë kolektive, është dhe fakti se në këto shoqëri lejohet që ortakët të ofrojnë kontributin e tyre edhe nëpërmjet shërbimeve. Pra secili ortak i shoqërisë kolektive mund të ofrojë kontributin e tij në shërbime dhe jo në para apo me kapitale në natyrë. Në një situatë të tillë ortaku nuk ofron një aset të trupëzuar me vlerë ekonomike, siç është paraja, apo kapitali në natyrë, por ofron shërbime të ndryshme, të cilat do të jenë në funksion të shoqërisë kolektive. Këto shërbime mund të jenë, në formën e punës, konsulencës për fusha të caktuara specifike profesionale, apo aftësi të caktuara, si arti, mjeshtëria, profesione të lira, apo çdo shërbim tjetër intelektual.

Te SHPK-të ortakët mund të ofrojnë kontributin e tyre vetëm në para ose duke ofruar kapitale në natyrë, si sende të luajtshme, apo të paluajtshme, për të cilat bëhet një vlerësim ekonomik.⁵⁵⁰ Ndërsa shërbimet nuk janë një formë me të cilën mund të kontribuojnë ortakët e SHPK-së.

Së pesti, mënyra e shpërndarjes së fitimit në këto dy lloj shoqërish ndjek parime të ndryshme. Në rastin e shoqërive më përgjegjësi të kufizuara sipas nenit 76 të ligjit,⁵⁵¹ shpërndarja e fitimit bëhet në raport të drejtë me pjesën që ka secili ortak në kapitalin e shoqërisë. Pra, një ortak që ka një kontribut më të madh në kapitalin themeltar të shoqërisë, rrjedhimisht ka një pjesë më të madhe dhe në proporcion me këtë përqindje do të marrë dhe fitimin, i cili ndahet në përfundim të vitit financiar në formën e dividendit. Megjithatë, ligji ka parashikuar edhe mundësinë që ortakët në statutin e shoqërisë të përcaktojnë raporte

⁵⁴⁸ QKB, “Kërko” <<http://qkr.gov.al/kerko/kerko-ne-regjistrin-tregtar/kerko-per-subjekt/>> aksesuar më 14 tetor 2020.

⁵⁴⁹ Per arsye të respektimit të të dhënave personale nuk është pasqyruar ekstrakti në QKB.

⁵⁵⁰ Neni 68 i Ligjit 9901/2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” i ndryshuar. përcakton që “Kontributi i ortakëve mund të jetë në para ose në natyrë (pasuri të luajtshme/të paluajtshme apo të drejta). Statuti përcakton mënyrat e shlyerjes së kontributeve.”

⁵⁵¹ Në nenin 76 të Ligjit 9901/2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” i ndryshuar, parashikohet që: “1. Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në statut, ortakët kanë të drejtë të ndajnë pjesën e fitimit të deklaruar në pasqyrat financiare të shoqërisë. 2. Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në statut, fitimi u shpërndahet ortakëve në raport me kuotat e zotëruara”.

të tjera të ndarjes së fitimit. Pra, në këtë aspekt, ligji i lë diskrecion statutit që të rregullojë marrëdhëniet mes ortakëve, përsa i përket pjesës së fitimit që do të marrë secili ortak. Mirëpo nëse në statut nuk janë parashikuar dispozita që rregullojnë në mënyrë të ndryshme nga ligji, ndarjen e fitimit mes ortakëve, atëherë prezumimi ligjor i parashikuar në paragrafin e dytë të nenit 76 të ligjit është i detyrueshëm.⁵⁵²

Në ndryshim nga SHPK-të, ligji bën një rregullim të ndryshëm për ndarjen e fitimit të shoqëritë kolektive. Sipas nenit 37/2 të këtij ligji, përcaktohet si dispozitë urdheruese rregulli që ortakët e një shoqërie kolektive i ndajnë fitimet në mënyrë të barabartë.⁵⁵³ Në shoqëritë kolektive përcaktohet si tipar dallues barazia e ortakëve në fitimet e shoqërisë, madje ligji nuk i jep të drejtë statutit të bëjë përcaktime të ndryshme, siç i jep neni 76 ortakëve të SHPK-ve.

Së gjashti, administrimi i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar bëhet në mënyrë të centralizuar mbi bazën e dispozitave të ligjit, statutit si dhe një kontrate apo akti emërimi, të lidhur mes shoqërisë dhe administratorit. Ky i fundit përfaqëson shoqërinë dhe bën administrimin e brendshëm dhe të jashtëm të veprimtarisë së saj në përputhje me të gjitha përgjegjësitë dhe parimet e miradministrimit. Administrator mund të caktohet një person fizik i jashtë rrethit të ortakëve, si profesionist në fushën e administrimit të aktivitetit tregtar, ashtu siç mund të caktohet dhe një apo disa nga ortakët e shoqërisë. Por në një rast të tillë këta nuk duhet të konfundojnë tagrat e administrimit me të drejtat e tyre si ortak të shoqërisë tregtare. Ndërsa në shoqërinë kolektive prezumimi ligjor i parashikuar në nenin 31 të ligjit në fuqi, është që të gjithë ortakët e saj kanë të drejtë të kryejnë veprime administrimi.⁵⁵⁴ Ky prezumim ligjor përforcohet akoma më shumë në nenin 38/1 të ligjit.⁵⁵⁵ Sipas këtyre parashikimeve ligjore, të gjithë ortakët e një shoqërie kolektive kanë të drejtë të kryejnë veprime të ndryshme administrimi dhe ta përfaqësojnë shoqërinë në raport me të tretët.⁵⁵⁶

Këto specifika të administrimit të shoqërive kolektive lidhen me faktin se këto lloj shoqëri themelohen mes subjekteve, të cilët në mënyrë kolektive e ushtrojnë aktivitetin tregtar. Pra kanë si karakteristikë faktin që dy ose më shumë subjekte aktive në ushtrimin

⁵⁵² Argita Malltezi, *E drejta shqiptare e shoqërive tregtare* (Shtëpia botuese Mediaprint 2011) fq. 47.

⁵⁵³ Sipas nenit 37/2 të Ligjit 9901/2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” i ndryshuar: “*Secili ortak ka të drejtë të përfitojë pjesë të barabartë të fitimeve dhe është i detyruar të marrë pjesë, në mënyrë të barabartë, në mbulimin e humbjeve që rrjedhin nga veprimtaria.*”

⁵⁵⁴ Sipas nenit 31 të Ligjit 9901/2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” i ndryshuar, parashikohet: “*1. Të gjithë ortakët kanë të drejtë ta administrojnë veprimtarinë tregtare të shoqërisë kolektive, duke vepruar si administratorë. 2. Nëse, në mbështetje të statutit, i është ngarkuar administrimi një apo disa prej ortakëve, ortakët e tjerë përjashtohen nga administrimi.*”

⁵⁵⁵ Neni 38/1 i Ligjit 9901/2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” i ndryshuar “*1. Secili ortak ka të drejtë të përfaqësojë shoqërinë në marrëdhënie me të tretët, me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në statut.*”

⁵⁵⁶ Po aty.

e aktivitetit tregtar bëhen së bashku për ta ushtruar këtë aktivitet tregtar në mënyrë kolektive. Si rrjedhim ortakët e një shoqërie kolektive janë shumë të ngjashëm me tregtarin si person fizik. Ndërsa ortakët e një SHPK-je nuk janë aktiv në ushtrimin e aktivitetit tregtar, pasi ky aktivitet ushtrohet nga shoqëria dhe jo nga ortakët e saj.

Megjithatë duhet nënvizuar se ky është prezumimi ligjor, por, edhe në shoqëritë kolektive, ligji i jep autonomi statutit që të përcaktojë vetëm njërin apo disa prej ortakëve si administratorë, pa qenë të detyruar të gjithë ortakët që të jenë domosdoshmërisht administratorë.

Në një rast të tillë ortakët që nuk janë përcaktuar si administratorë të shoqërisë, nuk kanë të drtejtë të kryejnë veprime administrimi të shoqërisë, dhe vetëm në këtë rast ata do të ngjasonin me ortakët e një SHPK-je për nga pasiviteti në ushtrimin e sipërmarrjes tregtare, por asnjëherë për nga aspekti i përgjegjësisë ndaj të tretëve, pasi ata gjithmonë kanë përgjegjësi të pakufizuar (ndryshe nga ortakët e SHPK-së të cilët kanë përgjegjësi të kufizuar).

4.8. Dallimi i SHPK-së në raport me Shoqërinë Komandite

Së pari, në ndryshim nga SHPK-të ku të gjithë ortakët e shoqërisë kanë përgjegjësi të kufizuar për humbjet e shoqërisë, te shoqëritë komandite kemi dy kategori ortakësh. Njëra kategori e ortakëve (një ose më shumë ortakë) ka përgjegjësi të pakufizuar për humbjet e shoqërisë, dhe kategoria tjetër (një ose më shumë ortakë) ka përgjegjësi të kufizuar për humbjet e shoqërisë. Sipas nenit 56 të ligjit 9901/2008, dispozitat ligjore të shoqërisë kolektive janë të aplikueshme për aq sa nuk parashikohet ndryshe në ligj.⁵⁵⁷

Kategoria e ortakëve me përgjegjësi të pakufizuar në shoqëritë komandite, ka të njëjtin status, përgjegjësi dhe risk, si ortakët e shoqërive kolektive që u shpjeguan më lart. Kjo do të thotë që, në rast se kreditorët e një shoqërie komandite, pasi kanë bërë të gjitha përpjekjet për të rikuperuar kredinë e tyre te shoqëria (pa sukses), ata legjitimohen që këto detyrime t'ua kërkojnë ortakëve me përgjegjësi të pakufizuar të shoqërisë. që të shlyejnë detyrimet e shoqërisë me pasurinë e tyre personale.⁵⁵⁸

⁵⁵⁷ Neni 56 i Ligjit 9901/2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” i ndryshuar përcakton se:

“1. Shoqëri komandite është shoqëria, në të cilën përgjegjësia e të paktën njërit prej ortakëve është e kufizuar deri në vlerën e kontributit të tij, ndërsa përgjegjësia e ortakëve të tjerë nuk është e kufizuar. Ortaku, përgjegjësia e të cilit është e kufizuar deri në vlerën e kontributit të tij, quhet ortak i kufizuar. Ortaku, përgjegjësia e të cilit nuk është e kufizuar deri në vlerën e kontributit të tij, quhet ortak i pakufizuar. Ortaku i pakufizuar ka statusin e ortakut të shoqërisë kolektive. 2. Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe, dispozitat që rregullojnë shoqërinë kolektive janë të zbatueshme edhe për shoqërinë komandite”.

⁵⁵⁸ Argita Malltezi, *E drejta shqiptare e shoqërive tregtare* (Shtëpia botuese “Mediaprint” 2011) fq. 37.

Ndërsa kategoria tjetër e ortakëve të shoqërisë komandite, janë ortakë që përgjigjen në mënyrë të kufizuar për humbjet e shoqërisë. Kjo përgjegjësi kufizohet vetëm deri në vlerën e kontributit të tyre në kapitalin e shoqërisë. Pra, ndryshe nga ortakët me përgjegjësi të pakufizuar, ortakët me përgjegjësi të kufizuar kanë vetëm detyrimin që të shlyejnë plotësisht kontributin për pjesëmarrjen në kapitalin e shoqërisë dhe nuk riskohen nga pretendimet e kreditorëve të shoqërisë.⁵⁵⁹

Një shoqëri komandite duhet të ketë një ose më shumë ortakë me përgjegjësi të pakufizuar dhe të paktën një ose më shumë ortakë me përgjegjësi të kufizuar, që të konsiderohet e tillë.⁵⁶⁰ Kjo formë shoqërie ka një natyrë hibride mes karakteristikave të shoqërisë kolektive, ku të gjithë ortakët kanë një rol aktiv në veprimtarinë tregtare dhe mbajnë përgjegjësi të pakufizuar, dhe karakteristikat e SHPK-së ku të gjithë ortakët janë me përgjegjësi të kufizuar dhe kanë rol pasiv në aktivitetin e sipërmarrjes tregtare.

Shoqëria komandite është një formë shoqërie, që në aspektin historik i ka paraprirë shoqërive me përgjegjësi të kufizuara, të cilat janë zhvilluar më pas. Shoqëria komandite është forma e parë e shoqërive tregtare ku u zhvillua koncepti i përgjegjësisë së kufizuar. Koncept ky që u përkrye/përmirësua në format e tjera të shoqërive, si shoqëria me përgjegjësi të kufizuar dhe, akoma më shumë, në shoqërinë aksionere.⁵⁶¹

Në aspektin e riskut dhe pasigurisë që i shoqëron sipërmarrjet tregtare, shoqëritë me përgjegjësi të kufizuara kanë avantazhin e madh që të gjithë ortakët e SHPK-së gëzojnë statusin e ortakut me përgjegjësi të kufizuar. Ndërsa shoqëritë komandite këtë “privilegj” ia ofrojnë vetëm njëres kategori të ortakëve. Kjo është dhe arsyeja që sipas statitikave të QKB, dallimi mes shifrave të shoqërive të themeluara si SHPK, në raport me ato të themeluara si shoqëri Komandite, është jashtëzakonisht i madh. Deri në vitin 2020 në Regjistrin Tregtar, rezultoi të jenë regjistruar 58084 shoqëri me përgjegjësi të kufizuar dhe vetëm 131 shoqëri komandite. Ky numër përfaqëson vetëm 0.2 % të numrit të SHPK-ve, pra vetëm një fraksion të numrit të tyre.⁵⁶²

Së dyti, siç u analizua më lart, ligji ka lejuar që një SHPK të mund të themelohet edhe me një ortak të vetëm, ndërsa një shoqëri komandite duhet të ketë detyrimisht të paktën dy ortakë.⁵⁶³ Ky parashikim ligjor përbën një aspekt tjetër favorizues për shoqëritë me përgjegjësi të kufizuara, në funksion të fleksibilitetit, përshtatshmërisë dhe jetëgjatësisë së

⁵⁵⁹ Ligji 9901/2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” i ndryshuar, neni 56.

⁵⁶⁰ Ligji 9901/2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” i ndryshuar, neni 56.

⁵⁶¹ Për më shumë shih Kreun “2.3. E drejta islame dhe shoqëritë tregtare para ” dhe “2.4. Periudha e Mesjetës dhe shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar” në këtë punim.

⁵⁶² Kthim përgjigje në format elektronik nga Qendra Kombëtare e Biznesit dt. 16.10.2020 (Drejtoria e Analizës dhe Regjistrave) kërkesës së autorit të këtij punimi të paraqitur pranë QKB me Nr 8640 prot, date 24.09.2020.

⁵⁶³ Ligji 9901/2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” i ndryshuar, neni 3.

tyre në treg. Për shembull; në rast se një shoqëri komandite, gjatë aktivitetit të saj largohen të gjithë ortakët e pakufizuar, atëherë kjo shoqëri duhet të prishet dhe të çregjistrohet.⁵⁶⁴ Shoqëria komandite nuk mund të vazhdojë aktivitetin tregtar pa pasur dy kategori ortakësh. Ndërsa në rastin e një SHPK-je dhe në rast se gjatë ushtrimit të aktivitetit tregtar për çdo lloj arsyeje mbetet me një ortak të vetëm, kjo nuk shkakton detyrimisht prishjen e shoqërisë, pasi ajo mund të vazhdojë aktivitetin tregtar edhe me një ortak të vetëm.

Së treti, siç u analizua te krahasimi me shoqëritë kolektive, edhe në rastin e krahasimit me shoqëritë komandite, qëndron dallimi në elementin e kapitalit themeltar. Ligji ka parashikuar për SHPK-të një kapital minimal themeltar të domosdoshëm si kontribut i ortakëve themelues. Pavarësisht se ky kapital minimal i parashikuar nga ligji aktual është në një vlerë krejt simbolike prej 100 lekësh, vlen për të ruajtur, qoftë edhe në aspektin formal, një karakteristikë të shoqërive të kapitalit.⁵⁶⁵ Ndërsa, për shoqëritë komandite, ligji nuk ka përcaktuar asnjë kapital minimal të domosdoshëm si kusht për themelimin e shoqërisë.⁵⁶⁶ Megjithëse duke pasur parasysh që në këto shoqëri kemi prezencën e domosdoshme të të paktën një ortaku me përgjegjësi të kufizuar, i cili nuk mund të ofrojë kontributin e tij në shërbime, atëherë, patjetër që një shoqëri komandite që në themelimin e saj ka dhe një kapital në para ose me pasuri në natyrë. Megjithatë ligji nuk përcakton një vlerë minimale të domosdoshme, duke e lënë në vlerësim të ortakëve themelues dhe marrëveshjes së tyre.⁵⁶⁷

Së katërti, mënyra e shpërndarjes së fitimit në këto dy lloj shoqërish ndjek parime të ndryshme. Në rastin e SHPK-ve, shpërndarja e fitimit bëhet në raport të drejtë me pjesën që ka secili ortak në kapitalin e shoqërisë. Megjithatë ligji ka parashikuar edhe mundësinë që ortakët në statutin e shoqërisë të përcaktojnë raporte të tjera të ndarjes së fitimit.⁵⁶⁸ Me këtë hapësirë përjashtimi nga rregulli i përgjithshëm, ligji u jep mundësinë SHPK-ve që të aplikojë parimet e shpërndarjes së fitimit njësoj në shoqëritë e personit. Ndërsa, në rastin e shoqërive komandite ligji në nenin 56/2 të tij, përcakton se nëse nuk parashikohet ndryshe,

⁵⁶⁴ Neni 67 i ligjit 9901/2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” i ndryshuar parashikon:

“1. Shoqëria komandite nuk prishet për shkak të vdekjes apo të prishjes së një ose më shumë prej ortakëve të kufizuar.

2. Nëse të gjithë ortakët e pakufizuar largohen nga shoqëria, atëherë shoqëria kolektive prishet dhe likuidohet sipas dispozitave të këtij ligji.

3. Nëse largohen të gjithë ortakët e kufizuar, atëherë veprimtaria tregtare e shoqërisë komandite mund të vazhdojë të ushtrohet në formën e një shoqërie kolektive apo, nëse mbetet vetëm një ortak i pakufizuar, veprimtaria mund të ushtrohet me statusin e tregtarit.

4. Ndryshimet e përmendura në pikat 1 e 3 të këtij neni duhet t’i njoftohen për regjistrim Qendrës Kombëtare të Regjistrimit.

5. Prishja e shoqërisë komandite në gjendjen e aftësisë paguese ka si pasojë hapjen e procedurave të likuidimit, sipas neneve 190 deri 205 të këtij ligji.”

⁵⁶⁵ Ligji 9901/2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” i ndryshuar, neni 70.

⁵⁶⁶ Ligji 9901/2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” i ndryshuar, neni 56 e vijues.

⁵⁶⁷ Ligji 9901/2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” i ndryshuar, neni 56/1.

⁵⁶⁸ Ligji 9901/2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” i ndryshuar, neni 76/2.

zbatohen rregullimet e parashikuara për shoqëritë kolektive.⁵⁶⁹ Dhe, në shoqëritë kolektive, shpërndarja e fitimit bëhet në mënyrë të barabartë.⁵⁷⁰ Pra, edhe në shoqëritë komandite përcaktohet si tipar dallues barazia e ortakëve në fitimet e shoqërisë.

Së pesti, administrimi i një SHPK-je paraqet karakteristika të ndryshme nga shoqëria komandite. Administrimi i SHPK-së bëhet në mënyrë të centralizuar mbi bazën e një marrëdhënieje të posaçme të lidhur mes shoqërisë dhe administratorit, i cili përfaqëson shoqërinë dhe bën administrimin e brendshëm dhe të jashtëm të shoqërisë, në përputhje me të gjitha përgjegjësitë ligjore dhe parimet e mirëadministrimit. Administrator mund të caktohet një person fizik i jashtëm si profesionist në fushën e administrimit të aktivitetit tregtar, ashtu siç mund të caktohet dhe një apo më shumë ortakë të shoqërisë. Ndërsa në shoqërinë komandite, ligji, në nenin 61 të tij, u ndalon ortakëve me përgjegjësi të kufizuar që të jenë përfaqësues ligjorë të shoqërisë.⁵⁷¹ Administrimi i shoqërisë komandite duhet të kryhet nga një ose disa ortakë me përgjegjësi të pakufizuar, ndërsa ortakët e kufizuar nuk mund të bëjnë asnjë veprim administrimi sipas nenit 59 të ligjit.⁵⁷² Në rast se ortakë me përgjegjësi të kufizuar kryen veprime administrimi apo përfaqësimi në shoqërinë komandite, veprimet do të konsiderohen të vlefshme, por ky ortak do të zhvishet nga privilegji i përgjegjësisë së kufizuar dhe do të trajtohet njësoj si ortakët me përgjegjësi të pakufizuar në raport me kreditorët.⁵⁷³

Këto specifika të administrimit të shoqërive komandite, lidhen me faktin se këto lloj shoqëri konsiderohen shoqëri personi dhe ortakët me përgjegjësi të pakufizuar kanë të njëjtin status si ortakët e shoqërisë kolektive. Veçoria e vetme është fakti që këtu kemi dhe një ose më shumë ortakë, të cilët nuk kanë rol aktiv në aktivitetin tregtar të shoqërisë, por vetëm kanë investuar kapitalin e tyre (në para ose në natyrë) te kjo shoqëri, kundrejt të drejtës për të marrë pjesë në fitimet vjetore sipas marrëveshjes. Ndalimi i këtyre ortakëve për të kryer veprime përfaqësimi apo administrimi lidhet me garantimin e të drejtave të kreditorëve të këtyre shoqërive të personit me qëllim që të mos krijohet konfuzion në cilësitë ligjore të ortakëve.

⁵⁶⁹ Ligji 9901/2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” i ndryshuar, neni 56/2.

⁵⁷⁰ Sipas nenit 37/2 të ligjit 9901/2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” i ndryshuar përcaktohet se: “2. Secili ortak ka të drejtë të përfitojë pjesë të barabartë të fitimeve dhe është i detyruar të marrë pjesë, në mënyrë të barabartë, në mbulimin e humbjeve që rrjedhin nga veprimtaria.”

⁵⁷¹ Sipas nenit 61 të Ligjit 9901/2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” i ndryshuar përcaktohet se: “Ortakë i kufizuar nuk mund të veprojnë si përfaqësues ligjor i shoqërisë komandite.”

⁵⁷² Sipas nenit 59 të ligjit 9901/2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” i ndryshuar, përcaktohet se: “Veprimtaria tregtare e shoqërisë komandite administrohet nga një ose më shumë ortakë të pakufizuar. Ortakët e kufizuar nuk kryejnë veprime administrimi”

⁵⁷³ Ligji 9901/2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” i ndryshuar, neni 64/3.

4.9. Dallimi i SHPK-së në raport me shoqërinë Aksionare

Së pari, dallimi kryesor i SHPK-së në raport me shoqërinë aksionare (SHA) është fakti që te SHA-të, i gjithë kapitali i shoqërisë përfaqësohet nga aksionet dhe është i ndarë në aksione, të cilat kanë të njëjtën vlerë nominale.⁵⁷⁴ Ndërsa te SHPK-të nuk kemi aksione, por pjesëmarrja e ortakëve në kapitalin e SHPK-së përfaqësohet nga kuota, e cila nuk është e thënë që të jetë e barabartë mes ortakëve të ndryshëm. Kuota mund të ilustruhet si një certifikatë që provon se ortaku ka një pjesë të kontributit në kapitalin themeltar të shoqërisë, dhe tregon pjesën në përqindje të këtij kontributi. Nga kjo përqindje varen dhe të gjitha të drejtat në shoqërinë me përgjegjësi të kufizuar, si për shembull: e drejta e votës apo e drejta e pjesëmarrjes në fitime apo në tepicën e likuidimit etj. Ndryshe nga shoqëria aksionare, në SHPK, çdo ortak disponon vetëm një kuota, e cila ka vlerë (ose peshë specifike) të ndryshme për ortakë të ndryshëm, në përpjesëtim të drejtë me përqindjen që zë kontributi i secilit në kapitalin themeltar (kapitalin e nënshkruar fillimisht). Vetëm në rast se ortakët kanë kontribute të barabarta, atëherë do të dispononin dhe kuota me vlerë të barabartë.

Në shoqëritë aksionare, subjektet që kanë vendosur të themelojnë këtë shoqëri dhe kanë kontribuar në kapitalin e kësaj shoqërie quhen aksionerë dhe jo ortakë, si te SHPK-ja. Po ashtu, edhe çdo subjekt që përfiton me blerje, apo çdo mënyrë tjetër, transferimi aksione pas themelimit të shoqërisë aksionare quhet aksioner i saj.

Te shoqëritë aksionare, që në momentin e themelimit të tyre, përcaktohet në statut numri i përgjithshëm i aksioneve dhe vlera nominale e tyre. Vlera nominale e një aksioni rrjedh nga pjesëtimi i vlerës që përfaqëson i gjithë kapitali i nënshkruar i shoqërisë aksionare me numrin e aksioneve. Ndryshe nga kuota në SHPK, e cila të jep të drejtën e votës në përpjesëtim me vlerën e kuotës, aksioni, si njësi më e vogël e pjesëtuar e kapitalit të shoqërisë është e barabartë me një votë. Pra vetëm te SHA-të gjen zbatim shprehja një aksion – një votë. Ndryshe nga kuotat e SHPK-së, çdo aksion ka të njëjtën vlerë nominale. Aksionerët themelues të shoqërisë mund të disponojnë shumë aksione, dhe ndryshimi i aksionerëve që kanë kontribute më të mëdha apo më të vogla nga njëri-tjetri, pasqyrohet në të njëjtin përpjesëtim të numri i aksioneve që ata disponojnë. Pra aksioneri që ka një kontribut më të madh në shoqëri, do të ketë më shumë aksione në këtë shoqëri dhe, për pasojë, do të ketë më shumë vota në vendimmarrjet e asamblesë dhe pjesëmarrje më të madhe në shpërndarjen e fitimit.

⁵⁷⁴ Sipas nenit 105/1 të ligjit 9901/2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” i ndryshuar, përcaktohet se: *“Shoqëria aksionare është një shoqëri tregtare, kapitali i së cilës është i ndarë në aksione të nënshkruara nga themeluesit. Themeluesit janë persona fizikë ose juridikë, të cilët nuk përgjigjen personalisht për detyrimet e shoqërisë e që mbulojnë humbjet e saj vetëm me vlerën e pashlyer të aksioneve të nënshkruara”.*

Aksioni vetë është një titull i konsideruar si një letër me vlerë, i cili pasqyron të drejtat pasurore që kanë aksionerët në shoqërinë aksionare.⁵⁷⁵ Si të tilla, ato janë sende të luajtshme, të patrupëzuara, mbi të cilat mund të ushtrohen të drejtat e pronësisë nga aksionerët. Edhe neni 141 i K. Civil përcakton se çdo gjë që mund të përbëjë objekt pronësie kategorizohet si send.⁵⁷⁶ Kjo e drejtë pronësie mbi pjesën që ka çdo ortak apo aksioner në kapitalin e shoqërisë ushtrohet mbi të drejtat që të jep kuota apo aksioni si; e drejta votës, e dividendit etj. dhe nuk ushtrohet drejtpërdrejt mbi kapitalet dhe asetet financiare të shoqërisë, pasi ato janë në pronësi të shoqërisë.

Një dallim i madh mes aksionit dhe kuotës është dhe fakti që në shoqëritë aksionere me ofertë publike aksionet janë tituj të pjesëmarrjes në kapital,⁵⁷⁷ të tregtueshëm në tregjet financiare, si dhe të hapur për t'u blerë nga publiku i gjerë. Në nenin 3 të ligjit 62/2020 "Për tregjet e kapitalit", në pikën 36 të tij, përcaktohet se çfarë janë titujt e pjesëmarrjes në kapital.⁵⁷⁸ Pra aksionet mund të konceptohen dhe si pjesë (fraksione) me vlerë të barabartë të kapitalit të shoqërisë, të cilat bëjnë të mundur një transferim sa më të lehtë të kapitalit të shoqërisë te subjektet e tjera. Duke siguruar kështu, fleksibilitet në shitjet e këtyre titujve dhe akumulimin të sa më shumë parave si kapital për shoqërinë aksionare, e cila i ka ofruar publikut aksionet e saj për nënshkrim dhe blerje.

Në literaturën juridike vendase dhe të huaj, aksionet janë përfshirë te kategoria e sendeve të luajtshme të patrupëzuara. Andrea Nathanaili që në vitet shtatëdhjetë të shekullit të kaluar, i konsideron aksionet si letra me vlerë, të cilat janë sende të një natyre të veçantë.⁵⁷⁹

Së dyti, ligji ka parashikuar një minimum të domosdoshëm për kapitalin e nënshkruar (i njohur dhe si kapitali themeltar dhe/ose kapitali i regjistruar) të shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar, por ky minimum ligjor është në një vlerë krejtësisht simbolike prej 100

⁵⁷⁵ Andrea Nathanaili dhe Nazmi Biçoku, *E drejta civile e Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë, Pjesa e përgjithshme 2* (Universiteti i Tiranës "Enver Hoxha" 1987) fq. 16.

⁵⁷⁶ Neni 141 i Kodit Civil përcakton se: "*Send është çdo gjë që mund të përbëjë objekt pronësie ose i të drejtës tjetër reale.*"

⁵⁷⁷ Sipas pikës 36 të nenit 3 të ligjit Ligji 62/2020 "Për tregjet e kapitalit" [2020] FZ 131:

"Tituj të pjesëmarrjes në kapital" janë aksionet dhe instrumentet e tjera financiare të transferueshme, ekuivalente me aksionet e shoqërive tregtare, si dhe çdo lloj tjetër instrumenti financiar i transferueshëm, i cili jep të drejtën për të blerë këto instrumente financiare, si pasojë e konvertimit të tyre ose e ushtrimit të të drejtave që rrjedhin nga to, me kusht që instrumentet financiare të llojit të dytë të emetohen nga emetuesi i aksioneve bazë ose nga një subjekt që i përket grupit të emetuesit në fjalë."

⁵⁷⁸ Për më shumë shih Ligjin 62/2020 "Për Tregjet e Kapitalit". Ky ligj ka shfuqizuar bazën ligjore të mëparshme për titujt dhe konkretisht sipas nenit 378 të tij; "*Me hyrjen në fuqi të këtij ligji, ligji nr.9879, datë 21.2.2008, "Për titujt", si dhe ligji Nr.10158, datë 15.10.2009, "Për obligacionet e shoqërive aksionare dhe të qeverisë vendore" shfuqizohen*"

⁵⁷⁹ Argita Malltezi, Jonida Rystemaj dhe Armela Kromiçi, *Gjykatat Shqiptare mbi shoqëritë dhe veprimtarinë Tregtare* (Shtëpia botuese "Mediaprint" 2015) fq. 18.

lekësh.⁵⁸⁰ Ndërsa për shoqëritë aksionare ligji ka parashikuar vlera shumë më të larta, përse i përket kapitalit të nënshkruar, i konsideruar ndryshe dhe si kapitali themeltar i shoqërisë. Në nenin 107 të ligjit 9901/2008, përcaktohet se kapitali minimal themeltar për një SHA me ofertë private është 3.500.000 lekë, ndërsa për një SHA me ofertë publike është 10.000.000 lekë.⁵⁸¹

Pra, këto vlera të kapitalit minimal të domosdoshëm janë vlera domethënëse, të cilat kanë një rëndësi të padiskutueshme në aspektin e potencialit financiar për një shoqëri të sapoformuar. Gjithashtu, edhe për kreditorët e këtyre shoqërive tregtare një rëndësi të madhe paraqet fakti që shoqëria ka një kapital substancial të domosdoshëm, i cili është dhe detyrim ligjor. Kjo është një karakteristikë tipike e shoqërive të kapitalit, në të cilat garancitë e kreditorëve sigurohen pikërisht me kapitalet e shoqërisë dhe jo nga cilësitë personale të aksionerëve apo ortakëve. Si rrjedhim mund të themi që shoqëria aksionare manifeston karakteristikat e shoqërive të kapitalit në mënyrë më të qartë sesa shoqëria me përgjegjësi të kufizuar.

Në versionin fillestar të ligjit Nr.9901/2008 “Për shoqëritë tregtare”, kapitali minimal i kërkuar për SHA-të me ofertë private ka qenë në vlerën prej 2.000.000 lekësh.⁵⁸² Por, me ndryshimet që i janë bërë këtij ligji me ligjin Nr.10 475, datë 27.10.2011, është ndryshuar pika e parë e nenit 107, duke e rritur kapitalin minimal edhe për SHA-të me ofertë private në vlerën 3.500.000 lekë.⁵⁸³ Ky ndryshim u bë me qëllim për ta përshtatur rregullimin e kapitalit minimal të shoqërive aksionare me Direktivën e Dytë të Keshillit (të BE) e cila përcakton një vlerë prej 25000 euro si kapital minimal i regjistruar për këto lloj shoqërish.⁵⁸⁴

Së treti, ligji ka parashikuar mundësinë që për shoqëritë aksionare (vetëm për shoqërinë aksionare me ofertë publike) të ofrojnë kapitalet e tyre për nënshkrim publikut të gjerë duke i ftuar ata të bëhen aksionerë.⁵⁸⁵ Në këtë mënyrë shoqëritë aksionare janë forma e vetme e shoqërive tregtare, që mund akumulojnë një kapital shumë të madh financiar nga një numër shumë i madh investitorësh. Madje ligje të veçanta që rregullojnë fusha të posaçme të

⁵⁸⁰ Ligji 9901/2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” i ndryshuar, neni 70.

⁵⁸¹ Sipas nenit 107 të Ligjit 9901/2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” i ndryshuar, përcakton se: “1. Shoqëria aksionare me ofertë private nuk mund të ketë një kapital më të vogël se 3 500 000 lekë. 2. Shoqëria aksionare me ofertë publike nuk mund të ketë një kapital më të vogël se 10 000 000 lekë.”

⁵⁸² Po aty.

⁵⁸³ Ligji 10475/2011 “Për një ndryshim në ligjin nr.9901, datë 14.4.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” [2011] FZ 152.

⁵⁸⁴ Second Council Directive 77/91/EEC of 13 December 1976 on coordination of safeguards which, for the protection of the interests of members and others, are required by Member States of companies within the meaning of the second paragraph of Article 58 of the Treaty, in respect of the formation of public limited liability companies and the maintenance and alteration of their capital, with a view to making such safeguards equivalent [1977] OJ L 26/1.

⁵⁸⁵ Thomas Bachner, Edmund-Philipp Schuster dhe Martin Winner (n 203) fq. 120.

veprimtarisë tregtare, përcaktojnë formën e shoqërisë aksionare si kusht për licensimin e këtyre bizneseve. Në këto raste ligji i posaçëm vendos edhe kufinj të tjerë shumë herë më të lartë sesa kufiri i kapitalit minimal të parashikuar në nenin 107 të ligjit për tregtarët dhe shoqëritë tregtare. Sektorë të tillë ekonomikë, janë sektori bankar,⁵⁸⁶ sektori i sigurimeve⁵⁸⁷ etj.

Gjithashtu, shoqëria aksionare është forma e vetme e shoqërive tregtare, e cila kapitalet e saj (të përfaqësuara nga aksionet), mundet që t'i ofrojë për tregtim në tregjet financiare të titujve (në bursë). Ndërsa shoqëria me përgjegjësi të kufizuar nuk mund të ofrojë kapitalin në tregjet financiare dhe as t'i ofrojë për nënshkrim publikut të gjerë. Kjo për shkak se SHPK-të nuk janë shoqëri të mirëfillta kapitali, pasi këto shoqëri konsiderohen shoqëri me natyrë mikse, pra kanë dhe karakteristikat e shoqërive të personit.

Nëse i referohemi vlerës minimale ligjore të kapitalit themeltar të SHPK-ve (kapitalit të ligjor), është e qartë që nuk ofrojnë atë nivel garancie që ofron një SHA për kreditorët e saj, pasi SHPK-ja mund të themelohet edhe me një vlerë simbolike prej vetëm 100 lekësh.

Së katërti, duke pasur parasysh dallimet e këtyrë dy lloj shoqërisë, në aspektin kapitalit, të analizuar më lart, si minimumi ligjor apo mundësia për të emetuar aksione publikut të gjerë, mund të themi se këto dy forma shoqërisë paraqesin një dallim të madh, përse i përket edhe numrit potencial të subjekteve që disponojnë pjesët e kapitalit të tyre (ortakët apo aksionerët). SHPK-të, duke ruajtur edhe karakteristika të shoqërive të personit, (siç është rëndësia e njohjes personale të ortakëve me njëri-tjetrin dhe vlera simbolike e kapitalit minimal të kërkuar nga ligji) nuk synojnë të bashkojnë një numër shumë të madh të ortakëve themelues. Për rrjedhojë, edhe kapitalet që mund të akumulojë një SHPK, janë më të vogla sesa një SHA. Megjithatë në praktikën tregtare shqiptare ka edhe SHPK, të cilat kanë operuar me sukses në sektorë të rëndësishëm ekonomikë me kapitale shumë të mëdha financiare. Ndërkohë që shoqëritë aksionare si shoqëri kapitali, konsiderohen një formë shoqërie, e cila synon të ftojë një numër sa më të madh aksionarësh, të cilët të bëjnë të mundur grumbullimin e një kapitali financiar në vlera shumë të larta, i cili shërben për kryerjen atyre veprimtarive tregtare që kërkojnë kapitale shumë të mëdha financiare. Kjo vlen vetëm për shoqëritë aksionare me ofertë publike, të cilat edhe aktualisht në Shqipëri janë shumë të pakta⁵⁸⁸ Ndërsa te SHA-të me ofertë private, ky dallim është më i zbehtë ose nuk ekziston fare.

Së pesti, shoqëria me përgjegjësi të kufizuar paraqet një mënyrë organizimi më të thjeshtë se shoqëria aksionare. Ligji parashikon dy organe drejtuese për SHPK-të, konkretisht;

⁵⁸⁶ Ligji 9662/2006 “Për Bankat në Republikën e Shqipërisë” [2006] FZ 149.

⁵⁸⁷ Ligji 52/2014 “Për veprimtarinë e Sigurimit dhe Risigurimit” [2014] FZ 93.

⁵⁸⁸ QKB, “Kërko për statusin e aplikimit të subjektit” <<https://qkb.gov.al/kerko/kerko-ne-regjistritin-tregtar/kerko-per-statusin-e-aplikimit-te-subjektit/>> aksesuar më 30 nëntor 2020.

Asamblenë e Ortakëve si organ vendimmarrës dhe Administratorin si përfaqësues i shoqërisë dhe gjithashtu, me kompetencat kryesore administruese.⁵⁸⁹ Ndërsa te shoqëritë aksionare, ligji ka parashikuar një strukturë më të ndërlikuar të organizimit dhe drejtimit.⁵⁹⁰ Në këto shoqëri, ndryshe nga SHPK-të, ligji ka parashikuar disa alternativa të ndryshme të organizimit dhe administrimit, të cilat u japin mundësi aksionerëve themelues që të zgjedhin mënyrën që e konsiderojnë më të përshtatshme në momentin e themelimit të saj. Por, nga momenti që është zgjedhur një model i caktuar, i pasqyruar në statutin e shoqërisë, ky model është i detyrueshëm për këtë shoqëri.

Njëri model i drejtimit të shoqërive aksionare, parashikon një strukturë më një nivel drejtimi të shoqërisë. Ky është i njohur si «modeli me një nivel drejtimi». Sipas këtij modeli, të gjitha funksionet administruese dhe të mbikëqyrjes, përqëndrohen në një strukturë të vetme, që është Këshilli i Administrimit. Megjithatë, edhe në një rast të tillë, Këshilli ia delegon shumicën e funksioneve një administratori të caktuar nga vetë Këshilli.⁵⁹¹

Në fakt, edhe sipas këtij modeli, organizimi i administrimit të shoqërisë parashikon dy organe. Njëri organ është kolegjal, Këshilli i Administrimit, i cili ka kompetencat e parashikuara në nenin 154 të Ligjit.⁵⁹² Ndërsa organi tjetër është Administratori i zgjedhur nga Këshilli i Administrimit për të bërë përfaqësimin juridik të shoqërisë.⁵⁹³ Gjithashtu, në nenin 154 pika "f" ku renditen kompetencat e Këshillit të Administrimit, parashikohet që ky këshill është kompetent për të caktuar një apo më shumë administratorë, dhe të ndajë kompetencat e tyre kur ka caktuar më shumë se një të tillë.⁵⁹⁴

Ndërsa modeli tjetër i drejtimit të shoqërive aksionare, parashkon dy nivele drejtuese të kësaj shoqërie. Ky është i njohur si "modeli me dy nivele drejtimi".⁵⁹⁵ Sipas këtij modeli, përveç asamblesë së aksonerëve të shoqërisë si organ vendimmarrës, shoqëria do të ketë dy nivele të tjera drejtuese. Këto janë administratorët, të cilët janë përgjegjës për

⁵⁸⁹ Ligji 9901/2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" i ndryshuar, neni 81, 82 dhe 95 e vijues.

⁵⁹⁰ Ligji 9901/2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" i ndryshuar, neni 135 e vijues.

⁵⁹¹ Ligji 9901/2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" i ndryshuar, neni 158.

⁵⁹² Ligji 9901/2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" i ndryshuar, neni 154.

⁵⁹³ Sipas nenit 158/1 të Ligjit 9901/2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" i ndryshuar, parashikohet që:

"1. Këshilli i administrimit emëron një ose më shumë persona fizikë si administratorë të shoqërisë, për një afat të përcaktuar në statut, i cili nuk mund të jetë më i gjatë se 3 vjet. Administratorët e shoqërisë mund të rizgjidhen. Anëtarët e këshillit të administrimit mund ta kryejnë detyrën e administratorit për sa kohë shumica e anëtarëve të këshillit të administrimit janë anëtarë të pavarur, që nuk kryejnë këtë detyrë. Emërimi prodhon pasojë pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit dhe të drejtat e të tretëve mbrohen sipas nenit 12 të këtij ligji. Statuti mund të vendosë rregulla të posaçme për emërimin".

⁵⁹⁴ Neni 154/f i Ligjit 9901/2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" i ndryshuar, përcakton se: "f) të emërojë dhe të shkarkojë administratorët, të ndajë kompetencat ndërmjet tyre."

⁵⁹⁵ Ligji 9901/2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" i ndryshuar, neni 166.

administrimin e përditshëm të shoqërisë dhe përfaqësimin e saj, si dhe Këshilli Mbikëqyrës i cili ka në kompetencë të kontrollojë vënien në zbatim të politikave tregtare nga administratori dhe përputhjen e tyre me ligjin dhe statutin. Pra, të mbikëqyrë punën e administratorëve.⁵⁹⁶

Madje në sistemin me dy nivele drejtimi, neni 167 i ligjit ka parashikuar dhe dy nënmodele të tjera alternative, të cilat mund të zgjidhen nga ana e aksionerëve themelues në momentin kur janë duke konstituuar shoqërinë. Brenda modelit me dy nivele drejtimi, aksionerët janë të lirë të zgjedhin dy alternativa të ndryshme të emërimit të administratorit, në varësi të faktit se sa duan të përfshihen në procesin e kontrollit të administratorit. Sipas njërit prej varianteve, parashikohet mundësia që administratori të emërohet në këtë pozicion nga Këshilli Mbikëqyrës dhe gjithashtu të shkarkohet nga ky organ.⁵⁹⁷ Ndërsa mënyra tjetër e lejuar nga ligji është që administratori të emërohet dhe të shkarkohet nga Asambleja e Aksionerëve.

Nga analiza e këtyre dispozitave konstatohet se, ndryshe nga SHPK-të, administrimi i SHA-ve realizohet në një mënyrë më komplekse dhe të shumëllojshme.

Së gjashti, aplikimi i institutit të përjashtimit dhe largimit të ortakut. Në nenet 101 dhe 102 të ligjit 9901/2008, janë parashikuar institutet e largimit dhe të përjashtimit të ortakut të shoqërisë.⁵⁹⁸ Këto institute të largimit dhe përjashtimit, nuk rezultojnë të jenë parashikuar në pjesën e dispozitave që rregullojnë shoqëritë aksionare. E vetmja dispozitë që parashikohet në pjesën e SHA-ve në këtë aspekt, është neni 124,⁵⁹⁹ sipas të cilit, aksionarit që nuk shlyen vlerën kapitalit të nënshkruar, shoqëria do t'i anulojë aksionet e tij, që i përkon vlerës së pashlyer, duke bërë zvogëlimin e kapitalit.⁶⁰⁰

Sipas nenit 102 të ligjit, në një SHPK parashikohet mundësia e ortakëve të tjerë që të marrin një vendim në Asamble, për t'iu drejtuar gjykatës me një kërkesë për përjashtimin e ortakut, i cili me veprimet e tij me faj i ka shkaktuar dëm shoqërisë, ose kur ortakut nuk ka

⁵⁹⁶ Sipas nenit 166/1 të ligjit 9901/2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” i ndryshuar, përcaktohet: *“1. Në sistemin e administrimit me dy nivele, administratorët drejtojnë shoqërinë dhe marrin vendime për mënyrën e vënies në zbatim të politikave tregtare, ndërsa Këshilli Mbikëqyrës, në cilësinë e organit mbikëqyrës, këqyr vënien në zbatim të këtyre politikave dhe përputhjen e tyre me ligjin dhe statutin”*

⁵⁹⁷ Në nenin 167 pika 2 të ligjit Ligji 9901/2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” i ndryshuar, përcaktohet se: *“2. Në bazë të parashikimeve të statutit, administratorët mund të emërohen dhe shkarkohen, në përputhje me pikat 1 e 2 të nenit 158 të këtij ligji, nga asambleja e përgjithshme apo nga këshilli mbikëqyrës.”*

⁵⁹⁸ Ligji 9901/2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” i ndryshuar, nenet 101-102.

⁵⁹⁹ Sipas nenit 124/3 të ligjit 9901/2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” i ndryshuar: *“3. Nëse aksionari nuk shlyen kontributet në para, brenda 3 muajve nga përfundimi i afatit të përcaktuar në pikën 2 të këtij neni, shoqëria mund të zvogëlojë kapitalin për vlerën e kontributit të pashlyer e të anulojë aksionin, sipas nenit 186 të këtij ligji.”*

⁶⁰⁰ Argita Malltezi, *E drejta shqiptare e shoqërive tregtare* (Shtëpia botuese “Mediaprint” 2011) fq. 232.

shlyer kontributin e tij, sipas parashikimeve të statutit, apo nëse ekzistojnë shkaqe të tjera të arsyeshme për përjashtimin. Kjo dispozitë në pikën 2 të saj, i ka përcaktuar se cilat do të konsiderohen shkaqe të arsyeshme për të kërkuar përjashtimin e ortakut.⁶⁰¹

Konsiderohen shkaqe të arsyeshme për përjashtimin e ortakut, ato raste kur ortaku me faj (në formën e dashjes ose pakujdesisë së rëndë) u shkakton shoqërisë, ose ortakëve të tjerë një dëm, kur ortaku ka shkelur statutin me faj, kur ortaku me veprimet e tij e bën të pamundur vazhdimin e marrëdhënies me shoqërinë, apo kur ai bëhet pengesë për veprimtarinë tregtare.⁶⁰²

Sipas kësaj dispozite është përcaktuar dhe shkalla e fajit në veprimet e ortakut, duke kategorizuar si faj veprimet e kryera me dashje ose pakujdesi të rëndë. Gjithashtu kjo dispozitë e lë të hapur mundësinë e përfshirjes edhe të rasteve të tjera, që mund të konsiderohen si shkaqe të arsyeshme, përveç atyre të numëruara në nenin 102/2 të ligjit. Pra, kjo listë nuk është shteruese, por orientuese. Gjithsesi, organi që vendos përfundimisht nëse shkakut është apo jo i arsyeshëm, do të jetë gjykata.

Ndërsa instituti i largimit të ortakut është parashikuar në nenin 101 të ligjit⁶⁰³ dhe lejon që një ortak i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar të tërhiqet (largohet) nga shoqëria kur kjo e fundit, apo ortakët e tjerë i kanë shkakuar dëm, kur është penguar në të drejtat e tij, apo me veprime të tjera e kanë bërë të pamundur vazhdimin e ortakërisë.

Të dyja këto insitute, qoftë përjashtimi i ortakut, apo largimi (tërheqja) i ortakut, janë institute të reja, të cilat janë përfshirë në ligjin 9901/2008 dhe nuk kanë ekzistuar në legjisllacionin shqiptar, që pas shfuqizimit të Kodit Tregtar të vitit 1932 (i cili i parashikonte).⁶⁰⁴ Këto janë koncepte, të cilat i japin shoqërisë fleksibilitet në zgjidhjen e

⁶⁰¹ Në nenin 102 pika 2 të ligjit 9901/2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” i ndryshuar, përcaktohet se

“konsiderohen shkaqe të arsyeshme për përjashtimin e ortakut, por pa u kufizuar në to, rastet kur ortakut:

- a) me dashje apo me pakujdesi të rëndë u shkakton dëme shoqërisë ose ortakëve të tjerë;*
- b) me dashje apo me pakujdesi të rëndë shkel statutin ose detyrimet e përcaktuara me ligj;*
- c) përfshihet në veprime, të cilat e bëjnë të pamundur vazhdimin e marrëdhënies midis shoqërisë tregtare dhe ortakut; ose*
- ç) me veprimet e tij dëmton ose pengon ndjeshëm veprimtarinë tregtare të shoqërisë.”*

⁶⁰² Ligji 9901/2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” i ndryshuar, neni 102.

⁶⁰³ Sipas nenit 101/1 të ligjit 9901/2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” i ndryshuar: “1. Ortaku mund të largohet nga shoqëria nëse ortakët e tjerë ose shoqëria kanë kryer veprime në dëm të tij, nëse është penguar të ushtrojë të drejtat e tij, nëse shoqëria i ka ngarkuar detyrime të paarsyeshme apo për shkaqe të tjera, që e bëjnë të pamundur vazhdimin e ortakërisë.”

⁶⁰⁴ Shih analizën për Kodin Tregtar të vitit 1932 në këtë punim “3.1.2. Kodi Tregtar i vitit 1932”.

shumë situatave të ndryshme konfliktuale. Edhe praktika gjyqësore⁶⁰⁵ ka treguar se këto institute kanë gjetur një zbatim të pasur që nga hyrja në fuqi e ligjit aktual e deri aktualisht.

Këto institute nuk janë parashikuar për shoqëritë aksionare për shkak të kërkesave të Direktivës së Dytë të KE, sipas së cilës kërkohet ruajtja e kapitalit të shoqërive aksionere dhe ndalohet kthimi i kapitalit të aksioneri.⁶⁰⁶ SHA-të si shoqëri të mirëfillta kapitali, presupozohen me një rreth të zgjeruar aksionerësh në rolin e investitorit, që akumulojnë kapitale të mëdha. Këto shoqëri kanë rregulla striktë të organizimit dhe drejtimit, duke pasur parasysh dhe impaktin dhe peshën specifike më të madhe që ka në sistemin ekonomik kjo lloj shoqërie. Gjithashtu strukturat e mirëorganizuara të qeverisjes dhe drejtimit të SHA-ve, normalisht reduktojnë në minimum ndikimin dhe rolin e veprimeve individuale të aksionerëve, për rrjedhojë, dhe dëmet që mund t'i vijnë shoqërisë nga këto veprime, janë më të vogla.⁶⁰⁷ Për këto arsye, ligjivënësi nuk ka parashikuar insitutet e përjashtimit dhe largimit në dispozitat që rregullojnë shoqëritë aksionare, por i ka parashikuar për SHPK-të.

⁶⁰⁵ Shih analizën rreth insitutit të largimit dhe përjashtimit në këtë punim “7.9. Largimi dhe Përjashtimi i ortakëve”.

⁶⁰⁶ Second Council Directive 77/91/EEC of 13 December 1976 on coordination of safeguards which, for the protection of the interests of members and others, are required by Member States of companies within the meaning of the second paragraph of Article 58 of the Treaty, in respect of the formation of public limited liability companies and the maintenance and alteration of their capital, with a view to making such safeguards equivalent [1977] OJ L 26/1.

⁶⁰⁷ Argita Malltezi, *E drejta shqiptare e shoqërive tregtare* (Shtëpia botuese “Mediaprint” 2011) fq. 233.

KREU V

5. Themelimi i Shoqërive me Përgjegjësi të Kufizuar sipas Ligjit në Fuqi

5.1. Procedura e regjistrimit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar

Për themelimin e një SHPK-je, ligji parashikon një procedurë të thjeshtë, e cila mund të realizohet në një kohë të shkurtër dhe me një kosto minimale, pothuajse të papërfillëshme në pikëpamjen financiare.⁶⁰⁸ Momenti i parë në themelimin e një SHPK-je, fillon me lindjen e vullnetit për të organizuar biznesin në formën e SHPK-së nga ortaku apo ortakët themelues. Nëse ka më shumë se një ortak, që shprehin vullnetin për të themeluar në mënyrë të përbashkët një SHPK, atëherë kërkohet përputhja e vullnetit të tyre njësoj si në çdo kontratë tjetër me shumë palë. Ky moment i shfaqjes dhe përputhjes së vullnetit të subjekteve të ndryshme për të themeluar një SHPK, materializohet në një akt me karakter rregullativ që quhet *statut* i shoqërisë.⁶⁰⁹

Në vazhdim ortakët themelues paraqesin kërkesën për regjistrimin e shoqërisë pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit dhe shoqëria regjistrohet në Regjistrin Tregtar. Në momentin kur QKB pranon aplikimin për regjistrimin e shoqërisë në regjistrin Tregtar, dhe lëshon ekstraktin përkatës, shoqëria konsiderohet e themeluar dhe fiton personalitetin juridik të veçantë si subjekt i pavaruar i së drejtës, i ndryshëm nga ortakët themelues të shoqërisë.⁶¹⁰

Nëse një SHPK do të themelohet nga një ortak i vetëm, atëherë mjafton shfaqja e njëanëshme e vullnetit të këtij ortaku, i cili pasi ka vendosur që të organizojë strukturën e sipërmarrjes së tij tregtare në formën e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar. Për të realizuar këtë, ai duhet të ndjekë dhe hapat e nevojshëm për regjistrimin e kësaj shoqërie në QKB. Qendra Kombëtare e Biznesit është një institucion i krijuar me ligjin Nr 131/2015 “Për Qendrën Kombëtare të Biznesit”.⁶¹¹ Sipas këtij ligji QKB është një institucion, i cili ka përfshirë procedurat e regjistrimit dhe të licensimit të biznesit në Shqipëri, të cilat më parë ushtroheshin nga dy institucione të veçanta, si Qendra Kombëtare e Regjistrimit dhe Qendra Kombëtare e Licensimit.⁶¹²

⁶⁰⁸ Ligji 9723/2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit” [2007] FZ 60, neni 22 e vijues.

⁶⁰⁹ Ligji 9901/2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” i ndryshuar, neni 6.

⁶¹⁰ Ligji 9901/2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” i ndryshuar, neni 3/3.

⁶¹¹ Shih Ligjin 131/2015 “Për Qendrën Kombëtare të Biznesit” [2015] FZ 215

⁶¹² Sipas nenit 3 të ligjit 131/2015 “Për Qendrën Kombëtare të Biznesit”:

“1. QKB ka këto funksione:

a) mban regjistrin tregtar, në përputhje me ligjin që rregullon regjistrimin e biznesit;

b) kryen regjistrimet në regjistrin tregtar, në përputhje me dispozitat e ligjit që rregullon regjistrimin e biznesit;

Regjistri tregtar është një regjistër unik, në të cilin regjistrohen të gjitha shoqëritë tregtare si persona juridikë. Sipas neni 3 të ligjit për QKB përcaktohet se Regjistri Tregtar, si dhe regjistrimet e shoqërive në këtë regjistër mbahen nga QKB. Në këtë regjistër regjistrohen edhe disa organizime të tjera, pavarësisht faktit nëse gëzojnë personalitet të veçantë juridik apo jo.

Neni 5/1 i ligjit Nr.9723/2007 për QKB, parashikon infrastrukturën institucionale të këtij institucioni.⁶¹³ Sipas këtij parashikimi, rezulton se infrastruktura juridike dhe institucionale në shërbim të sipërmarrësve dhe tregtarëve në Shqipëri, ofron një fleksibilitet dhe lehtësi të madhe në procedurat e regjistrimit të shoqërive tregtare. Kjo do të thotë që një SHPK mund të themelohet dhe të regjistrohet në vendin e banimit të subjekteve themelues, pavarësisht se ata mund të jenë në qytete të ndryshme të Shqipërisë. Në këtë mënyrë ortakët themelues të një SHPK-je kanë mundësi të kursejnë disa kosto transporti, por dhe kosto të angazhimit në kohë, me mundësinë e regjistrimit të shoqërisë në sportelet e QKB pranë njësive të qeverisjes vendore.

Edhe neni 22 të ligjit Nr.9723/2007 për QKB,⁶¹⁴ parashikon detyrimin e SHPK-ve për t'u regjistruar në QKB. Sipas pikës "b" të paragrafit 3 të këtij neni parashikohet që SHPK-të duhet të aplikojnë për regjistrim në QKB brenda 30 ditëve kalendarike nga data e themelimit, dhe nuk mund të fillojnë veprimtarinë tregtare pa u regjistruar.

c) kryen regjistrimin e subjekteve të përcaktuara në ligjin që rregullon regjistrimin e biznesit, për qëllim të regjistrimit fiskal, të sigurimeve shoqërore e shëndetësore, si dhe të inspektimit të marrëdhënieve të punës;

ç) lëshon certifikata, ekstrakte të regjistrimeve dhe kopje të vërtetuara të akteve të depozituara, sipas përcaktimit të ligjit që rregullon regjistrimin e biznesit;

d) publikon të dhënat e regjistruara, sipas ligjit që rregullon regjistrimin e biznesit, si dhe siguron aksesin e lirë të publikut në to;

dh) trajton procedurat e licensimit, të autorizimit apo të lejeve, të ndryshimit dhe revokimit të tyre, sipas ligjit që rregullon licensat, autorizimet dhe lejet;

e) mban dhe administron Regjistrin Kombëtar të Licensave, Autorizimeve dhe Lejeve, në përputhje me ligjin që rregullon licensat, autorizimet dhe lejet;

ë) siguron aksesin e lirë të publikut në Regjistrin Kombëtar të Licensave, Autorizimeve dhe Lejeve, në përputhje me ligjin që rregullon licensat, autorizimet dhe lejet;

f) informon dhe këshillon personat e interesuar për procedurat e regjistrimit të biznesit, si dhe procedurat e licencimit, autorizimit e lejimit;

g) jep mendim për çdo nismë ligjore apo nënligjore në fushën e regjistrimit të biznesit dhe të licensave, autorizimeve e lejeve;

gj) kryen studime për cilësinë e mjedisit rregullator, mbështet me informacion, analiza e këshilla ministrin, Këshillin e Ministrave apo institucionet qendrore dhe të pavarura, në lidhje me nismat e tyre normative dhe organizative në fushën e regjistrimit të biznesit dhe të licensave, autorizimeve e lejeve, si dhe asiston në përgatitjen e politikave për përmirësimin e mjedisit rregullator në këtë fushë".

⁶¹³ Ligji 9723/2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit" i ndryshuar, neni 5/1.

⁶¹⁴ Ligji 9723/2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit" i ndryshuar, neni 22.

Gjithashtu, në nenin 32 të këtij ligji përcaktohen edhe elementet thelbësore, të cilat duhet të plotësohen në formularin e aplikimit për një shoqëri tregtare. Këto elemente janë:

- a) emri;
- b) forma;
- c) data e themelimit;
- ç) të dhënat e identifikimit të themeluesve;
- d) selia;
- dh) objekti, në qoftë se është i përcaktuar;
- e) kohëzgjatja, në qoftë se është e përcaktuar;
- ë) të dhënat e identifikimit të personave përgjegjës për administrimin dhe përfaqësimin e shoqërisë në marrëdhënie me të tretët, kompetencat e përfaqësimit, si dhe afatet e emërimit të tyre.
- f) specimenet e nënshkrimit (firmave) të personave, që përfaqësojnë shoqërinë përpara të tretëve.⁶¹⁵

Ndërsa, në nenin 35 të ligjit përcaktohen dhe elementët shtesë të cilët duhet të plotësohen në rastin e regjistrimit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar.⁶¹⁶

Themeluesve të një SHPK-je, ju njihet e drejta që edhe para regjistrimit subjektivit të ardhshëm tregtar, ata mund bëjnë rezervimin e emrit të shoqërisë që kanë në plan të themelojnë në një të ardhme të afërt. Ligji për QKR i jep mundësi çdo individ që, duke paguar tarifën përkatëse, të rezervojë pranë regjistrimit tregtar, për llogari të tij apo të të tretëve, një apo më shumë emra të caktuar për regjistrimin.⁶¹⁷ Me rezervimin e emrit, kërkuesi fiton të drejtën që gjatë periudhës 30 ditore të afatit të rezervimit asnjë subjekt tjetër tregtar të mos regjistrohet me këtë emër të rezervuar.⁶¹⁸

⁶¹⁵ Ligji 9723/2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit” i ndryshuar, neni 32.

⁶¹⁶ Sipas nenit 35 të Ligjit 9723/2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit” i ndryshuar:

“Për regjistrimin fillestar të shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar, përveç sa parashikohet në nenin 32, të këtij ligji, është i detyrueshëm edhe njoftimi i vlerës së përgjithshme të kapitalit të nënshkruar, ndarja e kapitalit në një numër kuotash të barabarta me numrin e ortakëve, vlera dhe lloji i kontributit të secilit ortak, pjesa që kuota e secilit ortak zë në kapital, si dhe informacioni nëse kontributet e nënshkruara të kapitalit janë paguar ose jo.”

⁶¹⁷ Ligji 9723/2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit” i ndryshuar, neni 24/1.

⁶¹⁸ Sipas nenit 24 (pikat 4-6) të Ligjit 9723/2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit” i ndryshuar:
“4. Rezervimi i emrit, gjatë afatit të vlefshmërisë së parashikuar në këtë ligj, pengon të tretët të rezervojnë emra të njëjtë ose të ngjashëm, apo të regjistrojnë subjekte me të njëjtin emër ose emra të ngjashëm.

5. Rezervimi i emrit është i vlefshëm për një afat prej 30 ditësh, duke nisur nga data e rezervimit. Afati i rezervimit të emrit nuk mund të zgjatet. Rezervimi rishtazi nga i njëjti person i të njëjtit emër të rezervuar më parë vlerësohet si rezervim i ri dhe kryhet sipas rregullave të përgjithshëm për rezervimin e emrit, të parashikuar sipas këtij ligji.”

6. Verifikimi paraprak nëse një emër mund të regjistrohet ose jo, si dhe rezervimi paraprak i emrit, nuk përbëjnë kusht për regjistrimin fillestar, apo për ndryshimin e emrit të regjistruar.

5.2. Pasojat e regjistrimit

Nga momenti i regjistrimit të SHPK-së në Regjistrin tregtar, kjo shoqëri fiton personalitetin juridik si subjekt i së drejtës. Ky regjistrim është kusht që shoqëria të fitojë personalitetin juridik dhe të konsiderohet një entitet juridik i pavarur.⁶¹⁹

Veshja e shoqërisë tregtare me personalitet juridik të veçantë i jep asaj mundësinë të ketë të drejta dhe detyrime kundrejt të tretëve, por dhe kundrejt ortakëve të saj. Gjithashtu, shoqëria tregtare mund të jëtë palë ndërgjyqëse në procese gjyqësore, si palë paditëse apo si palë e paditur. Personaliteti i veçantë juridik, bën të mundur që shoqëria të zotërojë prona dhe figurojë në regjistrat e pasurive të paluajtshme apo regjistrat e pasurive të tjera që regjistrohen, (si psh. automjetet apo aksionet) si pronare e pasurive të saj. Madje një SHPK mund të disponojë dhe kuota apo aksione në një shoqëri tjetër tregtare me përgjegjesi të kufizuar apo aksionare, duke marrë kështu dhe rolin e ortakut apo aksionarit.

Pasuritë që janë në emër të shoqërisë, i shfrytëzon dhe administron vetë shoqëria dhe jo ortakët e saj.⁶²⁰ Ky administrim bëhet në interesin e shoqërisë në kuadër të aktivitetit tregtar të pasqyruar në statut apo në vendimet e asamblesë. Kjo vlen edhe në rastet kur shoqëria tregtare është shoqëri me një ortak të vetëm.⁶²¹ Me regjistrimin në QKB shoqëria me përgjegjesi të kufizuar njihet me emrin e vendosur nga ortakët themelues në statut, të cilës i shtohet dhe prapashtesa “SHPK”.⁶²²

Sipas nenit 23/1 të ligjit për QKR-në:

“ndalohet regjistrimi në regjistrin tregtar i subjekteve me emra të njëjtë ose të ngjashëm, me emra në trajtën e shquar apo shkurtimeve përkatëse të shteteve, qyteteve, krahinave gjeografike, organizatave ndërkombëtare, fetare ose institucioneve të pushtetit qendror apo vendor, pa shtesa dalluese ose me emra, që janë në kundërshtim me rendin e moralin publik apo me dispozitat urdhëruese të ligjit.”⁶²³

Shoqëria mund të përdorë, përveç emërtimeve tregtare, dhe shenja të tjera dalluese të veprimtarisë dhe i regjistrojnë këto në përputhje me nenin 44 pika 1 shkronja "a" të ligjit nr.9723/2007 “Për Qendrën Kombëtare të Biznesit”.⁶²⁴

⁶¹⁹ Neni 3 pika 3 i ligjit 9901/2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” i ndryshuar parashikon se:

“Shoqëritë tregtare fitojnë personalitetin juridik në datën kur kryhet regjistrimi i tyre në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit. Shoqëritë përgjigjen me të gjitha aktivet e tyre për detyrimet, që rrjedhin nga veprimtaritë e ushtruara”.

⁶²⁰ Philippe Malaurie dhe Laurent Aynes, “Les biens” *Le Biens* (botim i dytë, Botimet Defrenois 2005) fq. 36-37.

⁶²¹ Ligji 9901/2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” i ndryshuar, neni 3/1.

⁶²² Ligji 9901/2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” i ndryshuar, neni 4 pika 3.

⁶²³ Shih nenin 23/1 të ligjit 9723/2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit” i ndryshuar.

⁶²⁴ Ligji 9901/2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” i ndryshuar, neni 4.

5.3. Statuti i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar

Statuti është një akt i rëndësishëm, i cili duhet të miratohet nga ortakët themelues para se të bëhet regjistrimi i shoqërisë. Megjithatë ligji nr. 9723/2007 për QKB, në paragrafin 3 të nenit 28 të tij, parashikon mundësinë e hartimit edhe të një akti tjetër shtesë, që quhet *akt themelimi*⁶²⁵.

Pra, sipas ligjit për QKR parashikohet mundësia e ortakëve themelues që të hartojnë dy akte të ndryshme në momentin e themelimit të shoqërisë, gjithsesi nuk është i detyrueshëm hartimi i të dyja këtyre akteve, (statutit dhe aktit të themelimit) por vetëm në rast se vetë ortakët i kanë hartuar të ndara atëherë ato do të pranohen për depozitim pranë QKR. Ndërsa Ligji aktual Nr. 9901/2008, në nenin 6 të tij parashikon si akt për themelimin e shoqërisë dhe rregullimin e marrëdhënieve ndërmjet ortakëve, vetëm statutin e shoqërisë.⁶²⁶ Për të kuptuar arsyen se përse, ligji për QKR ka parashikuar që mund të paraqitet edhe një *akt themelimi*, duhet të kemi parasysh traditën e mëparshme të themelimit të shoqërive tregtare të bazuar në legjislacionin që ka qenë në fuqi deri në hyrjen në fuqi të ligjit Nr. 9901/2008.⁶²⁷

Para se të bëheshin reformimet e regjistrimit të shoqërive tregtare me ligjin e ri 9901/2008 si dhe ligjin Për Qendren Kombëtare të Regjistrimit (03.05.2007), doktrina i ka trajtuar këto dy dokumente si akte me karakter të ndryshëm, si në formë, edhe në përmbajtje, të rëndësishëm dhe të domosdoshëm për t'u hartuar para regjistrimit të shoqërisë në gjykatë. Akti i themelimit, në aspektin tradicional është konsideruar si një kontratë e themelimit të shoqërisë, në të cilën ortakët themelues shprehin vullnetin/pëlqimin për të bashkëpunuar së bashku në formën e një SHPK-je, duke përcaktuar edhe disa elemente thelbësore të kësaj shoqërie, si për shembull: ortakët e saj, kontributi i secilit ortak dhe mënyra e ndarjes së fitimit nga ortakët etj.⁶²⁸

Ndërsa Statuti përmban rregulla të hollësishëm të organizimit të saj të brendshëm, rregullat e funksionimit dhe administrimit të saj, rregullimin e marrëdhënieve mes ortakëve, si dhe mes këtyre dhe organeve të shoqërisë, mënyrat e zmadhimit të kapitalit, si dhe rregulla të tjerë, të cilët shmangin deri në minimumin e mundshëm lindjen e konflikteve brenda

⁶²⁵ Sipas nenit 28 pika 3 të ligjit Ligji 9723/2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit” i ndryshuar parashikohet:

“3. Shoqëritë tregtare regjistrohen në regjistrin tregtar, duke depozituar aplikimin për regjistrim fillestar, të plotësuar me të gjitha të dhënat e detyrueshme sipas këtij ligji, statutin dhe aktin e themelimit, në rast se janë hartuar si dy dokumente të veçanta, aktet e emërimit të organeve të shoqërisë, nëse nuk përfshihen në aktet e mësipërme, si dhe aktet e tjera të nevojshme për themelimin, sipas legjislacionit në fuqi.”

⁶²⁶ Ligji 9901/2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” i ndryshuar, neni 6.

⁶²⁷ Ligji 7638/1992 “Për shoqëritë tregtare” [1992] FZ 8 dhe Ligji 7667/1993 “Për regjistrin tregtar dhe formalitetet që duhen respektuar nga shoqëritë tregtare” [1993] FZ 1.

⁶²⁸ Jason Ellis, *Business and Company Legislation 2019/2020* (CLP Legal Practice Guides 2019) fq. 8.

shoqërisë tregtare.⁶²⁹ Dispozitat e statutit janë të detyrueshme vetëm për ortakët, ashtu si çdo kontratë, e cila sjell pasoja vetëm për palët kontraktuese.⁶³⁰

Në praktikën shqiptare të së drejtës së shoqërive tregtare, të periudhes së aplikimit të ligjit 7638/1992, shpesh ka ndodhur që këto akte të konfundohen dhe të mbivendosen. Në Vendimin nr. 487, datë 04. 03. 2003, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, ka arsyetuar se nuk është domosdoshmëri që akti i themelimit dhe statuti të ekzistojnë domosdoshmerisht si dy akte të veçanta.⁶³¹ Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë arsyeton në këtë vendim se të dyja këto aktet konvergjojnë në të njëjtin akt dhe se nuk është e nevojshme dallimi midis tyre, pasi kemi të bëjmë më të njëjtin akt themelimi dhe se ky është statuti.⁶³²

Studiues të së drejtës tregtare në vendin tonë, kanë bërë dallimin e qartë mes aktit të themelimit dhe statutit të shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar, duke sugjeruar që këto dy akte nuk duhet të mbivendosen me njëri-tjetrin.⁶³³ Gjithsesi, diskutimet dhe debatet rreth ekzistencës së këtyre dy akteve në momentin e themelimit të shoqërisë tashmë janë thjeshtëzuar, pas reformave të kuadrit ligjor të shoqërive tregtare me hyrjen në fuqi të ligjit Nr. 9901/2008, i cili siç u tha më lart parashikon si dokument të rëndësishëm vetëm statutin e shoqërisë, dhe nuk përmend fare aktin e themelimit.⁶³⁴ Për pasojë, nëse ortakët kanë

⁶²⁹ Frank Dornseifer, *Corporate Business Forms in Europe: A Compendium of Public and Private Limited Companies in Europe* (Sellier European Law Publishers 2005) fq. 275-277.

⁶³⁰ Mariana Semini Tutulani, *E drejta e detyrimeve dhe kontratave: pjesa e përgjithshme dhe pjesa e posaçme* (Real Stamp 2016) fq. 72.

⁶³¹ Shih Vendimin nr. 487, datë 04. 03. 2003, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë R.SH., i cili në arsyetim shprehet se: “Gjykata e Apelit pa të drejtë kërkon që për ekzistencën e kësaj shoqërie tregtare (të llojit sh.p.k.) është e nevojshme ekzistenca e njëkohshme e dy akteve të veçanta të karakterit themelues, pra të statutit dhe të aktit të themelimit”.

⁶³² Artan Hajdari shprehet se: “Ky konkluzioni i gjykatës është i gabuar, pasi kur flasim për akte themelimi të shoqërisë flasim për dy akte të ndryshme, si në formë, ashtu edhe në përmbajtje dhe konkretisht, për kontratën e themelimit ose aktin e themelimit, si dhe për statutin”. Hajdari (n 210) fq. 37.

⁶³³ Artan Hajdari (n 210) fq. 36 shprehet se:

“Dallimi midis këtyre dy akteve është thelbësor dhe ai fokusohet si në dallime të karakterit formal ashtu edhe në ato të karakterit të përmbajtjes. Ndërsa nga pikëpamja formale, të dyja këto akte duken sikur janë të njëjta, pasi respektojnë kritere të përbashkëta në hartimin e tyre, nga pikëpamja e përmbajtjes shprehin dallime thelbësore. Statuti i një shoqërie tregtare, në përmbajtjen e tij shpreh organizimin, funksionimin dhe strukturën administrative të shoqërisë, ndërsa kontrata shpreh raportet e detyrimeve të ortakëve apo aksionareve ndaj njëri-tjetrit dhe vetë shoqërisë që ata krijojnë. Ajo (kontrata apo akti i themelimit) nuk është gjë tjetër veçse pasqyrim i bazës së ekzistencës së shoqërisë në raport me ortakët apo aksionaret me vetë shoqërinë. Një tjetër dallim thelbësor është se statuti nuk mund të ndryshojë apo të tejkalojë ato rregulla që palët kanë rënë dakort në kontratën e themelimit të shoqërisë. Dallimi midis këtyre dy akteve, sidomos nga pikëpamja e përmbajtjes së tyre, ka një rëndësi të madhe praktike, por edhe doktrinale”.

⁶³⁴ Artan Hajdari shprehet se:

“Përsa i përket debatit nëse është e nevojshme ekzistenca e dy akteve, apo mjafton një statut për të përmbyllur kërkesat e regjistrimit të shoqërisë, mund të themi se atë e ka zgjidhur ligji, i cili aktualisht nuk kërkon domosdoshmërisht ekzistencën e të dyja akteve. Por, nëse themeluesit e një shoqërie do të zgjidhin hartimin e dy akteve, pra dhe të kontratës së themelimit, dhe të statutit, duhet të marrin në konsideratë ndryshimet mes tyre”.

hartuar statutin e shoqërisë, nuk paraqitet asnjë domosdoshmëri për hartimin e një akti, të titulluar si akt themelimi.

Përsa i përket përmbajtjes së statudit, për të katër format e shoqërive tregtare, neni 6 të ligjit 9901/2008, bën referimin në ligjin për QKB-në. Sipas këtij neni përcaktohet se statuti i shoqërisë përmban të dhënat e parashikuara nga ligji për QKB-në.⁶³⁵ Neni 28 paragrafi katër i ligjit 9723/2007 për QKB-në, përcakton se edhe SHPK-të mund të regjistrohen duke dorëzuar aplikimin për regjistrim dhe një deklaratë të posaçme.⁶³⁶ Pra është parashikuar mundësia që ortakët themelues të regjistrojnë një shoqëri të tillë, pa paraqitur një akt themelimi apo statut të shkruar, por vetëm duke nënshkruar formularin e aplikimit për regjistrim fillestar me të dhënat e nevojshme dhe një *“deklaratë të posaçme për njohjen, pranimin dhe zbatimin e dispozitave ligjore në fuqi për shpk-të”*.⁶³⁷ Në një situatë të tillë, formulari i aplikimit merr vlerën e statudit. Ky ndryshim u bë me qëllim thjeshtëzimin dhe lehtësimin e procedurave për regjistrimin e një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar, në kuadër të nxitjes së iniciativës së lirë ekonomike në Shqipëri.

Megjithëse ky parashikim, ka qenë në fuqi që nga viti 2007, nuk rezulton se është shfrytëzuar në mënyrë masive nga ortakët themelues të SHPK-ve. Një parashikim i tillë ka pasur si qëllim që të kursejë kohën dhe angazhimin e ortakëve themelues për t’u paraqitur te një noter publik për të nënshkruar statutin dhe aktin e themelimit, sipas traditës së ligjit 7638/1992. Po ashtu, një përcaktim i tillë, u kursente ortakëve themelues edhe kostot financiare për konsulencën juridike dhe për formalitetet që kryheshin pranë zyrës noteriale në hartimin e statudit dhe aktit të themelimit.

Por, nga ana tjetër, ky thjeshtëzim i procedurës shoqërohet njëkohsisht me angazhimin personal të të gjithë ortakëve themelues për t’u paraqitur pranë zyrës përkatëse të Qendrës Kombëtare të Regjistrimit, për të ezauruar procedurën e parashikuar më lart në nenin 28

Hajdari (n 210) fq. 37.

⁶³⁵ Ligji 9901/2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” i ndryshuar, në nenin 6 përcakton se *“Statuti i shoqërisë tregtare përmban të dhënat e përcaktuara në nenet 32 deri në 36 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”. Paragrafi i katërt i nenit 28 të ligjit të sipërpërmendur mbetet i zbatueshëm”*.

⁶³⁶ Ligji 9723/2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit” i ndryshuar në nenin 28 paragrafi 4 përcakton se:

“Shoqëritë kolektive, komandite dhe ato me përgjegjësi të kufizuar mund të regjistrohen, gjithashtu, duke depozituar vetëm aplikimin për regjistrim fillestar, të plotësuar me të gjitha të dhënat e detyrueshme sipas këtij ligji, dokumentet e identifikimit të anëtarëve apo ortakëve dhe duke nënshkruar deklaratën e posaçme për njohjen, pranimin dhe zbatimin e dispozitave ligjore në fuqi, për organizimin dhe funksionimin e llojit të shoqërisë që regjistrohet. Në këtë rast, aplikimi për regjistrim fillestar dhe deklarata e mësipërme, e nënshkruar sipas rastit nga ortakët, anëtarët ose nga personat e autorizuar të veprojnë në emër e për llogari të tyre, zëvendëson aktin e themelimit dhe statutin e shoqërisë.”

⁶³⁷ Po aty.

paragrafi 4 i ligjit Nr.9723/2007 për QKB.⁶³⁸ Ndërkohë që, në rast të paraqitjes së një statuti të shkruar pranë QKB, procedura e regjistrimit mund të kryhet vetëm nga administratori i caktuar në statut si përfaqësues i shoqërisë. Ky statut ka dhe vlerën e autorizimit të përfaqësuesit të ortakëve për të kryer procedurat e regjistrimit të shoqërisë. Megjithatë, ka dhe raste në praktikë, kur ortakët e hartojnë më vete aktin e autorizimit të përfaqësuesit të tyre, për të kryer këto procedura, por ky akt do të ishte i panevojshëm në kushtet kur përfaqësuesi pasqyrohet në statut si administrator i parë i shoqërisë.

Vlerësojmë se nuk është e rekomandueshme që ortakët themelues të një SHPK-je t'i privojnë vetes të drejtën për të pasur një statut, në të cilin përcaktohen rregullat e detajuar që lidhen me aspektet më të rëndësishme të saj, si; marrëdhëniet mes ortakëve, marrëdhëniet mes tyre dhe shoqërisë, rregullat e funksionimit, rregullat e administrimit të shoqërisë tregtare etj. Parashikimi i rregullave të detajuar në statut kontribuon në shmangien e konflikteve të mundshme eventuale, që mund të lindin mes ortakëve, apo mes tyre dhe organeve të shoqërisë. Pra, juridikisht është e këshillueshme që SHPK-të të miratojnë një statut sa më të plotë, me qëllim paracaktimin e rregullave të ortakërisë dhe funksionimit të SHPK-së, në elementet thelbësore të saj. Në këtë mënyrë statuti kontribuon në zvogëlimin e mundësisë së konflikteve eventuale në shoqëri dhe zgjidhjen e mosmarrëveshjeve.

Në referim të neneve 32 deri 36 të ligjit për QKB, në statutin e SHPK-së ortakët duhet të përfshijnë disa elemente, të cilët konsiderohen thelbësore për funksionimin e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar gjatë aktivitetit të saj tregtar. Megjithatë, ortakët themelues mund të përfshijnë në statut edhe rregulla dhe përcaktime të tjera në interes të mirëfunksionimit të shoqërisë.

5.4. Elementet thelbësore të statudit dhe autonomia statutore

Statuti i një SHPK-je duhet të pasqyrojë në mënyrë të qartë e të plotë, elementët të cilët janë të detyrueshëm për t'i plotësuar dhe në aplikimin e regjistrimit fillestar, sipas nenit 32 të ligjit 9723/2007 si:⁶³⁹

- a) Emri i shoqërisë, me të cilin ky subjekt do të identifikohet në marrëdhëniet tregtare dhe juridiko-civile me të tretët;
- b) Forma e shoqërisë. Ortakët themelues duhet të përcaktojnë në mënyrë të saktë formën e shoqërisë si shoqëri me përgjegjësi të kufizuar;
- c) Kohëzgjatja e shoqërisë nëse ortakët kanë caktuar një afat për ushtrimin e veprimtarisë tregtare në formën e SHPK-së që po themelojnë. Por ortakët

⁶³⁸ Po aty.

⁶³⁹ Ligji 9723/2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit" [2007] FZ 60, neni 32.

themelues mund të vendosin që shoqëria të themelohet pa përcaktuar një afat kohëzgjatjeje, pra pa afat. Edhe në rast se ortakët nuk janë shprehur fare në statut për kohëzgjatjen e shoqërisë, kjo heshtje duhet të interpretohet si kohëzgjatje pa afat. Në një situatë të tillë, shoqëria me përgjegjësi të kufizuar mund të vazhdojë veprimtarinë tregtare pa një afat të caktuar;

- d) Të dhënat e identifikimit të ortakëve themelues. Në rast se kemi ortak që janë persona juridikë, do të duhet të përshkruhet saktësisht emri dhe lloji i këtij personi juridik dhe të dhënat e regjistrimit nga regjistrat përkatës ku personi juridik është regjistruar, si dhe të dhënat e identifikimit të përfaqësuesit juridik të tij;
- e) Selia e shoqërisë, e cila i referohet vendit dhe adresës përkatëse ku do të ushtrojnë aktivitetin administrativ zyrat qendrore të SHPK-së dhe administratori i saj;
- f) Emrin dhe të dhënat e identifikimit të përfaqësuesit juridik, pra të administratorit apo të administratorëve, nëse shoqëria ka më shumë se një të tillë.
- g) Objekti i veprimtarisë së shoqërisë.⁶⁴⁰ Objekti mund të ketë lidhje me çfarëdolloj aktiviteti tregtar, me kushtin e vetëm që mos të jetë në kundërshtim me normat ligjore;
- h) Vlera e përgjithëshme e kapitalit të nënshkruar të shoqërisë. Ky njihet nga doktrina dhe si “Kapitali themeltar i shoqërisë”. Gjithashtu duhet të përcaktohet se në ç’formë është ofruar kapitali në momentin e themelimit të shoqërisë, në vlerë monetare apo në kapitale në natyrë. Në rast se janë aplikuar të dyja llojet e kapitalit, në statut duhet të pasqyrohet edhe vlerësimi i këtyre kapitaleve.
- i) Kontributin që ka secili ortak në kapitalin e nënshkruar të shoqërisë duke përcaktuar saktë llojin e kontributit (në para, apo në natyrë) dhe vlerën përkatëse të tij, si dhe informacioni nëse kontributet e nënshkruara të kapitalit janë paguar ose jo;
- j) Përcaktimin e vlerës së kuotës për seclin ortak të shoqërisë, duke e shprehur këtë vlerë si përqindje të pjesëmarrjes së ortakut në kapitalin e SHPK-së;
- k) Të dhënat e identifikimit të personave përgjegjës për administrimin dhe përfaqësimin e shoqërisë në marrëdhënie me të tretët, kompetencat e përfaqësimit, si dhe afatet e emërimit të tyre.
- l) Specimenet e nënshkrimit (firmave) të personave, që përfaqësojnë shoqërinë përpara të tretëve;
- m) Data e nënshkrimit të statutit.

⁶⁴⁰ Lidhur me këtë element të shoqërisë, neni 32 i ligjit 9723/2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit” [2007] FZ 60 e parashikon si element fakultativ dhe jo të detyrueshëm për t’u përcaktuar në statut. Megjithatë nga praktika e deritanishme rezulton se shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar, në pjesën dërrmuese të tyre, e kanë të përcaktuar objektin e veprimtarisë tregtare në statut.

Të dhënat e mësipërme janë të detyrueshme për t'u pasqyruar në çdo statut të shoqërive me përgjegjësi të kufizuar.⁶⁴¹ Megjithatë, nga praktika e veprimtarisë tregtare dhe kompleksiteti i marrëdhënieve juridiko-civile në këtë fushë, SHPK-të shpeshherë ekspozohen para situatave, në të cilat zgjidhja më e mirë do të vinte nëse statuti parashikon dispozita të qarta dhe u paraprin këtyre situatave.

Ligji aktual për tregtarët dhe shoqëritë tregtare u ka njohur ortakëve të SHPK-së një spektër të gjerë të lirisë statutore (apo autonomi statutore). Në këtë mënyrë ortakët mund të kontribuojnë në përmirësimin dhe plotësimin e kuadrit ligjor mbi të cilin do të ushtrojnë veprimtarinë shoqëria, duke përfshirë në statut dhe rregullime më të imtësishme se ato të listës së nenit 32 të ligjit për QKB, të cituar më lart. Edhe direktivat e KE rekomandojnë një angazhim aktiv të ortakëve në aktivitetin e shoqërisë tregtare.⁶⁴² Duke aplikuar në mënyrë profesionale këtë autonomi statutore ortakët mund të evitojnë situata që mund të dëmtojnë interesat e shoqërisë.⁶⁴³

Por ortakët themelues mund të vendosin edhe rregullime të tjera, që lidhen me funksionimin më të mirë të shoqërisë tregtare në të ardhmen. Të tillë rregulla mund të përfshijnë⁶⁴⁴ (pa u kufizuar vetëm në këtë listë):

- a) Parashikimin e së drejtës së parablerjes në rast të transferimit të kuotës (pjesës së tij në kapitalin e shoqërisë) nga një ortak i shoqërisë. Lidhur me të drejtën e kalimit të kuotave, në statut mund të parashikohen edhe kushtëzime të tjera, si psh., dhënia e pëlqimit nga organet e shoqërisë;⁶⁴⁵
- b) Parashikime të detajuara lidhur me situatat kur sjellja e ortakut do të konsiderohet e tillë që shkakton përjashtimin e tij nga shoqëria sipas paragrafit të dytë pika “b” dhe “ç” të nenit 102 të ligjit;⁶⁴⁶
- c) Rregullime më të detajuara lidhur me kompetencat e administratorit ose nëse shoqëria ka më shumë se një administrator, përcaktimin e mënyrës së ushtrimit të tagrave të administrimit;⁶⁴⁷

⁶⁴¹ Shih nenin 6 të ligjit 9901/2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” i ndryshuar i cili referon në nenin 32 dhe nenin 35 të ligjit 9723/2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit” i ndryshuar.

⁶⁴² Directive (EU) 2017/828/EC of the European Parliament and of the Council of 17 May 2017 amending Directive 2007/36/EC as regards the encouragement of long-term shareholder engagement (Text with EEA relevance) [2017] OJ L 132/1.

⁶⁴³ Hajdari (n 210) fq. 32.

⁶⁴⁴ Këtu janë përmblodhur parashikime të ndryshme ligjore në dispozitat e ligjit 9901/2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” i ndryshuar ku lejohet përcaktimi i rregullave në statutin e SHPK-së.

⁶⁴⁵ Ligji 9901/2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” i ndryshuar, neni 73.

⁶⁴⁶ Ligji 9901/2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” i ndryshuar, neni 102.

⁶⁴⁷ Ligji 9901/2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” i ndryshuar, neni 95.

- d) Mënyrat e shlyerjes së kontributit nga ortakët e shoqërisë,⁶⁴⁸ psh. në rast të kontributit në vlerë monetare, statuti mund të parashikojë edhe mundësinë e shlyerjes së kontributit me këste;
- e) Parashikime të ndryshme lidhur me shumica të cilësuar, në rastet kur ligji u jep mundësi ortakëve të vendosin një shumicë më të lartë në statut, si psh. në rastin e emërimit të administratorit, në statut mund të vendoset një shumicë e cilësuar vetëm për emërimin,⁶⁴⁹
- f) Rregullimin e marrëdhënieve ndërmjet ortakëve, por pa cenuar disponimet urdhëruese të ligjit.⁶⁵⁰
- g) Rregulla për të disiplinuar zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit të shoqërisë apo kushtet e anulimit të kuotave⁶⁵¹;
- h) Rregulla për të disiplinuar sipas interesave të ortakëve parimin e “Ndalimit të konkurrencës”⁶⁵²
- i) Periodicitetin dhe mënyrën e thirrjes së Asamblesë së ortakëve, si dhe delegimin e kompetencave të caktuara të vendimmarrjes, të cilat Asambleja e Ortakëve kërkon t’i mbajë si ekskluzivitet të vet.⁶⁵³
- j) Statuti mund të parashikojë dhe rregulla për mënyrën e likuidimit të shoqërisë dhe riorganizimin e shoqërisë me bashkim, ndarje apo shndërrim, në të ardhmen.

Të gjithë këta elementë të statutit të renditur në listën e dytë (më lart) janë parashikuar nga ligji në dispozita të ndryshme. Ortakët themelues të një SHPK-je në kuadër të autonomisë statutore mund t’i pëfshijnë në statut duke marrë kështu një rol më aktiv në përcaktimin e rregullave të funksionimit të shoqërisë në të ardhmen.

Gjithashtu, edhe gjatë vazhdimit të aktivitetit tregtar, në çdo kohë ortakët duke respektuar shumicën e parashikuar nga neni 87/1 i ligjit⁶⁵⁴ mund të vendosin ndryshimin e statutit. Si rrjedhim ortakët e çdo shoqërie tregtare, në çdo kohë, kanë mundësinë që të përcaktojnë vetë shumicën e rregullave, mbi të cilët do të funksionojë shoqëria tregtare, marrëdhëniet mes tyre, si dhe me organet e shoqërisë, me përjashtim të atyre dispozitave, të cilat kanë karakter urdhërues të përcaktuara shprehimisht në ligj, rregullimet e të cilave nuk mund të ndryshohen nga statuti.

⁶⁴⁸ Ligji 9901/2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” i ndryshuar, neni 68 pika 5.

⁶⁴⁹ Ligji 9901/2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” i ndryshuar, neni 87 dhe 88.

⁶⁵⁰ Ligji 9901/2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” i ndryshuar, neni 68 pika 4.

⁶⁵¹ Ligji 9901/2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” i ndryshuar, neni 80.

⁶⁵² Ligji 9901/2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” i ndryshuar, neni 17 dhe neni 58.

⁶⁵³ Ligji 9901/2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” i ndryshuar, neni 82 dhe 83.

⁶⁵⁴ Sipas nenit 87 pika 1 e ligjit 9901/2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” i ndryshuar:

“1. Me përjashtim të rasteve kur statuti parashikon një shumicë më të lartë, asambleja e përgjithshme vendos me tri të katërtat e votave të ortakëve pjesëmarrës, siç përcaktohet në pikën 1 të nenit 86 të këtij ligji, për ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.”

Nëpërmjet këtij punimi rekomandojmë që, SHPK-të duhet të përgatitin me kujdes statutin e tyre dhe ortakët t'u kushtojnë sa më shumë vëmendje dispozitave të statutit, me qëllim që të rregullojnë sa më shumë situata, të cilat, në një të ardhme, mund të lënë shkak për interpretime të ndryshme dhe konflikte mes ortakëve. Ndryshe nga ligji që ka qenë në fuqi para tij, (ligji Nr.7638/1992), ligji aktual 9901/2008, nuk ka rregulluar çështjen e zmadhimit të kapitalit themeltar (të nënshkruar) të SHPK-ve. Për këtë arsye, rekomadohet që ortakët të përfshijnë dispozita për rregullimin e procedurave të shlyerjes, zmadhimit dhe zvogëlimit të kapitalit të nënshkruar të shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar.

Në nenin 230 të ligjit Nr. 9901/2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” ishte parashikuar një dispozitë, e cila detyronte të gjitha shoqëritë tregtare që të përshtasin statutet e tyre me dispozitat e këtij ligji në kushtet kur ky ligj shfuqizoi ligjin e mëparshëm.⁶⁵⁵ Sipas kësaj dispozite shoqëritë tregtare, që kanë ekzistuar përpara hyrjes në fuqi të këtij ligji, janë të detyruara të përshtatin organizimin e tyre, sipas dispozitave të ligjit të ri brenda 3 vjetëve pas hyrjes së tij në fuqi të tij. Kjo dispozitë parashikonte se shoqëritë, të cilat nuk përshtaten me dispozitat e këtij ligji, do të vlerësohen të prishura dhe do të çregjistrohen nga Qendra Kombëtare e Regjistrimit.⁶⁵⁶ Një parashikim i tillë në dispozitat kalimtare të ligjit, përbënte një nxitje të fortë për ortakët dhe administratorët e shoqërive me përgjegjësi të kufizuar, por dhe të shoqërive të tjera, të cilat ishin regjistruar para hyrjes në fuqi të këtij ligji, që të merrnin masa për përshtatjen e statuteve të tyre me dispozitat e ligjit 9901/2008 brenda afatit 3-vjeçar nga hyrja në fuqi e ligjit.

Por, nga ana tjetër, kjo ishte një dispozitë që ekspozonte një numër jashtëzakonisht të madh shoqëri tregtare, para kushteve të prishjes dhe çregjistrimit të këtyre bizneseve pa ndonjë arsye ekonomike.⁶⁵⁷ Nëse një dispozitë e tillë do të zbatohet, do të shkaktonte një goditje të fortë ekonomisë së vendit, pasi është e qartë që një pjesë e madhe e ortakëve apo administratorëve të shoqërive tregtare, nuk kanë pasur kulturën dhe ndërgjegjësimin juridik për të respektuar këtë detyrim të nenit 230 dhe afateve të tij. Për këtë arsye kjo dispozitë, (pra neni 230) e ligjit Nr. 9901/2008 u shfuqizua me ligjin Nr. 129/2014 dhe nuk ka më efekt juridik.⁶⁵⁸

⁶⁵⁵ Ligji 9901/2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” i ndryshuar, neni 230.

⁶⁵⁶ Neni 230 i Ligjit Ligji 9901/2008 [2008] FZ 60 (version i pandryshuar) përcaktonte:

“1. Me hyrjen në fuqi të këtij ligji, shoqëritë tregtare ekzistuese do të vazhdojnë funksionimin, sipas mënyrës dhe kushteve, që kanë qenë të vlefshme në çastin e regjistrimit të tyre. 2. Shoqëritë tregtare, që kanë ekzistuar përpara hyrjes në fuqi të këtij ligji, janë të detyruara të përshtatin organizimin dhe funksionimin e tyre, sipas dispozitave të këtij ligji, brenda 3 vjetëve pas hyrjes së tij në fuqi. 3. Shoqëritë tregtare, të cilat nuk përshtaten me dispozitat e këtij ligji, sipas pikës 2 të këtij neni, vlerësohen të prishura dhe çregjistrohen nga Qendra Kombëtare e Regjistrimit pas përfundimit të procedurës së zbatueshme të likuidimit”.

⁶⁵⁷ Thomas Bachner, Edmund-Philipp Schuster dhe Martin Winner (n 203) fq. 20.

⁶⁵⁸ Ligji 129/2014 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9901, datë 14.4.2008, “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” [2014] FZ 163.

Megjithatë në dispozitat kalimtare të ligjit të mësipërm Nr. 129/2014, u parashikuan përsëri disa dënime administrative për shoqëritë tregtare, të cilat nuk kishin përshtatur statutet me dispozitat e ligjit Nr. 9901/2008, por duke shfuqizuar penalizimin ekstrem të prishjes dhe çregjistrimit.⁶⁵⁹ Parashikimi si kundërvajtje administrative, dhe ndëshkimi me gjobë në shumën prej 30.000 lekësh, është bërë me qëllim që të nxisë ortakët dhe organet drejtuese të shoqërive tregtare, të cilat për neglizhencë apo padijeni të ligjit nuk kanë marrë në kohë masat për përshtatjen e statuteve të tyre me dispozitat e ligjit në fuqi. Kjo është një masë më e arsyeshme dhe proporcionale në krahasim me parashikimin ekstrem të nenit 230 tashmë të shfuqizuar të ligjit.

5.5. Kapitali në një SHPK

Përsa i përket kapitalit fillestar (të nënshkruar në statut) për formimin e një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar ligji 9901/2008 përcakton një vlerë prej 100 lekësh, si kapital minimal i domosdoshëm.⁶⁶⁰ Përcaktimi i një minimumi të domosdoshëm të kapitalit, njihet nga doktrina, si koncepti i *kapitalit ligjor*. Sipas ligjit aktual, kapitali minimal i domosdoshëm për të themeluar një SHPK është ulur në krahasim me ligjin e mëparshëm të vitit 1992, në një vlerë krejtësisht simbolike dhe jo domethënëse në aspektin financiar.

⁶⁵⁹ Ligji 129/2014 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9901, datë 14.4.2008, “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” [2014] FZ 163 parashikon se:

“1. Pas datës së hyrjes në fuqi të këtij ligji, asnjë shoqëri tregtare nuk mund të priset për shkak të mospërbushjes përpara kësaj date të kërkesave të nenit 230, të ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, të ndryshuar.

2. Shoqëritë tregtare të regjistruara në regjistrin tregtar përpara datës 20.5.2008, të cilat në datën hyrjes në fuqi të këtij ligji ende nuk kanë adaptuar statutin e tyre me parashikimet e ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, të ndryshuar, janë të detyruara që jo më vonë se 3 muaj pas datës së hyrjes në fuqi të këtij ligji:

a) të miratojnë ndryshimet e nevojshme në statutin e tyre për ta përputhur atë me kërkesat e ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, të ndryshuar;

b) t'i regjistrojnë këto ndryshime të statutit pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit, sipas ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007, “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”, të ndryshuar.

3. Mospërbushja e detyrimeve, sipas pikës 2, të këtij neni, përbën kundërvajtje administrative dhe dënohet me gjobë 30 000 lekë. Gjoha aplikohet dhe vilet sipas përcaktimeve të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007, “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”, të ndryshuar. Qendra Kombëtare e Regjistrimit ndërpret shërbimin për këto shoqëri deri në kryerjen e veprimeve, sipas përcaktimit të shkronjave “a” ose “b”, të pikës 2, të këtij neni, dhe në pagesën e plotë të gjobës.

4. Afati 3-mujor, i përmendur në pikën 2, është afat për zbatimin e detyrimeve të regjistrimit sipas pikës 2, të këtij neni, dhe, në asnjë rast, nuk mund të përdoret si justifikim për moszbatimin e plotë të dispozitave në fuqi të ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, të ndryshuar.

5. Qendra Kombëtare e Regjistrimit ngarkohet të nisë dhe të vazhdojë deri në përfundimin e afatit të përcaktuar në pikën 2, të këtij neni, fushata informuese për publikum në faqen e saj në internet, si dhe në ambientet e sporteve të saj në qendër dhe në sportelet e tjera të saj të shërbimit për detyrimet, sipas këtij neni.”

⁶⁶⁰ Sipas nenit 70 të ligjit 9901/2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” i ndryshuar “Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar nuk mund të ketë një kapital më të vogël se 100 lekë.”

Kjo ka ndodhur në kuadër të përfaqjes së legjislacionit shqiptar me traditën evropiane të evoluimit të SHPK-ve, sipas së cilës nuk përcaktohet ndonje limit, apo kufizim, për kapitalin themeltar të këtyre shoqërive.⁶⁶¹

Gjithashtu, ulja në një vlerë simbolike e kapitalit themeltar për SHPK-të, ishte pjesë e një reforme tërësore për të lehtësuar dhe thjeshtëzuar procedurat e themelimit të këtyre shoqërive, duke nxitur sa më shumë themelimin e shoqërive me përgjegjësi të kufizuara në vendin tonë, si mjet i rëndësishëm për rritjen ekonomike dhe uljen e papunësisë.

Megjithatë ky parashikim i ligjit, nuk pengon ortakët që të përcaktojnë si kapital të nënshkruar, vlera shumë më të larta të kapitalit, të cilat, në fakt, u përshtaten edhe nevojave reale të financimit të veprimtarisë tregtare që do të kryejë shoqëria. Disponimi i një kapitali të konsiderueshëm themeltar (që pasqyrohet dhe në QKB), përfaqëson dhe një garanci më të madhe për kreditorët dhe subjektet e tjera, të cilët potencialisht mund të hyjnë në marrëdhënie të ndryshme tregtare me këtë shoqëri.

Përsa i përket mënyrës se si ortakët mund të kontribuojnë në kapitalin themeltar të një SHPK-je, neni 68 paragrafi i pestë i ligjit, përcakton që kontributet në kapital mund të ofrohet në para ose në natyrë.⁶⁶² Kapitali që të ofrohet në natyrë nga ortakët e shoqërisë, duhet të shlyhet tërësisht në momentin e nënshkrimit, duke ia kaluar në dispozicion shoqërisë në formim e sipër. Ndërsa për kapitalin në para ortakët në referim të nenit 10 të ligjit, mund të parashikojnë në statut që ta shlyejnë me këste sipas rregullimit që ata bëjnë në statut.⁶⁶³

Lidhur me terminologjinë e përdorur, përsa i përket kapitalit në SHPK, ashtu si dhe për shoqëritë e tjera, vlerësoj se duhet bërë një sqarim i terminologjisë si vijon. Në ligjin aktual 9901/2008, përdoret termi kapital i nënshkruar - i njohur dhe me termin kapital i regjistruar i shoqërisë⁶⁶⁴ dhe ka të njëjtin kuptim me termin kapital themeltar, i cili aplikohet në ligjin e mëparshëm të vitit 1992, si dhe në terminologjinë juridike të doktrinës së shoqërive tregtare. Ky kapital i nënshkruar, nënkupton kapitalin në momentin e nënshkrimit të statutit në fazat e para të themelimit të SHPK-së, pra kapitalin që do të ofrojë ortaku si kontribut në shoqëri i shprehur me anë të nënshkrimit në statut.

Ndërsa koncepti kapital ligjor është përdorur nga doktrina, dhe që i referohet kapitalit minimal të kërkuar nga ligji si kusht për themelimin e një shoqërie tregtare.⁶⁶⁵ Kapitali ligjor nënkupton kapitalin e domosdoshëm për themelimin e shoqërisë tregtare. Kapitali i

⁶⁶¹ Thomas Bachner, Edmund-Philipp Schuster dhe Martin Winner (n 203) fq. 59- 60.

⁶⁶² Ligji 9901/2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” i ndryshuar, neni 68/5.

⁶⁶³ Ligji 9901/2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” i ndryshuar, neni 10.

⁶⁶⁴ Ligji 9901/2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” i ndryshuar, neni 11/1 “a” dhe neni 87.

⁶⁶⁵ Thomas Bachner, Edmund-Philipp Schuster dhe Martin Winner (n 203) fq. 58-59.

nënshkruar apo kapitali themeltar, mund të jenë të barabarta me kapitalin ligjor, ose mund të jenë më të mëdha sesa kapitali ligjor, i cili përfaqëson vlerën minimale të domosdoshme për këtë lloj shoqërie, por asnjëherë më i vogël se kapitali ligjor.⁶⁶⁶ Me shprehjen kapital ligjor nënkuptohet edhe masa e kapitalit minimal të kërkuar nga ligje të posaçme si kusht për licensimin apo të drejten e ushtrimit të një aktiviteti tregtar të rregulluar me ligj të posaçëm, si psh. në fushën bankare, apo të tregut të sigurimeve etj.

Termi kapitalet e veta për shoqërinë tregtare nënkupton tërësinë e kapitaleve dhe asetëve të të gjitha formave të një shoqërie tregtare, në një moment të caktuar kohor. Pra, simbolikisht, mund të themi që kapitalet e veta janë një fotografim i asetëve të shoqërisë në një çast të caktuar.⁶⁶⁷ Kapitalet e veta mund të jenë më të mëdha se kapitali i nënshkruar në momentin e themelimit të shoqërisë, në rast se shoqëria nuk ka shpërndarë të gjitha fitimet si dividend ndër vite, por ka mbajtur një pjesë të fitimit vjetor si rezervë për shoqërinë dhe e ka kaluar në dispozicion të vetë shoqërisë. Madje ortakët, në ndonjë rast, për arsye të motivuara, mund të vendosin që mos të shpërndajnë fare fitim, dhe të gjitha fitimet t'i kalojnë si rezervë, duke rritur kështu kapacitetin financiar të shoqërisë. Në këtë mënyrë kapitalet e veta të shoqërisë janë më të mëdha sesa kapitali i nënshkruar. Në raste të tjera, kur shoqëria ka vepruar me humbje, mund të ndodhë që kapitalet e veta të shoqërisë të jenë më të vogla sesa kapitali i nënshkruar i shoqërisë. Në situata të tilla ortakët duhet të vlerësojnë mundësinë për të zvogëluar kapitalin e nënshkruar, me qëllim që ky kapital të mos mbetet në një vlerë fiktive, e cila mund të dëmtojë interesat e kreditorëve.

5.6. Pavlefshmëritë e themelimit të shoqërive me përgjegjësi të kufizuar

Në kontekstin historik, mund të sqarojmë, se me hyrjen në fuqi të ligjit 9901/2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, u shfuqizuan dispozitat për pavlefshmerinë e themelimit të shoqërive, që parashikonte ligji i mëparshëm. Ndërkohë, ligji aktual, fillimisht parashikoi në dispozita të ndryshme të tij,⁶⁶⁸ rastet e pavlefshmërisë së akteve të prodhuara nga organet e shoqërisë, si psh. rastet e pavlefshmërisë së vendimeve të asamblesë, akteve të administratorit etj.

Direktiva e Parë e Këshillit Nr. 68/151/EEC e dt. 9.03.1968, parashikon shkaqet e pavlefshmërisë së themelimit të shoqërive tregtare.⁶⁶⁹ Në këto kushte paraqitej nevoja për harmonizimin e ligjit 9901/2008, me parashikimet e kësaj direktive. Ky harmonizim u

⁶⁶⁶ Ligji 9901/2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” i ndryshuar, neni 70.

⁶⁶⁷ Shprehja kapitalet e veta.

⁶⁶⁸ Ligji 9901/2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” i ndryshuar, nenet 10, 13, 15, 81, 92, 94, 95.

⁶⁶⁹ First Council Directive 68/151/EEC of 9 March 1968 on co-ordination of safeguards which, for the protection of the interests of members and others, are required by Member States of companies within the meaning of the second paragraph of Article 58 of the Treaty, with a view to making such safeguards equivalent throughout the Community [1968] OJ Special edition.

realizua me ndryshemet që iu bënë ligjit në vitin 2014⁶⁷⁰ Nr. 129/2014 për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin Nr. 9901/2008, "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", ku u shtua neni 3/1, sipas së cilit përcaktohen rastet e pavlefshmërisë së themelimit të shoqërisë.

Pra, ligji aktual "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" përfshin dy regjime të ndryshme të pavlefshmërive në shoqëritë tregtare.⁶⁷¹ Njëri regjim i pavlefshmërive lidhet me veprimet gjatë themelimit të shoqërisë (pavlefshmëritë e themelimit), dhe kufizohet vetëm në dispozitën specifike (neni 3/1) të ligjit 9901/2008, ndërsa regjimi tjetër i pavlefshmërive lidhet me aktet e ndryshme të organeve të shoqërive tregtare⁶⁷² (si psh. pavlefshmëria e vendimeve të AO, administratorit apo likuiduesve), i cili përveç parashikimeve të posaçme në ligjin 9901/2008 referon edhe në dispozitat dhe parimet e Kodit Civil për pavlefshmërinë e veprimeve juridike.⁶⁷³

Në këtë regjim të dytë ku aplikohet Kodi Civil, hyjnë edhe pavlefshmëritë e kontratave tregtare. Gjykata e Lartë në jurisprudencën e saj, ka pranuar se kontratat për shitjen e kuotave të një SHPK-je, u nënshtrohen edhe dispozitave të Kodit Civil.⁶⁷⁴

Pavlefshmëritë e themelimit të shoqërive, që parashikon ligji, në pjesën më të madhe të tyre janë të aplikueshme edhe për SHPK-të.⁶⁷⁵ Shkaqet e pavlefshmërisë së themelimit të SHPK-së, pas regjistrimit të saj në Qendrën Kombëtare të Biznesit,⁶⁷⁶ sipas nenit 3/ ligjit në fuqi lidhen me situatat si vijon:

- a) kur ortakët themelues nuk kanë paraqitur në formë shkresore dokumentacionin për regjistrimin fillestar të shoqërisë, sipas nenit 28, të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007, "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit" të ndryshuar;
- b) kur të gjithë ortakët themelues të shoqërisë nuk kanë pasur zotësi juridike për të vepruar sipas kuptimit të Kodit Civil;
- c) në rast se objekti i veprimtarisë së shoqërisë është në kundërshtim me ligjin;
- c) kur në statutin e shoqërisë nuk përcaktohen elementë thelbësorë, si emri i shoqërisë, vlera e kontributeve të nënshkruara nga secili themelues, vlera e përgjithshme e kapitalit të nënshkruar nga të gjithë themeluesit, apo statuti, nuk përmban dispozita në lidhje me objektin e shoqërisë;
- d) vlera e përgjithshme e kapitalit të shoqërisë, nënshkruar nga të gjithë themeluesit, është më e ulët se vlera e kapitalit minimal, të kërkuar për shoqërinë tregtare, sipas parashikimeve të këtij ligji.⁶⁷⁷

⁶⁷⁰ Argita Malltezi, Jonida Rystemaj dhe Armela Kromiçi, *Gjykatat Shqiptare mbi shoqëritë dhe veprimtarinë Tregtare* (n 364) fq. 90.

⁶⁷¹ Po aty, fq. 95.

⁶⁷² Po aty, fq. 96.

⁶⁷³ Shih nenin 92 e vijues të Kodit Civil.

⁶⁷⁴ Gjykata e Lartë, Vendim Nr.00-2013-2598 i Vendimit (634) datës 07.11.2013, i Kolegjit Civil.

⁶⁷⁵ Ligji 9901/2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" i ndryshuar, neni 3/1.

⁶⁷⁶ Ligji 9723/2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit" i ndryshuar, neni 28.

⁶⁷⁷ Ligji 9901/2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" i ndryshuar, neni 3/1.

Neni 3/1 i Ligjit për 9901/2008, përmban dhe disa situata të përgjithshme të pavlefshmërisë së themelimit, të cilat u referohen të gjitha formave të shoqërive tregtare. Por jo të gjitha këto raste të pavlefshmërive duhet të aplikohen në SHPK, pasi disa prej tyre jana situata specifike për shoqëritë aksionare, për shembull, pika “dh” e nenit 3/1⁶⁷⁸. Gjithashtu, në pikën “ç” të paragrafit të parë të kësaj dispozite është përcaktuar si shkak pavlefshmërie edhe rasti kur “*statuti nuk përmban dispozita në lidhje me objektin e shoqërisë*”.⁶⁷⁹ Megjithatë, duke pasur parasysh nenin 32 të ligjit “Për Qendrën Kombëtare të Biznesit” të cituar më lart, konstatojmë se pasqyrimi i objektit të veprimtarisë nuk është element i domosdoshëm për themelimin e SHPK-ve. Vlerësoj se kjo pjesë e pikës “ç” të nenit 3/1 të ligjit, nuk është e aplikueshme për SHPK-të, por vetëm për SHA-të.

Si rrjedhim, mosplotësimi i këtij elementi, nuk mund të konsiderohet si pavlefshmëri e statutit. Pavarësisht se me qëllim disiplinimin e administratorëve në punën e tyre, është gjithnjë e rekomandueshme që statuti të jetë sa më i plotë dhe të përmbajë edhe dispozita rreth objektit të veprimtarisë tregtare.

Edhe në legjisllacionin anglez (që ka shërbyer si një nga modelet e ligjit tonë), parashikohet që, në rast se në statutin e shoqërisë, nuk përcaktohet asnjë objekt, do të interpretohet se shoqëria mund të ushtrojë çdo lloj veprimtarie.⁶⁸⁰ Si rrjedhim, nuk mund të konsiderohet si i pavlefshëm veprimi i kryer prej SHPK-së, për shkak se nuk është parashikuar ky lloj aktiviteti në statut, por një veprim i tillë mund të ngarkojë administratorin me përgjegjësi për shpërblim dëmi.⁶⁸¹

Nëse do t’i analizonim shkurtimisht shkaqet e pavlefshmërisë së themelimit të një SHPK-je, ato do të ishin si vijon.

Së pari, nëse nuk janë respektuar formalitetet gjatë regjistrimit përbën shkak për pavlefshmërinë e themelimit të shoqërisë. Ky shkak i referohet mungesës së dokumentacionit të nevojshëm për themelimin e SHPK-së. Në fakt, dhe ky shkak i parashikuar nga ligji merr një rendësi më të madhe te shoqëritë aksionare, për të cilat kërkohet detyrimisht paraqitja e statutit me shkrim, si kusht për regjistrimin e shoqërisë. Ndërsa për SHPK-të (siç u analizua më lart) nenit 28/4 i ligjit Nr.9723/2007 “Për Qendrën Kombëtare të Biznesit”, parashikon se këto shoqëri mund të regjistrohen edhe pa

⁶⁷⁸ Sipas nenit 3/1 të Ligjit 9901/2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” i ndryshuar, parashikohet si shkak pavlefshmërie: “*kapitali i nënshkruar i shoqërive aksionare nuk është shlyer nga themeluesit përpara regjistrimit të shoqërisë në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit, në mënyrat dhe në masën e kërkuar nga ky ligj*”.

⁶⁷⁹ Ligji 9901/2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” i ndryshuar, neni 3/1, pika “dh” dhe “ç”.

⁶⁸⁰ Erlanda Agaj, “*Regjimi i pavlefshmërisë juridike në shoqëritë tregtare të kapitalit: Aspekte teorike dhe praktike*” (Punimin shkencor, Shkolla e Magjistraturës 2018), fq. 53. Shih edhe UK Companies Act 2006, section 39 <<https://bit.ly/2IfiYNo>> aksesuar më 20 tetor 2020.

⁶⁸¹ John Birds and A J Boyle, *Boyle and Birds' Company Law* (8th edition, Jordan Publishing Limited 2011) fq. 161.

paraqitur një statut por vetëm duke dorëzuar aplikimin për regjistrim dhe një *deklaratë të posaçme për njohjen, pranimin dhe zbatimin e dispozitave ligjore në fuqi për shpk-të*. Gjithsesi, ky shkak pavlefshmerie do të aplikohet në rast se të dhënat e këtij formulari të aplikimit nuk janë të vërteta, pra janë të pasakta.

Së dyti, nëse të gjithë ortakët themelues kanë pasur mungesë të zotësisë juridike, kjo përbën shkak për pavlefshmërinë e themelimit të shoqërisë. Pra, sipas ligjit parashikohet si kusht për këtë pavlefshmëri vetëm në rast se të gjithë ortakët nuk kanë pasur zotësinë për të vepruar në kuptim të nenit 6 të K.Civil,⁶⁸² dhe jo vetëm disa prej tyre. Kjo, pasi në rast se do të kishim qoftë edhe një ortak që ka gëzuar zotësinë për të vepruar, atëherë nuk do të ishim para rastit të pavlefshmërisë së themelimit të shoqërisë, por para një situate tjetër juridike, pasojat e së cilës lidhen me rrethin e ortakëve, të drejtat dhe detyrimet e tyre. Gjithsesi formulimi i pikës “b”, të nenit 3/1, duket sikur u referohet vetëm ortakëve që janë persona fizikë. Në fakt ky parashikim duhet të interpretohet për të gjitha kategoritë e ortakëve, qofshin këta persona fizikë apo juridikë.

Së treti, kur objekti i shoqërisë ka qenë në kundërshtim me ligjin, përbën shkak për pavlefshmërinë e themelimit të saj. Objekti i shoqërisë pasqyron fushën e aktivitetit tregtar të SHPK-së. Kushti i vetëm që parashikon neni 7 i ligjit në fuqi, lidhur me objektin e shoqërive tregtare, është që objekti i shoqërisë duhet të jetë i ligjshëm.⁶⁸³ Me këtë duhet të kuptojmë që aktiviteti i parashikuar për t’u kryer nga shoqëria, nuk duhet të jetë parashikuar nga dispozitat penale, si veprimtari e ndaluar nga ligji penal. Pra, nuk duhet që aktiviteti i SHPK-së të përmbajë veprimtari të cilësuar si vepër penale. Një veprimtari e tillë, e kundërligjshme do të ishte nëse në objektin e shoqërisë parashikohet kultivimi i bimëve narkotike, shfrytëzimi i prostitucionit, apo veprimtari të tjera, të cilat megjithëse mund të realizojnë fitime ekonomike, janë të parashikuara nga ligji, si vepra penale dhe të kundërligjshme. Nëse një SHPK do të kishte parashikuar në objektin e saj një veprimtari të tillë të kundërligjshme, atëherë do të ishim para pavlefshmërisë së themelimit për shkak të paligjshmërisë së objektit.

Së katërti, paligjshmëria e objektit të SHPK-së nuk duhet të interpretohet në kontekst të zgjeruar për rastet kur shoqëria ka parashikuar në objekt veprimtari, për të cilat ligje të posaçme i parashikojnë kushte specifike licensimi, apo forme të shoqërisë. Për ilustrim, mund përmendim bankat dhe shoqëritë e sigurimit, të cilat sipas ligjeve specifike, mund të kryhen vetëm nga shoqëri të organizuara si SH.A-të. Nëse në statutin e një SHPK-je është përfshirë ndër të tjera dhe një aktivitet i tillë, atëherë, sipas ligjeve të posaçme dhe rregullave të licensimit, kjo SHPK nuk mund të licensohet për të kryer këtë lloj aktiviteti, por nuk mund të konkludojmë që jemi para pavlefshmërisë së themelimit, pasi kjo

⁶⁸² Kodi Civil, neni 6.

⁶⁸³ Ligji 9901/2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” i ndryshuar, neni 7.

veprimtari, megjithëse nuk mund të kryhet nga SHPK-ja, gjithsesi nuk është një veprimtari ekonomike e kundërligjshme. Gjithashtu nuk mund të zgjerohet interpretimi i pavlefshmërisë së themelimit të shoqërisë, duke përfshirë si shkak dhe rastin kur objekti i shoqërisë është në kundërshtim me moralin e shoqërisë. Koncepti i moralit të shoqërisë është një koncept kompleks dhe dinamik, i cili jo gjithmonë përputhet me ligjin. Kështu psh. një aktivitet i lojërave të fatit, apo i tregtisë së pijeve alkoolike, mund të jetë aktivitet i cili nuk përputhet me moralin e shoqërisë (ose të një pjese të saj), por për sa kohë është parashikuar nga kuadri ligjor si një aktivitet i ligjshëm, atëherë nuk përbën shkak për pavlefshmeri të themelimit të SHPK-së.

Së pesti, në kuadër të lirisë së sipërmarrjes, konsiderohet që çdo veprimtari ekonomike, e cila nuk është e ndaluar me ligj (*de jure*) mund të përfshihet në objektin e shoqërisë, pa qenë nevoja për një listë të veprimtarive të ligjshme. Këtu zbatohet parimi “*çdo gjë që nuk është e ndaluar nga ligji është e lejuar*” të kryhet. Kjo është dhe fryma e Direktivës Evropiane 68/151/EEC⁶⁸⁴ dhe jurisprudencës së Gjykatës Evropiane e Drejtësisë të konfirmuar në çështjen *Case C-106/89– Marleasing SA vs La Comercial Internacional de Alimentacion SA*.⁶⁸⁵

1. Në rast se nuk është përcaktuar në statut i emri i shoqërisë, përbën shkak për pavlefshmërinë e themelimit të saj. Kjo lloj pavlefshmërie, është e natyrës relative, pasi mund të korrigjohet me një vendim të asamblesë për regjistrimin e emrit në QKB. Emri i shoqërisë është një element i domosdoshëm identifikues, regjistrimi i të cilit është interes të vet SHPK-së si subjekt i pavarur i së drejtës. Por, gjithashtu, ky element është i domosdoshëm për ta identifikuar shoqërinë edhe nga institucionet shtetërore, kreditorët eventuale, dhe gjithë të tretët, të cilët mund të hyjnë në marrëdhënie juridiko-civile me këtë shoqëri. Ashtu si elementët e tjerë të statutit, ky është një element që duhet të kontrollohet nga punonjësit e QKB në momentin e regjistrimit. Gjithsesi me regjistrimin në QKB, shoqëria merr një numër unik identifikimi NUIS (Nipti), me të cilin bëhet identifikimi i saj si subjekt nga institucionet apo të tretët.
2. Në rast se nuk është përcaktuar në statut vlera e përgjithshme e kapitalit, kjo përbën shkak për pavlefshmëri themelimi të SHPK-së. Ky është një element i domosdoshëm i statutit të shoqërisë dhe i formularit të aplikimit. Këto shoqëri ruajnë dhe karakteristikat e shoqërive të kapitalit dhe, për pasojë, vlera e përgjithshme e kapitalit është garanci për kreditorët. Përcaktimi i vlerës së përgjithshme të kapitalit shërben edhe për të verifikuar nëse është respektuar vlera minimale ligjore e kapitalit për këtë lloj shoqërie.⁶⁸⁶

⁶⁸⁴ First Council Directive 68/151/EEC of 9 March 1968, neni 11.

⁶⁸⁵ Judgment of 13 November 1990, *Marleasing v Comercial Internacional de Alimentación*, C-106/89, ECLI:EU:C:1990:39.

⁶⁸⁶ Argita Malltezi, *E drejta shqiptare e shoqërive tregtare* (Shtëpia botuese “Mediaprint” 2011) fq. 12.

3. Në rast se nuk është përcaktuar në statut vlera e kontributeve të nënshkruara nga secili themelues, kjo përbën shkak për pavlefshmëri themelimi të SHPK-së. Siç u tha më lart, kapitali është një nga karakteristikat thelbësore të shoqërisë. Vlera e kontributit të secilit ortak në këtë shoqëri përbën dhe kufirin e përgjegjesisë së secilit ortak ndaj shoqërisë, por dhe ndaj kreditorëve të saj⁶⁸⁷. Prandaj ky është një element i rëndësishëm i themelimit të SHPK-së.
4. Në rast se nuk është respektuar vlera e kapitalit minimal të parashikuar me ligj, përbën shkak për pavlefshmëri themelimi të SHPK-së. Duke qenë se SHPK-ja ka karakteristika të shoqërisë së kapitalit dhe ortakët e saj kanë përgjegjësi të kufizuar, kapitali minimal ligjor parimisht është një garanci për kreditorët e shoqërisë. Megjithatë, në kushtet kur ligji në fuqi, e ka ulur vlerën e kapitalit minimal ligjor në një masë simbolike prej 100 lekësh, atëherë vështirë se mund të ndodhë në praktikë ky shkak i pavlefshmërisë së shoqërisë dhe gjithsesi, është lehtësisht i korrigjueshëm.

Sipas parashikimit të nenit 3/1 paragrafi i dytë i tij, përcaktohet se lista me shkaqet e pavlefshmërisë së themelimit të shoqërisë të listuara në paragrafin e parë është një listë shteruese, dhe nuk mund të ketë shkaqe të tjera që sjellin pavlefshmërinë e themelimit të shoqërisë pas regjistrimit të saj në Regjistrin Tregtar. Ky parashikim vjen në harmoni edhe me qëndrim jurisprudencën e mbajtur, nga Gjykata e Evropiane e Drejtësisë, në çështjen “*Marleasing SA vs La Comercial Internacional de Alimentacion SA /1990*”⁶⁸⁸ Edhe doktrina shqiptare e të drejtës së shoqërive tregtare mbështet qëndrimin se gjykata nuk mund konstatojë apo të shpallë pavlefshmërinë e themelimit të shoqërisë tej rasteve shteruese të parashikuara në nenin 3/1 të ligjit aktual.⁶⁸⁹

5.6.1. Pasojat e pavlefshmërisë

Në rastet e listuara në paragrafin e parë të nenit 3/1 të ligjit në fuqi, përfshihen raste të pavlefshmërisë absolute dhe raste të pavlefshmërisë relative, koncepte këto të prejardhura nga dispozitat e Kodit Civil. Por ligji nuk ka bërë ndarjen apo klasifikimin se cilat do të konsiderohen shkaqe të pavlefshmërisë absolute dhe cilat do të konsiderohen shkaqe të pavlefshmërisë relative.⁶⁹⁰ Për rrjedhojë, do të jetë jurisprudenca gjyqësore që do të ketë përgjegjësinë për të bërë një ndarje të tillë në rastet e konstatimit të pavlefshmërive të themelimit të shoqërive tregtare dhe me qëllim rregullimin e pasojave.

⁶⁸⁷ Argita Malltezi, *E drejta shqiptare e shoqërive tregtare* (Shtëpia botuese “Mediaprint” 2011) fq. 12.

⁶⁸⁸ Judgment of 13 November 1990, *Marleasing v Comercial Internacional de Alimentación*, C-106/89, ECLI:EU:C:1990:39. Në këtë çështje, Gjykata Evropiane e Drejtësisë konfirmoi se, nuk mundet që të përdoret si shkak për të shpallur pavlefshmërinë e shoqërive asnjë shkak tjetër, përveç atyre që janë parashikuar në Direktivën 68/151/CEE.

⁶⁸⁹ Argita Malltezi, Jonida Rystemaj dhe Armela Kromiçi, *Gjykatat Shqiptare mbi shoqëritë dhe veprimtarinë Tregtare* (n 364) fq. 94.

⁶⁹⁰ Ligji 9901/2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” i ndryshuar, neni 3/1.

Kjo ndarje në rastin e pavlefshmërive të themelimit kërkon një trajtim të posaçëm, duke pasur parasysh parashikimet e ligjit specifik (*lex specialis*), parimet e së drejtës tregtare dhe akteve ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë në fushën e së drejtës së shoqërive tregtare.⁶⁹¹ Sipas pikës 6 të nenit 3/1 të ligjit përcaktohet se; pavlefshmëria e themelimit të shoqërisë nuk mund t'u kundrejtohet palëve të treta që kanë fituar të drejta nga shoqëria pas regjistrimit të saj në QKB.⁶⁹² Pavlefshmëria e themelimit të SHPK-së nuk mund të cenojë të drejtat e të tretëve të cilët kanë pasur marrëdhënie juridike me këtë shoqëri, para momentit të vërtetimit të rrethanës së pavlefshmërisë në gjykatë. Pra ndryshe nga parimet e përgjithshme të së drejtës civile për zgjidhjen e pasojave juridike⁶⁹³, edhe në rast të konstatimit të pavlefshmërisë, efektet e pavlefshmërisë së themelimit të shoqërisë, fillojnë nga momenti i deklarimit/konstatimit të tyre (*ex nunc*), dhe jo nga momenti i kryerjes së veprimit të pavlefshëm (*ex tunc*)⁶⁹⁴. Edhe në rast të konstatimit të pavlefshmërisë absolute, apo shpalljes së pavlefshmërisë relative, ligji ka parashikuar një rregullim të posaçëm të zgjidhjes së pasojave të pavlefshmërisë së themelimit të shoqërisë tregtare pas themelimit të shoqërisë, i cili duhet të mbahet parasysh nga gjykatat dhe jo ai i parashikuar nga neni 92 e vijues i K. Civil.

Kërkimet për pavlefshmërinë e themelimit të shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar mund t'i vlerësojë vetëm gjykata mbi bazën e një padie të ngritur nga një palë e dëmtuar në rast të pavlefshmërisë relative. Në rastin e pavlefshmërisë absolute, padinë mund ta ngriejë çdo person që provon se ka interes juridik në kuptim të nenit 32 të Kodit të Procedurës Civile. Gjatë procesit gjyqësor, pala paditëse duhet të identifikojë saktë shkakun ligjor të padisë së tij dhe të përcaktojë nëse rasti i pavlefshmërisë së themelimit kategorizohet si pavlefshmëri absolute apo pavlefshmëri relative. Ndryshe nga rregullimi i përgjithshëm i bërë nga Kodi Civil, për pavlefshmërinë e veprimeve juridike, ndarja e llojit të pavlefshmërisë së themelimit të shoqërisë tregtare bazohet vetëm mbi parashikimet e ligjit 9901/2008. Kjo paraqet një rëndësi të madhe për shkak të mënyrës së zgjidhjes së pasojave të kësaj pavlefshmërie sipas koncepteve të së drejtës civile. Pasi, në rast se kemi të bëjmë me një pavlefshmëri absolute, veprimi juridik konsiderohet nul (nuk prodhon pasoja juridike) dhe palët e treta sillen sikur veprimi të mos jetë kryer.⁶⁹⁵ Ndërsa veprimet juridike relativisht të pavlefshme sjellin pasoja juridike deri në momentin kur gjykata deklaron pavlefshmërinë me vendim gjykate.⁶⁹⁶ Në rastin e pavlefshmërisë relative, rrethana që ka shkakuar këtë pavlefshmëri mund të korrigjohet dhe shoqëria të vazhdojë

⁶⁹¹ Argita Malltezi, Jonida Rystemaj dhe Armela Kromiçi, *Gjykatat Shqiptare mbi shoqëritë dhe veprimtarinë Tregtare* (n 364) fq. 96.

⁶⁹² Ligji 9901/2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” i ndryshuar, neni 3/1, pika 6.

⁶⁹³ Kodi Civil, nenet 106 – 111.

⁶⁹⁴ *ex nunc* që do të thotë nga tani e tutje, ndërsa *ex tunc* -që prej fillimit. Argita Malltezi, Jonida Rystemaj dhe Armela Kromiçi, *Gjykatat Shqiptare mbi shoqëritë dhe veprimtarinë Tregtare* (n 364) fq. 91-92.

⁶⁹⁵ Nuni (n 431) fq. 334.

⁶⁹⁶ Rustem Gjata, *E drejta civile Pjesa e Përgjithshme* (Botimet Alpaper 2010) fq. 143-170.

aktivitetit e saj, ndërsa në rast të një rrethanë të pavlefshmërisë absolute, shoqëria do të priset me vendim gjykate dhe të kryhet likuidimi e më pas çregjistrimi i shoqërisë nga regjistri tregtar.

Sipas pikës 3 të nenit 3/1 parashikohet dhe pasoja juridike për shoqërinë në rast të konstatimit të pavlefshmërisë absolute.⁶⁹⁷ Pavlefshmëria absolute, parashikuar në një nga shkaqet e pikës 1, konstatohet nga gjykata dhe sjell për pasojë prishjen e shoqërisë tregtare dhe hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e aftësisë pagueese, sipas parashikimeve të nenit 190, pika 1, ose të nenit 192, të këtij ligji, me përjashtim të rasteve kur është nisur një procedurë falimentimi.⁶⁹⁸ Megjithatë, siç u tha edhe me lart, dhe do të sqarohet edhe në vijim, koncepti i pavlefshmërisë absolute nuk mund të aplikohet plotësisht në rastet e pavlefshmërisë së themelimit të shoqërive, pasi rregullimi i pasojave të këtyre pavlefshmërive është i ndryshëm dhe nuk cenon të drejtat e fituara nga të tretët.

Ndërsa në pikën 4 të nenit 3/1 parashikohet dhe pasoja juridike për shoqërinë në rast të konstatimit të pavlefshmërisë relative. Pavlefshmëria relative, e parashikuar në një nga shkaqet e pikës 1, shpallet nga gjykata. Shpallja e pavlefshmërisë së themelimit të shoqërisë tregtare nuk do të ketë si pasojë prishjen e shoqërisë dhe hapjen e procedurave të likuidimit, nëse përpara vendimit gjyqësor, (që deklaron pavlefshmërinë dhe zgjidh pasojën juridike), rrethana që shkakton pavlefshmërinë është korrigjuar, dhe ky korrigjim është publikuar nga shoqëria në regjistrin tregtar, sipas parashikimeve të ligjit nr. 9723/2007, “Për Qendrën Kombëtare të Biznesit”⁶⁹⁹

Sipas kësaj dispozite; Gjykata që shqyrton padinë e ngritur në lidhje me pavlefshmërinë e themelimit të shoqërisë, gjatë të njëjtit proces gjyqësor duhet të vlerësojë nëse rrethana që shkakton pavlefshmërinë, është korrigjuar dhe publikuar sipas kërkesave të pikës 4 të këtij neni.⁷⁰⁰

Por, veçoria e trajtimit të pavlefshmërisë së themelimit të shoqërisë qëndron pikërisht në faktin se gjykata mund të bëjë një interpretim krejt të ndryshëm në raport me parashikimet e Kodit Civil për sa i përket klasifikimit nëse shkakun i parashikuar nga neni 3/1 i ligjit do të konsiderohet si pavlefshmëri absolute apo relative, si dhe zgjidhjes së pasojave të tyre.

Edhe në doktrinën e së drejtës tregtare është konsoliduar qëndrimi që për pavlefshmeritë e akteve të themelimit të shoqërive tregtare nuk paraqet ndonjë rëndësi të veçantë ndarja në

⁶⁹⁷ Ligji 9901/2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” i ndryshuar, neni 3/1, pika 3.

⁶⁹⁸ Ligji 9901/2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” i ndryshuar, neni 3/1, pika 3.

⁶⁹⁹ Ligji 9901/2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” i ndryshuar, neni 3/1, pika 4.

⁷⁰⁰ Ligji 9901/2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” i ndryshuar, neni 3/1, pika 5.

pavlefshmëri absolute dhe relative,⁷⁰¹ pasi ligji specifik (9901/2008) parashikon një trajtim të posaçëm të pavlefshmërive të akteve të themelimit, zgjidhjes së pasojave të tyre, si dhe afateve të parashkrimit për ngritjen e padisë. Sipas këtij qëndrimi, pavlefshmeritë e akteve të shoqërive janë kryesisht relative, për sa kohë pavlefshmëria nuk mund të sjellë pasoja për të tretët, si dhe për faktin se përgjithësisht, pavlefshmeritë e cituara në nenin 3 pika 1 të Ligjit 9901/2008 i ndryshuar janë pavlefshmëri, të cilat mund të kurohen, pra të korrigjohen pa shkaktuar prishjen e shoqërisë.⁷⁰²

Për ilustrim, mund të sjellim si shembull rastin e veprimit juridik të kryer nga të mitur nën moshën katërmbëdhjetë vjeç, e parashikuar nga neni 92/c i K.Civil⁷⁰³. Ky lloj veprimi konsiderohet si rast i pavlefshmërisë absolute të veprimit juridik dhe si rrjedhim, nuk mund të prodhojë pasoja juridike. Ndërkohë që, në rastin e themelimit të SHPK-së ligji në nenin 3/1 pika “b” të tij,⁷⁰⁴ parashikon se duhet t’i mungojë zotësia për të vepruar të gjithë ortakëve që të konsiderohet si shkak i pavlefshmërisë së themelimit të shoqërisë, dhe jo në rast se i mungon vetëm njërit apo disa prej ortakëve themelues.

Ndërkohë që edhe nëse marrim rastin hipotetik të mungesës së zotësisë për të vepruar të gjithë ortakëve në momentin e themelimit të shoqërisë, atëherë do të shtrohej pyetja; A mund të zbatohen parashikimet ligjore të pavlefshmërisë absolute ndaj të tretëve, në rast se me kalimin e pak ditëve pas themelimit, ortakët kanë fituar personalitetin juridik, pra është kuruar shkak i pavlefshmërisë. Përgjigjja do të ishte që; Nuk mund të zbatohen pasojat e pavlefshmërisë absolute.

Gjithashtu në nenin 92 pika “ç” të K.Civil parashikohen si shkak pavlefshmërie absolute veprimet juridike që *“bëhen në marrëveshje të palëve pa patur për qëllim që të sjellin pasoja juridike (fiktive ose të simuluar)”*.⁷⁰⁵ Por ky shkak nuk është përfshirë fare në shkaqet e pavlefshmërisë së themelimit të SHPK-së. Madje ky shkak nuk është parashikuar as në nenet 11 dhe 12 të Direktivës së Parë të Këshillit si rast pavlefshmërie në shoqëritë tregtare.⁷⁰⁶ Për pasojë, edhe në bazë të jurisprudencës së Gjykatës Evropiane

⁷⁰¹ Argita Malltezi, Jonida Rystemaj dhe Armela Kromiçi, *Gjykatat Shqiptare mbi shoqëritë dhe veprimtarinë Tregtare* (n 364) fq. 97-98.

⁷⁰² Per me shume shih Argita Malltezi, Jonida Rystemaj dhe Armela Kromiçi, *Gjykatat Shqiptare mbi shoqëritë dhe veprimtarinë Tregtare* (n 364) fq. 97-98.

⁷⁰³ Kodi Civil, neni 92 pika “c”.

⁷⁰⁴ Ligji 9901/2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” i ndryshuar, neni 3/1, pika “b ”: b) *Kur të gjithë ortakët themelues të shoqërisë nuk kanë pasur zotësi juridike për të vepruar sipas kuptimit të Kodit Civil.*

⁷⁰⁵ Kodi Civil, neni 92 pika “ç”.

⁷⁰⁶ First Council Directive 68/151/EEC of 9 March 1968.

të Drejtësisë⁷⁰⁷, veprimet e fiktive apo të simuluar nuk përfshihen në shkaqet e pavlefshmërisë së themelimit të shoqërive tregtare.⁷⁰⁸

Edhe në praktiken gjyqësore është pranuar ky regjim i posaçëm i pavlefshmërisë së themelimit të shoqërive tregtare, pasojat e së cilës duhet të zgjidhen në mënyrë të ndryshme nga rasti i pavlefshmërive sipas regjimit të Kodit Civil. Gjykata e Lartë, në Vendimin Nr. 15 dt. 19.01.2010⁷⁰⁹ ka bërë këtë diferencim dhe është shprehur se, pavarësisht se në momentet e para ka pasur të meta në aktet e themelimit, që lidheshin me mungesën e nënshkrimit nga ana e ortakut të vetëm, ato janë riparuar me kalimin e kohës duke u korrigjuar dhe, për pasojë, nuk konsiderohen të pavlefshme. Ndërkohë që Gjykata e Shkallës së Parë dhe ajo e Apelit, duke u bazuar në pavlefshmërinë absolute të tyre i kishte konstatuar të pavlefshme. Ndryshimi është i dukshëm, pasi në kushtet e interpretimit sipas regjimit të pavlefshmërive të veprimeve juridike sipas Kodit Civil, do të ishim para rastit të pavlefshmërisë absolute.

Nga ana tjetër edhe përsa i përket afatit të parashkrimit për pavlefshmërinë relative, paraqitet një rregullim i ndryshëm në ligjin specifik - 9901/2008, në krahasim me parashikimin e bërë në nenin 103 të K. Civil.⁷¹⁰ Kjo dispozitë e Kodit Civil parashikon një afat parashkrimi prej 5 vitesh për veprimet relativisht të pavlefshme. Ndërsa, në pikën 7 të nenit 3/1 të ligjit 9901/2008 parashikohet se afati është trevjeçar dhe fillon nga data e regjistrimit të shoqërisë.⁷¹¹

Në praktikën gjyqësore ka pasur qëndrime të ndryshme lidhur me rrethin e subjekteve që legjitimohen për të ngritur padinë e pavlefshmërisë së themelimit të shoqërive tregtare. Nëse u referohemi disa vendimeve të Gjykatës së Lartë, na rezulton se është bërë një interpretim i ngushtuar dhe jo i plotë përsa i përket rrethit të subjekteve që kanë interes për ngritjen e padisë, të cilët dhe kanë të drejtën të legjitimit aktiv për ngritjen e padisë. Në

⁷⁰⁷ Judgment of 13 November 1990, *Marleasing v Comercial Internacional de Alimentación*, C-106/89, ECLI:EU:C:1990:39.

⁷⁰⁸ Argita Malltezi, Jonida Rystemaj dhe Armela Kromiçi, *Gjykatat Shqiptare mbi shoqëritë dhe veprimtarinë Tregtare* (n 364) fq. 96.

⁷⁰⁹ Argita Malltezi, Jonida Rystemaj dhe Armela Kromiçi, *Gjykatat Shqiptare mbi shoqëritë dhe veprimtarinë Tregtare* (n 364) fq 99-103. Shiko edhe Vendimin Nr. 15 dt. 19.01.2010 të Kolegjit Civil Gjykatës së Lartë.

⁷¹⁰ Në nenin 103 të Kodit Civil parashikohet se “*Padia për të kërkuar që një veprim juridik të shpallet i pavlefshëm, parashkruhet brenda pesë vjetëve*”.

⁷¹¹ Neni 3/1 pika 7 i Ligjit 9901/2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” i ndryshuar parashikon se: “*Sipas kësaj dispozite; Padia për të kërkuar që shoqëria tregtare të shpallet e pavlefshme parashkruhet brenda tre vjetëve nga data e regjistrimit të shoqërisë në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit. Në çdo rast, padia e lidhur me pavlefshmërinë e themelimit të shoqërisë tregtare nuk mund të ngrihet pas publikimit të korrigjimit të rrethanës që shkakton pavlefshmërinë, sipas këtij neni, nëse kjo rrethanë mund të korrigjohet.*”

vendimin nr.1143, datë 27.11.2002, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë⁷¹² arsyeton në mënyrë kufizuese se, legjitimimi aktiv për të kërkuar pavlefshmërinë e themelimit të një shoqërie u përket vetëm ortakëve që janë palë në kontratën e shoqërisë, dhe se kjo kontratë nuk mund të goditet nga një person tjetër jashtë kontratës. Ky qëndrim është ritheksuar sërish, në vitin 2011, nga Gjykata e Lartë me Vendimin nr.421, datë 04.10.2011, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë.⁷¹³ Një interpretim i tillë duket kufizues dhe pa mbështetje ligjore.

Ndërkohë që doktrina e së drejtës tregtare ka një qëndrim më liberal dhe të konsoliduar, përse i përket rrethit të subjekteve që mund të gëzojnë legjitimimin aktiv, në paditë me objekt pavlefshmërinë e themelimit të shoqërisë tregtare. Sipas studiuesve të së drejtës së shoqërive tregtare,⁷¹⁴ në rastin e pavlefshmërisë relative legjitimohen për të ngritur padinë vetëm subjektet e cenuara, pra që u është shkaktuar një dëm nga kjo pavlefshmëri, ndërsa në rastin e pavlefshmërisë absolute, e drejta për të ngritur padinë i takon çdo personi që provon një interes të ligjshëm për ngritjen e padisë. Në zbatim të Vendimit Unifikues Nr. 5 dt.30.10.2012, të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë pavlefshmëria absolute nuk mund të ngrihet nga paditësi si një kërkim i vetëm, por gjithmonë në funksion të kërkimeve të tjera, apo kërkimit për të rregulluar një pasojë, që i ka ardhur paditësit nga veprimi absolutisht i pavlefshëm.⁷¹⁵

Ndërsa përse i përket legjitimit pasiv në rastin e padisë, me objekt pavlefshmërinë e themelimit të shoqërisë, pala e paditur do të jetë vetë shoqëria e cila pretendohet se është themeluar duke pasur një nga rastet e pavlefshmërisë së nenit 3/1 të ligjit 9901/2008.

Gjykata e Lartë (Kolegji Tregtar) në vendimin Nr. 589 dt. 11.02.1999⁷¹⁶ ku ka arsyetuar se nuk mund të paditet organi i shoqërisë (këshilli Mbikqyrës), pasi nuk gëzon personalitet juridik, por vetëm shoqëria e cila gëzon pesonalitetin juridik.

Neni 3/1 i ligjit 9901/2008 u referohet rasteve të pavlefshmërisë së themelimit të shoqërisë tregtare kur rrethana e pavlefshmërisë është vërtetuar pasi shoqëria është regjistruar në QKR. Por, teorikisht mund të ekzistojnë edhe raste të pavlefshmërisë së

⁷¹² Erlanda Agaj, “Regjimi i pavlefshmerisë juridike në shoqëritë tregtare të kapitalit: Aspekte teorike dhe praktike” (Punimin shkencor, Shkolla e Magjistraturës 2018) fq 59; Vendimi nr.1143, datë 27.11.2002, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë.

⁷¹³ Po aty. Shiko edhe Vendim nr.421, datë 04.10.2011, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë.

⁷¹⁴ Argita Mallezi, Jonida Rystemaj dhe Armela Kromiçi, *Gjykatat Shqiptare mbi shoqëritë dhe veprimtarinë Tregtare* (n 364) fq. 98.

⁷¹⁵ Shih Vendimin Unifikues Nr. 5 dt.30.10.2012 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë sipas të cilit: “Kërkimi për konstatimin e pavlefshmërisë absolute të një veprimi juridik nuk mund të bëhet si kërkim i mëvetësuar; ai gjithnjë duhet të bëhet gjatë gjykimit në themel të një çështjeje nga gjykata, ose të paktën si kërkim që shoqëron zgjidhjen e pasojave të ardhura nga ekzekutimi i tij.”

⁷¹⁶ Erlanda Agaj, “Regjimi i pavlefshmerisë juridike në shoqëritë tregtare të kapitalit: Aspekte teorike dhe praktike” (Punimin shkencor, Shkolla e Magjistraturës 2018) fq. 60; Shiko edhe Vendimin nr.589, datë 11.02.1999, Kolegji Tregtar i Gjykatës së Lartë.

veprimeve juridike të kryera në procedurat e shfaqjes dhe formalizimit të vullnetit të shoqërisë, të cilat janë konsatuar para se shoqëria të regjistrohet në Regjistrin Tregtar të QKB.

Për këto raste të pavlefshmërisë së veprimeve të kryera gjatë themelimit të shoqërisë, dhe të konstatuara para regjistrimit të shoqërisë në Regjistrin Tregtar, subjektet e interesuara legjitimohen të kërkojnë pavlefshmërinë e veprimeve juridike, duke u mbështetur në dispozitat e përgjithshme të së drejtës civile dhe konkretisht në nenin 92 të K. Civil.⁷¹⁷

Në nenin 10/1 të ligjit në fuqi Nr. 9901/2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” i ndryshuar, përcaktohet se personat e ngarkuar si perfaqësues gjatë procedurës së themelimit të shoqërisë përgjigjen personalisht në mënyrë të pakufizuar dhe solidare për veprimet e kryera nga shoqëria në këtë fazë.⁷¹⁸ Gjithashtu sipas kësaj dispozite në fjalinë e dytë paragrafi 2, parashikohet jo vetëm përgjegjësia ndaj të tretëve, por edhe përgjegjësia e themeluesve të shoqërisë për dëmet që ata i kanë shkaktuar shoqërisë.⁷¹⁹ Kjo lloj përgjegjësie merr kuptim vetëm nëse shoqëria arrin të regjistrohet dhe të fitojë personalitetin juridik.

5.6.2. Efekti i vendimit gjyqësor

Duke pasur parasysh karakteristikat e veçanta të pavlefshmërive të themelimit të shoqërive tregtare mund të themi se edhe vendimi gjyqësor që vendos për një pavlefshmëri të themelimit ka efekt të ndryshëm në krahasim me rastin kur vendimi gjyqësor konstaton apo shpall një pavlefshmëri të një natyre tjetër në shoqërinë tregtare, si psh. pavlefshmëria e akteve të organeve të shoqërisë. Kjo për faktin se pavlefshmëria e akteve të organeve të shoqërisë tregtare, apo pavlefshmëria e kontratave tregtare, përfshin edhe zbatimin e dispozitave të Kodit Civil, si psh. atë të pavlefshmërisë absolute sipas kuptimit të Kodit Civil.⁷²⁰

⁷¹⁷ Sipas nenit 92 të Kodit Civil parashikohet që:

“Veprimet juridike të pavlefshme nuk krijojnë asnjë pasojë juridike. Të tilla janë ato që: a) vijnë në kundërshtim me një dispozitë urdhëruese të ligjit; b) kryhen për të mashtruar ligjin; c) kryhen nga të mitur nën moshën katërbëdhjetë vjeç; ç) bëhen në marrëveshje të palëve pa patur për qëllim që të sjellin pasoja juridike (fiktive ose të simuluar).”

⁷¹⁸ Sipas nenit 10/1 të Ligjit 9901/2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” i ndryshuar: *“Personat që veprojnë në emër të shoqërisë, përpara se kjo të fitojë personalitetin juridik, përgjigjen personalisht në mënyrë të pakufizuar e solidare për veprimet e kryera në emër të saj. Me fitimin e personalitetit juridik, të drejtat e detyrimeve që rrjedhin nga këto veprime i kalojnë shoqërisë”.*

⁷¹⁹ Sipas nenit 10/2 të Ligjit 9901/2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” i ndryshuar: *“Themeluesit përgjigjen ndaj shoqërisë personalisht e në mënyrë solidare për dëmet e shkaktuara nga mospërbushja e këtyre detyrimeve apo nga përmbushja e tyre përtej afateve përkatëse.”*

⁷²⁰ Argita Malltezi, Jonida Rystemaj dhe Armela Kromiçi, *Gjykatat Shqiptare mbi shoqëritë dhe veprimtarinë Tregtare* (n 364) fq. 95-96.

Vendimi gjyqësor është akti kryesor i procesit gjyqësor,⁷²¹ pra akti ku shprehet vetë qëllimi i procesit për ta zgjidhur drejt konfliktin. Vendimi gjyqësor që konstaton apo shpall pavlefshmërinë e themelimit të shoqërisë tregtare ka efekt transformues të marrëdhënieve juridike dhe konsiderohet një vendim “*erga-omnes*”,⁷²² që do të thotë se prodhon pasoja juridike edhe për të tretët që nuk kanë qenë palë në proces⁷²³. Ky efekt përbën një përjashtim nga parimi i parashikuar në nenin 451/a të Kodit të Procedurës Civile, sipas të cilit, vendimi është i detyrueshëm për palët në proces.⁷²⁴

Megjithatë, vendimet që konstatojnë apo shpallin një pavlefshmëri të themelimit, kryesisht kane efekt “*ex nunc*”⁷²⁵ Kjo nënkupton se vendimi i gjykatës prodhon pasoja vetëm për marrëdhëniet juridike që krijohen pas hyrjes në fuqi të atij vendimi. Sidomos për të tretët që kanë fituar të drejta nga shoqëria.

Ndërsa, në rastin e pavlefshmërive të akteve të shoqërisë (psh. Pavlefshmërisë së vendimeve të asamblesë, akteve të administratorit apo likuiduesit), apo kontratave tregtare, nuk mund të thuhet e njëjta gjë. Efekti *ex nunc* do të aplikohet vetëm për të tretët që kanë fituar një të drejtë me mirëbesim, në përputhje me parashikimet e nenit 12 të ligjit 9901/2008. Ndërsa për të gjithë ortaktët apo organet e administrimit, si dhe kreditorët me keqbesim, efektet e vendimit gjyqësor për pavlefshmërinë e akteve të organeve të shoqërisë duhet të kenë efekt “*ex tunc*” që nënkupton se vendimi gjyqësor ka fuqi prapavepruese dhe zbatohet edhe për ato veprime, apo fakte juridike apo marrëdhënie që kanë ndodhur përpara hyrjes në fuqi të vendimit gjyqësor.

Gjithashtu, jurisprudenca e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut në çështjen *Shesti Mai Engineering OOD e të tjerë kundër Bullgarisë*, ka konstatuar se përbën shkelje të nenit 1 Protokollit 1 të Konventës, mungesa e garancive dhe mjeteve ligjore të ortakëve për t’u mbrojtur dhe dëmshpërblyer në mënyrë efektive në rast të shpalljes së pavlefshme të veprimeve të përfaqësimit të shoqërisë.⁷²⁶ Gjykata e Strasburgut arsyetoi se: “*Shteti e ka për detyrë të ofrojë procedurat gjyqësore të nevojshme që garantojnë dhe mundësojnë gjykatat vendase, që të gjykojnë me drejtësi dhe efektivitet.*”⁷²⁷

⁷²¹ Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë Vendimi Nr. 8 dt. 16.03.2011.

⁷²² Faik Brestovci, *E Drejta Procedurale Civile I* (Fakulteti Juridik, Universiteti i Prishtinës, 2004) fq. 160-161.

⁷²³ Alqiviadh Lamani, *Procedura Civile e Republikës Popullore të Shqipërisë* (Universiteti Shtetëror i Tiranës 1963) fq. 102-103.

⁷²⁴ Kodi i Procedurës Civile, nenin 451/a.

⁷²⁵ Erlanda Agaj, “*Regjimi i pavlefshmerisë juridike në shoqëritë tregtare të kapitalit: Aspekte teorike dhe praktike*” (Punimin shkencor, Shkolla e Magjistraturës 2018) fq 117; A G Toth, *The oxford Encyclopedia of European Community Law: Institutional Law Volum I* (Oxford University Press 2005) fq. 255.

⁷²⁶ Judgment of 20 September 2011, ECHR, *Shesti Mai Engineering OOD and Others v. Bulgaria*, Application no 17854/04.

⁷²⁷ Erlanda Agaj, “*Regjimi i pavlefshmerisë juridike në shoqëritë tregtare të kapitalit: Aspekte teorike dhe praktike*” (Punimin shkencor, Shkolla e Magjistraturës 2018) fq. 117.

Vendimet gjyqësore që kanë konstatuar apo deklaruar pavlefshmërinë e akteve të organeve drejtuese të shoqërive tregtare, praktika gjyqësore shqiptare nuk është e unifikuar dhe është në zhvillim të vazhdueshëm. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë me vendimin Nr. 4573 dt. 24.05.2017 ka konstatuar pavlefshmërinë e vendimit të AO dhe ka vendosur zgjidhjen e pasojave duke i kthyer palët në gjendjen e mëparshme, duke urdhëruar QKB të bëjë çregjistrimin e regjistrimit të vendimit të pavlefshëm.⁷²⁸

Një qëndrim të ndryshëm nga vendimet e mësipërme ka mbajtur Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës, me vendimin Nr. 11-2015-5120 dt.13.11.2015, sipas të cilit gjykata ka konstatuar mospërputhjen e bazës ligjore të padisë me natyrën e kërimit.⁷²⁹ Sipas këtij vendimi: *“Vendimet objekt padie nuk janë veprime juridike, por vendime që kanë të bëjnë me administrimin e shoqërisë tregtare... për pasojë është i gabuar referimi te neni 92/b i Kodit Civil”*.⁷³⁰

Si konkluzion mund të themi se pavlefshmëritë që mund të hasen në shoqëritë tregtare janë të natyrave të ndryshme dhe u nënshtrohen regjimeve të ndryshme. Pavlefshmëritë e themelimit në një SHPK i nënshtrohen një regjimi të posaçëm juridik, i cili është i parashikuar në ligjin 9901/2008/ (*lex specialis*) dhe kanë një trajtim të veçantë të parashikuar nga neni 3/1 i këtij ligji, përsa u përket pasojave të këtyre pavlefshërive.

Ndërsa pavlefshmëritë e akteve që dalin nga organet drejtuese të shoqërisë gjatë aktivitetit të saj përveç parashikimeve në ligjin e posaçëm u nënshtrohen dhe efekteve të pavlefshërive të parashikuara nga Kodi Civil, përveçse kur ligji 9901/2008 parashikon ndryshe. Gjithsesi praktika gjyqësore në trajtimin e këtyre pavlefshërive është në zhvillim e sipër dhe do të ishte me shumë interes edhe zhvillimi i praktikave njehsuese të Gjykatës së Lartë në këtë fushë.

⁷²⁸ Vendimin Nr. 4573 dt. 24.05.2017 Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Gjithashtu shiko edhe Vendimin 9432 dt. 22.11.2016 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

⁷²⁹ Vendimin Nr. Nr. 11-2015-5120 dt.13.11.2015 Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës.

⁷³⁰ Po aty.

KREU VI

6. Administrimi i Shoqërive me Përgjegjësi të Kufizuar dhe Organet e saj sipas Ligjit në Fuqi

6.1. Hyrje

SHPK-ja ka dy organe drejtuese, të cilat janë përgjegjëse për funksionimin e shoqërisë nga themelimi deri në përfundim të veprimtarisë së saj. Këto organe janë Asambleja e Ortakëve (AO), e njohur dhe si Asambleja e Përgjithshme, (AP) dhe Administratori. AO është organi vendimmarrës, i cili ka përgjegjësinë e ruajtjes së parimeve dhe qëllimit për të cilin është themeluar shoqëria, duke mbajtur ato kompetenca thelbësore që lidhen me vendimmarrjet që u referohen elementeve thelbësore që përcaktohen edhe në statutin e shoqërisë. Në këtë aspekt, AO ka dhe disa kompetenca administrimi në kuadër të drejtimit të brendshëm organizativ të shoqërisë.

Ndërsa administratori është organi përgjegjës për të gjithë veprimtarinë e zakonshme administruese dhe për përfaqësimin juridik të shoqërisë në raport me të tretët. Administrimi i SHPK-ve sipas nenit 95 të ligjit Nr. 9901/2008 mund të kryhet nga një ose më shumë administratorë. Sipas ligjit nuk ka asnjë ndalim që ortakët i shoqërisë të jetë dhe administrator i saj, madje edhe për rastin kur shoqëria është me ortak të vetëm.⁷³¹

Ndryshe nga aspekte të tjera të shoqërisë që lidhen me rregullimin e marrëdhënieve mes ortakëve ku ligji i ka lejuar një autonomi të dukshme statutit, përse i përket mënyrës së organizimit të SHPK-së dhe strukturës administruese të saj dispozitat e ligjit në fuqi kanë karakter urdhërues dhe nuk lënë shumë hapësirë për autonomi statutore.⁷³²

Mënyra e administrimit të SHPK-ve në ligjin aktual ka ndjekur një model të përafërt me modelin gjerman dhe atë anglo-sakson (*comon law*) të administrimit të shoqërive tregtare, të cilët kanë si karakteristike kryesore ndarjen e ortakëve nga përgjegjësia e administrimit, duke e veçuar figurën e administratorit.⁷³³ Ndërsa në sistemin italian për SHPK-të, parashikohen dy nivele drejtimi, përveç administratorit, shoqëria ka dhe Këshillin e Administrimit⁷³⁴ në mënyrë të ngjashme me parashikimet që bën ligji ynë për shoqëritë aksionare. Si rrjedhim, edhe praktika të ndryshme ku SHPK-të kanë parashikuar një këshill administrimi apo më tej akoma, një këshill mbikëqyrës në praktikën shqiptare, janë

⁷³¹ Ligji 9901/2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” i ndryshuar, neni 95.

⁷³² Hajdari (n 210) fq. 26-28.

⁷³³ Po aty, fq. 27.

⁷³⁴ Po aty, fq. 27.

pasqyrime te kultures juridike italiane, dhe nuk mund të konsiderohen në përputhje me legjislacionin tonë.⁷³⁵

6.2. Kompetenca dhe përgjegjësitë e administratorëve

Administratorët e një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar i marrin kompetencat e tyre kryesisht nga ligji Nr. 9901/2008, por edhe statuti i shoqërisë mund të caktojë kompetenca të tjera dhe të marrë një rëndësi thelbësore, në rastet kur shoqëria ka më shumë se një administrator. Në këto raste statuti duhet të disiplinojë mënyrën e ushtrimit të këtyre kompetencave nga administratorët.

Në nenin 95 pika 3 deri në pikën 6 të ligjit 9901 dt 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, sipas të cilit:⁷³⁶

Administratorët kanë të drejtë e detyrohen të:

- a) kryejnë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikën tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;
- b) përfaqësojnë shoqërinë tregtare;
- c) kujdesen për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
- d) përgatisin dhe nënshkruajnë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim;
- e) krijojnë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
- f) kryejnë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;
- g) raportojnë përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;
- h) kryejnë detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut.⁷³⁷

Sipas pikës 4 të nenit 95 përcaktohet se për vendimet e parashikuara nga pikat 3 e 5 të nenit 82 të këtij ligji, administratorët nuk mund të vendosin vetë, por detyrohen të thërrasin asamblenë e përgjithshme.⁷³⁸

⁷³⁵ Po aty, fq. 27.

⁷³⁶ Ligji 9901/2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” i ndryshuar, neni 95.

⁷³⁷ Ligji 9901/2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” i ndryshuar, neni 95.

⁷³⁸ Sipas pikës 3 të nenit 82 të ligjit 9901/2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” i ndryshuar parashikohet se:

“3. Asambleja e përgjithshme thirret nëse, sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim.”

Ndërsa sipas pikës 5 të këtij ligji parashikohet se:

“5. Asambleja e përgjithshme thirret kur shoqëria, brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5 përqind të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuar.”

Ne pikën 5 të nenit 95 parashikohet se, kur AO emëron më shumë se një administrator, ata duhet të veprojnë së bashku për administrimin e shoqërisë. Por, statuti ose vendime që ndryshojnë statutin, mund të parashikojnë një rregull të ndryshëm.

Administratorët u nënshtrohen edhe detyrimeve të përcaktuara në nenet 12-18, 98 të ligjit, që përfshijnë: i) detyrimin e besnikërisë;⁷³⁹ ii) ndalimin e konfliktit të interesit me personat e lidhur;⁷⁴⁰ iii) detyrimin për të qenë të përgjegjshëm;⁷⁴¹ dhe iv) detyrimin për të mos ushtruar aktivitetet konkurrues ndaj shoqërisë.⁷⁴²

⁷³⁹ Sipas pikës së parë të nenit 14 të ligjit 9901/2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” i ndryshuar parashikohet që: “1. Gjatë ushtrimit të të drejtave, ortakët dhe aksionarët veprojnë, duke marrë parasysh interesat e shoqërisë dhe të ortakëve apo të aksionarëve të tjerë. I njëjtidetyrim zbatohet edhe për administratorët, anëtarëtekëshillit të administrimit apo të këshillit mbikëqyrës.”

⁷⁴⁰ Ligji 9901/2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” i ndryshuar, neni 13.

⁷⁴¹ Sipas nenit 98 “Detyrimi i besnikërisë dhe përgjegjësia” të ligjit 9901/2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” i ndryshuar parashikohet se:

1. Përveç sa është parashikuar në dispozitat e përgjithshme të detyrimit të besnikërisë, sipas neneve 14, 15, 17 e 18 të këtij ligji, administratorët detyrohen:

a) të kryejnë detyrat e tyre të përcaktuara në ligj ose në statut në mirëbesim e në interesin më të mirë të shoqërisë në tërësi, duke i kushtuar vëmendje të veçantë ndikimit të veprimtarisë së shoqërisë në mjedis;

b) të ushtrojnë kompetencat që u njihen në ligj ose në statut vetëm për arritjen e qëllimeve të përcaktuara në këto dispozita;

c) të vlerësojnë me përgjegjësi çështjet, për të cilat merret vendim;

ç) të parandalojnë dhe mënjanojnë rastet e konfliktit, prezent apo të mundshëm, të interesave personalë me ata të shoqërisë;

d) të garantojnë miratimin e marrëveshjeve sipas dispozitave të pikës 3 të nenit 13 të këtij ligji;

dh) të ushtrojnë detyrat e tyre me profesionalizmin dhe kujdesin e nevojshëm.

2. Administratorët, gjatë kryerjes së detyrave të tyre, përgjigjen ndaj shoqërisë për çdo veprim ose mosveprim, që lidhet në mënyrë të arsyeshme me qëllimet e shoqërisë tregtare, me përjashtim të rasteve kur, në bazë të hetimit dhe vlerësimit të informacioneve përkatëse, veprimi ose mosveprimi është kryer në mirëbesim.

3. Nëse administratorët veprojnë në kundërshtim me detyrat dhe shkelin standardet profesionale, sipas pikave 1 e 2 të këtij neni, janë të detyruar t'i dëmshpërblejnë shoqërisë dëmet, që rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe t'i kalojnë çdo fitim personal që ata apo personat e lidhur meta kanë realizuar nga këto veprime të parregullta. Administratorët kanë barrën e provës për të vërtetuar kryerjen e detyrave të tyre në mënyrë të rregullt e sipas standardeve të kërkuara. Kur shkelja është kryer nga më shumë se një administrator, ata përgjigjen ndaj shoqërisë në mënyrë solidarë.

4. Në mënyrë të veçantë, por pa u kufizuar në to, administratorët janë të detyruar t'i dëmshpërblejnë shoqërisë dëmet e shkaktuara, nëse, në kundërshtim me dispozitat e këtij ligji, kryejnë veprimet e mëposhtme:

a) u kthejnë ortakëve kontributet;

b) u paguajnë ortakëve interesa apo dividendë;

c) u shpërndajnë aktivet shoqërisë;

ç) lejojnë që shoqëria të vazhdojë veprimtarinë tregtare, kur, në bazë të gjendjes financiare, duhej të parashikohej që shoqëria nuk do të kishte aftësi paguese për të shlyer detyrimet;

d) japin kredi.”

⁷⁴² Ligji 9901/2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” i ndryshuar, neni 17.

6.3. Marrëdhënia mes administratorit dhe shoqërisë

Në doktrinën e së drejtës tregtare, ekzistojnë disa teori⁷⁴³ përsa i përket marrëdhënies së krijuar mes administratorit dhe shoqërisë, siç janë:⁷⁴⁴

- teoria e agjencisë, që mbështet në marrëdhënien mes të përfaqësuarit, që janë ortakët dhe përfaqësuesit, që është administratori (principal – agjent)⁷⁴⁵;
- teoria e kostove të transaksionit, sipas së cilës, sipërmartjet tregtare operojnë me qëllim rritjen e fitimeve dhe uljen e kostove të të gjitha llojeve të transaksioneve që kryen shoqëria;⁷⁴⁶
- teoria e grupeve të interesit (*stakeholders*) sipas së cilës shoqëria duhet të operojë në përputhje me interesat e të gjitha grupeve, si të punësuarit, ortakët e minorancës, kreditorët dhe jo vetëm të ortakëve mazhoritarë;⁷⁴⁷ dhe
- teoria e administrimit, e cila mbështetet në motivimin e administratorëve me qëllim që të kryejnë detyrën e administrimit dhe përfaqësimit të shoqërisë me pasion dhe duke e konsideruar suksesin në administrim dhe si sukses të tyre personal.⁷⁴⁸

Ndërsa në realitetin shqiptar marrëdhënia mes administratorit të një SHPK-je dhe vetë shoqërisë, ka pasur interpretime të ndryshme nga doktrina dhe praktika gjyqësore, përsa i përket identifikimit nëse kjo është një marrëdhënie pune, apo një kontratë tjetër shërbimi. Diskutimi qëndron në faktin se në një pjesë të praktikës gjyqësore, kjo marrëdhënie është konsideruar si një marrëdhënie pune.

Për pasojë, për këtë kategori juristësh (gjyqtarë, avokatë etj.) edhe konfliktet e lindura mes administratorit dhe shoqërisë në rast shkarkimi të tij nga detyra, janë trajtuar si konflikte pune duke iu referuar dispozitave të Kodit të Punës. Pra, sipas kësaj pjese të praktikës gjyqësore, administratori është konsideruar si i punësuar në shoqërinë me përgjegjësi të kufizuar dhe vetë shoqëria si punëdhënëse. Si ilustrim mund të përmendim: Vendimi Nr. 415 dt. 17.02.2015 i Gjykatës së Apelit Tiranë⁷⁴⁹ dhe Vendimi Nr. 4271, datë 25.05.2015 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.⁷⁵⁰

⁷⁴³ Michael C Jensen dhe William H Meckling, “*Theory of the firm: Managerial behavior, agency costs and ownership structure*” (1976) 3 *Journal of Financial Economics* 305, fq. 308.

⁷⁴⁴ Kromiçi (n 73) fq. 6-13.

⁷⁴⁵ Kromiçi (n 73) fq. 6-13; Stephen A Ross, “The economic Theory of agency: The principal’s problem” (1973) 63:2 *The American Economic Review* 134, fq. 134-139.

⁷⁴⁶ Kromiçi (n 73) fq. 6-13; R H Coase, “The Nature of the Firm” (1937) 4:16 *Economica* 386, fq 386-405.

⁷⁴⁷ Kromiçi (n 73) fq. 6-13; R Edward Freeman dhe John M Mcvea, “A Stakeholder Approach to Strategic Management” (2001) Darden Graduate School of Business Administration University of Virginia <<https://ssrn.com/abstract=263511>> aksesuar më 20 tetor 2020, fq. 3.

⁷⁴⁸ Kromiçi (n 73) fq 6-13; James H Davis, F David Schoorman dhe Lex Donaldson, “*Toward a Stewardship Theory of Management*” (1997) 22:1 *The Academy of Management Review* 20.

⁷⁴⁹ Shih Vendimin Nr. 415 dt. 17.02.2015 i Gjykatës së Apelit Tiranë.

⁷⁵⁰ Shih Vendimin Nr. 4271, datë 25.05.2015 Gjykatës te Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe Vendimin Nr. Dt. 08. 02. 2017 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Ndërsa në një pjesë tjetër të praktikës gjyqësore, marrëdhënia mes administratorit dhe shoqërisë është konsideruar si një kontratë e posaçme shërbimi, për të cilën nuk duhet të zbatohen dispozitat e Kodit të Punës, por dispozitat e Kodit Civil për kontratat. Si ilustrim mund të përmendim Vendimin Nr. 5904, datë 16.05.2014 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë⁷⁵¹ dhe Vendimin Nr.229 dt 03.02.2017 i Gjykatës së Apelit Tiranë.⁷⁵²

Edhe Gjykata e Lartë ka qëndrime të ndryshme lidhur me këtë çështje. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë në vendimin Nr. 501 dt. 09. 10. 2014 ka konkluduar se:

Pavarësisht se mënyra e emërimit dhe shkarkimit të paditësit si likuidues rregullohet nga nenet 191 e vijues të Ligjit Nr. 9901, datë 14. 04. 2008, "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", padia e tij e lidhur me shpërblimet përkatëse në bazë të marrëdhënies së tij të punës me shoqërinë, nuk gjen rregullim specifik në këtë ligj, e për pasojë do të rregullohet nga dispozitat e Kodit të Punës.⁷⁵³

Me qëllim sqarimin e kësaj çështjeje duhet të kemi parasysh detyrat dhe kompetencat e administratorit të SHPK-së, të përcaktuara në dispozitat e përgjithshme (nenet 12-18) cituar më lart, si dhe në nenin 95 pika 3 deri në pikën 6 të ligjit 9901/2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare".⁷⁵⁴

Siç rezulton nga parashikimi i pikës 6 të nenit 95,⁷⁵⁵ ligji 9901/2008 nuk ka sqaruar se cilat do të jenë dispozitat ligjore në bazë të së cilave mund të bëjmë interpretimin e marrëdhënies mes administratorit dhe shoqërisë. Pra, ky ligj nuk ka bërë një përkufizim definitiv të kësaj marrëdhënieje, megjithëse, në disa dispozita ligji ka parashikuar rregulla për disiplinimin e marrëdhënies së administratorit me shoqërinë.

⁷⁵¹ Shih vendimin Vendimin Nr. 5904, datë 16.05.2014 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Në këtë vendim gjykata argumenton ndër të tjera se:

"Gjykata, vlerëson se, ushtrimi i funksionit të administratorit në shoqërinë aksionare, nuk kryhet në kuadër të urdhrave të shoqërisë, kështu mungon elementi i vartësisë. Gjykata, vlerëson se, nga njëra anë administratori e ushtron detyrën e tij në kuadër të organizimit të shoqërisë aksionare duke qenë se është organ i shoqërisë dhe kryen atë që njihet si përfaqësimi organik i personit juridik. Nga ana tjetër, administratori nuk e ushtron veprimtarinë në kuadër të urdhrave të shoqërisë, në këto kushte mungon elementi i vartësisë, i cili karakterizon marrëdhënien e punës dhe e dallon nga marrëdhëniet e tjera, të cilat disiplinohen nga ligje të ndryshme nga Kodi i Punës."

⁷⁵² Shih vendimin Vendimin Nr. 229 dt. 03.02.2017 të Gjykatës së Apelit Tiranë.

⁷⁵³ Shih Vendimin Nr. 501 dt. 09. 10. 2014 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë. (shih dhe vendimin Nr. 359 dt. 16. 07. 2015 i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë).

⁷⁵⁴ Ligji 9901/2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" i ndryshuar, neni 95.

⁷⁵⁵ Sipas pikës 6 të nenit 95 të Ligjit 9901/2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare"i ndryshuar parashikohet se:

"Asambleja e përgjithshme mund të shkarkojë administratorin në çdo kohë me shumicë të zakonshme. Statuti apo marrëveshje të tjera nuk mund të përjashtojnë apo kufizojnë këtë të drejtë. Paditë, që lidhen me shpërblimin e administratorit, në bazë të marrëdhënies kontraktore me shoqërinë, rregullohen sipas dispozitave ligjore në fuqi."

Nëse u referohemi legjislacioneve të vendeve të tjera, që kanë shërbyer si modele në përgatitjen e ligjit 9901/2008, mund të themi se në të drejtën anglo-saksone kategorizimi i marrëdhënies mes administratorit dhe shoqërisë tregtare nuk paraqet ndonjë rëndësi kaq të madhe, përse i perket diskutimit nëse kjo marrëdhënie duhet konsideruar si një marrëdhënie pune, apo një marrëdhënie shërbimi. Sipas *Brough*, këto kontrata përgjithësisht njihen si kontrata të shërbimit të administratorëve.⁷⁵⁶ Megjithatë, sipas këtij autori, ato në thelb janë kontrata pune midis administratorit dhe shoqërisë, së cilës i shërben, por me disa specifika të veçanta, si për shembull, te kontrata e shërbimit të administratorit janë karakterisitke dhe klauzolat që ndalojnë administratorin që largohet nga një shoqëri për t'i bërë konkurrencë shoqërisë tregtare ku ka punuar.⁷⁵⁷ Pra konstatojmë që në të drejtën anglosaksone, kjo marrëdhënie konsiderohet si një kontratë specifike shërbimi, pavarësisht faktit që marrëdhënie të tilla janë të ngjashme me kontratat e punës, të cilat kategorizohen gjithashtu si kontrata shërbimi, por me rregullim të posaçëm.

Në realitetin juridik shqiptar, kjo çështje ka marrë një rëndësi më të madhe dhe ka hapur shumë debate në praktikën gjyqësore të sipërperemundur dhe qëndrimet doktrimore, të cilat do të trajtohen më poshtë, për shkak të faktit se masa dhe lloji i dëmshpërblimit për rastet e shkarkimit të administratorit nga detyra e tij para përfundimit të mandatit, paraqitet e ndryshme në rast se kjo marrëdhënie do të konsiderohet zgjidhje e një marrëdhënieje pune apo zgjidhje e një kontrate shërbimi.

Ky debat ka lindur për shkak se Kodi i Punës duket se përmban parashikime më favorizuese për punëmarrësin, në rast të ndërprerjes së marrëdhënies së punës. Kodi i Punës në dispozitat e tij parashikon një procedurë rigoroze që duhet respektuar në rast të zgjidhjes së parakohshme të kontratës së punës.⁷⁵⁸ Gjithashtu, ky kod parashikon disa lloje dëmshpërblimesh dhe shpërblimesh që jepen në rast të zgjidhjes së menjëhershme të pajustificuar të kontratës së punës. Ndërsa, për zgjidhjen e një kontrate shërbimi do të duhet t'u referoheshim dispozitave të përgjithshme për kontratat në Kodin Civil, si dhe dispozitave të kontratës specifike të shërbimit, apo parashikimeve të vetë palëve në kontratë.

Në të vërtetë, në shumicën dërrmuese të SHPK-ve në Shqipëri, administratorët emërohen vetëm mbi bazën e një akti të thjeshtë emërimi të asamblesë së ortakëve dhe pranimit të tij nga personi i emëruar si administrator. Për pasojë, ky akt emërimi në të shumtën e rasteve nuk përmban të dhëna të plota për të përcaktuar natyrën juridike të marrëdhënies së krijuar, e cila të mund të zbatohet edhe në rast të një konflikti për shkarkim para përfundimit të

⁷⁵⁶ Gordon H. Brough, *Private Limited Companies: Formation and Management* (3rd edition, Sweet & Maxwell Ltd 1990) fq. 68 - 69.

⁷⁵⁷ Po aty, fq. 69.

⁷⁵⁸ Kodi i Punës, Nenet 144 e vijues.

afatit. Nga ana tjetër neni 95 pika 6 e ligjit nuk ka bërë një përcaktim të qartë të kësaj marrëdhënieje, por referon në dispozitat ligjore në fuqi, pa kufizim.

Në interpretimin e bërë ligjit Nr. 9901/2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” nga autorët Thomas Bachner, Edmund Philipp Shuster, Martin Winer, raporti mes administratorit me shoqërinë tregtare, bazohet mbi një kontratë shërbimi të bazuar mbi marrëdhënien themelore, i përfaqësuar – përfaqësues (*principal-agent*).⁷⁵⁹ Pra, sipas këtij qëndrimi, ortakët si pronarë të kapitalit të shoqërisë në organin e Asamblesë së Ortakëve (ose në momentin e hartimit të statutit) kanë të drejtën e vendimmarrjes në përcaktimin e përfaqësuesit të shoqërisë dhe konstituimin kështu të organit tjetër të rëndësishëm, që është administratori i shoqërisë. Marrëdhënia e krijuar mes personit të caktuar si administrator të shoqërisë dhe vetë shoqërisë, e cila, në këtë rast, përfaqësohet nga AO është një marrëdhënie komplekse, e cila është e vështirë të përkufizohet si një marrëdhënie pune. Administratori, në detyrën e tij të përfaqësimit të shoqërisë, duhet të udhëhiqet edhe nga disa parime, të cilat janë posaçërisht të parashikuara në ligjin Nr. 9901/2008.⁷⁶⁰

Referuar nenit 97 pika 1 e ligjit, është parashikuar mënyra e shpërblimit për administratorët. Sipas kësaj dispozite përveç shpërblimit bazë të administratorit, atij mund ti bëhen dhe shtesa që janë përqindje të caktuara nga fitimi i realizuar nga shoqëria.⁷⁶¹ Shtesa të tilla janë të ngjashme me mënyrën e shpërblimit të agentit në kontratën e agjencisë sipas neneve 953 e vijues të Kodit Civil.⁷⁶²

Studiues shqiptarë të së drejtës së shoqërive tregtare, kanë mbajtur qëndrimin se marrëdhënia që krijohet mes administratorit dhe shoqërisë, gjen mbështetje në dispozitat e kontratës së agjencisë në Kodin Civil.⁷⁶³ Megjithatë, në Kodin e Punës ka një parashikim, i cili i ka premisat për të krijuar një konfuzion lidhur me faktin nëse marrëdhënia agent-porositës është marrëdhënie pune apo jo. Kjo për arsye se, nga njëra anë kontrata e

⁷⁵⁹ Thomas Bachner, Edmund-Philipp Schuster dhe Martin Winner (n 203) fq. 109.

⁷⁶⁰ Ligji 9901/2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” i ndryshuar, nenet 3m 14 dhe 98.

⁷⁶¹ Sipas nenit 97 pika 1 të Ligjit 9901/2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” i ndryshuar përcaktohet se; “1. Shpërblimit bazë të administratorëve mund t’i bëhen shtesa, që mund të jenë përqindje në fitim ose të ngjashme. Shpërblimet e administratorëve përcaktohen me vendim të zakonshëm të asamblesës përgjithshme”.

⁷⁶² Kodi Civil, nenet 953 e vijues.

⁷⁶³ Artan Hajdari shprehet se:

“Një interpretim i drejtë i ligjit tregtar, por dhe legjislacionit në fuqi të çon në konkluzionin se marrëdhënia që lind ndërmjet administratorit dhe shoqërisë ka karakteristikat e një marrëdhënieje të posaçme, e cila rregullohet si nga ligji tregtar, por dhe nga dispozitat të veçanta të Kodit Civil, sidomos ato që bëjnë fjalë për kontratën e agjencisë. Vetë LSHT e pozicionin administratorin si një organ të posaçëm, i cili ka kompetenca që në logjikën juridike tejkalojnë një marrëdhënie të thjeshtë pune. Po ashtu nga ana tjetër administratori vishet me përgjegjësi, të cilat sërish tejkalojnë një marrëdhënie të thjeshtë pune”. Hajdari (n 210) fq. 95.

agjencisë parashikohet nga neni 950 e vijues i Kodit Civil,⁷⁶⁴ por nga ana tjetër në Kodin e Punës në nenin 16 të titulluar “Agjenti tregtar (Komisionerët)” marrëdhënia e krijuar mes agjentit tregtar dhe porositisit (principalit) futet brenda sferës së zbatimit të Kodit të Punës, duke e konsideruar këtë marrëdhënie si marrëdhënie pune.⁷⁶⁵

Studiues të tjerë të së drejtës tregtare, e konsiderojnë marrëdhënien që lind mes administratorit dhe shoqërisë si një marrëdhënie pune, për këtë qëndrim kanë si argument formal dhe legjislacionin fiskal, sipas të cilit ky kuadër ligjor e konsideron administratorin si të punësuar në shoqëri.⁷⁶⁶ Autorë të tjerë shqiptarë, e kanë konsideruar marrëdhënien që lind mes administratorit dhe shoqërisë, jo si një marrëdhënie pune, por si një kontratë shërbimi, megjithëse nuk është parashikuar nga Kodi Civil, ose si një kontratë *sui generis*, që rregullohet nga Kodi Civil.⁷⁶⁷

Por marrëdhënia e punës mbështet në një format të qartë të mirëkufizuar të drejtash dhe detyrimesh mes punëmarrësit dhe punëdhënësit, të përshkruara nga Kodi i Punës dhe nga kontrata e punës. Marrëdhënia mes administratorit dhe shoqërisë, në të cilën ai përfaqëson, është një marrëdhënie shumë më komplekse sesa një marrëdhënie pune. Kjo e fundit bazohet mbi raportin e varësisë dhe të zbatimit të urdhrave dhe detyrave nga punëmarrësi, sipas orientimeve të mirëpërcaktuara nga punëdhënësi me shkrim apo me gojë. Gjithashtu angazhimet, të drejtat dhe detyrimet e administratorit në shoqërinë tregtare ku është caktuar si administrator (dhe ka marrë përsipër ta kryejë këtë detyrë) e kapërcejnë dhe sferën e të drejtave dhe detyrimeve të parashikuara për agjentin tregtar në kontratën e agjencisë.

⁷⁶⁴ Sipas nenit 950 të Kodit Civil parashikohet që: “Me kontratën e agjencisë, njëra palë merr përsipër, në mënyrë të vazhdueshme dhe me shpërblim, që të lidhë kontratat në një zonë të caktuar, për llogari të palës tjetër. Secila palë ka të drejtë të marrë nga pala tjetër një kopje të kontratës të nënshkruar prej saj.”

⁷⁶⁵ Sipas nenit 16 të Kodit të Punës përcaktohet se:

“1. Me kontratën e punës të agjentit tregtar, punëmarrësi (agjenti tregtar) detyrohet kundrejt pagesës të hyjë në bisedime ose të përfundojë marrëveshje për veprimtari të çdo lloji natyre qofshin, jashtë ndërmarrjes, sipas urdhrave dhe për llogari të punëdhënësit. 2. Nuk konsiderohet si agjent tregtar personi që e ushtron këtë veprimtari në mënyrë të pavarur. 3. Dispozitat e këtij Kodi zbatohen edhe për kontratën e agjentit tregtar si punëmarrës.”

⁷⁶⁶ Vendim i Këshillit të Ministrave 285/2007 “Për përcaktimin e pagës referuese mujore, për efekt të llogaritjes së kontributeve të sigurimeve shoqërorë dhe shëndetësore, dhe të tatimit mbi të ardhurat personale, sipas nomenklaturës së veprimtarisë ekonomike, për të punësuarit në sektorin jopublik që kryejnë punë, të pakualifikuara e të kualifikuara, si dhe për personelin drejtues tekniko-ekonomik të tyre” [2007] FZ 59, neni 3.

⁷⁶⁷ Altina Xhoxhaj shprehet se:

“Por a mundet të jetë një kontratë shërbimi? Personalisht mendoj se po. Kjo për arsye se në këtë rast kemi një person, i cili vë në shërbim të një shoqërie të gjitha aftësitë e tij, njohuritë e tij, për të drejtuar një aktivitet ekonomik - tregtar, aftësi të cilat nuk i kanë ortakët, në rastin e administratorit jo ortak. Megjithatë, një kontratë e tillë nuk rregullohet nga Kodi ynë Civil. Ashtu siç mund të jetë një lloj i veçantë marrëdhënieje kontraktore *sui generis*, që rregullohet sipas Kodit Civil”.

Altina Xhoxhaj, *Gjykimi i çështjeve që lidhen me organizimin dhe funksionimin e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar* (Tezë doktore, Fakulteti i Drejtësisë Universiteti i Tiranës 2012) fq. 69.

Në të njëjtën kohë, administratorët u nënshtrohen dhe detyrimeve të përcaktuara në nenet 14, 13, 98 të ligjit, që përfshijnë detyrimin e besnikërisë,⁷⁶⁸ ndalimin e konfliktit të interesit me personat e lidhur,⁷⁶⁹ detyrimin për të qenë të përgjegjshëm⁷⁷⁰ dhe detyrimin për të mos ushtruar aktivitetet konkurrues ndaj shoqërisë.⁷⁷¹

Nga këto dispozita konstatohet se administratorët e një SHPK-je, shumicën e kompetencave dhe detyrimeve të tyre i marrin nga dispozitat e ligjit të mësipërm, - *ex lege* - dhe jo nga akti i emërimit apo nga vullneti i ortakëve në statut. AO nuk ka kompetenca të mirëfillta urdhëruese mbi administratorët, por vetëm në përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë, të cilat administratorët kanë detyrimin që t'i zbatojnë. Ndërsa kompetencat e tjera të Asamblesë në raport me administratorët kanë më shumë karakter kontrollues dhe

⁷⁶⁸ Sipas pikës së parë të nenit 14 të Ligjit 9901/2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” i ndryshuar parashikohet që:

“1. Gjatë ushtrimit të të drejtave, ortakët dhe aksionarët veprojnë, duke marrë parasysh interesat e shoqërisë dhe të ortakëve apo të aksionarëve të tjerë. I njëjti detyrim zbatohet edhe për administratorët, anëtarët e këshillit të administrimit apo të këshillit mbikëqyrës.”

⁷⁶⁹ Ligji 9901/2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” i ndryshuar, neni 13.

⁷⁷⁰ Sipas nenit 98 “Detyrimi i besnikërisë dhe përgjegjësisia” të ligjit parashikohet se:

1. Përveç sa është parashikuar në dispozitat e përgjithshme të detyrimit të besnikërisë, sipas neneve 14, 15, 17 e 18 të këtij ligji, administratorët detyrohen:

a) të kryejnë detyrat e tyre të përcaktuara në ligj ose në statut në mirëbesim e në interesin më të mirë të shoqërisë në tërësi, duke i kushtuar vëmendje të veçantë ndikimit të veprimtarisë së shoqërisë në mjedis;

b) të ushtrojnë kompetencat që u njihen në ligj ose në statut vetëm për arritjen e qëllimeve të përcaktuara në këto dispozita;

c) të vlerësojnë me përgjegjësi çështjet, për të cilat merret vendim;

ç) të parandalojnë dhe mënjanojnë rastet e konfliktit, prezent apo të mundshëm, të interesave personalë me ata të shoqërisë;

d) të garantojnë miratimin e marrëveshjeve sipas dispozitave të pikës 3 të nenit 13 të këtij ligji;

dh) të ushtrojnë detyrat e tyre me profesionalizmin dhe kujdesin e nevojshëm.

2. Administratorët, gjatë kryerjes së detyrave të tyre, përgjigjen ndaj shoqërisë për çdo veprim ose mosveprim, që lidhet në mënyrë të arsyeshme me qëllimet e shoqërisë tregtare, me përjashtim të rasteve kur, në bazë të hetimit dhe vlerësimit të informacioneve përkatëse, veprimi ose mosveprimi është kryer në mirëbesim.

3. Nëse administratorët veprojnë në kundërshtim me detyrat dhe shkelin standardet profesionale, sipas pikave 1 e 2 të këtij neni, janë të detyruar t'i dëmshpërblejnë shoqërisë dëmet, që rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe t'i kalojnë çdo fitim personal që ata apo personat e lidhur me ta kanë realizuar nga këto veprime të parregullta. Administratorët kanë barrën e provës për të vërtetuar kryerjen e detyrave të tyre në mënyrë të rregullt e sipas standardeve të kërkuara. Kur shkelja është kryer nga më shumë se një administrator, ata përgjigjen ndaj shoqërisë në mënyrë solidarë.

4. Në mënyrë të veçantë, por pa u kufizuar në to, administratorët janë të detyruar t'i dëmshpërblejnë shoqërisë dëmet e shkaktuara, nëse, në kundërshtim me dispozitat e këtij ligji, kryejnë veprimet e mëposhtme:

a) u kthejnë ortakëve kontributet;

b) u paguajnë ortakëve interesa apo dividendë;

c) u shpërndajnë aktivet shoqërisë;

ç) lejojnë që shoqëria të vazhdojë veprimtarinë tregtare, kur, në bazë të gjendjes financiare, duhej të parashikohej që shoqëria nuk do të kishte aftësi paguese për të shlyer detyrimet;

d) japin kredi.”

⁷⁷¹ Ligji 9901/2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” i ndryshuar, neni 17.

mbikëqyrës. Sigurisht që AO ka gjithnjë dhe të drejtën e përcaktimit të shpërblimit, si dhe të emërimit dhe shkarkimit të tyre. Në të gjitha rastet, kompetencat që ushtron AO në raport me Administratorin, ajo (AO) përfaqëson shoqërinë me përgjegjësi të kufizuar, si rast përjashtimor përfaqësimi. Ndërsa në të gjitha rastet e tjera, shoqëria përfaqësohet nga administratori i shoqërisë.⁷⁷²

Nga dispozitat e ligjit 9901/2008, dhe veçanërisht, kompetencat e administratorit të cituara në nenin 95, evidentohet një diskrecion i madh i administratorit në veprimet e administrimit të përditshëm të shoqërisë, qoftë ky administrimi i brendshëm i veprimtarisë ekonomiko-financiare dhe aktivitetit tregtar, qoftë për veprimet e administrimit të jashtëm, për të cilat administratori ka ekskluzivitetin e përfaqësimit të shoqërisë.

Nëse i referohemi Kodit të Punës, i cili është ligj organik, i miratuar me shumicë të cilësuar dhe në aspektin hierarkik, qëndron mbi legjislacionin tatimor, konstatohet se marrëdhënia e administratorit me shoqërinë nuk përfshihet në fushën e zbatimit të Kodit të Punës. Duke respektuar hierarkinë e normave juridike, pra duke i dhënë prioritet parashikimit të nenit 5 të Kodit të Punës do të konstatojmë se marrëdhënia që lind mes administratorit dhe shoqërisë është përjashtuar nga fusha e zbatimit të Kodit të Punës.⁷⁷³ Si rrjedhim, praktika e deritanishme e administratorëve për të mbështetur në Kodin e Punës kërkimet e tyre për dëmshpërblim në rast shkarkimi nga detyra, janë të pambështetura ligjërisht.

Gjithashtu, dhe dispozitat e pjesës së përgjithshme të Kodit Civil, parashikojnë dhe mundësinë e kontratave atipike (*sui generis*), të cilat i nënshtrohen gjithsesi pjesës së përgjithshme të detyrimeve kontraktuale.⁷⁷⁴ Pra, kjo marrëdhënie juridike që krijohet mes administratorit dhe SHPK-së, pasqyron një kompleksitet të drejtash dhe detyrimesh të ngjashme me institutin e përfaqësimit, porosisë, komisionit, agjencisë, kontratën e punës, dhe kontratave të tjera të shërbimit, por me specifikën që shumica e të drejtave dhe detyrimeve të palëve, janë parashikuar në ligjin specifik që është ligji Nr. 9901/2008.

Për këtë arsye, kjo marrëdhënie duhet konsideruar si një marrëdhënie e posaçme e shërbimit, e cila tejkalon karakteristikat e kontratës së punës. Pra, është një kontratë e posaçme, e cila rregullohet nga një ligj i veçantë (ligji 9901/2008), që ka dhe karakteristikat

⁷⁷² Ligji 9901/2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” i ndryshuar, neni 95/3 “b” dhe 96.

⁷⁷³ Sipas nenit 5 të Kodit të Punës rezulton se:

“Përjashtohen nga fusha e zbatimit të këtij Kodi: a) veprimtaria që kufizohet vetëm në ushtrimin e detyrës së këshilltarit ose anëtarit të organit të administrimit të personit juridik që ka formën juridike të një shoqërie, kur kjo veprimtari përmban vetëm ekzekutimin e detyrimeve që rrjedhin nga kjo detyrë; b) Shfuqizuar. c) punët familjare që kryhen nga: bashkëshorti, fëmijët dhe bashkëshortet e tyre, partnerët bashkëjetues, paraardhës të tyre, përfshirë të birësuarit, për aq kohë sa jetojnë me punëdhënësin në një ekonomi të përbashkët, me përjashtim të rasteve kur provohet se personat që i kryejnë ato janë punëmarrës.”

⁷⁷⁴ Shih nenet 659 e vijues të Kodit Civil.

e nje kontrate atipike (*sui generis*), e cila është në përputhje edhe me dispozitet e pjesës së përgjithshme të kontratave të Kodit Civil.

6.4. Kushtet për të qenë administrator

AO e shoqërisë mund të caktojë si administrator një ortak ose një person jashtë rrethit të ortakëve, me qëllim që shoqëria të përfitojë nga persona të kualifikuar në fushën e administrimit dhe menazhimit të veprimtarisë tregtare.⁷⁷⁵

Kushtet për të qenë administrator në një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, janë shumë liberale dhe ligji nuk kërkon ndonjë arsim, profesion apo eksperiencë të domosdoshme. Megjithatë, në ligj janë parashikuar disa kufizime për disa kategori personash, të cilët nuk mund të kryejnë detyrën e administratorit në një SHPK.

- a. Kushti i kryesor i përcaktuar nga ligji është që administratorët duhet të jenë gjithmonë persona fizikë me zotësi të plotë për të vepruar.⁷⁷⁶
- a. Gjithashtu sipas nenit 95/2 të ligjit, administratorët e një shoqërie tregtare mëmë, sipas përcaktimit të nenit 207 të këtij ligji, nuk mund të emërohen si administratorë të një shoqërie të kontrolluar e anasjelltas. Çdo emërim i bërë në kundërshtim me këto dispozita është i pavlefshëm.⁷⁷⁷
- b. Sipas nenit 13/1 të ligjit, përcaktohet që personat, që janë dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e veprave penale, të parashikuara në kreun III të pjesës së posaçme të Kodit Penal, për një afat deri në 5 vjet nga data e këtij dënimi, nuk mund të mbajnë funksionet e përfaqësuesit ligjor të një shoqërie tregtare.⁷⁷⁸

Përsa i përket rastit të tretë, të kushteve ndaluese për të ushtruar pozicionin e administratorit, duhet të kemi parasysh që ky i referohet një dënimi plotësues të parashikuar nga neni 30 pika 6 e Kodit Penal,⁷⁷⁹ i cili jepet nga Gjykata kompetente që ka dhënë

⁷⁷⁵ Ligji 9901/2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” i ndryshuar, neni 95.

⁷⁷⁶ Ligji 9901/2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” i ndryshuar, neni 95/2.

⁷⁷⁷ Sipas paragrafit të parë dhe të dytë të nenit 207 të ligjit 9901/2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” i ndryshuar:

1. Vlerësohet se ekziston një marrëdhënie mëmë-shoqëri e kontrolluar, kur një shoqëri tregtare silllet e vepron rregullisht, sipas orientimeve dhe udhëzimeve të një shoqërie tjetër. Ky kontroll quhet grup kontrollues.

2. Kur një shoqëri, në bazë të pjesës së kapitalit të zotëruar në një shoqëri tjetër ose në bazë të një marrëveshjeje me atë shoqëri, ka të drejtë të emërojë të paktën 30 për qind të administratorëve, të anëtarëve këshillit të administrimit apo të këshillit mbikëqyrës të saj, apo kur ajo zotëron të paktën 30 për qind të totalit të votave në asamblenë e përgjithshme, atëherë kjo shoqëri vlerësohet si mëmë e shoqërisë tjetër, ndërsa shoqëria tjetër vlerësohet shoqëri e kontrolluar. Ky kontroll quhet grup influencues.”

⁷⁷⁸ Ligji 9901/2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” i ndryshuar, neni 23.

⁷⁷⁹ Sipas nenit 30 të Kodit Penal:

dënimin, për një apo më shumë nga këto vepra penale që përfshin ky kre i Kodit Penal. Kreu III i Kodit penal përfshin 11 seksione duke filluar nga neni 134 deri në nenin 200.⁷⁸⁰

Megjithatë, sipas nenit 13 të ligjit 9901/2008, rezulton se jo çdo dënim penal për këto vepra penale përbën kusht përjashtues për të ushtruar detyrën e administratorit në një SHPK. Vetëm në rast se gjykata ka dhënë për autorin e veprës penale dhe një dënim plotësues sipas pikës 6 të nenit 30 të Kodit Penal, atëherë ky ndalim do të jetë i vlefshëm për aq kohë sa ka vendosur gjykata në vendimin e saj të formës së prerë. Gjithsesi referuar paragrafit të parë të nenit 13 të ligjit, kohëzgjatja e ndalimit për dënimin plotësues nuk i kalon 5 vite nga dhënia e vendimit të dënimit.⁷⁸¹

6.4. Mandati i administratorit

Në nenin 95 /1 të ligjit Nr. 9901/2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” është përcaktuar një afat maksimal për qëndrimin në detyrë detyrë administratorit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar. Sipas kësaj dispozite ky afat është 5 vite, me të drejtë riemërimi⁷⁸². Ky është një parashikim i ndryshëm, në raport me ligjin e mëparshëm nr. 7638/1992 “Për shoqëritë tregtare”, i cili në nenin 50 të tij nuk parashikonte një afat të qëndrimit në detyrë të administratorit. Sipas ligjit të mëparshëm administratori mund të emërohej në këtë detyrë edhe pa një afat të caktuar⁷⁸³.

Parashikimi i një mandati maksimal prej 5 vitesh për administratorin e një SHPK-je, i jep më shumë mundësi kontrolli asamblesë së ortakëve mbi administratorin e shoqërisë. Në këtë mënyrë, ortakët kanë një fleksibilitet më të madh për ndërrimin e administratorit në rast se performanca e tij nuk është brenda pritshmërive të tyre. Pra shoqëria mund ta përdorë mandatin e administratorit si mjet për largimin e tij, pa riskuar që ky largim të shoqërohet me kërkime apo padi për shpërbllim dëmi prej administratorit. Pikërisht për këtë arsye është e rekomandueshme për shoqëritë tregtare që mandati i emërimit të

“Për personat që kanë kryer krime ose kundërvajtje penale, bashkë me dënimin kryesor, mund të jepen edhe një ose disa nga këto dënime plotësuese:

1. [...]

6. Heqja e së drejtës për të ushtruar detyra drejtuese pranë personave juridikë.

7. [...]

⁷⁸⁰ Në këtë kre të Kodit Penal përfshihen veprat kundër pasurisë dhe në sferën ekonomike si vjedhjet (seksioni I), mashtrimet (seksioni II), shkatërrimi e pronës (seksioni III), veprat penale të kryera në shoqëritë tregtare (seksioni IV) si dhe ato në veprimtaritë bankare dhe financiare (seksioni IV/1) krimet në fushën e doganave (seksioni V), veprat penale në lidhje me tatimet dhe taksat (seksioni VI), fallsifikimi i letrave me vlerë (seksioni VII), falsifikimi i dokumenteve (seksioni VIII), veprat penale në fushën e falimentimit (seksioni IX), zhvillimi i palejuar i lojërave të fatit (seksioni X), vepra penale që cenojnë regjimin juridik të tokës dhe të ndërtimeve (seksioni XI).

⁷⁸² Ligji 9901/2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” i ndryshuar, neni 95, pika 1.

⁷⁸³ Ligji 7638/1992 “Për shoqëritë tregtare” [1992] FZ 8 (shfuqëzuar), neni 50.

administratorit në detyrë të vlerësohet me kujdes dhe nëse është rasti të caktohet dhe më i shkurtër sesa afati maksimal i parashikuar nga ligji.

Nëse i referohemi legjislacionit anglez i cili ka shërbyer si një prej burimeve të hartimit të ligjit 9901/2008, konstatojmë që në Angli ka një ligj specifik (*Section 319 of the Companies Act 1985*), i cili ka bërë të detyrueshëm përcaktimin e një afati maksimal prej 5 vitesh të kohëzgjatjes së kontratës së shërbimit të administratorit, si një mënyrë kontrolli e asamblesë së ortakëve mbi administratorin.⁷⁸⁴

Sipas pikës 6 të nenit 95 të ligjit, Asambleja e përgjithshme mund të shkarkojë administratorin në çdo kohë me shumicë të zakonshme. Statuti apo marrëveshje të tjera nuk mund të përjashtojnë apo kufizojnë këtë të drejtë. Paditë, që lidhen me shpërblimin e administratorit, në bazë të marrëdhënieve kontraktore me shoqërinë, rregullohen sipas dispozitave ligjore në fuqi.

Pra, sipas këtij parashikimi, kemi të bëjme më një dispozitë urdhëruese të ligjit përsa i përket mundësisë për shkarkimin e administratorit me shumicë të zakonshme. Kjo do të thotë që me statut nuk mund të parashikohet një shumicë më e lartë, (pra shumicë e cilësuar) për shkarkimin e administratorit. Edhe në rast se statuti përmban një dispozitë të tillë, atëherë ajo është e pavlefshme.⁷⁸⁵

6.5. Asambleja e Ortakëve

6.5.1. Kompetencat Asamblese së Ortakëve (AO)

Asambleja e Ortakëve është organi më lartë vendimmarrës i shoqërisë dhe ka përgjegjësinë e mbrojtjes së parimeve dhe qëllimit, për të cilin është themeluar shoqëria me përgjegjësi të kufizuar. Ajo ka kompetenca ekskluzive për vendimet ku diskutohen elementët konstituitivë thelbësorë, që përcaktohen në statutin e shoqërisë, si dhe miratimin e politikave dhe strategjive tregtare të shoqërisë. AO luan një rol të rëndësishëm edhe në aspektin e administrimit të shoqërisë, nëpërmjet planifikimit strategjik dhe përcaktimit të politikave tregtare të shoqërisë, si dhe me caktimin e administratorëve të cilët janë të detyruar të ndjekin këto politika.⁷⁸⁶ Ky organ me kompetencat e tij, merr dhe rolin e

⁷⁸⁴ Për më shumë lidhur me këtë trajtim teorik shih: Nichola Bourne, *Principles of Company Law* (Cavendish Publishing Limited 1993) fq 120.

⁷⁸⁵ Sipas nenit 95 pika 6 e ligjit 9901/2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” i ndryshuar përcaktohet se:

“6. Asambleja e përgjithshme mund të shkarkojë administratorin në çdo kohë me shumicë të zakonshme. Statuti apo marrëveshje të tjera nuk mund të përjashtojnë apo kufizojnë këtë të drejtë. Paditë, që lidhen me shpërblimin e administratorit, në bazë të marrëdhënieve kontraktore me shoqërinë, rregullohen sipas dispozitave ligjore në fuqi”.

⁷⁸⁶ Ligji 9901/2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” i ndryshuar, neni 81.

mbikëqyrësit dhe kontrollit të mënyrës se si administratori i shoqërisë ka zbatuar politikatat tregtare, si dhe detyrimet e tjera i që i burojnë nga ligji dhe nga statuti i shoqërisë.

Ligji 9901/2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” i ndryshuar, në nenin 81 të tij ka përcaktuar kompetencat e AO si “*të drejta dhe detyrime*” të Asamblesë. Pra, këto kompetenca të Asamblesë duhen konsideruar si përgjegjësi e këtij organi dhe ortakëve që e përbëjnë AO. Sipas nenit 81 të ligjit;⁷⁸⁷

“ 1. Asambleja e përgjithshme është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë për çështjet e mëposhtme:

- a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;*
- b) ndryshimet e statutit;*
- c) emërimin e shkarkimin e administratorëve;*
- ç) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;*
- d) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat "c" dhe "ç" të kësaj pike;*
- dh) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;*
- e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;*
- ë) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;*
- f) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;*
- g) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;*
- gj) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;*
- h) miratimin e rregullave proceduralë të mbledhjeve të asamblesë;*
- i) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.⁷⁸⁸*

Përsa i përket kompetencave të karakterit administrativ, të renditura në nenin 81 të ligjit, konstatojmë se e drejta për të përcaktuar politikatat tregtare të shoqërisë dhe ajo e emërimit dhe shkarkimit të administratorëve, si dhe përcaktimi i marrëdhënies me administratorët e shoqërisë, janë kompetenca aktive në administrimin e shoqërisë. Ndërsa kompetencat e tjera vendimmarrëse lidhen me miratimin e veprimtarisë administruese të përgatitur paraprakisht nga administratori, të cilat i vihen në dispozicion për miratim Asamblesë së Ortakëve.⁷⁸⁹

Gjithashtu, ligji parashikon dhe raste përjashtimore, në të cilat asambleja e ortakëve merr kompetencat për përfaqësimin e shoqërisë. Neni 92 pika 1 parashikon të drejtën e asamblesë së ortakëve që të ngrejë padi ndaj administratorit apo ortakëve të shoqërisë,⁷⁹⁰ pasi të ketë marrë një vendim me shumicë të cilësuar.

⁷⁸⁷ Ligji 9901/2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” i ndryshuar, neni 81

⁷⁸⁸ Ligji 9901/2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” i ndryshuar, neni 81.

⁷⁸⁹ Ligji 9901/2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” i ndryshuar, neni 81.

⁷⁹⁰ Ligji 9901/2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” i ndryshuar, Neni 92/1 parashikon që:

“1. Asambleja e përgjithshme, në bazë të një vendimi të marrë me shumicën e përcaktuar sipas pikës 2, neni 87, të këtij ligji, ka të drejtë të ngrejë padi përpara gjykatës kompetente për shfuqizimin e vendimeve të administratorëve, si pasojë e shkeljes së rëndë të ligjit ose të statutit dhe/ose padi të tjera që parashikon ky ligj ose statuti ndaj administratorëve apo ortakëve”.

Kjo është një dispozitë e re, e përfshirë me ndryshimet e vitit 2014 në ligjin 9901/2008. Nga interpretimi literal, formulimi i nenit 92/1, por edhe nenit 81/1 pika “g” të ligjit duket sikur ligji legjitimon organin e Asamblesë së Ortakëve të shoqërisë për të ngritur padinë në gjykatë, pra për të qenë palë ndërgjyqëse. Por në kushtet kur Asambleja nuk gëzon personalitet juridik, një qëndrim i tillë do të binte ndesh me parimet procedurale civile⁷⁹¹ dhe qëndrimin e një pjese të praktikës gjyqësore.⁷⁹² Në të vërtetë, praktika gjyqësore nuk është e unifikuar në këtë aspekt, pasi ka qëndrime të ndryshme përsa i përket faktit nëse mund të legjitimohet AO si palë në proces apo jo. Konstatohet se ka edhe shumë raste, në të cilat gjykatat kanë legjitimuar si palë paditëse vetë Asamblenë e ortakëve të shoqërisë.⁷⁹³

Kësaj çështjeje të legjitimitimit procedural i jep zgjidhje paragrafi i tretë i nenit 92 të ligjit 9901/2008, i cili ka rregulluar më qartë mënyrën e përfaqësimit të shoqërisë në rastin e një gjykimi me objekt një kërkim ndaj administratorit të saj, duke parashikuar se: *“Në rastet kur shoqëria ngre padi si më sipër, ajo merr pjesë në gjykim me anë të një përfaqësuesi të posaçëm, të caktuar nga asambleja e përgjithshme”*.⁷⁹⁴

Nga një interpretim harmonik me pikën 92/3 edhe për rastet e parashikuara në nenet 81 pika 1 germa “g” dhe 92 pika 1 të ligjit, vlerësojmë se në këto raste përjashtimore Asamblesë së Ortakëve i është dhënë kompetenca e përfaqësimit të shoqërisë në kuptimin funksionimit të brendshëm të shoqërisë, por jo në kuptimin e legjitimitimit procedural formal në gjykatë. Për të gëzuar cilësinë e përfaqësuesit, një subjekt do të duhet të gëzonte patjetër personalitet të pavarur juridik, gjë që i mungon organit të AO. Në këto lloj konfliktesh gjyqësore me administratorët, AO merr kompetenca për përfaqësimin e shoqërisë, por ajo detyrimisht duhet të caktojë një person fizik si përfaqësues të posaçëm të shoqërisë që do të paraqitet në gjykim. Pra, në këto raste legjitimitimi aktiv si palë paditëse i takon shoqërisë, e përfaqësuar në gjykim nga një përfaqësues i posaçëm (ortak apo avokat etj.) i caktuar me vendim të AO.

Në thelb kjo procedurë mund të themi se përbën një mënyrë përjashtimore të zëvendësimit të administratorit të shoqërisë me një person tjetër, i cili kryen rolin e përfaqësuesit ligjor të përkohshëm të saj, dhe me tagra të posaçëm përfaqësimi, që janë përcaktuar në këtë vendimmarrje të Asamblesë.

⁷⁹¹ Neni 90 i Kodit të Procedurës Civile parashikon se *“Palë në një gjykim civil janë personat fizikë ose juridikë, në emër ose kundër të cilëve zhvillohet gjykimi. Askush nuk mund të përfaqësojë në një gjykim civil të drejtat e të tjerëve, përveç kur ligji parashikon ndryshe.”*

⁷⁹² Shih Vendimin Nr 00-2016-1773 i Vendimit (165) dt.18.05.2016 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.

⁷⁹³ Shih Vendimin Nr.1372 dt.12.10.2018 Gjykata e Apelit Tiranë, Vendimin Nr.846 dt.04.12.2014, Gjykata e Apelit Tiranë, Vendimin Nr.528 dt.07.11.2012, Gjykata e Apelit Tiranë, dhe Vendimin nr.82, datë 19.03.2013, Gjykata e Apelit Tiranë.

⁷⁹⁴ Ligji 9901/2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” i ndryshuar, neni 92 pika 3.

Ligji ka parashikuar që edhe në rast se shoqëria zotërohet nga një ortak i vetëm, të drejtat dhe detyrimet e asamblesë së përgjithshme ushtrohen nga ortaku i vetëm. Por në një rast të tillë ligji parashikon një detyrim shtesë për shoqërinë me ortak të vetëm, i cili është mbajtja e një regjistri të posaçëm ku të shënohen vendimet e asamblesë.⁷⁹⁵

Ligji i ka kushtuar një rëndësi të madhe evidentimit të veprimtarisë vendimmarrëse të AO të SHPK-së, sidomos kur shoqëria ka vetëm një ortak. Ky regjistër ka për qëllim të identifikojë vendimet e asamblesë (me ortak të vetëm), në ushtrimin e kompetencave të saj, dhe shmangien e konfuzionit apo mbivendosjes së kompetencave në rast se ortaku i kësaj shoqërie kryen dhe ndonjë detyrë tjetër në shoqëri, si psh. atë të administratorit apo ekspertit kontabël (në shoqërinë ku është ortak i vetëm). Madje sipas paragrafit të fundit të nenit 81 parashikohet që: *“Vendimet që nuk janë të regjistruara në regjistrin e vendimeve janë absolutisht të pavlefshme”*. Kjo është një pasojë që prek vetëm ortakun e shoqërisë. Shoqëria nuk mund t'i kundrejtojë këtë pavlefshmëri kreditorëve, që kanë fituar të drejta në mirëbesim, përveç rastit kur shoqëria provon se i treti ka pasur dijeni për pavlefshmërinë, apo në bazë të rrethanave të qarta nuk mund të mos kishte pasur dijeni për të.

Përveç kompetencave të cituara në nenin 81 të ligjit, AO mund të vendosë edhe për çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti. Vetë ligji në dispozita të tjera ka parashikuar disa vendime që kërkojnë detyrimisht marrjen e një vendimi nga ana e asamblesë.⁷⁹⁶ Disa prej këtyre vendimeve janë: i) vlerësimi i veprimtarisë së një ortaku apo ngritjen e një padie ndaj tij (neni 89 i ligjit); ii) kryerja e hetimeve të posaçme dhe caktimi i ekspertëve të ndryshëm për këtë qëllim (neni 91 i ligjit); iii) vlerësimi punës së administratorëve apo ngritjen e padisë ndaj tij (neni 92 i ligjit); iv) largimi i ortakut (neni 101 i ligjit) përjashtimi i ortakut, (neni 102 i ligjit); v) anulimi i kuotës (neni 80/1 i ligjit), etj.

Ndërsa statuti i shoqërisë në kuadër të autonomisë statutore të analizuar më lart mund të parashikojë edhe kompetenca të tjera për AO. Disa prej këtyre kompetencave mund të jenë: i) dhënia e pëlqimit nga asambleja, si kusht për transferimin e kapitalit, ii) marrja e financimeve nga të tretët dhe kushtet përkatëse; iii) dhënia e pëlqimit për kontrata të caktuara mbi një limit të parashikuar të vlerës së kontratës; dhe iv) dhënia e autorizimeve të posaçme në funksion të ushtrimit të aktivitetit.⁷⁹⁷

⁷⁹⁵ Neni 81/3 i Ligjit 9901/2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” i ndryshuar, përcakton se:

“Të gjitha vendimet e marra nga ortaku i vetëm regjistrohen në një regjistër të vendimeve, të dhënat e të cilit nuk mund të ndryshohen ose të fshihen. Duhet regjistruar në veçanti, por pa u kufizuar në to, vendimet për:

a) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;

b) shpërndarjen e fitimeve vjetore dhe mbulimin e humbjeve;

c) investime;

ç) vendimet për riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

⁷⁹⁶ Ligji 9901/2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” i ndryshuar, nenet 89, 91, 92, 101, 102.

⁷⁹⁷ Hajdari (n 210) fq. 63.

Por në këtë aspekt, ortakët nuk mund ta tejkalojnë ligjin me parashikimet në statut, duke i lënë AO kompetenca të administrimit të zakonshëm të shoqërisë, të cilat, në bazë të ligjit, janë përgjegjësi e administratorit”.⁷⁹⁸ Pra, edhe autonomia statutore ka një kufizim, përsa u përket kompetencave që mund të parashikohen për Asamblenë. Ky limit konstatohet te dispozitat që parashikojnë kompetencat e administratorëve, si neni 95 i ligjit, dhe në çdo dispozitë tjetër në të cilën ligji ka përcaktuar në mënyrë ekskluzive kompetenca dhe përgjegjësi për administratorin e SHPK-së.

Si konkluzion mund të themi që ortakët e një SHPK-je, nëpërmjet statutit, si dhe aplikimit të të drejtave të parashikuara nga ligji, mund të zgjedhin vetë që t’i japin asamblesë së ortakëve një rol më aktiv apo një rol më pasiv në administrimin e shoqërisë tregtare. Kur ortakët dëshirojnë të jenë më të përfshirë në administrimin e shoqërisë tregtare, ata duhet të aplikojnë çdo hapësirë që ligji i ka lejuar në kuadër të lirisë statutore, dhe t’i parashikojnë në statut të gjitha ato përgjegjësi dhe kompetenca që mund të ushtrohen në mënyrë ekskluzive nga Asambleja, apo mënyrë të përbashkët me asamblenë, por gjithnjë pa cenuar kompetencat ekskluzive të administratorëve të parashikuara në ligj.

Në praktikë ka pasur edhe raste kur është keqinterpretuar liria statutore duke u përfshirë në statut edhe parashikime, të cilat i detyronin administratorët që të marrin pëlqimin e AO për çdo veprim administrimi. Një parashikim i tillë është i ekzagjeruar dhe vjen në kundërshtim me parashikimet e ligjit dhe konkretisht me nenin 12 dhe 95 të ligjit.

6.5.2. Mbledhjet e Asamblesë së Ortakëve

Ligji 9901/2008, ka përcaktuar një procedurë, e cila është e detyrueshme për t’u respektuar përsa i përket mbledhjes së AO. Sipas nenit 82 të ligjit, përcaktohet që mbledhja e zakonshme e Asamblesë duhet të zhvillohet të paktën një herë në vit për të miratuar pasqyrat financiare dhe kontabilitetin vjetor të shoqërisë. Gjithashtu, përcaktohet se asambleja mblidhet në rastet e përcaktuara nga ky ligj, nga ligje të tjera, ose nga dispozitat e statutit dhe sa herë që mbledhja është e nevojshme për të mbrojtur interesat e shoqërisë.⁷⁹⁹

Sipas nenit 82 të ligjit, Asambleja e përgjithëshme e ortakëve është e detyrueshme të thirret dhe të marrë vendim në rast se:

⁷⁹⁸ Sipas nenit 12/1 të ligjit 9901/2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” i ndryshuar:

“1. Statuti apo vendimet e shoqërisë nuk mund të ndryshojnë apo të kufizojnë kompetencat që ky ligj përcakton për organet e ndryshme të shoqërisë tregtare. Çdo veprim, që ka për qëllim ndryshimin apo kufizimin e kompetencave të organeve të shoqërisë, të cilat nuk lejohen shprehimisht, sipas këtij ligji, nuk mund t’u kundërshtohen palëve të treta edhe nëse janë bërë publike në statut apo sipas mënyrave të parashikuara nga ligji nr. 9723, datë 3.5.2007, “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”, të ndryshuar.

⁷⁹⁹ Ligji 9901/2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” i ndryshuar, neni 82.

- a. sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshembrenda 3 muajve në vazhdim⁸⁰⁰ (neni 82/3);
- b. kur shoqëria propozon të shesë apo të disponojë në mënyrë tjetër aktive, të cilat kanë një vlerë më të lartë se 5 përqind të asetëve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.⁸⁰¹ (neni 82/4);
- c. kur shoqëria, brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5 përqind të asetëve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.⁸⁰²

Mbledhjen e Asamblesë së shoqërisë e thërret administratori, por gjithashtu mund ta thërrasin edhe ortakët që disponojnë jo më pak se 5% të kapitalit të shoqërisë⁸⁰³ (ose nje kufi edhe me të ulët nëse është parashikuar në statutin e shoqërisë).

Siç konstatohet nga kjo dispozitë, ligji u ka dhënë një garanci të madhe ortakëve të shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar, për të kërkuar thirrjen e asamblesë së shoqërisë dhe për të përfshirë në diskutime në rendin e ditës, vendimmarrje lidhur me çështje për të cilat ata janë të interesuar. Kjo e drejtë u njihet edhe ortakëve në minorancë, pra ortakëve me pjesëmarrje të vogël në kapitalin e shoqërisë. Në rast se këto të drejta për thirrjen e mbledhjes së asamblesë nuk respektohen nga administratori, ligji u njeh ortakëve të drejtën që t'i drejtohen gjykatës duke kërkuar detyrimin e administratorit për të përmbushur këto të drejta. Ose, nëse ata e vlerësojnë si më të favorshme, mund të largohen nga shoqëria, duke e detyruar shoqërinë t'i blejë kuotat e zotëruara prej tyre. Kjo e fundit në fakt është një procedurë e ngjashme me largimin e ortakut e parashikuar nga neni 101 i ligjit, i cili parashikon rastet kur ortaku ka të drejtë të largohet nga shoqëria, duke kërkuar dhe likuidimin e kuotës në shoqëri.

Madje edhe në rast të aplikimit të nenit 84 pika 2 gërma “b”,⁸⁰⁴ shoqëria nuk mund të bëhet pronare e kapitalit të saj, por do të jetë e detyruar të anulojë këto kuota, pasi të ketë bërë shlyerjen e detyrimit për ortakun në minorancë. Në një rast të tillë mund të themi që edhe ky parashikim duhet të aplikohet sipas procedurës së përcaktuar në nenin 102 i ligjit, që

⁸⁰⁰ Ligji 9901/2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” i ndryshuar, neni 82/3.

⁸⁰¹ Ligji 9901/2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” i ndryshuar, neni 82/4.

⁸⁰² Ligji 9901/2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” i ndryshuar, neni 82/5.

⁸⁰³ Ligji 9901/2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” i ndryshuar, neni 84 parashikon që:

“Nëse, në kundërshtim me pikën 1 të këtij neni, asambleja e përgjithshme nuk thirret, ose çështja e kërkuar prej këtyre nuk futet në rendin e ditës, secili prej ortakëve, që kanë bërë kërkesën, ka të drejtë:

- a) të ngrejë padi në gjykatë, për të deklaruar shkeljen e detyrimit të besnikërisë, nëse administratorët nuk përmbushin kërkesat e ortakëve brenda 15 ditëve;
- b) t'i kërkojë shoqërisë blerjen e kuotave, të zotëruara prej tyre”

⁸⁰⁴ Ky nen parashikon të drejtën e ortakëve në minorancë t'i kërkojë shoqërisë blerjen e kuotave, të zotëruara prej tyre.

parashikon likuidimin e kuotës në rastin e largimit për shkaqe të justifikuara të ortakut nga shoqëria.⁸⁰⁵

Në mbledhjen e AO secili ortak mund të paraqitet personalisht ose të përfaqësohet nga një person tjetër i autorizuar prej tij. Në bazë të nenit 85 të ligjit në fuqi, ka vetëm një kufizim përsa i përket rrethit të personave që mund të jenë përfaqësues të ortakut në mbledhjet e AO.⁸⁰⁶ Administratori i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar nuk mund të jetë edhe përfaqësues i ortakut në mbledhjen e asamblesë së ortakëve.⁸⁰⁷ Ky parashikim rrjedh nga parimet e ndalimit të konfliktit të interesit, pasi siç u analizua më lart, AO është organi që mbikëqyr punën e administratorit të shoqërisë. Sigurisht që ky kufizim nuk mund të aplikohet në rast se vetë administratori është dhe ortak i shoqërisë, pasi në këtë rast ai merr pjesë në mbledhjen e asamblesë në cilësinë e ortakut.⁸⁰⁸

Ligji në fuqi nuk parshikon ndonjë detyrim përsa i përket aspektit të solemnitetit të aktit të autorizimit të përfaqësuesit. Pra nuk kërkohet që akti i përfaqësimit të jetë i nënshkruar para një noteri publik. Në këtë mënyrë, ligji aktual e ka bërë më të lehtë dhe me më pak kosto përgatitjen e një autorizimi nga ortaku i shoqërisë. Autorizimi për përfaqësimin e ortakut jepet në formë shkresore vetëm për një mbledhje të asamblesë së përgjithshme, por është i vlefshëm edhe për mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.⁸⁰⁹

Në praktikën gjyqësore ka pasur qëndrime të ndryshme lidhur me formën dhe efektin e aktit të përfaqësimit për ortakun në mbledhjen e asamblesë. Neni 85 i ligjit 9901/2008 i referohet aktit të përfaqësimit si një autorizim i thjeshtë me shkrim. Pyetja e ngritur për diskutim është; Nëse autorizimi i përfaqësimit bëhet në formën e prokurës së posaçme, të lëshuar sipas nenit 70 dhe 71 të Kodit Civil, a mund të ketë një efekt më të gjerë, pra të jetë i vlefshëm për më shumë se një mbledhje – ndryshe nga autorizimi i thjeshtë, me shkrim, sipas nenit 85 të ligjit me një⁸¹⁰?

⁸⁰⁵ Sipas pika 1 të nenit 102 të ligjit 9901/2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” i ndryshuar parashikohet se “1. Ortaku mund të largohet nga shoqëria nëse ortakët e tjerë ose shoqëria kanë kryer veprime në dëm të tij, nëse është penguar të ushtrojë të drejtat e tij, nëse shoqëria i ka ngarkuar detyrime të paarsyeshme apo për shkaqe të tjera, që e bëjnë të pamundur vazhdimin e ortakërisë”

⁸⁰⁶ Ligji 9901/2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” i ndryshuar, neni 85.

⁸⁰⁷ Ligji 9901/2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” i ndryshuar, neni 85.

⁸⁰⁸ Ligji 9901/2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” i ndryshuar, neni 85.

⁸⁰⁹ Ligji 9901/2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” i ndryshuar, neni 85.

⁸¹⁰ Sipas nenit 70 të Kodit Civil:

“Prokura është dokumenti në të cilin i përfaqësuari, me vullnetin e tij të lirë ka përcaktuar karakterin dhe përcaktohet se vëllimin e tagrave që i ka dhënë përfaqësuesit”. Ndërsa, sipas nenit 71/2 të Kodit Civil, përcaktohet se; “Prokura është e posaçme kur i përfaqësuari i ka dhënë përfaqësuesit tagrin për të kryer një ose disa veprime juridike të caktuara, që karakterizohen nga një qëllim i përbashkët.”

Diskutimi lidhet me faktin nëse është apo jo e vlefshme një prokurë e posaçme e lëshuar para noterit publik për përfaqësimin e ortakut në disa mbledhje të Asamblesë së Ortakëve, që nuk janë në vazhdim të të njëjtit rend dite. Studiues të ndryshëm të së drejtës tregtare kanë mbështetur qëndrimet e praktikës gjyqësore, që kanë arritur në konkluzionin që prokura e posaçme e lëshuar në përputhje me Kodin Civil duhet të konsiderohet e vlefshme edhe për përfaqësimin e ortakut në disa mbledhje të asamblesë, pra pa u kufizuar vetëm për një mbledhje të AO, siç shprehet neni 85 i ligjit për autorizimin.⁸¹¹

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë në vendimin e saj nr. 4413, datë 07.04.2014 ka vlerësuar se përfaqësimi në bazë të një prokure të posaçme të ortakut në disa mbledhje të AO nuk duhet të konsiderohet i vlefshëm, pasi në kuptim të nenit 85 të ligjit 9901/2008 për përfaqësimin e ortakut në mbledhjet e AO, kërkohet detyrimisht lëshimi i një autorizimi që është vlefshëm vetëm për një mbledhje. Gjykata ka argumentuar qëndrimin e saj duke analizuar nenin 85 të ligjit, si një parashikim i cili përbën përjashtim nga rregullat e përgjithshme të përfaqësimit, për shkak të specifikave që ka pushteti i votës së ortakut në Asamblesë e shoqërisë, qoftë në raport me shoqërinë, qoftë në raport me kreditorët e saj.⁸¹²

Një qëndrim të kundërt ka mbajtur Gjykata e Apelit me Vendimin e saj Nr. 107 datë 20. 01. 2015, e cila ka ndryshuar vendimin e mësipërm. Sipas Gjykatës së Apelit;

“... nëse ligjvënësi ka përdorur termin autorizim në rastin e përfaqësimit të një ortaku, kjo lidhet vetëm me arsye praktike, efikasiteti dhe ekonomike, për të krijuar lehtësira ortakëve në pjesëmarrjen e tyre personalisht apo nëpërmjet përfaqësimit nga të tretë, pa patur të nevojshme të paraqiten pranë një noteri. Por kjo nuk do të thotë që prokura e posaçme e lëshuar me tagra të specifikuar të mos jetë e vlefshme vetëm për faktin që kërkohet për çdo mbledhje të lëshohet një prokurë e veçantë. Nëpërmjet prokurës së posaçme të lëshuar për mbledhje të ndryshme me rend dite të ndryshëm, presupozohet se ortaku e ka shprehur vullnetin e tij për të qenë i përfaqësuar në mbledhjen përkatëse”.⁸¹³

⁸¹¹ Hajdari (n 210) fq. 66-67.

⁸¹² Shih Vendimi nr. 4413, datë 07.04.2014 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë ku gjykata arsyeton se:

“Gjykata çmon se, ortaku që kërkon të përfaqësohet rregullisht në mbledhjen e asamblesë, nuk duhet të njaftohet me lëshimin e një prokure (jo konkrete) për përfaqësuesin e tij, por ligji tregtar kërkon domosdoshmërisht që autorizimi të jetë vetëm për një mbledhje dhe vetëm për një rend dite, të asaj mbledhje (i cili në qoftë se nuk ezaurohet, konsiderohet se autorizimi është i vlefshëm edhe për mbledhjen pasardhëse me të njëjtin rend dite). Arsyet e një parashikimi të tillë të legjisllacionit tregtar janë të shumta dhe trajtohen gjerësisht nga e drejta tregtare, por në vija të përgjithshme gjykata vlerëson se ky parashikim ekziston, si përjashtim nga rregullat e përgjithshme të përfaqësimit, për të mbrojtur ortakun dhe të tretët, nga vendimmarrja e pakontrolluar e përfaqësuesit (votimi). Vota në mbledhjen e asamblesë është një pushtet shumë i rëndësishëm i ortakut (ky i fundit mund të mbajë përgjegjësi edhe individualisht për detyrimet e shoqërisë, në kushte të caktuara faktike dhe ligjore) dhe ndaj ligji kërkon që kur ai (ortaku) lëshon “autorizim” për dikë tjetër që ta përfaqësojë në mbledhje, duhet të jetë i vetëdijshëm për çfarë do të diskutohet në mbledhje (dhe përgjegjësitë eventuale që rrjedhin prej kësaj). Parashikimi i nenit 85(3) të ligjit 9901, është një kriter formal i ligjit, i cili është i detyrueshëm për zbatim, e që nuk mund të anashkalohet nga palët.”

⁸¹³ Shih Vendimin e saj Nr. 107 datë 20. 01. 2015 Gjykata e Apelit Tiranë.

Këtë praktikë e mbështet edhe një pjesë e doktrinës së të drejtës tregtare në punimet e saj, rreth kësaj çështjeje.⁸¹⁴ Megjithatë, kjo praktikë e Gjykatës së Apelit, sipas vlerësimit tonë, nuk ezauron arsyen se cili ka qenë qëllimi i ligjvënësit kur e ka kufizuar vlefshmërinë e aktit e përfaqësimit të emërtuar “autorizim” vetëm për një mbledhje. Nëse ligji ka pasur parasysh vetëm thjeshtësinë e hartimit, aspektin formal-josolemn të këtij akti, apo ligji ka pasur për qëllim që t’i kushtojë më shumë rëndësi cilësive ngushtësisht personale të ortakut, përse i përket shprehjes së vullnetit të tij në mbledhjet e asamblesë. Cilësitë personale të ortakut, edhe në shoqërinë me përgjegjësi të kufizuar, paraqesin një rëndësi që nuk duhet të neglizhohet, sidomos kur shtrohet për diskutim mënyra e funksionimit të organit vendimmarrës të Asamblesë së Ortakëve.

Kështu që analiza e bërë në vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, e cila mbështet te parimet mbrojtjes së interesave të ortakëve në ushtrimin e të drejtave të tyre në organin vendimmarrës, si dhe të kreditorëve, duket se justifikon më shumë këtë parashikim të nenit 85 të ligjit. Sipas kësaj analize, ligji ka tentuar të kufizojë mundësinë e ortakëve, që nëpërmjet një autorizimi të posaçëm, qoftë kjo edhe prokurë përfaqësimi, të mund të përfaqësohen për një kohë të pacaktuar dhe për një larmishmëri çështjesh në mbledhjet e AO. Nëse ligji do të kishte një qëllim të ndryshëm do të duhej të riformulohej dispozita (neni 85) në një mënyrë që t’i jepej qartësisht e drejta ortakut që të përfaqësohet në mbledhjet e AO nga një përfaqësues i posaçëm për një kohë të pacaktuar dhe për mbledhje të ndryshme të AO. Në kushtet e një interpretimi jouniform të nenit 85 të ligjit, kjo është një çështje që i mbetet për unifikim Gjykatës së Lartë, ose mund të jetë objekt i përmirësimit të vetë nenit 85 të ligjit në fuqi, me qëllim zbatimin më të qartë në praktikë.

Në nenin 88 të ligjit në fuqi është parashikuar dhe mundësia që ortakët, në kuadër të lirisë statutore, të përcaktojnë në statutin e shoqërisë edhe mjete të tjera elektronike të pjesëmarrjes së ortakut në mbledhje dhe në vendimarrje.⁸¹⁵ Por ligji ka vendosur si detyrim që aplikimi i mënyrave të teknologjisë së informacionit për realizimin e mbledhjeve të asamblese bëhet me kushtin që të merren masat teknike të nevojshme për të garantuar identifikimin e ortakëve dhe sigurinë e komunikimeve elektronike, deri në atë masë që ky përdorim të jetë proporcional me arritjen e këtyre qëllimeve.⁸¹⁶

⁸¹⁴ Hajdari (n 210) fq. 67.

⁸¹⁵ Sipas nenit 88/3 të ligjit 9901/2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” i ndryshuar “*Mjetet elektronike përfshijnë, por pa u kufizuar në to:*

- a) *transmetimin e mbledhjes së asamblesë së përgjithshme në kohë reale;*
- b) *komunikimin e ndërsjellë në kohë reale, i cili u mundëson ortakëve të shprehën për mbledhjen e asamblesë së përgjithshme nga një vendndodhje tjetër;*
- c) *mekanizma, që mundësojnë procesin e votimit, përpara apo gjatë mbajtjes së mbledhjes së asamblesë së përgjithshme, pa qenë nevoja të caktohet një përfaqësues i autorizuar, për të marrë pjesë fizikisht në mbledhje ”*

⁸¹⁶ Ligji 9901/2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” i ndryshuar, neni 88/4.

Ky parashikim është plotësisht në përputhje me zhvillimet e shpejta në fushën e teknologjisë së informacionit dhe krijon mundësinë që në çdo kohë statutet të përshtaten duke parashikuar mundësinë e pjesëmarrjes në mbledhjen e asamblesë me anë të videokonferencave, aplikacioneve të shumëllojshme të internetit dhe mjeteve të tjera moderne, që ofron zhvillimi teknologjik.

Lidhur me dokumentimin e mbledhjeve të asamblesë, Ligji 9901/2008 ka parashikuar në nenin 90 të tij detyrimin e shoqërisë që të dokumentojë me anë të procesverbalit të gjitha vendimet e asamblesë. Procesverbali duhet të përmbajë kohën (datën) dhe vendin e mbledhjes, rendin e ditës, emrin e kryetarit dhe të personit që mban procesverbalin, si dhe rezultatet e votimit. Këtij procesverbali duhet t'i bashkëlidhet dhe lista e pjesëmarrësve në mbledhje dhe njoftimi për thirrjen e mbledhjes, Pas përfundimit të mbledhjes, procesverbali duhet të nënshkruhet nga kryetari dhe personi që e mban. Përgjegjësinë për ruajtjen e këtyre procesverbaleve e ka administratori i shoqërisë. Kur shoqëria ka një faqe në internet, administratorët, duhet të publikojnë kopje të procesverbalit të mbledhjes së AO në këtë faqe.⁸¹⁷

Në praktikën gjyqësore ka pasur edhe raste kur, me vendim gjyqësor, janë shpallur të pavlefshme vendimet e mbledhjes së Asamblese së Ortakëve, pikërisht për shkak se nuk është mbajtur në formë të rregullt procesverbali i mbledhjes. Me Vendimin Nr.10024 datë 21.12.2015 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, ka pranuar pretendimet e paditësit për pavlefshmëri të mbledhjes, për shkak se nuk është mbajtur një procesverbal i rregullt në mbledhjen e AO, duke vendosur konstatimin e pavlefshmërisë absolute të këtij vendimi.⁸¹⁸

6.5.3. Procedurat e thirrjes së Asamblesë së Ortakëve

Në nenin 83 të ligjit në fuqi 9901/2008 parashikohet një procedurë e detyrueshme për t'u respektuar, përsa i përket mënyrës së njoftimit dhe mbledhjes së Asamblesë së Ortakëve.⁸¹⁹ Sipas këtij neni, parashikohet që ortakët duhet të njoftohen me shkrim për mbledhjen e asamblesë ose, kur është parashikuar në statutin e shoqërisë, mund të aplikohet edhe njoftimi me postë elektronike. Por njoftimi duhet të mbërrijë te ortakët të paktën 7 (shtatë) ditë përpara datës së mbledhjes dhe duhet të përmbajë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës.⁸²⁰ Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë me Vendimin nr. 3949 dt. 02.05.2018 ka

⁸¹⁷ Ligji 9901/2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" i ndryshuar, neni 90.

⁸¹⁸ Shih Vendimin Nr.10024 date 21.12.2015 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë ka arsyetuar se:
"Nga gjykimi rezultoi se në Vendimin nr. 6, datë 29.06.2010 të Asamblesë së Ortakëve të Shoqërisë "V***" sh.p.k. pala e paditur nuk ka mbajtur një akt të rregullt ligjor pasi rezultoi (pa numër protokolli, pa datë, te hartuara pa prezencën e përkthyesit të paditësit që është shtetas grek.) pra akti është fiktiv".

⁸¹⁹ Ligji 9901/2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" i ndryshuar, neni 83

⁸²⁰ Ligji 9901/2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" i ndryshuar neni 83.

konsideruar të pavlefshme mbledhjen e asamblesë së shoqërisë ***** për shkak se nuk ishte njoftuar i plotë rendi i ditës së mbledhjes.⁸²¹

Në rast se nuk respektohet kjo procedurë e thirrjes së asamblesë, dhe për shkak të kësaj parregullsie, nuk janë të pranishëm në mbledhje të gjithë ortakët e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar, atëherë mbledhja e AO është e pavlefshme dhe për rrjedhojë, edhe vendimet e saj, të cilat do të konsiderohen të pavlefshme. Madje, edhe në rast se ortakët kanë arritur të jenë prezent në mbledhjen e AO, por provojnë që ka pasur parregullsi përse i përket afatit kohor prej 7 ditësh për t'u njohur me të gjitha pikat e rendit të ditës, në këto kushte, qoftë edhe njëri prej ortakëve mund të kërkojë që mbledhja të konsiderohet e pavlefshme dhe, për pasojë, nuk mund të marrë vendime të vlefshme.⁸²²

I vetmi rast që mund të injorohet parregullsitë e kryera në mënyrën e thirrjes së mbledhjes së AO, është rasti kur të gjithë ortakët kanë arritur të jenë të pranishëm në mbledhjen e asamblesë pavarësisht parregullsisë, dhe të gjithë ortakët kanë rënë dakort që këto parregullsi nuk do të jenë shkak për pavlefshmëri të mbledhjes së asamblesë.⁸²³ Në një situatë të tillë përjashtimore AO mund të marrë vendime të vlefshme, pavarësisht parregullsisë formale të mënyrës së thirrjes së saj. Për këtë arsye është e rekomandueshme që në çdo rast të mbledhjes së AO pika e parë e diskutimeve të jetë verifikimi i vlefshmërisë së mbledhjes, si dhe dhënia e pëlqimit nga ortakët (me kusht që të jenë të gjithë ortakët e shoqërisë të pranishëm, ose të përfaqësuar, në mbledhje) lidhur me vlefshmërinë e mbledhjes, më pas të vazhdohet me pikat e tjera, që janë planifikuar për diskutim në rendin e ditës, pasi vetëm me unanimitetin e të gjithë ortakëve mbledhja mund të legjitimohet edhe nëse ka ndonjë parregullsi formale të njoftimeve. Ndërsa, për çështjet e tjera të planifikuara për diskutim në rendin e ditës së mbledhjes, ligji nuk kërkon unanimitet.⁸²⁴

Parashikimet e nenit 83 të ligjit në fuqi janë një garanci për të gjithë ortakët e shoqërisë, që u siguron atyre ushtrimin e të gjitha të drejtave që u rrjedhin nga pjesëmarrja në kapitalin e shoqërisë, pra nga kuota në një SHPK, pavarësisht madhësisë së kuotës në raport me të tjerët.⁸²⁵ Për të ilustruar se sa i rëndësishëm është respektimi procedurës së mbledhjes së AO dhe formalitetet e thirrjes së saj, po sjellim Vendimin Nr. 3516 Akti, Dt. 23.05.2011 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, sipas të cilit gjykata ka pranuar pretendimet e paditëses si ortake në minorancë për pavlefshmëri të mbledhjes së AO të datës 30.06.2010,

⁸²¹ Shih Vendimin Nr. 3949 dt. 02.05.2018 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

⁸²² Ligji 9901/2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" i ndryshuar, neni 83.

⁸²³ Ligji 9901/2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" i ndryshuar, neni 83.

⁸²⁴ Ligji 9901/2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" i ndryshuar, neni 83.

⁸²⁵ Ligji 9901/2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" i ndryshuar, neni 83.

pikërisht për shkak të mosrespektimit të mënyrës së njoftimit efektiv të ortakëve, të parashikuara në nenin 83 të ligjit në fuqi.⁸²⁶

Po ashtu një analizë e ngjashme është bërë dhe në Vendimin Nr. 785 dt. 08.02.2016 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, ku është pranuar padia e njërit prej ortakëve për pavlefshmëri të mbledhjes së asamblesë, pikërisht për shkak të parregullsive të njoftimit.⁸²⁷

6.5.4. Kuorumi dhe votimi në mbledhjen e Asamblesë së Ortakëve

Sipas nenit 86 të ligjit në fuqi për shoqëritë tregtare, parashikohet se kuorumi është i ndryshëm për vendimet që kërkojnë një shumicë të zakonshme, nga ato që kërkojnë një shumicë të cilësuar (të kualifikuar sipas termit të përdorur në ligj).⁸²⁸

Paraprakisht duhet të kemi parasysh, se kur një vendimmarrje konsiderohet me shumicë të zakonshme dhe kur konsiderohet me shumicë të kualifikuar. Për efekt të këtij ligji duhet të konsiderojmë si shumicë të zakonshme për marrjen e një vendimi, kur në favor të miratimit të këtij vendimi kanë votuar ortakët që disponojnë më shumë se 50% të kapitalit, të cilët janë prezent ose të përfaqësuar në mbledhjen e AO.⁸²⁹ Këto vendime quhen vendime me shumicë të zakonshme dhe janë të gjitha ato vendime të parashikuara në nenin 81 të sipërcituar (kompetencat e AO), për të cilat ligji apo statuti nuk ka parashikuar një shumicë të kualifikuar.⁸³⁰

⁸²⁶ Shih *Vendimin Nr. 3516 Akti, Dt. 23.05.2011 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë*, sipas së cilit gjykata ka arsyetuar se:

*“Konform nenit 83 të ligjit nr.9901, njoftimi për të paditurën duhet të ishte bërë me shkresë. Kjo nuk nënkupton vetëm shkresën e datës 06.10.2010 të përpiluar nga administratorja, por mbi të gjitha ka të bëjë me mënyrën e dokumentimit të njoftimit, i cili duhet të jetë në formë të shkruar. Kjo gjë përmbushet me anën e dëftesave postare me lajmërim marrjeje, të cilat në rastin konkret mungojnë. Për rrjedhojë paditësja nuk ka marrë dijeni për mbledhjen e datës 18.10.2010. Pala e paditur nuk duhet të ishte njaftuar vetëm me dërgimin e njoftimit, por duhej që përpara se të realizonte vendimmarrjen e datës 18.10.2010, të konfirmonte nëse ortakja në minorancë kishte marrë apo jo dijeni. Kjo pasi, nga pasja apo jo dijeni, e ortakes (zotëruese e 49% të kuotave) E*** K***(***) , varej rregullshmëria e mbledhjes. Realizimi i mbledhjes së datës 18.10.2010, pa u konfirmuar dijenia e paditëses dhe pa bërë asnjë përpjekje për njoftimin e saj (pas konstatimit të mungesës së dijenisë), bën që përveç nenit 83 të ligjit 9901, të jenë cenuar edhe nenet 14 e 15 të këtij ligji si dhe të drejtat e paditëses që rrjedhin nga zotërimi i kuotës (neni 93). Në kushtet kur asambleja e përgjithshme nuk është thirrur në respektim të kushteve të pikës 1 të nenit 83, ajo mund të merrte vendime të vlefshme vetëm nëse të gjithë ortakët (përfshirë edhe E*** K***) do të ishin dakord, për të marrë vendime, pavarësisht parregullsisë. Një gjë e tillë nuk ka ndodhur, për shkak se duke mos pasur dijeni, paditësja nuk ka marrë pjesë fare në mbledhje (gjë që konfirmohet nga procesverbali i mbledhjes). Për pasojë, të gjitha vendimet e mbledhjes së asamblesë të datës 18.10.2010 janë të pavlefshme dhe nuk mund të sjellin asnjë pasojë juridike.”*

⁸²⁷ Shih *Vendimin Nr. 785, dhe nr 13043/2885 Regj dt. 08.02.2016 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë*.

⁸²⁸ Ligji 9901/2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” i ndryshuar, nenin 86.

⁸²⁹ Ligji 9901/2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” i ndryshuar, neni 86.

⁸³⁰ Ligji 9901/2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” i ndryshuar, neni 86.

Vendimet që kërkojnë një shumicë të kualifikuar (cilësuar) janë ato vendime për miratimin e të cilave duhet të kenë votuar “*pro*”, ortakët që disponojnë një shumicë më të lartë se 50% e kapitalit e përcaktuar në ligj apo në statut, si psh $\frac{3}{4}$ e votave apo $\frac{2}{3}$ e votave.⁸³¹ Për efekt të këtij ligji, në nenin 87 të tij janë përcaktuar si vendime që kërkojnë një shumicë të kualifikuar, vendimet që për miratimin e tyre kërkojnë mbështetjen e $\frac{3}{4}$ së votave të ortakëve që janë të pranishëm ose të përfaqësuar në mbledhjen e AO. Në nenin 87 të ligjit janë parashikuar disa nga vendimet që kërkojnë një shumicë të kualifikuar prej $\frac{3}{4}$ të votave të ortakëve pjesëmarrës në mbledhje.⁸³² Vendime të tilla që kërkojnë shumicë të kualifikuar janë: i) vendimet për ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar; ii) vendimet për shpërndarjen e fitimeve të realizuara nga shoqëria; dhe vendimet për riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.⁸³³

Edhe për këto lloj vendimesh ligji i ka dhënë liri statutit, që të parashikojë një shumicë akoma më të lartë për marrjen e vendimit, por në asnjë rast statuti nuk mund të parashikojë një shumicë më të ulët, përdryshe do të ishte e pavlefshme. Ndërkohë, në dispozita të tjera të ligjit mund të parashikohen dhe vendime të tjera, për të cilat kërkohet një shumicë e kualifikuar.

Gjithashtu, siç kemi shpjeguar më lart, ortakët mund të parashikojnë në statutin e shoqërisë vendosjen e një shumice të kualifikuar edhe për shumë çështje të tjera, tej atyre të parashikuara shprehimisht në ligj. Megjithatë, në këtë aspekt duhet bërë kujdes me ato çështje, për të cilat ligji ka vendosur kufizime të posaçme, siç është rasti i shkarkimit të administratorëve, për të cilët ligji ka sanksionuar që vendimi merret me shumicë të thjeshtë dhe nuk merret parasysh asnjë shumicë e kualifikuar e vendosur në statut. Pra, lista e vendimeve që kërkojnë një shumicë të kualifikuar, në çdo rast është shteruese dhe ortakët mund ta verifikojnë atë duke pasur parasysh dispozitat e ligjit si dhe të statutit të shoqërisë.

Kuorumi është një element tjetër i domosdoshëm i parashikuar nga ligji në nenin 86 të tij, për të konsideruar si të vlefshme një mbledhje të AO. Numri i votave është në përpjestim të drejtë më vlerën nominale të kuotës së secilit ortak, nëse nuk parashikohet ndryshe në statut⁸³⁴ Kështu që për verifikimin e kuorumit, për një mbledhje të Asamblesë, duhet të verifikohet numri apo përqindja e votave që janë prezent në mbledhje dhe jo e ortakëve,

⁸³¹ Ligji 9901/2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” i ndryshuar, neni 86.

⁸³² Ligji 9901/2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” i ndryshuar, neni 86.

⁸³³ Sipas nenit 87/1 të ligjit 9901/2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” i ndryshuar përcaktohet se:
“1. Me përjashtim të rasteve kur statuti parashikon një shumicë më të lartë, asambleja e përgjithshme vendos me tri të katërtat e votave të ortakëve pjesëmarrës, siç përcaktohet në pikën 1 të nenit 86 të këtij ligji, për ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë”.

⁸³⁴ Ligji 9901/2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” i ndryshuar, neni 88.

pasi në rast se statuti nuk ka parashikuar ndryshe, ortakët nuk është e thënë të kenë të njëjtin numër votash.⁸³⁵

Për vendimet që kërkojnë një shumicë të zakonshme, AO mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë në mbledhje ortakët me të drejtë vote që zotërojnë më shumë se 30 për qind të kuotave.⁸³⁶ Ndërsa, në rastin kur AO duhet të vendosë për çështje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar, sipas nenit 87 të këtij ligji, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse janë të pranishëm ose të përfaqësuar ortakët që zotërojnë më shumë se gjysmën e numrit total të votave.⁸³⁷

⁸³⁵ Argita Malltezi, *E drejta shqiptare e shoqërive tregtare* (Shtëpia botuese “Mediaprint” 2011) fq. 79.

⁸³⁶ Ligji 9901/2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” i ndryshuar, nenet 86-87.

⁸³⁷ Ligji 9901/2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” i ndryshuar, neni 86.

KREU VII

7. Të Drejtat e Ortakëve në një SHPK dhe Aspekte të Veçanta të Marrëdhënieve mes tyre sipas Ligjit në Fuqi

7.1. Hyrje

Të drejtat dhe detyrimet e ortakëve në një SHPK lindin që me përputhjen e vullnetit të tyre për të themeluar një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar dhe vazhdojnë deri në fazën përfundimtare të prishjes dhe çregjistrimit të saj nga Regjistri Tregtar i QKB. Ortakët, duke pasur zotësi të plotë për të vepruar, liri të planifikimit dhe strategjive të aktivitetit tregtar, në kuadër të ushtrimit të aktivitetit të një SHPK-je, kanë të drejta dhe detyrime të ndryshme, të cilat edhe pse nuk janë pasqyruar në një listë shteruese, janë të shpërndara në dispozita të ndryshme të ligjit dhe të analizuara në pjesë të ndryshme të këtij punimi. Megjithatë, në raport me vetë shoqërinë ortakët kanë disa të drejta dhe detyrime thelbësore, të cilat janë unike për çdo shoqëri tregtare .

7.2. E drejta e votës së ortakëve në asamble

Në nenin 88 të ligjit në fuqi parashikohet që e drejta e votës së çdo ortaku është në përpjesëtim me vlerën nominale të kuotës së tij, në rast se statuti nuk parashikon ndryshe.⁸³⁸ Pra, ligji ka përcaktuar si rregull parimin e shoqërive të kapitalit, sipas të cilave të drejtat e ortakëve në shoqëri janë në përpjesëtim të drejtë me kontributin e ortakëve në kapitalin e regjistruar të shoqërisë. Pra një ortak që ka kontribute më të mëdha në kapitalin e regjistruar të njohur dhe me shprehjen kapitali themeltar, ka marrë përsipër një risk më të madh, i cili në proporcion me këtë kontribut dhe risk, do të ketë dhe të drejtat që burojnë nga kuota e tij në shoqëri.

Megjithatë ligji iu ka lejuar ortakëve një autonomi statutore në këtë çështje, duke lejuar dhe mundësinë që ortakët në statut të bëjnë korrigjime të caktura të këtij parimi, si psh. duke u dhënë të gjithë ortakëve të drejta të barabarta në votim në AO, pavarësisht faktit që kontributet e tyre mund të mos jenë plotësisht të barabarta.

Në fakt kjo është një karakteristikë e shoqërive të personit, por gjithsesi mbetet vetëm një mundësi potenciale që ortakët mund ta aplikojnë në kuadër të lirisë statutore në një SHPK. Ky rast përjashtimor nuk rezulton të ketë gjetur përhapje në praktikë dhe në këto kushte, nuk është zhvilluar as jurisprudenca gjyqësore, që të interpretojë këtë të drejtë që ligji i ka

⁸³⁸ Ligji 9901/2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” i ndryshuar, neni 88.

dhënë statutit për të parashikuar të drejta të vote në mënyrë joproporcionale me kontributet e ortakëve.

Ligji nuk ka vendosur kufizime se deri në çfarë mase mund të aplikohet liria (autonomia) statutore, dhe për këtë arsye, mbetet i hapur diskutimi nëse do të ishte e vlefshme një klauzolë e statutit, e cila parashikon të drejta vote që janë në mënyrë të dukshme joproporcionale me kontributin e ortakëve. Për shembull: A mundet statuti t'i japë një ortakut a) që ka kontribut në masën 10% në kapitalin e shoqërisë një votë të barabartë me një ortak b) që ka kontribut në masën 90 %? Po nëse statuti shkon akoma më tej dhe përcakton se ortakut me kontribut 10 % ka një votë me vlerë më të madhe se ortakut që ka kontributin shumë më të madh, si psh. 90% të kapitalit?

Ligji nuk ka përcaktuar ndonjë kufizim në mënyrën e aplikimit të autonomisë statutore, por, gjithsesi, mendojmë që në këtë rast do të ishin të aplikueshme parimet e përgjithshme të kontratave të parashikuara në Kodin Civil. Kjo liri statutore do të kishte kuptim nëse do të synonte korrektive të arsyeshme në drejtim të barazimit të së drejtës së votës për të gjithë ortakët e shoqërisë. Por, nuk do të kishte kuptim të bëheshin parashikime krejtësisht shpërpjestimore, nga të cilat një apo disa ortakë do të dilnin dukshëm më të dëmtuar se një apo disa të tjerë. Ky konkluzion mbështetet në parimet e përgjithshme të interpretimit të kontratave të parashikuara në Kodin Civil dhe konkretisht, në nenin 686 paragrafi i dytë të K. Civil, i cili parashikon pavlefshmërinë e kushteve kontraktore, të cilat sjellin humbje të shpërpjestuar për njërin palë.⁸³⁹

Në këto kushte do të ishte me interes një rishikim i kësaj dispozite nga ana e legjislatorit, me qëllim që lirisë statutore t'i jepet një kuptim më i qartë përsa i përket të drejtës së votës së ortakëve në SHPK, si dhe kufijve deri ku mund të aplikohet ajo.

Kur një kuotë zotërohet nga më shumë se një person, atëherë ata ushtrojnë të drejtat e votës bashkërisht, sipas nenit 72 të këtij ligji⁸⁴⁰ dhe dispozitave të Kodit Civil për

⁸³⁹ Kodi Civil në nenin 686 paragrafi 2 përcakton se:

“Janë të pavlefshme kushtet e përgjithshme që sjellin një humbje ose dëmtim të shpërpjestuar të interesave të palës kontraktuese, posaçërisht kur ato ndryshojnë në mënyrë thelbësore nga parimet e barazisë e të paanësisë të shprehura në dispozitat e këtij Kodi që rregullojnë marrëdhëniet kontraktuale”.

⁸⁴⁰ Sipas paragrafit 2 dhe 3 të nenit 72 të ligjit 9901/2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” i ndryshuar përcaktohet se:

“2. Në rastin kur një kuotë e kapitalit të shoqërisë zotërohet nga më shumë se një person, në marrëdhënie me shoqërinë këta persona trajtohen si një ortak dhe të drejtat e tyre ushtrohen, nëpërmjet një përfaqësuesi të përbashkët. Këta persona përgjigjen personalisht dhe në mënyrë solidare për detyrimet që lindin nga zotërimi i kuotës.

3. Personat që zotërojnë një kuotë të kapitalit të shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar, merren vesh ndërmjet tyre për ndarjen e të drejtave e të detyrimeve, që rrjedhin nga kjo kuotë. Këto të drejta e detyrime mund të ndahen në mënyrë të barabartë ose jo.”

bashkëpronësinë. Në raport me shoqërinë, ata do të përfaqësohen nga një person i vetëm dhe në mbledhjen AO do të ushtrohet e drejta e votës nga ky përfaqësues në përpjestim me vlerën që ka kjo kuotë në raport me kuotat e tjera të shoqërisë.⁸⁴¹

Në ligjin Nr. 9901/2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” i ndryshuar, në variantin fillestar të ligjit, neni 88, ishte shkruar në një mënyrë jo të qartë dhe linte vend për keqinterpretime. Sipas pikës së parë të nenit 88, përpara ndryshimeve të bëra në vitin 2014, përcaktohej se; “*Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në statut, çdo kuotë jep të drejtën e një vote.*”⁸⁴² Në këtë mënyrë krijohet vend për keqkuptim, pasi nga interpretimi gramatikor i kësaj dispozite, në mungesë të një rregullimi në statut, ortakët mund të pretendonin të drejta vote të barabarta në mbledhjet e AO, pavarësisht faktit që kanë kontribute në vlera të ndryshme në shoqëri dhe disponojnë kuota me vlerë jo të barabartë me njëri-tjetrin.

Por, në respektim të të drejtave që të jep kuota në një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, pesha specifike e votës së një ortaku që ka një kontribut më të lartë në kapitalin e shoqërisë duhet të jetë proporcionalisht më e lartë sesa pesha specifike e ortakut që ka një kontribut më të vogël në kapitalin e shoqërisë.

Megjithatë, kjo paqartësi u korrigjua me ligjin nr. 129/2014 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9901/2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, të ndryshuar dhe duke përcaktuar qartësisht në nenin 88 të tij që e drejta e votës së çdo ortaku është në përpjesëtim me vlerën nominale të kuotës së tij në rast se statuti nuk parashikon ndryshe.⁸⁴³

7.3. Përjashtimi nga e drejta e votës

Në nenin 89 të ligjit në fuqi parashikohen rastet kur ortakët përjashtohen nga e drejta e votës në Asamble. Të gjitha rastet lidhen me shmangien e konfliktit të interesit. Sipas kësaj dispozite ortaku prezumohet se është në konflikt interesi në diskutimet dhe vendimmarrjet e Asamblesë, kur ky organ vlerëson veprimtarinë e këtij ortaku në shoqëri, kur vlerëson shuarjen e ndonjë detyrimi të këtij ortaku, apo ngritjen e padisë ndaj tij nga ana e shoqërisë, si dhe rastin kur diskutohet dhënia ose jo e përfitimeve të tjera këtij ortaku.⁸⁴⁴

⁸⁴¹ Ligji 9901/2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” i ndryshuar, neni 72 .

⁸⁴² Ligji 9901/2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” [2008] FZ 60, neni 88.

⁸⁴³ Në nenin 13 të Ligjit 129/2014 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9901, datë 14.4.2008, “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” [2014] FZ 163 përcaktohet se:

“Në nenin 88, pika 1 ndryshohet si më poshtë: “1. Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në statut, çdo ortak ka të drejta vote në përpjesëtim me vlerën nominale të kuotës së tij. Bashkëzotëruesit e një kuote ushtrojnë të drejtat e votës bashkërisht, sipas nenit 72 të këtij ligji”.

⁸⁴⁴ Sipas nenit 89 të ligjit 9901/2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” i ndryshuar përcaktohet se:

Siç konstatohet nga formulimi i nenit 89 të ligjit, janë parashikuar dhe rastet përjashtimore kur një ortak nuk mund të ushtrojë të drejtën e votës në Asamblenë e Ortakëve. Kur një ortak ndodhet në kushtet kur nuk mund të ushtrojë të drejtën e votës në asamble, atëherë vota e tij nuk duhet të llogaritet as në kuorumin e parashikuar nga neni 86 i ligjit, i cili është kusht për vlefshmërinë e mbledhjes. Pra, në një situatë e tillë, vlerësojmë se edhe kuorumi duhet të llogaritet pa e marrë në konsideratë votën që disponon ortakun, i cili është përjashtuar nga e drejta e votës, pavarësisht se sa e madhe është vlera e kuotës së këtij ortakut.

Ligji është orvatatur të rendisë në një listë shteruese rastet e përjashtimit të ortakut nga e drejta e votës, por, në të vërtetë, secila prej pikave të nenit 89/1 mund të përfshijë situata të ndryshme, të cilat vlerësohen si raste të përjashtimit të ortakut nga e drejta e votës.⁸⁴⁵ Një nga rastet që është me i diskutuari në praktikën gjyqësore, është kur Asambleja e Ortakëve diskuton mbi përjashtimin e ortakut nga shoqëria.

Diskutimi që ngrihet është; nëse do të konsiderohet dhe ky si një rast i përjashtimit nga e drejta e votës, pavarësisht se nuk është cituar shprehimisht nga neni 89/1 i ligjit. Nga konkluzioni i kësaj çështjeje merr një panoramë më të qartë edhe diskutimi i kuorunit, mbi të cilin do të llogaritet vlefshmëria e mbledhjes së AO në rastin e përjashtimit të ortakut. Në rast se do të konkludojmë që në vendimin për përjashtimin e ortakut nuk duhet të llogaritet vota ortakut që do të përjashtohet, atëherë Asambleja e ka më të lehtë të marrë një vendim të tillë, i cili gjithsesi nuk prodhon asnjë pasojë juridike për ortakun, pasi është Gjykata ajo që do të vlerësojë përfundimisht nëse ortakun do të përjashtohet apo jo.

Praktika Gjyqësore në shumicën e rasteve ka shmangur një analizë juridike lidhur me këtë çështje dhe u është referuar vetëm parashikimeve të nenit 86 dhe 87 të ligjit për vlefshmërinë e mbledhjes së asamblesë së ortakëve.⁸⁴⁶ Në vendimin, nr. 4413, datë 07.04.2014 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, rezulton se gjykata e ka llogaritur dhe votën e ortakut për të cilin është kërkuar përjashtimi në kuorumin për vlefshmërinë e mbledhjes, madje edhe në votim.⁸⁴⁷

Por, nëse do të aplikojmë një logjikë të tillë, atëherë do të bëhej shumë e vështirë që të respektohet procedura e parashikuar në nenin 102 të ligjit, në kërkesën për përjashtimin e

“1. Ortaku nuk mund të ushtrojë të drejtën e votës nëse asambleja e përgjithshme merr vendim për: a) vlerësimin e veprimtarisë së tij; b) shuarjen e ndonjë detyrimi në ngarkim të tij; c) ngritjen e një padie ndaj tij nga shoqëria; ç) dhënien ose jo të përfitimeve të reja.

2. Kur ortakun përfaqësohet nga një përfaqësues i autorizuar, i autorizuari vlerësohet të jetë në të njëjtin konflikt interesi, ashtu si dhe ortakun, të cilin përfaqëson.”

⁸⁴⁵ Ligji 9901/2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” i ndryshuar, neni 89/1.

⁸⁴⁶ Shih Vendimin nr. 4413, datë 07.04.2014 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

⁸⁴⁷ Po aty.

një ortak, i cili ka 50% të kapitalit të shoqërisë, ose një pjesëmarrje më të lartë, pasi ky ortak me mospjesëmarrje do të bllokonte, një vendimmarrje të tillë dhe si rrjedhim Asambleja e Ortakëve nuk do të mund të merrte një vendim që t'i drejtohej gjykatës me padinë për përjashtimin e ortakut. Gjithsesi, ortak, për të cilin do të kërkohet përjashtimi, do të duhet të njoftohet rregullisht për mbledhjen dhe rendin e ditës, si garanci e së drejtës së tij për informim.

Ndërsa në Vendimin Nr 1372 dt.12.10.2018 të Gjykatës së Apelit Tiranë rezulton se ortakja ***. me një kuotë prej 50% të kapitalit të shoqërisë *** ka mbledhur AO me pjesëmarrjen e vet dhe ndër të tjera, ka marrë vendimin për t'iu drejtuar gjykatës për përjashtimin e ortakut ***, i cili dispononte gjithashtu 50% të kapitalit të shoqërisë.⁸⁴⁸ Ky ortak nuk ka qenë prezent në mbledhjen e asamblesë. Gjykata e Apelit, pavarësisht se nuk ka bërë asnjë analizë të vlefshmërisë së kësaj mbledhjeje të AO, e ka legjitimuar këtë mbledhje. Me vendimin e saj kjo gjykatë ka pranuar padinë e ngritur nga AO, ku ishte pjesëmarrës vetëm ortakja ***, duke pranuar padinë dhe duke vendosur përjashtimin e ortakut ***, pasi ka arsyetuar se me veprimet e tij i ka shkaktuar dëm shoqërisë.

Megjithatë ka dhe raste, kur gjykatat kanë konsideruar edhe rastin e përjashtimit të ortakut si një praj rasteve të nenit 89 të ligjit. Në një konkluzion të tillë ka arritur Gjykata e Apelit Durrës në Vendimin nr.10-2011-1471(706), datë 01.12.2011, është shprehur se:

“Ligji nuk shprehet nëse ortak për të cilin do të merret vendim ka të drejtë të marrë pjesë vetë në votim apo jo. Asnjë nga shkaqet për përjashtimin e së drejtës së votës të renditura në nenin 89/1 të Ligjit për Shoqëritë Tregtare nuk i referohet këtij rasti në mënyrë direkte. Gjithsesi, të lejosh ortakun e interesuar të votojë kundër përjashtimit të tij qartësisht e bën më të vështirë për shoqërinë që të “heqë qafe” një ortak dhe nëse përjashtimi i tij do të jetë tërësisht i justifikuar nga sjellja e tij, dhe e bën praktikisht të pamundur të përjashtosh një ortak maxhoritar. Për shkaqe politikash, për rrjedhojë, mund të konsiderohet zgjerimi i nenit 89/1 të Ligjit për Shoqëritë Tregtare ku të përfshihet edhe situata kur Asambleja e Përgjithshme vendos lidhur me përjashtimin.....Vendimi i Asamblesë së Përgjithshme është vetëm një hap drejt përjashtimit.”⁸⁴⁹

Vlerësojmë se në rastin e diskutimit për ngritjen e padisë së përjashtimit të ortakut nga shoqëria kjo vendimmarrje e Asamblesë duhet të kategorizohet në rastet e parashikuara nga neni 89 i ligjit 9901/2008. Madje ky lloj vendimi përfshin dy nga pikat e nenit 89, që parashikon rastet në të cilat përjashtohet vota e ortakut në mbledhjen e Asamblesë, konkretisht pikën “a) vlerësimin e veprimtarisë së tij;”, si dhe pikën “c) ngritjen e një padie ndaj tij nga shoqëria”.⁸⁵⁰

⁸⁴⁸ Vendimi Nr 1372 dt.12.10.2018 i Gjykatës së Apelit Tiranë.

⁸⁴⁹ Vendimi nr.10-2011-1471(706), datë 01.12.2011, Gjykates së Apelit Durrës.

⁸⁵⁰ Ligji 9901/2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” i ndryshuar, neni 89.

Në referim të nenit 102 të ligjit 9901/2008, është e qartë, asambleja gjatë diskutimit nëse do t'i drejtohet gjykatës me një padi për përjashtimin e ortakut, domosdoshmërisht ndodhet në kushtet e pikës “a” të nenit 89. Në një vendimmarrje të tillë, asambleja merr vendim për vlerësimin e veprimtarisë së ortakut. Për pasojë, ortakut për të cilin AO po merr këtë vendim për vlerësimin e veprimtarisë së tij, duhet të përjashtohet nga e drejta e votës.

Gjithashtu një vendimmarrje e tillë nga Asambleja, kryhet pikërisht me qëllimin që ndaj ortakut të ngrihet një padi me objekt kërkimi “përjashtimin e ortakut nga shoqëria” dhe kjo padi do të shqyrtohet nga Gjykata. Pra është plotësisht e qartë, që kjo vendimmarrje përfshihet edhe në kushtet e pikës “c” të nenit 89, pasi ky vendim ka për objekt ngritjen e padisë për përjashtimin e ortakut nga shoqëria. Si konkluzion mund të themi se, edhe diskutimi dhe vendimi për t'iu drejtuar gjykatës për përjashtimin e ortakut, përfshihet në rastet e nenit 89 pika 1 e ligjit, i cili parashikon përjashtimin e ortakut nga e drejta e votës.

Për rrjedhojë, edhe kuorumi i nevojshëm për marrjen e një vendimi për të ndjekur procedurën e përjashtimit të ortakut nuk duhet të llogaritet duke pasur parasysh kuotën apo votat e ortakut për të cilin do të fillojë procedura e përjashtimit të tij nga shoqëria. Është e qartë, që ky ortak ka të drejtën e informimit dhe të mbrojtjes përse i përket pretendimeve të Asamblesë, por nuk ka të drejtën e votës në bazë të analizës së bërë më lart. Vendimi i AO nuk përjashton ortakun, por është një vendim i cili inicion procedurën gjyqësore për ngritjen e padisë me objekt përjashtimin e ortakut.

Në bazë të dispozitave të Kodit të Procedurës Civile, ortakut i thirret si i paditur ka gjithë të drejtën për t'u njohur me kërkimet dhe provat e paraqitura nga Asambleja e Ortakëve në proces, si dhe të drejtën për t'u mbrojtur me prapësime dhe prova nga ana e tij.⁸⁵¹ Procedura e përjashtimit të ortakut të SHPK-së, është një procedurë që vetëm sa vihet në lëvizje (inicohet) nga asambleja e ortakëve, por në thelb, vlerësimi nëse ekzistojnë shkaqet e përjashtimit apo jo, dhe vendimi për përjashtim, kryhet nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor që ka kompetencën territoriale.⁸⁵²

7.4. Pjesëmarrja në kapitalin e shoqërisë, kuota

Në shoqëritë me përgjegjësi të kufizuara çdo ortak ka të drejtën dhe përgjegjësinë (detyrimin) për të marrë pjesë në kapitalin e shoqërisë, duke ofruar kontributin e tij me vlera monetare ose me pasuri në natyrë, që kanë një vlerë ekonomike.⁸⁵³

⁸⁵¹ Neni 18 i Kodit të Procedurës Civile parashikon parimin e kontradiktoritetit sipas së cilit “Asnjë palë nuk mund të gjykohej pa u dëgjuar ose pa u thirrur në gjykim”.

⁸⁵² Ligji 9901/2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” i ndryshuar, neni 102-103.

⁸⁵³ Sipas nenit 68 pika 5 e ligjit Ligji 9901/2008 FZ 60 përcaktohet se: “Kontributi i ortakëve mund të jetë në para ose në natyrë (pasuri të luajtshme/të paluajtshme apo të drejta)”.

Për çdo ortak të shoqërisë është detyrim që të ofrojë një kontribut të caktuar në kapitalin fillestar të shoqërisë, si kusht ky për të fituar cilësinë e ortakut të SHPK-së. Masa e kontributit që ofron çdo ortak është në varësi të vullnetit të tij dhe të ortakëve të tjerë të shoqërisë sipas marrëveshjes së tyre për themelimin e shoqërisë. Në shoqëritë me përgjegjësi të kufizuara nuk lejohet që ortakët të kontribuojnë me shërbime. Kjo është një karakteristikë e shoqërive të kapitalit e analizuar më lart në këtë punim.

Ortakët e SHPK-së, duke kontribuar në kapitalin e nënshkruar (themeltar) të shoqërisë bëhen zotërues të të drejtave të cilat i përfaqëson *kuota* në këtë shoqëri. Përqindja që zë kontributi i ortakut në kapitalin e shoqërisë përcakton dhe të drejtat që ka ky ortak nga kuota e tij në shoqëri, të cilat janë në përpjestim me kuotën e tij.

Në paragrafin e dytë të nenit 10 të ligjit në fuqi, përcakohet dhe përgjegjësia për ortakët, të cilët nuk përmbushin detyrimin për të vënë në dispozicion të shoqërisë (procesi i shlyerjes) kontributet e tyre, për të cilat kanë nënshkruar në statutin e shoqërisë.⁸⁵⁴ Sipas kësaj dispozite ortakët që nuk përmbushin në mënyrë të rregullt këtë detyrim, apo tejkalojnë afatet e parashikuara në statut për shlyerjen e kontributit në para, do të mbajnë përgjegjësi personalisht dhe në mënyrë solidare për të gjitha dëmet që i shkaktohen SHPK-së.

Pra, ky është rasti kur ortakët e një SHPK-je detyrohen të mbajnë përgjegjësi për dëmet e shkaktuara shoqërisë. Në kushte të tilla, edhe kreditorët e shoqërisë legjitimohen sipas paragrafit 3 të nenit 10, që të kërkojnë prej ortakut, i cili që nuk ka shlyer kontributin e tij në shoqëri, që të mbahet përgjegjës për dëmet e shkaktuara shoqërisë sipas këtij neni.⁸⁵⁵

Rastet e mospërmbushjes së detyrimit të ortakut të një SHPK-je për të shlyer kontributet e tij në shoqëri i japin kuptim fjalës “kufizuar”, në konceptin e përgjegjësisë së kufizuar të ortakut në një SHPK. Kjo do të thotë se kufiri që kufizon i përgjegjësinë e ortakut në këto shoqëri, lidhet me kontributin e pashlyer të tij. Ose e thënë ndryshe, - ortaku ekspozohet ndaj detyrimit për shlyerjen e dëmëve të shoqërisë, në masën e kontributit të pashlyer prej tij.⁸⁵⁶

⁸⁵⁴ Sipas nenit 10 pika 2 e ligjit 9901/2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” i ndryshuar përcaktohet se:

“Themeluesit japin kontributet e tyre në shoqëri, në para ose në natyrë, sipas mënyrave e afateve të parashikuara në statut dhe kryejnë formalitetet e themelimit sipas kërkesave të këtij ligji dhe të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007”Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”. Themeluesit përgjigjen ndaj shoqërisë personalisht e në mënyrë solidare për dëmet e shkaktuara nga mospërmbushja e këtyre detyrimeve apo nga përmbushja e tyre përtej afateve përkatëse.”

⁸⁵⁵ Ligji 9901/2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” i ndryshuar, neni 10 paragrafi 3.

⁸⁵⁶ Ligji 9901/2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” i ndryshuar, neni 10 paragrafi 3.

7.5. Kuota

Në nenin 68 pika 2 e ligjit aktual 9901/2008, parashikohet që çdo ortak ka kuotën e tij në përpjesëtim me kontributin e tij në shoqëri.⁸⁵⁷ Ortakët, në varësi të vullnetit dhe mundësive ekonomike të tyre mund të kenë pjesëmarrje të ndryshme nga njëri-tjetri në kapitalin e shoqërisë. Kuota që secili ortak gëzon në një SHPK, do të jetë në përpjesëtim të drejtë me kontributin që ka dhënë secili në kapitalin e shoqërisë.

Për rrjedhojë edhe të drejtat dhe përfitimet e ortakëve, do të jenë në përpjestim të drejtë me këtë përqindje të kontributit në kapitalin e shoqërisë. Në këto lloj shoqëri, çdo ortak ka vetëm një kuotë, por nuk do të thotë që kjo kuotë është e barabartë apo ka të njëjtën vlerë për secilin ortak. Barazia e kuotave do të ekzistonte vetëm nëse ortakët kanë kontribute të barabarta në kapitalin e SHPK-së. Në rast se kontributet nuk janë të barabarta, atëherë edhe kuota e secilit ortak në SHPK do të ruajë të njëjtin proporcion me përqindjen e kontributit të ortakut në kapitalin e shoqërisë. Sipas paragrafit të dytë të nenit 76 të ligjit aktual, përcaktohet dhe mënyra e ndarjes së fitimit mes ortakëve ku thuhet se fitimi u ndahet ortakëve në raport me kuotat e zotëruara, nëse nuk parashikohet ndryshe në statut.⁸⁵⁸

Ky rregull ndiqet edhe për të drejtën e votës në SHPK, siç u analizua më sipër. Pra, edhe e drejta e vendimmarrjes në mbledhjet e Asamblesë së Ortakëve (AO), do të ushtrohet në përputhje me vlerën e kuotës që zotëron secili ortak, në përpjestim të drejtë me kontributin që ka dhënë në kapitalin fillestar gjatë themelimit të SHPK-së.⁸⁵⁹

Gëzimi i një kuote në një SHPK, është një e drejtë pasurore e njëjtë si e drejta e pronësisë mbi një send. Në doktrinën e së drejtës tregtare dhe civile pjesët e kapitalit, pra dhe kuotat e një SHPK-je konsiderohen sende të luajtshme të patrupëzuara.⁸⁶⁰

Kuota në një SHPK mund t'i nënshtrohet edhe pjestimit për shkaqe të ndryshme të parashikuara në ligj, të cilat janë të lidhura dhe me rastet e transferimit (kalimit) të kuotave të parashikuara në nenin 73 të ligjit 9901/2008.⁸⁶¹ Një nga arsyet e pjesëtimit të kuotës mund të ishte rasti i ndarjes së pasurisë bashkëshortore të një ortaku.⁸⁶² Sipas nenit 74 pika

⁸⁵⁷ Sipas nenit 68 pika 2 të ligjit 9901/2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" i ndryshuar: "*Secili ortak gëzon kuotën e tij në shoqëri, në përpjesëtim me kontributin që ka dhënë në kapital. Kapitali i regjistruar i shoqërisë ndahet ndërmjet ortakëve në kuota, sipas këtij raporti.*"

⁸⁵⁸ Neni 76/2 i Ligjit 9901/2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" i ndryshuar përcakton se "2. Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në statut, fitimi u shpërndahet ortakëve në raport me kuotat e zotëruara."

⁸⁵⁹ Ligji 9901/2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" i ndryshuar, neni 88.

⁸⁶⁰ Argita Malltezi, Jonida Rystemaj dhe Armela Kromiçi, *Gjykatat Shqiptare mbi shoqëritë dhe veprimtarinë Tregtare* (n 364) fq. 46.

⁸⁶¹ Kodi i Familjes, neni 98.

⁸⁶² Fatri Islamaj, "*Regjimet pasurore martesore sipas Kodit të Familjes*" (Punim shkencor, Shkolla e Magjistraturës 2005) fq. 33-38.

“ç” e Kodit të Familjes, në bashkësi (pasuria e përbashkët e të dy bashkëshortëve) bën pjesë edhe “veprimtaria tregtare e krijuar gjatë martesës”.⁸⁶³ Si rrjedhim, në rast të pjesëtimit të pasurisë bashkëshortore, kuota e njërit ortak në një SHPK, e cila përfaqëson pikërisht veprimtarinë tregtare të tij në shoqëri, do t’i nënshtrohet pjesëtimit, njësoj si edhe sendet e tjera që janë pjesë e bashkësisë ligjore.⁸⁶⁴

Megjithatë, gjatë procedurës së pjesëtimit bashkëshortët me marrëveshje mes tyre mund të të aplikojnë edhe kompensime të ndryshme të parashikuara në Kodin e Familjes⁸⁶⁵ dhe t’i japin mundësi bashkëshortit që është ortak në një SHPK që të mbajë kuotën e tij të papjesëtuar kundrejt detyrimit për të kompensuar plotësisht pjesën ideale të bashkëshortit tjetër. Ky aplikim do të ishte dhe në favor të ortakëve të tjerë të shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar, por, gjithsesi, është një procedurë që mund të bëhet me marrëveshje të përbashkët të ish-bashkëshortëve, pasi në mungesë të marrëveshjes, kuota në një SHPK është një send që i nënshtrohet pjesëtimit.

Edhe në praktikën gjyqësore shqiptare, është konsoliduar qëndrimi që kuota apo pjesa e kapitalit në shoqërinë me përgjegjësi të kufizuar duhet të futet në kategorinë e sendeve sipas përkufizimit të bërë në nenin 141 të K.Civil.⁸⁶⁶ Për shembull, Gjykata e Lartë e R. Sh. në Vendimin e saj Nr. 11112-02188-00-2011 Regj Themeltar Nr. 00-2012-2043 i Vendimit (340) dt. 26.06.2012 të Kolegjit Civil të saj⁸⁶⁷ në çështjen juridike të ngritur, nëse mund t’i nënshtrohen pjesëtimit gjyqësor pjesët e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar apo jo, ka arritur në përfundimin se kontributi i ortakëve në shoqërinë tregtare futet në kategorinë e sendeve dhe si rrjedhim, edhe pjesët në kapitalin themeltar të shoqërisë mund t’i nënshtrohen pjesëtimit mes bashkëpronarëve.

Në të njëjtin qëndim, kishin arritur dhe dy gjykatat e tjera me vendimet përkatëse për të cilat është ushtruar rekursi; Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë me vendimin 15025/4897 dt. 04.04.2011 dhe Gjykata e Apelit me vendimin e dt. 12.07.2011.⁸⁶⁸ Gjithashtu, kjo çështje është gjykuar edhe nga Gjykata Kushtetuese me Vendimin nr. 22 datë 08.02.2013 është shprehur se:

⁸⁶³ Kodi i Familjes, neni 74.

⁸⁶⁴ Po aty, neni 74.

⁸⁶⁵ Kodi i Familjes, nenet 79; 101-102.

⁸⁶⁶ Sipas nenit 141 të Kodit Civil përcaktohet se: “Send është çdo gjë që mund të përbëjë objekt pronësie ose i të drejtës tjetër reale”.

⁸⁶⁷ Argita Malltezi, Jonida Rystemaj dhe Armela Kromiçi, *Gjykatat Shqiptare mbi shoqëritë dhe veprimtarinë Tregtare* (n 364) fq. 29.

⁸⁶⁸ Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë me vendimin 15025/4897 dt. 04.04.2011 dhe Gjykata e Apelit me vendimin e dt. 12.07.2011

*“Lejimi i pjesëtimit të një pasurie, që përfshin si sende të paluajtshme ashtu dhe të luajtshme (tituj pronësie-kuotat e shoqërisë), nuk presupozon se personi juridik në vetvete do të prishet dhe nuk do të ekzistojë më”.*⁸⁶⁹

Gjykata Kushtetuese në këtë vendim të saj i konsideron kuotat e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar si tituj pronësie mbi sende të luajtshme.⁸⁷⁰

Po ashtu, në doktrinën vendase të së drejtës tregtare është arritur në përfundimin se kuota e SHPK-së, duhet të trajtohet si një titull pronësie mbi pjesën e kapitalit të ortakut, në mënyrë të ngjashme me aksionin në këtë aspekt, pavarësisht se nuk janë letra me vlerë.⁸⁷¹ Ndërkohë që edhe në doktrinën e së drejtës civile është mbajtur qëndrimi që edhe letrat me vlerë janë sende të një natyre të veçantë.⁸⁷²

Gjithashtu, edhe legjislacioni penal, i konsideron kuotat e një SHPK-je si send apo pasuri⁸⁷³ mbi të cilat mund të vendoset sekuestrimi për efekt të hetimit penal.⁸⁷⁴

Kësisoj, ortaku që disponon një kuotë të një SHPK-je, gëzon dhe të drejtat e pronarit mbi këtë kuotë (pjesë e kapitalit të shoqërisë), në kuptimin e të gjitha tagrave të pronësisë, përfshirë dhe disponimin saj, pra nëpërmjet transferimit të pronësisë të një person tjetër. Gjithashtu, edhe të drejtat që të jep kuota në shoqëri, (që janë të drejtat e votës në asamble,

⁸⁶⁹ Gjykata Kushtetuese me Vendimin nr. 22 datë 08.02.2013.

⁸⁷⁰ Vendim nr. 22 datë 08.02.2013 i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, sipas të cilit:

“11. Në lidhje me pretendimin se gjykimi i pjesëtimit ka cenuar lirinë e ushtrimit të veprimtarisë ekonomike, duke ndërhyrë në ndarjen e kuotave që tashmë ishin të ndara, Kolegji vlerëson se është kontradiktor dhe i pabazuar. Nga njëra anë pranohet nga vetë kërkuuesi dhe pohohet se kuotat kanë qenë të ndara, nga ana tjetër, kundërshtohet ndarja e kuotave për efekt të pjesëtimit gjyqësor. Lejimi i pjesëtimit të një pasurie, që përfshin si sende të paluajtshme ashtu dhe të luajtshme (tituj pronësie-kuotat e shoqërisë), nuk presupozon se personi juridik në vetvete do të prishet dhe nuk do të ekzistojë më. Në rastin konkret kemi dy shoqëri me përgjegjësi të kufizuara, të cilat janë në pronësi të barabartë të të dy palëve ndërgjyqëse dhe është propozuar, nga njëra palë, që secili prej tyre të mbajë njërin shoqëri. Pjesëtimi gjyqësor nuk presupozon prishje të shoqërive, si persona juridikë, pasi këta të fundit do të kenë po ato të drejta dhe detyrime siç kanë pasur më parë, me ndryshimin se do të jenë me një ortak të vetëm. Pra, nuk ka cenim të ushtrimit të veprimtarisë ekonomike.”

⁸⁷¹ Argita Malltezi, Jonida Rystemaj dhe Armela Kromiçi, *Gjykatat Shqiptare mbi shoqëritë dhe veprimtarinë Tregtare* (n 364) fq. 46.

⁸⁷² Studiuesi i së drejtës civile Andrea Nathanili ka mbajtur një qëndrim të tillë. Cituar nga Argita Malltezi, Jonida Rystemaj dhe Armela Kromiçi, *Gjykatat Shqiptare mbi shoqëritë dhe veprimtarinë Tregtare* (n 364) fq. 18.

⁸⁷³ Altin Shegani, Fatri Islamaj dhe Ylli Pjetërnikaj, “Regjimet martesore postmartesore dhe impakti ndaj tyre prej përgjegjësisë penale të subjekteve tregtare” në Argita Malltezi, Jonida Rystemaj dhe Armela Kromiçi (editor) *Të drejtat e grave mbi shoqëritë tregtare që janë pjesë e bashkësisë ligjore* (Albas 2018) fq. 177.

⁸⁷⁴ Ligji 10192/2009 “Për Parandalimin Dhe Goditjen e Krimit Të Organizuar, Trafikimit, Korrupsionit dhe Krimeve të Tjera Nëpërmjet Masave Parandaluese Kundër Pasurisë” ndryshuar për herë të fundit me ligjin 85/2020 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.10192, datë 3.12.2009, “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit, korrupsionit dhe krimeve të tjera nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë” [2020] FZ 138, neni 14.

të dividendit si pjesëmarrje në fitimin e shoqërisë, apo disponimin kësaj kuote) janë të drejta ekskluzive të atij ortakut që gëzon kuotën në SHPK, njësoj si tagrat e pronësisë së pronarit mbi sendin që ka në pronësi.

Edhe Protokolli Nr. 1 i Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, dhe jurisprudenca e Gjykatës së Strasburgut, i jep kuotës së shoqërisë tregtare kuptimin e sendit mbi të cilin mund të ushtrohen të drejtat e pronësisë.⁸⁷⁵

Sipas nenit 72 të ligjit, parashikohet dhe mundësia që një kuotë të zotërohet nga një ose më shumë persona.⁸⁷⁶ Pra edhe në këtë dispozitë është trajtuar kuota si një send mbi të cilin mund të ushtrohen tagrat e pronësisë dhe të bashkëpronësisë.

Sipas nenit 80 të ligjit 9901/2008, parashikohet dhe mundësia e anulimit të kuotës nga shoqëria, por vetëm në rast se është parashikuar në statut⁸⁷⁷. Kjo dispozitë dhe në mënyrë të veçantë pika e parë e saj, duhet të ketë një zbatim të kujdesshëm, në përputhje me parimet e këtij ligji dhe parimet e përgjithshme të mbrojtjes së të drejtës së pronësisë, pasi statuti nuk mund të ketë liri të pakufizuar për të anuluar kuota, për të cilat janë paguar kontributet nga ortakët. Këto kuota përbëjnë objekt të së drejtës së pronësisë së ortakut dhe si çdo send tjetër, u nënshtrohen garancive të së drejtës së pronësisë.

E drejta e shoqërisë për të anuluar një kuotë mund të aplikohet vetëm në raste përjashtimore, të cilat lidhen me pasoja të situatave të posaçme të parashikuara

⁸⁷⁵ Shih Judgment of ECHR (1982), *Lars Bramelid and Anne Malmström against Sweden*, Application Nos. 8588/79 and 8589/79 dhe çështjen Judgment of 12 January 2012, ECHR, *Pekárny A Cukrárny Klatovy, A.S. V. The Czech Republic*, Applications nos. 12266/07, 40059/07, 36038/09 and 47155/09.

⁸⁷⁶ Shih nenin 72 të ligjit 9901/2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" i ndryshuar, përcakton se:

"2. Në rastin se një kuotë e kapitalit të shoqërisë zotërohet nga më shumë se një person, në marrëdhënie me shoqërinë këta persona trajtohen si një ortak dhe të drejtat e tyre ushtrohen, nëpërmjet një përfaqësuesi të përbashkët. Këta persona përgjigjen personalisht dhe në mënyrë solidare për detyrimet që lindin nga zotërimi i kuotës.

3. Personat që zotërojnë një kuotë të kapitalit të shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar, merren vesh ndërmjet tyre për ndarjen e të drejtave e të detyrimeve, që rrjedhin nga kjo kuotë. Këto të drejta e detyrime mund të ndahen në mënyrë të barabartë ose jo.

4. Veprimet e shoqërisë ndaj kuotës së zotëruar nga më shumë se një person krijojnë pasoja ndaj të gjithë zotëruesve të saj edhe nëse veprimi i shoqërisë i drejtohet vetëm njërit prej zotëruesve.

5. Shoqëria tregtare mund të lëshojë një certifikatë për të vërtetuar zotërimin e kuotës së kapitalit. Kjo certifikatë lëshohet në emër të personit apo të personave, që zotërojnë kuotën dhe nuk përbën letër me vlerë.

6. Nëse personat që zotërojnë një kuotë nuk arrijnë një marrëveshje, sipas pikës 3 të këtij neni, atëherë zbatohen dispozitat e Kodit Civil për bashkëpronësinë."

⁸⁷⁷ Neni 80 i ligjit 9901/2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" i ndryshuar, përcakton se:

"1. Statuti mund të parashikojë të drejtën e shoqërisë për të anuluar një kuotë. Në këto raste statuti duhet të parashikojë shkaqet e procedurat për anulimin e likuidimin e kuotës.

2. Kuota mund të anulohet në çdo rast me miratimin e ortakut përkatës, me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe nga statuti.

3. Të drejtat e detyrimit, që i rrjedhin ortakut nga zotërimi i kuotës, shuhen me anulimin e saj"

shprehimisht në ligj. Situata të tilla, kur shoqëria mund të vendos për anulimin e një kuote, janë rastet kur me vendim të gjykatës kompetente është vendosur largimi apo përjashtimi i ortakut sipas neneve 101 dhe 102 të ligjit 9901/2008, apo rastet kur ortakut nuk ka shlyer kontributet e nënshkruara. Statuti nuk mund të parashikojë raste të tjera, tej atyre të parashikuara në ligj, për anulimin e kuotave dhe heqjen kështu të së drejtës së pronësisë së ortakut mbi një kuotë (pjesë të kapitalit të shoqërisë).

7.6. Transferimi i kapitalit, e drejta e parablerjes

Në nenin 73 të ligjit aktual parashikohet e drejta e ortakëve që t'i transferojnë lirisht pjesët e tyre të kapitalit edhe te të tretët, pra personat që nuk janë ortakë.⁸⁷⁸ Në këtë mënyrë, mbi kuotën mund të ushtrohen tagrat e pronësisë njësoj si mbi një send tjetër. Një ortak mund të transferojë të gjithë kuotën e tij ose vetëm një pjesë të kuotës së tij te një apo më shumë persona të tjerë. Në rastin e transferimit të të gjithë kuotës së vet te një apo disa persona të tjerë, ortakut e humb këtë cilësi si ortak, duke u larguar nga kjo shoqëri.

Në rast se ortakut transferon vetëm një pjesë të kuotës së tij te një person i tretë, atëherë ortakut ruan një kuotë me vlerë më të vogël në shoqëri dhe personi që ka blerë pjesën tjetër të kuotës së ortakut shitës, bëhet ortak i ri në shoqëri, duke marrë një kuotë që provon pjesëmarrjen në kapitalin e kësaj shoqërie. Në çdo rast të transferimit të kuotës nga një ortak te personat të tjerë jashtë shoqërisë, nuk cenohen të drejtat e ortakëve të tjerë në shoqëri, pasi ata ruajnë të njëjtat kuota me të njëjtat të drejta ndaj shoqërisë.

Në ndryshim nga ligji aktual në ligjin për shoqëritë tregtare të vitit 1992 parashikohet si kusht vlefshmërie, që transferimi i pjesëve të kapitalit në një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar duhet të bëhet me akt notarial.⁸⁷⁹ Si rrjedhim, në çdo rast të transferimit të kapitalit nga një ortak te një ortak tjetër, ky veprim duhet të shoqërohet dhe me burrokracitë e paraqitjes para noterit dhe kishte kostot e veta financiare. Në nenin 73 paragrafi i dytë i

⁸⁷⁸ Sipas nenit 73/1 të ligjit 9901/2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” i ndryshuar:

“1. Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;
b) shitblerjes;
c) trashëgimisë;
ç) dhurimit;
d) çdo mënyrë tjetër të parashikuar me ligj.”

⁸⁷⁹ Shih nenin 45 të Ligji 7638/1992 “Për shoqëritë tregtare” [1992] FZ 8 (shfuqizuar), sipas të cilit:

“Pjesët e kapitalit themeltar nuk mund të përfaqësohen nga letra me vlerë të tregtueshme. Transferimet e pjesëve të kapitalit themeltar duhet të vërtetohen me një akt notarial. Shoqëria ose të tretët duhet të respektojnë këto transferime sapo t'i bëhen të ditura asaj”

ligjit aktual 9901/2008, janë bërë disa ndryshime ne vitin 2014 me ligjin, Nr.129/2014,⁸⁸⁰, me anë të së cilave u liberalizua në maksimum procedura e kalimit të kuotave, pra e transferimit të pronësisë së kuotës (pjesës së kapitalit) në një SHPK. Me ndryshimet e vitit 2014 paragrafi i dytë i nenit 73, u riformulua duke shprehur qartësisht faktin se vlefshmëria e kontratave për transferimin e kuotave në shoqëri, nuk kushtëzohet as me aspektin e solemnitetit të kontratës, as me ndonjë procedurë dhe formalitet për regjistrimin e kontratës në QKB.⁸⁸¹

Sipas ligjit aktual, mjafton të shprehet vullneti në formë shkresore mes ortakut ekzistues dhe personit që do të fitojë pronësinë e kuotës, që kontrata të konsiderohet e vlefshme dhe të prodhojë pasoja juridike.⁸⁸² Pra nuk kërkohet ndonjë formë solemne për kontratat që kanë për objekt transferimin e pronësisë së kuotave të një SHPK-je. Si rrjedhim, që nga viti 2014 e në vijim, nuk është kusht për vlefshmërinë e këtyre kontratave paraqitja te noteri publik dhe as nuk kërkohet si kusht regjistrimi i kontratës në QKB, apo ndonjë formalitet tjetër me efekt deklarativ. Edhe në paragrafin e dytë të nenit 74 të ligjit, përcaktohet se, regjistrimi në QKB i kontratës për transferimin e kuotave ka efekt deklarativ, që do të thotë se nuk është kusht vlefshmërie për veprimin juridik.⁸⁸³

Mund të themi se në vendin tonë është krijuar infrastruktura e plotë ligjore për të respektuar lirinë e transferimit të kuotave të një SHPK-je, madje duke respektuar dhe privatësinë e plotë të kontratave për shit-blerje, dhurim, apo transferim, në çdo formë të kuotave të shoqërive me përgjegjësi të kufizuara, nga një ortak i shoqërisë të një person tjetër (fizik apo juridik). Kjo kontratë konsiderohet e vlefshme dhe prodhon pasoja juridike, megjithëse nuk është regjistruar në QKB, dhe nuk është bërë publike.

Këto ndryshime ligjore, përsa u përket kushteve të transferimit të kuotave të SHPK-ve, janë pasqyruar në mënyrë të njëjtë edhe për transferimin e aksioneve të shoqëritë aksionare,⁸⁸⁴ dhe reflektojnë një liri dhe thjeshtësi në veprimet juridike për transferimin e kapitalit në një shoqëri.

⁸⁸⁰ Ligji 129/2014 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9901, datë 14.4.2008, “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” [2014] FZ 163.

⁸⁸¹ Shih 73/2 të ligjit 9901/2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” i ndryshuar përcakton se:

“..Në rastet e kalimit të kuotave me kontratë, kushtet dhe momenti i kalimit të titullit të pronësisë mbi kuotën, si dhe kushtet e tjera të kalimit, përfshirë momentin e pagesës së çmimit, rregullohen nga kontrata. Kontrata për kalimin e kuotës hartohet në formë shkresore dhe noterizimi nuk përbën kusht për vlefshmërinë apo regjistrimin e kontratës. Me përjashtim të rasteve kur parashikohet shprehimisht ndryshe nga ligji, apo kur palët bien dakord në kontratë, vlefshmëria e kalimit të titullit të pronësisë mbi kuotat nuk do të kushtëzohet nga kryerja e formaliteteve të ndryshme me efekt deklarativ, përfshi këtu formalitetet e regjistrimit ose të publikimit të kontratës apo të kalimit të titullit”.

⁸⁸² Ligji 9901/2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” i ndryshuar, neni 73/2.

⁸⁸³ Ligji 9901/2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” i ndryshuar, neni 74/2.

⁸⁸⁴ Sipas nenit 117 paragrafi 3 të ligjit 9901/2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” i ndryshuar përcaktohet se:

Por nga ana tjetër mund të kufizojnë transparencën në veprimtarinë e këtyre shoqërive për një farë kohë të kufizuar. Kjo për shkak se me këtë kuadër ligjor, ekziston mundësia që të dhënat rreth ortakëve (dhe aksionerëve) si dhe pjesës së kapitalit që disponon secili prej tyre, të publikuara në QKB në një moment të caktuar, mund të mos pasqyrojnë emrat e vërtetë të ortakëve/aksionerëve, pasi potencialisht ekziston mundësia që të ketë pasur veprime juridike për transferimin e kapitalit te persona të tjerë dhe të mos jenë pasqyruar akoma në Regjistrin Tregtar të QKB-së. Ndërkohë që këto veprime juridike për transferimin e kapitalit, sipas ligjit në fuqi janë plotësisht të vlefshme dhe prodhojnë pasojat juridike, por ky fakt mbetet i paekspozuar dhe mund të mbahet si informacion i rezervuar vetëm për ortakun që ka transferuar kapitalin dhe personin që ka fituar kuotën (apo aksionet), duke u bërë ortak i ri në shoqëri, deri në një moment kur ky person e konsideron të përshtatshme të ekspozojë këtë informacion për të tjerët.

Ndryshe nga sa parashikohet në Kodin Tregtar të vitit 1932 (Neni 145 paragraf 5) dhe në ligjin e mëparshëm Nr.7638 të vitit 1992 “Për shoqëritë tregtare” (Neni 47 i ligjit), ligji aktual nuk ka përfshirë si të detyrueshëm respektimin e të drejtës së parablerjes. E drejta e parablerjes sipas pikës 3 të nenit 73, duhet të respektohet vetëm nëse është parashikuar në statutin e shoqërisë. Pra, në rast se në statutin e një SHPK-je nuk është parashikuar e drejta e parablerjes, atëherë ortakët mund të disponojnë lirisht pjesën e tyre të kapitalit në një SHPK, duke ua transferuar edhe personave të tretë jashtë shoqërisë. Pra, siç konstatohet, ligji aktual për tregtarët dhe shoqëritë tregtare, duke implementuar prezumimin e lirisë së plotë të transferimit të kapitalit edhe në shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar, ka përforcuar një karakteristikë tipike të shoqërive të kapitalit. Megjithatë, ligji në fuqi, në nenin 73 pika 3, ka lënë hapsirën që ortakët themelues të përfshijnë parimin e së drejtës së parablerjes në statutin e shoqërisë.

7.7. E drejta e pjesëmarrjes në fitimet e shoqërisë (dividenti)

Një nga të drejtat themelore të ortakëve në SHPK është e drejta për të marrë pjesë në fitimet e shoqërisë. Ky është dhe qëllimi primar i vetë ekzistencës dhe themelimit të një SHPK-je

“Në rastet e kalimit të aksioneve me kontratë, kushtet dhe momenti i kalimit të titullit të pronësisë mbi aksionin, si dhe kushtet e tjera të kalimit, përfshi momentin e pagesës së çnimit, rregullohen nga kontrata. Kontrata për kalimin e aksionit hartohet në formë shkresore dhe noterizimi nuk përbën kusht për vlefshmërinë apo regjistrimin e kontratës. Transaksionet në formë elektronike, sipas parashikimeve të ligjit nr. 9879, datë 21.2.2008, "Për titujt", konsiderohen të kryera në formë shkresore në përputhje me parashikimet e këtij neni. Me përjashtim të rasteve kur parashikohet shprehimisht ndryshe nga ligji apo kur palët bien dakord në kontratë, vlefshmëria e kalimit të titullit të pronësisë mbi aksionet nuk do të kushtëzohet nga kryerja e formaliteteve të ndryshme me efekt deklarativ, përfshi këtu formalitetet e regjistrimit a publikimit të kontratës apo të kalimit të titullit.”

nga ortakët e saj. Masa e fitimit vjetor, rezulton nga rritja e të ardhurave të pasqyruara në bilancin e shoqërisë, pasi janë zbritur shpenzimet për një interval periodik njëvjeçar.⁸⁸⁵

Sipas nenit 76 të ligjit 9901/2008 parashikohet se fitimi u shpërndahet ortakëve në raport me kuotat e zotëruara, në rast se nuk ka ndonjë parashikim tjetër në statut.⁸⁸⁶ Pra rregulli i përgjithshëm është ai i respektimit të parimit të proporcionalitetit, sipas së cilit ortaku merr pjesë në fitimet e shoqërisë në përpjesëtim të drejtë me përqindjen e kontributit në kapitalin e kësaj shoqërie dhe peshës specifike të kuotës së tij në shoqëri, njësoj si në rastin e të drejtës së votës. Megjithatë, ligji u ka lejuar ortakëve mundësinë, që nëpërmjet statutit të bëjnë dhe korrigjime të caktuara nga ky parim dhe këto shmangie të përcaktohen në statutin e shoqërisë. Ky lloj përjashtimi është karakteristikë e shoqërive të personit dhe në praktikën e shoqërive trgtare në vendin tonë nuk rezulton të jetë evidentuar si një fenomen i aplikuar.

Por, në të ardhmen, ky parashikim mund të përbëjë një burim për konflikte të ndryshme në funksionimin e SHPK-ve. Ligji nuk ka vendosur kufizime se deri në çfarë mase mund të aplikohet autonomia statutore dhe për këtë arsye, mbetet i hapur diskutimi, nëse do të ishte e vlefshme një klauzolë e statutit, e cila parashikon një mënyrë të ndarjes së fitimit që është dukshëm joproportionale me kontributin e ortakëve. Kjo liri statutore do të kishte kuptim nëse do të synonte motivimin pozitiv të ortakëve dhe deri diku, barazinë në shpërndarjen e fitimit për të gjithë ortakët e shoqërisë. Por nuk do të ishte e arsyeshme, që të parashikojë mënyra krejtësisht shpërpjesëtimore të ndarjes së fitimit, në disproporcion të madh me kontributet në shoqëri. Ky konkluzion mbështetet në parimet e përgjithshme të interpretimit të kontratave, të parashikuara në Kodin Civil, siç është neni 686 paragrafi i dytë të K. Civil, i cili parashikon pavlefshmërinë e kushteve kontraktore, të cilat sjellin humbje të shpërpjesëtuar për njërën palë.⁸⁸⁷

Për një kuptim më të qartë të autonomisë statutore në rastin e pjesëmarrjes në fitimet e shoqërisë, do të ishte me interes një rishikim nga ana e legjislatorit i formulimit të nenit 76 të ligjit 9901/2008, me qëllim që të përcaktohet dhe kufizimi që mund të ketë shmangia nga parimi i proporcionalitetit me kontributet e ortakut, që përbën rregullin e përgjithshëm. Shpërndarja e fitimit vendoset nga asambleja e përgjithshme me vendim, i cili kërkon shumicë të kualifikuar (sipas nenit 87).⁸⁸⁸ Ndryshe nga shoqëritë aksionare,⁸⁸⁹ në rastin e SHPK-ve ligji nuk parashikon detyrimisht mbajtjen e një pjese të fitimit vjetor si rezervë për shoqërinë. Por, statuti i shoqërisë mund të parashikojë që një pjesë e fitimit të mbahet si rezervë me qëllim rritjen e kapacitetit financiar të shoqërisë dhe konsolidimit të

⁸⁸⁵ Julie Cassidy, *Concise Corporations Law* (5th edition, The Federation Press 2006) fq. 139.

⁸⁸⁶ Ligji 9901/2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” i ndryshuar, neni 76/2.

⁸⁸⁷ Kodi Civil, neni 686 pika 2.

⁸⁸⁸ Ligji 9901/2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” i ndryshuar, neni 87.

⁸⁸⁹ Ligji 9901/2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” i ndryshuar, neni 127.

veprimtarisë tregtare, veprim i cili është në interes të shoqërisë, por edhe të ortakëve të saj.⁸⁹⁰

Në kushtet kur ligji ka parashikuar se vendimi për shpërndarjen e fitimit duhet të merret me shumicë të cilësuar, njësoj si vendimet për ndryshimin e statutit të shoqërisë, sipas mendimit tonë është plotësisht e mundur që asambleja e përgjithshme të vendosë kufizimin e shpërndarjes së dividendit edhe nëse statuti nuk e ka parashikuar. Pra, asambleja e përgjithshme, me shumicë të cilësuar, mund të vendosë që një pjesë e fitimit neto vjetor, të realizuar nga shoqëria, të mos shpërndahet si dividend, por të kalojë te rezervat e shoqërisë me qëllim rritjen e investimeve.⁸⁹¹ Duke pasur parasysh që e drejta për dividendin është një e drejtë thelbësore e ortakëve të shoqërisë, vlerësojmë se vendimet e AO për kufizimin e shpërndarjes së dividendit, duhet të jenë të mirëargumentuara dhe të justifikojnë nevojën e shoqërisë për këto shuma financiare, të cilat do të kalojnë te rezervat e shoqërisë. Për raste të caktuara dhe të argumentuara në interesin e shoqërisë, AO, me shumicë të cilësuar, mund të vendosë edhe që mos ta shpërndajë fare fitimin vjetor, por ta kalojë atë te rezervat e shoqërisë.

Kjo është dhe arsyeja, përse neni 88 i ligjit e ka parashikuar vendimin për shpërndarjen e fitimit si vendim që kërkon shumicë të cilësuar prej $\frac{3}{4}$ të votave. Një vendim i tillë cenon pritshmëritë e ligjshme të ortakëve në pakicë, pra atyre që nuk janë dakord për të mos e shpërndarë dividendin.⁸⁹² Nga praktika gjyqësore janë konstatuar dhe raste kur ortakët në minorancë kanë ngritur pretendime për veprime abuzive nga ana e ortakëve që kanë shumicën e votave, dhe kanë vendosur mosshpërndarjen e fitimit për periudha të gjata kohe.⁸⁹³

Në doktrinën e së drejtës tregtare mosndarja e dividendit për një kohë të gjatë është konsideruar si një situatë, e cila riskon të vijë për shkak të abuzimit të shumicës.⁸⁹⁴ Për shembull, në rast se shumatat e akumuluar në depozitat e shoqërisë mbahen nëpër llogari bankare pa asnjë plan investimi, atëherë do të konsiderohet i vështirë justifikimi i arsyeshmërisë së vendimit për të mos shpërndarë fitime për një kohë të gjatë. Në rast se provohet se rezervat e fitimeve të pashpërndara janë perdorur nga administratori, apo ortakët e shumicës në konflikt interesi, në kundërshtim me parimet e mirëadministrimit, mirëbesimit dhe interesit më të lartë të shoqërisë, (nenet 14-16 të ligjit) atëherë ortakët e

⁸⁹⁰ Ligji 9901/2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” i ndryshuar, neni 76/1

⁸⁹¹ Shih Vendimin e Gjykatës së Lartë Nr. 131 dt. 26.10.2017.

⁸⁹² Argita Malltezi, Jonida Rystemaj dhe Armela Kromiçi, *Gjykatat Shqiptare mbi shoqëritë dhe veprimtarinë Tregtare* (n 364) fq. 146

⁸⁹³ Vendimin Nr. 53 dt. 03.02.2011 i Gjykatës së Lartë.

⁸⁹⁴ Argita Malltezi, Jonida Rystemaj dhe Armela Kromiçi, *Gjykatat Shqiptare mbi shoqëritë dhe veprimtarinë Tregtare* (n 364) 148; Gregor Bachmann, Horst Eidenmüller, Andreas Engert, Holger Fleischer and Wolfgang Schön, *Regulating the Closed Corporation* (European Company Law and Financial Law Review Vol 4, De Gruyter 2014) fq. 34-40.

pakicës justifikohen plotësisht për të kundërshtuar vendimin e mosshpërndarjes së fitimit. Në një rast të tillë, ata mund të kërkojnë dhe dëmin e shkaktuar në përputhje me nenin 93 (të drejtat që burojnë nga kuota)⁸⁹⁵.

Në rastet e mosshpërndarjes së dividetit, shoqëria duhet të argumentojë plotësisht që vendimi për kufizimin apo mosshpërndarjen e fitimit është bërë në interesin më të mirë të saj dhe për pasojë, edhe të të gjithë ortakëve.⁸⁹⁶ Pra, në rast të një konflikti gjyqësor duhet të vërtetohet interesi më i lartë ekonomik dhe volitshmëria ekonomike e një vendimi për mosshpërndarjen apo kufizimin e ndarjes së dividetit për të ardhmen shoqërisë. Nëse vërtetohet ky interes ekonomik për shoqërinë, kjo do të thotë se edhe ortakëve që kanë qenë në pakicë do t'u rritet vlera ekonomike e kuotës së tyre dhe pritshmëritë për të realizuar më shumë fitime në të ardhmen.

Në nenin 77 të ligjit janë parashikuar edhe kushtet (certifikata e aftësisë paguese) për të bërë shpërndarjen e fitimit dhe kufizimet e shpërndarjeve të fitimit. Ky nen parashikon që shoqëria mund të ndajë dividend (fitimin për ortakët), vetëm pasi të sigurohet që aktivet e saj mbulojnë plotësisht humbjet e shoqërisë, si dhe mbetet likuiditet i mjaftueshëm për të shlyer detyrimet që maturohen brenda vitit të ardhshëm.⁸⁹⁷ Vetëm pasi administratori sigurohet që detyrimet mund të shlyhen, ka të drejtë të lëshojë certifikatën e aftësisë paguese dhe të shpërndajë fitimet.⁸⁹⁸

Ndërsa në nenin 78 të ligjit është përcaktuar se përgjegjësia për shpërndarjet e ndaluara të fitimit bie mbi administratorët, të cilët nga pakujdesia lëshojnë një certifikatë të pasaktë të aftësisë paguese. Në një situatë të tillë ata përgjigjen personalisht përpara shoqërisë për

⁸⁹⁵ Ligji 9901/2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” i ndryshuar, neni 93.

⁸⁹⁶ Argita Malltezi, Jonida Rystemaj dhe Armela Kromiçi, *Gjykatat Shqiptare mbi shoqëritë dhe veprimtarinë Tregtare* (n 364) fq. 147.

⁸⁹⁷ Neni 77 i Ligjit 9901/2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” i ndryshuar parashikon:

“1. Shoqëria mund t'u shpërndajë fitime ortakëve, vetëm nëse pas pagimit të dividendit:

a) aktivet e shoqërisë mbulojnë tërësisht detyrimet e saj;

b) shoqëria ka aktive likuide të mjaftueshme për të shlyer detyrimet që bëhen të kërkueshme brenda 12 muajve në vazhdim.

2. Administratorët lëshojnë një certifikatë të aftësisë paguese, e cila konfirmon shprehimisht se shpërndarja e propozuar e dividendëve përmbush kërkesat e pikës 1 të këtij neni, ndërsa kur gjendja e shoqërisë tregon se shpërndarja e propozuar e dividendëve nuk i përmbush këto kritere, administratorët nuk mund ta lëshojnë këtë certifikatë.

3. Kërkesat e pikave 1 dhe 2, të këtij neni, zbatohen gjithashtu në rastet kur, pavarësisht nga dhënia e miratimeve të nevojshme, sipas nenit 13, të këtij ligji, shoqëria do të kryejë një pagesë në favor të një prej ortakëve të saj, në bazë të një marrëveshjeje të lidhur mes shoqërisë dhe ortakut, e cila përmban kushte më pak të favorshme për shoqërinë, në krahasim me kushtet normale të tregut.

4. Administratorët përgjigjen ndaj shoqërisë për vërtetësinë e certifikatës së aftësisë paguese që duhet të lëshohet sipas këtij neni”.

⁸⁹⁸ Ligji 9901/2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” i ndryshuar, neni 77.

kthimin e dividendëve të shpërndarë.⁸⁹⁹ Por, sipas kësaj dispozite, edhe ortakët që kanë përfituar dividend në kundërshtim me nenin 77, pa u lëshuar certifikata e aftësisë paguese, janë përgjegjës personalisht para shoqërisë për kthimin e këtyre shumave.

Këto parashikime ligjore për shpërndarjen e fitimit synojnë të rrisin efikasitetin dhe mirëadministrimin e veprimtarisë tregtare të SHPK-ve, si dhe të garantojnë të drejtat e kreditorëve të këtyre shoqërive. Duke pasur parasysh që forma e SHPK-së është një formë shume e përhapur edhe në sipërmarrjet tregtare të mesme dhe në veprimtaritë tregtare të themeluara mbi baza të iniciativës familjare, dhe madje, në shumë raste kemi dhe SHPK me ortak të vetëm, këto dispozita kanë një rol të rëndësishëm në rritjen e përgjegjshmërisë dhe shmangien e konfuzionit në veprimet e administrimit ekonomik-financiar të shoqërive me përgjegjësi të kufizuar.

Këto dispozita përcaktojnë qartë, që për ortakët kanë jo vetëm të drejta, por edhe detyrime në një SHPK. Kryesisht këto detyrime lindin në rast se ata nuk respektojnë procedurat korrekte ligjore për ndarjen e fitimit, të analizuara më lart. Gjithashtu në pjesën hyrëse të këtij punimi kemi analizuar dhe detyrimet që u vijnë ortakëve në rastet e parashikuara në nenin 16 të ligjit për tregtarët dhe shoqëritë tregtare 9901/2008. Këtu përfshihen rastet e përfshira në konceptin e njohur si “*Piercing Corporate Veil*”,⁹⁰⁰ apo heqja e privilegjit të përgjegjësisë së kufizuar të ortakut në rastet e abuzimit prej tyre të parashikuara nga neni 16 i ligjit.⁹⁰¹ Këto parashikime synojnë që të pengojnë ortakët, të cilët me keqdashje

⁸⁹⁹ Sipas nenit 78 të ligjit 9901/2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” i ndryshuar:

“1. Administratorët, të cilët nga pakujdesia lëshojnë një certifikatë të pasaktë të aftësisë paguese, sipas pikës 2 të nenit 77 të këtij ligji, përgjigjen personalisht përpara shoqërisë për kthimin e dividendëve të shpërndarë.

2. Ortakët, që kanë marrë nga shoqëria dividendë, përgjigjen personalisht ndaj shoqërisë për kthimin e dividendëve, që u janë shpërndarë kur nuk është lëshuar certifikata e aftësisë paguese, ose kur, pavarësisht lëshimit të certifikatës, këta ortakë kanë pasur dijeni për gjendjen e paaftësisë paguese të shoqërisë, sipas pikës 1 të nenit 77 të këtij ligji, ose në bazë të rrethanave të qarta, nuk mund të mos kishin pasur dijeni për këtë gjendje.”

⁹⁰⁰ Humphreys (n 425).

⁹⁰¹ Sipas nenit 16/1 të ligjit 9901/2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” i ndryshuar përcaktohet se:

“Abuzimi me detyrën dhe formën e shoqërisë

1. Individit, i cili gëzon cilësinë e ortakut, aksionarit apo përfaqësuesit të ortakut ose aksionarit, të administratorit apo të anëtarit të këshillit të administrimit të shoqërisë tregtare, i cili, me veprimet apo mosveprimet e tij, i siguron vetes apo të tretëve një përfitim ekonomik të padrejtë, apo i shkakton një të treti pakësimin e pasurisë me dashje, është përgjegjës personalisht ndaj të tretëve, përfshi autoritetet publike, me pasurinë e tij, për shlyerjen e detyrimeve të shoqërisë kur:

a) ka abuzuar me formën dhe/ose përgjegjësinë e kufizuar që ofron shoqëria tregtare; ose
b) ka trajtuar pasuritë e shoqërisë tregtare si të ishin pasuritë e tij/të saj personale; ose
c) në çastin kur ka marrë dijeni apo duhet të kishte marrë dijeni që shoqëria nuk ka kapital të mjaftueshëm për të përmbushur detyrimet ndaj palëve të treta, nuk mori masat e nevojshme, të përfshira në kompetencat e tij/të saj, sipas këtij ligji, për të mos lejuar që, në varësi të rrethanave, shoqëria të vazhdonte ushtrimin e veprimtarisë tregtare, dhe/ose marrjen përsipër të detyrimeve të reja ndaj palëve të treta, përfshirë autoritetet publike...”

tentojnë të abuzojnë me infrastrukturën juridike të shoqërive me përgjegjësi të kufizuar (duke përdorur formën e tyre) në dëm të interesave të kreditorëve. Në rast të vërtetimit të situatave të tilla në një proces gjyqësor, atëherë ortakët zhvishen nga “petku” i përgjegjesisë së kufizuar dhe mbajnë përgjegjësi personale për dëmin e shkaktuar.⁹⁰²

7.8. E drejta e pjesëmarrjes në shpërndarjen e tepricës së likuidimit

Ortakët e një SHPK-je kanë dhe të drejtën për të përfituar nga shpërndarja e tepricës së likuidimit, pra të marrin pjesë në ndarjen e aseteve të shoqërisë të mbetura në fund, pas procesit të likuidimit të saj.⁹⁰³ Ky proces kryhet pasi është vendosur prishja dhe likuidimi i shoqërisë në gjendjen e aftësisë pagueuse (pra, në rastet kur shoqëria nuk ndodhet në një situatë të falimentit), dhe pasi janë shlyer të gjitha detyrimet ndaj të tretëve. E drejta e përfitimit nga teprica e likuidimit është në përpjesëtim të drejtë me pjesëmarrjen në kapitalin e shoqërisë dhe madhësinë e kuotës së secilit. Pra, kjo e drejtë zbatohet njësoj si e drejta e pjesëmarrjes në fitimet e shoqërisë të analizuar më lart. Ligji ka parashikuar dhe mundësinë që ortakët në statutin e shoqërisë të përcaktojnë një radhë preferimi të caktuar në shpërndarjen e tepricës së likuidimit.⁹⁰⁴ Vetëm në rast se statuti parashikon një radhë preferimi, atëherë duhet të respektohet ky parashikim.

Gjithashtu, në këtë fazë të likuidimit të shoqërisë, ortakët që i kanë dhënë shoqërisë pasuri të ndryshme me qira apo në përdorim, kanë të drejtë të marrin pasuritë e tyre, pasi këto pasuri nuk janë asete të shoqërisë, por të ortakëve, Kjo është një marrëdhënie normale civile, që ndërton shoqëria me ortakun, njësoj si me çdo person tjetër.⁹⁰⁵ Në nenin 201 të ligjit 9901/2008, është përcaktuar dhe procedura se si kryhet shpërndarja e tepricës së likuidimit nga likuiduesi i shoqërisë në favor të ortakëve.⁹⁰⁶

⁹⁰² Ligji 9901/2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” i ndryshuar, neni 16/1.

⁹⁰³ Ligji 9901/2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” i ndryshuar, neni 201.

⁹⁰⁴ Ligji 9901/2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” i ndryshuar, neni 201.

⁹⁰⁵ Ligji 9901/2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” i ndryshuar, neni 201.

⁹⁰⁶ Sipas nenit 201 të ligjit 9901/2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” i ndryshuar, përcaktohet se:

“1. Pas shlyerjes së detyrimeve ndaj kreditorëve, likuiduesi u shpërndan ortakëve apo aksionarëve aktivet e mbetura, sipas të drejtave që ata kanë në ndarjen e fitimeve, me përjashtim të rastit kur statuti parashikon radhë preference.

2. Pasuritë, që i janë dhënë shoqërisë me qira apo në përdorim, me çfarëdo titulli u kthehen ortakëve apo aksionarëve. Ortakët apo aksionarët nuk kanë të drejtën e dëmshpërblimit në rast shkatërrimi, dëmtimi apo uljeje të vlerës së pasurisë, nëse kjo nuk varet nga veprimi apo mosveprimi i shoqërisë ose personave, që kanë vepruar në emër të saj”.

7.9. E drejta e informimit

Në nenin 15 të ligjit në fuqi 9901/2008, parashikohet parimi i përgjithshëm i të drejtës së informimit për të gjitha shoqëritë tregtare, që vlen edhe për SHPK-të. Në këtë dispozitë garantohet e drejta e ortakëve për informim, si aspekt i rëndësishëm i mirëqeverisjes së shoqërive tregtare.⁹⁰⁷ Ortakët kanë të drejtë të njihen në çdo kohë me llogaritë vjetore të shoqërisë, bilancet, raportet e organeve drejtuese, dhe çdo dokument tjetër të brendshëm të shoqërisë, me përjashtim të atyre që kategorizohen si sekret tregtar nga neni 18 i ligjit.⁹⁰⁸

Kjo është një dispozitë urdhëruese e ligjit, e cila nuk garanton të drejtën e ortakëve për informim dhe gjithashtu interpretohet si detyrim apo përgjegjësi për administratorët e shoqërisë. Kjo e drejtë nuk mund të kufizohet apo të ndalohet me asnjë parashikim të statutit. Dhe në rast se statuti përmban parashikime që e kufizojnë të drejtën për informim të ortakëve, ato janë të pavlefshme dhe për pasojë të pazbatueshme. Në rast se ortakëve u refuzohet apo nuk u kthehet përgjigje për informim sipas kësaj dispozite, ata brenda 30 ditësh nga refuzimi kanë të drejtë t'i drejtohen Gjykatës dhe të kërkojnë që nëpërmjet përbaruesit gjyqësor të ekzekutojnë të drejtën e tyre për informim.⁹⁰⁹

Gjithashtu në nenin 91 të ligjit në fuqi parashikohet e drejta e ortakëve të SHPK-së që nëpërmjet një vendimi të AP të nisë një hetim të posaçëm për të verifikuar çdo aspekt të veprimtarisë tregtare, që nga fazat më të para të themelimit të shoqërisë.⁹¹⁰ Ky lloj hetimi i ngarkohet një eksperti të pavarur të fushës. Të drejtën për të iniciuar një hetim të tillë, e kanë edhe ortakët në minorancë të një SHPK-je, të cilët disponojnë të paktën 5 % të kapitalit të shoqërisë, si dhe kreditorët e saj. Në rast se AP refuzon një kërkesë të tillë, ortakët në minorancë, apo kreditorët, sipas nenit 91/2 të ligjit, kanë të drejtë që t'i drejtohen Gjykatës për të emëruar një ekspert të fushës me qëllim kryerjen e hetimeve e posaçme të kërkuara prej tyre.⁹¹¹ E drejta për të kërkuar kryerjen e këtyre hetimeve të posaçme në një

⁹⁰⁷ Sipas pikave 1 dhe 2 të nenit 15 të ligjit 9901/2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” i ndryshuar parashikohet që:

“ Personat përgjegjës për administrimin e shoqërisë informojnë të gjithë ortakët apo aksionarët për ecurinë e veprimtarisë së shoqërisë tregtare dhe, me kërkesën e tyre, duhet t'u vënë në dispozicion llogaritë vjetore, përfshirë llogaritë e konsoliduara, raportet për gjendjen dhe ecurinë e veprimtarisë së shoqërisë tregtare, raportet e organeve drejtuese apo të ekspertëve kontabël të autorizuar, si dhe çdo dokument tjetër të brendshëm të shoqërisë, me përjashtim të atyre të përcaktuar në nenin 18 të këtij ligji. Ky detyrim mund të përmbushet edhe duke evendosur këtë informacion në faqen e internetit të shoqërisë tregtare dhe duke informuar për këtë personat, të cilët e bëjnë kërkesën. Në të kundërt, këto dokumente duhet të vihen në dispozicion, për shqyrtim, pranë zyrës qendrore të shoqërisë tregtare.2. Çdo dispozitë e statutit, që ndalon ose kufizon ushtrimin e të drejtave të përmendura në pikën 1 të këtij neni, është e pavlefshme.”

⁹⁰⁸ Ligji 9901/2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” i ndryshuar, neni 15 pika 1 dhe 2.

⁹⁰⁹ Ligji 9901/2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” i ndryshuar, neni 15 pika 3.

⁹¹⁰ Ligji 9901/2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” i ndryshuar, neni 91.

⁹¹¹ Ligji 9901/2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” i ndryshuar, neni 91/2.

SHPK, është një mjet i rëndësishëm për ortakët e shoqërisë në kuadër të ushtrimit të drejtave të tyre për informim dhe transparencë, lidhur me veprimtarinë e shoqërisë tregtare.

7.9. Largimi dhe Përrjashtimi i ortakëve

Instituti i largimit të ortakut nga shoqëria (tërheqja me vullnetin e tij) dhe ai i përrjashtimit të ortakut janë dy institute të cilat i japin mundësi shoqërisë dhe ortakëve që t'i japin fund marrëdhënies së ortakërisë së një ortakut të caktuar në një SHPK. Këta dy mekanizma juridikë përfaqësojnë zgjidhje të ndryshme nga njëri-tjetri për nga rrethanat dhe vullnetin që vë në lëvizje këta mekanizma. Largimi i ortakut nga shoqëria bëhet me vullnetin e ortakut, nëse ekzistojnë shkaqe të justifikuara, ndërsa përrjashtimi i ortakut nga shoqëria bëhet për shkak të vullnetit të shumicës së ortakëve në AO, të cilët kanë të drejtë t'i kërkojnë gjykatës kompetente që të vendosë përrjashtimin e ortakut për shkaqe të arsyeshme.

Për herë të parë, në legjislacionin shqiptar këto institute janë parashikuar në Kodin Tregtar të vitit 1932, në nenet 250 - 252 "*Përrjashtimi dhe tërheqja e shokëve*".⁹¹² Por, për shkak të ndryshimeve regresive ligjore të ndodhura në sistemin politiko-ekonomik shqiptar, pas Luftës së Dytë Botërore, legjislacioni për shoqëritë tregtare u shfuqizua.⁹¹³ Siç u analizua me lart në këtë punim, ligji "Për shoqëritë tregtare" Nr.7638/1992, i cili ka qenë në fuqi nga viti 1992 deri në vitin 2008, nuk e njihte konceptin e përrjashtimit të ortakut. Ky qëndrim është konfirmuar edhe nga jurisprudenca e Gjykatës së Lartë, e cila në vendimin Nr. 39 datë 30.05.2002,⁹¹⁴ konkludonte në qëndrimin se një ortak nuk mund të përrjashtohet nga shoqëria, pavarësisht çdo lloj veprimi të tij dhe pasojave që mund t'i kene ardhur shoqërisë.

Ligji Nr. 9901/14.04.2008 i ka përrfshirë këto institute të largimit dhe përrjashtimit të ortakut për herë të parë pas rreth 65 vitesh, në nenet 101-103 të tij.⁹¹⁵ Të dyja këto institute janë mekanizma të rëndësishëm në interes të shoqërive me përrgjegjësi të kufizuara, aplikimi i të cilave mund të shërbejë pozitivisht si alternativë në zgjidhjen e situatave konfliktuale që lindin mes ortakëve të shoqërisë dhe që synojnë në "*shërimin*" e gjendjeve të mosmarrëveshjeve serioze në shoqëri, duke shmangur prishjen e shoqërisë tregtare.

⁹¹² Fatri Islamaj, "*Vështrim krahasues i disa instituteve të shoqërive tregtare sipas kodit tregtar të vitit 1932 dhe ligjit aktual Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare në Shqipëri*" (2020) 1 Revista Juridike Shkencore "Jeta Juridike" fq. 27-52.

⁹¹³ Për më shumë shih Kreun III në këtë punim, "3.2. Shoqëria me përrgjegjësi të kufizuar në periudhën 1944 - 1991 dhe aktet normative të kësaj periudhe"

⁹¹⁴ Gjykata e Lartë, Vendim Unifikues i Kolegjeve të Bashkuara Nr. 39 datë 30.05.2002.

⁹¹⁵ Ligji 9901/2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" i ndryshuar, neni 101-103.

Këto dy insitute dhe veçanërisht ai i përjashtimit të ortakut, rezulton se kanë gjetur një aplikim të gjerë në aktivitetin e shoqërive tregtare dhe në praktikën gjyqësore shqiptare pas vitit 2008 e në vazhdim. Megjithatë, evidentohen edhe situata të paqartësive apo aplikimit jouniform të këtyre instituteve në praktikë.

7.9.1. Largimi i ortakut nga shoqëria, koncepti, procedura

Largimi i ortakut është një e drejtë e ortakut të SHPK-së për t'u tërhequr nga ortakëria, duke kërkuar likuidimin e kuotës së tij në SHPK. Kjo e drejtë e ortakut konsiderohet si një mënyrë për të zgjidhur një situatë konfliktuale të lindur mes shoqërisë dhe këtij ortakut, i cili provon që të drejtat e tij në shoqëri po cenohen.

Në disa raste termi “largim i ortakut” është kuptuar në mënyrë të paqartë nga përdoruesit, duke e keqkuptuar si largim kundër vullnetit të tij, pra si përjashtim ortakut. Në vendimin Nr 8091 datë 13.10.2016 e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë⁹¹⁶ rezulton se paditësi fillimisht në padi ka kërkuar largimin e ortakut, por ndërkohë shkak ligjor i padisë dhe argumentimi i saj nënkuptonin se paditësi është duke kërkuar përjashtimin e ortakut. Në këtë rast rezulton se paditësi ka bërë saktësimin (ndryshimin) e objektit të padisë, pa ndryshuar bazën ligjore. Por, duke marrë shkak nga ky rast praktik mund të themi se terminologjia e përdorur në Kodin Tregtar të vitit 1932, “tërheqja” e ortakut është më e saktë dhe adekuate dhe nuk lë vend për keqkuptime të tilla. Ky fakt mund t'i adresohet dhe legjislatorit, si një mundësi për përmirësimin e terminologjisë së këtij instituti.

Largimi (tërheqja) i ortakut është parashikuar nga neni 101 i ligjit në fuqi, në të cilin janë listuar dhe disa nga rastet që konsiderohen shkaqe të arsyeshme që ortakut vlerëson të largohet nga një SHPK. Sipas kësaj dispozite, ortakut ka të drejtë që të largohet nga shoqëria:

- në rast se ortakët e tjerë ose vetë shoqëria kanë kryer veprime në dëm të tij;
- në rast se është penguar të ushtrojë të drejtat e tij në SHPK;
- në rast se organet e SHPK-së i kanë ngarkuar detyrime të pa arsyeshme;
- ose për shkaqe të tjera, që e bëjnë të pamundur vazhdimin e ortakërisë.⁹¹⁷

Siç konstatohet nga ky nen, kjo nuk është një listë shtëruese e shkaqeve të largimit pasi në këte paragraf parashikohet që ortakut mund të largohet edhe për shkaqe të tjera që e bëjnë të pamundur vazhdimin e ortakërisë. Në thelb të konceptit të largimit është e drejta që e çdo ortakut që ti japë fund marrëveshjes për të qenë ortak në një SHPK, kur ai vlerëson se të drejtat e tij si ortak po cenohen apo në çdo mënyrë tjetër është bërë e pamundur për të vazhdimi i ortakërisë në këtë shoqëri.

⁹¹⁶ Shih vendimin Nr 8091 datë 13.10.2016 e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

⁹¹⁷ Ligji 9901/2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” i ndryshuar, neni 101/1.

Në rast se nje ortak i SHPK-së kerkon te largohet nga shoqeria, ka detyrimin që të njoftojë shoqërinë me shkrim, si dhe ta njohë shoqërinë me shkaqet e largimit.⁹¹⁸ Sapo të marrë një njoftim të tillë administratori i shoqërisë duhet të thërrasë mbledhjen e asamblesë së përgjithshme menjëherë. Ky organ ka në kompetencë për të vendosur nëse ortakut do t'i likuidohet kuota e tij apo jo. Ky vendim merret në varësi të vlerësimit të AO, nëse shkaqet e largimit janë apo jo të arsyeshme.⁹¹⁹

Sipas paragrafit 4 të këtij neni, në rast se administratori refuzon të mbledhë AP për të vendosur lidhur me kërkesën e ortakut për largimin dhe likuidimin e kuotën, ortaku ka të drejtë që t'i drejtohet gjykatës dhe të kërkojë detyrimin e shoqërisë për likuidimin e kuotës.

Doktrina dhe praktika gjyqësore shqiptare për shoqëritë tregtare nuk ka një qëndrim të konsoliduar lidhur me kompetencën e vendimmarrjes, përse i përket të drejtës së ortakut për t'u tërhequr nga shoqëria duke u larguar. Disa studiues mbajnë qëndrimin që kërkesa për largimin e ortakut, është një kërkesë që duhet të vlerësohet nga AO në të dy komponentët e saj, qoftë përse i përket faktit nëse do të pranohet kërkesa e ortakut për t'u tërhequr (larguar) nga shoqëria, ashtu edhe përse i përket kërkimit për likuidimin e kuotës së këtij ortakut.⁹²⁰ Ndërsa studiues të tjerë⁹²¹ janë të mendimit që AO ka në kompetencë të saj vetëm për të vendosur nëse ortakut do t'i likuidohet kuota apo jo, në varësi të faktit nëse ekzistojnë shkaqe të arsyeshme për largimin. Sipas këtij qëndrimi, vullneti i ortakut të SHPK-së për t'u larguar nga shoqëria, nuk është një disponim që i takon asamblesë së ortakëve, por vetë ortakut që ka vlerësuar se ndodhet në kushtet e largimit për shkaqe të arsyeshme.

Pra, sipas këtij qëndrimi të doktrinës, largimi i ortakut realizohet vetëm me shfaqjen e njëanshme të vullnetit të ortakut, i cili vlerëson se duhet të largohet.⁹²²

⁹¹⁸ Ligji 9901/2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” i ndryshuar, neni 101/2.

⁹¹⁹ Ligji 9901/2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” i ndryshuar, neni 101/3.

⁹²⁰ Artan Hajdari shprehet se:

“Në mënyrë që ortaku të ushtrojë të drejtën e tij për t'u larguar nga shoqëria, ai duhet të ndjekë procedurën e përcaktuar në ligj dhe në statutin e shoqërisë. Në të kundërt kërkesa e tij për largim do të konsiderohet e papramueshme. Në lidhje me këtë është kompetente për të vendosur Asambleja e Ortakëve, e cila vendos të pranojë ose jo kërkesën për largim. Nëse mungojnë shkaqet e arsyeshme për largim, asambleja refuzon kërkesën dhe në këtë moment, sipas ligjit është gjykata kompetente ajo që do të zgjidhë konfliktin e lindur tashmë mes shoqërisë dhe ortakut që kërkon të largohet”. Hajdari (n 210) fq. 54.

⁹²¹ Argita Malltezi, Jonida Rystemaj dhe Armela Kromiçi, *Gjykatat Shqiptare mbi shoqëritë dhe veprimtarinë Tregtare* (n 364) fq. 228-229.

⁹²² Altina Xhoxhaj shprehet se:

“Largimi i ortakut ushtrohet nëpërmjet deklarimit me shkrim të vullnetit të tij, që në thelb është një veprim juridik i njëanshëm, me anë të të cilit ortaku vendos të shuajë të drejta dhe detyrime që ka marrë përsipër me anë të marrëveshjes së themelimit të shoqërisë”. Xhoxhaj (n 767) fq. 86.

Paragrafi i dytë i nenit 101 të ligjit, fillon me shprehjen: “*Ortaku që kërkon largimin, duhet të njoftojë shoqërinë me shkrim, si dhe të parashtojë shkaqet e largimit*”.⁹²³ Kjo fjali ka krijuar një konfuzion lidhur me diskutimin nëse largimi i ortakut mund të bëhet vetëm me miratimin e AO apo largimi i ortakut është në diskrecionin e vetë ortakut dhe asamblesë i mbetet të vendosë vetëm nëse do të likuidohet kuota e tij në shoqëri. Kjo pikë e nenit 101 që fillon me shprehjen “*ortaku që kërkon largimin*” është interpretuar në disa raste se ortakut që kërkon të tërhiqet nga shoqëria për shkaqe të arsyeshme, mund ta bëjë kërkesën para AO, dhe është kompetent ky organ për të vendosur nëse do të pranohet largimi i ortakut nga shoqëria.⁹²⁴ Për rrjedhojë sipas këtij qëndrimi, nuk mjafton vullneti i ortakut për largimin nga shoqëria, por duhet që ky vullnet të miratohet nga organi i AO ose nga gjykata nëse vendimi i asamblesë kundërshtohet në gjykatë.⁹²⁵

Megjithatë, nga mënyra se si janë formuluar pikat e tjera të nenit 101 të ligjit 9901/2008, e lë në diskrecionin e vetë ortakut vendimin nëse ai dëshiron të largohet nga shoqëria. Sipas paragrafit të tretë të nenit 101 Asambleja e Ortakëve është përgjegjëse për të vendosur nëse do t’i likuidohet kuota ortakut apo jo, në varësi të vlerësimit nëse ekzistojnë shkaqet e arsyeshme për ortakun që kërkon të tërhiqet dhe të largohet nga ortakëria. Por, ky nen në asnjë paragraf të tij nuk i ka lënë në kompetencë asamblesë së ortakëve, që të vlerësojë nëse do të pranohet apo jo kërkesën e ortakut për t’u larguar nga shoqëria. Pra, pyetja hipotetike që mund të ngrihet, do të ishte: A ka të drejtë AO të vendosë mospranimin e kërkesës së ortakut për t’u larguar nga shoqëria, në rast se nga vlerësimi i saj rezulton se mungojnë shkaqet e arsyeshme?

Nga mënyra si është formuluar neni 101 i ligjit, përgjigjja e pyetjes së mësipërme do të ishte “Jo”. Asambleja e ortakëve ka të drejtë vetëm për të shqyrtuar nëse ekzistojnë shkaqet e arsyeshme të largimit apo jo, dhe në varësi të saj, të vendosë për likuidimin e kuotës së ortakut. Ky konkluzion do të ishte një konkluzion logjik dhe në pajtim edhe me liritë vetjake të ortakut, ndër të cilat është edhe e drejta e çdo personi për të vazhduar ortakërinë në një shoqëri ose jo. Shoqëria tregtare rezulton të jetë e mbrojtur nga dëmi ekonomik në rast të largimit të ortakut pa shkaqe të arsyeshme, pasi në një situatë të tillë, ortakut nuk i likuidohet kuota, si rrjedhim, nuk riskon të shoqërohet me kosto ekonomike për shoqërinë. Gjithsesi, nëse provohet se dëmi kalon vlerën e kuotës së ortakut, shoqëria ruan dhe të drejtën që të kërkojë dëmshpërblim.

Në pikat 4-6 të nenit 101 të ligjit, konstatohet se i vetmi konflikt apo mosmarrëveshje që mund të lindte, mes shoqërisë dhe ortakut, lidhur me kërkesën e tij për largimin nga shoqëria, është vendimi nëse ortakut do t’i likuidohet kuota apo jo. Pra edhe në rastin

⁹²³ Ligji 9901/2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” i ndryshuar, neni 101.

⁹²⁴ Ligji 9901/2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” i ndryshuar, neni 101 pika 2.

⁹²⁵ Ligji 9901/2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” i ndryshuar, neni 101 pika 2.

hipotetik, kur një ortak ka vendosur të largohet nga shoqëria pa pasur shkaqe të arsyeshme, largimi do të konsiderohej gjithsesi i vlefshëm, por ortaku, në këtë rast riskon që të mos marrë vleftën e kuotës së tij. Kjo për shkakun se një largim i ortakut, i pa mbështetur në shkaqe të arsyeshme, nuk detyron shoqërinë të likuideojë kuotën, pasi mund t'i shkaktojë dëm ekonomik asaj. Ndërsa, në pikën 5 të nenit 101 të ligjit parashikohet se: “*Ortaku që kërkon largimin nga shoqëria, detyrohet ta dëmshpërblejë shoqërinë për dëmet e shkaktuara, nëse rezulton se largimi është kryer në bazë të shkaqeve të paarsyeshme.*”⁹²⁶

Edhe sipas këtij parashikimi përforcohet qëndrimi doktrinal se largimi i ortakut nga shoqëria, është në diskrecionin e lirë të vetë ortakut që tërhiqet dhe nuk mund të kufizohet nga vullneti i asamblesë së ortakëve.

Pra mënyra se si është shkruar kjo dispozitë i jep Asamblesë së Ortakëve vetëm tagrin për të vendosur nëse do të likuideohet kuota apo jo, në varësi të faktit nëse ka pasur apo jo shkaqe të arsyeshme, ortakut që është larguar. Nëse ligji do t'i rezervonte AO të drejtën për të vendosur pranimin apo jo të kërkesës për largimin e ortakut nga shoqëria, atëherë nuk do të ekzistonte situata e parashikuar në pikën 5 të nenit 101 të ligjit, i cili e konsideron largimin si fakt të kryer. Sipas këtij rregullimi, AO ka vetëm të drejtën për të vlerësuar shkaqet e largimit *post factum*, ku fakti i largimit nuk rezulton të jetë në kompetencën e këtij organi. Në varësi të rezultatit, nëse provohen apo jo shkaqet e ligjshme të largimit të ortakut, shoqërisë i lind dhe e drejta për të kërkuar nga ortaku shpërblimin e dëmit në rast se provohet që ai (ortaku) është larguar nga shoqëria pa pasur shkaqe të arsyeshme. Pra ligji ka parashikuar një penalitet për ortakun i cili largohet pa shkaqe të arsyeshme, që të dëmshpërblejë shoqërinë për çdo dëm të shkaktuar.⁹²⁷

Por ligji nuk ka sqaruar plotësisht, nëse ky dëmshpërblim do të kompensohet me një vendim për moslikuidimin e kuotës, apo këto të dy mjete konkurojnë me njëri-tjetrin. Nga një interpretim logjik në përputhje me parimin e proporcionalitetit, do të arrinim në konkluzionin se, nëse masa e dëmit të shkaktuar nga ortaku që vendos të largohet nga shoqëria mbulohet nga kuota e tij në shoqëri, atëherë shoqëria nuk mund t'i kërkojë këtij ortakut të paguajë ndonjë vlerë tjetër shtesë.

Një pyetje tjetër që lind është, nëse vlera e kuotës së ortakut që largohet pa shkaqe të arsyeshme është më e madhe sesa vlera e dëmit të shkaktuar shoqërisë, A mundet ta kërkojë ky ortak likuidimin e vlerës së kuotës për pjesën që tejkalon dëmin e shkaktuar? Duke pasur parasysh parimin e proporcionalitetit dhe faktin që kontrata e shoqërisë është një kontratë vullnetare, përgjigjja do të ishte “Po.” Megjithatë, kjo çështje do të vlerësohet në

⁹²⁶ Ligji 9901/2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” i ndryshuar, neni 101/5.

⁹²⁷ Ligji 9901/2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” i ndryshuar, neni 101/5.

të ardhmen, në varësi të zhvillimit të jurisprudencës dhe mundësisht, nga një qëndrim njehsues i Gjykatës së Lartë.

Gjithashtu, edhe sipas pikës 6 të nenit 101, ortakut i njihet e drejta që t'i drejtohet gjykatës me padi, për të kërkuar shpërblimin e dëmit nga shoqëria dhe/ose ortakët e tjerë të cilët mbahen solidarisht përgjegjës (bashkë me shoqërinë) për dëmin e shkaktuar ortakut, i cili është vendosur në kushtet për t'u tërhequr nga shoqëria për shkaqe të arsyeshme. Në këtë rast ligji i njeh ortakut që largohet, të drejtën për dëmshpërblim tej së drejtës për likuidimin e kuotës së tij.

Ndërkohë neni 103 paragrafi i parë, ka një formulim të paqartë dhe duket sikur përfshin të dyja alternativat, edhe rastin që për largimin mjafton vullneti i ortakut, edhe në rastin kur largimi mund të kryhet vetëm me miratimin e AO, apo gjykatës në rast konflikti.⁹²⁸ Nga ky diskutim përcaktohet se cili është vullneti përcaktues, që bën të mundur largimin e një ortaku nga SHPK-ja, nëse është vetë vullneti i ortakut i shprehur në njoftimin me shkrim, apo është vullneti i AO, i cili duhet të miratojë një kërkesë të ortakut të motivuar plotësisht me shkaqe të justifikuara të sipas nenit 101.

Zgjidhja e çështjes së shtruar më lart, nëse është apo jo në diskrecionin e ortakut që të largohet nga shoqëria me vetëm me shfaqjen e vullnetit të tij apo jo, paraqet një rëndësi të madhe në praktikë, pasi nga ky diskutim varet edhe momenti se kur përfundon cilësia e ortakut në shoqëri dhe fillimi i pasojave juridike të largimit të ortakut.

Në rast se qëllimi i legjislatorit, ka qenë që AO nuk ka në kompetencë të pranojë apo të refuzojë kërkesën për largim, por vetëm kërkesën për likuidimin e kuotës, atëherë subjekti që ishte ortak e humbet këtë cilësi, që në momentin e njoftimit me shkrim të shoqërisë sipas pikës 2 të neni 101.⁹²⁹ Ndërkohë që, në rast se do të bënim një interpretim më të zgjeruar të nenit 101⁹³⁰ të ligjit, duke e konsideruar se AO ka në kompetencë jo vetëm nëse do likuidohet kuota, por edhe nëse do të pranohet vullneti i ortakut për largimin nga shoqëri, atëherë efektet vendimit të largimit do të fillojnë nga momenti kur është vendosur të pranohet kërkesa e ortakut nga AO dhe nëse ky organ nuk do të pranonte kërkesën për largim, ortakut do të vazhdonte të konsiderohej si i tillë deri në zgjidhjen e këtij konflikti nga gjykata.

⁹²⁸ Neni 103 pika 1 i ligjit 9901/2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” i ndryshuar parashikon se; “*Të gjitha të drejtat, që rrjedhin nga cilësia e ortakut në shoqëri, shuhen në datën e largimit ose të vendimit të formës së prerë të gjykatës për largimin ose përjashtimin.*”

⁹²⁹ Ligji 9901/2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” i ndryshuar, neni 101.

⁹³⁰ Hajdari (n 210) fq. 54.

Nëse u referohemi doktrinës dhe legjislacioneve të tjera, konstatojmë se në legjislacionin e shtetit të Delaware në SHBA, si dhe jurisprudencës së këtij vendi,⁹³¹ rezulton se largimi i ortakut nga shoqëria nuk mund të bëhet thjesht me vullnetin e tij, në rast se nuk është parashikuar nga vetë marrëveshja e ortakëve, pra nga statuti i shoqërisë. Sipas këtij qëndrimi, SHPK-ja është në thelb një krijesë që buron nga kontrata e themelimit mes ortakëve dhe si e tillë, ajo duhet të respektohet nga të gjithë ortakët.

Ndërsa në legjislacionin italian, rezulton se është e parashikuar shprehimisht në neni 2473 prg. 2 i K.Civil italian⁹³² e drejta e ortakut për t'u larguar nga shoqëria duke njoftuar paraprakisht shoqërinë 180 ditë përpara.⁹³³ Pra sipas këtij kodi është e qartë që vendimi i largimit është e drejtë ekskluzive e ortakut dhe madje, nuk kushtëzohet kjo e drejtë as me ekzistencën e shkaqeve të ligjshme, por vetëm me detyrimin për të njoftuar shoqërinë 180 ditë përpara. Edhe sipas doktrinës italiane, rezulton se akti i themelimit mund të shërbejë si një kuadër i mirë rregullator përse i përket disiplinimit të procedurave të largimit të ortakut në një SHPK.⁹³⁴

Ligji nuk ka bërë parashikime të detajuara lidhur me efektet financiare të likuidimit të kuotës së ortakut, i cili largohet nga shoqëria për shkaqe të arsyeshme. Nuk parashikohen procedura apo modalitetet, se në ç'mënyrë dhe me cilat burime ekonomike do të bëhet likuidimi i kuotës së ortakut, i cili tërhiqet nga shoqëria për shkaqe të arsyeshme. Në këtë mënyrë i ka lënë shoqërisë një diapazon të gjerë të mjeteve ekonomike me anë të të cilave mund të bëjë likuidimin e kuotës së ortakut të larguar për shkaqe të arsyeshme.

Likuidimi i kuotës së ortakut nënkupton kompensimin ekonomik të ortakut për vlerën ekonomike që ka kuota e tij në atë moment. Është e qartë, që kontributet në natyrë të ofruara në themelimin e shoqërisë nga ortaku që largohet, nuk mund t'i rikthehen automatikisht atij, pasi ai ka humbur çdo të drejtë pronësie mbi to dhe asetet janë në pronësi të shoqërisë. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë në Vendimin Nr. 7565 Akti dt. 20.10.2014 e ka të qartë këtë koncept dhe shprehet se ortaku nuk mund të kërkojë pjesën e aseteve që ka kontribuar në themelimin e shoqërisë, por vetëm të kompensohet për vlerën ekonomike të kuotës.⁹³⁵

⁹³¹ Tarik J Haskins, "Exit Stage Left: Getting out of Your Limited Liability Company" (ABA, 31 korrik 2013) <https://www.americanbar.org/groups/business_law/publications/blt/2013/07/01_haskins/> aksesuar më 10 shtator 2020. Shiko edhe Delaware Limited Liability Company Act si dhe çështjen Chancery Court (Delaware USA), *Ross Holding & Mgmt. Co. v. Advance Realty Grp LLC*, (2010) WL 3448227.

⁹³² Lisenko Moçka (përkthyes), *Kodi Civil Italian* (Dudaj 2014) neni 2473; Shiko edhe versionin original në Regio Decreto 16 marzo 1942, n. 262, Approvazione del testo del Codice civile [1942] GU 79 i azhornuar me ndryshimet e fundit.

⁹³³ Galgano (n 200) fq. 964.

⁹³⁴ Po aty, fq. 964-965

⁹³⁵ Shih Vendimin Nr 7565 Akti dt. 20.10.2014 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, e cila në pjesën arsyetuese shprehet se:

"Nocioni i përdorur nga ligjvënësi në Ligjin "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" në lidhje me "likuidimin e kuotës", nuk nënkupton likuidim total apo të pjesshëm të shoqërisë, por ka të bëjë

Potencialisht ekzistojnë disa alternative të ndryshme të burimeve ekonomike të cilat mund të aplikohen për të bërë likuidimin e kuotës së ortakut të larguar dhe më pas anullimin e saj. Për shembull, shoqëria mund të përdorë rezervat e akumuluar ndërsa vite për të bërë likuidimin e kuotës. Në rast se rezervat nuk do të mjaftonin, atëherë shoqëria mundet që nëpërmjet një vendimi të AO të vendosë zvogëlimin e kapitalit të nënshkruar, me qëllim përdorimin e një pjese të kapitalit të nënshkruar për realizimin e vlerës ekonomike për likuidimin e kuotës.

Gjithashtu ortakët e shoqërisë mund të vendosin që të zmadhojnë kapitalin duke kontribuar për të realizuar vlerën e likuidimit të kuotës, por sipas kësaj alternative hipotetike, zmadhimi i kapitalit do të duhej të disiplinohet me dispozita të statutit ose me vendim të AO. Kjo me qëllim ruajtjen e parimit të proporcionalitetit të ortakëve të tjerë në ofrimin e kontributeve, me qëllim që të ruajnë të drejtat që ka kuota e secilit ortak që mbetet në shoqëri, në raport me njëri-tjetrin. Gjithsesi kjo të të varej edhe nga mundësia ekonomike apo vullneti i secilit ortak për të kontribuar me një zmadhim të tillë të kapitalit të shoqërisë.

Gjithashtu, shoqëria mund të aplikojë dhe burime të tjera ekonomike, si për shembull, nëse një i tretë shpreh gatishmërinë për blerjen e kuotës së ortakut që largohet apo të negociojë me ndonjërin prej ortakëve ekzistues, duke realizuar një lloj marrëveshjeje për blerjen e kuotës së ortakut të larguar nga një ose disa ortakë të shoqërisë. Këta mekanizma do të ishin shumë të favorshëm në aspektin ekonomik, pasi largimi i ortakut nuk do të shkaktonte asnjë pasojë financiare në kapitalin dhe rezervat e shoqërisë.

Ka pasur edhe raste, kur në procesin gjyqësor ka konkurruar instituti i largimit të ortakut me atë të përjashtimit të ortakut. Për ilustrim mund të përmendim një çështje të gjykuar në Gjykatën e Rrethit Durrës, e cila ka shkuar deri në Gjykatën e Lartë⁹³⁶. Vendimet e këtyre dy gjykatave janë një shembull i nevojës së madhe për trajnime të mëtejshme në fushën e së drejtës tregtare dhe unifikimit të qëndrimeve për çështje të ngjashme.

Në këtë çështje shoqëria *** në rolin e paditësit ka kërkuar përjashtimin e ortakut *** duke argumentuar se i ka shkaktuar dëm të konsiderueshëm shoqërisë, për shkak se në cilësinë e administratorit ka përvetësuar makineritë e linjës së prodhimit (77 makina qepëse) që ishin asete të shoqërisë dhe i ka trajtuar si pasuri personale të tij. Këtë veprim e ka kryer në shërbim të hapjes së një aktiviteti tregtar tjetër, duke ushtruar aktivitet konkurues në dëm të interesave të shoqërisë. Ndërsa ky ortak i paditur në gjykatë, pasi ka

me të drejtën e ortakut që largohet për të marrë vlerën e kuotës së tij në të holla. Pra, në këtë moment, ortakut që largohet nuk mund të kërkojë kuotën e tij në aktivet e shoqërisë, pasi nuk gëzon asnjë të drejtë mbi to, por vetëm kompensimin nga shoqëria të vlerës së kuotës së tij”.

⁹³⁶ Shih Vendim Nr.11-2011-152 (84), datë 17.01.2011 Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës, Vendim.Nr. 00-2015-3952 i Vendimit (488) dt. 25.11.2015 Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë.

filluar procesi ka kërkuar rrëzimin e padisë, anulimin e vendimit të asamblesë për përjashtimin e tij, dhe me kundërpadi ka kërkuar likuidimin e kuotës nëpërmjet aseteve të përvetësuara nga shoqëria. Me vendimin e saj Nr.11-2011-152 (84), datë 17.01.2011, Gjykata e Rrethit Durrës ka rrëzuar padinë e shoqërisë, me të cilën kërkohej përjashtimi i ortakut për veprime abuzive dhe ka pranuar kundërpadinë e ortakut të paditur për largimin nga shoqëria, duke i likuiduar kuotën në shoqëri.⁹³⁷ Likuidimin e kuotës e ka konsideruar të kryer pikërisht me veprimet që ishin shkak për të cilin ishte kërkuar përjashtimi i ortakut. (me anë të përvetësimit të makinerive që shërbenin si linjë prodhimi në këtë shoqëri, dhe ishin kontribut fillestar i ortakut në shoqëri). Për më tepër, gjykata e ka dhënë vendimin me ekzekutim të përkohshëm referuar nenit 317 të Kodit të Procedurës Civile, duke ligjëruar kështu përvetësimin e aseteve të shoqërisë nga ortaku *** i paditur kundërpaditës. Gjykata e Apelit Durrës me Vendimin nr.10-2011-1471(706), datë 01.12.2011, ka vendosur ndryshimin e këtij vendimi dhe pranimin e padisë për përjashtimin e ortakut **** nga shoqëria dhe rrëzimin e kundërpadisë së ngritur për likuidimin e kuotës nga ortaku i paditur.⁹³⁸ Ndërsa Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë në bazë të rekursit të palës së paditur kundërpaditëse, me vendimin Nr. Nr. 00-2015-3952 i Vendimit (488) dt. 25.11.2015 ka vendosur “Prishjen e vendimit nr.10-2011-1471 (706), datë 01.12.2011, të Gjykatës së Apelit Durrës dhe lënien në fuqi të vendimit nr.11-2011-152 (84), datë 17.01.2011, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës”.⁹³⁹

Nga këto vendime nuk rezulton që gjykata të ketë bërë një analizë përsa i përket faktit se a mund të konsiderohet largimi i ortakut i vlefshëm vetëm me shfaqjen e vullnetit nga ana e tij, apo duhet t’i nënshtrohet vendimmarrjes nga asambleja, njësoj si kërkesa për likuidimin e kuotës.

Nga ana tjetër nuk rezulton që t’i jetë dhënë një përgjigje aspektit procedural të likuidimit të kuotës në rastin konkret. A mundet gjykata të marrë në shqyrtim kërkesën për likuidimin e kuotës, nëse ortaku nuk e ka ezauruar detyrimin e nenit 101/2 të ligjit për të njoftuar fillimisht asamblenë?

Nga arsyetimi i këtyre vendimeve rezulton zgjidhja e dhënë nga Gjykata e Lartë, si dhe Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës, duke rrëzuar padinë me objekt përjashtimin e ortakut dhe duke pranuar kundërpadinë e ortakut për likuidimin e kuotës, duke u larguar nga shoqëria bashkë me kapitalet që ishin të shoqërisë, nuk pasqyron një arsyetim të drejtë, të

⁹³⁷ Vendim Nr.11-2011-152 (84), datë 17.01.2011 Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës. Për një trajtim teorik dhe doktrinor shih Fatri Islamaj, “Vështrim krahasues i disa instituteve të shoqërive tregtare sipas kodit tregtar të vitit 1932 dhe ligjit aktual Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare në Shqipëri” (2020) 1 Revista Juridike Shkencore “Jeta Juridike” fq 27-52.

⁹³⁸ Vendim Nr.10-2011-1471(706), datë 01.12.2011 tëGjykatës së Apelit Durrës.

⁹³⁹ Vendim Nr. Nr. 00-2015-3952 i Vendimit (488) dt. 25.11.2015 Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë.

bazuar mbi rrethanat e faktit dhe parashikimet e ligjit.⁹⁴⁰ Këto gjykata nuk i kanë dhënë një përgjigje të qartë pretendimeve të ngritura nga shoqëria, sipas të cilave i padituri i ka shkaktuar dëm shoqërisë duke përvetësuar kapitalet e shoqërisë, të cilat ishin pajisje dhe makineri dhe duke i trajtuar si personale. Gjithashtu rezulton se këto gjykata nuk kanë zbatuar parashikimet të nenit 16 dhe 17 të ligjit Nr.9901/2008⁹⁴¹ ku përcaktohen veprimet abuzive për të cilat parashikohen rastet e aplikimit të zhveshjes së përgjegjësisë së kufizuar (*Piercing Corporate Veil*) të ortakut dhe administratorit në rast abuzimi.

Në kushtet kur ky ligj i ka dhënë një hapsirë të madhe autonomisë stature dhe veçanërisht përsa u përket rregullimit të marrëdhënieve mes ortakëve (siç u analizua me lart në këtë punim), ortakët themelues mund të aplikojnë dispozita që disiplinojnë në mënyrë më të qartë mënyrën e largimit (daljes apo tërheqjes nga shoqëria), qoftë përsa i përket shkaqeve të arsyeshme qoftë përsa i përket procedurës dhe pasojave financiare të likuidimit të kuotës. Psh. ortakët mund të parashikojnë edhe një procedurë të likuidimit të kuotës me këste, në një afat të caktuar, me qëllim që të mos rëndohet së tepërmi pozita financiare e shoqërisë dhe të rrezikohet prishja e saj. Sipas nenit 103/2 të ligjit statuti nuk mund të kufizojë apo të heqë të drejtën e ortakut për t'u larguar dhe as AO për të kërkuar përjashtimin, por kjo nuk do të thotë që statuti të mos ofrojë dispozita më të qarta për aplikimin e këtyre institutëve të rëndësishme në praktikë.

Në kushtet kur ekzistojnë disa aspekte të paqarta lidhur me procedurën e largimit të ortakut, do të ishte e rekomandueshme për legjislatorin, që të marrë masa për përmirësimin e formulimit të nenit 101 të ligjit 9901/2008, me qëllim përcaktimin më të qartë të kësaj procedure. Gjithashtu Gjykata e Lartë mund të japë një kontribut të vyer me jurisprudencën e saj njehsuese, me qëllim unifikimin e praktikave të ndryshme në gjykatat më të ulëta lidhur me këtë çështje.

7.9.2. Përjashtimi i ortakut

Përjashtimi i ortakut është parashikuar në nenin 102 të ligjit 9901/2008 dhe rezulton të ketë gjetur një aplikim të gjerë në praktikën gjyqësore shqiptare.⁹⁴² Siç u tha më lart, edhe ky institut ofron një lloj zgjidhjeje alternative, për situatat konfliktuale të lindura mes ortakëve të një SHPK-je, apo mes shoqërisë dhe një ortakut, i cili në kundërshtim me ligjin, statutin

⁹⁴⁰ Vendim Nr.11-2011-152 (84), datë 17.01.2011 Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës; Vendim Nr. Nr. 00-2015-3952 i Vendimit (488) dt. 25.11.2015 Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë.

⁹⁴¹ Neni 16/1 pika "b" e Ligjit 9901/2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" i ndryshuar e konsideron veprim abuziv të ortakut dhe/ose administratorit, kur "ka trajtuar pasuritë e shoqërisë tregtare si të ishin pasuritë e tij/të saj personale". Ndërsa neni 17 i Ligjit 9901/2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" i ndryshuar parashikon ndalimin e ushtrimit të aktivitetit konkurrues.

⁹⁴² Ligji 9901/2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" i ndryshuar, neni 102.

apo parimet e mirëadministrimit të veprimtarisë tregtare synon të kryejë veprime, të cilat cenojnë interesat e shoqërisë.

Në ndryshim nga instituti i largimit të ortakut, i cili vjen nga vullneti i vetë ortakut, përjashtimi vihet në lëvizje nga shoqëria për të përjashtuar një ortak, që kryen veprime në dëm të shoqërisë. Por procedura e përjashtimit të ortakut, nuk është një vendim i cili finalizohet brenda shoqërisë. AO ka vetëm të drejtën për të iniciuar procedurën e përjashtimit të ortakut (pra për të bërë kërkesën drejtuar gjykatës), dhe pastaj është gjykata që vlerëson nëse ekzistojnë shkaqet e arsyeshme për përjashtimin apo jo.

Sipas pikës së parë të nenit 102 të ligjit, rezulton se asambleja e ortakëve mund të marrë një vendim të tillë, për t'iu drejtuar gjykatës me kërkesën për përjashtimin e ortakut në rast se:

- *ortaku nuk ka shlyer kontributin e tij në shoqëri;*
- *në raste të tjera kur ka shkelur dispozitat e statutit*
- *si dhe nëse ekzistojnë shkaqe të tjera të arsyeshme për të kërkuar përjashtimin e tij.*⁹⁴³

Paragrafi i parë i këtij neni përcakton një rrethanë të qartë, që përbën shkak për përjashtimin e ortakut, dhe kjo është kur ortaku nuk ka shlyer kontributin e tij në kapitalin themeltar të shoqërisë. Siç është sqaruar më lart në këtë punim, në SHPK, ortakët që kontribuojnë me pasuri në natyrë duhet ta shlyejnë tërësisht këtë kontribut para regjistrimit të shoqërisë, ndërsa për ortakët që kontribuojnë në para, statuti mund të përcaktojë procedurat e shlyerjes, duke u dhënë mundësi ortakëve që të shlyejnë kontributin edhe me këste, sipas afateve të përcaktuara. Nëse ortaku nuk u përmbahet afateve të parashikuara në statut për shlyerjen e kontributit, dhe nuk shlyen këto kontribute, atëherë kjo mospërmbushje detyrimi përbën një shkak për përjashtimin e tij nga shoqëria.

Në paragrafin e parë të nenit 102 jepen dhe dy situata të përgjithshme me karakter orientues, kur mund të aplikohet përjashtimi i ortakëve. Këtu përfshihen rastet kur, ortaku ka shkelur dispozitat e statutit ose kur ekzistojnë shkaqe të tjera të arsyeshme. Por, në praktikë lindin pyetje të tjera, të cilave jurisprudenca duhet t'u japë përgjigje. Këto janë; A mund të konsiderojmë çdo shkelje të statutit si shkak për përjashtimin e ortakut, dhe cilat do të konsiderohen si shkaqe të arsyeshme të përjashtimit. Në aplikimin e institutit të përjashtimit, duhet të kemi parasysh dhe parimin e proporcionalitetit, pra duhet të vlerësohen pasojat e shkeljes së statutit dhe të vlerësohet arsyetueshmëria e një vendimi të tillë, i cili ka pasojat serioze për ortakun ndaj të cilit fillon procedura për përjashtim.

⁹⁴³ Ligji 9901/2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” i ndryshuar, neni 102/1.

Në nenin 102 i ligjit, në pikën 2, parashikohet dhe një listë orientuese e shkaqeve që konsideron të arsyeshme për përjashtimin e ortakut, por duke e lënë të hapur këtë listë dhe joshteruese.

Kjo listë përfshin rastet kur ortakut:

- a) me dashje ose me pakujdesi të rëndë i shkakton dëme shoqërisë ose ortakëve të tjerë;
- b) me dashje apo me pakujdesi të rëndë shkel statutin ose detyrimet e përcaktuara me ligj;
- c) përfshihet në veprime, të cilat e bëjnë të pamundur vazhdimin e marrëdhënieve midis shoqërisë tregtare dhe ortakut; ose
- ç) me veprimet e tij dëmton ose pengon ndjeshëm veprimtarinë tregtare të shoqërisë.⁹⁴⁴

Në këtë listë të shkaqeve të arsyeshme të parashikuara në pikën e dytë të nenit 102, janë listuar katër situata me karakter orientues për gjykatën, e cila shqyrton kërkesën për përjashtimin e ortakut.

Së pari, ligji ka parashikuar si shkak të arsyeshëm për përjashtimin e ortakut, kur nga veprimet e tij u shkaktohet një dëm shoqërisë ose ortakëve të tjerë. Por, si kusht për lindjen e kësaj përgjegjësie, ligji ka parashikuar që duhet të ekzistojë dhe aspekti i anës subjektive, pra i fajit të ortakut që ka shkakuar dëmin. Ndryshe nga koncepti i përgjithshëm i përgjegjësisë civile në shkaktimin e dëmit jashtëkontraktor, (ku aplikohet edhe përgjegjësia pa faj)⁹⁴⁵ në rastin e përjashtimit të ortakut nga shoqëria kërkohet përgjegjësia subjektive e ortakut, pra kërkohet ekzistenca e fajit në formën e dashjes ose pakujdesisë së rëndë.

Forma e dashjes (*culpa*), është forma më e rëndë e fajit. Në këtë rast, personi që ka shkakuar dëmin dëshiron ardhjen e pasojave (dashja direkte) ose pavarësisht se i parashikon pasojat e dëmshme të veprimit të tij, me ndërjegje lejon ardhjen e tyre edhe nëse nuk ka për synim të drejtpërdrejtë pasojën (dashja indirekte).⁹⁴⁶

Ndërsa koncepti i pakujdesisë së rëndë, e cila konsiderohet nga doktrina si forma më e rëndë e pakujdesisë (*culpa lata*), lidhet me një neglizhencë ekstreme, apo indiferentizëm, të një personi, përsa u përket pasojave të veprimeve apo mosveprimeve të tij të tjerët.⁹⁴⁷

Doktrina njih disa lloje të pakujdesisë si forma faji, të prejardhura nga e drejta romake. Siç janë; *culpa levis* (pakujdesi e lehtë), *culpa lata* (pakujdesi e rëndë), *culpa levis in abstracto* (pakujdesi e lehtë abstrakte) dhe *culpa levis in concreto* (pakujdesi e lehtë konkrete).⁹⁴⁸ Sipas së drejtës romake, një person kryen një dëm nga pakujdesia e rëndë, kur nuk mendon

⁹⁴⁴ Ligji 9901/2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” i ndryshuar, neni 102/2 .

⁹⁴⁵ Rustem Gjata, *Detyrimet Jashtëkontraktore* (Muza 2010) fq. 41-43.

⁹⁴⁶ Afet Mamuti, “Përgjegjësia Juridike Civile Për Shpërblimin e Dëmit në Maqedoni” (Tezë Doktorature, Departamenti i së Drejtës Civile Fakulteti i Drejtësisë Universiteti i Tiranë 2013) fq. 76-80.

⁹⁴⁷ Alan Calnan, “The Fault(s) in Negligence Law” (2007) 25 *Quinnipiac Law Review* <http://www.swlaw.edu/faculty/faculty_listing/ssrn> aksesuar më 20 tetor 2020, fq. 105-108.

⁹⁴⁸ Mamuti (n 946) fq 79.

pasojën e veprimeve apo mosveprimeve të tij dhe nuk kupton atë që do të kuptonin të gjithë qytetarët (njeriu mesatar), duke u sjellë me shpërfillje ndaj rregullave të mirësjelljes, “*culpa lata est nimia negligentia, id est non intellegere quod omnes intellegunt*”.⁹⁴⁹ Pakujdesia e rëndë “*culpa lata*”- është forma më e rëndë e pakujdesisë në shkallëzimin e fajit, e cila barazohet me dashjen.⁹⁵⁰ Me këtë pakujdesi dëmtuesi e shkakton dëmin duke cenuar kujdesin e rëndomtë.⁹⁵¹ Pra dëmi i shkaktuar nga ortaku në kushtet e pakujdesisë së rëndë është një dëm, i cili do të duhej të parashikohej dhe të shmangej nga çdo njeri me inteligjencë normale apo mesatare.⁹⁵²

Së dyti, situata tjetër (neni 102/2/b), e konsideruar si shkak i arsyeshëm për përjashtimin e ortakut, është rasti kur ortaku ka shkelur dispozitat e statutit apo detyrimeve të ligjit. Ligji edhe në këtë rast ka zbatuar të njëjtin standard, përsa i përket anës subjektive, apo qëndrimit psikik ortaku, lidhur me veprimet e kryera prej tij në kundërshtim me dispozitat e statutit dhe ligjit. Pra kërkohet si kusht që ortaku ta ketë kryer këtë veprim me faj, në formën e dashjes direkte ose pakujdesisë së rëndë. Por në këtë rast nuk rezulton të jetë përfshirë si kusht domosdoshmëria e pasojës, që është dëmi i shkaktuar shoqërisë. Për rrjedhojë në një interpretim të ngushtë literal të pikës “b” të nenit 102/2, ortaku i SHPK-së do të ishte i ekspozuar ndaj procedurës për përjashtim, në rast se shkel një dispozitë të statutit apo detyrimet e ngarkuara nga ligji. Gjithsesi mospërmbushja e detyrimeve të ortakut në përgjithësi shoqërohet me cenim të interesave të shoqërisë dhe eventualisht shoqërohet me një dëm të caktuar për shoqërinë.

Në praktikën gjyqësore, mund të shtrohet për diskutim dhe dilema nëse përbën shkak për përjashtimin e një ortaku nga shoqëria nje shkelje formale e statutit, por që është e parëndësishme dhe që nuk i shkakton asnjë dëm shoqërisë. A mund të mjaftojë çdo lloj shkeljeje, që sipas pikës “b” e nenit 102/2 të shërbejë si shkak i arsyeshëm për përjashtimin e ortakut? Kjo është një çështje që mbetet për t’u parë, në varësi të mënyrës se si do të zbatohet ky nen nga praktika gjyqësore. Megjithatë në aspektin logjik, jo çdo shkelje formale e dispozitave të statutit do të duhet të shkaktojë domosdoshmërisht përjashtimin e ortakut. Në rast se një veprim apo mosveprim i ortakut, i cili formalisht vjen në kundërshtim me statutin, por nuk i ka sjellë asnjë pasojë të dëmshme shoqërisë, atëherë

⁹⁴⁹ Mamuti (n 946) fq 80; Reinhard Zimmermann, *The Law of Obligations: Roman Foundations of the Civilian Tradition* (Oxford University Press 1996) fq. 209

⁹⁵⁰ Afet Mamuti shprehet që:

“*Culpa lata apo pakujdesia e rëndë shpeshherë barazohet me dashje (culpa lata dolus est), dhe sanksioni për këto dy raste do të jetë i njëjtë. Te pakujdesia e rëndë sjellja e të dëmtuarit kualifikohet si lëshim apo pakujdesi e rëndë. Kjo ndodh kështu për arsye se, shkaktuesi i dëmit në qarkullimin juridik nuk sillet si njeri i arsyeshëm, që në situatë të tillë do të silleshte çdo njeri me nivel dhe vetëdije të zakonshme.*” Mamuti (n 946) fq. 80.

⁹⁵¹ Sevdai Morina, “*Kriteret dhe kushtet që duhet të plotësohen për caktimin e përgjegjësisë civile për dëmin jashtëkontraktor në Republikën e Shqipërisë dhe Republikën e Kosovës*” (Tezë Doktorature, Shkolla Doktorale Universiteti European i Tiranës 2017) fq. 128.

⁹⁵² Rustem Gjata, *Detyrimet Jashtëkontraktore* (Muza 2010) fq. 43.

nuk do të kishte kuptim përjashtimi i ortakut nga shoqëria. Kjo pasi një veprim i tillë do ishte në kundërshtim me parimin e proporcionalitetit, por dhe me vetë frymën dhe qëllimin e marrëveshjes së bashkëpunimit mes ortakëve për themelimin një SHPK-je.

Së treti, në pikën “c” të nenit 102/2 të ligjit, parashikohen si shkak përjashtimi ato veprime të ortakut, të cilat e bëjnë të pamundur vazhdimin e marrëdhënies mes ortakut dhe shoqërisë. Ligji nuk ka bërë një listim të këtyre situatave, pasi do të ishte e vështirë të parashikohen të gjitha rastet, apo veprimet (dhe mosveprimet), me të cilat ortaku e bën të pamundur vazhdimin e marrëdhënies mes tij dhe shoqërisë. Një nga këto raste mund të konsiderohet kur, ortaku sillet me një një indiferentizëm ekstrem për t’u paraqitur në mbledhjet e asamblesë, edhe kur vota e tij është e nevojshme për të marrë vendime të rëndësishme për vazhdimin e aktivitetit tregtar të shoqërisë. Një indiferencë e pajustificuar e ortakut mund të shkaktojë pamundësinë e funksionimit të asamblese për shkak se nuk realizohet kuorumi i vlefshëm për mbledhje. Një situatë e tillë shkakton pamundësinë për të marrë vendime të domosdoshme për shoqërinë, siç janë miratimi i bilanceve, pasqyrave financiare, shpërndarja e fitimit, zmadhimi i kapitalit etj. Gjithsesi nga zhvillimet e praktikës gjyqësore veprimet, të cilat e bëjnë të pamundur vazhdimin e marrëdhënies mes ortakut dhe shoqërisë do të mund të zhvillohen dhe të përcaktohen standarte më të qarta, pasi aktualisht ky formulim lë një hapsirë të gjerë interpretimi.

Së katërti, në pikën “ç” të nenit 102/2, është parashikuar si shkak i arsyeshëm edhe rasti kur ortaku me veprimet e tij pengon ndjeshëm veprimtarinë tregtare të shoqërisë. Kjo është një situatë e cila normalisht lidhet edhe me pikën “a”, që parashikon shkaktimin e dëmit, pasi nga pengimi i veprimtarisë tregtare, në mënyrë të kuptueshme shoqërisë i shkaktohet një dëm ekonomik. Ligji ka vendosur si kusht fjalën “*të ndjeshme*” me qëllim për të saktësuar se pengimi i veprimtarisë ekonomike nga ortaku duhet të jetë në një nivel domethënës dhe jo të papërfillshëm.

Një situatë e tillë e pengimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, në realitet mund (por jo domosdoshmerisht duhet) të shkaktohet duke kryer veprime të cilat janë parashikuar në pikat e mësipërme “a”, “b” dhe “c” të nenit 102/2. Si shembull mund të risjellim rastin i bllokimit të qëllimtë të vendimmarrjes së shoqërisë tregtare nga ortaku mazhoritar, i cili e bën Asamblenë e Ortakëve jofunksionale. Gjithsesi mënyra e formulimit të këtij shkakut, i jep mundësi shoqërisë që të motivojë kërkesën për përjashtim edhe për veprime të tjera të ortakut, të cilat në mënyrë të ndjeshme pengojnë veprimtarinë tregtare të shoqërisë, pavarësisht se nuk provohen shkaqet e tjera të arsyeshme të këtij neni.

Si konkluzion mund të themi se, të gjitha shkaqet e arsyeshme të parashikuara në pikën 2 të nenit 102 të ligjit, janë raste alternative, të cilat nuk është e domosdoshme të mbivendosen, por mjafton të ekzistojë vetëm njëri prej tyre që AO të mblidhet dhe të

vendosë ngritjen e padisë në gjykatë me objekt “Përrjashtimin e ortakut”. Madje AO gjykata mund të pretendojë përjashtimin e ortakut, edhe për raste të tjera tej këtyre pikave, pasi ato kanë kryesisht karakter orientues dhe jo shterues për gjykatën.

Shoqëria që ka kërkuar përjashtimin e ortakut në gjykatë, në bazë të pikës 4 të nenit 102 ka të drejtë që të kërkojë dhe shpërblimin e dëmit të shaktuar nga ortakut, nëse provon se shoqërisë i ka ardhur një dëm nga ky veprim i këtij ortakut.⁹⁵³

Kjo dispozitë parashikon dhe të drejtën e paditësit që; në rast nevojë emergjente, për arsye të justifikuar, t’i kërkojë gjykatës marrjen e masave për sigurimin e padisë, duke pezulluar të drejtën e votës së ortakut, për të cilin është kërkuar përjashtimi, ashtu edhe të drejtatve të tjera, që i burojnë nga zotërimi i kuotës. Në varësi të nevojave dhe riskut potencial, të argumentuar me prova, gjykata mund të pranojë një kërkesë të tillë, qoftë për një apo për të gjitha të drejtat që i rrjedhin ortakut nga kuota në shoqëri. Nëse gjykata do të vendosë një masë të tillë sigurie, atëherë të drejtat e ortakut në shoqëri (vetëm ato të drejta që vlerëson gjykata) do të pezullohen dhe ortakut nuk mund t’i ushtrojë ato deri në përfundim të procesit gjyqësor.

Nga ana tjetër, në rast se kërkesa për përjashtimin e ortakut konsiderohet e pabazuar dhe rrëzohet nga gjykata, atëherë ortakut në bazë të pikës 5 të nenit 102 i lind e drejta që të kërkojë prej shoqërisë të dëmshpërblehet, nëse provon se atij i ka ardhur një dëm nga ky proces i kryer ndaj tij.

7.9.2.1. Likuidimi i kuotës së ortakut që përjashtohet

Në nenin 102 pika 6 në pjesën e parë të fjalisë, është bërë një përcaktim i përgjithshëm, i cili nuk është plotësisht i qartë, përse i përket likuidimit të kuotës së ortakut për të cilin gjykata vendos të pranojë kërkesën për përjashtim. Sipas kësaj dispozite, ortakut nuk ka të drejtë që të kërkojë likuidimin e kuotës në kushtet kur ai është përjashtuar për shkaqe të arsyeshme.

Por në vazhdim të së njëjtës fjali parashikohet se vlera e kuotës së ortakut në shoqëri, mund të përdoret nga ky ortak si kompensim, në rast se shoqëria ngre një padi ndaj ortakut për shpërblimin e dëmit të shkaktuar. Në këtë mënyrë ortakut i njihet e drejta që të përdorë kuotën e tij si mjet për kompensimin e dëmeve të shkaktuara. Ky është një qëndrim i ndryshëm nga pjesa e parë e fjalisë, pasi sipas pjesës së dytë të kësaj fjalie, ortakut që përjashtohet mund të përfitojë nga likuidimi i kuotës dhe ta përdorë këtë pasuri për të shpërblyer një dëm të shkaktuar shoqërisë.

⁹⁵³ Ligji 9901/2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” i ndryshuar, neni 102.

Ndryshe nga rastet e largimit të ortakut, procedura e përjashtimit të ortakut është e kushtëzuar me ekzistencën e shkakut të arsyeshëm në çdo rast. Përjashtimi është një vendim, i cili merret vetëm nga gjykata pasi ka konstatuar se ekzistojnë shkaqet e arsyeshme, përndryshe nuk pranohet kërkesa për përjashtim, pra nuk mund të ketë përjashtim ortaku pa u provuar shkakut i arsyeshëm.

Pika 6 e nenit 102 të ligjit ka përfshirë dy standarte të ndryshme aplikimi, dhe për rrjedhojë nuk rezultojnë të kemi një formulim të qartë përsa i përket së drejtës së ortakut për likuidimin e kuotës në rastin e përjashtimit të tij. Kjo pasi nga njëra anë parashikon rregullin e përgjithshëm sipas të cilit ortaku që përjashtohet për shkaqe të arsyeshme nga shoqëria nuk ka të drejtë të kërkojë likuidimin e kuotës, dhe nga ana tjetër u jep mundësi ortakëve të përjashtuar që i kanë shkaktuar dhe dëm shoqërisë, që ta përdorin kuotën si kompensim për dëmin.

Një përcaktim i tillë, i vendos në pozita jo të barabarta ortakët, të cilët janë përjashtuar për shkaqe të arsyeshme, por që nuk i kanë sjellë një dëm shoqërisë, ose dëmi është në mënyrë domethënëse më i vogël sesa kuota e ortakut në shoqëri.

Në Vendimin Nr. 00-2015-2056 i Vendimit (301) dt. 11.06.2015 të Gjykatës së Lartë,⁹⁵⁴ e cila ka lënë në fuqi vendimet e gjykatave më të ulëta, rezultojnë se është pranuar kërkesa për përjashtimin e ortakut *** për shkaqe të arsyeshme dhe gjykatat kanë vendosur moslikuidimin e kuotës. Gjykatat nuk kanë bërë ndonjë analizë krahasimore mes dëmit të shkaktuar nga ortaku dhe vlerës së kuotës se tij në shoqëri.

Në doktrinën e së drejtës tregtare është mbajtur një qëndrim më tolerant dhe i arsyeshëm, përsa i përket likuidimit të kuotës për ortakun që përjashtohet.⁹⁵⁵ Studiosi Artan Hajdari mendon se duhet bërë një interpretim i zgjeruar i kësaj dispozite, pasi jo në të gjitha rastet ortaku që përjashtohet ka vepruar me faj.⁹⁵⁶ Gjithsesi, në këtë diskutim, treguesi kryesor do të ishte vlera e dëmit të shkaktuar, si dhe e drejta ekskluzive e pronësisë së ortakut mbi kuotën e tij dhe jo faji.

Në vlerësimin tonë, ortaku nuk mund të privohet automatikisht nga e drejta e tij për likuidimin e kuotës në shoqëri edhe në rastin e përjashtimit të tij me shkaqe të arsyeshme, pasi kjo do të binte në kundërshtim me parimet tashmë të konsoliduara të mbrojtjes së të drejtës së pronësisë. E drejta e kuotës, në kuptimin juridik, përfaqëson një të drejtë pronësie

⁹⁵⁴ Vendimin Nr. 00-2015-2056 i Vendimit (301) dt. 11.06.2015 të Gjykatës së Lartë i cili ka lënë në fuqi vendimin Nr.78, datë 07.02.2012 të Gjykatës së Apelit Tiranë, dhe ky i fundit kishte lënë në fuqi Vendimin Nr.7517, datë 03.10.2010 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

⁹⁵⁵ Hajdari (n 210) fq. 58-59.

⁹⁵⁶ Po aty.

mbi një send me vlerë ekonomike dhe si e tillë, gëzon të gjithë mbrojtjen juridike të garantuar nga legjislacioni shqiptar, si dhe Protokolli Nr. 1 i Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut dhe jurisprudenca e Gjykatës së Strasburgut.⁹⁵⁷ Për këtë arsye, është i rekomandueshëm një rishikim i kësaj dispozite nga legjislatori, me qëllim përmirësimin e mënyrës së formulimit, për sa i përket likuidimit të kuotës, në respekt të së drejtës së pronësisë së ortakut mbi kuotën e tij. Ky rast i konfuzionit mbi likuidimin e kuotës, mund të jetë dhe objekt i interpretimit të Gjykatës Kushtetuese në funksion të së drejtës së pronës të garantuar nga neni 41 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. Gjithashtu, një kontribut pozitiv me qëllim unifikimin e praktikës gjyqësore lidhur me këtë çështje, mund të japë Gjykata e Lartë me vendimet e saj.

7.9.2.2. Procedura për përjashtimin e ortakut

Neni 102 i ligjit 9901/2008 i ndryshuar parashikon edhe rregulla proceduralë, për sa u përket hapave që duhet të ndiqen për përjashtimin e një ortaku në SHPK. Instituti i përjashtimit të ortakut, duke pasur parasysh rëndësinë e madhe të pasojave dhe implikimin e interesave të rëndësishëm të ortakëve, është lënë në vlerësimin përfundimtar të gjykatës dhe jo të organeve të shoqërisë.

Shoqëria tregtare nëpërmjet AO ka vetëm të drejtën për të vënë në lëvizje procedurën e përjashtimit të ortakut, duke e diskutuar në mbledhjen e asamblesë, nëse do të ngrihet një padi e tillë për përjashtimin e ortakut apo jo. Në rast se AO, me shumicë të thjeshtë votash, konstaton se ekziston të paktën një shkak i arsyeshëm për përjashtimin e ortakut, atëherë vendos ngritjen e padisë në gjykatë me objekt përjashtimin e ortakut. Është gjykata, që vlerëson bazueshmërinë në prova e në ligj të kësaj padie, e cila nëse konstaton se ekziston të paktën një shkak i arsyeshëm për përjashtimin e ortakut, vendos pranimin e padisë, në të kundërt vendos rrëzimin e saj.

Ligji nuk ka parashikuar një shumicë të cilësuar për vendimin e Asamblesë lidhur me përjashtimin e ortakut. Për rrjedhojë, duhet konsideruar se vendimi i AO, për të paraqitur padi me objekt përjashtimin e ortakut, është një vendim, i cili merret me shumicë të thjeshtë.

⁹⁵⁷ Council of Europe, “Convention for the Protection of Human Rights and Fundamental Freedoms” [1950] OJ Special edition; Protocol 1 to the Convention for the Protection of Human Rights and Fundamental Freedoms [1952] OJ Special edition. Judgment of 18 December 2007, ECHR, *Marini against Albania*, Application no.3738/02; Judgment of 24 October 1995, ECHR, *Agrotexim and Others v. Greece*, Application no 6552/1984. Në çështjen Marini kundër Shqipërisë: “Gjykata vëren se aksionet që i takonin kërkuesit padyshim që kishin vlerë ekonomike që bie në kuptimin e fjalës „pasuri” sipas Nenit 1 të Protokollit 1, duke e bërë këtë nen të aplikueshëm.”.

Në aspektin procedural, vendimi i Asamblesë ku diskutohet përjashtimi i ortakut të shoqërisë duhet të respektojë nenin 86 të ligjit,⁹⁵⁸ sipas të cilit për vendimet që kërkojnë një shumicë të zakonshme, kuorumi minimal i nevojshëm për vlefshmërinë e mbledhjes është pjesëmarrja e ortakëve që disponojnë jo më pak se 30 % të kapitalit.⁹⁵⁹

Duke pasur parasysh frymën e gjerë të autonomisë statutoare që ka lejuar ligji, sidomos përsa i përket rregullimit të marrëdhënieve mes ortakëve, mund të ngrihet pyetja: A mundet statuti të parashikojë një shumicë të cilësuar lidhur me vendimin e AO për të paraqitur padi në gjykatë me objekt përjashtimin e ortakut?

Përgjigjen e kësaj pyetjeje e gjejmë në nenin 103/ 2 të ligjit,⁹⁶⁰ sipas të cilit është sanksionuar një kufizim i lirisë statutoare për këtë lloj vendimarrjeje. Sipas këtij parashikimi ligjor, statuti nuk mund të ndalojë dhe as të kufizojë të drejtën e shoqërisë për të kërkuar përjashtimin e ortakut. Çdo parashikim i statudit për shumicë të cilësuar të vendimmarrjes së AO, për ngritjen e padisë për përjashtimin e ortakut, do të kufizonte të drejtën e shoqërisë për të marrë një vendim të tillë, për rrjedhojë, do të konsiderohet i pavlefshëm në kuptim të nenit 103 të ligjit.

Ndërkohë, siç u analizua më sipër në këtë punim (në analizën e të drejtës së votës), mendojmë se votat e ortakut, për të cilin po iniciohet procedura e përjashtimit, nuk duhet të llogariten as në kuorumin për vlefshmërinë e mbledhjes dhe as në vendimmarrjen e AO për ngritjen ose jo të padisë me objekt përjashtimin e këtij ortaku. Llogaritja në kuorum e votave të këtij ortaku do të mund të përdorej nga një ortak maxhoritar, si mjet për të sabotuar një mbledhje ku diskutohet përjashtimi i tij. Dhe, në këtë mënyrë, të kufizonte të drejtën e ortakëve të tjerë për të iniciuar procedurën gjyqësore të përjashtimit. Por, gjithsesi, ortaku për të cilin synohet përjashtimi, duhet të njoftohet për zhvillimin e mbledhjes dhe rendin e ditës si pjesë e së drejtës së tij për informim. Në aspektin formal, çdo ortak ka të drejtë që të njoftohet për veprimtarinë e shoqërisë dhe aq më tepër të AO. Pra, njoftimi për mbledhjen dhe për rendin e ditës duhet t'i dërgohet edhe ortakut për të cilin kërkohet përjashtimi, pavarësisht se vendimi i AO është vetëm hapi i parë i procedurës dhe nuk sjell asnjë pasojë juridike mbi të drejtat e ortakut. Është gjykata që merr vendimin e përjashtimit, pasi shqyrton padinë e shoqërisë dhe pretendimet e ortakut. Dhe vetëm nëse gjykata pranon padinë, atëherë ky vendim (nëse merr formë të prerë) do të sjellë pasojë mbi të drejtat e ortakut.

⁹⁵⁸ Ligji 9901/2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” i ndryshuar, neni 86.

⁹⁵⁹ Ligji 9901/2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” i ndryshuar, neni 103.

⁹⁶⁰ Neni 103/2 i ligjit 9901/2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” i ndryshuar parashikon se: “Statuti nuk mund të përjashtojë apo të kufizojë të drejtën e ortakut për t'u larguar nga shoqëria dhe të drejtën e shoqërisë për të përjashtuar ortakun”

Praktika Gjyqësore ka qëndrime të ndryshme lidhur me këtë çështje. Në shumë raste rezulton se gjykatat e kanë llogaritur dhe votën e ortakut për të cilin është kërkuar përjashtimi në kuorumin për vlefshmërinë e mbledhjes, si dhe në votim.⁹⁶¹ Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, në Vendimin Nr. 3949 dt. 02.05.2018,⁹⁶² vlerëson se votat e ortakut, për të cilin kërkohet përjashtimi, duhet të llogariten në kuorumin për vlefshmërinë e mbledhjes, por jo në shumicën për vendimmarrje, pasi e konsideron si një nga rastet e nenit 89 të përjashtimit nga e drejta e votës.

Një qëndrim i tillë do të vështirësonte nisjen e procedurës së përjashtimit të ortakut. Sidomos kur ortaku ka një pjesë të konsiderueshme të kapitalit, apo edhe 50% të tij, pasi ky ortak do të bllokonte një vendimmarrje të tillë dhe si rrjedhim, Asambleja e Ortakëve nuk do të mund të merrte një vendim për t'iu drejtuar gjykatës me padinë për përjashtimin e ortakut.

Por ka edhe raste kur gjykatat me të drejtë kanë klasifikuar vendimmarrjen mbi procedurën e përjashtimit të ortakut tek ato vendime ku ortaku nuk ka të drejtë vote, pra si pjesë të nenit 89 të ligjit. Në një konkluzion të tillë ka arritur Gjykata e Apelit Durrës, në Vendimin nr.10-2011-1471(706), datë 01.12.2011,⁹⁶³ ku është shprehur se pavarasësisht se, rasti i vendimmarrjes për përjashtimin e ortakut duhet të konsiderohet që ortaku nuk ka të drejtë vote, pasi AO është mbledhur për të vendosur ngritjen e një padie ndaj tij dhe ortaku ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit.

Vlerësojmë se ky qëndrim është një qëndrim i drejtë. Në rastin e diskutimit për ngritjen padisë së përjashtimit të ortakut nga shoqëria, kjo vendimmarrje e AO duhet të kategorizohet si e përfshirë në rastet e parashikuara nga neni 89 i ligjit 9901/2008. Kjo është një situatë që përputhet plotësisht me rastin e parashikuar nga neni 89/c, që parashikon: “c) ngritjen e një padie ndaj tij nga shoqëria;”⁹⁶⁴

Në procedurën e përjashtimit të ortakut, Asambleja ka pikërisht këtë kompetencë, që të vendosë nëse do të ngrihet kjo padi ndaj ortakut sipas nenit 102. Në këto kushte ortaku

⁹⁶¹ Shih Vendimin nr. 4413, datë 07.04.2014 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

⁹⁶² Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, Vendimi Nr. 3949 dt. 02.05.2018.

⁹⁶³ Vendimi nr.10-2011-1471(706), datë 01.12.2011, Gjykatës së Apelit Durrës, shprehet se:

“Ligji nuk shprehet nëse ortaku për të cilin do të merrret vendim ka të drejtë të marrë pjesë vetë në votim apo jo. Asnjë nga shkaqet për përjashtimin e së drejtës së votës të renditura në nenin 89/1 të Ligjit për Shoqëritë Tregtare nuk i referohet këtij rasti në mënyrë direkt. Gjithsesi, të lejojsh ortakun e interesuar të votojë kundër përjashtimit të tij qartësisht e bën më të vështirë për shoqërinë që të “heqë qafe” një ortak dhe nëse përjashtimi i tij do të jetë tërësisht i justifikuar nga sjellja e tij, dhe e bën praktikisht të pamundur të përjashtosh një ortak maxhoritar. Për shkaqe politikash, për rrjedhojë, mund të konsiderohet zgjerimi i nenit 89/1 të Ligjit për Shoqëritë Tregtare ku të përfshihet edhe situata kur Asambleja e Përgjithshme vendos lidhur me përjashtimin.....Vendimi i Asamblesë së Përgjithshme është vetëm një hap drejt përjashtimit.”

⁹⁶⁴ Ligji 9901/2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” i ndryshuar, neni 89 pika “c”.

ndaj të cilit mund të ngrihet padia është qartësisht në kushtet e konfliktit të interesit dhe ky është një rast i përfshirë në pikën “c” të nenit 89 të ligjit, sipas të cilit ortakut përjashtohet nga e drejta e votës në asamble.

Por, gjithashtu, një vendimmarrje e tillë mund të kategorizohet edhe sipas pikës “a” të nenit 89 (“a) vlerësimin e veprimtarisë së tij;”), e cila parashikon rastin kur asambleja mbledhet për të vlerësuar veprimtarinë e një ortakut të shoqërisë.⁹⁶⁵ Për pasojë, ortakut, për të cilin AO po merr këtë vendim për vlerësimin e veprimtarisë së tij, duhet të përjashtohet nga e drejta e votës, sipas nenit 89/a të ligjit.

Si konkluzion mund të themi se, vendimi për t’iu drejtuar gjykatës për përjashtimin e ortakut, përfshihet në rastet e nenit 89 pika 1 e ligjit, i cili parashikon përjashtimin e ortakut nga e drejta e votës.⁹⁶⁶ Si rrjedhim edhe kuorumi i nevojshëm për marrjen e një vendimi për të filluar procedurën e përjashtimit të ortakut, nuk duhet të marrë në konsideratë kuotën apo votat e ortakut, për të cilin do të fillojë procedura e përjashtimit të tij nga shoqëria.

Roli i administratorit në procedurën e përjashtimit të ortakut, sipas nenit 102 të ligjit, nuk rezulton t’i jetë kushtuar një vëmendje e veçantë në ligj. Por, në kushtet kur administratori prezumohet se është në dijeni të çdo problematike që përballet shoqëria në aktivitetin e saj, ai mund të luajë një rol të rëndësishëm koordinativ për t’i vënë ortakët në dijeni, për rrethanat potencialisht të disfavorshme të ardhura nga njëri prej ortakëve të shoqërisë.

Megjithëse administratori nuk ka asnjë kompetencë vendimmarrjeje përsa i përket përjashtimit të ortakut nga shoqëria, ai si përfaqësues i shoqërisë duhet ta thërrasë mbledhjen e AO për këtë qëllim. Administratori duhet të informojë Asamblenë për veprimet apo mosveprimet e secilit ortak, të cilat mund të përbëjnë shkaqe të arsyeshme për përjashtimin e tij. Gjithashtu, administratori i shoqërisë përfaqëson shoqërinë në gjykimin e nisur me objekt përjashtimin e ortakut.

7.9.2.3. Legjitimimi aktiv në ngritjen e padisë

Legjitimimi aktiv për ngritjen e padisë me objekt përjashtimin e ortakut, në kushte normale i takon vetë shoqërisë, e cila është e përfaqësuar nga administratori. Ekzistenca e një vendimi paraprak të Asamblesë është kusht i domosdoshëm për legjitimimin e paditësit në padinë me objekt përjashtimin e ortakut. Ligji në fuqi, nuk përjashton edhe mundësinë që një ose disa ortakë, që janë në minorancë, të kërkojnë mbledhjen e asamblesë për të përjashtuar një ortak mazhoritar, i cili është në kushtet e nenit 102. Por, edhe në këtë rast, duhet të respektohet procedura për thirrjen e AO me rendin e ditës të përcaktuar për

⁹⁶⁵ Ligji 9901/2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” i ndryshuar, neni 89 pika “a”.

⁹⁶⁶ Ligji 9901/2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” i ndryshuar, neni 89.

përrjashtimin e ortakut mazhoritar. Në vendimin e saj **** Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës e pranon konceptin e përrjashtimit të ortakut mazhoritar nga shoqëria, por me kushtin që të ezaurohet procedura për thirrjen e Asamblesë së Ortakëve.⁹⁶⁷ Në rast të refuzimit për të thirrur AO, apo mungesës së një vendimmarrjeje në asamble, atëherë do të legjitimoheshin ortakët në minorancë, si asamble përfaqësuese e shoqërisë që t'i drejtohen gjykatës me kërkesën për përrjashtim në përputhje me nenin 92/6 të ligjit 9901/2008.

Edhe në praktikën gjyqësore, është konfirmuar qëndrimi, sipas së cilit ortaku i shoqërisë nuk legjitimohet në ngritjen e kësaj padie, nëse nuk është respektuar më parë procedura e mbledhjes dhe vendimmarrjes në asamblenë e ortakëve, për të ngritur një padi të tillë.⁹⁶⁸ Në vendimin Nr.(11-2015-3451) 1280 datë 13.07.2015, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës⁹⁶⁹ ka vendosur “Rrëzimin e padisë” për përrjashtimin e ortakut, pasi ka vlerësuar se ortaku nuk legjitimohet në një kërkim të tillë, për sa kohë nuk është kërkuar thirrja e asamblesë për të vendosur ngritjen e padisë për përrjashtimin e ortakut.

Qëllimi i ligjvënësit në përcaktimin e shoqërisë si palë që gëzon legjitimitimin aktiv në padinë për përrjashtimin e ortakut, është në harmoni me frymën e dispozitave të tjera të Ligjit Nr.9901/2008, për sa i përket rregullimit të marrëdhënieve mes ortakëve të shoqërisë prej vetë organit të saj vendimmarrës, që është asambleja. Vetëm në raste përrjashtimore, kur konflikti nuk zgjidhet nga AO, përcaktohet gjykata si organ kompetent për zgjidhjen e konfliktit. Kjo është dhe fryma e legjislacionit të vendeve të BE në fushën e së drejtës tregtare, si dhe legjislacionit anglez, që kanë shërbyer si modele në kohën e përgatitjes dhe miratimit të ligjit 9901/2008.⁹⁷⁰

Mund të ndodhë që ortaku, i cili ka dhe cilësinë e administratorit, të jetë në kushtet e parashikuara nga neni 102 të ligjit, pra të ketë kryer veprime apo mosveprime, të cilat përbëjnë shkak të arsyeshëm për përrjashtimin e tij. Kjo do të ishte një situatë më e ndërlikuar në aspektin procedural, pasi në këtë rast, ky ortak, në cilësinë e administratorit,

⁹⁶⁷ Shih Vendimin Nr.(11-2015-3451) 1280 datë13.07.2015 Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës ku arsyetohet se:

“Gjykata vëren se padia për kërkimin e përrjashtimit të ortakut mazhoritar nga ortaku i pakicës në emër të shoqërisë njihet në doktrinën e së drejtës tregtare si padi e prejardhur/derivative (actio pro socio), e cila mund të ngrihet vetëm në ato raste kur ortaku i pakicës arrin të provojë të paktën në dukje (prima facie) përpara Gjykatës mungesën e vendimmarrjes së Asamblesë së Përgjithshme lidhur me kërkesën e tij, ose refuzimin e Asamblesë për të vendosur për kërkesën e ortakut.”

⁹⁶⁸ Shih vendimin Nr. 1916 dt 13.09.2017 të Gjykatës së Apelit Tiranë, i cili ka lënë në fuqi vendimin Nr. 9669 dt.09.12.2015 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

⁹⁶⁹ Shih Vendimin Nr.(11-2015-3451) 1280 datë13.07.2015 Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës.

⁹⁷⁰ Shih çëshjen e gjykatës angleze Court of Chancery, *Foss v. Harbottle (1843) 67 ER 189*, rregulli kryesor i të cilit është se:

“Gjykata, si rregull, nuk duhet të ndërhyrë në çështje që i përkasin vetë shoqërisë t'i zgjidhë, ose që i përkasin të verifikojë apo rregullojë sipas procedurave të saj në raste parregullish. Në rastet që pretendohet se shoqërisë i është shkaktuar një dëm, prima facie, i vetmi paditës i legjitimuar për të ngritur kërkimin është vetë shoqëria”.

do të ndodhë në konflikt të qartë interesi dhe mund të refuzojë që të kryejë veprimet për mbledhjen e AO.

Në një rast të tillë hipotetik, ortakët e tjerë kanë të drejtën që të thërrasin vetë mbledhjen e asamblesë në përputhje me parashikimet e nenit 83 dhe 84 të ligjit 9901/2008⁹⁷¹ dhe të vendosin në cilësinë e AO, nëse do të paraqitet kërkesë në gjykatë për përjashtimin e ortakut. Kjo dispozitë e kombinuar edhe me nenin 92 të ligjit ofron zgjidhjen procedurale për ortakët, të cilët administratori tenton t'i pengojë në të drejtat e tyre për të iniciuar procedurën e përjashtimit të ortakut.

Në një situatë të tillë, do të shtrohej për diskutim edhe çështja se cila do të jetë pala që gëzon të drejtën e legjitimitit aktiv në gjykatë, në padinë me objekt përjashtimin e ortakut. Është e qartë, që në një rast të tillë shoqërinë nuk mund ta përfaqësojë administratori, pasi jemi në kushtet e konfliktit të interesit dhe administratori është vetë ortaku i paditur, për të cilin kërkohet përjashtimi.

Sipas praktikës së Gjykatës së Lartë, asambleja e ortakëve të shoqërisë nuk gëzon personalitet juridik dhe nuk mund të paraqitet si palë paditëse.⁹⁷² Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, me Vendimin Nr. 165 dt.18.05.2016, ka konkluduar se Asambleja e Ortakëve nuk mund të legjitimohet si palë paditëse në procesin me objekt përjashtimin e ortakut dhe për pasojë, ka vendosur prishjen e vendimeve të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë⁹⁷³ dhe Vendimit të Gjykatës së Apelit⁹⁷⁴, të cilat kishin pranuar padinë e Asamblesë së Ortakëve të shoqërisë për përjashtimin e ortakut.

Megjithatë, ky qëndrim i Gjykatës së Lartë në disa raste të praktikës gjyqësore rezultoi të jetë vënë në diskutim duke u legjitimuar si palë ndërgjyqëse edhe Asambleja e ortakaëve. Qendrimet e tilla kontradiktore duket se janë mbështetur nga një interpretim jo i thelluar dhe harmonik i dispozitave të ligjit 9901/2008 të posaçëm, i cili parashikon disa raste përjashtimore kur asambleja e ortakëve mund të jetë në rolin e përfaqësuesit të shoqërisë.

Ligji 9901/2008, në nenin 92 pika 1,⁹⁷⁵ në një interpretim literal të tij, i jep të drejtë asamblesë së ortakëve që të ngrejë padi ndaj administratorit apo ortakëve të shoqërisë, pasi të ketë marrë një vendim me shumicë të cilësuar. Nga formulimi i nenit 92/1 dhe nenit 81

⁹⁷¹ Ligji 9901/2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" i ndryshuar, nenet 86-84.

⁹⁷² Shih Vendimin Nr 00-2016-1773 i Vendimit (165) dt.18.05.2016 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.

⁹⁷³ Shih Vendimin Nr nr.113 akti, datë 16.01.2013 të Gjykatës e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

⁹⁷⁴ Shih Vendimin nr.82, date 19.03.2013 Gjykata e Apelit Tiranë.

⁹⁷⁵ Neni 92/1 I Ligjit 9901/2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" i ndryshuar përcakton që:

"1. Asambleja e përgjithshme, në bazë të një vendimi të marrë me shumicën e përcaktuar sipas pikës 2, neni 87, të këtij ligji, ka të drejtë të ngrejë padi përpara gjykatës kompetente për shfuqizimin e vendimeve të administratorëve, si pasojë e shkeljes së rëndë të ligjit ose të statutit dhe/ose padi të tjera që parashikon ky ligj ose statuti ndaj administratorëve apo ortakëve."

të ligjit, duket sikur ligji legjitimon organin e asamblesë së ortakëve të shoqërisë për të ngritur padinë në gjykatë. Në praktikën gjyqësore hasen jo pak raste, kur Asambleja e Ortakëve është legjitimuar si palë paditëse në padinë me objekt përjashtimin e ortakut. Por, në kushtet kur asambleja nuk gëzon personalitet juridik, një qëndrim i tillë do të binte ndesh me parimet procedurale civile⁹⁷⁶ dhe qëndrimin e praktikës gjyqësore.⁹⁷⁷

Por, ky diskutim rreth legjitimitit procedural zgjidhet nga paragrafi i tretë i nenit 92 të ligjit, i cili ka rregulluar më qartë mënyrën e përfaqësimit të shoqërisë në rastin e një gjykimi me objekt një kërkim ndaj administratorit të saj, duke parashikuar se: *“Në rastet kur shoqëria ngre padi si më sipër, ajo merr pjesë në gjykim me anë të një përfaqësuesi të posaçëm, të caktuar nga asambleja e përgjithshme”*⁹⁷⁸ Kjo dispozitë duhet lezuar në harmoni edhe me nenet 92/1 dhe 81 të Ligjit 9901/2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” i ndryshuar.

Në këto rrethana, duhet bërë një interpretim i zgjeruar i nenit 81 pika 1 gërma “g”, dhe nenit 92 pika 1 duke i njohur Asamblesë së Ortakëve të drejtën për të përfaqësuar shoqërinë vetëm në kuptimin e funksionimit të brendshëm të shoqërisë tregtare në raport me organet e saj, por jo në kuptimin e legjitimitit procedural formal në gjykatë.

Në këto lloj konfliktesh gjyqësore me administratorët, Asambleja merr kompetenca për përfaqësimin e shoqërisë, por ajo detyrimisht duhet të caktojë një përfaqësues të posaçëm për t’u paraqitur në gjykim, pasi vetë asambleja nuk ka personalitet juridik dhe nuk mund të jetë palë ndërgjyqëse.

Në këto raste legjitimimi aktiv si palë paditëse i takon shoqërisë, e përfaqësuar në gjykim nga një përfaqësues i posaçëm (ortak apo avokat etj.) i caktuar me vendim të Asamblesë së Ortakëve. Ndërsa në rastet kur administratori nuk ka asnjë konflikt interesi me këtë gjykim, atëherë do të jetë vetë administratori që përfaqëson shoqërinë.

Pra, mund të themi se kjo procedurë përbën një mënyrë specifike përjashtimore të zëvendësimit të administratorit të shoqërisë me një person tjetër, i cili kryen rolin e përfaqësuesit ligjor të përkohshëm të saj dhe me tagër të posaçëm që është i përcaktuar në këtë vendimarrje të asamblesë.

⁹⁷⁶ Neni 90 i Kodit të Procedurës Civile parashikon se *“Palë në një gjykim civil janë personat fizikë ose juridikë, në emër ose kundër të cilëve zhvillohet gjykimi. Askush nuk mund të përfaqësojë në një gjykim civil të drejtat e të tjerëve, përveç kur ligji parashikon ndryshe.”*

⁹⁷⁷ Shih Vendimin Nr 00-2016-1773 i Vendimit (165) dt.18.05.2016 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.

⁹⁷⁸ Ligji 9901/2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” i ndryshuar, neni 92 pika 3.

Përsa i përket legjitimitetit pasiv, është e qartë, që palë e paditur në gjykimin për përjashtimin e ortakut do të jetë vetë ortakut për të cilin kërkohet përjashtimi nga shoqëria.

KREU VIII

8. Prishja e Shoqërisë, Likuidimi dhe Falimentimi i saj

8.1. Shkaqet e prishjes së SHPK-së

Me prishjen e shoqërisë kuptojmë vërtetimin e një rrethane, e cila i jep fund aktivitetit tregtar të kësaj shoqërie dhe aplikimin e procedurave përfundimtare për likuidimin dhe më pas çregjistrimin e këtij personi juridik nga QKB. Me çregjistrimin e shoqërisë nga Regjistri Tregtari i QKB, shoqëria humbet personalitetin juridik.⁹⁷⁹ Në nenin 99 të ligjit 9901/2008 janë parashikuar dhe rastet e prishjes së SHPK-së.⁹⁸⁰ Sipas këtij neni janë renditur në një listë joshteruese, shkaqet kryesore, të cilat shkaktojnë prishjen e shoqërisë, e cila pasohet me aplikimin e procedurave të likuidimit dhe çregjistrimit nga QKB. Në pjesën më të madhe të këtyre rasteve, siç do të shpjegohen në vijim, procedura e prishjes kryhet me vendim të asamblesë me shumicë të cilësuar.⁹⁸¹

Në këtë listë mund të grupojmë dy kategori shkaqesh; ato të cilat vijnë nga vullneti i ortakëve (apo shumicës së tyre në AO), si dhe shkaqet që nuk vijnë drejtpërdrejt nga vullneti i ortakëve dhe organi vendimmarrës (AO), por nga rrethana të tjera.

Në grupin e shkaqeve që burojnë nga vullneti i ortakëve hyjnë rastet e mëposhtme: Së pari, Neni 99/1 “a” i ligjit parashikon përfundimin e afatit të kohëzgjatjes së shoqërisë tregtare, i parashikuar në statut. Ky lloj shkaku paraqitet vetëm në ato raste kur në statutin

⁹⁷⁹ Ligji 9723/2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit” i ndryshuar, nenet 43; 48-53 dhe Ligjin 8/2015 “për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9723, datë 3.5.2007, “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit” [2015] FZ 32.

⁹⁸⁰ Ligji 9901/2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” i ndryshuar, neni 99. Në paragrafin e parë parashikohen shkaqet e prishjes së shoqërisë, si më poshtë:

1. Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar priset:

- a) kur mbaron kohëzgjatja, për të cilën është themeluar;
- b) me përfundimin e procedurave të falimentimit apo në rast të pamjaftueshmërisë së pasurive për të mbuluar shpenzimet e procedurës së falimentimit;
- c) në rast se objekti bëhet i perealizueshëm për shkak të mosfunksionimit të vazhduar të organeve të shoqërisë apo për shkaqe të tjera që e bëjnë absolutisht të pamundur vazhdimin e veprimtarisë tregtare;
- ç) në rastet e pavlefshmërisë së themelimit të shoqërisë, të parashikuara nga neni 3/1 i këtij ligj;
- d) në raste të tjera, të parashikuara në statut;
- dh) në raste të tjera, të parashikuara me ligj;
- e) për çdo shkak tjetër të vendosur nga asambleja e ortakëve.”

⁹⁸¹ Neni 99/2 i Ligjit 9901/2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” i ndryshuar parashikon se: “Prishja e shoqërisë, si pasojë e një apo më shumë prej shkaqeve të përcaktuara në shkronjat “a”, “c”, “d”, “dh” dhe “e”, të pikës 1, të këtij neni, vendoset nga asambleja e ortakëve me shumicën e parashikuar sipas pikës 1, të nenit 87, të këtij ligji.”

e shoqërisë është parashikuar një afat i caktuar për kohëzgjatjen e veprimtarisë tregtare. Në rast se përmbushet ky afat, dhe shoqëria nuk ka ndryshuar dispozitën e statutit, që përcakton këtë afat, atëherë kjo shoqëri duhet të prishet. Vendimin për prishjen e shoqërisë e merr Asambleja e Ortakëve dhe në mungesë të veprimit të saj, çdo person i interesuar ka të drejtë që t'i kërkojë gjykatës të vendosë prishjen e shoqërisë me vendim gjyqësor. Ky shkak për prishjen e shoqërisë mund të shmanget duke mos parashikuar një kohëzgjatje pa afat në statutin e shoqërisë, ose duke e ndryshuar statutin me vendim të AO para se të përfundojë afati.

Së dyti, *Neni 99/1 "d"* i ligjit 9901/2008 i ndryshuar përcakton që prishja e shoqërisë mund të ndodhë edhe në raste të tjera të parashikuara në statutin e shoqërisë. Ligji i ka dhënë një autonomi të konsiderueshme vullnetit të ortakëve themelues të shprehur në statut. Pra statuti mund të parashikojë edhe situata të tjera apo fakte dhe rrethana të caktuara, me vërtetimin e të cilave të plotësohet kushti për prishjen e shoqërisë. Në mënyrë të ngjashme si me përfundimin e kohëzgjatjes, edhe në rastet e tjera të parashikuara në statut si kusht për prishjen e shoqërisë, kompetente për të konstatuar këtë shkak dhe për të vendosur prishjen e shoqërisë është AO. Në nenin 99/3 të ligjit parashikohet që në rast mosveprimi të AO, çdo person i interesuar mund t'i drejtohet gjykatës për të konstatuar prishjen e shoqërisë.

Së treti, gjithashtu prishja e shoqërisë mund të bëhet për shkak të vullnetit momental të Asamblesë dhe një vendimi me shumicë të cilësuar (sipas nenit 87 të ligjit) të saj ku shumica prej 2/3 të ortakëve shprehin vullnetin për t'i dhënë fund aktivitetit tregtar dhe për të prishur shoqërinë, pa pasur asnjë nevojë për të argumentuar me një shkak apo motiv (*Neni 99/1 "e"*)⁹⁸².

Në grupin e shkaqeve që nuk vijnë drejtpërdrejt nga vullneti i ortakëve janë si vijon: Së pari, prishja e shoqërisë për shkak të paaftësisë pagueuse të saj, pra situatës së falimentimit të vërtetuar në gjykatë sipas ligjit 110/2016 "Për Falimentin" (*Neni 99/1 "b"*)⁹⁸³ Sipas këtij ligji parashikohen dy situata të përfundimit të procedurës.⁹⁸⁴ Njëra që në fazën e parë, në rast të pamjaftueshmërisë së pasurive për të mbuluar shpenzimet e procedurës së falimentimit,⁹⁸⁵ nuk kalohet në fazën e dytë të çeljes së procedurës së falimentit dhe shoqëria, sipas nenit 99/5, konsiderohet e prishur, pavarësisht se gjykata rrëzon kërkesën për çeljen e procedurës së falimentit. Ndërsa situata tjetër, në përfundim të procedurës së falimentit, me likuidimin e pasurive të shoqërisë. Në përfundim të të dyja këtyre procedurave subjekti çregjistrohet nga regjistri tregtar i QKB.⁹⁸⁶ Procedura e falimentit

⁹⁸² Ligji 9901/2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" i ndryshuar, neni 99/1.

⁹⁸³ Ligji 9901/2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" i ndryshuar, neni 99 /1.

⁹⁸⁴ Ligji 9901/2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" i ndryshuar, neni 99/5.

⁹⁸⁵ Ligji 110/2016 "Për Falimentimin", neni 20.

⁹⁸⁶ Ligji 9901/2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" i ndryshuar, neni 100.

mund të vihet në lëvizje pranë gjykatës me kërkesë të vetë shoqërisë debitoare apo të çdo kreditori të saj.⁹⁸⁷

Rasti i dytë është prishja e shoqërisë për shkak se objekti i veprimtarisë tregtare bëhet i perealizueshëm (*Neni 99/1 "c"*).⁹⁸⁸ Një situatë e tillë, mund të ndodhë në rast se shoqëria ka përcaktuar në statutin e saj një objekt veprimtarie, i cili për rrethana të pavaruara nga vullneti i ortakëve, bëhet i pamundur për t'u ushtruar në vazhdim. Psh. në rast se objekti parashikon kultivimin e kulturave bujqësore në një territor të caktuar, i cili, për shkak të ndërimit të një dige për liqen artificial, tokat përmythen dhe nuk mund të kultivohen. Vendimin për prishjen e shoqërisë në një rast të tillë e merr Asambleja e Ortakëve dhe në mungesë të veprimit të saj, çdo person i interesuar ka të drejtë që t'i kërkojë gjykatës të vendosë prishjen e shoqërisë me vendim gjyqësor. Ky shkak për prishjen e shoqërisë mund të evitohet duke ndryshuar statutin e shoqërisë në rubrikën e objektit të veprimtarisë dhe duke përcaktuar një objekt të realizueshëm.

Së treti, Neni 99/1 "c" përcakton që prishja e shoqërisë për shkak të mosfunksionimit të vazhduar të organeve të shoqërisë, apo për shkaqe të tjera që e bëjnë absolutisht të pamundur vazhdimin e veprimtarisë tregtare. Në këtë kategori përfshihen ato raste kur mes ortakëve të shoqërisë ka një situatë konfliktuale, e cila bën të pamundur funksionimin e organeve drejtuese të saj si Asambleja e Ortakëve apo administratorit. Psh. në kushtet kur statuti parashikon një shumicë të cilësuar për zgjedhjen administratorit, por kjo shumicë nuk arrihet të realizohet në mënyrë të vazhdueshme, edhe pasi administratorit të mëparshëm i ka mbaruar mandati. Ose rastet, kur ortakët që disponojnë një pjesë të konsiderueshme të kapitalit nuk paraqiten vetë, apo me përfaqësim në asamblenë e shoqërisë, duke bërë kështu të pamundur realizimin e kuorumit për vendime të domosdoshme. Në një rast të tillë vendimin për prishjen e shoqërisë e merr Asambleja e Ortakëve dhe në mungesë të veprimit të saj, çdo person i interesuar ka të drejtë që t'i kërkojë gjykatës të vendosë prishjen e shoqërisë me vendim gjyqësor. Gjykata e Lartë⁹⁸⁹ ka lënë në fuqi vendimet e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor dhe të Apelit sipas të cilave është rrëzuar padia e ortakut minoritar, i cili duke u nisur nga mosmarrëveshjet e vazhdueshme, ka kërkuar prishjen dhe likuidimin e shoqërisë me argumentimin se shoqëria *** nuk ndodhet në kushtet e pamundësisë së vazhdimit të veprimtarisë dhe mosfunksionimit të organeve të saj, pasi ortaku i paditur disponon 66.66% të kapitalit dhe kjo i jep mundësi që të bëjë funksionale mbledhjen e asamblesë së ortakëve dhe të ketë vendimmarrje⁹⁹⁰. Një

⁹⁸⁷ Ligji 110/2016 "Për Falimentin", neni 13.

⁹⁸⁸ Ligji 9901/2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" i ndryshuar, neni 99/1.

⁹⁸⁹ Vendimi Nr.00-2014-3076 i Vendimit (476) dt. 18.09.2014, i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, i cili ka lënë në fuqi Vendimin Rr.494, datë 18.11.2010 e Gjykatës së Apelit Tiranë, e cila kishte "*Lënien në fuqi të vendimit nr.4025, datë 17.05.2010, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë*".

⁹⁹⁰ Vendimi Nr.00-2014-3076 i Vendimit (476) dt. 18.09.2014, i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë,

qëndrim të ngjashëm ka mbajtur Gjykata e Lartë edhe në Vendimin Nr.00-2012-1830 i Vendimit (232) datës 08.05.2012, të Kolegjit Civil.⁹⁹¹

Një alternativë e mundshme për të evituar prishjen e shoqërisë, në rastet kur një ortak për arsye të tij subjektive (te qëllimita) bëhet shkak për mosfunksionimin e organeve të shoqërisë, do të ishte dhe aplikimi i dispozitave për përjashtimin e ortakut, i parashikuar në nenet 102-103 të ligjit.⁹⁹² Gjithashtu, nëse ekzistojnë kushtet e nenit 101 të ligjit, një mënyrë tjetër alternative për të shmangur prishjen e shoqërisë, do të ishte aplikimi i nenit 101 nga ortaku që vlerëson se ndodhet në kushtet e largimit dhe likuidimit të kuotës dhe shmangia kështu e situatës konfliktuale në shoqëri.⁹⁹³

Së katërti, Neni 99/1 “ç” i ligjit, parashikon që një prej rasteve të prishjes së shoqërisë është rasti i vërtetimit të pavlefshmërisë së themelimit të shoqërisë, i parashikuar nga neni 3/1 i ligjit. Pas ndryshimeve që iu bënë ligjit 9901/2008, në vitin 2014, me nenin 3/1 të ligjit u shtuan dhe shkaqet e pavlefshmërisë së themelimit të shoqërisë.⁹⁹⁴ Megjithatë, duhet nënvizuar se në shumicën e rasteve ligji parashikon mundësinë e riparimit të pavlefshmërive. Në rast se shkak i pavlefshmërisë është kuruar (riparuar) atëherë shoqëria nuk mund të priset. Prishja e shoqërisë mund të ndodhë vetëm në rast të një pavlefshmërie absolute të riparueshme.

Së pesti, prishja e shoqërisë për arsye të tjera të parashikuara me ligj.⁹⁹⁵ Me këtë formulim ligji ka parashikuar dhe mundësinë që në dispozita të tjera ligjore të parashikohet prishja e shoqërisë. Për shembull, një rast i tillë është kur ndaj SHPK-së jepet një dënim penal me mbyllje të personit juridik i parashikuar në nenin 9 të Ligjit Nr.9754, datë 14.6.2007 “Për Përgjegjësinë Penale të Personave Juridikë”.⁹⁹⁶ Vendimin për prishjen e shoqërisë në një rast të tillë e merr Asambleja e Ortakëve dhe në mungesë të veprimit të saj, çdo person i interesuar ka të drejtë që t’i kërkojë gjykatës të vendosë prishjen e shoqërisë me vendim gjyqësor.

Në nenin 99 pika 4 parashikohet edhe mundësia e korigjimit të shkaqeve të prishjes së shoqërisë të parashikuara në shkronjat "a", "c", "d", "dh" dhe "e", të pikës 1, për të cilat i është lënë vetë Asamblesë së Ortakëve fillimisht, kompetenca e konstatimit të një situatë të tillë. Madje AO mund të marrë masa për të korigjuar shkakun e prishjes deri sa nuk

⁹⁹¹ Vendimi Nr.00-2012-1830 i Vendimit (232) datës 08.05.2012. i Kolegjit Civi të Gjykatës së Lartë.

⁹⁹² Ligji 9901/2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” i ndryshuar, nenet 102 dhe 103 dhe trajtimin e këtij instituti në Kreun VII pika 7.9.2, të këtij punimi.

⁹⁹³ Për më shumë rreth përjashtimit dhe largimit të ortakut të SHPK-të shih Kreun VII, pika 7.9 në këtë punim, “7.9. Largimi dhe Përjashtimi i ortakëve”.

⁹⁹⁴ Për më shumë rreth pavlefshmërive të themelimit të SHPK-së shih Kreun V, pika 5.6, në këtë punim, “5.6. Pavlefshmëritë e themelimit të shoqërive me përgjegjësi të kufizuar”

⁹⁹⁵ Ligji 9901/2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” i ndryshuar, neni 99/1 “dh”.

⁹⁹⁶ Ligji 9754/2007 “Për Përgjegjësinë Penale të Personave Juridikë” [2007] FZ 77, neni 9.

është marr një vendim gjyqësor i formës së prerë sipas pikës 3 të nenit 99. Por korrigjimi i shkakut të prishjes së shoqërisë duhet të publikohet në QKB.⁹⁹⁷

Si konkluzion, mund të themi se këto parshikime të nenit 99/4 i shërbejnë AO të shoqërisë si mekanizëm për të bërë të gjitha përpjekjet e mundshme që të shmangin prishjen e shoqërisë dhe të bëjnë të mundur korrigjimin e shkakut të prishjes. Qëllimi i nxitjes së shoqërive që të korrigjojnë shkaqet e prishjes dhe të shmangin mbylljen e veprimtarisë ekonomike, i shërben mjedisit ekonomik të shoqërisë, pasi çdo shoqëri tregtare që prishet ka një efekt jo të dëshiruar në aspektin e ekonomisë së vendit.

Ndërsa, për shkaqet e parashikuara në shkronjat “b” dhe “ç” të nenit 99/1 (që lidhen me falimentimin e shoqërisë dhe pavlefshmërinë absolute të themelimit) të cilat janë shkaqe që vërtetohen me vendim gjyqësor të formës së prerë, prishja e shoqërisë është një efekt (pasojë) e menjëhershme, që shoqëron konstatimin e këtyre shkaqeve.

Sipas nenit 100 të ligjit 9901/2008 përcaktohen edhe detyrimet procedurale të regjistrimit të vendimit të prishjes së shoqërisë në QKB. Për të gjitha rastet, kur vendimi i prishjes së shoqërisë është marrë me vendim të Asamblesë së Ortakëve të shoqërisë, do të jetë detyrim i administratorëve të kësaj shoqërie, që të regjistrojnë këtë vendim në QKB sipas nenit 43 të ligjit 9723/2007. Ndërsa, kur vendimi për prishjen e SHPK-së është marrë nga gjykata, atëherë është vetë gjykata që njofton QKB me këtë vendim dhe prishja regjistrohet në përputhje me nenin 45 dhe 51 të ligjit 9723/2007 për QKB.

Vendimi i prishjes së shoqërisë pavarësisht nëse është marrë nga AO apo nga gjykata, nuk i heq automatikisht personalitetin juridik shoqërisë, pasi shoqëria duhet të kryejë dhe një procedurë tjetër të rëndësishme para se të çregjistrohet nga QKB. Kjo procedurë është likuidimi i shoqërisë dhe zgjat deri në kryerjen e plotë të saj, pa pasur një kushtëzim kohor të përcaktuar në ligj. Gjatë kësaj kohë shoqëria e ruan personalitetin juridik dhe mund të jetë edhe palë ndërgjyqëse.⁹⁹⁸

8.2. Likuidimi i SHPK-ve

Likuidimi i shoqërive është një koncept i cili lidhet me sistemimin e të gjitha logarive financiare të shoqërisë, shlyerjen e debitorëve dhe vjeljen e kredive, si dhe disponimin përfundimtar të aseteve dhe kapitaleve të mbetura në shoqëri, pasi është marrë vendimi i prishjes së shoqërisë. Likuidimi i shoqërisë sipas parashikimeve të ligjit 9901/2008 është një procedurë që vijon menjëherë pas vendimit të prishjes së shoqërisë dhe kryhet vetëm

⁹⁹⁷ Ligji 9901/2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” i ndryshuar, neni 99/4.

⁹⁹⁸ Argita Malltezi, *E drejta shqiptare e shoqërive tregtare* (Shtëpia botuese “Mediaprint” 2011) fq. 305.

nëse shoqëria është në kushtet e aftësisë paguese për të shlyer të gjitha detyrimet e kreditorëve. Pra, kapitalet e shoqërisë duhet të jenë më të mëdha sesa detyrimet e saj.

Në ligjin 9901/2008 njihen dy mënyra të kryerjes së likuidimit. Mënyra e parë është likuidimi i zakonshëm i rregulluar në nenet 190-203 të ligjit.⁹⁹⁹ Ndërsa mënyra e dytë është likuidimi i thjeshtëzuar i rregulluar në nenet 204-205 të ligjit.¹⁰⁰⁰ Në rast se SHPK-ja ndodhet në kushtet e paaftësisë paguese, pavarësisht nëse ky fakt konstatohet para apo pas vendimit të prishjes, nuk mund të aplikohen dispozitat e sipërcituara për likuidimin, por duhet të aplikohet ligji 110/2016 “Për Falimentimin”.

8.2.1. Likuidimi i zakonshëm

Me caktimin e likuiduesit, detyra e administratorit përfundon. Likuiduesi i shoqërisë zëvendëson administratorin (apo administratorët) e saj duke marrë të gjitha kompetencat e përfaqësimit të shoqërisë, si dhe të administrimit të saj.¹⁰⁰¹ Në një shoqëri mund të caktohen edhe më shumë se sa një likuidues, dhe në këtë rast ata veprojnë bashkërisht duke respektuar dispozitat e këtij ligji, për rastin kur ka më shumë se një përfaqësues ligjor për shoqërinë, duke mbajtur përgjegjësi solidare.

Vendimi i caktimit të likuiduesit duhet të publikohet në QKB¹⁰⁰² pasi përbën një rrethanë të rëndësishme për të gjithë kreditorët e kësaj shoqërie dhe menjëherë, kjo shoqëri merr statusin si shoqëri në likuidim e sipër.¹⁰⁰³ Ndërkohë, edhe gjatë procesit të likuidimit, likuiduesi bën publikisht pranë QKB-së dhe në faqen e internetit të shoqërisë (nësa ka një të tillë) ftesën për kreditorët që të paraqesin pretendimet e tyre ndaj shoqërisë. Ky njoftim më afat 30 ditor duhet të përsëritet dy herë.¹⁰⁰⁴

Ligji nuk ka parashikuar ndonjë pengesë që në pozicionin e likuiduesit të caktohet dhe administratori i shoqërisë, por në rast se personat e interesuar kanë pretendime për ndonjë konflikt interesi, ata mund t’i kërkojnë gjykatës zëvendësimin e tij në përputhje me nenin 191 të ligjit.

8.2.1.1. Likuidimi nga Asambleja e Ortakëve

Procedura e likuidimit të zakonshëm fillon që në momentin e marrjes së vendimit të AO për prishjen e shoqërisë. Sipas nenit 191 të ligjit, asambleja e shoqërisë duhet të caktojë

⁹⁹⁹ Ligji 9901/2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” i ndryshuar, nenet 190-203.

¹⁰⁰⁰ Ligji 9901/2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” i ndryshuar, nenet 204-205.

¹⁰⁰¹ Ligji 9901/2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” i ndryshuar, neni 196.

¹⁰⁰² Ligji 9723/2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit” i ndryshuar, neni 43/c.

¹⁰⁰³ Ligji 9901/2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” i ndryshuar, neni 194.

¹⁰⁰⁴ Ligji 9901/2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” i ndryshuar, neni 195.

likuiduesin brenda 30 ditëve pasi ka marrë vendimin për prishjen¹⁰⁰⁵. Ligji nuk parashikon një shumicë të cilësuar për emërimin e likuiduesit, si rrjedhim mund të themi se likuiduesi emërohet nga asambleja me shumicë të zakonshme dhe kuorumin përkatës (prej ortakëve që disponojnë jo më pak se 30% të kapitalit)¹⁰⁰⁶

Në rast se AO refuzon të caktojë likuiduesin brenda këtij afati, çdo person i interesuar ka të drejtë që t'i kërkojë gjykatës caktimin e tij. Madje sipas pikës 2 të nenit 191 parashikohet edhe e drejta e çdo personi të interesuar për t'i kërkuar gjykatës zëvendësimin e likuiduesit të caktuar nga AO me një person tjetër, nëse kanë arsye të bazuara për të dyshuar se likuiduesi i caktuar nga asambleja nuk do të kryejë një proces të rregullt likuidimi.¹⁰⁰⁷

Arsye të tilla mund të jenë rastet kur ai ka kryer veprime që janë në konflikt të hapur interesi, apo kur ky person ka një dënim penal të formës së prerë për vepra penale në fushën e shoqërive tregtare, dhe nuk ka kaluar akoma afati i ndalimit të dënimit plotësues¹⁰⁰⁸. Por, gjithsesi, kërkesa për caktimin e likuiduesit duhet të vijë si pasojë e vendimit për prishjen e shoqërisë. Në praktikën gjyqësore ka pasur raste të rrëzimit të padisë për likuidimin e shoqërisë në rrugë gjyqësore, për shkak se nuk është paraqitur si pasojë e një vendimi të prishjes së shoqërisë, apo nuk është shtruar më parë për diskutim në asamblesë e ortakëve. Në një përfundim të tillë ka arritur Gjykata e Lartë me vendimin Nr.00-2012-1830 i Vendimit (232) datës 08.05.2012 të Kolegjit Civil.¹⁰⁰⁹

Pra, në çdo rast të prishjes së shoqërisë me vendim të asamblesë se ortakëve, është pikërisht ky organ që vendos edhe likuiduesin e shoqërisë, si pasojë të drejtpërdrejtë të prishjes së shoqërisë.

Vetëm në rast se asambleja nuk realizon dot një vendim të tillë, atëherë ortakët apo personat e tjerë të interesuar mund t'i drejtohen gjykatës për të caktuar likuiduesin. AO ka të drejtë që të vendosë edhe shkarkimin e likuiduesit në të njëjtën mënyrë siç është bërë dhe emërimi i tij, pra me shumicë të thjeshtë votash, ashtu siç edhe zëvendësimin e tij.¹⁰¹⁰

¹⁰⁰⁵ Ligji 9901/2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” i ndryshuar, neni 191 pika 2

¹⁰⁰⁶ Ligji 9901/2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” i ndryshuar, nenet 86-87.

¹⁰⁰⁷ Ligji 9901/2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” i ndryshuar, neni 191.

¹⁰⁰⁸ Shih nenin 30/6 të Kodit Penal i cili parashikon si dënim plotësues “*Heqja e së drejtës për të ushtruar detyra drejtuese pranë personave juridikë*”.

¹⁰⁰⁹ Vendimi Nr.00-2012-1830 i Vendimit (232) datës 08.05.2012 i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.

¹⁰¹⁰ Ligji 9901/2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” i ndryshuar, neni 191.

8.2.3. Likuidimi me procedurë gjyqësore

Kur vendimi për prishjen e shoqërisë është dhënë nga gjykata, atëherë edhe procedura e likuidimit vendoset nga gjykata, e cila cakton likuiduesin e shoqërisë.¹⁰¹¹ Në një rast të tillë, edhe zëvendësimi i tij mund të bëhet vetëm nga gjykata.

Gjithashtu, likuiduesi mund të caktohet nga gjykata në rastet që u përmendën më lart, kur asambleja e ortakëve pasi ka marrë vendimin e prishjes së shoqërisë, nuk merr vendimin për të caktuar likuiduesin brenda afatit 30 ditor të parashikuar në nenin 191 të ligjit.¹⁰¹²

8.2.4. Tagrat e Likuiduesit dhe Raporti i Likuidimit

Likuiduesi i shoqërisë vepron nën mbikqyrjen e Asamblesë së Ortakëve dhe kjo e fundit ka të drejtë të njihet me të gjithë veprimtarinë e likuiduesit. Në nenin 197 janë pasqyruar të drejtat dhe detyrimet e likuiduesit me qëllim orientimin dhe disiplinimin e punës së tij, e cila ka një synim të përcaktuar, që është likuidimi i shoqërisë në një mënyrë sa më efektive dhe të shpejtë.¹⁰¹³

Kjo dispozitë i jep të drejtë likuiduesit, të kryejë edhe veprime të reja tregtare, por gjithmonë, me qëllim përmbylljen e një operacioni tregtar të nisur më parë, që të mos krijohen humbje financiare për shoqërinë. Likuiduesi, në cilësinë e përfaqësuesit juridik, teorikisht mund të kryejë çdo veprim përfaqësimi dhe administrimi, por gjithnjë, në funksion të procesit të likuidimit. Pra, neni 197 i ligjit përcakton misionin e veprimtarisë së likuiduesit dhe qëllimin kryesor të veprimeve të tij, që lidhet me shlyerjen të gjitha detyrimeve, mbledhjen e kredive të ndryshme, që mund të ketë shoqëria, si dhe kontributeve të pashlyera nga ortakët, siç edhe shitja e të gjitha pasurive të shoqërisë me qëllim për t'i konvertuar në vlerë monetare.

Duke i konvertuar të gjitha asetet e shoqërisë në vlerë monetare është më e lehtë për likuidatorin që të kryejë shlyerjen e borxheve ndaj kreditorëve, të bëjë shpërndarjen e tepricës së likuidimit, si dhe të përballojë dhe shpenzimet e vetë procedurës së likuidimit. Në procedurën e shitjes së aseteve të shoqërisë, likuiduesi duhet të respektojë parimet e

¹⁰¹¹ Ligji 9901/2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” i ndryshuar, neni 192.

¹⁰¹² Ligji 9901/2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” i ndryshuar, neni 191.

¹⁰¹³ Neni 197 pika 1 dhe 2 e ligjit 9901/2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” i ndryshuar përcakton se:

“1. Detyra e likuiduesve është mbyllja e të gjitha veprimeve të shoqërisë, mbledhja e kredive të paarkëtuara dhe e kontributeve të pashlyera, shitja e pasurive të shoqërisë dhe shlyerja e kreditorëve duke respektuar radhën preferimit, sipas nenit 605 të Kodit Civil.

2. Likuiduesi mund të kryejë edhe veprime të reja tregtare, për mbylljen e një veprimi të papërfunduar.”

mirëbesimit dhe të veprojë në interesin më të lartë të shoqërisë, duke mos abuzuar me shitjen e asetëve me çmime të paarsyeshme.¹⁰¹⁴

Kjo dispozitë i jep të drejtë likuiduesit që të përmbyllë edhe veprime tregtare të papërfunduara. Kjo nuk ka për qëllim zgjatjen e afatit të veprimtarisë tregtare si qëllim më vete, por bëhet me qëllim që të mos i shkaktohen shoqërisë humbje, dhe vjeljen e të gjitha kredive të saj.

Nëse gjatë procesit të likuidimit likuduesi konstaton se kapitalet e shoqërisë nuk mjaftojnë për të shlyer në mënyrë të plotë të gjitha detyrimet ndaj kreditorëve, ai është i detyruar të ndërpresë procesin e likuidimit dhe t'i drejtohet gjykatës për të çelur procedurën e falimentimit në përputhje me parashikimet e ligjit për falimentin.¹⁰¹⁵

Me qëllim dokumentimin sa më të mirë të procedurës së likuidimit, ligji ka parashikuar që likuiduesi duhet të përgatisë një bilanc të plotë të gjendjes së shoqërisë në momentin e parë të hapjes së likuidimit dhe një bilanc tjetër përfundimtar, në momentin e mbylljes së procedurës së likuidimit.¹⁰¹⁶

Likuiduesi i shoqërisë duhet të respektojë afatet e parashikuara në nenin 195 të ligjit të sipërcituara, gjatë së cilave kreditorët e shoqërisë kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre. Likuiduesi nuk mund të fillojë procedurën e shpërndarjes së asetëve të mbetura si tepricë e likuidimit pa kaluar këto afate. Madje edhe nëse kreditorë të caktuar, të cilët janë vërtetuar si të tillë nga ana e likuiduesit, nuk paraqiten për të tërhequr vlerën monetare përkatëse të kredisë, ato duhet të depozitohen pranë gjykatës, ndërsa sendet e luajtshme duhet të depozitohen në një magazinë për ruajtje, por me shpenzimet e kreditorit.¹⁰¹⁷

Në nenin 200 të ligjit¹⁰¹⁸ parashikohet se likuiduesi, pasi të ketë bërë shlyerjen e të gjitha detyrimeve ndaj kreditorëve, duhet të përllogarisë dhe shpenzimet për shpërblimin e punës së tij. Tepricën e kapitaleve të mbetura, likuiduesi duhet t'ua shpërndajë ortakëve në proporcion të drejtë me kuotën që ka secili ortak në shoqëri, apo sipas dispozitave të statutit, nëse statuti parashikon një mënyrë të ndryshme të shpërndarjes apo një radhë preferimi¹⁰¹⁹.

Këtë veprimtari të tij, si dhe shpërndarjen e tepricës së likuidimit, likuiduesi e pasqyron në një dokument që është “Raporti i likuidimit”, të cilin ia paraqet për miratim Asamblesë së

¹⁰¹⁴ Terex Solutions Inc, *Self Directed IRA LLC* (Terex Solutions 2010) fq 41.

¹⁰¹⁵ Ligji 9901/2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” i ndryshuar, neni 197 pika 3.

¹⁰¹⁶ Ligji 9901/2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” i ndryshuar, neni 198.

¹⁰¹⁷ Ligji 9901/2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” i ndryshuar, neni 199.

¹⁰¹⁸ Ligji 9901/2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” i ndryshuar, neni 200.

¹⁰¹⁹ Ligji 9901/2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” i ndryshuar, neni 201.

Ortakëve. Në rast e AO e miraton raportin e likuidimit, atëherë likuiduesi përfiton shpërblimin për punën e tij dhe lirohet nga detyra e tij, duke përfunduar kështu edhe procedura e likuidimit të SHPK-së.

Në rast AO nuk e miraton raportin e likuidimit, likuiduesi duhet t'i drejtohet gjykatës me kërkesën për miratimin e raportit të likuidimit dhe për ta liruar nga detyra, për shkak të përmbushjes në mënyrën e duhur të detyrave. Në rast se gjykata e pranon kërkesën, ai përfiton shpërblimin për punën e tij, shpërblim, i cili është përcaktuar si në raportin e likuidimit.

Në rast se likuiduesi është caktuar nga gjykata për shkak të procedurës së prishjes së shoqërisë me vendim gjykate, atëherë likuiduesi duhet ta paraqesë raportin e tij para gjykatës dhe do të jetë ky institucion që miraton raportin e likuidimit.

Me miratimin e raportit të likuidimit, likuiduesi bën shpërndarjen e tepricës së likuidimit sipas raportit. Gjithashtu, likuiduesi duhet t'u kthejë ortakëve sendet apo pasuritë, të cilat janë lënë në përdorim të shoqërisë dhe për të cilat shoqëria nuk ka përfituar të drejtën e pronësisë.

Pas shpërndarjes së tepricës së likuidimit, likuiduesi duhet të njoftojë Qendrën Kombëtare të Biznesit për përfundimin e procedurës së likuidimit dhe kërkon çregjistrimin e shoqërisë sipas dispozitave të parashikuara në seksionin V të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit".¹⁰²⁰

8.2.1.5. Revokimi i procedurës së likuidimit

Në doktrinën e së drejtës tregtare është shtruar për diskutim çështja nëse mundet një shoqëri në likuidim e sipër të ndërpresë procesin e likuidimit, ta revokojë atë vendim dhe të vazhdojë përsëri aktivitetin tregtar në mënyrë normale. Pra a ka të drejtë një shoqëri të anullojë vendimin për prishjen dhe likuidimin dhe t'i rikthehet normalisht aktivitetin tregtar?

Një pjesë e studiuesve mban qëndrimin që kjo nuk mund të ndodhë, për sa kohë ligji 9901/2008 nuk parashikon shprehimisht një të drejtë të tillë për Asamblenë e Ortakëve.¹⁰²¹ Por, një konkluzion i tillë, do të binte në kundërshtim me parimin kushtetues që "një gjë që nuk është e ndaluar me ligj do të thotë se është e lejuar".¹⁰²² Nga ana tjetër ligji

¹⁰²⁰ Ligji 9723/2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit" [2007] FZ 60.

¹⁰²¹ Argita Malltezi, Jonida Rystemaj dhe Armela Kromiçi, *Gjykatat Shqiptare mbi shoqëritë dhe veprimtarinë tregtare* (n 364) fq. 251-252.

¹⁰²² Shih Vendim i Gjykatës Kushtetuese Federale të Gjermanisë (Bundesverfassungsgericht), 6 qershor 1989, Nr. i çështjes 1 BvR 921/85.

9901/2008 nuk rezulton se ka ndonjë parashikim të shprehur apo dispozitë urdhëruese të ndalojë Asamblenë e Ortakëve që të ndryshojë vendimet e saj, të cilat nuk kanë sjellë akoma pasoja juridike të riparueshme.

Në këtë kontekst mund të shtrohej pyejtja: A ka të drejtë asambleja e ortakëve, që të ndryshojë vendimet e veta? Nëse po, a duhet ta trajtojmë dhe vendimin për prishjen e shoqërisë në ato vendime, të cilat mund të ndryshohen duke respektuar të njëjtën shumicë siç është marrë vendimi (pra, shumicë të cilësuar)?

Në legjislacionin italian ekziston një parashikim i tillë, që i jep mundësinë AO të një shoqërie të anulojë procedurën prishjes dhe likuidimit të shoqërisë dhe ta kthejë shoqërinë në aktivitet tregtar normal, pasi të ketë riparuar shkaku që ka çuar në prishjen e shoqërisë dhe likuidimin e saj.¹⁰²³ Sipas legjislacionit italian AO mund të marrë një vendim të tillë, deri në momentin sa nuk ka filluar procedurën e shlyerjes së detyrimeve ndaj kreditorëve.¹⁰²⁴

Legjislacioni në SHBA, si dhe doktrina amerikane, e pranon mundësinë e revokimit të likuidimit vullnetar dhe riaktivizimit të shoqërisë tregtare në regjistrin tregtar.¹⁰²⁵ Edhe sipas studiuesve dhe juristëve hollandezë,¹⁰²⁶ pavarësisht se ligji nuk e ka parashikuar shprehimisht, revokimi i vendimit për prishjen dhe likuidimin e shoqërisë mund të merret në rast se nuk ka filluar akoma procedura e likuidimit, dhe nuk cenohen kreditorët dhe palët e treta.

Gjithashtu, në legjislacionin turk parashikohet mundësia e revokimit të procesit të likuidimit të shoqërisë. Sipas Kodit Tregtar të Turqisë (6102), në nenin 548 parashikohet se një vendim i tillë për revokimin e procesit të likuidimit mund të merret nga Asambleja e Përgjithshme e ortakëve, deri në momentin sa nuk ka filluar shpërndarja e asetëve. Vendimi i asamblesë kërkon një shumë prej të paktën 60% të kapitalit dhe duhet të regjistrohet e të publikohet nga administratori.¹⁰²⁷

Qëllimi i përgjithshëm i legjislacionit shqiptar në fushën tregtare është nxitja e veprimtarisë ekonomike dhe ofrimi i të gjitha shanseve të mundshme shoqërive tregtare, që të vazhdojnë

¹⁰²³ Lisenko Moçka (përkthyes), *Kodi Civil Italian* (Dudaj 2014) neni 2487.

¹⁰²⁴ Po aty.

¹⁰²⁵ Joel D Gusky, “*Dissolution, Forfeiture, and Liquidation of Virginia Corporations*” (1978) 12:2 *University of Richmond Law Review* 333, fq. 346-349.

¹⁰²⁶ Alexander Spoor, “*Revocation of liquidation possible?*” (Baker McKenzie Netherlands, 31 korrik 2012) aksesuar më 10 dhjetor 2021.

¹⁰²⁷ Kodi Tregtar i Turqisë, Act No. 6102/2011 [2011] *Gazeta Zyrtare* 27846. Për më shumë rreth kësaj çështje të trajtuar në kodin tregtar turk shih: Erdem & Erdem law office “*Dissolution and Liquidation of Joint Stock Companies*” (publikuar në Korrik 2012 <<http://www.erdem-erdem.av.tr/publications/law-post/dissolution-and-liquidation-of-joint-stock-companies/>> aksesuar më 1 tetor 2020.

aktivitetin tregtar nëse ai është në përputhje me ligjin. Kjo frymë është qartësisht e shprehur edhe në ligjin 110/2016 të ligjit “Për falimentimin”, në të cilin është parashikuar procedura e riorganizimit dhe rehabilitimit të shoqërisë.¹⁰²⁸

Sipas profesorit të mirënjohur Aharon Barak:

“Gjyqtari duhet të interpretojë ligjin në kuptimin që e përmbush më së miri qëllimin e tij. Dhe, për të njohur qëllimin e i ligjit na ndihmon objekti i ligjit, natyra e marrëdhënieve që ai rregullon, ligjet e tjera të lidhura me të, kuadri ligjor në tërësi, sfondi social/historic, si dhe dhe parimet themelore të një shteti demokratik.”¹⁰²⁹

Si rrjedhim i këtij arsytimi, vlerësoj se edhe në realitetin juridik shqiptar, praktika gjyqësore mund të evoluojë dhe të zhvillohet në drejtim të njohjes së të drejtës së asamblesë së përgjithshme të ortakëve, që të revokojë vendimin e prishjes dhe likuidimit të shoqërisë, vetëm në ato raste, kur vendimi i prishjes ka ardhur si vullnet i organit të saj vendimmarrës AO, për një shkak të korigjueshëm, ose sipas pikës “e” të nenit 99/1.

Gjithsesi, ky revokim mund të shtrohet për diskutim vetëm në fazat e para të procesit të likuidimit, sa nuk ka filluar shlyerja e detyrimeve të kreditorëve dhe shpërndarja e aseteve të shoqërisë. Ndërsa, për të gjitha rastet, kur vendimi i prishjes së shoqërisë është dhënë me vendim të gjykatës, ky vendim është i formës së prerë dhe procesi i likuidimit nuk mund të anulohet, por duhet detyrimisht të përfundojë.

Një zgjidhje më të qartë dhe efektive, do të mund të ofronte legjislatori duke ndërhyrë në ligj dhe duke i njohur të drejtën e AO, që me një shumicë të cilësuar të ketë të drejtën për të revokuar/anuluar vendimin për prishjen dhe likuidimin e shoqërisë në fazat e para të tij dhe të disiplinonjë më tej këtë procedurë.

8.2.3. Likuidimi i thjeshtëzuar

Në nenin 204 të ligjit 9901/2008 parashikohet dhe një koncept novator për likuidimin e shoqërive tregtare.¹⁰³⁰ Ky është likuidimi i thjeshtëzuar dhe ka gjetur një aplikim të gjerë në praktikën shqiptare, pavarësisht se është një institut i ri.

Sipas kësaj procedure i njihet asamblesë së ortakëve e drejta që të kryejë një procedurë të përshpejtuar për likuidimin e shoqërisë, e cila paraqet disa avantazhe domethënëse për shoqërinë.

¹⁰²⁸ Ligji 110/2016 “Për Falimentimin”, neni 94 si dhe nenet 96 e vijues.

¹⁰²⁹ Aharon Barak, *Gjyqtari në demokraci* (ribotim i Shkolles së Magjistratures, Botimet Morava 2016) fq. 148-151.

¹⁰³⁰ Ligji 9901/2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” i ndryshuar, neni 204.

8.2.3.1. Avantazhet që paraqet procedura e likuidimit të thjeshtëzuar

Së pari, kjo procedurë redukton kostot ekonomike për shoqërinë, pasi nuk nevojitet caktimi i një likuiduesi për të kryer procedurat e likuidimit dhe përgatitjes së raportit të likuidimit, angazhimi i të cilit do të shoqërohej edhe me kosto ekonomike për shoqërinë.

Së dyti, kjo procedurë ka si karakteristikë dhe qëllim nga vetë ligji, që të jetë e përsheptuar, pra të përmbyllë procesin e likuidimit në një kohë sa më të shpejtë dhe të thjeshtë.

Në thelb të kësaj procedure qëndron angazhimi i organeve të SHPK-së për të kryer vetë procesin e likuidimit, pra për të shlyer të gjitha detyrimet që shoqëria ka ndaj të tretëve (të gjitha kategoritë e kreditorëve apo punëmarrësve), dhe deklarimi i këtij fakti para gjykatës me qëllim miratimin e likuidimit të thjeshtëzuar.

8.2.3.2. Procedura e likuidimit të thjeshtëzuar

Një procedurë e tillë është shumë e favorshme për shoqëritë relativisht të pangarkuara me shumë detyrime, për të cilat nuk është e nevojshme caktimi i një likuiduesi, pasi veprimet përmbyllëse, si dhe shpërndarjen e asetëve të mbetura si tepricë likuidimi mund t'i kryejë dhe vetë administratori i shoqërisë me pëlqimin e AO.

Gjithsesi, për aplikimin e procedurës së likuidimit të thjeshtëzuar ligji kërkon plotësimin e disa kushteve, si dhe respektimin e një procedure strikte, e cila përfshin dhe miratimin më vendim të gjykatës.¹⁰³¹

Kushti thelbësor që kërkon ligji, para se të lejojë aplikimin e kësaj procedure të likuidimit të thjeshtëzuar është që organet e shoqërisë (AO dhe Administratori) të kenë bërë shlyerjen e të gjitha detyrimeve të shoqërisë ndaj kreditorëve dhe punëmarrësve.¹⁰³² Pra, një kërkesë për likuidim të thjeshtëzuar nuk mund të bëhet nëse shoqëria nuk ka shlyer të gjitha detyrimet e saj paraprakisht.

Në aspektin procedural, neni 204 i ligjit parashikon se për aplikimin e likuidimit të thjeshtëzuar duhet:

- Të vendosin të gjithë ortakët e SHPK-së, pra kërkohet një vendim unanim i AO për vazhdimin e kësaj procedure.¹⁰³³

¹⁰³¹ Ligji 9901/2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” i ndryshuar, neni 204.

¹⁰³² Ligji 9901/2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” i ndryshuar, neni 204.

¹⁰³³ Ligji 9901/2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” i ndryshuar, neni 204.

- Gjithashtu, fakti i shlyerjes së detyrimeve financiare të shoqërisë duhet të deklarohet me përgjegjësi personale nga të gjithë ortakët e shoqërisë në një deklaratë me shkrim.
- Administratori i shoqërisë para se t'i drejtohet gjykatës për miratimin e kërkesës për likuidim të thjeshtëzuar, duhet të njoftojë QKB-në për këtë vendim.
- Kërkesa për miratimin e likuidimit të thjeshtëzuar paraqitet nga përfaqësuesi i shoqërisë në gjykatën që ka kompetencën tokësore dhe është gjykata e cila vendos miratimin e procedurës së likuidimit të thjeshtëzuar pasi verifikon procedurën e parashikuar nga neni 204.

Nga formulimi i pjesës së parë të dispozitës, duket sikur është anashkaluar roli i administratorëve dhe del më shumë në pah roli i ortakëve për procedurën e likuidimit të thjeshtëzuar. Por, në fakt, ortakët nuk mund të marrin një vendim të tillë pa pasur një përshkrim dhe analizë të qartë dhe të detajuar të situatës financiare të shoqërisë nga administratori i saj.

Në paragrafin e tretë të nenit 204 parashikohet se edhe administratorët, edhe ortakët e shoqërisë, mbajnë përgjegjësi për dëmet që mund të shkaktojnë nga shkelja e detyrave të tyre në këtë procedurë. Gjithashtu, edhe ortakët e shoqërisë mbajnë përgjegjësi solidare për shumat që ata kanë marrë¹⁰³⁴ Pavarësisht se kjo dispozitë nuk reflekton një pasqyrim të saktë të detyrimeve të administratorëve, është e qartë se administratorët luajnë një rol të rëndësishëm në procedurën e likuidimit të thjeshtëzuar, pasi administratori i shoqërisë do të kujdeset për shlyerjen e të gjitha detyrimeve ndaj kreditorëve, qofshin këta subjekte kontraktuese, punëmarrës, të tretë apo institucione fiskale.

Garancitë e kreditorëve në një procedurë të likuidimit të thjeshtëzuar, e cila shmang plotësisht afatet e parashikuara në nenin 195 të ligjit për paraqitjen e pretendimeve ndaj shoqërisë, janë pikërisht përgjegjësitë që i ngarkon paragrafi 3 i nenit 204 administratorëve dhe ortakëve të shoqërisë që të veprojnë me përgjegjshmëri, pasi në të kundërt do të ngarkohen personalisht me përgjegjësi financiare, në rast se kanë vepruar në kundërshtim me ligjin apo kanë bërë deklaratë të pavërtetë. Gjithashtu, pjesë e garancive është edhe procedura gjyqësore dhe fakti se deklaratimet e ortakëve që kanë shlyer detyrimet duhet të hartohen pikërisht për të vërtetuar para gjykatës një situatë të tillë.

Neni 204 i ligjit 9901/2008 nuk parashikon se deri në çfarë mase duhet të përfshihet gjykata në verifikimin e kushteve të procedurës së likuidimit të thjeshtëzuar. Pra nuk përcaktohet nëse gjykata duhet të kryejë ndonjë hetim gjyqësor për të verifikuar vërtetësinë e deklaratës

¹⁰³⁴ Neni 204 pika 3 I ligjit 9901/2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” i ndryshuar parshikon se: *“Administratorët janë përgjegjës për dëmin e shkaktuar nga shkelja e detyrave të tyre gjatë likuidimit të thjeshtëzuar. Përveç administratorëve, ortakët apo aksionarët e shoqërisë përgjigjen në mënyrë solidare deri në shumat e marra”.*

së ortakëve të shoqërisë se janë shlyer të gjitha borxhet e saj apo thjesht duhet të mjaftohet me deklaratën me përgjegjësi të plotë të ortakëve për përmbajtjen e saj. Në praktikën gjyqësore shqiptare ka pasur shumë raste të aplikimit të procedurës së likuidimit të thjeshtëzuar.

Në pjesën më të madhe të rasteve, gjykatat kanë zhvilluar praktikën e tyre duke administruar deklaratën e të gjithë ortakëve që kanë shlyer detyrimet, si dhe me disa vërtetime (*vërtetime negative*) të institucioneve tatimore dhe doganore, që i paraqet vëtë pala kërkuese, sipas të cilave konfirmohet se shoqëria nuk ka detyrime ndaj tyre. Në këto raste gjykata miraton në një kohë të shpejtë kërkesën për likuidimin e thjeshtëzuar, duke e bërë një mjet efikas për mbylljen e përshpejtuar të shoqërisë.¹⁰³⁵

Ka edhe raste, kur gjykata nuk e ka vlerësuar të nevojshme për të administruar vërtetime negative të institucioneve fiskale apo doganore, por është mjaftuar vetëm me deklaratën e ortakëve, të përmendur në nenin 204 të ligjit. Një rast i tillë konstatohet në Vendimin me Nr. 14968 Regj datë 21.11.2014 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.¹⁰³⁶

Pika 3 e dispozitës parashikon përgjegjësinë solidare të ortakëve për të gjitha shumat e shpërndara si tepricë likuidimi dhe gjithashtu, parashikon përgjegjësinë personale të administratorit për dëmet që mund të shkaktojë nga shkelja e detyrimeve të tij. Në këtë kontekst, dëmet që mund të shkaktojë administratori janë edhe mospasqyrimi i saktë i detyrimeve të shoqërisë ndaj kreditorëve në momentin e diskutimit në AO për aplikimin apo jo të kësaj procedure.

Duke vlerësuar veçoritë e kësaj procedure të falimentimit të thjeshtëzuar, vlerësojmë se roli i gjykatës në këtë procedurë, në kushte normale nuk ka pse të jetë shume angazhues dhe aktiv në drejtim të hetimit gjyqësor për verifikimin e vërtetësisë së deklarimeve të ortakëve. Vetëm në rast se gjykata do të kishte indicie apo informacion për ndonjë pasaktësi apo pasqyrim të pavërtetë të deklarimeve, atëherë ajo mund të kryejë një rol më aktiv në verifikimin e vërtetësisë së deklaratës së ortakëve për shlyerjen e detyrimeve. Që në fjalinë e parë të nenit 204 parashikohet se qëllimi i likuidimit të thjeshtëzuar është që të jetë një procedurë e përshpejtuar në kohë, pra qëllimi i saj është që të mbyllet në një kohë relativisht të shkurtër dhe të shpejtë.

¹⁰³⁵ Shih praktikën gjyqësore si vijon: Vendimi me Nr.7612 Akti, dt 16.05.2016 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë; Vendimi me Nr.13616 Akti datë 10.12. 2010 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë; Vendimi me Nr. 9768 Regj datë 06.09.2010 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë; Vendimi Nr. 4840 datë 04.11.2020 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë; Vendimi Nr. 3643 datë 21.09.2020 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

¹⁰³⁶ Vendimi me Nr. 14968 Regj datë 21.11.2014 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Menjëhërë pasi gjykata bën miratimin e kërkesës së shoqërisë për likuidimin e thjeshtëzuar, administratori i shoqërisë kryen shpërndarjen e aseteve të mbetura si tepricë e likuidimit të ortakët, sipas parashikimeve të statutit, ose në mungesë të tyre në përpjesëtim të drejtë me pjesëmarrjen që ka secili ortak në shoqëri. Gjithashtu, administratori depoziton vendimin e Gjykatës në Qendrën Kombëtare të Biznesit për përfundimin e procedurës dhe çregjistrimin e subjektit juridik nga regjistri tregtar në përputhje me nenin 49 të ligjit 9723/3.5.2007 " Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit"

Si konkluzion mund të themi se përfshirja në ligj e një procedure të përsheptuar dhe të thjeshtë të likuidimit, siç është likuidimi i thjeshtëzuar, ka rezultuar një hap pozitiv dhe në interes të SHPK-ve në Shqipëri, duke reduktuar kohën dhe kostot e likuidimit. Kjo procedurë e përsheptuar është aplikuar me sukses nga gjykatat në vendin tonë dhe nuk rezulton të jetë shoqëruar me pasoja anësore problematike për kreditorët e shoqërive tregtare.

8.3. Falimentimi i SHPK-ve

Njëra nga arsyet e përfundimit të aktivitetit dhe më pas prishjes së një shoqërie tregtare është gjendja e falimentit¹⁰³⁷.

Për të rregulluar procedurën e falimentimit, ka një ligj të veçantë,¹⁰³⁸ i cili duhet të zbatohet në të gjitha rastet, kur subjekti ndodhet në kushtet e falimentit.

Një shoqëri ndodhet në kushtet e falimentimit kur provohet se është në gjendjen e paaftësisë pagueuse. Sipas pikës 21 të nenit 3 të ligjit 110/2016¹⁰³⁹ gjendja e "*Paaftësisë pagueuse*" të debitorit paraqitet në rastet:

1. kur ky debitor nuk ka mundësi financiare të paguajë borxhet e tij brenda afatit,
2. ose situata financiare, në të cilën shuma e detyrimeve të debitorit tejkalon vlerën totale të pasurive të tij

Sipas nenit 14/1 të ligjit 110/2016 debitori legjitimohet të kërkojë çeljen e procedurës së falimentit, jo vetëm kur ndodhet tashmë në kushtet e paaftësisë pagueuse, por edhe nëse ai provon se, në një të ardhme të afërt, parashikon se do të jetë në kushtet e paaftësisë pagueuse.¹⁰⁴⁰

¹⁰³⁷ Ligji 9901/2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" i ndryshuar, nenin 99/1 pika "b".

¹⁰³⁸ Ligji 110/2016 "Për Falimentimin".

¹⁰³⁹ Ligji 110/2016 "Për Falimentimin", neni 3 pika 21.

¹⁰⁴⁰ Ligji 110/2016 "Për Falimentimin", neni 14.

Me qëllim që të mos përkeqësohet situata financiare e shoqërisë që është në kushtet e falimentit, si dhe që të mos shtohet risku i kreditorëve për pamundësinë e rikuperimit të plotë të borxhit ndaj debitorit, ligji ka parashikuar disa detyrime për subjektet që janë në kushtet e falimentimit, që të fillojnë sa më parë, pa vonesa, procedurën e falimentit.

Në nenin 15 të ligjit parashikohet detyrimi i debitorit dhe i të gjithë anëtarëve të organit drejtues (Në rastin e SHPK-ve këtu përfshihen administratori ose administratorët, në kushte normale, si dhe likuiduesi ose likuiduesit, në rast se ka filluar procedura e likuidimit) që brenda një afati prej 60 ditësh nga data që kanë marrë dijëni, apo duhet të kishin marrë dijëni për paaftësinë paguese, t'i drejtohen gjykatës me kërkesën për çeljen e procedurave të falimentit.¹⁰⁴¹ Në rast të kundërt, ligji parashikon se këta persona do të mbajnë përgjegjësi personale për humbjet e shkaktuara ndaj kreditorëve për shkak të vonesës.

Madje edhe në Kodin Penal, në nenet 193 deri 196,¹⁰⁴² parashikohen disa dispozita penale, duke parashikuar si vepra penale veprimet me keqbesim të administratorëve të shoqërive, të cilat synojnë që të japin një efekt në parandalimin e përgjithshëm, për të mos kryer veprime në kundërshtim me ligjin, kur subjekti ndodhet në kushtet e falimentit. Në nenin 194 të Kodit Penal parashikohet pikërisht përgjegjësia penale ndaj subjekteve që janë të ndërgjegjshëm që ndodhen në kushtet e falimentit dhe fshehin këtë situatë (duke mos marrë masa për t'iu drejtuar gjykatës për çeljen e procedurës së falimentit) dhe ndërkohë hyjnë në marrëdhënie tregtare me subjekte të tjera.¹⁰⁴³ Veprime të tilla paraqesin riskun e rritjes së numrit të kreditorëve të shoqërisë, duke zvogëluar mundësinë kreditorëve për rikuperimin e borxheve.

Procedura e falimentimit mund të vihet në lëvizje nga vetë shoqëria që është debitore apo nga kreditorët e saj duke iu drejtuar gjykatës me një kërkesë për këtë qëllim.¹⁰⁴⁴ Kjo procedurë mund të fillojë edhe ndaj një SHPK-je, për të cilën është marrë vendimi i prishjes dhe për të cilën kanë filluar procedurat e likuidimit, në rast se provohet se ajo është në kushtet e paaftësisë paguese.¹⁰⁴⁵

Falimentimi është një procedurë, e cila në çdo rast mbikëqyret nga gjykata dhe për të cilën subjektet e interesuara duhet t'i drejtohen gjykatës për ta filluar, në përputhje me ligjin e posaçëm Nr. 110/2016 “Për falimentin”. Ky ligj rregullon të gjithë procedurën se si kryhet falimentimi i një SHPK-je, si dhe i subjekteve të tjera.

¹⁰⁴¹ Ligji 110/2016 “Për Falimentimin”, neni 15/1.

¹⁰⁴² Kodi Penal, nenet 193-196.

¹⁰⁴³ Neni 194 i Kodit Penal parashikon se “*Hyrja në marrëdhënie ekonomike tregtare me të tretët nga ana e personit juridik, me qëllim të fshehtë gjendjen e falimentimit, dënohet me gjobë ose me burgim gjer në pesë vjet*”.

¹⁰⁴⁴ Ligji 110/2016 “Për Falimentimin”, Neni 13/1.

¹⁰⁴⁵ Ligji 110/2016 “Për Falimentimin”, Neni 7.

Faza e parë e procedurës së falimentit fillon me caktimin nga ana e gjykatës të një administratori të përkohshëm të falimentit, i cili ka për detyrë që të verifikojë nëse ekzistojnë kushtet e falimentit apo jo, si dhe të verifikojë nëse subjekti ndaj të cilit kërkohet të çelet procedura e falimentit, ka kapitale të mjaftueshme (masë falimenti) për të përballuar shpenzimet e procedurës së falimentit, apo nuk ka.¹⁰⁴⁶

Në rast se provohet gjendja e paaftësisë paguese të shoqërisë debitore dhe gjithashtu, provohet se ky subjekt nuk ka pasuri të mjaftueshme për të mbuluar shpenzimet e procedurës së falimentimit, gjykata merr vendim për përfundimin e procedurës për shkak të mungesës së pasurive.¹⁰⁴⁷

Në këtë rast shoqëria konsiderohet e prishur sipas nenit 99/5 të ligjit 9901/2008¹⁰⁴⁸ dhe vendimi i gjykatës përcillet në QKB, e cila bën çregjistrimin e shoqërisë në përputhje me nenin 100 të Ligjit 9901/2008¹⁰⁴⁹ dhe nenin 45 të ligjit 9723/2007 “Për Qendrën Kombëtare të Biznesit”.¹⁰⁵⁰

Gjykata e falimentit, përpara se të vendosë përfundimin e procedurës, duhet të informojë kreditorët e shoqërisë, si dhe të bëjë shpallje publike të gjendjes së falimentit në QKB, si dhe në të gjitha autoritetet publike që kërkohen nga ligji. Kreditorët dhe personat e tjerë të interesuar kanë të drejtë, që në afatin brenda 60 ditëve nga njoftimi i mësipërm, të paraqesin kundërshtimet e tyre për përfundimin e procedurës për shkak të mungesës së pasurive në gjykatë për arsyet e mëposhtme: i) nëse ata provojnë se debitori ka pasuri, të cilat nuk janë konstatuar nga administratori i përkohshëm (eksperti) apo ii) nëse provojnë se nevojitet një hetim më i thelluar në lidhje me pasuritë që debitori ka transferuar nëpërmjet shmangieve (nenet 79 - 81 të ligjit 110/2016).¹⁰⁵¹

Në rast se në fazën e parë provohet gjendja e paaftësisë paguese të shoqërisë debitore, por shoqëria ka kapitale/pasuri të mjaftueshme për të mbuluar shpenzimet e procedurës së falimentimit, atëherë gjykata merr vendim për çeljen e procedurës së falimentit duke kaluar kështu në një fazë të dytë të procedurës.

¹⁰⁴⁶ Ligji 110/2016 “Për Falimentimin”, neni 19/c.

¹⁰⁴⁷ Ligji 110/2016 “Për Falimentimin”, neni 20/1.

¹⁰⁴⁸ Ligj 9901/2008 i ndryshuar, neni 99 pika 5.

¹⁰⁴⁹ Ligji 9901/2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” i ndryshuar, neni 100.

¹⁰⁵⁰ Ligji 9723/2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit” i ndryshuar, neni 45.

¹⁰⁵¹ Ligji 110/2016 “Për Falimentimin”, neni 20/2.

Në fazën e dytë të procedurës së falimentit caktohet një administrator falimenti, i cili ndjek me përpikëri procedurat e parashikuara në ligjin e posaçëm 110/2016 në bashkëpunim të plotë me kreditorët e shoqërisë dhe nën mbikqyrjen e gjykatës së falimentit.¹⁰⁵²

Administratori i falimentit merr tagrat e administratorit të shoqërisë, duke vepruar në interes të shoqërisë në funksion të procedurave të falimentit. Administratori i shoqërisë harton inventaret dhe bilance për të gjitha aktivet e shoqërisë, si dhe detyrimet e saj, duke identifikuar të gjithë kreditorët e shoqërisë dhe masën e detyrimit që ka debitori për secilin kreditor.¹⁰⁵³

Ligji 110/2016 parashikon dhe konceptin e riorganizimit të shoqërisë, duke vlerësuar mundësinë që, me pëlqimin e shumicës së kreditorëve, t'i jepet shoqërisë mundësia e riorganizimit dhe ristrukturimit të borxheve si një shans i dytë, në rast se vlerësohet se kjo shoqëri mund të tejkalojë gjendjen e paaftësisë paguese dhe të vazhdojë aktivitetin tregtar pa u prishur.¹⁰⁵⁴

Ky është varianti më optimist i mundshëm i një procedurë falimenti dhe nuk ka për pasojë prishjen e shoqërisë, por riorganizimin e saj. Sipas nenit 93 të ligjit 110/2016 të ligjit për falimentin, një vendim i tillë merret në mbledhjen e raportimit, e cila drejtohet nga gjykata e falimentit dhe ka për qëllim që të vendosë nëse procedura e falimentit do të vazhdojë me riorganizimin e shoqërisë dhe ristrukturimin e borxhit apo me likuidimin e pasurive të shoqërisë dhe prishjen e saj.¹⁰⁵⁵

Në rast se në mbledhjen e raportimit është vendosur që të bëhet likuidimi i pasurive të mbetura të shoqërisë, atëherë administratori i falimentit duhet të hartojë planin për likuidimin e masës së falimentit në përputhje me mënyrën dhe afatet e parashikuara në ligj, afate kohore, siç është rregulluar në këtë ligj në pjesën mbi likuidimin.¹⁰⁵⁶

Në përfundim të likuidimit dhe procedurës së shpërndarjes përfundimtare të aseteve të debitorit, sipas parashikimeve të ligjit 110/2016, gjykata e falimentit merr vendim për përfundimin e procedurës së falimentit për subjektin debitor.¹⁰⁵⁷ Në këtë rast shoqëria konsiderohet e prishur sipas nenit 99/5 të ligjit 9901/2008¹⁰⁵⁸ dhe vendimi i gjykatës

¹⁰⁵² Ligji 110/2016 “Për Falimentimin”, neni 20.

¹⁰⁵³ Ligji 110/2016 “Për Falimentimin”, neni 20.

¹⁰⁵⁴ Ligji 110/2016 “Për Falimentimin”, Neni 94.

¹⁰⁵⁵ Ligji 110/2016 “Për Falimentimin”, Neni 93.

¹⁰⁵⁶ Ligji 110/2016 “Për Falimentimin”, Neni 95.

¹⁰⁵⁷ Ligji 110/2016 “Për Falimentimin”, Neni 153.

¹⁰⁵⁸ Ligji 9901/2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” i ndryshuar, neni 99 pika 5.

përcillet në QKB, e cila bën çregjistrimin e shoqërisë në përputhje me nenin 100 të Ligjit 9901/2008¹⁰⁵⁹ dhe nenin 45 të ligjit 9723/2007 për QKB.¹⁰⁶⁰

Çdo vonesë në aplikimin e procedurave të falimentit do të minimizonte masën e rikuperimit të borxhit për kreditorët e shoqërive që janë në kushtet e falimentit, si dhe, potencialisht, do të rrisë numrin e kreditorëve ndaj këtyre shoqërive duke ndikuar negativisht në ambjentin ekonomik të vendit. Prandaj, shoqëritë që janë në kushtet e paaftësisë pague, si dhe kreditorët e tyre, duhet të iniciojnë sa më shpejt procedurën e falimentit, me qëllim që situata financiare e këtyre SHPK-ve të mos përkeqësohet më tepër.


Nga statistikat e siguruara pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, që është gjykata më e madhe e vendit, lidhur me procedurat e falimentit për gjashtë vitet e fundit, rezulton se ka një numër shumë të ulët të rasteve të falimentit të SHPK-ve krahasuar me numrin total të shoqërive të këtij lloji në vendin tonë. Nga statistikat e vëna në dispozicion nga Qendra Kombëtare e Biznesit¹⁰⁶¹ rezulton se në vitin 2020, në Regjistrin Tregtar të këtij institucioni figurojnë të regjistruara 58084 shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, që përbëjnë rreth 96% të të gjithë shoqërive tregtare që figurojnë në Regjistrin Tregtar.

Figura 4: Numri dhe vëllimi i shprehur në përqindje i shoqërive tregtare në Republikën e Shqipërisë nga viti 1992 e deri më Tetor 2020

¹⁰⁵⁹ Ligji 9901/2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” i ndryshuar, neni 100.

¹⁰⁶⁰ Ligji 9723/2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit” i ndryshuar, neni 45.

¹⁰⁶¹ Kthim përgjigjeje në format elektronik nga Qendra Kombëtare e Biznesit dt. 16.10.2020 (Drejtoria e Analizës dhe Regjistrave) kërkesës së autorit të këtij punimi të paraqitur pranë QKB me Nr. 8640 prot., datë 24.09.2020.



Burimi: Drejtoria e Analizës dhe Regjistrave (të dhëna të përpunuara nga autori).¹⁰⁶²

Ndërkohë që nga të dhënat e sigurara nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë,¹⁰⁶³ rezulton se:

- Në vitin 2015 rezulton të jenë paraqitur 44 kërkesa të reja nga SHPK-të, për hapjen e procedurës së falimentit në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë.
- Në vitin 2016 rezulton të jenë paraqitur 11 kërkesa të reja nga SHPK-të, për hapjen e procedurës së falimentit në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë.
- Në vitin 2017 rezulton të jenë paraqitur 3 kërkesa të reja nga SHPK-të, për hapjen e procedurës së falimentit në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë.
- Në vitin 2018 rezulton të jenë paraqitur 6 kërkesa të reja nga SHPK-të, për hapjen e procedurës së falimentit në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë.
- Në vitin 2019 rezulton të jenë paraqitur 3 kërkesa të reja nga SHPK-të, për hapjen e procedurës së falimentit në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

¹⁰⁶² Qendra Kombëtare e Biznesit, Drejtoria e Analizës dhe Regjistrave, *Informacion i gjeneruar nga regjistri tregtar - të dhëna statistikore*, kthim përgjigjeje datë 16 Tetor 2020 në bazë të kërkesës së Doktorantit Fatri Islamaj protokolluar nga QKB me Nr. 8640 prot., datë 24.09.2020.

¹⁰⁶³ Informacioni statistikor është gjeneruar nga sistemi elektronik i menazhimit të çështjeve gjyqësore ARK-IT i instaluar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë ku autori i këtij punimi ka pasur akses për shkak të funksionit si gjyqtar.

- Ndërsa në vitin 2020 rezultojnë të jenë paraqitur 2 kërkesa të reja nga SHPK-të, për hapjen e procedurës së falimentit në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë.¹⁰⁶⁴

Vlen të theksohet, se nga statistikat e të gjitha çështjeve të falimentit në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë rezultojnë se në kategorinë e subjekteve në procedurë falimenti, pjesa më e madhe e tyre janë të formës së SHPK-ve. Ndërsa format e tjera të shoqërive tregtare, bashkë me personat fizikë, zënë një numër të papërfillshëm të procedurave. Kjo tregon se për të gjitha kategoritë e subjekteve tregtare në Shqipëri, reflektohet një numër shumë i ulët i procedurave të falimentit .

Ndërkohë, praktika e deritanishme tregtare në nivel global ka treguar që sipërmarrjet tregtare të çdo lloji, përfshirë dhe SHPK-të, kanë edhe një element të konsiderueshëm pasigurie në raport me suksesin apo dështimin e tyre në aspektin ekonomik. Për pasojë edhe risku i ekspozimit para situatës së paaftësisë paguese dhe falimentit në Shqipëri është relativisht i lartë edhe për SHPK-të. Sipas statistikave të publikuara për vitin 2017, në nivel evropian rezultojnë se një në pesë biznese të hapura në Evropë ka falimentuar që në vitin e parë, ndërsa në tri vitet e para vetëm dy të tretat e bizneseve mbijetojnë, ndërsa në pesë vitet e para, vetëm gjysma (50%) e bizneseve mbijetojnë.¹⁰⁶⁵

Ndërkohë në kushtet e krizës së përgjithshme ekonomike të shkaktuar sidomos në vitet e fundit në Shqipëri, edhe për shkak të situatave me pandeminë e COVID-19, është e qartë që numri i SHPK-ve të ekspozuara para situatës së falimentit, në realitet është rritur shumë më tepër.

Pra, në vendin tonë nuk përputhet situata faktike e subjekteve, të cilat janë realisht në kushtet e falimentit, me statistikat e procedurave të falimentit të formalizuara në gjykatat e vendit në bazë të ligjit të falimentit. Këto statistika me shifra të ulëta të procedurave të falimentit në Shqipëri, për fat të keq, nuk mund të interpretohen si sukses i sipërmarrjeve tregtare në vendin tonë, ndryshe nga priorja evropiane dhe globale. Por, këto të dhëna pasqyrojnë një informalitet në shkallë të konsiderueshme dhe reflektojnë një situatë ku eventualisht një numër shumë i madh i subjekteve tregtare, të cilat janë në kushtet e falimentit në kundërshtim me parashikimet ligjore të sipërcituara, nuk marrin masa për të filluar procedurat e falimentit.

Në këto kushte nevojitet një ndërgjegjësim dhe sensibilizim më i madh i të gjithë aktorëve që tërheqin interesa, qofshin këto vetë organet drejtuese të SHPK-ve, ortakët e tyre apo

¹⁰⁶⁴ Për vitin 2020 të dhënat janë deri në muajin tetor, kur është marrë informacioni nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

¹⁰⁶⁵ D Clark, “Business survival rates in selected European countries in 2017, by length of survival” (9 Shtator 2020) <<https://www.statista.com/statistics/1114070/eu-business-survival-rates-by-country-2017/>> aksesuar më 17 tetor 2020.

kreditorët e shoqërive (përfshirë dhe institucionet shtetërore), të cilët kanë interes që të vënë në lëvizje sa më parë procedurat e falimentimit për ato SHPK që janë në kushtet e paaftësisë pague. Një rol të rëndësishëm në aspektet e sensibilizimit mund të luajnë institucionet shtetërore, si Qendra Kombëtare e Biznesit, institucionet fiskale, ato të këshillimit nëpërmjet Dhomave të avokatëve dhe noterëve, Institutet e Ekspertëve Kontabël, si dhe institucionet bankare dhe të kreditimit.

8.3.1. Gjykata kompetente

Në gjykimin e të gjitha mosmarrëveshjeve që lidhen me SHPK-të janë të zbatueshme parimet e përgjithshme të gjykimit nga një gjykatë e formuar me ligj, të garantuara nga neni 6 i Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut,¹⁰⁶⁶ si dhe Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë.¹⁰⁶⁷ Në këtë koncept përfshihen edhe respektimi i dispozitave për kompetencat territoriale dhe lëndore.¹⁰⁶⁸

Për efekt të këtij punimi, në të gjitha rastet, kur i referohemi gjykatës, do të kuptojmë seksionin tregtar të gjykatës së rrethit gjyqësor përkatës, në përputhje edhe me nenet 334 - 336 të Kodit të Procedurës Civile.¹⁰⁶⁹ Edhe ligji për falimentin, në nenin 3/9 ka të njëjtin rregullim¹⁰⁷⁰. Sipas nenit 335 të Kodit të Procedurës Civile përcaktohet dhe kompetenca territoriale e gjykatës, duke e lidhur atë me vendin ku ndodhet selia e SHPK-së¹⁰⁷¹, në rast se palët nuk kanë përcaktuar një gjykatë tjetër kompetente në kontratë.¹⁰⁷²

Koncepti i gjykatës së caktuar me ligj, e cila mund të zgjidhë konflikte të ndryshme që lindin në një shoqëri tregtare, apo mes një SHPK-je dhe subjekteve të tjera, mund të jenë edhe mënyrat alternative të zgjidhjes së konflikteve (me disa përjashtime, si psh. ai i procedurës së falimentit) nëse janë parashikuar nga palët në kontratë. Këto mënyra

¹⁰⁶⁶ Shih nenin 6 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, si dhe jurisprudencën e gjerë lidhur me këtë parim, veçanërisht çështjet: Judgment of 27 May 2014, ECHR, *Baka v. Hungary*, App. no. 20261/12; Judgment of 13 November 2007, *D. H. and Others v. the Czech Republic*, App. no. 57325/00.

¹⁰⁶⁷ Shih Vendimin Nr. 31 dt. 05.07.2011 të Gjykatës Kushtetuese të R.Sh.

¹⁰⁶⁸ Shih Judgment of 1988, ECHR, *Belilos against Switzerland*, Applications no.10328/83.

¹⁰⁶⁹ Neni 1 pika 4 e ligjit 9901/2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” i ndryshuar përcakton se: “Nëse nuk parashikohet ndryshe, gjykata e përmendur në këtë ligj është seksioni tregtar i gjykatës së rrethit gjyqësor përkatës, sipas dispozitave të neneve 334 deri në 336 të Kodit të Procedurës Civile.”

¹⁰⁷⁰ Ligji 110/2016 “Për Falimentimin”, neni 3 pika 9.

¹⁰⁷¹ Neni 335 i Kodit të Procedurës Civile parashikon se:

“Padia sipas nenit 334 të këtij Kodi shqyrtohet nga seksioni përkatës i gjykatës së shkallës së parë, në zonën e së cilës ka qendrën personi juridik a fizik tregtar i paditur, përveç kur palët në kontratë kanë caktuar një gjykatë tjetër, që edhe ajo është kompetente. Kur padia paraqitet në gjykatën e shkallës së parë në territorin e së cilës ka qendrën personi juridik a fizik tregtar, kjo ia dërgon atë jo më vonë se tri ditë gjykatës ku është krijuar seksioni për gjykimin e mosmarrëveshjeve tregtare”.

¹⁰⁷² Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, Vendimi Nr. 4794 dt. 30.05.2017 ka konsideruar kompetente Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Dibër, për arsye se palet në konflikt, paraprakisht, kishin përcaktuar këtë si gjykatë kompetente.

alternative përfshijnë Arbitrazhin¹⁰⁷³ dhe Ndërmjetësimin, vendimet e të cilave kanë të njëjtën vlerë ligjore si vendimi gjyqësor. Palët mund të vendosin si klauzolë në kontratën mes tyre, që mosmarrëveshjet të zgjidhen nëpërmjet arbitrazhit.¹⁰⁷⁴

Megjithatë, në rrethet e juristëve ka një paqartësi për sa i përket spektrit të çështjeve që mund të gjykohen me mjete alternative, siç është arbitrazhi apo ndërmjetësimi, për sa kohë që ligji specifik nuk e ka bërë një saktësim të tillë.

Edhe në nivel ndërkombëtar, studiues të ndryshëm mbajnë qëndrimin se jo çdo lloj konflikti mund të zgjidhet nëpërmjet arbitrazhit dhe ndërmjetësimit.¹⁰⁷⁵ Për shembull, mosmarrëveshjet lidhur me pavlefshmëritë e themelimit të shoqërive apo pavlefshmëri të tjera të akteve të organeve të shoqërive për shkak të efekteve erga-omnes,¹⁰⁷⁶ ndikojnë edhe në interesa të personave të tretë,¹⁰⁷⁷ apo interesa publikë.¹⁰⁷⁸ Sipas këtyre studiuesve, çështjet që përfshijnë edhe të drejta publike ose interesat e palëve të treta janë objekt i autoritetit unik shtetëror dhe nuk mund t'i nënshtrohen arbitrazhit dhe ndërmjetësimit.¹⁰⁷⁹

Studiues të tjerë të së drejtës tregtare, mbajnë qëndrimin se arbitrazhi mund të aplikohet në të gjitha mosmarrëveshjet, rregullimi i të cilave varet nga autonomia e vullnetit (liria) e palëve për të negociuar mes tyre.¹⁰⁸⁰ Pra, duke mos përjashtuar as konfliktet që lidhen me pavlefshmëritë në shoqëritë tregtare.

Ndërkohë Neni 402 i Kodit të Procedurës Civile parashikonte se “Çdo pretendim pasuror ose kërkesë që rrjedh nga një marrëdhënie pasurore, mund të jetë objekt i një gjykimi të arbitrazhit”.¹⁰⁸¹

Mbajmë parasysh se i gjithë Titulli IV i dispozitave të K.Pr. Civile nga neni 402 e vijues që rregullojnë Arbitrazhin janë shfuqizuar me ligjin nr. 122/2013, datë 18.4.2013, por sipas

¹⁰⁷³ Flutura Kola Tafaj dhe Silvana Cinari, *Zgjidhjet Alternative të Mosmarrëveshjeve* (Shtëpia botuese “Albas” 2015) fq. 79-80.

¹⁰⁷⁴ Shih Vendimin 00-2017-2682 dt. 19.12.2017 e Kolegji Civil të Gjykatës së Lartë.

¹⁰⁷⁵ Miquel Martín-Casals dhe Diego M. Papayannis, *Uncertain Causation in Tort Law* (Cambridge University Press 2016) fq. 281-286.

¹⁰⁷⁶ Gert-Jan Vossestein, *Modernization of European Company Law and Corporate Governance* (Kluwer Law International 2010) fq. 25-26.

¹⁰⁷⁷ Për më shumë rreth efektit erga omnes të vendimit shih: Faik Brestovci, Iset Morina, Rrustem Qehaja, *E Drejta procedurale civile, procedura kontestimore* (Universiteti i Prishtinës, Fakulteti Juridik 2017).

¹⁰⁷⁸ Erlanda Agaj, “Regjimi i pavlefshmërisë juridike në shoqëritë tregtare të kapitalit: Aspekte teorike dhe praktike” (Punimin shkencor, Shkolla e Magjistraturës 2018) fq. 124-130. Shiko edhe Vendimin e Gjykatës Federale Gjermane (Bundesgerichtshof), 06 prill 2009, Nr. i çështjes Zr. 255/08.

¹⁰⁷⁹ Erlanda Agaj, “Regjimi i pavlefshmërisë juridike në shoqëritë tregtare të kapitalit: Aspekte teorike dhe praktike” (Punimin shkencor, Shkolla e Magjistraturës 2018) fq. 124-125.

¹⁰⁸⁰ Argita Malltezi, Jonida Rystemaj dhe Lealba Pelinku, *Aspekte të së drejtës së biznesit në Shqipëri* (Shtëpia botuese “Mediaprint” 2013) fq. 537-538.

¹⁰⁸¹ Shih nenin 402 të K. Pr. Civile para se të bëheshin ndryshimet në kod me ligjin 122/2013.

nenit 49 të ligjit 122/2013, datë 18.4.2013, ky shfuqizim do të hyjë në fuqi kur të miratohet ligji për arbitrazhin. Ndërkohë, edhe pse kanë kaluar disa vite, nuk rezulton që të jetë miratuar akoma ligji për arbitrazhin, për pasojë janë akoma të zbatueshme dispozitat e K.Pr. Civile.

Ndërkohe ligji për ndërmjetësimin 10385/2011 pika 2 e nenit 2 parashikon se:

*“2. Ndërmjetësimi zbatohet për zgjidhjen e të gjitha mosmarrëveshjeve në fushën e së drejtës civile, tregtare, të punës dhe familjare, pronësisë intelektuale, të drejtave të konsumatorëve, si dhe të mosmarrëveshjeve midis organeve të administratës publike dhe subjekteve private”.*¹⁰⁸²

Ky ligj përse i përket fushës së zbatimit të ndërmjetësimin, ka implementuar parashikimet e Direktivës së KE Nr, 52 të vitit 2008,¹⁰⁸³ *“Mbi disa aspekte të ndërmjetësimin në çështjet civile dhe tregtare”*.¹⁰⁸⁴

Vetë neni 4/1 i ligjit 9901/2008 parashikone se: *“Nëse nuk parashikohet ndryshe, gjykata e përmendur në këtë ligj është seksioni tregtar i gjykatës së rrethit gjyqësor përkatës, sipas dispozitave të neneve 334 deri në 336 të Kodit të Procedurës Civile.”*¹⁰⁸⁵

Ky lloj formulimi u jep palëve mundësi që të përfshijnë një gamë të gjerë të çështjeve në klauzolat e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve nëpërmjet mënyrave alternative të zgjidhjes së konflikteve, pasi nuk bën përjashtim për asnjë lloj mosmarrëveshjeje.

Gjithashtu, Gjykata e Lartë, në vendimin Nr. 1339 dt. 10.07.2003, e ka pranuar klauzolën e arbitrazhit në mosmarrëveshjet brenda shoqërive tregtare pa asnjë kufizim.¹⁰⁸⁶

Ndërsa ligji Nr. 110/2016 “Për Falimentimin” i ndryshuar, Neni 3 pika 9 përcakton se *“Gjykatë e falimentimit” është gjyqtari i vetëm i seksionit tregtar në gjykatën e rrethit gjyqësor, i ngarkuar me procedurat e falimentimit*”

Ky është një parashikim më i qartë dhe kufizues lidhur me këtë çështje, pasi nuk përfshin shprehjen “nëse nuk parashikohet ndryshe”, pra nuk i jep të drejtë palëve të parashikojnë klauzola për mjete alternative të zgjidhjes së konfliktit. Si rrjedhim, mund të thuhet se në procedurat e falimentit nuk mund të aplikohet arbitrazhi dhe ndërmjetësimi.

¹⁰⁸² Shih Ligjin 10385/2011 “Për Ndërmjetësimin në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve” [2011] FZ 25 i ndryshuar me ligjin 26/2018 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 10385, datë 24.2.2011, “Për ndërmjetësimin në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve” [2018] FZ 85.

¹⁰⁸³ Directive 2008/52/EC of the European Parliament and of the Council of 21 May 2008 on certain aspects of mediation in civil and commercial matters [2008] OJ L 136/3.

¹⁰⁸⁴ Për më shumë rreth direktivës shih; Giuseppe De Palo dhe Mary B Trevor, *EU Mediation Law and Practice* (Oxford University Press 2012).

¹⁰⁸⁵ Ligji 9901/2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” i ndryshuar, neni 1 pika 4.

¹⁰⁸⁶ Vendimi Nr Nr. 1339 dt. 10.07.2003 i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.

Në kushtet, kur vendi ynë është akoma në konditat e draftimit të ligjit për arbitrazhin dhe arbitrazhin ndërkombëtar,¹⁰⁸⁷ është pikërisht momenti për të parashikuar edhe dispozita të qarta përsa i përket aplikimit të arbitrazhit në sferën e mosmarrëveshjeve të shoqërive tregtare. Pra, nëse do të jetë i aplikueshëm në të gjitha llojet e mosmarrëveshjeve, apo do të ketë rezerva përsa i përket shqyrtimit të pretendimeve për pavlefshmëri në shoqëritë tregtare.

¹⁰⁸⁷ Projektligji “Per Arbitrazhin ne Republikën e Shqipërisë” <<https://konsultimipublik.gov.al/Konsultime/Detaje/292>> aksesuar më 20 nëntor 2020.

KREU IX

9. Konkluzione dhe Rekomandime

Në këtë kre janë përmbledhur konkluzione të ndryshme, të cilat mund të përmblihen shkurtimisht si në vijim:

- i. Konkluzionet që lidhen me kuptimin dhe interpretimin më të saktë të dispozitave ligjore që janë zbatuar në mënyrë jo uniforme në praktikën gjyqësore, veçanërisht për institutet:
 - e përfaqësimit të ortakut në AO,
 - mënyrën e ndarjes së fitimit apo ushtrimit të së drejtës së votës,
 - autonomisë statutore,
 - Përfjashtimit dhe largimit të ortakut etj.
- ii. Konkluzione të karakterit organizativ-administrativ, që lidhen me:
 - rolin e rëndësishëm të statutit në SHPK,
 - funksionimin e organeve të administrimit, apo;
 - performancës së institucioneve shtetërore, si QKB, institucionet fiskale etj.
- iii. Konkluzione që lidhen me jurisprudencën dhe gjyqësorin; në kuadër të unifikimit të praktikave më të mira në interpretimin dhe zbatimin e ligjit 9901/2008.

Gjithashtu, në këtë kapitull janë përfshirë rekomandimet e autorit të këtij punimi, të cilat janë të katër kategorive të ndryshme, si më poshtë.

- i. Rekomandime të karakterit legjislativ-draftues;
- ii. Rekomandime të karakterit organizativ-administrativ;
- iii. Rekomandime që lidhen me jurisprudencën dhe gjyqësorin;
- iv. Rekomandime të karakterit doktrinor dhe edukativ.

Trajtimi në vijim prezanton në mënyrë të imtësishme konkluzionet dhe rekomandimet për secilin kre, respektivisht:

KREU 2. Zhvillimi Historik i Shoqërive më Përgjegjësi të Kufizuar në Shqipëri

Për shkak të rrethanave historike, në vendin tonë, deri në periudhën e mesjetës, ka pasur një ndikim të theksuar e drejta zakonore e ndikuar nga e drejta romake dhe modelet e njohura nga ky legjislacion edhe në fushën tregtare. Më pas, për shkak të ndikimit të ushtruar nga Perandoria Osmane, është zbatuar legjislacioni osman dhe e drejta islame, e cila është zhvilluar që nga shekulli VIII dhe IX, e në vazhdim. Nga hulumtimet e studiuesve të së drejtës islame, rezulton se ky sistem normash e ka njohur edhe konceptin e shoqërive tregtare si subjekte të së drejtës, madje edhe shoqërinë me përgjegjësi të kufizuar, si një formë organizimi tregtie me emrin *Kirad* ose *Mudarabah*.

Ndërsa, në periudhën e Mesjetës së hershme (shekulli XI), në Evropë është zhvilluar sipërmarrja tregtare me emrin *Komenda*, e cila nënkupton bashkëpunimin mes një sipërmarrësi aktiv dhe një ose më shumë investitorëve që mbajnë përgjegjësi të kufizuar për humbjet e shoqërisë. Ky ishte një koncept i ngjashëm me shoqëritë komandite dhe paraardhës i konceptit modern për shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar.

Format e organizimit apo bashkëpunimit tregtar të njohura në periudhën e lashtësisë (kur kanë lulëzuar qytetërimi grek, ilir dhe ai romak), kanë qenë kryesisht në formën e huasë detare (*foenus nauticum*). Kjo lloj huaje apo kredie, ishte një marrëdhënie kontraktuale midis sipërmarrësve tregtarë, që posedonin anije lundrimi dhe një apo më shumë investitorëve, të cilët mbështesnin financiarisht dhe/ose me kapitale sipërmarrësin lundërtar, me qëllim minimizimin e riskut të sipërmarrjes. Megjithatë, me zhvillimin e të Drejtës Romake janë njohur dhe forma të organizimit të biznesit (*societas consensu contracta*), të cilat paraqesin disa ngjashmëri me shoqërinë me përgjegjësi të kufizuar, por, gjithsesi, nuk pranohej plotësisht koncepti i personalitetit juridik të pavarur të këtyre shoqërive. Rreth shekullit II para Krishtit u shfaq një strukturë e re e sipërmarrjes tregtare, që drejtohej nga një skllav, i cili ishte në bashkëpronësi të dy ose më shumë personave (*negotiatio per servos communes*). Siç dihet, në të drejtën romake, skllavërit nuk gëzonin cilësinë e personit, por kategorizoheshin si sende apo objekt i së drejtës së pronësisë (*in potestas*). Kjo lloj sipërmarrjeje tregtare, e drejtuar nga skllavi, posedonte edhe kapitale të caktuara, të cilat ishin të identifikuar si *peculium*. Kjo mund të konsiderohet një formë e ngjashme me konceptin modern të përgjegjësisë së kufizuar, pasi kreditorët nuk mund të kërkonin shlyerjen e borxhit me pasurinë e pronarit të skllavit, por vetëm me pasurinë e investuar në tregti (*peculium*) dhe në rastin ekstrem, me jetën e skllavit që drejtonte këtë sipërmarrje.

Në fund të shekullit XIX dhe dy dekadat e para të shekullit XX, kur shoqëritë tregtare me përgjegjësi të kufizuar filluan të bëhen një realitet në vendet e Evropës Përendimore, Shqipëria, zbatonte akoma legjislacionin osman që ishte Kodi Civil Osman, i njohur si "*Mexheleja*". Ky Kod u miratua në kuadër të Reformave të Tanzimatit, në mes të shekullit XIX, dhe ishte pjesë e një reformimi tërësor të kuadrit ligjor osman sipas modeleve përparimtare të kohës. Pas shpalljes së pavarësisë, në legjislacionin e miratuar nga shteti shqiptar, SHPK-të janë rregulluar për herë të parë në Kodin Tregtar të vitit 1932. Në këtë kod, SHPK-të njiheshin me emrin "*Shoqni me garanci të kufizueme*" dhe ishin pjesë e një legjislacioni shumë përparimtar, të harmonizuar me modelet më të mira që njiheshin në Evropë në fushën e shoqërive tregtare.

KREU 3. Evoluimi i legjislacionit shqiptar për Shoqëritë me Përgjegjësi të Kufizuar

Evoluimi i legjislacionit për SHPK-të në vendin tonë fillon me reformat ligjore të kohës së Monarkisë Shqiptare, nga viti 1928 e në vijim. Me miratimin Kodit Civil të vitit 1928 u parashikuan shoqëritë tregtare të themeluara me kontratë. Kodi Civil i vitit 1928 njohte shoqëritë e përgjithshme apo universale, si dhe shoqëritë partikolare. Këto shoqëri gëzonin personalitet juridik të pavarur nga ortakët, dhe paraqisnin disa ngjashmëri me SHPK-të. Por ndryshe nga SHPK-të, në këto shoqëri nuk ishte konsoliduar parimi i përgjegjësisë së kufizuar të ortakut. Karakteristika kryesore e këtyre shoqërive ishte se ato themeloheshin mbi vullnetin e ortakëve, duke u mbështetur kryesisht në mirëbesimin reciprok dhe cilësitë e veçanta të secilit ortak (*intuitu personae*).

Me hyrjen në fuqi të Kodit Tregtar të vitit 1932, u prezantuan dhe format moderne të shoqërive tregtare në legjislacionin shqiptar. Një nga këto forma ishte dhe *shoqnia me garanci të kufizueme*, e cila përkon me konceptin e sotëm të SHPK-së. Ky Kod përbënte një korpus të plotë juridik dhe shumë modern për zhvillimin e tregtisë në vendin tonë, duke parashikuar rregulla të detajuar për themelimin dhe organizimin e katër formave të shoqërive tregtare që njihen dhe sot në legjislacionin aktual.

Kodi përcaktoi rregulla të detajuar për mënyrën e themelimit të SHPK-ve, të funksionimit të tyre, të organeve drejtuese, rastet e prishjes së këtyre shoqërive, si dhe mënyrën e likuidimit. Megjithëse ka kaluar pothuajse një shekull nga koha e miratimit të këtij Kodi, vihet re që rregullimet ligjore të tij kanë qenë shumë përparimtare dhe të ngjashme edhe me legjislacionin më modern shqiptar në fushën e shoqërive tregtare, të miratuar pas reformave të vitit 2008. Madje disa prej instituteve juridike të rregulluara nga Kodi Tregtar i vitit 1932, si psh. ai i “*përrjashtimit të ortakut*” apo “*tërheqjes së ortakut*”, nuk janë njohur as në legjislacionin tregtar të implementuar në vitin 1992 e në vazhdim, deri në hyrjen në fuqi të ligjit aktual 9901/2008. Kjo infrastrukturë ligjore krijonte kushtet për themelimin dhe organizimin e sipërmarrjeve të ndryshme tregtare në Shqipëri, sipas modeleve më të zhvilluara të vendeve përëndimore. Si rrjedhim përbënte një shtysë pozitive për investitorët nga vende të ndryshme, për të investuar në Shqipëri.

Në periudhën pas Luftës së Dytë Botërore e deri në vitin 1991, në vendin tonë u imponua sistemi politik komunist, përgjatë të cilit ka pasur një regres të vazhdueshëm në të gjitha konceptet e ekonomisë së tregut të lirë, deri në mbylljen totale dhe zhdukjen e konceptit të shoqërive me përgjegjësi të kufizuar, dhe të gjitha shoqërive tregtare si forma të sipërmarrjes së lirë ekonomike. Në Kushtetutat e vitit 1946 dhe atë të 1950, u konsoliduan të gjitha parimet e një rendi ekonomik të centralizuar, ku mjetet e prodhimit dhe burimet ekonomike, tregtia e jashtme dhe tregtia e brendshme, ishin të gjitha në kontroll të shtetit. Për pasojë, nuk mbetej më hapësirë për veprimtarinë e lirë të shoqërive tregtare. Ligji 2022

dt. 02.05.1955 “*Për Pjesën e Përgjithshme të Kodit Civil*”, hoqi në mënyrë përfundimtare mundësinë e themelimit të shoqërive tregtare, pasi nuk njihite personat juridikë privatë.

Me rënien e sistemit komunist në Shqipëri, në vitin 1991, u hodhën dhe hapat e parë që synonin një demokraci funksionale në vendin tonë dhe riinstalimin e një sistemi të ekonomisë së tregut të lirë. Këto ndryshime demokratike sollën një tërësi reformash ligjore dhe institucionale, me qëllim ndërtimin e shtetit të së drejtës dhe respektimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, përfshirë edhe të drejtën e iniciativës së lirë ekonomike. Ligji Nr. 7491, datë 29.4.1991 “*Për Dispozitat Kryesore Kushtetuese*”, në nenin 10 të tij, riktheu në Shqipëri konceptin e pronës private, duke i garantuar mbrojtje kushtetuese. Gjithashtu, në këtë nen konfirmohet e drejta për iniciativën e lirë ekonomike e të gjitha subjekteve. Ndryshimet politiko-ekonomike të vendit, si dhe ndryshimet kushtetuese, ekspozuan nevojën e një reforme tërësore për rregullimin më të hollësishëm të aktivitetit tregtar në Shqipërinë e pas vitit 1991. Këto ndryshime i dhanë një kthesë pozitive rrugëtimit të vështirë të evoluimit të legjislacionit për shoqëritë tregtare në vendin tonë.

Një nga hapat e parë legjislativë në të drejtën tregtare ishte hyrja në fuqi e Ligjit 7512, datë 10.08.1991 “*Për sanksionimin dhe mbrojtjen e pronës private, të nismës së lirë, të veprimtarive private të pavarura dhe privatizimit*”. Me anë të këtij ligji, për herë të parë pas shumë dekadash, u pranua edhe në Shqipëri mundësia për të krijuar sipërmarrje tregtare, qoftë si individid, ashtu edhe si shoqëri tregtare. Në kuadër të këtyre reformave, me qëllim plotësimin e nevojave për kuadrin ligjor që rregullon funksionimin e subjekteve tregtare, në vitin 1992, u miratua dhe Ligji nr. 7632, datë 04.11.1992 “*Për dispozitat që rregullojnë pjesën e parë të Kodit Tregtar*”, si një hap që synonte kodifikimin e legjislacionit tregtar dhe ravijëzonte natyrën juridike të së drejtës tregtare, si lëndë e dallueshme nga e drejta civile në përgjithësi. Legjislacioni tregtar nuk ndoqi një model të kodifikuar, por u pasurua në vazhdim me ligje të tjera, të cilat gjithsesi përmirësuan në mënyrë domethënëse infrastrukturën juridike për sipërmarrjet tregtare në përgjithësi, përfshirë dhe SHPK-të.

Hapi më i rëndësishëm pas vitit 1992, në zbatim të reformave demokratike, ishte pa dyshim ligji Nr.7638, datë 19.11.1992 “*Për shoqëritë tregtare*”, në të cilin u përcaktuan katër format e shoqërive tregtare, të cilat mund të themeloheshin në Shqipëri, kuptimi, organizimi dhe funksionimi i këtyre shoqërive. Në këtë ligj u përcaktuan rregulla të detajuar për mënyrën se si themelohen shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar, si funksionojnë ato dhe cilat janë organet drejtuese dhe përfaqësuese të SHPK-ve, rastet e prishjes së tyre, si dhe mënyra e likuidimit të këtyre shoqërive. Në këtë ligj parashikohej mundësia për të themeluar një SHPK, nga një ose më shumë persona fizikë ose juridikë, të cilët përballojnë humbjet e shoqërisë vetëm deri në kufirin e vlerës së kontributit të tyre në kapitalin themeltar. Në ndryshim nga ligji aktual, i cili në nenin 71 të tij parashikon disa detyrime

formale për shoqërinë që mbetet me një ortak, në ligjin e vitit 1992 nuk konstatohen këto detyrime. Gjithashtu ky ligj nuk parashikonte institutet e përjashtimit apo largimit të ortakut. Në këtë punim janë analizuar në mënyrë të detajuar ndryshimet e kuadrit ligjor përsa i përket SHPK-ve në raport me ligjin 9901/2008.

Në mbështetje të ligjit të vitit 1992 “Për shoqëritë tregtare”, u miratua dhe ligji nr. 7667, datë 28/01/1993 “Për Regjistrin Tregtar dhe formalitet që duhet respektuar nga Shoqëritë Tregtare”, sipas të cilit, të gjitha shoqëritë tregtare duhet të regjistroheshin në Regjistrin Tregtar të Gjykatës së Rrethit Tiranë nëpërmjet një procedure gjyqësore.

Gjatë kësaj periudhe, kuadri ligjor i shoqërive tregtare u pasuria me ligje të tjera, si: Ligji Nr. 7926 dt. dt 20.4.1995 “Per transformimin e ndërmarrjeve shtetërore në shoqëri tregtare”, Ligji Nr. 8334, datë 23.4.1998 “Për privatizimin e shoqërive tregtare që veprojnë në sektorët jostrategjikë” dhe një sërë ligjesh dhe aktesh nënligjore, si vendime të Këshillit të Ministrave, urdhra të ministrave dhe akte të tjera në këtë fushë. Një hap të rëndësishëm në plotësimin e legjislacionit civil dhe tregtar të kësaj periudhe, përbente miratimi i Kodit Civil të R.Sh. me Ligjin Nr.7850, datë 29.7.1994, në të cilin u rregullua dhe kategoria e personave juridikë privatë, në kategorinë e subjekteve të së drejtës, duke përfshirë këtu edhe shoqëritë tregtare.

Me Kushtetutën e vitit 1998, Shqipëria avancoi akoma më shumë në synimin e saj për të implementuar një shtet të së drejtës dhe garantimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut sipas standardeve më të mira ndërkombëtare. Për këtë qëllim, Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut u implementua në vetë Kushtetutën tonë. Në nenin 11 të Kushtutës parashikohet që, sistemi ekonomik i vendit bazohet mbi parimet e mbrojtjes së pronës private, si dhe të ekonomisë së tregut të lirë. Gjykata Kushtetuese e ka zbërthyer këtë liri edhe në të drejta dhe liri të tjera, si liria e ushtrimit të biznesit/veprimtarisë tregtare, e drejta për të krijuar dhe ushtuar një sipërmarrje tregtare, liria e tregtisë në fushën importimit apo eksportimit të mallrave dhe shërbimeve etj.

KREU 4. Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar si Subjekt i Pavarur i së Drejtës dhe Karakteristikat e Veçanta të saj

SHPK-të si formë e veçantë e shoqërive tregtare kanë disa karakteristika thelbësore dhe veçori dalluese në raport me subjektet e tjera të së dejtës tregtare. Sipas ligjit Nr. 9901/2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” i ndryshuar, shoqëritë kolektive, shoqëritë komandite, shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar dhe shoqëritë aksionare, janë tregtare për shkak të formës së tyre. Regjistrimi i shoqërive tregtare në Qendrën Kombëtare të Biznesit, është kusht pa të cilin nuk do të fitonin personalitetin juridik (*condicio juris*). Karakteristika më thelbësore e të gjitha shoqërive tregtare në përgjithësi, përfshirë dhe SHPK-të, është

personaliteti juridik i veçantë i tyre. Ky personalitet juridik i shoqërisë është i pavarur nga personaliteti juridik i ortakëve të saj.

Një nga përfitimet e këtij fakti është dhe përgjegjësia e kufizuar e ortakëve për detyrimet e shoqërisë, si dhe fakti që vetë shoqëria nuk mban përgjegjësi për detyrimet personale të ortakëve. Ky është një tipar karakteristik i shoqërive të kapitalit, siç janë shoqëria me përgjegjësi të kufizuar dhe shoqëria aksionare. Personaliteti i veçantë juridik bën të mundur që shoqëria të zotërojë prona dhe të figurojë në regjistrat e pasurive të paluajtshme apo regjistrat e pasurive të tjera që regjistrohen (si psh. automjetet apo aksionet), si pronare e pasurive të saj. Madje një SHPK mund të disponojë dhe kuota apo aksione në një shoqëri tjetër tregtare me përgjegjësi të kufizuar apo aksionare, duke marrë kështu dhe rolin e ortakut apo aksionarit. Pasuritë që janë në emër të shoqërisë, i administrojnë vetë shoqëria dhe jo ortakët e saj. Ky administrim bëhet në interesin e shoqërisë, në kuadër të aktivitetit tregtar të pasqyruar në statut. Kjo vlen edhe në rastet kur shoqëria tregtare është shoqëri me një ortak të vetëm.

Qëllimi primar i themeluesve të një SHPK-je, është që të realizojnë fitime për veten e tyre, duke bërë të mundur që një apo disa sipërmarrje tregtare të kryhen në emër dhe për llogari të një subjekti tjetër, siç është SHPK-ja, e cila mban të gjithë përgjegjësinë e veprimeve dhe marrëdhënieve me kreditorët dhe të tretët. Ndërkohë që SHPK-ja, si formë e shoqërisë tregtare, u jep mundësi ortakëve të saj, që në përfundim të çdo viti financiar, të përfitojnë ekonomikisht nga ndarja e fitimit neto që realizon shoqëria. Pra forma e SHPK-së si shoqëri tregtare, u jep çdo qytetari apo subjekti të së drejtës mundësi, duke përfshirë këtu të gjitha kategoritë e personave juridikë (persona juridik publikë, si institucionet apo entet shtetërore, persona juridikë (privat apo publik), që të bëhen pjesë e një sipërmarrje tregtare, si ortakë të kësaj shoqërie. Madje, edhe në rastet kur ligje të posaçme parashikojnë kufizime apo ndalesa për subjekte të caktuara të së drejtës, (persona fizikë apo juridikë) që të ushtrojnë veprimtari tregtare në cilësinë e tregtarit, ky lloj kufizimi nuk i ndalon ata që të jenë ortakë në një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar. (me përjashtim të rasteve kur kufizimi ligjor e shpreh në mënyrë eksplicite edhe ndalimin e të drejtës për të qenë ortak në një SHPK).

Koncepti i përgjegjësisë së kufizuar, është një nga bazat e ekzistencës dhe zhvillimit të SHPK-ve. Ky koncept konsiston në garancinë që kanë ortakët, që të mos mbajnë përgjegjësi financiare dhe pasurore për humbjet, apo borxhet që shoqëria ka ndaj kreditorëve të ndryshëm. Pasuria personale e ortakëve të shoqërisë është e ekspozuar ndaj kërkimeve të kreditorëve, vetëm deri në vlerën e pashlyer të kontributit të nënshkruar në shoqëri. Në kushte normale, pjesa tjetër e pasurisë personale të ortakut është e “*imunizuar*” nga pretendimet e kreditorëve të shoqërisë. Që do të thotë, se kreditorët e shoqërisë nuk kanë të drejtë të pretendojnë shlyerjen e detyrimeve me pasurinë personale të ortakëve të

SHPK-së. Përgjegjësia e kufizuar, e kombinuar me efektet e personalitetit të pavarur juridik të shoqërisë, janë mekanizma juridikë që i sigurojnë ortakut “*imunitet*” për borxhet e shoqërisë, por edhe shoqërisë i sigurojnë mbrojtje dhe “*imunitet*” për paprekshmërinë e aseteve të saj nga kreditorët personalë të ortakëve. Pra, koncepti i përgjegjësive së kufizuar është konsideruar si një privilegj për ortakët e kësaj forme shoqërie. Ky privilegj mund të ilustruhet në mënyrë figurative, si një “*petk mbrojtës*” apo “*vello mbrojtëse*”, e cila i ndalon kreditorët e shoqërisë që të kërkojnë nga ortakët e kësaj shoqërie shlyerjen e detyrimeve që nuk i shlyen dot shoqëria.

Megjithatë, koncepti i përgjegjësive së kufizuar të ortakëve të SHPK-së ka dhe disa përjashtime apo kufizime. Njëri prej këtyre përjashtimeve njihet nga literatura si koncepti i “*Piercing Corporate Veil*”, i implementuar në nenin 16 të ligjit 9901/2008. Sipas këtij instituti, ortakët e një SHPK-je mund të zhvishen nga «*petku mbrojtës*» i përgjegjësive së kufizuar, kur;

- a) me veprimet e tyre, abuzojnë me formën e shoqërisë për arritjen e qëllimeve të paligjshme,
- b) trajtojnë pasuritë e shoqërisë tregtare sikur të ishin pasuritë e tyre, si dhe;
- c) nuk kanë marrë masat e nevojshme, për të mos lejuar që shoqëria të vazhdonte veprimtarinë tregtare, megjithëse kishin marrë dijeni apo duhet të kishin marrë dijeni se shoqëria nuk ka asete të mjaftueshme për të përmbushur detyrimet ndaj kreditorëve.

SHPK-të kanë disa veçori dalluese në raport me të gjitha subjektet e së drejtës tregtare, qofshin këto shoqëri tregtare, apo tregtarët, si persona fizikë. Këto karakteristika që bashkojnë privilegjin e përgjegjësive së kufizuar dhe thjeshtësinë e themelimit dhe administrimit të tyre, i kanë bërë SHPK-të formën më të përhapur të organizimit të biznesit në vendin tonë. Këto karakteristika dalluese në raport me format e tjera të subjekteve tregtare, janë trajtuar hollësisht në këtë kre.

Nga statistikat e marra në QKB rezulton se numri total i të katër formave të shoqërive tregtare që njeh ligji Nr.9901/2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” është 60.434. Nga këto, rezulton se 58.084 janë të organizuara si SHPK. Pra, e shprehur në përqindje, rezulton se më shumë se 96 % e të gjitha shoqërive tregtare të regjistruara në QKB, janë shoqëri me përgjegjësi të kufizuar.

KREU 5. Themelimi i Shoqërive me Përgjegjësi të Kufizuar sipas Ligjit në Fuqi

Themelimi i një SHPK-je fillon me lindjen e vullnetit për të organizuar biznesin në formën e SHPK-së nga ortakët themeleues. Nëse ka më shumë se një ortak që shprehin vullnetin për të themeluar në mënyrë të përbashkët një SHPK, atëherë kërkohet përputhja e vullnetit të tyre, njësoj si në çdo kontratë tjetër. Dokumenti ku pasqyrohet vullneti i ortakëve për të

themeluar një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, si dhe rregullat e organizimit të shoqërisë, është *statuti* i shoqërisë.

Ortakët themelues duhet të paraqesin aplikimin për regjistrimin e shoqërisë pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit. Nëse një SHPK do të themelohet nga një ortak i vetëm, atëherë mjafton shfaqja e njëanëshme e vullnetit të këtij ortaku, i cili pasi ka vendosur që të organizojë strukturën e biznesit të tij, në formën e SHPK-së, nënshkruan statutin, bën aplikimin për regjistrim në QKB. Që nga momenti që ky institucion pranon aplikimin për regjistrimin e shoqërisë në regjistrin tregtar dhe lëshon ekstraktin përkatës, shoqëria konsiderohet e themeluar dhe fiton personalitetin juridik të veçantë, si subjekt i pavaruar i së drejtës. Ky regjistrim është kusht që shoqëria të fitojë personalitetin juridik dhe të konsiderohet një entitet juridik i pavarur. Pas regjistrimit shoqëria njihet me emrin e vendosur në statut, të cilit i shtohet dhe prapashtesa “SHPK”.

Ligji Nr.9723/2007 për QKB, në nenin 28/4 përcakton se ortakët themelues mund të regjistrojnë një SHPK pa paraqitur një statut të shkruar, por vetëm duke nënshkruar formularin e aplikimit për regjistrim fillestar me të dhënat e nevojshme dhe një deklaratë të posaçme për pranimin dhe zbatimin e ligjit në fuqi për SHPK-të. Në një situatë të tillë, formulari i aplikimit merr vlerën e statutit. Ky ndryshim u bë në vitin 2007, me qëllim thjeshtëzimin dhe lehtësimin e procedurave për regjistrimin e një SHPK-je, në kuadër të nxitjes së iniciativës së lirë ekonomike në Shqipëri.

Rekomandim i karakterit organizativ

Nëpërmjet këtij punimi rekomandojmë që ortakët themelues të mos e privojnë veten nga e të drejta për të pasur një statut të shkruar, në të cilin përcaktohen rregullat kryesore për aspektet më të rëndësishme të shoqërisë, si; marrëdhëniet mes ortakëve, marrëdhëniet mes tyre dhe organeve të shoqërisë, rregullat e funksionimit, rregullat e administrimit të shoqërisë tregtare etj. Parashikimi i rregullave të detajuar në statut, kontribuon në shmangien e konflikteve të mundshme që mund të lindin mes ortakëve, apo mes tyre dhe organeve të shoqërisë. Rekomandojmë që SHPK-të të përgatisin me kujdes statutin e tyre dhe ortakët t'i kushtojnë sa më shumë vëmendje dispozitave të statutit, me qëllim që ky akt të rregullojë sa më shumë situata, të cilat mund të kenë interpretime të ndryshme nga ortakët, dhe eventualisht do të mund të zgjidhen më lehtë në rast të konfliktit mes tyre.

Në nenin 32 Ligji të ligjit 9723/2007 “Për Qendën Kombëtare të Regjistrimit”, parashikohen elementet thelbësore që duhet të përfshihen në statutin e një SHPK në mënyrë të detyrueshme, si; forma, emri, selia, kohëzgjatja, kapitali, të dhënat identifikuese të ortakëve dhe administratorit dhe objekti i shoqërisë, nëse është i përcaktuar. Por, ligji aktual “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” 9901/2008, u ka njohur ortakëve të SHPK-ve

një spektër të gjerë të lirisë statutore (autonomisë statutore), duke u dhënë të drejtë ortakëve që të kontribuojnë në përmirësimin dhe plotësimin e kuadrit ligjor, mbi të cilin do të ushtrojë veprimtarinë shoqëria. Ortakët mund të përfshijnë në statut dhe rregullime më të detajuara, tej atyre të parashikuara në nenin 32 të ligjit 9723/2007 “Për Qendrën Kombëtare të Biznesit”. Rregulime të tilla mund të jenë: për të drejtën e parablerjes, shkaqet e përjashtimit apo largimit të ortakut, kompetencat e administratorëve, mënyrën dhe afatet e shlyerjes së kontributit në para, rastet shitesë, kur duhet të aplikohet një shumicë e cilësuar në mbledhjet e asamblesë, periodicitetin e mbledhjeve, marrëdhëniet mes ortakëve, të drejtën e votës, dhe ndarjen e fitimit, etj.

Ndryshe nga ligji që ka qenë në fuqi para tij (ligji Nr.7638/1992), një nga çështjet që ligji aktual 9901/2008 nuk ka rregulluar, është zmadhimi i kapitalit themeltar (të nënshkruar) të SHPK-së. Për këtë arsye, rekomandohet që ortakët të përfshijnë dispozita që normojnë dhe disiplinojnë rastet dhe procedurat e zmadhimit dhe zvogëlimit të kapitalit të nënshkruar të shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar.

Përsa i përket terminologjisë së përdorur për kapitalin në SHPK, ashtu si dhe për shoqëritë e tjera, konkludojmë se termi **kapital i nënshkruar**, i njohur dhe me termin **kapital i regjistruar** i shoqërisë, ka të njëjtin kuptim me termin **kapital themeltar**, i cili aplikohet në ligjin e mëparshëm të vitit 1992. Ky kapital i nënshkruar, nënkupton kapitalin për të cilin kanë shprehur vullnetin me anë të nënshkrimit në statut ortakët e shoqërisë, që ta ofrojnë si kontribut në shoqëri.

Ndërsa termi **kapital ligjor** është përdorur kryesisht nga doktrina dhe i referohet kapitalit minimal të kërkuar nga ligji, si kusht për themelimin e një shoqërie tregtare. Kapitali ligjor, nënkupton kapitalin e domosdoshëm të kërkuar nga ligji për themelimin e shoqërisë tregtare. Kapitali i nënshkruar, i njohur dhe si kapitali themeltar, mund të jetë i barabartë me kapitalin ligjor, ose mund të jetë më i madh sesa kapitali ligjor, por asnjëherë më i vogël se ky i fundit. Ndërsa termi **kapitalet e veta**, të shoqërisë tregtare, nënkupton tërësinë e kapitaleve dhe asetëve që janë në dispozicion të një shoqërie tregtare në një moment të caktuar kohor. Pra, simbolikisht mund të themi që kapitalet e veta janë një fotografim i asetëve të shoqërisë në një çast të caktuar. Kapitalet e veta mund të jenë më të mëdha se kapitali i nënshkruar në momentin e themelimit të shoqërisë, në rast se shoqëria nuk ka shpërndarë të gjitha fitimet si dividend ndër vite, por ka mbajtur një pjesë të fitimit vjetor si rezervë për shoqërinë. Në raste të tjera, kur shoqëria ka vepruar me humbje, mund të ndodhë që kapitalet e veta të shoqërisë të jenë më të vogla sesa kapitali i nënshkruar i shoqërisë.

Në nenin 3/1 të ligjit 9901/2008 parashikohen shkaqet e pavlefshmërisë së themelimit të shoqërive tregtare. Kjo dispozitë përcakton disa shkaqe të përgjithëshme të pavlefshmërisë

së themelimit, të cilat u referohen të gjitha formave të shoqërive tregtare. Por jo të gjitha këto raste të pavlefshmërive duhet të aplikohen në SHPK, pasi disa prej tyre janë situata specifike për shoqëritë aksionare. Për shembull, pika “dh” e nenit 3/1, u referohet vetëm SHA-ve.

Gjithashtu, në pikën “ç” të paragrafit të parë të kësaj dispozite është përcaktuar si shkak pavlefshmërie edhe rasti kur “*statuti nuk përmban dispozita në lidhje me objektin e shoqërisë*” Megjithatë duke pasur parasysh nenin 32 të ligjit për Qendrën Kombëtare të Biznesit, konstatojmë se pasqyrimi i objektit të veprimtarisë nuk është element i domosdoshëm për themelimin e SHPK-ve. Për këtë arsye konkludojmë se kjo pjesë e pikës “ç” të nenit 3/1 të ligjit, nuk është e aplikueshme për SHPK-të, por vetëm për SHA-të. Gjithashtu formulimi i pikës “b” të nenit 3/1, duket sikur u referohet vetëm ortakëve që janë persona fizikë. Vlerësojmë se ky parashikim duhet të interpretohet për të gjitha kategoritë e ortakëve, qofshin këta persona fizikë apo persona juridikë. Pra, në këtë shkak pavlefshmërie duhet të përfshihen edhe ata persona juridikë, të cilët provohet se nuk gëzonin personalitet juridik në momentin e themelimit të SHPK-së.

Rekomandim i karakterit legjislativ-draftues

Për një kuptim më të qartë të kësaj dispozite, do të rekomandonim një përmirësim të mënyrës së formulimit të pikës “b” të nenit 3/1 të ligjit, duke përfshirë në cilësinë e ortakut, qoftë personat fizikë, qoftë personat juridikë.

Në rastet e listuara në paragrafin e parë të nenit 3/1 të ligjit, përfshihen raste të pavlefshmërisë absolute dhe raste të pavlefshmërisë relative, koncepte këto të prejardhura nga Kodi Civil. Por, ligji nuk ka bërë ndarjen apo klasifikimin e qartë, se cilat do të konsiderohen shkaqe të pavlefshmërisë absolute, dhe cilat do të konsiderohen shkaqe të pavlefshmërisë relative. Për rrjedhojë, do të jetë jurisprudenca gjyqësore, e cila do të ketë përgjegjësinë për të bërë një ndarje të tillë në rastet e konstatimit të pavlefshmërive të themelimit të shoqërive tregtare, me qëllim rregullimin e pasojave.

Sipas pikës 6 të nenit 3/1 të ligjit përcaktohet se; Pavlefshmëria e themelimit të shoqërisë, nuk mund t'u kundrejtohet palëve të treta që kanë fituar të drejta nga shoqëria pas regjistrimit të saj në QKB. Si rrjedhim, edhe pavlefshmëria absolute e themelimit të SHPK-së nuk mund të cenojë të drejtat e të tretëve, të cilët në mirëbesim kanë hyrë në marrëdhënie juridike me këtë shoqëri përpara vërtetimit të rrethanës së pavlefshmërisë në gjykatë. Ndryshe nga parimet e përgjithshme të se drejtës civile, efektet e pavlefshmërisë së themelimit të shoqërisë tregtare, fillojnë nga momenti i deklarimit/konstatimit të tyre (*ex nunc*) dhe jo nga momenti i kryerjes së veprimit të pavlefshëm (*ex tunc*). Pra, qoftë në rast të konstatimit të pavlefshmërisë absolute, apo shpalljes së pavlefshmërisë relative, ligji ka parashikuar një rregullim të posaçëm të zgjidhjes së pasojave të pavlefshmërisë

së themelimit të shoqërisë tregtare pas themelimit të shoqërisë, i cili duhet të mbahet parasysh nga gjykatat, dhe jo ai i parashikuar nga neni 92 e vijues i K. Civil.

Si konkluzion mund të themi se pavlefshmëritë që mund të hasen në shoqëritë tregtare janë të natyrave të ndryshme dhe u nënshtrohen regjimeve të ndryshme. Pavlefshmerite e themelimit në një SHPK i nënshtrohen një regjimi të posaçëm juridik i cili është i parashikuar në ligjin 9901/2008/ (*lex specialis*) dhe kanë një trajtim të veçantë të parashikuar nga neni 3/1 i këtij ligji përse i përket pasojave të këtyre pavlefshërive.

Ndërsa pavlefshmëritë e akteve që dalin nga organet drejtuese të shoqërisë gjatë aktivitetit të saj, përveç parashikimeve në ligjin e posaçëm, u nënshtrohen dhe efekteve të pavlefshërive të parashikuara nga Kodi Civil, përveç se kur ligji 9901/2008 parashikon ndryshe. Gjithsesi praktika gjyqësore në trajtimin e këtyre pavlefshërive është në zhvillim e sipër, dhe do të ishte me shumë interes edhe zhvillimi i praktikave njehsuese të Gjykatës së Lartë në këtë fushë.

KREU 6. Administrimi i Shoqërive me Përgjegjësi të Kufizuar dhe Organet e saj sipas Ligjit në Fuqi

SHPK-ja ka dy organe drejtuese, të cilat janë përgjegjëse për funksionimin e shoqërisë, nga themelimi, deri në përfundim të veprimtarisë së saj. Këto organe janë, Asambleja e Ortakëve (AO) dhe Administratori. Organi vendimmarrës i Asamblesë së ortakëve njihet në ligj dhe në doktrinë edhe me termin Asambleja e Përgjithëshme (AP), por në kuptim të ligjit 9901/2008 ka të njëjtin kuptim me termin asamble e ortakëve. AO është organi vendimmarrës, i cili ka përgjegjësinë e ruajtjes së parimeve dhe qëllimit për të cilin është themeluar shoqëria, duke mbajtur ato kompetenca thelbësore që lidhen me vendimmarrjet që u referohen elementeve thelbësore që përcaktohen edhe në statutin e shoqërisë. Ndërsa Administratori është organi përgjegjës për të gjithë veprimtarinë e zakonshme dhe të përditshme administruese dhe për përfaqësimin juridik të shoqërisë në raport me të tretët. Administrimi i SHPK-ve mund të kryhet nga një ose më shumë persona fizikë dhe nuk ka asnjë ndalim që ortaku i shoqërisë të jetë dhe administrator i saj, madje edhe për rastin kur shoqëria është me ortak të vetëm. Kompetencat dhe përgjegjësitë e administratorit janë përcaktuar në nenet 12-18, si dhe 95-98 të ligjit 9901/2008. Por, edhe AO ka disa kompetenca administrimi në kuadër të drejtimit të brendshëm organizativ të shoqërisë, që lidhen me planifikimin e politikave tregtare dhe miratimin e bilanceve, pasqyrave financiare dhe shpërndarjes së fitimit. Kompetencat e Asamblesë përcaktohen në nenet 13, 16-18 si dhe 82-94 të ligjit 9901/2008.

Në doktrinën dhe praktikën gjyqësore shqiptare marrëdhënia mes administratorit dhe vetë shoqërisë ka pasur interpretime të ndryshme, përse i përket identifikimit nëse kjo është një

marrëdhënie pune apo një kontratë tjetër shërbimi. Por, në konkluzion të analizës ligjore të këtij punimi, arrijmë në përfundimin se marrëdhënia juridike që krijohet mes administratorit dhe shoqërisë, pasqyron një kompleksitet të drejtash dhe detyrimesh të ngjashme me institutin e përfaqësimit, porosisë, komisionit, agjencisë, kontratës së punës, dhe kontratave të tjera të shërbimit, por me specifikën që shumica e të drejtave dhe detyrimeve të palëve janë parashikuar në ligjin specifik, që është ligji Nr. 9901/2008. Për këtë arsye, kjo marrëdhënie duhet konsideruar si një marrëdhënie e posaçme e shërbimit, e cila tejkalon karakteristikat e kontratës së punës. Si konkluzion, mund themi që kjo marrëdhënie buron nga një kontratë e posaçme, e parashikuar në ligjin 9901/2008, por që është në përputhje edhe me dispozitat e pjesës së përgjithshme të kontratave të Kodit Civil.

Përfaqësimi i shoqërisë është një kompetencë ekskluzive e administratorit të saj, por ligji parashikon disa raste përjashtimore, në të cilat asambleja e ortakëve merr kompetencat për përfaqësimin e shoqërisë. Neni 92 pika 1 parashikon të drejtën e AO për të ngritur padi ndaj administratorit apo ortakëve të shoqërisë. Kjo është një dispozitë e re e përfshirë me ndryshimet e vitit 2014 në ligjin 9901/2008. Nga interpretimi literal i nenit 92/1 dhe nenit 81/1 pika “g” të ligjit, duket sikur ligji legjitimon organin e Asamblesë së Ortakëve për të ngritur padinë në gjykatë dhe për të qenë palë në proces. Në kushtet kur Asambleja nuk gëzon personalitet juridik, një qëndrim i tillë do të binte ndesh me parimet procedurale civile dhe qëndrimin e një pjese të praktikës gjyqësore. Konstatohet se gjykatat nuk kanë një qëndrim të unifikuar për këtë çështje, pasi ka dhe raste që AO është legjitimuar si palë në proces.

Diskutimit mbi legjitimitimin procedural ose jo të AO, i jep zgjidhje paragrafi i tretë i nenit 92 të ligjit 9901/2008. Kjo dispozitë ka sqaruar mënyrën e përfaqësimit të shoqërisë në rastin e një gjykimi me objekt një kërkim ndaj administratorit të saj, duke parashikuar se: *“Në rastet kur shoqëria ngre padi si më sipër, ajo merr pjesë në gjykim me anë të një përfaqësuesi të posaçëm, të caktuar nga asambleja e përgjithshme. Në këto raste legjitimitimi aktiv si palë paditëse i takon shoqërisë, e përfaqësuar në gjykim nga një përfaqësues i posaçëm i caktuar me vendim të AO.*

Neni 85 i ligjit në fuqi, që rregullon përfaqësimin e ortakut në mbledhjet e asamblesë, rezulton se ka një formulim që ka shkaktuar paqartësi në zbatimin praktik. Diskutimi lidhet me faktin nëse është apo jo e vlefshme një prokurë e posaçme e lëshuar para noterit publik për përfaqësimin e ortakut në disa mbledhje të Asamblesë së Ortakëve, që nuk janë në vazhdim të të njëjtit rend dite. Nga analiza e pikës 3 të nenit 85 arrihet në konkluzionin se akti i përfaqësimit bëhet me shkresë dhe ka vlerë vetëm kur u referohet konkretisht çështjeve për të cilat do të diskutohet në mbledhjen e AO. Pra, efekti i këtij akti është për një mbledhje të caktuar, si dhe mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite, pavarësisht formës noteriale apo të thjeshtë. Ky parashikim përbën përjashtim nga rregullat e përgjithshëm të

përfaqësimit, pasi kufizon të drejtën e të përfaqësuarit që të autorizojë një përfaqësues të tij për të marrë pjesë në mbledhje të ndryshme të AO për një kohë të pacaktuar. Ky lloj përjashtimi në ligjin e posaçëm, mendojmë se mbështetet në specifikat që ka roli i ortakut në një SHPK dhe cilësitë personale të tij në ushtrimin e votës në Asamblenë e shoqërisë, qoftë në raport me shoqërinë, qoftë në raport me kreditorët e saj. Për rrjedhim, ky parashikim synon të kufizojë delegimin e cilësive të ortakut te një person tjetër, vetëm për një mbledhje të AO (si dhe ato vijuese me të njëjtin rend dite), por jo për të gjitha mbledhjet në një kohë të pacaktuar.

Rekomandim i karakterit legjislativ-draftues

Nëse ligji do të kishte një qëllim të ndryshëm nga sa më lart, atëherë do të rekomandonim riformulimin e nenit 85 të tij, në një mënyrë që t'i jepej qartësisht e drejta ortakut që të përfaqësohet në mbledhjet e AO nga një përfaqësues i posaçëm për një kohë të pacaktuar dhe për mbledhje të ndryshme të AO.

KREU 7. Të Drejtat e Ortakëve në një SHPK dhe Aspekte të Veçanta të Marrëdhënieve mes tyre sipas Ligjit në Fuqi

Të drejtat dhe detyrimet e ortakëve në një SHPK lindin që me përputhjen e vullnetit të tyre për të themeluar një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar dhe vazhdojnë deri në fazën përfundimtare të prishjes dhe çregjistrimit të saj nga Regjistri Tregtar i QKB.

Në nenin 68 pika 2 e ligjit aktual 9901/2008, parashikohet që çdo ortak ka kuotën e tij në përpjesëtim me kontributin e tij në shoqëri. Ortakët, në varësi të vullnetit dhe mundësive ekonomike të tyre, mund të kenë pjesëmarrje të ndryshme nga njëri-tjetri në kapitalin e shoqërisë. Kuota që secili ortak gëzon në një SHPK do të jetë në përpjesëtim të drejtë me kontributin që ka dhënë në kapitalin e shoqërisë. Për rrjedhojë, edhe të drejtat dhe përfitimet e ortakëve do të jenë në përpjesëtim të drejtë me këtë masë të kontributit në kapitalin e shoqërisë. Pra, në një SHPK çdo ortak ka një kuotë, por kjo kuotë nuk do të thotë që është e barabartë apo ka të njëjtën vlerë për secilin ortak. Barazia e kuotave do të ekzistonte vetëm nëse ortakët kanë kontribute të barabarta në kapitalin e SHPK-së. Gëzimi i një kuote në një SHPK është një e drejtë pasurore e njëjtë si e drejta e pronësisë mbi një send. Në doktrinën e së drejtës tregtare dhe civile, pjesët e kapitalit, pra dhe kuotat e një SHPK-je, konsiderohen sende të luajtshme të patrupëzuara.¹⁰⁸⁸

¹⁰⁸⁸ Malltezi, A., Rystemaj, J., Kromiçi, A., *Gjykatat shqiptare mbi shoqëritë dhe veprimtarinë tregtare*, Shtëpia botuese "Mediaprint", Tiranë, 2015, fq. 46.

Sipas nenit 80 të ligjit 9901/2008, parashikohet dhe mundësia e anulimit të kuotës nga shoqëria, por kjo vetëm në rast se është parashikuar në statut.¹⁰⁸⁹ Kjo dispozitë, dhe në mënyrë të veçantë pika e parë e saj, duhet të ketë një zbatim të kujdesshëm, në përputhje me parimet e këtij ligji dhe parimet e përgjithshme të mbrojtjes së të drejtës së pronësisë. Statuti nuk mund të ketë liri të pakufizuar për të anuluar kuotën për të cilën ortaku që e disponon ka paguar kontribut, pasi kjo kuotë përbën objekt të së drejtës së pronësisë së ortakut dhe u nënshtrohet garancive të së drejtës së pronësisë si çdo send tjetër. E drejta e shoqërisë për të anuluar një kuotë mund të aplikohet vetëm në raste përjashtimore, të cilat lidhen me rregullimin e pasojave të situatave të posaçme të parashikuara shprehimisht në ligj. Situata të tilla, kur shoqëria mund të vendosë për anulimin e një kuote, janë rastet, kur me vendim të gjykatës kompetente është vendosur largimi apo përjashtimi i ortakut sipas neneve 101 dhe 102 të ligjit 9901/2008, apo rastet, kur ortaku nuk ka shlyer kontributet e nënshkruara.

E drejta e votës së ortakëve në SHPK është një e drejtë që i takon çdo ortakut. Sipas nenit 88 të ligjit 9901/2008, vlera e votës (pesha specifike e saj) është në përpjesëtim të drejtë me pjesën e kapitalit (kuotën) e secilit ortak, nëse statuti nuk përcakton një ndarje të votave në mënyrë të ndryshme. Rregulli i përgjithshëm i ushtrimit të së drejtës së votës, është ai i proporcionalitetit me kontributet, por statutit i delegohet e drejta të parashikojë dhe një rregullim të ndryshëm. Konstatojmë që ligji nuk ka vendosur kufizime, se deri në çfarë mase mund të aplikohet liria (autonomia) statutore dhe për këtë arsye, mbetet i hapur diskutimi, nëse do të ishte e vlefshme një klauzolë e statutit, e cila të parashikojë të drejta vote që janë në mënyrë të dukshme jo proporcionale me kontributin e ortakëve. Kjo liri statutore do të kishte kuptim nëse do të synonte barazimin e së drejtës së votës për të gjithë ortakët e shoqërisë, por jo parashikime krejtësisht shpërpjesëtimore, nga të cilat një apo disa ortakë do të dilnin dukshëm më të dëmtuar se një apo disa të tjerë. Ky konkluzion mbështetet në parimet e përgjithshme të interpretimit të kontratave të parashikuara në Kodin Civil dhe konkretisht, në nenin 686 paragrafi i dytë të K. Civil, i cili parashikon pavlefshmërinë e kushteve kontraktore, të cilat sjellin humbje të shpërpjesëtuar për njërin palë.

E drejta e pjesëmarrjes në fitim. Në të njëjtin konkluzion arrijmë edhe përsa i përket të drejtës për të marrë pjesë në fitimet e shoqërisë, pra shpërndarjes së dividendit. Në nenin 76 të ligjit parashikohet se fitimi u shpërndahet ortakëve në raport me kuotat e zotëruara, në rast se nuk ka ndonjë parashikim tjetër në statut. Pra, rregulli i përgjithshëm është proporcionaliteti me kontributet por statutit i delegohet e drejta të parashikojë dhe një rregull të ndryshëm, njësoj si në rastin e së drejtës së votës.

¹⁰⁸⁹ Ligj, Nr.9901, Dt. Aktit:14.04.2008, Dt. Miratimit:14.04.2008, Fletore Zyrtare Nr.60, Faqe: 2631, i ndryshuar, neni 80.

Rekomandim i karakterit legjislativ-draftues

Për një kuptim më të qartë të autonomisë statutore në rastin e të drejtës së votës dhe pjesëmarrjes në fitimet e shoqërisë, do të ishte me interes një rishikim i formulimit të neneve 88 dhe 76 të ligjit 9901/2008 nga ana e legjislatorit, me qëllim që të përcaktohet dhe kufizimi që mund të ketë shmangia nga parimi i proporcionalitetit me kontributet e ortakut, që përbën rregullin e përgjithshëm.

Përrjashtimi nga e drejta e votës. Në nenin 89 të ligjit në fuqi parashikohen rastet kur ortakët përrjashtohen nga e drejta e votës në asamble. Të gjitha rastet e listuara në këtë dispozitë lidhen me shmangien e konfliktit të interesit. Pavarësisht se nuk është përrfshirë shprehimisht në nenin 89, përrjashtimi nga e drejta e votës duhet të zbatohet edhe për rastin kur diskutohet ngritja e padisë për përrjashtimin e një ortaku nga shoqëria, i parashikuar në nenin 102 të ligjit 9901/2008. Nga analiza e bërë në këtë punim arrihet në konkluzionin se ky lloj vendimi përrfshin dy nga pikat e nenit 89, që parashikon rastet në të cilat përrjashtohet vota e ortakut në mbledhjen e Asamblesë, konkretisht pikën “a) vlerësimin e veprimtarisë së tij”, si dhe pikën “c) ngritjen e një padie ndaj tij nga shoqëria;”.

Transferimi i kapitalit në një SHPK bëhet në mënyrë të lirshme dhe e drejta e parablerjes nuk është kusht, për sa kohë që nuk parashikohet shprehimisht në statut. Sipas ligjit aktual parashikohet një fleksibilitet i theksuar në transferimin e kapitalit të shoqërisë. Mjafton të shprehet vullneti në formë shkresore të thjeshtë, mes ortakut ekzistues dhe personit që do të fitojë pronësinë e kuotës në një shoqëri, që kontrata të konsiderohet e vlefshme dhe të prodhojë pasoja juridike. Nuk kërkohet ndonjë formë solemne (noteriale) për kontratat që kanë për objekt transferimin e pronësisë së kuotave të një SHPK-je. Me ndryshimet që iu bënë ligjit 9901/2008, në vitin 2014, nuk kërkohet si kusht regjistrimi i kontratës në Qendrën Kombëtare të Biznesit, apo ndonjë formalitet tjetër me efekt deklarativ. Në këtë mënyrë janë krijuar dhe kushtet për të siguruar një shkallë të lartë të privatësisë në transferimin e kapitalit të SHPK-ve.

E drejta e parablerjes. Ndryshe nga sa parashikohet në Kodin Tregtar të vitit 1932 dhe në ligjin e mëparshëm Nr.7638 të vitit 1992 “Për shoqëritë tregtare”, ligji aktual nuk ka përrfshirë si të detyrueshëm respektimin e të drejtës së parablerjes.

Largimi i ortakut. Në nenin 101 të ligjit 9901/2008, parashikohet e drejta e ortakut të SHPK-së që të largohet me vullnetin e tij nga shoqëria, kur ai vlerëson se të drejtat e tij janë cenuar nga ortakët e tjerë, apo nga shoqëria, si dhe kur ndaj tij vendosen detyrime të paarsyeshme, që e bëjnë të pamundur vazhdimin e ortakërisë. Terminologjia e përdorur nga ligji për këtë institut, rezulton se, në disa raste, ka krijuar keqkuptime duke e përdorur në praktikë shprehjen “largim të ortakut”, edhe në rastin kur shoqëria apo ortakët e tjerë

janë duke aplikuar në fakt institutin e përjashtimit të ortakut kundër vullnetit të tij. Për këtë arsye, do të ishte e rekomandueshme, që legjislatori të përmirësojë terminologjinë e këtij instituti në mënyrë të ngjashme me Kodin Tregtar të vitit 1932, në të cilin përdorej termi “*tërheqja e shokut*”, pra tërheqja e ortakut.

Rekomandim i karakterit legjislativ-draftues dhe jurisprudencial për gjyqësorin

Në nenin 101 të ligjit, parashikohet se është e drejtë e asamblesë së ortakëve, që të shqyrtojë kërkesën dhe të verifikojë nëse ekzistojnë shkaqet e arsyeshme të largimit dhe në varësi të saj, të vendosë nëse ortakut do t'i likuidohet kuota apo jo. Gjithsesi ortaku ka të drejtën e kundërshtimit të këtij vendimi në gjykatë, si dhe të kërkojë likuidimin e kuotës, në rast se provohet se ortaku është larguar për shkaqe të arsyeshme.

Evidentohet një qëndrim jo uniform i praktikës gjyqësore dhe doktrinës, përse i përket faktit nëse largimi i ortakut do të prodhojë pasoja në mënyrë të menjëherëshme me shfaqjen e vullnetit të njëanshëm të tij, apo do të duhet patjetër të pranohet kërkesa për largim nga Asambleja e Ortakëve. Si rrjedhim, konkludojmë se neni 101 nuk është kuptuar plotësisht në mënyrë të qartë, përse i përket rastit të largimit të ortakut, nëse vendimi i AO është determinant për largimin efektiv të ortakut, apo vetëm për të drejtën e tij për likuidimin e kuotës.

Nga mënyra se si është formuluar pika 5 e nenit 101 të ligjit 9901/2008, Asambleja e Ortakëve ka vetëm tagrin për të vendosur nëse do të likuidohet kuota apo jo, në varësi të faktit nëse ortaku ka pasur apo jo shkaqe të arsyeshme që është larguar nga shoqëria. Nëse ligji do t'i rezervonte AO të drejtën për të vendosur pranimin apo jo të kërkesës për largimin e ortakut nga shoqëria, atëherë nuk do të ekzistonte situata e parashikuar në pikën 5 të nenit 101, e cila e konsideron largimin si fakt të kryer. Pra sipas këtij rregullimi AO ka vetëm të drejtën për të vlerësuar shkaqet e largimit *post factum*, ku fakti i largimit nuk rezulton të jetë në kompetencën e këtij organi. Në varësi të rezultatit nëse provohen apo jo shkaqet e ligjshme të largimit të ortakut, shoqërisë i lind dhe e drejta për të kërkuar nga ortaku shpërblimin e dëmit, në rast se provohet që ai (ortaku) është larguar nga shoqëria pa pasur shkaqe të arsyeshme. Për këtë arsye ligji ka parashikuar një penalitet për ortakun, i cili largohet pa shkaqe të arsyeshme që të dëmshpërblejë shoqërinë për çdo dëm të shkaktuar. Ky është një argument shtesë në favor të qëndrimit që largimi i ortakut nga shoqëria bëhet vetëm mbi bazën e vullnetit të njëanshëm të tij.

Nëse vlera e kuotës së ortakut që largohet pa shkaqe të arsyeshme është më e madhe se vlera e dëmit të shkaktuar shoqërisë, ky ortak mund t'i kërkojë shoqërisë likuidimin e vlerës së kuotës që tejkalon dëmin e shkaktuar. Ligji nuk e ka rregulluar në mënyrë të qartë këtë

situatë, por duke pasur parasysh parimin e proporcionalitetit dhe faktin që kontrata e shoqërisë është një kontratë vullnetare, një kërkim i tillë do të ishte i arsyeshëm. Megjithatë kjo është një çështje që duhet të vlerësohet në të ardhmen nga jurisprudenca gjyqësore në interpretimin e nenit 101 (rekomandim jurisprudencial për gjyqësorin), si dhe legjislatori në kuadër të përmirësimit të ligjit.

Ligji nuk ka bërë parashikime të detajuara lidhur me efektet financiare të likuidimit të kuotës së ortakut, i cili largohet nga shoqëria për shkaqe të arsyeshme. Nuk parashikohen procedura apo modalitete se në ç'mënyrë dhe me cilat burime ekonomike do të bëhet likuidimi i kuotës së ortakut, i cili tërhiqet nga shoqëria për shkaqe të arsyeshme. Në këtë mënyrë i ka lënë shoqërisë një larmi të pakufizuar të mjeteve ekonomike, me anë të të cilave mund të bëjë likuidimin e kuotës së ortakut të larguar për shkaqe të arsyeshme. Likuidimi i kuotës së ortakut nënkupton kompensimin ekonomik të tij për vlerën ekonomike që ka kuota e tij në momentin e largimit. Kontributet në natyrë të ofruara në themelimin e shoqërisë nga ortaku që largohet, nuk mund t'i rikthehen atij automatikisht si likuidim kuote, pasi ai ka humbur çdo të drejtë pronësie mbi to dhe këto asete tashmë janë në pronësi të shoqërisë.

Rekomandim i karakterit organizativ

Sipas nenit 103/2 të ligjit, statuti nuk mund t'i kufizojë apo t'i heqë të drejtën ortakut për t'u larguar, dhe as asamblesë për të kërkuar përjashtimin, por kjo nuk do të thotë që statuti të mos ofrojë dispozita më të qarta për aplikimin e këtyre instituteve të rëndësishme në praktikë. Ky ligj i ka dhënë një hapësirë të madhe autonomisë statutore, dhe veçanërisht përsa u përket rregullimit të marrëdhënieve mes ortakëve (siç u analizua me lart në këtë punim), atëherë ortakët themelues mund të disiplinojnë në mënyrë më të qartë mënyrën e largimit të ortakut (daljes apo tërheqjes nga shoqëria), si përsa i përket shkaqeve të arsyeshme, ashtu dhe përsa u përket procedurës dhe pasojave financiare të likuidimit të kuotës.

Rekomandime për jurisprudencën dhe gjyqësorin

Në kushtet kur ekzistojnë disa aspekte të paqarta lidhur me procedurën e largimit të ortakut, rekomandojmë që legjislatori të rishikojë nenin 101 të ligjit 9901/2008, me qëllim përmirësimin e formulimit duke bërë përcaktime më të qarta, të detajura dhe gjithpërfshirëse të procedurës dhe efekteve të largimit të ortakut. Gjithashtu edhe Gjykata e Lartë mund të japë një kontribut të vyer me jurisprudencën e saj njehsuese, me qëllim unifikimin e praktikave të ndryshme në gjykatat me të ulëta lidhur me këtë çështje.

Përrjashtimi i ortakut është një mekanizëm, i cili mund të vihet në lëvizje nga SHPK-ja për të përrjashtuar një ortak, i cili kryen veprime në dëm të shoqërisë, i parashikuar në nenin 102 të ligjit 9901/2008, dhe rezulton të ketë gjetur një aplikim të gjerë në praktikën gjyqësore shqiptare. Ky institut ofron një zgjidhje alternative për situatat konfliktuale të lindura mes shoqërisë dhe një ortaku të saj, i cili në kundërshtim me ligjin, statutin apo parimet e ushtrimit të veprimtarisë tregtare, ka kryer veprime, të cilat cenojnë interesat e shoqërisë. Sipas nenit 102, asambleja e ortakëve mund të marrë një vendim për t'iu drejtuar gjykatës me kërkesën për përrjashtimin e ortakut, në rast se ortaku nuk ka shlyer kontributin e tij në shoqëri. Gjithashtu ortaku mund të përrjashtohet kur ka shkelur dispozitat e statutit, si dhe nëse ekzistojnë shkaqe të tjera të arsyeshme për të kërkuar përrjashtimin e tij. Në pikën 2 të nenit 102, parashikohet dhe një listë orientuese e shkaqeve që konsideron të arsyeshme për përrjashtimin e ortakut, por duke e lënë të hapur këtë listë dhe jo shteruese.

Procedura e përrjashtimit të ortakut fillon me vendimin e asamblesë së ortakëve, e cila me shumicë të thjeshtë ka të drejtë të vendosë, nëse do të ngrihet kjo padi ndaj ortakut apo jo. Në këtë mbledhje, ortaku ndaj të cilit mund të ngrihet padia, nuk mund të votojë, për arsye se ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit. Në këtë konkluzion mbërrijmë në përputhje me parashikimet e nenit 89 (pika “c” dhe “a”) të ligjit 9901/2001. Legjitimimi aktiv për ngritjen e padisë me objekt përrjashtimin e ortakut i takon vetë shoqërisë, e cila në kushte normale është e përfaqësuar nga administratori. Ekzistenca e një vendimi paraprak të Asamblesë është kusht i domosdoshëm për legjitimimin e paditësit në padinë me objekt përrjashtimin e ortakut në çdo rast. Kjo vlen edhe në rastet kur një ortak në minorancë kërkon që AO të përrjashtojë një ortak mazhoritar, i cili është në kushtet e nenit 102 të ligjit 9901/2008. Ndryshe nga rastet e largimit të ortakut, procedura e përrjashtimit të ortakut është e kushtëzuar me ekzistencën e shkakut të arsyeshëm dhe vendimmarrjen e AO, si kushte të domosdoshme për fillimin e procedurës. Përrjashtimi është një vendim që merret vetëm nga gjykata, pasi ka konstatuar se ekziston të paktën një shkak i arsyeshëm, përndryshe nuk pranohet kërkesa për përrjashtim.

Në nenin 102 pika 6, në pjesën e parë të fjalisë, është bërë një përcaktim i përgjithshëm përse i përket likuidimit të kuotës së ortakut, për të cilin gjykata vendos të pranojë kërkesën për përrjashtim. Ky parashikim ka lënë vend për interpretime të ndryshme në praktikë. Sipas kësaj dispozite, ortaku nuk ka të drejtë që të kërkojë likuidimin e kuotës në kushtet kur ai është përrjashtuar për shkaqe të arsyeshme. Por në vazhdim të së njëjtës fjali, parashikohet se vlera e kuotës së ortakut në shoqëri mund të përdoret nga ky ortak si kompensim, në rast se shoqëria ngre një padi ndaj ortakut për shpërrblimin e dëmit të shkaktuar. Në këtë mënyrë ortakut i njihet e drejta që të përdorë kuotën e tij si mjet për kompensimin e dëmeve të shkaktuara. Ky është një qëndrim i ndryshëm nga pjesa e parë e fjalisë, pasi sipas pjesës së dytë të kësaj fjalie, ortaku mund të përfitojë nga likuidimi i kuotës dhe ta përdorë këtë pasuri për të shpërrblyer një dëm të shkaktuar shoqërisë. Pika 6 e nenit 102 të ligjit ka

përfshirë dy standarde të ndryshme dhe për rrjedhojë, nuk rezultojnë të kemi një formulim të qartë përsa i përket të drejtës së ortakut për likuidimin e kuotës, në rastin e përjashtimit të tij. Një rregullim i tillë, i vendosur në pozita jo të barabarta ortakët, të cilët janë përjashtuar për shkaqe të arsyeshme, por që nuk i kanë sjellë dëm shoqërisë, ose kur dëmi është në mënyrë domethënëse më i vogël sesa kuota e ortakut në shoqëri.

Rekomandime legislative dhe jurisprudenciale

Në vlerësimin tonë, ortaku nuk mund të privohet automatikisht nga e drejta e tij për likuidimin e kuotës në shoqëri, edhe në rastin e përjashtimit të tij me shkaqe të arsyeshme, pasi kjo do të binte në kundërshtim me parimet tashmë të konsoliduara të mbrojtjes së të drejtës së pronësisë. E drejta e kuotës, në kuptimin juridik, përfaqëson një të drejtë pronësie mbi një send me vlerë ekonomike dhe si e tillë, gëzon të gjithë mbrojtjen juridike të garantuar nga legjislacioni shqiptar, si dhe Protokollin Nr. 1 i Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (dhe jurisprudenca e Gjykatës së Strasburgut). Për këtë arsye, është i rekomandueshëm një rishikim i kësaj dispozite nga legjislatori, me qëllim përmirësimin e mënyrës së formulimit përsa i përket likuidimit të kuotës, në respekt të së drejtës së pronësisë së ortakut mbi kuotën e tij. Kjo dispozitë, mund të jetë dhe objekt i interpretimit të Gjykatës Kushtetuese në funksion të së drejtës së pronës, garantuar nga neni 41 i Kushtetutës. Gjithashtu, Gjykata e Lartë mund të japë një kontribut pozitiv me qëllim unifikimin e praktikës gjyqësore lidhur me këtë çështje.

KREU 8. Prishja e Shoqërisë, Likuidimi dhe Falimentimi i saj

Në nenin 99 të ligjit 9901/2008 janë parashikuar dhe rastet e prishjes së SHPK-së. Sipas këtij neni janë renditur në një listë joshteruese shkaqet kryesore që shkaktojnë prishjen e shoqërisë, e cila vendoset nga AO, ose nga gjykata, në rastet e caktuara në ligj. Pas vendimit për prishjen e shoqërisë, aplikohen procedurat e likuidimit, me përfundimin e të cilave kryhet dhe çregjistrimi i shoqërisë nga QKB.

Ligji në fuqi, në nenin 204 të tij, ka parashikuar dhe një procedurë të përshpejtuar dhe të thjeshtë të likuidimit, siç është likuidimi i thjeshtëzuar. Ky ka rezultuar një hap pozitiv dhe në interes të shoqërive tregtare në Shqipëri, duke reduktuar kohën dhe kostot e likuidimit. Kjo procedurë e përshpejtuar, është aplikuar me sukses nga gjykatat në vendin tonë dhe nuk rezultojnë të jetë shoqëruar me pasoja anësore problematike për kreditorët e shoqërive tregtare.

Diskutimi nëse mund të revokohet vendimi për prishjen e shoqërisë apo jo, është një dilemë, e cila ende nuk ka marrë një përgjigje përfundimisht përcaktuese. Ligji në fuqi nuk

ka asnjë parashikim për mundësinë e revokimit të vendimit të prishjes gjatë likuidimit të shoqërisë dhe kthimin e saj në aktivitet tregtar. Megjithatë, ky është një koncept i njohur dhe i pranuar në legjislacionet e tjera të vendeve evropiane. Në aspektin teorik, nuk mund të përjashtohet mundësia e revokimit të vendimit të prishjes së shoqërisë, kur ky vendim është marrë nga AO për një shkak prishjeje që lidhet vetëm me vullnetin e organit vendimmarrës, i cili ka dhe kompetencën për të korigjuar shkaqet e prishjes, kur ato janë të tilla që mund të riparohen. Qëllimi i përgjithshëm i legjislacionit shqiptar në fushën tregtare është nxitja e veprimtarisë ekonomike dhe ofrimi shoqërive tregtare i të gjitha shanseve të mundshme që të vazhdojnë aktivitetin tregtar. Kjo frymë është qartësisht e shprehur edhe në ligjin 110/2016 “Per falimentimin”, në të cilin është parashikuar procedura e riorganizimit dhe rehabilitimit të shoqërisë. Por mundësia e revokimit të prishjes mund të shtrohet për diskutim vetëm në fazat e para të procesit të likuidimit, për sa kohë nuk ka filluar shlyerja e detyrimeve të kreditorëve dhe shpërndarja e aseteve të shoqërisë. Ndërsa, për të gjitha rastet, kur vendimi i prishjes së shoqërisë është dhënë me vendim të formës së prerë të gjykatës, procesi i likuidimit nuk mund të anulohet.

Rekomandime të karakterit legjislativ

Për sqarimin përfundimtar të këtij diskutimi, rekomandohet që legjislatori të ndjekë dhe modelet e tjera (si për shembull, atë italian), dhe të bëjë ndryshimet e duhura ligjore, duke i njohur organit vendimmarrës (AO), të drejtën që, me një shumicë të cilësuar, të ketë të drejtën për të revokuar/anuluar vendimin për prishjen dhe likuidimin e shoqërisë në fazat e para të tij dhe të disiplinojë më tej këtë procedurë.

Falimentimi i SHPK-ve. Njëra nga arsytet e përfundimit të aktivitetit dhe prishjes së një shoqërie tregtare, është gjendja e falimentimit (rasti kur shoqëria ndodhet në kushtet e paaftësisë paguese). Procedura e falimentimit rregullohet me ligj të veçantë (Ligji Nr. 110/2016 “Për falimentimin”), zhvillohet nën mbikqyrjen dhe kontrollin e gjykatës, dhe duhet të zbatohet në të gjitha rastet kur subjekti ndodhet në kushtet e falimentit. Madje, edhe në rast se ka filluar procedura e likuidimit të shoqërisë, dhe konstatohet se ky subjekt ndodhet në kushtet e paaftësisë paguese, duhet të ndërpritet procedura e likuidimit dhe të fillojë ajo e falimentimit. Kjo procedurë mund të vihet në lëvizje, si nga shoqëria që ndodhet në kushtet e paaftësisë paguese (debitori), ashtu edhe nga kreditorët e saj.

Në rast se provohet gjendja e paaftësisë paguese të shoqërisë debitore, por ky subjekt nuk ka pasuri të mjaftueshme për të mbuluar shpenzimet e procedurës së falimentimit, gjykata merr vendim për përfundimin e procedurës për shkak të mungesës së pasurive. Në bazë të këtij vendimi, shoqëria çregjistrohet nga QKB. Në rast se në fazën e parë provohet gjendja e paaftësisë paguese të shoqërisë debitore, por shoqëria ka kapitale/pasuri të mjaftueshme

për të mbuluar shpenzimet e procedurës së falimentimit, atëherë gjykata merr vendim për çeljen e procedurës së falimentit, duke kaluar kështu, në një fazë të dytë të procedurës. Në fazën e dytë shoqëria mbyllet me likuidimin e pasurive të shoqërisë në favor të kreditorëve dhe çregjitrimit të saj, ose në rastin më të mirë, me riorganizimin e saj dhe ristrukturimin e borxheve.

Me qëllim që të mos përkeqësohet situata financiare e shoqërisë që është në kushtet e falimentit, si dhe që të mos shtohet risku i kreditorëve për pamundësinë e rikuperimit të borxhit ndaj shoqërisë, ligji ka parashikuar disa detyrime për subjektet që janë në kushtet e falimentimit, që ato të fillojnë pa vonesa procedurën e falimentit.

Në nenin 15 të ligjit 110/2016, parashikohet detyrimi i personave përgjegjës për administrimin e shoqërive që, brenda 60 ditëve nga data e konstatimit të paaftësisë paguese të fillojnë procedurën e falimentit, në të kundërt do të mbajnë përgjegjësi personale për humbjet e shkaktuara kreditorëve për shkak të vonesës. Madje, edhe Kodi Penal, në nenin 194 të tij, parashikon përgjegjësi penale ndaj subjekteve që janë në dijeni që ndodhen në kushtet e falimentit dhe e fshehin këtë situatë, (duke mos marrë masa për t'iu drejtuar gjykatës për çeljen e procedurës së falimentit) ndërkohë që hyjnë në marrëdhënie tregtare me subjekte të tjera.

Nga statistikën e analizuar në këtë punim rezulton se në vendin tonë nuk përputhet situata faktike e subjekteve të cilat janë realisht në kushtet e falimentit, me statistikën e procedurave të falimentit, të formalizuara në gjykatat e vendit në bazë të ligjit të falimentit. Këto statistika pasqyrojnë një informalitet në shkallë të konsiderueshme dhe reflektojnë një situatë ku, eventualisht, një numër shumë i madh i subjekteve tregtare, të cilat janë në kushtet e falimentit në kundërshtim me parashikimet ligjore të sipërcituara, nuk marrin masa për të filluar procedurat e falimentit.

Rekomandime të karakterit edukativ

Nëpërmjet këtij punimi, sugjerojmë aplikimin e mekanizmave ndërgjegjësues dhe sensibilizues për të gjithë aktorët që tërheqin interesa nga situata falimentimit të SHPK-ve, qofshin këto vetë organet drejtuese të shoqërive, ortakët e tyre, si dhe kreditorët e shoqërive (përfshirë dhe institucionet shtetërore), të cilët kanë interes që të vënë në lëvizje sa më parë procedurat e falimentimit. Një rol të rëndësishëm në aspektet e sensibilizimit, mendojmë se mund të luajnë institucionet shtetërore, si Qendra Kombëtare e Biznesit, institucionet fiskale, ato të këshillimit nëpërmjet dhomave të avokatëve dhe noterëve, institutet e ekspertëve kontabël, si dhe institucionet bankare dhe ato të kreditimit.

Rekomandime të karakterit organizativ

U rekomandojmë QKB dhe institucioneve fiskale, që të përmirësojnë infrastrukturën e sistemeve elektronike, me qëllim evidentimin e të gjitha subjekteve tregtare, për të cilat ka të dhëna që ndodhen në kushtet e paaftësisë paguese. Kjo do t'u shërbejë kreditorëve të këtyre shoqërive, përfshirë dhe institucionet fiskale si kreditorë eventuale të këtyre subjekteve, që të fillojnë pa vonesë procedurat e falimentit të këtyre shoqërive. Aplikimi i këtyre fushatave do të kontribuonte në pastrimin e Regjistrimit Tregtar nga të shtuqajturat shoqëri “*fantazmë*”, të cilat nuk kanë asete ekonomike, por përsëri figurojnë në QKB.

Në përfundim të këtij punimi, propozojmë edhe disa rekomandime të karakterit doktrinor edukativ, si në vijim:

- Pasurimi i kurrikulave të shkollave të nivelit parauniversitar dhe universitar me informacione bazike rreth rolit të SHPK-ve në ekonominë e vendit.
- Pasurimi i doktrinës lidhur me elementet thelbësore të SHPK-ve si dhe insituteve më të rëndësishme të tyre.
- Zgjerimi i kurrikulave të shkollave profesionale pasuniversitare me këto njohuri doktrinare (Shkollat e Magjistraturës, Shkolla e Avokatisë dhe ajo e Noterisë).
- Aplikimi i strategjive të ndryshme lidhur me edukimin bazik ligjor të qytetarëve rreth rëndësisë së njohjes së organizimit dhe funksionimit të SHPK-ve. Në mënyrë të veçantë, atyre qytetarëve që janë të angazhuar si ortakë apo administrator të një SHPK-je.

Bibliografia

Legjislacioni amerikan

Delaware Limited Liability Company Act

Legjislacioni anglez

UK Companies Act 2006, section 39

Legjislacioni i Bashkimit Evropian

First Council Directive 68/151/EEC of 9 March 1968 on co-ordination of safeguards which, for the protection of the interests of members and others, are required by Member States of companies within the meaning of the second paragraph of Article 58 of the Treaty, with a view to making such safeguards equivalent throughout the Community [1968] OJ Special edition

Directive 2003/58/EC of the European Parliament and of the Council of 15 July 2003 amending Council Directive 68/151/EEC, as regards disclosure requirements in respect of certain types of companies [2003] OJ L 221/13

Second Council Directive 77/91/EEC of 13 December 1976 on coordination of safeguards which, for the protection of the interests of members and others, are required by Member States of companies within the meaning of the second paragraph of Article 58 of the Treaty, in respect of the formation of public limited liability companies and the maintenance and alteration of their capital, with a view to making such safeguards equivalent [1977] OJ L 26/1

Directive 2006/68/EC of the European Parliament and of the Council of 6 September 2006 amending Council Directive 77/91/EEC as regards the formation of public limited liability companies and the maintenance and alteration of their capital (Text with EEA relevance) [2006] OJ L 264/32

Directive 2008/52/EC of the European Parliament and of the Council of 21 May 2008 on certain aspects of mediation in civil and commercial matters [2008] OJ L 136/3

Directive 2009/101/EC of the European Parliament and of the Council of 16 September 2009 on coordination of safeguards which, for the protection of the interests of members and third parties, are required by Member States of companies within the

meaning of the second paragraph of Article 48 of the Treaty, with a view to making such safeguards equivalent (Text with EEA relevance) [2009] OJ L 258/11

Directive (EU) 2017/828/EC of the European Parliament and of the Council of 17 May 2017 amending Directive 2007/36/EC as regards the encouragement of long-term shareholder engagement (Text with EEA relevance) [2017] OJ L 132/1

Legjislacioni i Këshillit të Evropës

Council of Europe, “Convention for the Protection of Human Rights and Fundamental Freedoms” [1950] OJ Special edition; Protocol 1 to the Convention for the Protection of Human Rights and Fundamental Freedoms [1952] OJ Special edition

Legjislacioni turk

Kodi Tregtar i Turqisë, Act No. 6102/2011 [2011] Gazeta Zyrtare 27846.

Legjislacioni italian

Regio Decreto 16 marzo 1942, n. 262, Approvazione del testo del Codice civile [1942] GU 79 i azhornuar me ndryshimet e fundit.

Legjislacioni shqiptar

Ministria e Drejtësisë, *Kodi Civil i vitit 1929* (Botimet Toena 1998).

Kodi Tregtar, (1932) Fletore Zyrtare, datë 5 mars 1932.

Asambleja Kushtetuese, Statuti i Republikës Popullore të Shqipërisë (Bashkimi 1946) <<http://shtetiweb.org/wp-content/uploads/2012/10/STATUTI-I-ASAMBLESE-KUSHTETONJE%C2%A6%C3%AASE-1946.pdf>> aksesuar më 14 Mars 2020

Kushtetuta e Republikës Popullore të Shqipërisë-1950 <<http://shtetiweb.org/2013/10/08/kushtetuta-e-republikes-popullore-te-shqiperise-1950/>> aksesuar më 15 mars 2020

Ligji 2022/1955, “Për Pjesën e Përgjithshme të Kodit Civil” Gazeta Zyrtare 4.

Kushtetuta së Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë e vitit 1976
<<http://shtetiweb.org/2013/10/08/kushtetuta-e-republikes-socialiste-te-shqiperise-1976/>> aksesuar më 15 mars 2020

Ligji 7491/1991 “Për Dispozitat Kryesore Kushtetuese” [1991] FZ 4.

Ligji 7491/1991 “Për Dispozitat Kryesore Kushtetuese” [1991] FZ 4 i ndryshuar ligjin 7561/1992 “Për disa ndryshime e plotësime në ligjin nr.7491 dt.29.04.1991 “Për dispozitat kryesore kushtetuese” [1992] FZ 2 (Ligji 7491/1991 “Për Dispozitave Kryesore Kushtetuese” i ndryshuar).

Ligji Nr.7512/1991 “Për sanksionimin dhe mbrojtjen e pronës private, të nismës së lirë, të veprimtarive private të pavarura dhe privatizimit” [1991] FZ 6

Ligji 7632/1992 “Për Dispozitat që Rregullojnë Pjesën e Parë të Kodit Tregtar” [1992] FZ 8 (i ndryshuar).

Ligji 7638/1992 “Për shoqëritë tregtare” [1992] FZ 8 (shfuqizuar).

Ligji 7667/1993 “Për regjistrin tregtar dhe formalitetet që duhen respektuar nga shoqëritë tregtare” [1993] FZ 1.

Ligji 7850/1994 “Për Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë” [1994] FZ 11 ndryshuar së fundmi me Ligjin 113/2016 “për disa shtesa në ligjin nr. 7850, datë 29.7.1994, “kodi civil i republikës së shqipërisë”” [2016] FZ 219 (Kodi Civil).

Ligji 7895/1995 “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë” [1995] FZ 2 amenduar së fundmi me ligjin 146/2020 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 7895, datë 27.1.1995, “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë” [2020] FZ 5 (Kodi Penal).

Ligji 7926/1995 “Për transformimin e ndermarrjeve shtetërore në shoqëri tregtare” [1995] FZ 11.

Ligji 7961/1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë” [1995] FZ 16 përditësuar me Ligjin 136/2015 (Kodi i Punës).

Ligji 8116/1996 “Kodi i Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë” [1996] FZ 9, 10, 11 ndryshuar së fundmi me ligjin 38/2017 [2017] FZ 98 (Kodi i Proçedurës Civile).

- Ligji 8438/1998 “Për tatimin mbi të ardhurat” [1998] FZ 32, amenduar së fundmi me ligjin 94/2018 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat” [2018] FZ 183.
- Ligji 8417/1998 “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë” [1998] FZ 28, ndryshuar së fundmi me ligjin 115/2020 “Për disa ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë” [2020] FZ 153.
- Ligji 8901/2002 “Për Falimentimin” [2002] FZ 31
- Ligji 9062/2003 “Kodi i Familjes” [2003] FZ 49 i ndryshuar me ligjin 134/2015 “Për disa ndryshime në ligjin nr. 9062, datë 8.5.2003, “Kodi i Familjes” [2015] FZ 220.
- Ligji 9662/2006 “Për Bankat në Republikën e Shqipërisë” [2006] FZ 149.
- Ligji 9723/2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit” [2007] FZ 60, i ndryshuar së fundmi me Ligjin 30/2019 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9723, datë 3.5.2007, “Për regjistrimin e biznesit” [2019] FZ 99 (Ligji 9723/2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit” i ndryshuar)
- Ligji 9754/2007 “Për Përgjegjësinë Penale të Personave Juridikë” [2007] FZ 77
- Ligji 9887/2008 “ Për Mbrojtjen e të dhënave personale” [2008] FZ 44, ndryshuar së fundmi me ligjin 120/2014 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9887, datë 10.3.2008, “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” [2014] FZ 160.
- Ligji 9901/2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” [2008] FZ 60.
- Ligji 9901/2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” [2008] FZ 60, ndryshuar me ligjin 129/2014 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9901, datë 14.4.2008, “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” [2014] FZ 163 (Ligji 9901/2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, i ndryshuar).
- Ligji 10192/2009 “Për Parandalimin Dhe Goditjen e Krimit Të Organizuar, Trafikimit, Korrupsionit dhe Krimeve të Tjera Nëpërmjet Masave Parandaluese Kundër Pasurisë”, ndryshuar së fundmi me ligjin 85/2020 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.10192, datë 3.12.2009, “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit, korrupsionit dhe krimeve të tjera nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë” [2020] FZ 138.

Ligji 8788/2001 “Për Organizatat Jofitimprurëse” [2001] FZ 28, ndryshuar nga Ligji 92/2013 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8788, datë 7.5.2001 “Për organizatat jofitimprurëse”, të ndryshuar” [2013] FZ 36 (Ligji 8788/2001 “Për Organizatat Jofitimprurëse” i ndryshuar).

Ligji 48/2014 “Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare” [2014] FZ 70 ndryshuar nga ligji “Për një shtesë në ligjin nr. 48/2014, “Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare” [2015] FZ 64.

Ligji 52/2014 “Për veprimtarinë e Sigurimit dhe Risigurimit” [2014] FZ 93.

Ligji 129/2014 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9901, datë 14.4.2008, “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” [2014] FZ 163.

Ligji 8/2015 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9723, datë 3.5.2007, “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit” [2015] FZ 32.

Ligji 131/2015 “Për Qendrën Kombëtare të Biznesit” [2015] FZ 215.

Ligji 110/2016 “Për Falimentimin” [2016] FZ 226.

Ligji 9787/2007 “Për një shtesë në ligjin nr.7638, datë 19.11.1992 "për shoqëritë tregtare” [2007] FZ 103.

Ligji 10171/2009 “Për profesionet e rregulluara në Republikën e Shqipërisë” [2009] FZ 154 ndryshuar së fundmi nga Ligji 90/2016 “për një shtesë në ligjin nr. 10 171, datë 22.10.2009, “Për Profesionet e Rregulluara në Republikën e Shqipërisë” [2016] FZ 126.

Ligji 10475/2011 “Për një ndryshim në ligjin nr.9901, datë 14.4.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” [2011] FZ 152.

Ligji 10385/2011 “Për Ndërmjetësimin në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve” [2011] FZ 25 i ndryshuar me ligjin 26/2018 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 10385, datë 24.2.2011, “Për ndërmjetësimin në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve” [2018] FZ 85.

Ligji 55/2018 “Për Profesionin e Avokatit në Republikën e Shqipërisë” [2018] FZ 123.

Ligji 110/2018 “Për Noterinë” [2018] FZ 16.

Ligji 62/2020 “Për tregjet e kapitalit” [2020] FZ 131

Udhëzimi i Ministrit të Financave 5/2006 “Për Tatimin mbi të Ardhurat i ndryshuar” [2006] ndryshuar me Udhëzim 14/2014 [2014] FZ 80.

Vendim i Këshillit të Ministrave 285/2007 “Për përcaktimin e pagës referuese mujore, për efekt të llogaritjes së kontributeve të sigurimeve shoqërorë dhe shëndetësore, dhe të tatimit mbi të ardhurat personale, sipas nomenklaturës së veprimtarisë ekonomike, për të punësuarit në sektorin jopublik që kryejnë punë, të pakualifikuara e të kualifikuara, si dhe për personelin drejtues tekniko-ekonomik të tyre” [2007] FZ 59.

Projektligji “Per Arbitrazhin ne Republikën e Shqipërisë”
<<https://konsultimipublik.gov.al/Konsultime/Detaje/292>> aksesuar më 27 dhjetor 2020

Jurisprudenca angleze

United States Court of Appeals (Seventh Circuit), *Van Dorn Co. v. Future Chemical and Oil Corp.*, (1985) 753 F.2d 565

Court of Chancery (UK), *Foss v. Harbottle*, (1843) 67 ER 189

Jurisprudenca e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut

Judgment of ECHR (1982), *Lars Bramelid and Anne Malmström against Sweden*, Application Nos. 8588/79 and 8589/79

Judgment of 13 November 2007, *D. H. and Others v. the Czech Republic*, App. no. 57325/00

Judgment of 24 October 1995, ECHR, *Agrotexim and Others v. Greece*, Application no 6552/1984

Judgment of 1988, ECHR, *Belilos against Switzerland*, Applications no.10328/83.

Judgment of 18 December 2007, ECHR, *Marini against Albania*, Application no.3738/02

Judgment of 20 April 2010, *Kin-Stib and Majkić against Serbia*, Application no. 12312/05

Judgment of 20 September 2011, ECHR, *Shesti Mai Engineering OOD and Others v. Bulgaria*, Application no 17854/04

Judgment of 12 January 2012, ECHR, *Pekárny A Cukrárny Klatovy, A.S. V. The Czech Republic*, Applications nos. 12266/07, 40059/07, 36038/09 and 47155/09

Judgment of 27 May 2014, ECHR, *Baka v. Hungary*, App. no. 20261/12

Jurisprudenca e Gjykatës së Drejtësisë së Bashkimit European

Judgment of 13 November 1990, *Marleasing v Comercial Internacional de Alimentación*, C-106/89, ECLI:EU:C:1990:39.

Jurisprudenca gjermane

Vendim i Gjykatës Federale Gjermane (Bundesgerichtshof), 06 prill 2009, Nr. çështjes Zr 255/08.

Vendim i Gjykatës Kushtetuese Federale të Gjermanisë (Bundesverfassungsgericht), 6 qershor 1989, Nr. i çështjes 1 BvR 921/85.

Jurisprudenca në Shtetet e Bashkuara të Amerikës

United States Court of Appeals (Seventh Circuit), *Sea-Land Services, Inc. v. Pepper Source*, (1993) 993 F.2d 1309.

Chancery Court (Delaware USA), *Ross Holding & Mgmt. Co. v. Advance Realty Grp LLC*, (2010) WL 3448227.

Jurisprudenca shqiptare

Gjykata Kushtetuese

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë Vendimi Nr. 10 dt. 19.03.2008

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë Vendimi Nr. 24 dt. 24.07.2009

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë Vendimi Nr. 9 i vitit 2010

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë Vendimi Nr. 8 dt. 16.03.2011

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë Vendimi Nr. 31 dt. 05.07.2011

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, Vendim Nr. 22 datë 08.02.2013

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, Vendim Nr. 14 datë 21.03.2014

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë Vendimi Nr. 85 dt. 29.05.2015

Gjykata e Lartë

Gjykata e Lartë, Kolegji Tregtar i Gjykatës së Lartë, Vendim nr.589, datë 11.02.1999

Gjykata e Lartë, Vendim Unifikues i Kolegjeve të Bashkuara Nr. 39 datë 30.05.2002

Gjykata e Lartë , Vendim Unifikues i Kolegjeve të Bashkuara Nr 5 dt.30.10.2012

Gjykata e Lartë,Vendim nr.1143, datë 27.11.2002, Kolegji Civil

Gjykata e Lartë, Vendimi Nr. 1339 dt. 10.07.2003

Gjykata e Lartë, Vendimi Nr. 15 datë 19.01.2010, Kolegji Civil

Gjykata e Lartë, Vendim Nr.00-2012-1830 i Vendimit (232) datës 08.05.2012, i Kolegjit Civil

Gjykata e Lartë, Vendim Nr.00-2013-2598 i Vendimit (634) datës 07.11.2013, i Kolegjit Civil

Gjykata e Lartë, Vendimi Nr.00-2014-3076 i Vendimit (476) dt. 18.09.2014, i Kolegjit Civil

Gjykata e Lartë, Vendimi Nr. 501 dt. 09. 10. 2014 i Kolegjit Civil

Gjykata e Lartë, Vendimi Nr. 359 dt. 16. 07. 2015 i Kolegjit Civil

Gjykata e Lartë, Vendim nr.421, datë 04.10.2011, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë

Gjykata e Lartë, Kolegji Civil, Vendimi Nr. 11112-02188-00-2011 Regj Themeltar Nr. 00-2012-2043 i Vendimit (340) dt. 26.06.2012

Gjykata e Lartë, Kolegji Civil, Vendimin Nr. 00-2015-2056 i Vendimit (301) dt. 11.06.2015

Gjykata e Lartë, Kolegji Civil, Vendim Nr. Nr. 00-2015-3952 i Vendimit (488) dt. 25.11.2015

Gjykata e Lartë, Kolegji Civil,Vendimi Nr 00-2016-1773 i Vendimit (165) dt.18.05.2016

Gjykata e Lartë, Kolegji Civil, Vendimi Nr. 131 dt. 26.10.2017

Gjykata e Lartë, Kolegji Civil, Vendimi Nr 00-2017-2682 dt. 19.12.2017

Gjykata e Apelit Durrës

Gjykata e Apelit Durrës, Vendim Nr.10-2011-1471(706), datë 01.12.2011

Gjykata e Apelit Tiranë

Gjykata e Apelit Tiranë, Vendimi Nr.494, datë 18.11.2010

Gjykata e Apelit Tiranë, Vendimi Nr.78, datë 07.02.2012

Gjykata e Apelit Tiranë, Vendimi Nr.528 dt.07.11.2012

Gjykata e Apelit Tiranë, Vendimi nr.82, date 19.03.2013

Gjykata e Apelit Tiranë, Vendimi Nr.846 dt.04.12.2014

Gjykata e Apelit Tiranë, Vendimi Nr.2546 datë 09.12.2016

Gjykata e Apelit Tiranë, Vendimi Nr. 107 datë 20. 01. 2015

Gjykata e Apelit Tiranë, Vendimi Nr. 415 dt 17.02.2015

Gjykata e Apelit Tiranë, Vendimi Nr.229 dt 03.02.2017

Gjykata e Apelit Tiranë, Vendimi Nr 1637, date 18.06.1997

Gjykata e Apelit Tiranë, Vendimi Nr. 1416 dt. 26.05.2017

Gjykata e Apelit Tiranë, Vendimi Nr. 1916 dt 13.09.2017

Gjykata e Apelit Tiranë, Vendimi Nr.853 dt.30.05.2018

Gjykata e Apelit Tiranë, Vendimi Nr.1372 dt.12.10.2018

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës Vendimin Nr.(11-2015-3451) 1280, datë13.07.2015

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës, Vendim Nr.11-2011-152 (84), datë 17.01.2011

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës Vendimi Nr. 11-2015-5120 dt.13.11.2015

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë, Vendimi Nr. 3268, datë 26.12.1995

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, Vendimin Nr.7517, datë 03.10.2010

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, Vendimi Nr.4025, datë 17.05.2010.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, Vendimi me Nr. 9768 Regj datë 06.09.2010

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, Vendimi me Nr.13616 Akti datë 10.12. 2010

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, Vendim Nr. 3516 Akti, Dt. 23.05.2011

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë Vendimi Nr nr.113 akti, datë 16.01.2013

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, Vendim Nr.785, dt. 08.02.2016

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, Vendim Nr.10024 date 21.12.2015

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, Vendim Nr. 4413, datë 07.04.2014

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, Vendimi Nr 7565 Akti dt. 20.10.2014

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, Vendimi Nr. 5904, date 16.05.2014

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, Vendim me Nr. 14968 Regj datë 21.11.2014

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, Vendimi Nr. 4271, date 25.05.2015

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, Vendimi Nr 951 Akti dt. 12.02.2015

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, Nr. 9669 dt.09.12.2015.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, Vendimi nr.5724, datë 30.06.2016

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, Vendimi Nr. 9397 dt. 21.11.2016

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, Vendimi Nr.7612 Akti, dt 16.05.2016

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, Vendimi Nr. 8091 datë 13.10.2016

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, Vendim Nr. 4573 dt. 24.05.2017

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, Vendim Nr. Dt. 08. 02. 2017

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, Vendimi Nr. 4794 dt. 30.05.2017

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, Vendimi Nr. 9432 dt. 22.11.2016

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, Vendimi Nr. 3949 dt. 02.05.2018

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, Vendimi Nr. 3643 datë 21.09.2020

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, Vendimi Nr. 4840 datë 04.11.2020

Libra, artikuj dhe faqe interneti

Abatino B, Mattiacci D G and Perotti C E, “*Early Elements of the Corporate Form: Depersonalization of Business in Ancient Rome*” (2009) 32:1 Oxford Journal of Legal Studies 1

Agaj E, “*Regjimi i pavlefshmërisë juridike në shoqëritë tregtare të kapitalit: Aspekte teorike dhe praktike*” (Punimin shkencor, Shkolla e Magjistraturës 2018)

Anastasi A, *Historia e Institucioneve* (Ribotim i punuar, SHBLU 2011)

Anastasi A, *Historia e së drejtës kushtetuese në Shqipëri 1912-1939* (Shtëpia botuese “Pegi” 2007)

Andreau J, *Banking and Business in the Roman World* (Cambridge University Press 1999)

Asambleja Kushtetënjëse, Statuti i Republikës Popullore të Shqipërisë (Bashkimi 1946)
<<http://shtetiweb.org/wp-content/uploads/2012/10/STATUTI-I-ASAMBLESE-KUSHTETONJE%C2%A6%C3%AASE-1946.pdf>> aksesuar më 14 Mars 2020

Auletta G G, *Il contratto di societa commerciale* (Giuffré 1937)

Bachmann G, Eidenmüller H, Engert A, Fleischer H and Schön W, *Regulating the Closed Corporation* (European Company Law and Financial Law Review Vol. 4, De Gruyter 2014)

- Bachner T, Schuster P E dhe Winner M, *Ligji i ri shqiptar për shoqëritë tregtare: interpretuar sipas burimeve të tij në të drejtën evropiane* (Dudaj 2009)
- Badura P, *Staatsrecht*, (Mynih 1996)
- Bainbridge M S and Henderson T M, *Limited Liability: A Legal and Economic Analysis* (Elgar 2016)
- Balanca Z dhe Anastasi A, *Historia e institucioneve: Periudha moderne dhe bashkëkohore. Pjesa 2* (Luarasi 1995)
- Benussi B, *Obligimet dhe kontratat përgjithësisht: Titulli II i librit IV të Kodit Civil* (Botim i Ministrisë së Drejtësisë 1932)
- Barak A, *Gjyqtari në demokraci* (ribotim i Shkollës së Magjistraturës, Botimet Morava 2016)
- Bello H, “Kodi Civil Osman - “Mexheleja” dhe trashëgimia juridike osmane në Shqipërinë e viteve 1912 – 1929” (2013) 2 Zani i Naltë <
<https://zanimalte.al/2013/09/mexheleja-kodi-civil-osman-dhe-trashegimia-juridike-osmane-ne-shqiperine-e-viteve-1912-1929/>> aksesuar më 14 shtator 2020
- Benussi B, *Komentaret e Kodit Civil të vitit 1929: Sendet, zotënimi dhe modifikimet e tij* dhe *Obligimet dhe kontratat përgjithësisht* (Botime të Ministrisë së Drejtësisë 1932)
- Berberi B, *Komente të ligjit Nr 7638 dt. 19.11.1992 “Për Shoqëritë tregtare”* (Shtëpia botuese Morava 2004)
- Biba D dhe Zaganjori Xh, “*Rule of Law and Albanian Institutional Reality*” (2010) 32 *Political Thought*
- Birds J and Boyle J A, *Boyle and Birds’ Company Law* (8th edition, Jordan Publishing Limited 2011)
- Boseta B, “Veprimtaria Parlamentare në Shqipëri në vitet e Monarkisë Shqiptare, 1928 – 1939” (Tezë Doktorature, Departamenti i Historisë, Fakulteti i Historisë dhe i Filologjisë 2019)
- Bourne N, *Principles of Company Law* (Cavendish Publishing Limited 1993)

- Brestovci F, *E Drejta Procedurale Civile I* (Fakulteti Juridik, Universiteti i Prishtinës, 2004)
- Brestovci F, Morina I, Qehaja R, *E Drejta procedurale civile, procedura kontestimore* (Universiteti i Prishtinës, Fakulteti Juridik 2017)
- Brough H G, *Private Limited Companies: Formation and Management* (3rd edition, Sweet & Maxwell Ltd 1990)
- Brouwer M, “*Managing Uncertainty through Profit Sharing Contracts From Medieval Italy to Silicon Valley*” (2005) 9 *Journal of Management and Governance* 237
- Calnan A, “*The Fault(s) in Negligence Law*” (2007) 25 *Quinnipiac Law Review* 695
- Cassidy J, *Concise Corporations Law* (5th edition, The Federation Press 2006)
- Ceka N, “*Pesëdhjetë vjet studime për qytetet ilire*” (1998) 28 *Iliria*
- Clark D, “Business survival rates in selected European countries in 2017, by length of survival” (9 shtator 2020) <<https://www.statista.com/statistics/1114070/eu-business-survival-rates-by-country-2017/>> aksesuar më 17 tetor 2020
- Coase H R, “The Nature of the Firm” (1937) 4:16 *Economica* 386
- Cody T, Hopkins A D and Perlman A L, *Guide to Limited Liability Companies* (9th edition, Wolters Kluwer business 2007)
- Davis H J, Schoorman D F dhe Donaldson L, “*Toward a Stewardship Theory of Management*” (1997) 22:1 *The Academy of Management Review* 20
- De Palo G dhe Trevor B M, *EU Mediation Law and Practice* (Oxford University Press 2012)
- Della Rocca M R, *Kombësia dhe feja në Shqipëri* (Shtëpia botuese “Eleni Gjika” 1994)
- Dine J, *The Governance of Corporate Groups* (Cambridge University Press 2000)
- Dornseifer F, *Corporate Business Forms in Europe: A Compendium of Public and Private Limited Companies in Europe* (Sellier European Law Publishers 2005)

Drejtoria e Politikave të Konkurrueshmërisë së Ekonomisë, “Kodi i Drejtimit të Brendshëm të Shoqërive Tregtare në Shqipëri” <https://www.bkt.com.al/assets/uploads/documents/kodi_i_qeverisjes_se_korporatave_al.pdf> aksesuar me 19 shtator 2020.

Ellis J, *Business and Company Legislation 2019/2020* (CLP Legal Practice Guides 2019)

Erdem & Erdem law office “*Dissolution and Liquidation of Joint Stock Companies*” (publikuar në Korrik 2012 <<http://www.erdem-erdem.av.tr/publications/law-post/dissolution-and-liquidation-of-joint-stock-companies/>> aksesuar më 1 tetor 2020

Ferrara F, *Le Persone giuridiche* (UTET Torino 1938)

Ferrara Jr. F dhe Corsi F, *Gli imprenditori e le società* (Giuffrè 2011)

Ferrara Jr. F, *La teoria giuridica dell'azienda* (Giuffrè 1982)

Fisher B, *Mbreti Zog dhe përpjekja për stabilitet në Shqipëri* (Shtëpia Botuese “Çabej” 2004)

Fjalor Shqip, “Shoqëri” <<http://www.fjalorshqip.com/>> aksesuar më 20 korrik 2020.

Frazer A C, *World History the Easy Way Volume One* (Barrons Educational Series 1997)

Freeman R E dhe Mcvea M J, “A Stakeholder Approach to Strategic Management” (2001) Darden Graduate School of Business Administration University of Virginia <<https://ssrn.com/abstract=263511>> aksesuar më 20 tetor 2020

Galgano F (përktheu Alban Dauti dhe Artan Fida), *E Drejta Tregtare* (Botim kompakt i Luarasi University Press 2009).

Gjata R, *Detyrimet jashtëkontraktore* (Muza 2010)

Gjata R, *E drejta civile Pjesa e Përgjithshme* (Botimet “Alpaper” 2010)

Gjeta A, “Shoqëria e thjeshtë midis Kodit Civil dhe legjislacionit tregtar” (2019) 31 Revista Avokatia

- Gjilani F, “*Shteti dhe e drejta gjatë regjimit të A. Zogut*”, në *Historia e Shtetit dhe e së Drejtës në Shqipëri, Pjesa II* (Luarasi 1997)
- Gusky D J, “*Dissolution, Forfeiture, and Liquidation of Virginia Corporations*” (1978) 12:2 *University of Richmond Law Review* 333
- Hajdari A, “*Natyra juridike e administrimit të shoqërive tregtare*” (Tezë Doktorature, Fakulteti i Drejtësisë, Universiteti i Tiranës 2019)
- Hamilton A dhe Medison J (përkthyer nga Kristaq Traja), *Letrat e Federalistit, Pjesa e parë* (Drejtësia Kushtetuese, Luarasi 2000)
- Harris R, “*The Transplantation of a Legal Discourse: Corporate Personality Theories from German Codification to British Political Pluralism and American Big Business*”, (2006) 63 *Washington & Lee Law Review* 1421
- Haskins J T, “Exit Stage Left: Getting out of Your Limited Liability Company” (ABA, 31 korrik 2013)
<https://www.americanbar.org/groups/business_law/publications/blt/2013/07/01_haskins/> aksesuar më 10 shtator 2020
- Hillman W R, “*Limited Liability in Historical Perspective*” (1997) 54:2 *Washington & Lee Law Review* 613
- Hoover B C, “*The Sea Loan in Genoa in the Twelfth Century*” (1926) 40:3 *Quarterly Journal of Economics* 495
- Humphreys A T, *Limited Liability Companies* (Law Journal Press 2003)
- Islamaj F, “*Një analizë Juridike e Shoqërive Tregtare në Kodin Civil të Periudhës së Monarkisë në Shqipëri*” (2020) 11 *Bedër Journal of Humanities (BHJ)* 33
- Islamaj F, “*Regjimet pasurore martesore sipas Kodit të Familjes*” (Punim shkencor, Shkolla e Magjistraturës 2005)
- Islamaj F, “*Vështrim krahasues i disa instituteve të shoqërive tregtare sipas kodit tregtar të vitit 1932 dhe ligjit aktual “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare në Shqipëri”* (2020) 1 *Revista Juridike Shkencore “Jeta Juridike”*

- Jan Vossestein G, *Modernization of European Company Law and Corporate Governance* (Kluwer Law International 2010)
- Jensen C M dhe Meckling H W, “*Theory of the firm: Managerial behavior, agency costs and ownership structure*” (1976) 3 *Journal of Financial Economics* 305
- Karic F, *Studime për të drejtën e sheriatit dhe institucionet* (Shtëpia Botuese “Logos-A” 2015)
- Kathryn Rudie Harrigan, *Strategies for Joint Ventures* (Lexington Books 1985)
- Kromiçi A, “*Qeverisja e mirë e shoqërive tregtare në tregun financiar jobankar dhe kontrolli publik i tyre*” (Tezë Doktorature, Fakultetit të Drejtësisë në Universitetin e Tiranës 2015)
- Laffi U, “*Colonie e municipi nello stato romano, 2007*” (2008) 77 *L’Antique Clasique* 710
- Lamani A, *Procedura Civile e Republikës Popullore të Shqipërisë* (Universiteti Shtetëror i Tiranës 1963)
- Lopez S R dhe Raymond W I (përkthyes), *Medieval Trade in the Mediterranean World: Illustrative Documents* (Columbia University Press 1955)
- Malaurie P dhe Aynes L, “*Les biens*” *Le Biens* (botim i dytë, Botimet “Defrenois” 2005)
- Malltezi A, *E drejta shqiptare e shoqërive tregtare* (Shtëpia botuese “Mediaprint” 2011)
- Malltezi A, Rystemaj J dhe Kromiçi A, *Gjykatat Shqiptare mbi shoqëritë dhe veprimtarinë tregtare* (Shtëpia botuese “Mediaprint” 2015)
- Malltezi A, Rystemaj J dhe Pelinku L, *Aspekte të së drejtës së biznesit në Shqipëri* (Shtëpia botuese “Mediaprint” 2013)
- Mamuti A, “*Përgjegjësia Juridike Civile Për Shpërblimin e Dëmit në Maqedoni*” (Tezë Doktorature, Departamenti i së Drejtës Civile Fakulteti i Drejtësisë Universiteti i Tiranës 2013)
- Mandro A, *E drejta romake* (Emal 2007)

- Martín-Casals M dhe Papayannis M D, *Uncertain Causation in Tort Law* (Cambridge University Press 2016)
- Micklethwait J dhe Wooldridge A, *The Company: A Short History of a Revolutionary Idea* (Modern Library 2005)
- Ministria e Drejtësisë, *Kodi Civil i vitit 1929* (Botimet “Toena” 1998)
- Moçka L (përkthyes), *Kodi Civil Italian* (Dudaj 2014)
- Montanari M, *Impresa e responsabilità. Sviluppo storico e disciplina positive* (Giuffrè 1990)
- Morina I (editor), *Fjalori Juridik* (Akademia e Drejtësisë së Kosovës 2019)
- Morina S, “*Kriteret dhe kushtet që duhet të plotësohen për caktimin e përgjegjësisë civile për dëmin jashtëkontraktor në Republikën e Shqipërisë dhe Republikën e Kosovës*” (Tezë Doktorure, Shkolla Doktorale Universiteti European i Tiranës 2017)
- Nathanaili A dhe Biçoku N, *E drejta civile e Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë, Pjesa e përgjithëshme 2* (Universiteti i Tiranës “Enver Hoxha” 1987)
- Nathanaili A, *E drejta Civile në Republikën Popullore të Shqipërisë - Pjesa e përgjithëshme* (Kurs leksionesh 1974)
- Nuni A, *E drejta Civile, Pjesa e përgjithëshme* (Tiranë 2012)
- OECD, “Kodin Etik të Qeverisjes së Korporatave dhe Parimet e mireqeverisjes së korporatave të OECD-së” <<http://www.oecd.org/corporate/principles-corporate-governance/> marrë online datë 17.12.2020> aksesuar me 19 shtator 2020
- Olldashi E, *E drejta Romake: Cikël leksionesh* (2011)
- Omari L dhe Anastasi A, *E drejta Kushtetuese* (Shtëpia Botuese ABC 2008)
- Patterson L J, “The Development of the Concept of Corporation From Earliest Roman Times To A.D. 476” (1983) 10:1 The Accounting Historians Journal 87

- Qendra Kombëtare e Biznesit (Drejtoria e Analizës dhe Regjistrave) Kthim përgjigjeje në format elektronik dt. 16.10.2020 sipas kërkesës së autorit të këtij punimi të paraqitur pranë QKB me Nr. 8640 prot., datë 24.09.2020
- QKB, “Kërko për statusin e aplikimit të subjektit” <<https://qkb.gov.al/kerko/kerko-ne-regjistrin-tregtar/kerko-per-statusin-e-aplikimit-te-subjektit/>> aksesuar 30 nëntor 2020
- QKB, “Kërko” <<http://qkr.gov.al/kerko/kerko-ne-regjistrin-tregtar/kerko-per-subjekt/>> aksesuar më 14 tetor 2020
- Ruxho F, “*Sfidat e bizneseve shqiptare në tregun e ardhshëm europian*” (Tezë Doktorure, Shkolla Doktorale Universiteti Europian i Tiranës 2018)
- Salem Y M, *Islamic Commercial Law* (Wiley Finance 2006)
- Sapuan M N, “*An Evolution of Mudarabah Contract: A Viewpoint from Classical and Contemporary Islamic Scholars*” (2016) 35 *Procedia Economics and Finance* 349
- Scheidel W, Morris I dhe Saller P R (Editor), *The Cambridge Economic History of the Greco-Roman world* (Cambridge University Press 2007)
- Selmani B dhe Rexhepi B, *E drejta romake: ndikimi i saj në sistemet e së drejtës bashkëkohore* (Ferizaj 2014)
- Shegani A, Islamaj F dhe Pjetërnika Y, “Regjimet martesore postmartesore dhe impakti ndaj tyre prej përgjegjësisë penale të subjekteve tregtare” në Argita Malltezi, Jonida Rystemaj dhe Armela Kromiçi (editor) *Të drejtat e grave mbi shoqëritë tregtare që janë pjesë e bashkësisë ligjore* (Albas 2018)
- Shenkman M M, Weiner S dhe Taback I, *Starting a Limited Liability Company* (2nd edition, Wiley 2003)
- Shqipëria më 1937: Veprimi shtetnor gjatë njëzet e pesë vjetëve të parë të vetqeverrimit, vëllimi I* (Luarasi 1937)
- Sjåffjell B, “Environmental Piercing of the Corporate Veil The Norwegian Supreme Court Decision in the *Hampel Case*” (2010) 7:4 *European Company Law* 154-160

- Spoor A, “*Revocation of liquidation possible?*” (Baker McKenzie Netherlands, 31 korrik 2012) aksesuar më 10 dhjetor 2020
- Stephen A Ross, “The economic Theory of agency: The principal’s problem” (1973) 63:2 The American Economic Review 134
- Stipceviç A, “*Iliret, historia, jeta, kultura, simbolet e kultit*” (Toena 2002)
- Tafaj K F dhe Cinari S, *Zgjidhjet Alternative të Mosmarrëveshjeve* (Shtëpia botuese “Albas” 2015)
- Terex Solutions Inc, *Self Directed IRA LLC* (Terex Solutions 2010)
- Toth G A, *The oxford Encyclopedia of European Community Law: Institutional Law Volum I* (Oxford University Press 2005)
- Tutulani S M, *E drejta e detyrimeve dhe kontratave: pjesa e përgjithshme dhe pjesa e posaçme* (Real Stamp 2016)
- Udovitch L A, “At the Origins of the Western Commenda: Islam, Israel, Byzantium?” (1962) 37:2 Speculum – A Journal of Medieval Studies 198
- Udovitch L A, *Partnership and Profit in Medieval Islam* (Princeton University Press 1970)
- Vandekerckhove K, *Piercing the Corporate Veil* (Kluwer Law International 2007)
- Vendime të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë 2010* (Shtypshkronja “ILAR” 2010)
- von Gierke F O, *Community in Historical Perspective, A Translation of selections from Das Deutche Genossenschaftsrecht* (Cambridge University Press 2000)
- Watson A, *Roman Law & Comparative Law* (University of Georgia Press 1991)
- Watson A, *The Law of Obligations in The Later Roman Republic* (Clarendon P 1965)
- Weber M (përkthyes Frank H Knight), *General Economic History* (Greenberg 1927)
- Weber M (përkthyes Lutz Kaelber), *The History of Commercial Partnerships in the Middle Ages* (Rowman & Littlefield Publishers 2002)

Xhoxhaj A, *Gjykimi i çështjeve që lidhen me organizimin dhe funksionimin e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar* (Tezë doktorature, Fakulteti i Drejtësisë Universiteti i Tiranës 2012)

Zaganjori X, Anastasi A dhe Çani M E, *Shteti i së Drejtës në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë* (Shtëpia Botuese “Adelprint” 2011)

Zimmermann R, *The Law of Obligations: Roman Foundations of the Civilian Tradition* (Oxford University Press 1996)